

ENVER HOXHA

VEPRA

8

PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

ENVER HOXHA

VEPRA

**HOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE
SHQIPERISE**



ENVER HOXHA

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE - LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

ENVER HOXHA

VËLLIMI

8

JANAR - DHJETOR 1951

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»
TIRANË, 1971

PARATHËNJE PËR VËLLIMIN 8

Vëllimi i 8-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përfshin shkrime të vitit 1951. Ndër këto shkrime janë: Raporti në Plenumin IX të KQ të PPSH «Mbi gjendjen politike dhe punën e Partisë», Raporti po në këtë Plenum «Mbi gabimet dhe të metat e Tuk Jakovës», Fjala në Plenumin e Jashtëzakonshëm për çështjen e kolektivizimit të bujqësisë, Raporti në Plenumin XI të KQ të PPSH «Mbi direktivat e planit të parë pesëvjeçar 1951-1955».

Veprat e kësaj periudhe kanë shërbyer si një armë e fuqishme për të kapërcyer pengesat e vështirësitë në gjendjen e rëndë të viteve 1949—1951 që u krijua nga sulmet dhe presionet e forta të imperialistëve me imperializmin amerikan në krye, në bashkërendim me monarko-fashistët grekë dhe revizionistët jugosllavë kundër Republikës Popullore të Shqipërisë, të rrethuar gjeografikisht nga çdo anë. Këto vepra i kanë orientuar në rrugë të drejtë komunistët dhe punonjësit shqiptarë, nuk e kanë lënë Partinë të bjerë në gabime të rënda e të pandreqshme, e kanë ndihmuar atë të ndjekë rrugën e vet revolucionare marksiste-leniniste në mënyrë konsekuente.

Shkrimet e këtij vëllimi përqëndrohen veçanërisht

në kuptimin dhe zhvillimin e drejtë të luftës së klasave, në kuptimin dhe zbatimin e drejtë të politikës së kolektivizimit të bujqësisë në kushtet konkrete të vendit, në udhëheqjen politike të ekonomisë nga ana e Partisë.

Përpara presionit të fortë që ushtronin armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm të klasës, Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli shqiptar qëndronin dhe luftonin me heroizëm për ndërtimin e bazave të socializmit; megjithatë pati disa komunistë, midis të cilëve edhe Tuk Jakova, anëtar i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të PPSH, që u gjunjëzuan përpara këtij presioni.

Duke zbuluar shkaqet e një gjunjëzimi të tillë dhe duke e dënuar oportunizmin e Tuk Jakovës, shoku Enver Hoxha e mësonte Partinë të mos mendonte kurrë se klasat e përmbysura do të hiqnin dorë nga përpjekjet e tyre për të rifituar privilegjet e humbura, e mobilizonte atë për t'i prerë rrugën çdo prirjeje dhe shfaqjeje pajtimi me armikun e klasës. Njëkohësisht ai kërkonte të mos kalohej në veprime arbitrare, sektare që çonin në ashpërsimin artificial të luftës së klasave, nga i cili nxirrnin përfitim vetëm armiqtë.

Në luftën për kolektivizimin e bujqësisë, ai argumentonte domosdoshmërinë e mbajtjes kurdoherë parasysht të kushteve objektive e subjektive në plotësimin e kësaj detyre të madhe, theksonte drejtësinë e politikës së Partisë në kushtet konkrete të ecjes përpara në rrugën e shndërrimit socialist të fshatit me hapa të matur, duke vënë theksin në atë kohë të forcimi i kooperativave bujqësore të pranishme, të shfrytëzimi i të gjitha mundësive të ekonomisë së vogël fshatare për rritjen

e prodhimeve bujqësore dhe jo te zgjerimi i kolektivizimit. Shoku Enver Hoxha në Plenumin e Jashtëzakonshëm të Komitetit Qendror të Partisë (14 maj 1951) argumentoi nevojën e ndreqjes së vendimit të shpejtuar të Plenumit X të KQ të PPSH (9—10 prill 1951) për të kaluar në kolektivizimin në masë të bujqësisë, vendim që përmbante në vetëvete rrezikun e komprometimit të kolektivizimit.

Në gjendjen e koklavitur dhe të ashpërsimit të madh të luftës së klasave, që karakterizonin vitet 1949—1952, vendimtare ishte, mësonte shoku Enver Hoxha, forcimi i unitetit ideologjik dhe organizativ të Partisë, por sidomos përmirësimi i metodës së punës. Ai kërkonte të luftohej kundër shtrembërimeve burokratike, të forcohej udhëheqja kolegjiale, të shtohej kërkesa e llogarisë ndaj komunistëve dhe sidomos ndaj anëtarëve të organeve udhëheqëse të Partisë. Komitetet dhe organizatat bazë të Partisë duhej të përmirësonin metodën e udhëheqjes politike të ekonomisë, pasi në këtë fushë ato kishin ende pak përvojë dhe bënë shpesh punën që u takonte organeve të pushtetit popullor e të ekonomisë.

Materialet e këtij vëllimi kanë qenë një kontribut i madh në përgatitjen e Partisë për Kongresin II të saj që u mbajt më 31 mars — 7 prill 1952.

DISA ÇËSHTJE PËR PUNËN ME KUADRIN

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

12 janar 1951

Ndryshimi që po bëjmë për riorganizimin e Drejtorisë së kuadrit në aparatit e Komitetit Qendror është i drejtë, veçse këtë duhet ta zbatojmë mirë në praktikë. Deri në një farë shkalle unë jam dakord me pikën e parë të projektvendimit ku thuhet se Partia ka bërë një punë mjaft të madhe me kuadrin për kalitjen dhe

¹ Byroja Politike në këtë mbledhje vendosi që Drejtoria e kuadrit pranë KQ të PPSH dhe seksionet e kuadrit pranë komiteteve të Partisë në rrethe të shkriheshin. Funkcionet e tyre t'i kryenin drejtoritë dhe seksionet e tjera të aparatit të Komitetit Qendror dhe të komiteteve të Partisë në rrethe për vetë kuadrot e sektorëve të tyre. Në Drejtorinë e organeve të Partisë, rinisë e bashkimeve profesionale pranë KQ të Partisë të krijohej seksioni i kuadrit, ndërsa në rrethe të krijohej zyra e regjistrimit të kuadrit, që do të lidhej me seksionin përkatës të Drejtorisë së organeve të Partisë, rinisë e bashkimeve profesionale pranë KQ të Partisë. Më 1966, me shkurtimin e organeve, pa përjashtuar nga detyrat dhe përgjegjësia për çështjet e kuadrit sektorët e tjerë, në aparatit e KQ të PPSH dhe të komiteteve të Partisë në rrethe u krijua sektori i kuadrit.

edukimin ideologjik të tij dhe patjetër që kemi përmirësime dhe suksese, por në këtë drejtim kemi edhe mjaft dobësi. Një nga këto dobësi është se puna me kuadrin është parë vetëm në lëvizjen e njerëzve, sikur çdo gjë konsiston vetëm në këtë. Kjo s'është e tëra. Kryesorja është ndjekja në jetë e punës së tyre, si punojnë, ç'bëjnë për edukimin e tyre etj. dhe verifikimi në praktikë nëse është vënë secili në vendin e përshtatshëm apo jo. Natyrisht, edhe në këtë drejtim është punuar, por jo aq sa duhet, prandaj ka akoma shumë të meta.

Me këtë formë të re organizimi çdo drejtori duhet të kujdeset vetë për çështjen e kuadrit. Kjo gjë nuk duhet parë vetëm nga ana e lëvizjes horizontale ose vertikale të kuadrove, por edhe nga mënyra se si të zbatohen vendimet e Komitetit Qendror e të qeverisë. Ato duhet të kontrollojnë e të ndihmojnë për ngritjen ideologjike të kuadrove, duke përdorur të gjitha format që janë caktuar për këtë qëllim nga ana e Partisë ose e shtetit. Për zbatimin e këtyre vendimeve Komiteti Qendror do t'i kërkojë llogari Sekretariatit dhe ky i fundit drejtorive të aparatit të Komitetit Qendror. Prandaj interesimi për kuadrin duhet të jetë që nga lart e deri te instruktorët, të cilët duhen porositur që ta marrin mirë në dorë këtë punë dhe të zbatohen deri në fund vendimet përkatëse. Kjo, domosdo, do të kryhet me sukses po qe se do të përpiqet secili me të gjitha mundësitë për t'u bërë një specialist i mirë për detyrën e ngarkuar që, kur të shkojë poshtë, në bazë, të mos kalojë si ndonjë vizitor, por të kontrollojë mirë zbatimin e vendimeve.

Dua të them edhe disa fjalë për drejtorët e drejtorive të aparatit të Komitetit Qendror, për zëvendësit e tyre dhe për shokët instruktorë. Puna që ata kanë bërë deri tani me kuadrot e sektorëve të tyre nuk ka qenë aq e kënaqshme dhe kjo konsiston në atë që ata nuk i kanë ndjekur vendimet në procesin e zbatimit të tyre. Përsa u përket instruktorëve, atyre nuk u hiqet veshi për të metat e punës së tyre. Me këtë dua të them se mos krijohet në ta pikëpamja që «ne jemi vetëm për të parë dhe për të kritikuar të tjerët». Prandaj edhe puna e tyre duhet të kontrollohet pak më mirë dhe nuk është e mjaftueshme që ata vetëm të dëgjohen, por edhe të kontrollohen e, kur gabojnë, të ndihmohen ose të merren masa sipas rastit. Instruktorët, që shkojnë poshtë në bazë, ashtu si edhe për problemet e tjera, kur kthehen duhet të na thonë edhe si shkon problemi i kuadrit atje, pse kështu edhe ne do ta kemi të lehtë për të marrë masa të drejta e në kohë, pse për çështjen e kuadrit ne duhet të rrahim vazhdimisht mendime me qëllim që puna të na shkojë mbarë. Shokët drejtorë duhet të shkojnë më dendur poshtë në bazë që të njohin mirë njerëzit në punë, pse kështu do të verifikohen më mirë edhe raportet e instruktorëve nëse janë të plota e të drejta apo jo.

Një problem tjetër me rëndësi lidhur me këtë vendim është edhe çështja e konspiracionit. Tani me problemin e kuadrove do të merren më shumë njerëz, prandaj ata duhet të vihen përpara përgjegjësisë që të ruajnë mirë konspiracionin dhe çështja e kuadrit të mos bëhet muhabet pazari, pse po u bë kështu, do ta dëmtojme Partinë. Në këtë drejtim duhet pasur kujdes dhe

të ketë vazhdimisht kontroll e të goditet çdo simptomë e dekonspirimit.

Kjo formë organizimi e punës me kuadrin mendoj se është e përshtatshme për kushtet tona të sotme, vetëm se tani duhet të mobilizohemi që ky vendim që marrim të zbatohet mirë. Duke kryer këtë riorganizim kam bindjen se çështja e kuadrit në të ardhshmen do të na shkojë akoma më mirë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

**TELEGRAM URIMI DËRGUAR
SHOKUT VILHELM PIK ME RASTIN E
75-VJETORIT TË DITËLINDJES**

SHOKUT VILHELM PIK

Berlin

Me rastin e 75-vjetorit të ditëlindjes Suaj, më lejoni t'Ju shfaq në emër të Komitetit Qendror të PPSH dhe në emrin tim personal përshëndetjet më të përzemërta nga ana e komunistëve dhe gjithë popullit shqiptar.

Komiteti Qendror i PPSH ju uron Juve, militant i palodhur i lëvizjes punëtore gjermane, jetë të gjatë dhe shëndet të plotë për lumturinë e popullit gjerman dhe për bashkimin e Gjermanisë demokratike kundër planeve të luftënxitësve imperialistë, që përpiqen ta hedhin popullin gjerman në një luftë të re.

Ne përshëndesim përzemërsisht luftën që bën populli paqedashës i Gjermanisë demokratike kundër luftënxitësve imperialistë, për paqen, demokracinë dhe socializmin përkrah popujve të të gjithë botës nën udhëheqjen e flamurtarit të pathyeshëm të paqes dhe

të socializmit, Bashkimit të madh Sovjetik dhe Stalinit të madh.

Enver Hoxha

Sekretar i Përgjithshëm i Partisë
së Punës të Shqipërisë

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 2 (707), 3 janar 1951*

*Botohet sipas tekstit të gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 2 (707),
3 janar 1951*

**TELEGRAM PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR
KQ TË PK ITALIANE ME RASTIN E 30-VJETORIT
TË FORMIMIT TË SAJ**

21 janar 1951

**KOMITETIT QENDROR TË PARTISË KOMUNISTE ITALIANE
SHOKUT PALMIRO TOLIATI**

R o m ë

Me rastin e 30-vjetorit të formimit të Partisë Komuniste Italiane ju dërgojmë përshëndetjet më të nxehta të Partisë së Punës të Shqipërisë, të Komitetit Qendror dhe të miat personale. Partia Komuniste Italiane e udhëhequr nga mësimet e Leninit e të Stalinit ka ditur të korrë fitore të mëdha në luftën e saj heroike për të drejtat e klasës punëtore dhe të masave punonjëse, për liritë demokratike dhe për kauzën e paqes e të socializmit. Partia e Punës e Shqipërisë dhe gjithë populli shqiptar përshëndetin nga zemra këto fitore të Partisë Komuniste Italiane dhe i urojnë suksese të reja në luftën kundër luftënxitësve amerikanë dhe anglezë e veglave të tyre të brendshme që mundohen ta hedhin popullin italian në një kasaphanë të re. Urojmë nga

zemra fitore të reja në luftën që bën populli italian për forcimin e gjithë kampit të paqes e të demokracisë që kryesohet nga Bashkimi i lavdishëm Sovjetik dhe Stalini i madh.

Për Komitetin Qendror të Partisë
së Punës të Shqipërisë

Sekretari i Përgjithshëm

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 19 (724), 23 janar 1951*

*Botohet sipas tekstit të gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 19 (724),
23 janar 1951*

TË NJOHIM MIRË GABIMET DHE TË METAT NË REALIZIMIN E PLANIT DYVJEÇAR QË ATO TË MOS PËRSËRITEN NË PLANET E ARDHSHME

Nga diskutimi në mbledhjen e Qeverisë së RPSH¹

22 janar 1951

Unë mendoj se konkluzionet që nxorën shokët nënkryeministra në diskutimet e tyre janë plotësisht të drejta dhe këto duhet të shërbejnë jo vetëm për ministrat, por për gjithë aparatën e shtetit për t'u thelluar edhe më tej në këto vërejtje e konkluzione dhe për të marrë masat e duhura për të ardhshmen.

Konstatohet edhe një gjë tjetër: kjo mbledhje e qeverisë ka pasë një anë pozitive, pse u vunë re diskutime me frymë të lartë kritike dhe autokritike, pra në këtë drejtim ka një përparim. Një punë që bëhet mbi bazën e kritikës dhe të autokritikës patjetër jep rezultate.

Pasqyra dhe krahasimet me 1948-n që na paraqiti këtu shoku Koço Theodhosi janë inkurajuese dhe duken përpjekjet e mëdha të Partisë e të njerëzve që i janë

¹ Në këtë mbledhje u analizuan sukseset dhe të metat mbi realizimin e planit dyvjeçar.

përveshur punës, por ne jemi akoma prapa me problemet që na ka ngarkuar Komiteti Qendror, prandaj nuk duhet të jemi të kënaqur me punën tonë pse, në realitet, planin nuk e kemi realizuar e sidomos në disa sektorë të rëndësishëm.

Ne morëm angazhim para Komitetit Qendror që planin dyvjeçar ta realizonim, po nuk e kemi përmbushur atë. Kjo ka ardhë kryesisht nga çrregullimet subjektive dhe dezorganizimi në punë.

Komisioni i Planit të Shtetit ka bërë përpjekje të mëdha për ta vënë drejt çështjen e planit. Hapa përpara janë bërë edhe sa i përket metodologjisë, ajo që kemi vendosur nuk ka gabime. Vetëm se sa zbatohet dhe si ndihmohet për realizimin e planit nga dikasteret e tjera, kjo varet nga puna që bëhet, pse po të ketë konfuzion, patjetër, edhe metodologjia e drejtë shtrembërohet. Nuk mundet Komisioni i Planit të dalë me gjëra të sakta, në rast se çdo ministri nuk vë të gjithë kujdesin në çështjet që përbëjnë hartimin e planeve të tyre. Këtyre çrregullimeve duhet t'u vëmë fre dhe këto gjëra që na ngjasin nga pakujdesia, nga mungesa e kontrollit etj., duhet medoemos të marrin fund. Në rast se nuk do t'u japim fund këtyre gjërave, ne nuk kemi zbatuar drejt vijën e detyrat që na ka ngarkuar Partia e Komiteti Qendror.

Nuk është e pranueshme të thuhet që janë paguar 2 milion lekë për 350 voza, të cilat janë harruar dhe kanë 4 muaj që rrinë pa u shfrytëzuar. A respektohet këtu disiplina e planit? Në qoftë se nuk ndiqen problemet si duhet, nuk ka zbatim plani, nuk ka disiplinë plani, prandaj duhet të merren masa serioze. Këto gjëra

na vënë përpara përgjegjësisë para Komitetit Qendror, Partisë dhe popullit.

Unë konstatova se në diskutimet nuk u ngrit çështja e mungesës së materialeve, gjë që dikur na ngrihej përpara si shkak kryesor për mosrealizimin e planit. Kjo tregon se në këtë drejtim është punuar më mirë. Nga ana tjetër transporti, si një faktor me rëndësi, nuk e ka penguar realizimin e planit. Transporti e ka realizuar planin e vet dhe, po të ishin korrekte dikasteret e tjera, do ta realizonte edhe më shumë atë. Këtu meriton të vihet në dukje puna organizative e këmbëngulëse e shokut Shefqet Peçi.

Komisioni i Planit është një nga organet e Këshillit të Ministrave, ai duhet të zbatojë ato që janë vendosur dhe të mos lëshojë asnjë grimë mbi çështjet që ka vendosur qeveria.

Unë jam i mendimit se Ministria e Financave ka punuar mirë. Aty vihet re një kuptim i drejtë për lekun e shtetit. Por kontrolli financiar duhet të jetë më i rreptë e të mos bëhen lëshime nga ana financiare. Gjithë aktiviteti ekonomik të mbahet nën një presion të shëndoshë. Këtej varet që financat tona të ngrihen, të mos ketë vjedhje etj. Këtë duhet ta kemi të qartë të gjithë ne. Kontrolli i Shtetit e ka kryer mirë punën. Shokët që punojnë atje e kanë kuptuar mirë funksionin e planit dhe kanë bërë përparime; shoku Manush [Myftiu] ka ndihmuar që Kontrolli i Shtetit të forcohet e të ecë në rrugën e drejtë. Komisioni i Planit, Ministria e Financave dhe Kontrolli i Shtetit duhet të jenë rigorozë, të mos lëshojnë, të jenë të ashpër për zbatimin e planit dhe të zbulojnë dëmtuesit e pasurisë së popullit.

Çështja e bujqësisë është me rëndësi. Njerëzit aty bëjnë përpjekje për ta gjetur hallkën e problemit, pse duhet të gjesh rrënjët nga të ngresh degët. Në bujqësi po fillohet të punohet në këtë drejtim. Bujqësia jonë ka probleme të mëdha dhe për këto duhen bërë studime. Ministria e Bujqësisë u është futur këtyre studimeve.

Vendi ynë është bujqësor. Këto gjëra që na ngjasin lidhen me ligje ekonomike. Bujqësia ka një sërë problemesh që janë të lidhura me industrinë, me masat punojëse të qyteteve. Unë mendoj se të gjitha urdhëresat që kemi nxjerrë në lidhje me marrëdhënjet bujqësi-industri janë të drejta dhe situata në vendin tonë ka qenë e përshtatshme që këto të viheshin në zbatim. Zbatimi i urdhëresave të drejta ka raste që nënvleftësohet, nuk i zbatojmë drejt ato, sepsë nuk i mbështetim me gjithë masat e nevojshme. Ne duhet të studjojmë se a e kemi ndihmuar sa duhet sektorin e bujqësisë apo jo, pse kam mendimin që ndihmë i kemi dhënë, por jo sa duhej t'i jepnim. Në rast se rendimentet nuk i studjojmë mirë, nuk vendosim kadastrën, në rast se nuk zbatojmë drejt urdhëresat që kanë të bëjnë me marrëdhënjet midis shtetit dhe fshatit, atëhere e varfërojmë fshatin, largohemi nga baza, prandaj duhet të shtojmë ndihmën tonë në këtë drejtim.

Për ndihmën në drejtim të bujqësisë duhet të bëjmë një kthesë, të madhe e të rëndësishme; bonifikimit të tokave; punimit me traktor etj., duhet t'u japim një rëndësi të madhe dhe të zbatohen drejt urdhëresat që kemi nxjerrë. Po ta rrethojmë katundarin me një kujdes të tillë, ne do të mund të shpejtojmë dhe kolektivizimin.

Forcën motorike duhet ta shtojmë, por në rast se

marrim edhe masa të tjera, mund të bëjmë edhe me një numër më të vogël traktorësh. Me një kujdes më të mirë një shumicë kooperativash kanë përmirësuar jetën e tyre. Në të ardhshmen të tilla do të kemi edhe më shumë.

Gjithashtu edhe për pyjet ka përparime, por duhet ta ndjekim më shumë këtë problem. Të gjitha sa u folën këtu për pyjet, duhet të ndiqen, pse pyjet janë një pasuri e madhe.

Sa i përket tregëtisë, jam dakord me të gjitha vërejtjet që bënë shokët. Duhet të kemi shumë kujdes, pse ajo ka lidhje me masat e gjera të popullit. Lëshime e shkelje vije në tregëti nuk do të tolerojmë, veçanërisht ndaj njerëzve me përbërje të keqe, që punojnë në këtë sektor. Vjedhjeve dhe abuzimeve duhet t'u japim fund. Pra, po nuk u vumë rëndësi çështjeve financiare, punët atje nuk do të shkojnë mirë. Për të gjitha këto kemi përgjegjësi të rëndë; çështjen e kontrollit të zbatimit të vendimeve nuk e kemi ndjekur si duhet; kjo vjen, ndoshta, se mund të ketë dhe një farë familjariteti në mes kuadrove, që shfaqet dhe në detyrë. Në detyrë të mos lejojmë familjaritet. Kur të japim llogari para Komitetit Qendror, në rast se kemi bërë gabime, të na dridhen këmbët.

Përsa u përket ndërtimeve, edhe këtu ka përparime, megjithëse ka pasur punë armiqësore, pse në këtë sektor punojnë dhe elementë që nuk janë me ne. Por mua më duket se në raport ka pasur tendenca që të tregohet se plani është realizuar, por plani duhet të realizohet në të tërë zërat. Duhet me u ruejt, duhet me qenë ekzakt. Normat, disiplina financiare dhe kontrolli në punë do të bëjnë që të realizohet plani. Çështjen e

koston së shtëpive ne ja ngarkuam Ministrisë së Ndërtimit. Ajo duhet ta studjojë dhe të na paraqesë ndryshimet që duhen bërë, pse në punë e sipër do të spastrojmë kalbësirat.

Ministria e Industrisë duhej ta kishte realizuar e tejkaluar planin. Këpucët nuk u bënë, fajin e ka industria, po ashtu edhe për sharrat e për panxharin e sheqerit etj.

Industria lokale nuk duhet të nënvleftësohet, përkundrazi t'i vihet rëndësi e madhe. Këtë problem na e ka vënë përpara Komiteti Qendror. Në industri këto gjëra duhet të zhduken. Të zbatohen si duhet vendimet e qeverisë. Ndryshime nuk duhet të bëhen, por çdo ministër ka të drejtë të bëjë vërejtjet e tija, propozime etj. Vetëm qeveria mund ta lëvizë planin. Problemi i minierave është shumë i gjerë. Ky sektor nuk ka realizuar planin. Kjo gjë duhet ta bëjë si ministrin përkatës ashtu edhe qeverinë të mos i zërë gjumi. Këto pësime duhet të na bëhen mësim. Në naftë kemi pasur humbje të mëdha. Situatës, që ka qenë gjatë këtyre dy vjetëve, duhet t'i japim fund. Qeveria të kontrollojë zbatimin e vendimit të Byrosë Politike dhe të bëjë të gjitha përpjekjet ta furnizojë këtë sektor me materialet e nevojshme. Edhe këtë vit atje ka një fillim të keq. Po të vazhdojë kështu, do të kemi konsekuenca të këqia, do të kërkohet që të ndërrojmë planin, por këtë nuk do ta pranojmë. Nafta është prodhimi ynë kryesor; po aq me rëndësi janë edhe mineralet e tjera, prandaj duhet të shtojmë përpjekjet, pse i kemi mundësitë që t'i realizojmë planet në këtë sektor.

Edhe për çështjen e fuqisë punëtore, përpjekjet

kanë qenë të mëdha, por nuk është bërë sa duhet për sigurimin e banesave të punëtorëve. Aty ku kemi perspektiva për shtimin e prodhimit, duhet të marrim masa për ndërtimin e banesave.

Shokët kanë ngritur mjaft probleme, të cilat mendoj se mund t'i shikojmë në Kryesi dhe mbasandaj t'i dalim qeverisë me propozime. Me pak fjalë unë mendoj që të gjithë ne, para kësaj situatë, duhet të bëjmë autokritikë dhe kjo frymë të kalojë edhe në shokët e tjerë. Të ringjallet puna jonë kudo. Përpara kemi planin pesë-vjeçar, për hartimin e të cilit, me ndihmat që na janë siguruar, kemi baza të shëndosha.

Nga ana tjetër duhet të mos harrojmë situatën politike të jashtme e të brendshme. Imperializmi ditaditës po përgatitet për luftë. Armiqtë na kanë rrethuar e po bëjnë përpjekje për ta sulmuar popullin tonë. Ata po organizojnë komplete e po mobilizojnë armiqtë e popullit që të na luftojnë. Këtë rrezik mos ta harrojmë asnjë sekondë, por të jemi të gatshëm dhe detyrat t'i kryejmë mirë. Kësaj situatë duhet t'i qëndrojmë heroikisht. Populli të jetë përgatitur politikisht dhe ekonomikisht etj. Të mos na zërë gjumi. Nga të gjitha këto që thamë varet jeta e popullit tonë. Edhe për lëshimin në të vogël të na vrasë ndërgegjja dhe t'i ndreqim menjëherë të metat. Të bëhet kudo një punë luftarake. Të kritikohen e të ndihmohen njerëzit. T'i edukojmë ata me të gjitha armët që na i jep Partia.

Çështja e kuadrit është problem me rëndësi të veçantë, pse kuadrot i kemi të ulët, nuk kemi sa duhet etj. Pse vijnë këto? Unë mendoj se këto vijnë nga një e metë e madhe e disa shokëve që janë bërë praktikienë

dhe harrojnë të mësojnë, të studjojnë. Studimi nuk është një problem i thjeshtë. Jam i sigurtë se ka shokë që nuk hapin libra të studjojnë marksizëm-leninizmin, pa le libra teknike. Komunistët armatosen me këtë teori dhe dinë bazat teorike të çështjeve, por, po nuk e zbatuan teorinë në praktikë, nuk do të dinë të luftojnë deviacionet etj. Ka shokë që po t'i pyesësh se sa lexojnë — del se nuk lexojnë. Material ka plot, por nuk shfrytëzohet. Duhet t'i japim fund kësaj gjendjeje. Komiteti Qendror do të çaktojë edhe rregulla, por edhe çdonjëri duhet ta marrë studimin më me seriozitet. Kohën për të studjuar të paktën një orë e gjysmë në ditë mund ta gjejë kushdo. Edhe studimi është nevojë e domosdoshme, pa këtë nuk ecën puna përpara. Këtë të metë duhet ta luftojmë. Kjo do të na vërë në rrugën e drejtë.

Të gjitha këto që u thanë në këtë mbledhje më duket se përbëjnë esencën e atyre që kërkohet të bëjë qeveria.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Qeverisë
së RPSH që gjendet në Arkivin
e Këshillit të Ministrave
të RPSH*

MBI PËRMIRËSIMIN E MËTEJSHËM TË GJENDJES EKONOMIKE NË FSHAT

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të
KQ të PPSH¹*

16 shkurt 1951

Mendimi im është se studimi që na paraqiti shoku Mehmet do të na shërbejë të marrim masa për të përmirësuar jo vetëm gjendjen e fshatarësisë, po edhe atë të popullsisë së qyteteve. Ky është vërtet një studim për çështjen fshatare, po të mos harrojmë se është i lidhur me të gjitha problemet e tjera që preokupojnë vendin tonë. Nga studimi dhe diskutimet del se fshatarësia përbën shumicën e popullit tonë dhe ajo ndihmon në një shkallë shumë të madhe për ndërtimin e socializmit. Ajo është gjithashtu burim për sigurimin e fuqisë punëtore të domosdoshme për ngritjen e industrisë si

¹ Në këtë mbledhje u shqyrtua materiall «Mbi studimin e çështjes fshatare», paraqitur nga shoku Mehmet Shehu, i cili, në krye të një grupi pune, me propozim të shokut Enver në mbledhjen e Byrosë Politike të 15 dhjetorit 1950, ishte ngarkuar të bënte këtë studim, ku trajtoheshin karakteristikat kryesore të zhvillimit të ekonomisë sonë bujqësore, forcimi i aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë, lufta e klasave në fshat, sigurimi i bukës, kolektivizimi i bujqësisë etj.

dhe për parashikimin e investimeve për të ardhshmen etj.

Një nga konkluzionet që duhet të nxjerrim nga ky studim është se situata e tanishme për fshatarësinë është ca e vështirë dhe ne duhet ta shohim mirë këtë çështje. Prej këtej dalin dy detyra: e para të marrim disa masa për ta lehtësuar fshatarin dhe e dyta, por më e rëndësishmja, është të përmirësojmë bujqësinë tonë me të cilën ai është i lidhur.

Për situatën që po kalojmë Partia duhet të kishte punuar më shumë për të mos na ndodhur gjithë këto humbje në produktet bujqësore e blegtorale. Po të kishim evituar dëmtimet dhe të kishim luftuar më me forcë kundër tyre, do të kishim bërë kursime shumë më të mëdha, gjë që do të influente edhe në industrinë tonë për të dhënë më shumë prodhim. Këto humbje janë një minus për ekonominë tonë, aq më tepër po të kemi parasysh edhe gjendjen e sotme të vështirë të fshatarësisë që edhe kjo përbën një minus tjetër. Prandaj nga ky studim Partia të përfitojë dhe nga zbatimi i detyrave që dalin prej tij, fshatarësia duhet patjetër të nxitet. E gjithë Partia duhet të bëjë përpjekje për t'i kryer këto detyra të mëdha që na dalin përpara dhe të mos harrojmë se, për t'i kryer mirë këto detyra, duhet që me fshatarët të zhvillohet një punë e gjerë politike. Gjithashtu duhet të luftojmë që lehtësitë, që do t'u krijojmë atyre, të jenë një shtytje e madhe për të shtuar prodhimin. Për këtë duhet luftuar kundër mentalitetit mikroborgjez që mund të shfaqet te ndonjëri se «tani që shteti më kërkon më pak detyrime, unë kam mjaft, prandaj të mos lodhem edhe aq shumë». Këtë

rrezik ne duhet ta kapërcejmë dhe do ta kapërcejmë, pse fshatari ynë jo vetëm që është patriot dhe e dëgjon kurdoherë Partinë, por në këto masa ai do të shikojë edhe interesin e tij. Pa dyshim puna e madhe që do të zhvillojë me të Partia, do të bëjë që ai t'i kuptojë drejt këto masa që do të marrim në favor të tij dhe ato do të japin frutet e duhura. Unë jam dakord me të gjitha masat që propozohen në këtë studim lidhur me përmirësimin e gjendjes në fshat. Ato duhet të jenë nga detyrat kryesore për Partinë, prandaj të vihen të gjitha forcat për plotësimin e tyre, pse ato do të bëjnë që të realizohet edhe plani i shtetit.

Një çështje tjetër me shumë rëndësi për përmirësimin e gjendjes në fshat është edhe ajo e kolektivizimit. Këtu ne duhet të kemi shumë kujdes, të ruajmë parimin që fshatarët të futen vullnetarisht në kooperativë, të vijnë e të thonë vetë: «Unë dua të bëhem anëtar i kooperativës». Për këtë të merren edhe masat që propozohen në studim në lidhje me bonifikimin, ujëtimin dhe përmirësimin e disa tokave. Këto masa duhet medoemos t'i zbatojmë që në planin e parë pesëvjeçar, pse vetëm kështu do ta shpiem përpara bujqësinë. Tani në Ministrinë e Bujqësisë nuk është më ajo situatë që ka qenë përpara, atje po bëhen studime të cilat janë një bazë dhe një ndihmë e mirë për Partinë për realizimin e planit të parë pesëvjeçar në sektorin e bujqësisë.

Përsa i përket lehtësimit të fshatarësisë, edhe këtë problem jam dakord që ta shohim mirë. Fshatarësia, me tokën dhe bagëtinë që disponon, ka mundësi që jo vetëm të ngrejë mirëqenjen e saj, por të japë edhe më shumë prodhime bujqësore e blegtorale për pjesën tjetër të

popullsisë sonë. Këtu u tha se mund të ulim edhe çmimet e tregut reciprok. Kjo është një ndihmë, po në këtë problem është më mirë të thellohemi si duhet që të mos na krijohet një disproporcion në të ardhurat dhe shpenzimet e fshatarëve nga një anë dhe të punëtorëve nga ana tjetër si edhe në furnizimin e qyteteve me prodhimet e nevojshme bujqësore e blegtorale.

Unë isha i mendimit që çmimet e tregut reciprok të mos jenë të njëjta me ato të tregut të garantuar, por këtë ta studjojmë mirë edhe në lidhje me të ardhurat e punonjësve të qytetit. Natyrisht, punonjësve të qytetit jeta u kërkon disa nevoja më të mëdha se sa atyre të fshatit, po duhet pasur parasysh se ka ardhur koha që edhe fshatarët nuk mund të rrinë më me gjysmopingë, prandaj të shihen mirë edhe nevojat e tyre. Derisa vendi ynë të marrë mirë veten duhet të bëhen akoma sakrifica si në qytet, ashtu dhe në fshat. E them këtë se kam përshtypjen që çmimet që propozohen, janë caktuar me hamendje, ato duhet të studjohen mirë nga ana e financave dhe e tregëtisë. Pra, mendoj se duhet të ketë diferencë midis tregut reciprok dhe atij të garantuar, pse kjo do të bëjë që fshatari të ndërrojë konceptet e të prodhojë sa më shumë. Një masë tjetër që duhet të marrim është dhe ajo që tregun reciprok ta furnizojmë më mirë, ndërsa në tregun e lirë të vihen çmime edhe më të larta.

Edhe unë jam i mendimit që koeficientet¹ t'i ulim.

¹ Është fjala për koeficientet e kulturave bujqësore sipas klasifikimit të tokave që shërbenin për të përcaktuar tatimet e ekonomive bujqësore.

por për këtë çështje të ngarkojmë shokë që ta shohin edhe një herë dhe së shpejti të bëjmë mbledhjen e Byrosë Politike për të marrë vendimet përkatëse. Çështja është që ne bukën duhet ta sigurojmë medoemos, pse është një situatë jashtëzakonisht e vështirë. Këtë vit ka pasur thatësi. Kjo situatë e vështirë na vë detyra të mëdha që planet t'i zbatojmë deri në fund, pse ato tani janë më të studjuara dhe më të drejta. Deri tani, zbatimi i tyre nuk ka qenë i mirë dhe ne si udhëheqje, si Parti kemi përgjegjësi të mëdha para popullit. Të gjithë duhet t'i vihemi mirë punës, të kemi mirë të qartë gjendjen, pse tani te ne nuk punohet më për të huajin, po për popullin; këtë gjë duhet ta kuptojë mirë në radhë të parë Partia.

Çështjen e furnizimit me mish mendoj se duhet ta zgjidhim, siç u tha këtu, duke zgjeruar dhe rrjetin e peshkimit, pse është një burim i madh furnizimi për ekonominë tonë.

Vëmendjen duhet ta përqëndrojmë edhe në kultivimin e bimëve industriale, sidomos për pambukun, pse vihet re që fshatari akoma nuk i ka hyrë si duhet kësaj kulture. Ne duhet të gjejmë rrugët për ta nxitur atë të prodhojë e t'i dorëzojë shtetit sa më shumë pambuk. Natyrisht, ai do ta bëjë këtë më mirë, kur ne ta furnizojmë atë me më shumë beze.

Si të studjohen mirë marrëdhënjet me fshatarin, duhet të punohet më mirë se ç'është punuar deri tani. Në rast se organet e tregëtisë e organizojnë me të meta tregëtinë në fshat, ashtu si deri më sot, nuk do të realizohen vendimet që po marrim. Po kështu edhe një-rëzit që punojnë në sektorin e grumbullimit duhet t'i

kryejnë mirë detyrat e tyre dhe t'i zbatojnë vendimet, ndryshe do të kemi çrregullime të mëdha në këtë sektor, jo vetëm për çështjen e bukës, po dhe për prodhimet e tjera. Më vonë, kur t'i ulim koeficientet, mundet që fshatari të ngrejë çmimin e bukës, prandaj këto probleme të studjohen e të ndiqen mirë se janë shumë serioze, pse këto janë të lidhura edhe me industrinë e me sektorë të tjerë të ekonomisë sonë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

R A P O R T

«MBI GJENDJEN POLITIKE DHE PUNËN E PARTISE»

Mbajtur në Plenumin IX të KQ të PPSH

19 shkurt 1951

I. MBI GJENDJEN E JASHTME POLITIKE

Shokë,

Partia dhe populli ynë janë të sigurtë në të ardhshmen e tyre dhe të mbarë njerëzimit. I rrethuar nga të katër anët me armiq, populli ynë në asnjë moment nuk është frikësuar ose tronditur, por çdo ditë që shkon ai e ka ndjerë veten më të fortë se kurrë, ka qëndruar i vendosur dhe ka korrur suksese në mbrojtjen e pavarësisë dhe të të drejtave të tija. Vigjilenca dhe forcimi i fuqisë mbrojtëse të vendit tonë kanë qenë dhe duhet të bëhen çdo ditë më të forta, pse Partia, udhëheqja e saj dhe populli ynë janë të ndërgjegjshëm për situatat e rënda dhe kritike nga ku kalon sot njerëzimi përparimtar.

Problemi i mbrojtjes aktive të paqes, është bërë çështje e qindra miliona njerëzve në të gjithë botën.

Njerëz të shtresave, të besimeve dhe të pikëpamjeve politike të ndryshme janë bashkuar në një kamp të fuqishëm të paqes, që rritet e forcohet çdo ditë dhe që bën të dështojnë dhe të falimentojnë orvatjet e shfrenuara dhe politika agresive e imperialistëve amerikanë dhe anglezë. Në krye të këtij kampi qëndron Bashkimi Sovjetik dhe Stalini i madh. Besimi i miliona e miliona njerëzve, që luftojnë me guxim kundër luftës dhe për vendosjen e paqes, është ipatundur.

Lufta e dytë botërore, që u solli mjerime të mëdha popujve, ishte varri për Hitlerin, Musolinin, Hiro Hiton e hordhitë e tyre gjakatare që mbuluan Evropën dhe Azinë në zi e në mjerim, por njëkohësisht ishte një katastrofë edhe për imperialistët amerikano-anglezë që nxitën agresionin e përgatitën atë kasaphanë. Imperialistët amerikanë dhe anglezë pësuan deziluzione të tmerrshme. Ata kujtuan se Bashkimi Sovjetik do të dilte i dobësuar nga lufta dhe fati i mbarë popujve do të ishte në duart e tyre. Kjo nuk mund të ngjiste dhe nuk ngjau. Triumfi i Bashkimit Sovjetik mbi forcat hitleriane dhe forcat e errëta imperialiste, u dha zemër dhe forcë popujve të mbarë botës të intensifikojnë luftën e tyre të çlirimit, për të këputur zinxhirët e tiranisë kapitaliste.

Pak vjet kanë kaluar nga mbarimi i Luftës së dytë botërore dhe përsëri njerëzimi kërcënohet nga imperialistët amerikanë, me një luftë të re, akoma më të egër dhe më të tmerrshme se ato dy të parat. Imperialistët amerikanë, që udhëheqin dhe sundojnë mbi botën kapitaliste, që udhëheqin kampin e luftënxitësve, kanë zënë vendin e Hitlerit, po me siguri do të kenë edhe

fatin e tij. Përpara krizës së madhe ekonomike dhe politike, që ka shpërthyer me forcë në gjirin e tyre, përpara forcës të të gjithë popujve të botës, imperialistët amerikanë dhe anglezë, shohin t'u afrohet fundi regjimeve të tyre të urryera, shtypëse dhe të përgjakshme. Lufta e re botërore, që imperialistët amerikano-anglezë kërkojnë të shpërthejnë i përngjet spazmës së fundit të njeriut që jep shpirt, ashtu siç është regjimi i kapitalit, në agoninë e tij të fundit.

Gjatë gjithë periudhës së pasluftës së dytë botërore, imperialistët amerikanë, anglezë dhe francezë, kanë shkëlur të gjitha traktatet ndërkombëtare që do të rregullonin situatën për vendosjen e paqes. Imperialistët, traktatet e Jaltës, të Potsdamit etj., i kanë konsideruar si fletëkarte të thjeshta. Përpara qëndrimit të vendosur dhe paqësor të Bashkimit Sovjetik për rregullimin e drejtë dhe në interesin e popujve të të gjitha çështjeve ndërkombëtare, imperialistët amerikanë dhe satelitët e tyre kanë bërë veshin e shurdhër dhe i kanë shkëlur detyrimet ndërkombëtare. Është, pra, e qartë që bota kapitaliste, e udhëhequr nga imperializmi amerikan, po ecën drejt një lufte të re kundër Bashkimit Sovjetik dhe demokracive popullore, kundër kampit të paqes dhe të socializmit në botë. Këto qëllime ka edhe Pakti i Atlantikut Verior, karakterin e vërtetë agresiv të të cilit nuk mund ta fshehin as imperialistët amerikanë as satelitët e tyre. Maska u çor krejtësisht nga politika tej pamëse paqësore staliniane dhe u bë e qartë për të gjithë njerëzit se ç'krime kurdisen nën mbulesën gjoja paqësore të kësaj aleance në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të gjithë pjesëtarëve të tjerë të këtij

pakti. Fjalët «paqe» e «sigurim paqësor» të imperialistëve s'janë veçse lulka, me të cilat ata kërkojnë të mbulojnë veprat e tyre kriminale. Plani Marshall ka pasur po të njëjtin qëllim: varfërimin e popujve të vendeve të marshallizuara, mbytjen e industrisë lokale nën thundrën e dollarit, paralizimin e industrisë kyçe të vendeve të marshallizuara, shtimin e urisë dhe të mjerimeve të këtyre popujve, zmadhimin e jashtëzakonshëm të papunësisë dhe hedhjen në dorë nga ana e imperialistëve amerikanë të të gjithë industrisë të këtyre vendeve, për ta drejtuar atë në rrugën dhe në prodhimin e materialeve të luftës.

Politika agresive, antiñjerëzore dhe antipopullore e imperialistëve amerikanë e bën të padurueshme jetën ekonomike në këto vende, ku kriza ekonomike po vete dita-ditës duke u shtuar, ashtu sikundër ngjet dhe brenda në Shtetet e Bashkuara. Borxhet e vendeve satelite të Shteteve të Bashkuara ndaj imperializmit të dollarit po shtohen me hapa të mëdhenj, prodhimi industrial po rrokulliset teposhtë vazhdimisht, gjë që shkakton inflacione e mjerime për klasën punëtore dhe masat punonjëse. Çmimet ngrihen vazhdimisht në mënyrë katastrofale dhe rrogat reale të punonjësve ulen. Borgjezia dhe kapitalistët e këtyre vendeve të shitur te imperialistët amerikanë, në këtë periudhë përgatitjeje për luftë, shtërngojnë më fort burgjitë e shfrytëzimit të klasës punëtore dhe të masave punonjëse dhe kur ua do puna, me masa fashiste, terroriste ata mbrojnë interesat e tyre ekonomike, politike dhe pushtetin e tyre të kalbur.

Imperializmi amerikan i ka shndërruar vendet

satelite e të marshallizuara në «place d'armes» të tij, të fortifikuara dhe të mbrojtura nga ushtarë amerikanë. Asnjë respekt s'ka për lirinë dhe pavarësinë e këtyre popujve, të cilët ai synon t'i shndërrojë në kolonë dhe mish për top për interesat e manjatëve kapitalistë të Uoll Strit-it. Shtetet satelite të Evropës Perëndimore po u nënshtrohen çdo ditë e më tepër ultimatumëve të Amerikës, e cila kërkon me çdo kusht dhe me shpejtësi t'i armatosë. Kjo ngjet me Francën, me Britaninë e Madhe, me shtetet e Beneluksit, me Italinë, me Jugosllavinë, me Greqinë etj. Gjermania Perëndimore, për imperializmin amerikan dhe satelitët e tjerë të tij, është kolona vertebrale në Evropë e gjithë përgatitjes për luftë. Kukullat e Bonit, pasardhësit direktë të Hitlerit, nën drejtimin e amerikanëve e kanë shndërruar Gjermaninë Perëndimore në një arsenal luftime. Fabrikat dhe industria e rëndë e Ruhrit punojnë me rendiment të plotë, si në kohën e Hitlerit, për fabrikimin e armëve, të topave, të tanksave e të tjera mjete luftime dhe shfarosjeje. Armatimi i Gjermanisë Perëndimore përbën aksin e politikës agresive të Shteteve të Bashkuara në Evropë, që e përgatitin militarizmin gjerman të luajë përsëri rolin e satrapit dhe të forcës agresive të imperializmit amerikan, ashtu sikundër ngjau dhe në Luftën e dytë botërore me hitlerianët, të cilët u financuan dhe u armatosën nga po këta peshkaqenë dhe gjakpirës popujsh.

Si rezultat i përgatitjeve për luftë, imperializmi amerikan, duke sulmuar popullin paqedashës dhe heroik korean kaloi në agresion të hapët. Ky krim i tmerrshëm u mbulua me flamurin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të cilën imperialistët amerikanë, e kanë bërë

një vegël të bindur dhe servile në duart e tyre. Duke demaskuar vendimin e turpshëm të Kombeve të Bashkuara, që deklaroi si agresore Republikën Popullore të Kinës, si dhe situatën që ekziston tani në këtë organizatë, në intervistën e ditëve të fundit shoku Stalin thotë:

«E cilësoj si një vendim të turpshëm. Në të vërtetë duhet të jesh krejt i pacipë që të thuash se Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që kanë pushtuar një tokë kineze, ishullin e Taivanit dhe kanë invaduar Korenë deri në kufitë e Kinës, janë ana që mbrohet, kurse Republika Popullore e Kinës, që mbron kufitë e vet dhe përpiqet të shtjerë përsëri në dorë ishullin e Taivanit, të pushtuar nga amerikanët, është agresore.

Organizata e Kombeve të Bashkuara, e krijuar si një mburojë për ruajtjen e paqes, po shndërrohet në një vegël lufte, në një mjet për shpërthimin e një lufte të re botërore. Bërthama agresore e OKB-së janë dhjetë vende, anëtare të Paktit agresiv të Atlantikut Verior (SHBA, Angli, Francë, Kanada, Belgjikë, Hollandë, Luksemburg, Danimarkë, Norvegji, Islandë) dhe njëzet vende të Amerikës Latine...»¹.

Dhe më poshtë shoku Stalin vazhdon:

¹ J. V. Stalin. Bisedë me korrespondentin e gazetës «Pravda». «Pravda», Nr. 48 (11885), 17 shkurt 1951.

«Në thelb OKB-ja sot është jo aq një organizatë botërore, sa një organizatë për amerikanët, që vepron sipas interesave të agresorëve amerikanë»¹.

«Organizata e Kombeve të Bashkuara po vihet kështu në rrugën e palavdishme të Lidhjes së Kombeve. Me këtë ajo po e varros autoritetin e vet moral. . .»².

Por agresorët amerikanë u gabuan në llogaritë e tyre para popullit trim korean. Ata menduan se do ta likuidonin shpejt Korenë dhe, që andej, të përgatitnin agresionin e ri kundër Republikës Popullore të Kinës. Populli korean lufton heroikisht dhe ai është më se i sigurtë se do t'i kapërcejë të gjitha vështirësitë dhe do të fitojë, pse kauza e tij e drejtë është për lirinë, pavarësinë dhe socializmin. Në intervistën që shoku Stalin i dha disa ditë më parë korrespondentit të gazetës «Pravda» në lidhje me dhënjen fund të ndërhyrjes së armatosur të agresorëve amerikano-anglezë në Kore, ka thënë:

«Po që se Anglia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës i hedhin poshtë përfundimisht propozimet paqësore të Qeverisë Popullore të Kinës, lufta në Kore mund të përfundojë vetëm me disfatën e intervencionistëve»³.

¹ J. V. Stalin. Bisedë me korrespondentin e gazetës «Pravda». «Pravda», Nr. 48 (11885), 17 shkurt 1951.

² Po aty.

³ Po aty.

Lufta heroike e popullit korean ngriti peshë gjithë popujt e botës. Krimet e agresorëve amerikanë në Kore dhe të bandave të armatosura të Sin Man Ri-së e të shërbëtorëve të tjerë të amerikanëve, ua kalojnë krimeve të tmerrshme të hitlerianëve. Ata e kanë bërë Korenë shkumb e hi, ata kanë vrarë pa mëshirë popullatën e pafajshme dhe të çarmatosur, ata kanë shfarosur sa kanë mundur e në mënyrë shtazarake, gra, pleq, kalamanë, monumente të artit dhe të kulturës, shkolla, spitale dhe çdo gjë që ndodhej në këmbë. Por hakmarrja e popullit korean, i ndihmuar nga vullnetarët heroikë kinezë, ka qenë e pamëshirshme. Agresorët amerikanë dhe satelitët e tyre pësuan disfatën më të turpshme në Kore, duke u thyer keqas dhe shpejt e patjetër do të vijë dita që ata të hidhen në det.

Agresioni amerikan kundër Koresë ka për qëllim të zgjerohet në Lindjen e Largme dhe në të gjithë Azinë. Imperialistët amerikanë s'vunë mend nga disfata e turpshme që ata pësuan në Kinë, duke financuar dhe duke armatosur haptas kukullën e tyre, Çan Kai Shi-në. Republika Popullore e Kinës është bërë tani e pamposhtur, ku do të thyhen të gjitha orvatjet dhe intrigat e imperialistëve amerikanë, anglezë e shërbëtorëve të tyre. Lufta heroike e popullit korean, e popullit të Vietnamit, të Malezisë, të Filipineve, tregon më së miri ndryshimin e madh që ka ngjarë në popujt kolonialë dhe gjysmëkolonialë të Azisë, të cilët po luftojnë dhe fitojnë kundër zgjedhës kapitaliste të kolonizatorëve amerikanë dhe anglezë. Lëvizja e madhe revolucionare e popujve të Azisë do të ketë sigurisht përfundimin logjik të hedhjes tej të zgjedhës së urryer koloniale.

Rezistenca heroike e popujve të Azisë, e ka tronditur thellë imperializmin amerikan dhe satelitët e tij, të cilët fillojnë të mendohen më thellë për «zotësinë» e partnerit të vet kryesor, te i cili kanë vënë të gjitha shpresat e shpëtimit të regjimeve të tyre antipopullore. Kjo lëkundje e partnerëve të imperializmit amerikan, e bën këtë të shpejtë përgatitjet e luftës, të cilat shoqërohen edhe me masa terrori kundër partive komuniste në Amerikë dhe në vendet e marshallizuara, pse këto mobilizojnë masat e gjera të popullit dhe të kampit të partizanëve të paqes që luftojnë me heroizëm, për ta ndaluar agresionin e imperialistëve. Ligje të ashpra po vihen në fuqi, për të penguar dhe për të shuar hovin revolucionar të masave punonjëse me në krye klasën punëtore, e cila i pengon imperialistët dhe qeveritë kukulla të vendeve të marshallizuara të realizojnë planet e tyre djallëzore.

Imperialistët amerikanë kanë hedhur ganxhat e tyre në të katër anët e botës. Spanja e Frankos, Jugosllavia titiste, Greqia monarko-fashiste, Italia dhe Turqia satelite që janë bërë preja dhe qendra agresioni të imperializmit amerikan në Evropë, po përgatitin shtojcën e Paktit agresiv të Atlantikut Verior, blokun agresiv të Mesdheut. Përgatitjet për luftë në këto çerdhe fashizmi po bëhen me shpejtësi të madhe.

Por me gjithë këto masa, me gjithë shantazhet e shpifjet, me gjithë histerinë dhe përgatitjet për luftë, politika agresive e Pentagonit dhe e Departamentit të Shtetit ka dështuar me turp përpara murit të çelniktë dhe të pamposhtur të forcave përparimtare të botës me Bashkimin Sovjetik në krye. Të gjitha përpjekjet e djallëzuara të imperializmit amerikan dhe anglez, për

të fshehur qëllimet e tyre agresive, u demaskuan lakuriq nga delegacioni sovjetik në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Bashkimi Sovjetik, që ndjek me vendosmëri politikën paqësore staliniane dhe të miqësisë në mes popujve, ka mbrojtur me vendosmërinë më të madhe paqen dhe të drejtat e popujve në lëmin ndërkombëtar. Ai është bërë kampion i paqes dhe ka fituar dashurinë dhe simpatinë e gjithë popujve të botës që aspirojnë dhe luftojnë për paqen.

Sesioni i pestë i Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara¹ u ndoq me interesim të jashtëzakonshëm prej gjithë popujve të botës. Në këtë sesion, delegacioni sovjetik i kryesuar nga Andrei Vishinski, një nga miqtë e shtrenjtë e dashamirës sovjetikë të popullit tonë, mbrojtë me vendosmëri popullin vëlla korean, u vuri në dukje qartë popujve të botës krimet e imperialistëve amerikanë dhe të satelitëve të tyre, demaskoi agresionin e blokut agresiv amerikan dhe kërkoi ndalimin e tij në Kore dhe në Kinë.

Nga ana tjetër, delegacioni sovjetik shtroi përpara Organizatës së Kombeve të Bashkuara propozime të qarta dhe paqësore sovjetike, që do të zhduknin kërcënimin e paqes ndërkombëtare. Bota e gjithë pa edhe një herë sa të drejta dhe të qarta ishin këto propozime, që s'u pranuan nga bloku amerikan-anglez. Por një qëndrim i tillë agresiv i këtij bloku i demaskoi keqas këta xhelatë, ndërsa propozimet paqësore sovjetike gjetën përkrahjen unanime të opinionit publik të të gjitha vendeve.

¹ Ky sesion u hap në shtator 1950.

Në një kohë kur imperializmi amerikan pësonte fiaskon më të turpshme në Lindjen e Largme dhe si konsekuencë, lëkundjen e partnerëve të tij në Evropën Perëndimore, manjatët e Uoll Strit-it dërguan njërin pas tjetrit, Açesonin¹ dhe të tjerë, për të aktivizuar dhe për t'u dhënë zemër partnerëve të tyre të frikësuar të Evropës Perëndimore. Mbledhjet dhe konferencat e partnerëve të ndryshëm të blokut agresiv të Atlantikut, vunë qartë në dukje çështjen e militarizimit të Gjermanisë Perëndimore, riarmatimin e militarizimit gjerman dhe futjen e tij në Paktin e Atlantikut.

Vendimi historik i adoptuar në Konferencën e Ministrave të Jashtëm të vendeve socialiste evropiane që u mbajt në Pragë në muajin tetor të vitit të kaluar², është një ngjarje e rëndësishme, pse vendimet e Pragës i vunë edhe një herë përpara përgjegjësitë të rënda Amerikën, Anglinë dhe Francën në respektimin e akordeve të Potsdamit. Qeveria sovjetike në interesin e paqes në botë dhe në interesin e popullit gjerman kërkon me këmbëngulje që të krijohet një shtet gjerman unik, demokratik e paqësor dhe, duke u zbatuar marrëveshja e Potsdamit, të çmilitarizohet Gjermania, të tërhiqen trupat e pushtimit, në mënyrë që të arrihet sa më parë

¹ Din Açeson — Sekretar i Departamentit të Shtetit të SHBA në vitet 1949—1953.

² Në këtë konferencë u vendos marrja e një sërë masash për zgjidhjen e problemit gjerman: përfundimi i një traktati paqeje me Gjermaninë, moslejimi i militarizimit të saj, formimi i një shteti gjerman të unifikuuar dhe zgjedhja e një Asambleje Kushtetuese për gjithë Gjermaninë.

nënshkrimi i traktatit të paqes me Gjermaninë. Mirëpo bloku amerikano-anglez, duke shkelur në mënyrë arbitrare marrëveshjen e Potsdamit, ka filluar riarmatimin e Gjermanisë Perëndimore; po ashtu edhe Franca e Anglia, që kanë shkelur njëkohësisht traktatin e aleancës së tyre me Bashkimin Sovjetik, ndjekin të njëjtën rrugë.

Ashtu sikundër e kanë zakon, imperialistët amerikano-anglezë, për të justifikuar para popujve të tyre dhe para opinionit publik botëror garën e ethshme të armatimeve, akuzojnë Bashkimin Sovjetik se gjoja ai, pas mbarimit të luftës, jo vetëm nuk u çarmatos, po përkundrazi — sipas tyre — i ka shtuar gjithnjë e më shumë forcat e tija të armatosura. Shpifjeve të tilla të poshtra, që vazhdojnë të përsëriten nga armiqtë e Bashkimit Sovjetik, ashtu sikurse edhe deklaratës së fundit bërë në Dhomën e Komuneve të Anglisë nga tradhëtari i klasës, Etli¹, shoku Stalin u jep si kurdoherë një goditje dërmuese. Në intervistën që ka dhënë ditët e fundit, midis të tjerave ai thotë:

«Këtë deklaratë të kryeministrit Etli unë e cilësoj si një shpifje kundër Bashkimit Sovjetik. Gjithë bota e di se pas luftës Bashkimi Sovjetik bëri çmobilizimin e ushtrisë së vet»².

¹ Klement Riçard Etli (1883—1967) — lider i Partisë Laburiste Angleze, kryeministër i Anglisë në vitet 1945—1951, i cili ndoqi një politikë antipunëtore sido që e hiqte veten si mbrojtës të interesave të tyre.

² J. V. Stalin. Bisedë me korrespondentin e gazetës «Pravda». «Pravda», Nr. 48 (11885), 17 shkurt 1951.

Dhe shoku Stalin vazhdon:

«Kryeministrit Etli i duhet një gënjeshtër kundër Bashkimit Sovjetik, atij i duhet ta paraqesë politikën paqësore të Bashkimit Sovjetik si një politikë agresive, ndërsa politikën agresive të qeverisë angleze si një politikë paqësore, me qëllim që të mashtrojë popullin anglez, ta bëjë atë që t'i besojë kësaj gënjeshtre rreth Bashkimit Sovjetik dhe kështu, me anë të mashtrimit, ta hedhë në luftën e re botërore që po përgatitet nga qarqet drejtuese të Shteteve të Bashkuara të Amerikës»¹.

Më poshtë shoku Stalin thotë:

«Është e qartë se kryeministri Etli nuk është për ruajtjen e paqes, por për shpërthimin e një lufte të re botërore agresive»².

Bashkimi i madh Sovjetik vazhdimisht ka shprehur vullnetin e tij për rregullimin e drejtë të çështjeve ndërkombëtare në interes të paqes së njerëzimit dhe në interes të mirëqenjes së popujve të botës. Ai ka manifestuar vazhdimisht vullnetin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Në prillin e vitit 1947, shoku Stalin duke ju përgjegjur një personaliteti amerikan mbi këtë

¹ J. V. Stalin. Bisedë me korrespondentin e gazetës «Pravda». «Pravda», Nr. 48 (11885), 17 shkurt 1951.

² Po aty.

çështje, tha se po të ekzistojë dëshira e bashkëpunimit, bashkëpunimi është i mundshëm në mes sistemeve të ndryshme ekonomike, por në qoftë se nuk ekziston dëshira e bashkëpunimit, atëherë edhe sikur sistemet të jenë të njëjta, shtetet dhe popujt mund të shqyhen me njëri-tjetrin.

Por bloku agresiv amerikano-anglez e ka refuzuar këtë bashkëpunim paqësor ndërkombëtar, e ka refuzuar propozimin sovjetik të paktit të të pestëve¹ që paraqiti delegacioni sovjetik në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Imperializmi amerikan dhe satelitët e tij ndjekin rrugën e agresionit dhe të aventurave ushtarake. Duke folur për këtë çështje shoku Stalin ka thënë:

«Luftënxitësit, që përpiqen të shpërthejnë një luftë të re, më shumë se nga çdo gjë kanë frikë nga marrëveshjet e nga bashkëpunimi me BRSS, sepse politika e marrëveshjeve me BRSS i minon pozitat e luftënxitësve dhe e bën të kotë politikën agresive të këtyre zotërinjve»².

Intervista e ditëve të fundit e shokut Stalin tregon edhe një herë se Bashkimi Sovjetik është luftëtari më i vendosur i mbrojtjes së paqes në botë. Ajo demaskon në mënyrë të rreptë politikën luftënxitëse të imperialistëve agresorë amerikanë dhe anglezë. Kjo intervistë

¹ Sipas këtij propozimi kërkohet të krijohet pakti i të pestëve: BS, SHBA, Kina, Anglia dhe Franca, të cilët të nënshkruanin një traktat paqeje dhe mossulmimi.

² J. V. Stalin. «Përgjegje pyetjeve të korrespondentit të gazetës «Pravda». «Pravda», Nr. 303 (11044), 29 tetor 1948.

është një dokument i rëndësishëm për mbrojtjen e paqes dhe sigurimin e botës. Shoku Stalin e përfundon intervistën e tij me këto fjalë të urta:

«Paqja do të ruhet dhe do të forcohet, në qoftë se popujt do ta marrin në duart e veta çështjen e ruajtjes së paqes dhe do ta mbrojnë atë deri në fund. Lufta mund të bëhet e pashmangshme, në qoftë se luftënxitësit do të arrijnë t'i gënjejnë, t'i mashtrojnë masat popullore dhe t'i futin ato në një luftë të re.

Prandaj fushata e gjerë për ruajtjen e paqes, si mjet për demaskimin e makinacioneve kriminale të luftënxitësve, sot ka rëndësi të dorës së parë.

Sa për Bashkimin Sovjetik, ai do të ndjekë i patundur edhe paskëtaj politikën e parandalimit të luftës dhe të ruajtjes së paqes»¹.

Kampi i fuqishëm i partizanëve të paqes, që frymëzohet dhe udhëhiqet nga Bashkimi i lavdishëm Sovjetik dhe nga Stalini i madh, është bërë një forcë e madhe që u del përpara forcave të errëta të agresionit dhe u thotë «ndal!» në veprën e tyre gjakatare. Apeli i Stokholmit, që u nënshkrua prej qindra milion njerëzish në të katër anët e botës, i tmerroi imperialistët dhe ua ndali dorën e tyre kriminale në përdorimin e bombës atomike. Kongresi i dytë i Partizanëve të Paqes që u

¹ J. V. Stalin. Bisedë me korrespondentin e gazetës «Pravda». «Pravda», Nr. 48 (11885), 17 shkurt 1951.

mbajt në Varshavë¹, ishte një tjetër manifestim edhe më i fuqishëm i vullnetit të mbarë popujve të botës për të mbrojtur paqen. Më kot imperialistët amerikanë dhe anglezë u munduan të sabotonin kongresin duke mos lejuar në orët e fundit që ai të mbahej në Sheffield, më kot ata dhe gazetarët nën urdhërat e tyre u përpoqën të shpifnin kundër kongresit. Kongresi tregoi se lufta nuk është e paevitueshme, por forca e popujve mund ta ndalojë atë dhe do të bëjë që paqja të triumfojë. Pyetjes që i është bërë shokut Stalin prej korrespondentit të «Pravdës» nëse e konsideron të paevitueshme një luftë të re botërore, ai i është përgjigjur:

«Jo. Të paktën sot për sot ajo nuk mund të quhet e pashmangshme.

Sigurisht, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Angli si dhe në Francë, ka forca agresive të etura për një luftë të re. Atyre u duhet lufta për të nxjerrë superfitime, për të plaçkitur vendet e tjera. Këta janë miliardërit e milionerët që e shikojnë luftën si një kapitull të ardhurash që jep fitime kolosale.

Këto forca agresive i kanë në dorë qeveritë reaksionare dhe i drejtojnë ato. Por njëkohësisht ato kanë frikë nga popujt e vet, të cilët nuk duan një luftë të re dhe janë për ruajtjen e paqes. Prandaj ato mundohen t'i përdorin qeve-

¹ Kongresi ishte parashikuar të mbledhej në Sheffield (Angli), por qeveria angleze nuk lejoi të vinin një sërë delegacionesh, prandaj u detyrua të mbahej në Varshavë nga 16—21 nëntor 1950.

ritë reaksionare për t'i gënjyer, për t'i mashtruar popujt e vet dhe për ta paraqitur luftën e re si një luftë mbrojtëse, ndërsa politikën paqësore të vendeve paqedashëse si një politikë agresive. Ato mundohen t'i mashtrojnë popujt e vet për t'u imponuar planet e veta agresive dhe për t'i futur në një luftë të re.

Pikërisht për këtë arsye ato kanë frikë nga fushata për mbrojtjen e paqes, duke druajtur se ajo mund t'i zbulonte qëllimet agresive të qeverive reaksionare»¹.

Për mbrojtjen e paqes luftojnë me heroizëm në krye të të gjithë popujve, popujt e Bashkimit Sovjetik, luftojnë gjithë popujt e vendeve të demokracive popullore të Evropës dhe të Azisë, luftojnë heroikisht popujt e Koresë, të Vietnamit, të Malezisë, të Filipineve, luftojnë heroikisht klasa punëtore italiane dhe masat punonjëse të të gjithë Italisë, luftojnë proletariati francez, popujt e Hindit dhe të të gjithë Azisë, popujt e Australisë dhe të Amerikës së Veriut e të Jugut, popujt e shtypur e të martirizuar të Jugosllavisë dhe të Greqisë, të Spanjës etj. Vizitat e Mak Arthurit² e të gjeneralit Ajzenhauer³,

¹ J. V. Stalin. Bisedë me korrespondentin e gazetës «Pravda». «Pravda», Nr. 48 (11885), 17 shkurt 1951.

² Dugllas Mak Arthur, ish-kryekomandant i forcave ushtarake amerikane në Lindjen e Lartme.

³ Duajt Ajzenhauer (1890—1969) — në këtë kohë ishte komandant i forcave ushtarake amerikane në Evropën Perëndimore dhe i ushtrive të NATO-s. President i SHBA-së në vitet 1952—1960.

priten kudo me greva dhe me demonstrata të fuqishme, të cilat shërbëtorët e Uoll Strit-it në vendet e marshallizuara i shtypin me gjak. Por asgjë s'mund ta ndalojë hovin hakmarrës të masave punonjëse që kërkojnë lirinë dhe paqen në shtëpitë e tyre.

Në një kohë kur bota kapitaliste me imperializmin amerikan në krye është zhytur në një krizë të madhe dhe të pafund, në një kohë kur në këto vende mbretëron histeria e luftës dhe vazhdon gara e armatimeve, Bashkimi Sovjetik ecën me hapa të mëdhenj përpara: Atje lulëzon jeta dhe begatia, forca ekonomike sovjetike po bëhet dita-ditës më e madhe. Plani pesëvjeçar stalinian i pasluftës u tejkalua. Volumi i prodhimit industrial në krahasim me atë të paraluftës, u kapërcye 70 për qind. Më 1950 Bashkimi Sovjetik mori 300 milion pud drithëra më shumë se në vitin 1940. Plani i punimeve të mëdha në Vollgë, Dniepër dhe në Amur-Darja, përbëjnë planin madhështor të transformimit të natyrës dhe të triumfit të regjimit socialist. Në vigjilien e Vitit të ri dhe tani së fundi populli sovjetik manifestoi edhe një herë tjetër, me rastin e zgjedhjeve të sovjetëve, forcën dhe dashurinë e tij të madhe për Partinë e lavdishme Bolshevike, për Stalinin e madh dhe për pushtetin sovjetik. Të gjitha këto vënë në dritë forcën e madhe të Bashkimit Sovjetik, i cili ecën drejt jetës komuniste.

Republika Popullore e Kinës, vendet e demokracisë popullore po korrin suksese të mëdha në ndërtimin e socializmit në vendet e tyre, po zhdukin rrënimet e luftës, po ndër marrin punime kolosale për përmirësimin e jetës së masave të gjera punonjëse. Zhvillimi ekonomik dhe kultural në vendet e demokracisë popullore po

lulëzon, standardi i jetës së popullit po ngrihet dita-ditës, këtu nuk njihen kriza, papunësia, uria.

Këto tregojnë se kampi i paqes dhe i socializmit me Bashkimin Sovjetik në krye është më i fortë se kurrë, i fuqishëm dhe i pamposhtur, i aftë për t'u bërë ballë me sukses orvatjeve dhe kërcënimeve të kampit imperialist luftëdashës. Kampi i fuqishëm i paqes, i bindur në forcën e tij të pamposhtur dhe në drejtësinë e tij të madhe, do të korrë vazhdimisht suksese kundër qëllimeve të poshtra të luftënxitësve imperialistë amerikanë e anglezë, që kërkojnë të hedhin edhe një herë botën në zjarr e në flakë. Kampi i paqes dhe i socializmit do të triumfojë. Paqja do të triumfojë mbi luftërat grabitqare.

Përpara kësaj situate ndërkombëtare Partisë sonë i dalin këto detyra:

1) Të çelnikosë unitetin e popullit tonë dhe ta mobilizojë atë në luftë aktive për mbrojtjen e vendit. T'i bëjë të njohur popullit luftën që bëjnë për mbrojtjen e paqes popujt e Bashkimit Sovjetik, popujt e demokracive popullore dhe gjithë popujt e botës.

2) Të ruajë me vigjilencë integritetin tokësor dhe pavarësinë e vendit tonë që çdo ditë e kërcënojnë imperialistët amerikanë, anglezë, nacionalistët jugosllavë, monarko-fashistët grekë dhe neofashistët italianë.

3) Të forcojë çdo ditë e më shumë Ushtrinë Popullore dhe organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Kujdesi i gjithë Partisë dhe i udhëheqjes duhet të jetë i madh dhe i vazhdueshëm për këto armë. Duhet t'i ndihmojë pa pushim, t'i çelnikosë dhe t'i bëjë çdo ditë më të afta për të shtypur çdo armik, nën çdo maskë që

'ai do të përpiqet të fshihet. Ushtria dhe organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme duhet të kenë mbështetjen, dashurinë dhe përkrahjen e pakufishme të popullit, të dikastereve, të enteve, të çdo njeriu dhe këto armë të bëjnë çdo përpjekje për t'u bërë të afta dhe kurdoherë të gatshme për të mbrojtur popullin, Partinë, lirinë, pavarësinë dhe Republikën nga armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm.

4) Të forcojë dita-ditës më shumë ekonominë tonë popullore. Realizimi i planeve tona ekonomike në të ardhshmen duhet të jetë i plotë dhe të bëhen përpjekje nga të gjithë punonjësit, me në krye klasën punëtore të udhëhequr nga Partia, për t'u tejkaluar. Të luftojë me ashpërsi gabimet dhe të metat, që kanë ekzistuar në punën tonë, të luftojë pa mëshirë armiqtë dhe sabotatorët, të luftojë javashllëkun dhe burokratizmin etj. T'u besojë funksione të rëndësishme punëtorëve dhe fshatarëve në ekonomi dhe kudo dhe të ngrejë me mijëra kuadro të rinj që duhet të vijnë nga klasa punëtore në radhë të parë, besnikë të Partisë e të socializmit. Të shtohen prodhimet tona industriale, minerale, bujqësore në mënyrë të tillë që të fuqizohet ekonomia dhe të ngrihet çdo ditë niveli i jetesës së masave punonjëse.

5) Të çelënikosë në zemrat e popullit dashurinë dhe besnikërinë për Bashkimin Sovjetik. Populli të shohë çdo ditë e më qartë përkrahjen dhe ndihmën që i jep Bashkimi Sovjetik dhe Stalini. Populli të njohë të gjitha sukseset dhe përparimet që arrihen në Bashkimin Sovjetik, pse këto suksese dhe përparime janë njëkohësisht të tijat. Masat punonjëse të udhëhiqen në punën e tyre nga eksperiencia sovjetike.

6) Të forcojë dhe të çelnikisë miqësinë e popullit tonë me vendet e demokracive popullore. Populli ynë të njihet më shumë me jetën, me punën, me sukseset e popujve vëllezër të demokracive popullore.

7) T'ja bëjë të qarta popullit qëllimet agresive dhe luftëdashëse të imperialistëve amerikanë dhe të satelitëve të tyre. Rreziku i madh, që kërcënon paqen dhe vendin tonë nga këta banditë, të mos harrohet për asnjë çast. Të demaskohen të gjitha krimet e imperialistëve amerikanë në Kore dhe në vendet e tjera të marshallizuara, të demaskohen krimet dhe qëllimet agresive të titistëve, të monarko-fashistëve grekë dhe të fashistëve italianë, kundër popujve të tyre dhe kundër vendit tonë.

II. MBI GJENDJEN E BRENDSHME TË VENDIT

Partia dhe populli ynë i kanë jetuar dhe i jetojnë intensivisht këto situata kaq të ndera ndërkombëtare dhe vazhdimisht kanë qenë të ndërgjegjshëm dhe në përpjekje të mëdha për të forcuar sa më shumë gjendjen e brendshme, aftësinë mbrojtëse të vendit dhe luftën aktive për të mbrojtur paqen. Dhe në fakt situata e brendshme e vendit tonë është forcuar nga të gjitha pikëpamjet, si nga ana ekonomike, politike, ushtarake, ashtu dhe e sigurimit të brendshëm.

Ekonomikisht vendi ynë ka bërë hapa përpara në saje të përpjekjeve dhe të punës së palodhur të Partisë, të klasës punëtore dhe të punonjësve të vendit. Të mendojmë ku ka qenë vendi ynë më parë dhe ku është sot me industrinë dhe zhvillimin e minierave tona! Të

mendojmë sabotimet e tmerrshme të trockistëve jugosllavë, që u përpoqën me çdo mjet të na i shkallmonin këta sektorë kaq të rëndësishëm dhe si ne e morëm veten shpejt! Industria jonë e vogël dhe e shkatërruar është rimëkëmbur, përmirësuar dhe jep rendiment të mirë, pavarësisht se ka dhe të meta në punën tonë. Po të studjojmë grafikun e rritjes, ne do të shohim se gjendja e kaluar me të sotmen është si nata me ditën. Ne s'kishim maqineritë e nevojshme, vegla të ndryshme dhe të domosdoshme, neve na mungonte eksperiencia. Bashkimi Sovjetik na ndihmoi për t'i pajisë me maqineri e me vegla minierat tona të naftës, të bakrit, të kromit, të serës, të qymyrit. Ai na dërgoi specialistë në të gjithë sektorët, të cilët, pa kursyer, mësojnë kuadrot tanë punëtorë. Dhe puna ecën përpara me ritëm të kënaqshëm dhe të pakrahasueshëm me të kaluarën. Këto realizime janë një gjë madhështore për industrinë tonë dhe për popullin. Ne së shpejti do të përpunojmë planin pesëvjeçar, i pari plan perspektiv i vendit tonë që do të forcojë dhe do të pasurojë ekonominë tonë, do të shtojë mirëqenjen e njerëzve. Për hartimin e planit pesëvjeçar çdo gjë është në rregull. Bashkimi Sovjetik dhe demokracitë popullore motra na akorduan kreditë që ne u kërkuam. Kërkesave të Komitetit Qendror dhe të qeverisë sonë, Partia Bolshevike, shoku Stalin dhe gjithë partitë dhe qeveritë e demokracive popullore, u janë përgjegjur pozitivisht. Kjo tregon si kurdoherë dashurinë e madhe që ushqejnë ata për popullin tonë, të cilin e ndihmojnë me të gjitha mundësitë e tyre që ai të përparojë.

Bujqësia jonë po ecën përpara. Tani ajo ka stacione

të maqinave e të traktorëve, të cilat me planin tonë perspektiv do të zgjerohen, do të pasurohen edhe më tepër me traktorë dhe me maqina të tjera bujqësore.

Gjendja ekonomike e Shqipërisë është përmirësuar shumë, populli rron më mirë, ushqehet dhe vishet më mirë, edukohet dhe mësohet më mirë. Përpjekjet e popullit tonë në punë, në fabrika dhe në fusha, kanë dhënë rezultate të kënaqshme. Çmimet e tregut janë ulur në krahasim me të kaluarën. Populli furnizohet më mirë me sendet e nevojës së parë. Qeveria bëri zbritje çmimesh dhe nga kjo populli kurseu rreth 300 milion lekë. Financat tona janë forcuar dhe ne këtë ja detyrojmë ngritjes së ekonomisë popullore dhe ligjeve të drejta socialiste në favor të popullit. Shteti ka krijuar akumulacione të mira dhe ka siguruar të ardhura të konsiderueshme në buxhet, me të cilat ka kryer ndërtime të mëdha në industri, në bujqësi, në arësim, në kulturë, në art, në muzikë, në shëndetësi dhe në çdo sektor tjetër të aktivitetit ekonomik dhe shoqëror të vendit. Të gjitha këto kanë ngritur mirëqenjen e popullit, kanë forcuar ekonominë tonë popullore. Thatësira e madhe e sivjetme, që na shkaktoi dëme të konsiderueshme në drithëra dhe veçanërisht në misër, prodhimi i paktë i ullinjve, që është një pasuri e çmueshme e vendit dhe që lidhet ngushtë, përveç të tjerave, me prodhimin e vajit dhe të saponit për furnizimin e popullit, mosrealizimi i plotë i planit tonë dyvjeçar në disa sektorë të rëndësishëm, kanë qenë sivjet një minus për ekonominë tonë dhe kanë vështirësuar deri diku furnizimin e rregullt të popullit. Armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm përpiqen t'i përdorin këto momente për

të dobësuar politikisht veprën e madhe të Partisë dhe janë në përpjekje të vazhdueshme për të diskredituar ligjet dhe urdhëresat e drejta të qeverisë sonë. Por edhe këtu deziluzionet e tyre do të jenë të mëdha, pse popullit tonë me gjithë thatësirën, buka nuk do t'i mungojë kurrë.

Gjendja politike e brendshme e vendit tonë është shumë e shëndoshë. Partia i udhëheq dhe i edukon masat e gjera punonjëse në frymën revolucionare. Ajo me qartësinë e vijës së saj leniniste-staliniane ka çelnikosur ndjenjën e sigurisë në forcat e gjalla dhe revolucionare të popullit, ka krijuar një unitet të shëndoshë të popullit, që s'do të jenë kurrë në gjendje ta dëmtojnë armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm; ka çelnikosur patriotizmin e vërtetë në shpirtin e njerëzve të thjeshtë, të cilët janë ngritur politikisht në një mënyrë të tillë të lartë, që qartësisht dhe shpejt orientohen në çdo situatë sado e vështirë dhe e koklavitur qoftë. Politika e lavdishme e Partisë sonë është bërë politika e popullit tonë, është bërë fari ndriçues i rrugës së popullit dhe kjo, nga puna e palodhur e Partisë, është konkretizuar në një mënyrë të tillë në zemrën e popullit tonë që s'ka forcë që ta lëkundë. Ky është rezultat i punës së pavdekshme dhe madhështore që ka bërë Partia.

Populli ynë është i lidhur më fort se kurrë me Partinë, ai ka besim të madh dhe të patundur te Partia, ai e ka të rrënjosur thellë dashurinë për Partinë e tij që e shpëtoi nga hallet dhe nga rreziqet, ai ka besim të patundur në politikën e Partisë dhe e ndjek me besnikërinë më të madhe në rrugën që i ka caktuar ajo, drejt socializmit. Këta faktorë vendimtarë e bëjnë popullin

tonë të pamposhtur, të guximshëm, të pafrikshëm dhe të sigurtë në të sotmen dhe në të ardhshmen.

I rrethuar nga të katër anët me armiq të egër, populli ynë kurrë s'e ka ndjerë veten larg nga Bashkimi Sovjetik, nga demokracitë popullore, nga kampi i paqes dhe i socializmit. Vendi ynë qëndron i patundur, si një kala e fortë, në prapavijat e armikut dhe njëkohësisht në zemrën e kampit të socializmit dhe të paqes. Populli ynë i ka ndjekur me kujdes ngjarjet ndërkombëtare dhe ka luftuar pareshtur në radhët e para të partizanëve të paqes, kundër luftës grabitqare, kundër nxitësve të luftës, amerikanëve, anglezëve, trockistëve të Beogradit, fashistëve italianë dhe grekë etj. Urrejtja e popullit tonë është e pakufishme ndaj atyre që kërkojnë të shtypin dhe të skllavërojnë popullin dhe vendin tonë. Për mbrojtjen e paqes, i gjithë populli ynë është mobilizuar aktivisht. Ai ju përgjegj i tëri thirrjeve të kongreseve të partizanëve të paqes, thirrjes së Stokholmit e të Varshavës dhe ka dënuar agresionin e poshtër amerikan në Kore. I madh e i vogël në vendin tonë, dhanë ç'kishin për të ndihmuar luftëtarët trima të Koresë që luftojnë për lirinë e tyre. Populli ynë e di sa e vlefshme është liria, sa gjak dhe mjerim ajo i ka kushtuar, ç'kriminelë dhe barbarë janë imperialistët amerikanë e anglezë dhe shërbëtorët e tyre.

Ligji i Kuvendit Popullor¹ kundër nxitësve të luftës

¹ Në janar 1951, Kuvendi Popullor i RPSH nxori ligjin që dënonte nxitjen dhe propagandën për luftë agresive, duke i cilësuar këto si «krime ndaj njerëzimit, paqes midis popujve dhe atdheut».

u aprovua nga i gjithë populli ynë. Janë formuar kudo komitetet e paqes, të cilat luftojnë aktivisht për të vënë në dukje qëllimet agresive të imperialistëve, barbarizmat e pashembullta që ata kryejnë në Kore e gjetkë, kërcënimet e tyre kundër Republikës së madhe Popullore të Kinës si dhe kundër kampit të paqes e të socializmit.

Ngjarje me rëndësi të madhe ka qenë për ne, vitin e kaluar, festimi i ditës së përvjetorit të çlirimit të vendit tonë. Ajo ditë ishte një manifestim i madh i forcës së popullit tonë. Armiqtë e egër të vendit tonë, imperialistët amerikanë dhe shërbëtorët e tyre titistë e të tjerë, panë se megjithëqë vendi ynë është i vogël e i rrethuar gjeografikisht prej tyre, ai është i madh, i fortë, i paprekshëm dhe i papërkulur. Në këtë ditë feste u manifestua edhe një herë solidariteti i popujve të tjerë vëllezër me popullin tonë. Delegacionet që kanë shkuar nga vendi ynë këto vite në Bashkimin Sovjetik, janë entuziazmuar nga dashuria që ushqejnë popujt sovjetikë për popullin tonë. Grupe artistike dhe kulturore kanë ardhur nga Bashkimi Sovjetik në vendin tonë, të cilat gjithashtu kanë ngjallur një entuziazëm të madh në masat tona punonjëse.

Ngjarje me rëndësi ka qenë për vendin tonë dhe nënshkrimi nga ana e gjithë popullit i mesazhit drejtuar Stalinit me rastin e 71-vjetorit të ditëlindjes së tij. Kjo ishte shprehje e zjarrtë e një besnikërie të madhe ndaj Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Bolshevike.

Zgjedhjet e 11 shkurtit për gjykatësit popullorë treguan dhe një herë forcën dhe unitetin e shëndoshë të popullit rreth Partisë dhe pushtetit popullor. Ato

ishin një fitore e shkëlqyer e demokracisë dhe e socializmit në vendin tonë dhe një grusht i fortë për armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm. Votimet për kandidatët e Frontit kanë qenë kudo mbi 99 për qind dhe pjesëmarrja ka qenë 100 për qind, 99 e ca për qind dhe mbi 98 për qind. Kjo tregon se forca e Partisë dhe e popullit tonë është e pathyeshme.

Nga ana ushtarake vendi dhe populli ynë janë kurdoherë vigjilentë. Ushtria jonë është e fortë, e edukuar mirë, ajo vazhdimisht bën hapa përpara dhe modernizohet. Ajo çdo ditë e më shumë përvetëson artin e lavdishëm ushtarak stalinian. Ajo është e lidhur ngushtë me popullin, i cili e do me shpirt dhe e ndihmon. Ushtria qëndron kurdoherë vigjilente dhe e gatshme për të mbrojtur pavarësinë dhe lirinë, integritetin tokësor të vendit dhe fitoret e popullit nga çdo armik i jashtëm dhe i brendshëm që do të përpiqet t'i kërcënojë.

Nga ana e Sigurimit të Shtetit kontributi ka qenë shumë i madh në shfarosjen e armiqve të brendshëm dhe të jashtëm, që përpiqen vazhdimisht të dëmtojnë popullin, Partinë dhe ndërtimin e socializmit.

Në valën e histerisë së përgatitjeve të mëdha për luftë, imperializmi amerikan me anë të satelitëve të tij, nacionalistëve të Beogradit, monarko-fashistëve të Athinës dhe neofashistëve të Romës, po bën përpjekje të panumërta për të rrëzuar pushtetin tonë popullor dhe për të skllavëruar e copëtuar Shqipërinë. Jashtë vendit tonë, nën drejtimin e amerikanëve, po organizohen banditët tradhëtarë të emigruar, të cilët po stërviten në kurse speciale për diversion dhe sabotazh kundër Republikës Popullore të Shqipërisë. Siç dihet, midis emi-

grantëve tradhëtarë shqiptarë ka kontradikta në mes njëri-tjetrit, ka grindje, por ka edhe bashkim për një qëllim të vetëm, që është qëllimi i tyre kryesor, të rrëzojnë pushtetin tonë popullor dhe të skllavërojnë popullin nën thundrën e imperialistëve amerikanë e anglezë dhe të satelitëve të tyre. Ka gjithashtu kontradikta në mes shteteve satelite të Amerikës siç janë Italia, Jugosllavia dhe Greqia, por qëllimi i tyre kryesor është të rrëzojnë pushtetin tonë popullor dhe ta copëtojnë Shqipërinë në mes të tyre. Prandaj të gjithë këta armiq të popullit tonë nën drejtimin e amerikanëve kanë përqëndruar bateritë e tyre edhe kundër nesh. Jugosllavia, ku sundojnë Tito me shokë, është shndërruar në një qendër spiunazhi amerikan. Tani s'ekziston më as maska e hollë në fytyrën e tradhëtarëve të Beogradit, që shitën Jugosllavinë te amerikanët. Atje mbretëron terrori dhe shtypja kundër njerëzve të thjeshtë të popullit, të klasës punëtore, kundër elementëve të shquar komunistë dhe patriotë. Industria, minierat, bujqësia punojnë për interesin e borgjezisë së re titiste e të kapitalistëve amerikanë.

Lidhje të ngushta dhe tanimë jo të maskuara, po kryhen në mes të titistëve e të monarko-fashistëve, në mes të titistëve e të fashistëve që janë në fuqi në Itali si dhe midis të treve me njëri-tjetrin. Tradhëtarët e Beogradit u ranë në shpinë partizanëve heroikë grekë. Me xhelatët e popullit grek ata janë plotësisht dakord, kanë rregulluar marrëdhënjet e tyre ekonomike, politike dhe strategjike. Selaniku është bërë porti jugosllavo-amerikan nga ku kalon materiali luftarak për Jugosllavinë dhe pasuritë e grabitura të popullit jugos-

llav për manjatët imperialistë amerikanë. Këto tri shtete satelite të amerikanëve janë në tratativa për krijimin e një aleance ballkanike kundër popullit shqiptar e bullgar dhe njëkohësisht po përgatitin, kurdoherë të drejtuar nga padronët e tyre, paktin agresiv të Mesdheut që do të përbëjë kompletimin e Paktit agresiv të Atlantikut Verior. Jugosllavia, Greqia dhe Italia, pra, janë bërë tri vatra shumë të rrezikshme për kampin e paqes dhe të socializmit dhe veçanërisht për vendin tonë. Provokacionet e tyre kundër nesh kanë qenë të vazhdueshme, si nga kufiri jugosllav ashtu edhe nga ai grek e italian, me anë të detit dhe të ajrit. Në këto tri vende, përveç përgatitjeve në ethe të armatosjes, janë grumbulluar edhe tradhëtarët fashistë, emigrantët shqiptarë, banditët dhe dezertorët e çdo kallëpi, të cilët përgatiten dhe bëjnë tentativa të shumta për t'u futur në vendin tonë me qëllime të caktuara: të organizojnë lëvizje me armë, sabotime, atentate kundër udhëheqësve të Partisë dhe të shtetit, të organizojnë qendra spiunazhi dhe informacioni për veten e tyre dhe për padronët e tyre. Këto veprime janë të koordinuara. Kuptohet vetëvetiu sa të nevojshme kanë qenë dhe janë forcimi dita-ditës i vigjilencës dhe goditjet e ashpra kundër gjithë kësaj veprimtarie armiqësore ndaj vendit tonë.

Ne kemi korrur suksese në luftën kundër armiqve të vendit, janë shfarosur banda parashutistësh të ardhur nga Italia dhe gjetkë. Të tilla kanë qenë grupet e parashutistëve të Ethem Çakos e grupi shumë i rrezikshëm i Alush Leshanakut që u shfarosën kryekëput; të tillë kanë qenë një numër i konsiderueshëm spiunësh dhe sabotatorësh të dërguar nga Rankoviçi dhe nga fashistët

grekë e italianë. Janë shpartalluar pa mëshirë tentativat e krijimit nga ana e tyre të bandave të armatosura në male. Me dhjetëra e me dhjetëra të tillë brigantë dhe spiunë janë likuiduar. Mbeturina e tyre, kriminelë ordinerë, dezertorë dhe vjedhës, që enden akoma andej-këtej u është bërë jeta e padurueshme. Bazat dhe çerdhet e spiunazhit të tyre në Jugosllavi, në Itali dhe Greqi, po dërmohen. Tani imperialistët amerikanë dhe shërbëtorët e tyre, traktet e veta të ndyta, në emër të organizatës tradhëtare «Shqipëria e lirë» i hedhin me anë avionësh. Ata shpresojnë të impresionojnë popullin për të mbuluar disfatat e tyre të njëpasnjëshme dhe njëkohësisht t'u japin armë dhe zemër reaksionarëve të brendshëm. Armës së Sigurimit të Shtetit i takojnë këto suksese të rëndësishme për mbrojtjen e vendit. Ajo ka qenë vigjilente, aktive, e zonja të përballojë këtë veprimtari të madhe armike dhe me ndihmën e popullit të korrë suksese.

Por me gjithë sukseset e mëdha që kemi arritur, të kemi mendjen të mos na zërë gjumi mbi dafina, pse armiku nuk fle dhe pikërisht forcimi i vendit tonë dhe disfatat e njëpasnjëshme të armikut e bëjnë atë ta ashpërsojë edhe më tepër luftën kundër Partisë dhe popullit. Është e domosdoshme të jetë e qartë për Partinë, se në të ardhshmen i duhet të përballojë rreziqe edhe më të mëdha që i pregatitin imperialistët amerikano-anglezë dhe shërbëtorët e tyre. Partia dhe i gjithë populli duhet të jenë kurdoherë të mobilizuar, të jenë vigjilentë dhe të pamëshirshëm kundër armiqve të brendshëm dhe të jashtëm. Mbrojtja e atdheut, e lirisë, e paqes dhe e socializmit s'është funksioni i disa armëve

speciale, por detyra urgjente dhe e parë e gjithë Partisë dhe popullit. Armët ndryshken në rast se Partia dhe populli dobësojnë luftën dhe vigjilencën. Vigjilenca dhe lufta e ashpër kundër armikut konsiston në zhvillimin e luftës së klasave që duhet të bëjë Partia dhe i gjithë populli i udhëhequr prej saj. Armiku i brendshëm dhe i jashtëm nuk e lufton Partinë dhe punën ndërtimtare të saj vetëm me parashutistë dhe diversantë, por ai përpiqet të na luftojë kudo dhe me njëmijë mënyra, për të sabotuar prapavijat tona, për të ulur moralin e njerëzve. Lufta e klasës dhe ashpërsimi i saj nuk duhet të zhvillohet vetëm në fshat kundër kulakut, siç e kuptojnë disa komunistë, por ajo duhet të zhvillohet e ashpër kudo, në fshat dhe në qytet, në fabrikë, në shkollë, në vetë njerëzit, që presioni i borgjezisë i influencon, i korrupton, i demoralizon. Lufta e klasës duhet të bëhet e ashpër kundër kulakut, kundër mentalitetit mikroborgjez të fshatarit, kundër fanatizmit, paditurisë, prapambetjes; lufta e klasës konsiston dhe duhet të bëhet atje ku ka vjedhje, ku ka prishje, ku ka shkatërrime të pasurisë së shtetit. Lufta e klasës duhet të bëhet edhe kundër shfaqjeve mikroborgjeze në komunistët, kundër burokratizmit, javashllëkut etj.

Partia duhet, më fort se kurrë, të shtërngojë radhët e saja dhe këto t'i mbajë kurdoherë të pastra nga elementët armiq, që përpiqen të infiltrojnë për ta marrë kalanë nga brenda. Ajo duhet të zhvillojë një luftë të ashpër dhe të pamëshirshme kundër banditëve të Beogradit dhe agjentëve të tyre.

Të demaskojmë të gjitha orvatjet dhe krimet e imperialistëve amerikanë e anglezë, të monarko-fashis-

tëve grekë, të neofashistëve italianë, të forcojmë vigjilencën dhe të ashpërsojmë luftën e klasave në vendin tonë, pse vetëm kështu vendi ynë do të forcohet edhe më shumë dhe do t'i mposhtim të gjitha orvatjet e armiqve të brendshëm dhe të jashtëm.

Duke bërë fjalë mbi mësimet që duhen nxjerrë nga procesi kundër kriminelit të shtetit hungarez Rajk dhe bashkëpunëtorëve të tij, «Për një paqe të qendrueshme, për një demokraci popullore», organ i Byrosë Informative të partive komuniste dhe punëtoze, në kryeartikullin e saj «Për më shumë vigjilencë revolucionare» shkruan:

«Procesi i Budapestit shtron me një forcë të përtëritur, përpara partive komuniste dhe punëtoze, çështjen e përforcimit të vigjilencës dhe të largpamjes revolucionare. Ky proces na mëson se është e nevojshme të jemi të pamëshirshëm kundrejt intrigave imperialiste, se është e nevojshme të qërojmë energjikisht agjentët e tyre që kanë depërtuar gabimisht në radhët e partive komuniste. Procesi tregon se partitë komuniste dhe punëtoze të vendeve të demokracive popullore, Çekosllovakia, Poloni, Rumani etj., duhet ta dyfishojnë vigjilencën në mënyrë të veçantë. Armiqtë e demaskuar në procesin e Budapestit pranuan se klika Tito ka bërë çdo përpjekje për të zhvilluar punën e saj minuese dhe në vendet e tjera të demokracisë popullore. Marksizëm-leninizmi na mëson se partitë e klasës punëtoze mund ta zbulojnë dhe ta thyejnë kudo armikun, cilado qoftë maska nën të cilën ai fshihet, vetëm në qoftë se ato ngrenë sistematikisht nivelin politik dhe ideologjik të kuadrove të tyre, në qoftë se i edukojnë këta kuadro

me një shpirt intransigjent për çdo shtrembërim të vijës së marksizëm-leninizmit, në qoftë se i konsolidojnë radhët e tyre nga pikëpamja organizative, në qoftë se çrrënjosin pa mëshirë nga radhët e tyre elementët e huaj, në qoftë se i denoncojnë dhe i dërmojnë me kohë të gjitha shtrembërimet nacionaliste dhe revizioniste duke ngritur ndërgjegjen e klasës punëtore dhe të të gjithë punonjësve. Le të dyfishojmë pra vigjilencën».¹

III. TË PËRMIRËSOJMË METODËN E UDHËHEQJES POLITIKE E ORGANIZATIVE TË PARTISË

Byroja Politike e KQ të PPSH dhe qeveria analizuan punën në lidhje me planin dyvjeçar të shtetit. Raportet që paraqesim përpara Komitetit Qendror përbejnë konkluzionet e kësaj analize.

Siç del nga raporti «Mbi realizimin e planit dyvjeçar», plani nuk është realizuar plotësisht dhe veçanërisht në disa sektorë, si ai i minierave, i industrisë, i grumbullimeve etj. Por ne kemi pasur edhe suksese. Nga këto suksese jeta e punonjësve është përmirësuar dhe mbrojtja e vendit është forcuar mjaft. Rezultatet e planit dyvjeçar, me gjithë mosrealizimin e plotë të tij, tregojnë një rritje të kënaqshme në të gjithë sektorët në krahasim me vitin 1948. Po ky grafik gjithashtu na tregon se përpjekjet për realizimin e planit janë shtuar nga viti në vit. Grafiku i vitit 1950 tregon një rritje më

¹ Gazeta «Për një paqe të qëndrueshme, për një demokraci popullore», Nr. 19 (46), 23 shtator 1949.

të mirë nga i vitit 1949, po kështu edhe nga një 3-mujor në tjetrin të vitit 1950. Gati në të gjithë sektorët janë bërë përparime si në realizime, ashtu edhe në drejtimin e në kontrollin e detyrave që u viheshin përpara udhëheqësve dhe punonjësve.

Përpjekjet e mëdha të Partisë, mobilizimi i klasës punëtore dhe entuziazmi i masave punonjëse të qytetit dhe të fshatit, kanë qenë faktorë vendimtarë për arritjen e këtyre sukseseve. Vetëm nuk duhet të kënaqemi me kaq dhe të vihemi në gjumë për të mos kërkuar e për të mos gjetur ku kanë qenë të metat dhe gabimet.

Kur Komiteti Qendror hartoi planin dyvjeçar të shtetit, ishte i bindur në mundësitë e realizimit të tij, pse planet tona s'janë plane «hipotezë», siç i cilëson shoku Stalin të ashtuquajturat plane që bëjnë vendet kapitaliste, por

«... plane-direktivë, të cilat janë të detyrueshme për organet drejtuese dhe që përcaktojnë drejtimin e zhvillimit tonë ekonomik në të ardhshmen për të gjithë vendin»¹.

Nga analiza që bëri Byroja doli qartë se plani ynë dyvjeçar duhej të ishte realizuar plotësisht. Komiteti Qendror dhe gjithë Partia, që ta përmbushnin me nder këtë detyrë, peshuan mungesat, vështirësitë, kuadrot teknike dhe joteknike etj., peshuan gjithashtu dhe anët pozitive që ekzistonin.

Një gjë del e qartë se ky mosrealizim si tërësi dhe

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 10, f. 317.

në veçantitë e tija, rrjedh nga mungesat tona subjektive në drejtimin, organizimin dhe në kontrollin jo të shëndoshë të ushtruar nga Partia dhe në radhë të parë nga forumet e saj udhëheqëse dhe nga qeveria e organet e saj vartëse.

Ne shohim nga ana tjetër se konditat objektive për realizimin e plotë të planit kanë ekzistuar:

a) Ne kemi një Parti heroike dhe luftëtare, të aftë të realizojë të gjitha detyrat, të mposhtë çdo armik, besnike deri në fund e marksizëm-leninizmit dhe e gatshme në çdo moment të hidhet në zjarr për të mbrojtur popullin e vet. Entuziazmi i masave punonjëse të vendit tonë, me në krye klasën punëtore, ka qenë shumë i madh dhe kjo ishte një armë e paçmueshme dhe vendimtare për Partinë që të korrte një sukses të plotë.

b) Realizimi me sukses të plotë i planit, ishte plotësisht i mundshëm, pse vendi ynë është një demokraci popullore, ku ndërtohet socializmi dhe ku janë shtetëzuar minierat, industria, transportet, financat, tregëtia e brendshme dhe e jashtme e kështu me radhë.

c) Kemi pasur ndihmën e madhe materiale të BRSS, kemi eksperiencën e vazhdueshme dhe të gjerë të tij, që na jepet në të gjithë sektorët e jetës së vendit tonë. Kemi pasur ndihmën edhe të demokracive popullore.

Me hartimin e planit dyvjeçar, Partia kishte për qëllim ngritjen e nivelit ekonomik, politik dhe kultural të masave punonjëse, ngritjen e nivelit të jetës së popullit, forcimin e pushtetit dhe mbrojtjen e vendit nga të gjitha pikëpamjet. Për t'i arritur këto qëllime, plani synonte që industria dhe minierat të zhvilloheshin

dhe të shtohet prodhimi ynë industrial dhe mineral, të zhvillohet e të përmirësohet bujqësia për të prodhuar më shumë dhe më mirë, të shtohet dhe të përmirësohet rrjeti i komunikacioneve dhe mjetet e transportit, të organizohet dhe të forcohet tregëtia e brendshme shtetërore dhe kooperativiste, të zhvillohet dhe të bëhet e masave kulturore dhe arsimore, të forcohen financat, pushteti, mbrojtja e vendit e kështu me radhë.

A i realizuam ne si duhet detyrat që kishim përpara për të zbatuar plotësisht vijën e Partisë? I realizuam, po me mjaft të meta dhe gabime. Raporti «Mbi realizimin e planit dyvjeçar» i vë në dukje këto të meta dhe përcakton masat që duhet të marrim në të ardhshmen për t'i zhdukur ato. Por ka edhe më. Të metat dhe gabimet kanë ekzistuar edhe për një arsye tjetër që na duket shumë e rëndësishme: disa mungesa nga ana e drejtimit dhe e mobilizimit të Partisë. Fshati që duket s'do kallauz. Vetë mosrealizimi i planit tregon se në punën tonë dhe në vetë ne ka pasur lëshime dhe gabime, që kanë dëmtuar dhe kanë frenuar ecjen përpara. Është detyra e Partisë dhe e udhëheqjes së saj t'i shohë drejt në sy këto gabime, t'i godasë dhe t'i spastrojë sa më parë, pse detyra edhe më të rëndësishme do të na vihen përpara në të ardhshmen në lidhje me planin tonë pesëvjeçar që do të hartojmë për së shpejti. Në «Historinë e PK (b) të BS» për këtë çështje thuhet:

«Partia është e pathyeshme, kur ajo nuk ka frikë nga kritika dhe autokritika, kur ajo nuk i fsheh gabimet dhe të metat në punën e saj, kur ajo i mëson dhe i edukon kuadrot duke

marrë si shembull gabimet e punës së partisë dhe kur ajo di t'i ndreqë me kohë gabimet e veta»¹.

Komiteti Qendror dhe Partia mbajnë përgjegjësinë përpara popullit për mosrealizimin e këtij plani dhe ky plenum duhet t'i nxjerrë qartë këto përgjegjësi. Prandaj duhet të bëjmë një analizë të shëndoshë të problemit që na paraqitet. Ne kemi bërë shumë herë analiza që i kanë vlejtur Partisë, që kanë sjellë përmirësime në punë, që kanë ndrequr gabime dhe situata të vështira. Ne kemi kritikuar shokë dhe organe, qoftë këta të Partisë ose të pushtetit dhe kritikantët kanë bërë mirë, kanë ndihmuar, por në të shumtat e herës kritikantët kanë qenë të njëanshëm, nga lart-poshtë dhe jo edhe nga poshtë-lart. Kemi kritikuar të tjerët, por kemi evituar të kritikojmë veten, kur edhe ne kemi bërë gabime. Kemi kërkuar të bëhet autokritikë, por autokritikë të shëndoshë nuk kemi bërë ashtu si duhet kur edhe ne kemi gabuar. Kjo tregon se kritika dhe autokritika në Partinë tonë dhe veçanërisht në organet udhëheqëse, lë mjaft për të dëshiruar. Është, pra, urgjente që Komiteti Qendror t'i japë shembullin Partisë, pse vihen re shumë shfaqje jo të mira në disa shokë të Komitetit Qendror dhe në udhëheqës të tjerë që punojnë në Parti dhe në pushtet. Kritika dhe autokritika bolshevike është i vetmi mjet që paralajmëron dhe spastron manifestimet si kryelartësinë, fodullëkun, kënaqësinë me vetëveten, arrogancën, burokratizmin,

¹ «Historia e PK (b) të BS». Tiranë, 1953, f. 373—374.

mungesën e vigjilencës revolucionare, javashllëkun dhe shumë të meta të tjera, që po s'u zhdukën me kohë, trashen dhe e çojnë komunistin në rrugëkryq me Partinë. Klasikët na mësojnë se qëndrimi kritik kundrejt të metave dhe gabimeve, edukimi i kuadrove me frymën e kritikës e të autokritikës, përbëjnë një nga tiparet më karakteristike të partive marksiste-revolucionare, se kondita e parë e pathyeshmërisë dhe e vitalitetit të partive është një kritikë e hapët, një kritikë parimore, që nuk toleron kompromise, një autokritikë e singërtë dhe krejt e ndershme.

Është, pra, e domosdoshme që ne të përpiqemi të gjejmë shkaqet e mosrealizimit të këtyre detyrave, të pranojmë ndershmërisht kritikën që na bëhen nga të tjerët, të bëjmë gjithashtu autokritikë, pse vetëm atëherë kritika që do t'u bëjmë ne të tjerëve, do të jetë e pranueshme dhe do të zërë vend.

1. — ROLI DREJTUES I KOMITETIT QENDROB DHE LËSHIMET QË JANË VËRTËTUAR NË KËTË DREJTIM

A kemi qenë ne rigorozë dhe vigjilentë sa duhej që Komiteti Qendror të ushtronte kompetencat dhe detyrat e mëdha që i ka ngarkuar kongresi? Kjo gjë është bërë me të meta dhe këto të meta qëndrojnë te ne vetë dhe në metodën e punës jo të shëndoshë sa duhet. Kjo ka ndikuar negativisht dhe është reflektuar edhe në bazë. Le të nisemi që këtej për të gjetur burimin e shumë të metave e gabimeve që vërtetohen në punën tonë. Asnjë nga ne nuk mund të thotë se nuk i ka të qarta detyrat

dhe rolin udhëheqës të Komitetit Qendror si forumi më i lartë i Partisë pas kongresit. Gjithashtu secili nga ne e di rolin dhe përgjegjësinë që ka, si një nga udhëheqësit kryesorë, anëtari i këtij forumi të lartë të Partisë. Por praktika e punës na tregon se në këtë drejtim kemi bërë lëshime si forum dhe si pjesëtarë veç e veç të këtij forumi.

a) *Pregatitjet e mbledhjeve të Plenumit të Komitetit Qendror*

Është Byroja Politike ajo që duhet të përgatitë mbledhjet e zakonshme dhe të jashtzakonshme të Komitetit Qendror e të drejtojnë zhvillimin e punimeve të tij. Problemet që shtron Byroja Politike përpara plenumit, nuk mund të jenë të shkëputura nga jeta e Partisë dhe e shtetit, nga detyrat që i janë caktuar atij dhe Partisë për t'i kryer. Ajo jep llogari përpara Komitetit Qendror dhe kërkon ndihmën e tij. Byroja Politike ka përballuar një volum të madh pune dhe ka luftuar të drejtojnë të gjithë sektorët, por megjithkëtë, ajo ka pasur edhe të meta në punën e saj. Një e metë serioze e Byrosë në këtë drejtim ka qenë mospregatitja mirë e materialeve që do t'i shtroheshin plenumit. Ne kemi bërë plume, ku janë ngritur çështje të rëndësishme që kanë forcuar Partinë, që kanë spastruar situata të sëmura dhe të rrezikshme, por këto mund të bëheshin edhe më shumë e të përgatiteshin edhe më mirë. Mund të bëheshin edhe plume të veçanta, posaçërisht për probleme të rëndësishme, siç janë problemi i edukimit marksist-leninist në Parti, problemi i fshatit, problemi i forcimit të Partisë me elementë të klasës

punëtore, çështja e demokracisë së brendshme, e kritikës dhe e autokritikës në Parti, problemi i drejtësisë në Republikën tonë Popullore, problemi i arësimit e i kulturës, problemi i shtypit etj. etj. Komitetit Qendror, pra, duhej t'i ishin paraqitur një sërë problemesh me rëndësi për Partinë dhe për vendin që ai jo vetëm të vihej në dijeni si duhej, por t'i jepej mundësia për të dhënë ndihmën e tij nëpërmjet vendimeve më të qarta, më të plota, se sa ato që ka zgjidhur Byroja Politike. Është, pra, një e metë e Byrosë Politike në këtë drejtim që nuk ka qenë në gjendje t'ja përgatitë mirë këto materiale Komitetit Qendror dhe të kërkonte më shumë ndihmën e tij. Një gjë e tillë do të bëhej mirë dhe do të kishte rezultate, në rast se për përgatitjet e materialeve, që i janë paraqitur plenumit, do të kontribuonin më shumë të gjithë anëtarët e Byrosë Politike dhe vetë shokët e plenumit.

Materialet që i përgatiten plenumit nëpërmjet raporteve të Byrosë, duhet të jenë rezultati i studimit të hollësishëm të problemeve nga ana e Byrosë, të jenë sinteza e debateve dhe e diskutimeve nga ana e saj. Por zakonisht nuk është bërë kështu. Të pakta kanë qënë preokupacionet e Byrosë për përgatitjen e plenumit, me përjashtim të atij shoku që përgatit referatin e që, zakonisht, kam qenë unë. Vështirësia nuk qëndron në formulimin e raportit, por në brendinë e tij. Duke ndjekur një metodë pune, që lë shumë për të dëshiruar, problemet që janë shtruar në Byro, kanë qënë të shumta e të pastudjuara thellë. Një gjë e tillë ka shkaktuar për mua vështirësi në paraqitjen e problemeve, pse pa një punë përgatitore të mirë nga ana e Byrosë, edhe refe-

ratet e mia kanë dalë me të meta. Është Sekretari i Përgjithshëm ai që, zakonisht, duhet të paraqesë përpara plenumit raportet kryesore, por dhe shokët e tjerë duhet të ngarkohen me këtë punë. Këtë gjë e kemi praktikuar më mirë tani së fundi, ndërsa më parë një pjesë e shokëve të Byrosë aktivizoheshin më pak duke menduar se referatin duhet ta bëjë Sekretari i Përgjithshëm dhe kështu bëhej deri diku një farë shkarkimi nga kjo detyrë. Përveç këtyre të metave, referati diskutohet përciptas edhe në Byro, pse ka pasur raste që disa shokë të kenë ardhur të papregatitur, bile edhe diskutimin ta kenë improvizuar gjatë mbledhjes.

Si rrjedhim i këtyre të metave, mbledhjet e plenumit nuk kanë qenë aq frutdhënëse, diskutimet kanë qenë të dobëta, problemeve nuk u shkohej deri në fund, pse shtroheshin shumë probleme dhe vëmendja e interesimi shpërndahehin, kritika e autokritika ishte e dobët, kritika drejtohej vetëm nga lart-poshtë, kritikohesh dhe bënte autokritikë vetëm shoku i Komitetit Qendror që ishte i lidhur me problemin, ndërsa të tjerët, me në krye anëtarët e Byrosë, i shpëtonin kritikës dhe autokritikës për të metat dhe gabimet e tyre. Sigurisht ai anëtar i Komitetit Qendror që kritikohesh, mund të kishte gabime në punën e vet, por gabimet e tij nuk mund të kenë qenë të shkëputura nga gabimet e të tjerëve që kanë përgjegjësi më të larta se ai në Parti ose në shtet. Shumë çështje rrjedhin nga një punë e tillë që e dobësojnë kuptimin e vërtetë të rolit drejtues të Komitetit Qendror. Krijohet në shokët e Komitetit Qendror drojtja për të kritikuar dhe kjo, pse ne nuk i hapim rrugën dhe perspektivën që ai të shohë më gjerë

qështjet, t'i thellojë dhe më shumë problemet, të shohë më mirë të metat e gabimet, jo vetëm të tijat, por edhe të të tjerëve, edhe të Byrosë, edhe të Sekretariatit dhe të të gjitha forumeve të tjera të Partisë.

Thashë më lart se Byroja duhej t'i shtronte plenumit probleme të veçanta, të rëndësishme dhe të studjuara më mirë, pse këto jo vetëm do të sillnin me vete të mirat, që përmenda pak më sipër, por do të vinin përpara përgjegjesisë personale shokët e Komitetit Qendror që drejtojnë sektorin e punës që analizon plenumi. Kështu shoku përgjegjës i një sektori punë nuk mund të lajë duart nga përgjegjësia e madhe e tij, siç bëhet zakonisht, kur në plenum shtrohen njëqind probleme dhe me lehtësi kalohet me një diskutim të improvizuar gjatë mbledhjes. Kështu që çdo shok i Komitetit Qendror nuk mund të qëndrojë më spektator ose dëgjues kur rrihen probleme të rëndësishme të Partisë dhe të shtetit. Komiteti Qendror do të dëgjojë pse punët shkojnë keq në miniera, ose pse qështjet organizative të Partisë nuk çin mirë dhe pse bëhen gabime në këtë drejtim, ose pse në sektorin e drejtësisë ekziston oportunitizëm i theksuar, pse edukimi marksist-leninist dhe kultura në përgjithësi nuk bëjnë hapa përpara sa duhet etj. Byroja Politike duhet të marrë përgjegjësitë e saja, por edhe shoku përgjegjës, anëtar i Komitetit Qendror, i ngarkuar në këto punë, t'i japë llogari si duhet Komitetit Qendror për punën e vet e të vartësve të tij, për punën e Partisë e të organeve shtetërore që ai drejton në sektorin e tij. Kështu gjallërohet Komiteti Qendror, kështu përqëndrohemi në problemet që kërkojnë zgjidhje, kështu zbulohen të metat dhe

gabimet, zhvillohet ndjenja e përgjegjësisë, forcohet kritika e autokritika, demokracia e brendshme e Partisë dhe kuptohet drejt roli i madh drejtues i Komitetit Qendror.

b) Anëtari i Komitetit Qendror të mbajë përgjegjësi si drejtues i sektorit të ngarkuar dhe si anëtar i forumit udhëheqës

Çdo anëtar i Komitetit Qendror është caktuar në krye të një sektori të rëndësishëm, qoftë në funksione partie, qoftë në funksione shtetërore, qoftë në të dyja njëkohësisht në bazë të organizimit që ka caktuar Partia për drejtimin e Partisë dhe të pushtetit tonë popullor. Ka shokë të Komitetit Qendror që, duke pasur përgjegjësi të ndryshme në Parti ose në shtet, bëjnë pjesë në Byronë Politike ose në Sekretariat. Çdo forum ka detyrat dhe kompetencat e tija dhe gjithashtu çdo anëtar i Komitetit Qendror ka përgjegjësi për kryerjen e detyrës së veçantë që i është ngarkuar, por njëkohësisht ka përgjegjësi edhe si udhëheqës i forumit të lartë ku ai bën pjesë. Këto dy përgjegjësi nuk mund të ndahen nga njëra-tjetra. Ç'thashë më lart, mund të duken të qarta, por në praktikën e punës nuk kuptohen dhe nuk zbatohen mirë. S'kuptohet mirë përgjegjësia personale e nuk kombinohet drejt kjo me përgjegjësinë kolektive.

Ka mjaft shokë të Komitetit Qendror që, të zhytur në detyrën që u është ngarkuar, e ndjejnë veten të shkëputur dhe pa përgjegjësi për sektorët e tjerë të jetës së Partisë dhe të shtetit si udhëheqës dhe anëtarë të Komitetit Qendror ose të Byrosë Politike që janë. Të mendohet e të vepohet në këtë mënyrë do të thotë

të harrohet përgjegjësia që ka gjithsecili si anëtar i forumit udhëheqës. Kur ngjet kështu kjo sjell, natyrisht, me vete dhe nënvleftësimin e vetë forumit udhëheqës. Duke rënë në këtë gabim të parë, rrëshqitet edhe në një tjetër: udhëheqja kryesore e Partisë, ka rrezik të shihet jo më në Komitetin Qendror, por në Byronë Politike, në Sekretariatit ose në sekretarët e Komitetit Qendror veç e veç, pse me këto forume dhe me këta shokë janë edhe takimet më të shpeshta. Në fakt, pra, mendohet se përgjegjësia e gjithsecilit anon më shumë përpara Byrosë ose Sekretariatit se sa para Komitetit Qendror. Krijohet kështu kuptimi i një udhëheqjeje së prapthi dhe një farë imuniteti për Byronë e Sekretariatit ose për anëtarët veç e veç të këtyre forumeve. Duke mos e ndjerë sa duhet përgjegjësinë e madhe kolektive, duke mos e kuptuar rolin mbi të gjithë njerëzit dhe forumet e Komitetit Qendror, duke mos u interesuar si udhëheqës për sektorët e tjerë të jetës së Partisë dhe të shtetit, vjen vetëvetiu nënvleftësimi i rolit udhëheqës të Komitetit Qendror, rrjedh gabimi tjetër që, Byroja ose Sekretariati ose sekretarët e Komitetit Qendror janë të pagabueshëm, pra, të përjashtuar nga kritika dhe autokritika. Por ka edhe rreziqe të tjera. Këtej rrjedh rreziku i një pune mekanike, burokratike në udhëheqje, i një pune ku mungon perspektiva e gjerë prej një udhëheqësi me kompetenca, me inisiativë vetëvepruese në gjithsecilin prej nesh dhe në tërësi si forum. Këtu e ka burimin dhe koncepti i gabuar që «unë mjafton të bëj punën time, se për punët e mëdha ka kush mendon, janë dy, tre, ose pesë shokë nga më kryesorët». Kështu harrojmë se udhëheqja e Partisë sonë

në të gjithë gamën e saj nuk qëndron në dy-tre shokë, por në udhëheqjen kolegjiale, ku gjithsecili sjell eksperiencën e gjithë Partisë dhe të popullit, të punës së tij, të mendjes së tij dhe formohet kështu udhëheqja jonë e shëndoshë marksiste-leniniste.

Çdo forum i Partisë ka detyra, ka përgjegjësi, ka kompetenca të caktuara mirë, ashtu si kanë edhe njerëzit në punë, të cilat duhet t'i kemi të qarta të gjithë dhe të mos gabojmë më në këtë drejtim.

Po i njëjti fenomen ngjet dhe në Byronë Politike. Ka shokë që i diskutojnë gjallërisht problemet, po ka edhe raste që bëhen diskutime të cekta, gjë që ka rrezik të çojë në ngushtësinë e konceptit të drejtimit nga ana e Byrosë dhe, me dashje ose pa dashje, të dalim në rrugën që «Sekretariati është në praktikë forumi më i rëndësishëm i Partisë, pse atje janë shokët më të rëndësishëm». Po të mendohet kështu format organizative të udhëheqjes së Partisë, i kemi përmbysur dhe u kemi ndryshuar kuptimin. Këtu të çojnë këto pikëpamje jo të drejta përse i përket rolit drejtues të Komitetit Qendror, të Byrosë Politike dhe të Sekretariatit. Këtej, pastaj, lind dhe zhvillohet kuptimi tjetër i gabuar se, sa më tepër të afrohesh te Sekretariati, aq më i paprekshëm dhe i pakritikueshëm bëhesh. Pikëpamje të tilla, natyrisht, në rast se nuk luftohen dhe nuk pastrohen, bëhen të rrezikshme për Partinë dhe të çojnë në rrugën antiparti. Disa prej njerëzve «kryesorë» u rritet mendja, kujtojnë se janë të pagabueshëm, flasin për kritikën dhe autokritikën, por vetëm të bëhet në një drejtim nga lart-poshtë, kurse asaj nga poshtë-lart, ja mbyllin rrugën me prita; flasin kundër burokratizmit, por zhyten vetë

në të, bërtasin për demokracinë e brendshme të Partisë, por ata janë të parët që e dobësojnë atë, dobësohet kontrolli dhe disiplina në punë, krijohen moskënaqësira të justifikueshme dhe të pajustificueshme, të hapëta dhe të heshtura, por vjen momenti që pëlçasin në rrugën e drejtë ose të shtrembër. Është urgjente që këto pikëpamje të gabuara të spastrohen sa më parë.

c) Shokët e forumit udhëheqës të lënë gjurmë kudo që shkojnë

Ne kemi vendosur dhe kështu bëhet, që çdo anëtar i Komitetit Qendror të vihet në dijeni të direktivave, të qarkoreve dhe të rezolucioneve që lëshon Byroja Politike e Sekretariati. Shokët e Komitetit Qendror i kanë dyert të hapura kudo në Parti, në Byro, në Sekretariat, te sekretarët veç e veç dhe kudo në pushtet. Pra, si drejtues kryesorë të Partisë e kanë për detyrë të interesohen dhe të kontrollojnë çdo gjë dhe për të kryer këtë ata i kanë të gjitha mundësitë. Por këto kompetenca dhe detyra nuk zbatohen si duhet. Të rrallë janë ata shokë të Komitetit Qendror që interesohen për problemet e Partisë dhe të shtetit si udhëheqës kryesorë, si anëtarë të Komitetit Qendror që, atje ku shkojnë, të ndërrojnë rrënjësisht situatën, jo vetëm në sektorin e tyre të punës, por edhe në sektorë të tjerë dhe të lënë gjurmët e vajtjes së tyre në bazë. Ata në shumë raste, përkundrazi, s' shohin veçse punën e tyre të caktuar, pavarësisht se dhe atë e shohin mirë apo keq. Anëtarët e Komitetit Qendror shkojnë shpesh (por ka dhe që shkojnë rrallë) të kontrollojnë sektorët e punës së tyre, por fare pak, për të mos thënë aspak, interesohen për

problemet e tjera të Partisë ose të pushtetit në atë rreth ose në atë ndërmarrje. Ata as që bisedojnë me sekretarët e Partisë në rrethe ose me funksionarët e Partisë ose të pushtetit jashtë sferës së punës speciale të tyre. Shokët e Komitetit Qendror shumë rrallë i shohim të vijnë në Byro ose në Sekretariat ose te unë, për të na vënë në korrent për gjendjen, për situatat që ata konstatojnë, për gabimet, për pikëpamjet e gabuara që shfaqen në sektorët e tyre dhe në sektorë të tjerë. Këto gjëra pak i preokupojnë anëtarët e Komitetit Qendror. Kështu nuk ndihmohet as Partia as udhëheqja dhe nuk korrigjohen të metat. Por ka edhe më. Shokët e Komitetit Qendror, që drejtojnë sektorë të rëndësishëm në pushtet, nuk mbështeten si duhet mbi Partinë dhe rrallë u shkon në mendje që të këshillohen dhe të këshillojnë, ose të drejtojnë me udhëzime dhe me ndihma Partinë në dikasteret e tyre ose në ndërmarrjet vartëse. Ata bëjnë me dhjetëra mbledhje të shefave e të nënshefave, por s'u shkon ndërmend se puna që çalon, që ka vjedhje, që ka sabotime, abuzime, mungesë disipline etj., vjen ngaqë Partia në atë sektor nuk është luftarake sa duhet, nuk ka si duhet vigjilencë revolucionare, nuk respektohet gjithnjë demokracia e brendshme, nuk është në lartësinë e duhur kritika dhe autokritika e shëndoshë nga poshtë-lart dhe nga lart-poshtë, nuk ekziston kudo një disiplinë e çelniktë që vetëm Partia është në gjendje ta vendosë. Anëtari i Komitetit Qendror nuk interesohet sa duhet për politikën e kuadrove në sektorin e tij, nuk shtrohet si duhet me sekretarin e Partisë dhe me funksionarët që merren me këtë punë për t'i ndihmuar, për t'i këshilluar, për t'i kritikuar për gabimet. Ai kujton

se vëtëm plani duhet të realizohet, por nuk mendon sa duhet se planin e realizon Partia dhe njerëzit. Ka raste që ndonjë anëtar i Komitetit Qendror neglizhon të vejë në cclulën e tij, bile dhe kur vete, jo vëtëm nuk interesohehet më parë ta ndihmojë sekretarin e celulës për mënyrën e shtruarjes së problemeve, por edhe pjesëmarrja e tij në diskutim nuk është shumë e dalluar nga lartësia e diskutantëve të tjerë, anëtarë të thjeshtë të Partisë.

Të gjitha këto gjëra, këto të meta dhe gabime në këtë drejtim nuk na kanë lejuar të shikonim dobësitë e tjera që do të analizojmë më poshtë. Këto patjetër e kanë dobësuar punën.

Prandaj detyra e çdo anëtari të Komitetit Qendror është t'i analizojë mirë këto situata dhe t'i zhdukë sa më parë këto të meta nga vetja e tij, pse spastrimi i këtyre të metave kryesore (ka edhe të tjera), do ta bëjnë Komitetin Qendror më të aftë të drejtojë si duhet Partinë dhe shtetin dhe do të shtojnë më shumë energjinë, inisiativën, mpreftësinë dhe zotësinë e çdo njërit nga ne. Kjo do të jetë një ndihmë e paçmueshme për Partinë tonë. Duhet në radhë të parë që autoriteti i Komitetit Qendror të jetë i plotë. Ai dhe çdo anëtar i tij, veç e veç, të kenë mirë në dorë të gjithë drejtimin, të gjitha kompetencat që u ka dhënë kongresi dhe Partia, të drejtojnë dhe të kontrollojnë mirë gjithë Partinë dhe forumet e saj, të udhëheqin me vendosmëri dhe urtësi në rrugën e ndritur drejt socializmit.

2. — SI KA DREJTUAR DHE SI KA KONTROLLUAR BYROJA POLITIKE ZBATIMIN E DETYRAVE TË SAJA?

Byroja Politike si një nga forumet kryesore udhëheqëse të Partisë, drejton Partinë dhe qeverinë nëpërmjet formave organizative që i ka caktuar Statuti dhe Partia. Ajo shqyrton çështjet që i vijnë nga Sekretariati dhe nga qeveria. Me anë të Sekretariatit, që është udhëheqja operative e punëve të drejtorive të Komitetit Qendror dhe koordinuesja e aktivitetit të tyre, Byroja Politike drejton dhe kontrollon aktivitetin e Partisë, jetën politike dhe organizative të saj, drejton dhe kontrollon të gjithë aktivitetin e Partisë për realizimin e vijës në të gjithë sektorët e ndryshëm. Nga ana tjetër, Byroja Politike drejton aktivitetin shtetëror nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe organeve të saj vartëse. Duhet, pra, që Byroja Politike të ushqehet mirë dhe drejt nga Sekretariati dhe nga qeveria, ta ketë mirë punën në duart e veta, që të mund të zgjidhë drejt problemet që i dalin përpara, të caktojë mirë detyrat, të kontrollojë rigorozisht zbatimin e detyrave që i shtrohen Partisë dhe pushtetit dhe të marrë masa atje ku çalon puna. Byroja Politike ka kryer një punë të madhe në këtë drejtim, me gjithë të metat që ka pasur në veprimtarinë e saj.

Në punën e Byrosë Politike ka pasur përparime në krahasim me të kaluarën. Ajo ka kryer organizimin e aparatit të Komitetit Qendror, organizimin e aparateve të komiteteve të rretheve, ka përmirësuar metodën e punës së këtyre aparateve, gjë që ka sjellë përmirësim të dukshëm dhe hov më të madh të punës së Partisë.

Nga ana tjetër Byroja Politike me masat organizative që ka marrë në drejtim të pushtetit, duke organizuar Kryesinë e Këshillit të Ministrave, duke bërë një ndarje më të mirë të dikastereve dhe të ndërmarrjeve vartëse të tyre, duke përmirësuar aparatet e këtyre dikastereve dhe të ndërmarrjeve, ka bërë që edhe në këtë sektor të ndjehen efektet e kësaj pune më të mirë, më të rregullt, më të kontrolluar se ç'ka qenë më parë. Por kjo nuk ka qenë e mjaftë dhe në aktivitetin e Byrosë, të Sekretariatit dhe të qeverisë ka pasur mjaft të meta dhe gabime, që e kanë dëmtuar seriozisht punën.

Përsa i përket drejtimit të qeverisë dhe kontrollit të zbatimit të detyrave që shtroheshin përpara Partisë dhe shtetit, lidhur me realizimin e planit dyvjeçar deri në muajin qershor të vitit të kaluar, në punën e Byrosë Politike ka pasur të meta dhe gabime. Konkretisht për çështjet e qeverisë dhe drejtimin e ekonomisë merreshim unë dhe shoku Spiro Koleka. Por praktikisht për mua ka qenë shumë vështirë të mbaja në lidhje dhe të kontrolloja tërë punën që duhet të kryenin ministrinë. Ishim shoku Koleka dhe unë që duhej t'i paraqitnim Byrosë Politike të gjitha problemet që i shtroheshin Partisë sonë në drejtimin e ekonomisë popullore. Kjo është kryer, por me të meta dhe këtu qëndron një nga arësyet që plani në vitin 1949 nuk ka ecur mirë dhe pati reperkusionet e tij në vitin e dytë të planit tonë ekonomik. Megjithkëtë, Byroja Politike zgjidhi një sërë problemesh gjatë vitit 1949, studjoi një varg çështjesh, mori një sërë vendimesh e masash të rëndësishme, por kontrolli i zbatimit të tyre nga shokët ministra dhe nga ne ishte i dobët.

Industria jonë nuk shkonte mirë, minierat po ashtu, komunikacioni ca më keq, bujqësia shumë dobët. Në ndërtime, në tregëti, po e njëjta gjë. Byroja Politike shumë herë i ka marrë në shqyrtim këta sektorë, ka dalë dhe me vendime, por nuk është thelluar sa duhet në problemet e tyre, për arsye se vetë organizimi i punës ishte i dobët si nga ndihma e kontrolli i Partisë, ashtu edhe nga drejtimi kolegjial i qeverisë. Nga mungesa e kontrollit të zbatimit të vendimeve të Byrosë Politike u rrezikua realizimi i planit. Disa nga ministrat, duke u munguar kontrolli nga lart, nuk i kanë ndjekur si duhet detyrat e tyre dhe llogaria, që ata jepnin përpara Këshillit të Ministrave dhe përpara Byrosë Politike ka qenë e cekët. Studimet e paraqitura prej tyre shumë herë nuk tregonin realitetin, pse ata vetë nuk ishin si duhet në krye të detyrës, nuk e ndiqnin realizimin e planit këmba-këmbës që të zbatonin deri në fund vendimet e Byrosë Politike dhe të qeverisë. Në një situatë të tillë, natyrisht, përfituan armiqtë për të goditur ekonominë tonë, për të shthurur disiplinën e planit, për ta sabotuar këtë. Armiku gjeti fushë të na sabotonte egërsisht në transport, në industri, në prodhimin e naftës dhe të mineraleve të tjera, që kanë dëmtuar kryesisht realizimin e planit tonë dyvjeçar. Patjetër Byroja Politike nuk fjeti në këtë drejtim. Ajo e mori në studim shumë herë çështjen e naftës, ku tri herë në një vit u detyrua të rishikonte planin. Ajo mori në shqyrtim transportet dhe sektorët e tjerë që çalonin dhe doli me masa konkrete dhe energjike, të cilat i dhanë fund kësaj situatë shumë të sëmurë, që kishte mundur të krijonte grupi i Abedin Shehut, Niazi Islamit,

Shyqri Këllezit e të tjerë. Ajo mori gjithashtu masat për riorganizimin e qeverisë dhe krijimin e Kryesisë së Këshillit të Ministrave që do ta vinte punën më në rrugë të drejtë. Jo vetëm Byroja Politike nuk ishte në gjendje të kontrollonte si duhej realizimin e planit, por as vetë Komisioni i Planit nuk ishte në gjendje të bënte këtë kontroll, qoftë dhe në punimet më kryesore. Për këtë përgjegjësi kemi të gjithë, si ne shokët e Byrosë Politike e të Komisionit të Planit, ashtu dhe shokët ministra, anëtarë të Komitetit Qendror ose jo. Ministrat, duke mos qenë si duhet në krye të detyrës, duke u mbytur në një punë burokratike, në vend që të zbatonin deri në fund vendimet e Komitetit Qendror, të Byrosë dhe të qeverisë dhe t'ju lehtësonin atyre punën, ua vështirësuan ca më tepër. Shumë probleme i kanë shpëtuar Byrosë nga këto të meta dhe gabime, shumë probleme ajo nuk i ka studjuar rrënjësisht dhe disa herë nuk ka dalë me vendime të qarta. Në këtë çështje kam përgjegjësi edhe unë se duhet të isha më rigoroz në kërkimin e llogarisë, në ndarjen dhe në zbatimin e detyrave që i caktonim vetes dhe shokëve të tjerë. Po edhe ndihma në këtë drejtim nga disa shokë të Byrosë nuk ka qënë e mjaftueshme. Kërkohet një thellim më i madh në problemet që shqyrton Byroja, një pjesëmarrje më aktive në rrahjen e çështjeve, pavarësisht se në cilin sektor punon njëri ose tjetri. Ka shokë që interesohen gjallërisht dhe puna ecën përpara. Shoku Mehmet është një nga ata që ka kontribuar shumë në mbarëvajtjen e punës në Byro. Ai ka qënë në krye të detyrës vazhdimisht dhe punën e sotme nuk e le për nesër. Ai është i ashpër, por i drejtë në kërkimin e llogarisë; ai është

metodik në punë, i studjon çështjet dhe di të kombinojë mirë studimin me operativitetin. Përsa i përket shokut Tuk, puna e tij nuk ka qenë e kënaqshme, përkundrazi, ka qenë shumë e dobët, me gabime dhe të meta shumë serioze në kryerjen e detyrës si sekretar i Komitetit Qendror për çështjet organizative dhe kuadrot. Ai ka pasur pikëpamje oportuniste në vijën politike dhe organizative të Partisë. Kjo ka dëmtuar mjaft punën tonë dhe ka qenë një pengesë serioze. Çështja e shokut Tuk do të trajtohet veçanërisht.

Këto të meta që kanë ekzistuar në Byro, kanë sjellë me vete edhe mungesën e kritikës e të autokritikës që do të na shërbenin për korigjimin e të metave dhe të gabimeve, të cilat janë shfaqur te ne dhe te puna jonë. Shokët që përbëjnë Sekretariatën, janë kritikuar më pak se të tjerët dhe, po të vazhdohet kështu, ka rrezik që sekretarët e Komitetit Qendror të vihen në pozita të privilegjuara në raport me shokët e tjerë të Byrosë. Kjo do të ishte shumë e dëmshme, ashtu sikurse do të ishte e dëmshme po të krijohet një pozitë e privilegjuar dhe e shtrembër për Byronë në raport me shokët e tjerë të Komitetit Qendror. Kjo nuk do të thotë se shokët, që kanë bërë gabime, nuk janë kritikuar ose nuk kanë bërë autokritikë, por ne themi se kritika dhe autokritika nuk kanë qenë në lartësinë e duhur. Shumë herë kritikata janë pranuar, kurse disa herë i është hedhur ujë verës ose ka raste që ato janë pranuar, por pa shumë bindje. Nga mungesa e kontrollit dhe e dhënjes llogari prej gjithsecilit për punën, që i është ngarkuar, është shkuar në familjaritet, në butësi, në oportunizëm dhe në gjy-kime të përcipta mbi problemet dhe mbi kuadrot.

Disa shokë të Byrosë e të Sekretariatit, nga eksperiencia e përditshme e punës, nga raportet e Partisë dhe nga raportet e ministrive, kanë sjellë në Byro shumë çështje, mirëpo ka pasur raste që mjaft prej tyre të kenë qenë më tepër në formë konstatimesh ose në formë projektvendimesh të pathelluara si duhet dhe pa detyra të caktuara e masa konkrete. Jemi vënë në korrent se ka mungesë kontrolli, dobësi në punën politike, dobësi drejtimi, mungesë operativiteti, mungesë organizimi, mungesë vigjilence etj. dhe sigurisht, janë marrë masa në këtë drejtim, por çfarë rezultatesh kemi korrur, ç'është bërë me fatin e këtyre vendimeve e direktivave, Byroja Politike nuk është informuar shumë. Anëtarët e Byrosë, me disa përjashtime, nuk e kanë angazhuar atë me problemet e sektorit që u është ngarkuar dhe më e theksuar në këtë drejtim ka qenë nga ana e shokëve Tuk dhe Bedri. Një e metë tjetër e rëndësishme e punës së Byrosë është çështja e kontrollit të realizimit të planit, i cili duhej të bëhej vazhdimisht me periudha të caktuara, ku çdo nënkryeministër të mbante Byronë në korrent të situatës, që të ndiqeshin me vëmendje realizimet e sektorëve më të rëndësishëm të planit për problemet kyçe. Mirëpo kjo gjë akoma nuk është vënë në rrugën e drejtë me gjithë përmirësimet që janë bërë në këtë drejtim.

Planet e punës të Byrosë Politike jo kurdoherë kanë qenë të studjuara mirë dhe të koordinuara si duhet. Zakonisht këto plane duhet t'i pregatiten Byrosë nga Sekretariati, por Sekretariati është mjaftuar duke u bërë pak ndryshime planeve të punës që paraqesin drejtoritë e Komitetit Qendror nëpërmjet sekretarëve

të Komitetit Qendror. Në të shumtat e rasteve këto projektplane përmbanin më shumë probleme të apara-teve se sa probleme që duhej të zgjidhte Sekretariati. Ndihma e Sekretariatit në drejtim të Byrosë Politike nuk ka qenë e mjaftueshme, sepse Sekretariati është ndihmuar dobët nga sekretarët e Komitetit Qendror; shokët Tuk e Bedri si dhe nga shoqja Liri si anëtare e Byrosë e ngarkuar me çështjet organizative. Sekretariati ka pasur kujdes që të dallonte kompetencat e tija nga ato të Byrosë Politike, por kjo gjë nuk përjashton që edhe ngandonjëherë t'ja ketë «hangër bukën» Byrosë Politike dhe kjo, jo për çështje të nomenklaturës së kuadrit as për probleme të rëndësishme të Partisë ose të qeverisë, por për marrje vendimesh për disa çështje urgjente, gjë që ka ndodhur nga metoda e ngadalshme për kalimin e çështjeve në Byrosë Politike. Kjo e bënte Sekretariatit që të vendoste me urgjencë edhe për ndonjë çështje, e cila i takonte Byrosë Politike. Sekretariati as që merrte dot frymë nga projektvendimet mbi kuadrin ose nga projektvendimet e Drejtorisë së agjitacionit e të propagandës. Këto ishin në kompetencën e Sekretariatit dhe duhet të bëheshin, pse kanë qenë të nevojshme dhe i kanë sjellë një përmirësim të dukshëm punës, por, lidhur me këto çështje, sekretarët e Komitetit Qendror, Tuku dhe Bedriu, fare rrallë jepnin llogari përpara Sekretariatit dhe Byrosë Politike për fatin e zbatimit të vendimeve që merreshin dhe, si rrjedhim, nuk na kanë mbajtur në korrent.

Shoku Bedri Spahiu, si sekretar i KQ, drejton dy drejtori nga më të rëndësishmet: të agjitacionit e të propagandës dhe të bujqësisë. Patjetër puna ecën më

mirë se përpara, sidomos në Drejtorinë e agjitacionit e të propagandës, kurse në atë të bujqësisë puna është akoma mjaft e dobët dhe kjo ndodh pse shoku Bedri nuk është thelluar shumë në problemet e mëdha që i dalin Partisë në këtë fushë të rëndësishme. Vendimet e marrura, jo vetëm që nuk kanë dalë nga një studim i thellë i problemeve, por ato kanë qenë të përcipta e më shumë në lidhje me gjëra praktike dhe nuk është ndjekur e kontrolluar zbatimi rigoroz i tyre. Problemi i madh dhe i një rëndësie të dorës së parë për Partinë, siç është edukimi marksist-leninist i kuadrove të Partisë, akoma nuk ka hyrë në rrugën e duhur të zgjidhjes dhe nuk është bërë si duhet një problem i madh partie. Shumë flitet për këtë, por rezultatet janë të ngadalshme. Byroja Politike di se janë hapur shkolla dhe kurse për të studjuar marksizëm-leninizmin, por duhej të mbahej në korrent më shpesh se si shkon puna në to. Sa për studimin e marksizëm-leninizmit, jashtë këtyre shkollave dhe kurseve, pak fjalë bëhet, pak kontroll ka. Ky problem nuk është marrë me seriozitetin e duhur nga ana e Byrosë dhe këtu kemi një përgjegjësi të rëndë. Si ky ka dhe shumë probleme të tjera. Kemi marrë projektvendime për kulturën në përgjithësi, për arësimin, për artet figurative e muzikën, për punimet që zhvillohen në Institutin e shkencave, për luftën kundër analfabetizmit, për historinë e Partisë, për zhvillimin e shpërndarjen e shtypit etj., por Byroja Politike nuk ka kërkuar llogari sa duhet për këto çështje dhe nuk ka reaguar më në kohë e si duhet me masa të nevojshme për këto probleme kaq të rëndësishme. Megjithatë, ka përparime dhe, në rast se

sekretari përkatës dhe ne tok me të do të thelloheshim edhe më tepër në këtë drejtim, do t'i paraqitnim Byrosë dhe Komitetit Qendror studime të plota, do të ndihmohej jo vetëm udhëheqja, por dhe vetë sekretari i agjitacionit e i propagandës dhe aktiviteti i Partisë në këtë drejtim do të gjallërohej më shumë. Shoku Bedri ka qenë i butë në kërkimin e llogarisë, e ka tërhequr zvarrë puna dhe e ka gozhduar në zyrë duke e mbyllur në një punë burokratike të tepruar. Shumë rrallë, për të mos thënë fare, ai del nga zyra për të marrë kontakt me organizatat e Partisë në rrethe dhe të shohë vetë si mendon Partia për problemet e ndryshme, si punon, si aktivizohet, si i zbaton në jetë vendimet. Kjo ka qenë një e metë shumë serioze te Bedriu, që ka sjellë shumë dëme dhe të meta në zbatimin si duhet të direktivave dhe të vijës së Partisë. Drejtoria e agjitacionit dhe e propagandës, nga më të rëndësishmet e Komitetit Qendror, është ajo që zhvillon agjitacion e propagandë për vijën e Partisë, e cila duhet zbatuar nëpërmjet formave të ndryshme. Format janë të gjitha të mira dhe ato ne i kemi adaptuar sipas eksperiencës së Partisë Bolshevike, por ato duhen vënë në jetë nga njerëzit tanë. Gjithashtu interesimi i Bedriut për drejtimin e Drejtorisë së bujqësisë ka qenë shumë i paktë dhe i cekët; edhe puna në këtë drejtori nuk ka qenë sa duhet e frutshme.

Puna e shoqes Liri Belishova është kufizuar vetëm në drejtorinë e saj. Atje ne kemi pasur disa suksese si kudo, por Byroja Politike dhe udhëheqja e Partisë nuk është vënë në korrent si duhet mbi jetën e Partisë, mbi jetën dhe punën e organizatave, mbi tendencat dhe shfaqjet e sëmura që kanë ekzistuar. Është e vërtetë

se shoqja Liri lidhej me Sekretariatën nëpërmjet shokut Tuk, i cili është interesuar pak për punën e këtij sektori, por megjithatë ajo është anëtare e Byrosë dhe kishte të gjitha mundësitë ta mbante në korrent udhëheqjen mbi një çështje nga më kryesoret, siç është jeta e brendshme dhe organizimi i Partisë.

Byroja Politike dhe Sekretariati kanë marrë një sërë vendimesh për bolshevizimin e Partisë, për vendosjen si duhet në Parti të demokracisë së brendshme, për forcimin e kritikës e të autokritikës, ashtu si na i cakton kongresi në Rezolucionin e tij ku thuhet:

«Të plotësohet sa më shpejt kthesa e madhe e Partisë duke vendosur sa më shpejt parimet marksiste në strukturën dhe jetën e brendshme të Partisë, në bazë të Statutit të Partisë. Këto parime të zbatohen me rigozitet dhe të luftohet pa hezitim kundër tentativave që synojnë shkeljen e këtyre parimeve:

a) *Të zbatohet dhe të ruhet si drita e syve parimi leninist-stalinian i centralizmit demokratik si parimi kryesor mbi të cilin ndërtohet Partia dhe i cili konsiston në zgjedhshmërinë e të gjitha organeve drejtuese të Partisë prej poshtë-lart, në dhënjen llogari nga koha në kohë prej organeve drejtuese para organizatave që i kanë zgjedhur e që ata drejtojnë mbi të gjithë aktivitetin e tyre, në ruajtjen e disiplinës së hekurt e të ndërgjegjshme të Partisë, me nënshtrimin e pakicës ndaj shumicës dhe në detyrimin e organeve inferiore për t'ju bindur pa kondita organeve superiore.*

b) *Të luftohet për zhdukjen e shfaqjeve jomarksiste, burokratike, policore dhe vdekjeprurëse për Partinë, në jetën e brendshme të Partisë, duke ruajtur*

dhe zhvilluar vazhdimisht demokracinë e brendshme në të gjitha organizatat e Partisë, ku të respektohen plotësisht të gjitha detyrat dhe të drejtat e anëtarit të Partisë në bazë të Statutit të Partisë, ku të gjitha çështjet e Partisë të zgjidhen me metodën marksiste-leniniste, të kritikës dhe të autokritikës së shëndoshë, ku anëtari i Partisë ta ndjejë veten si në shtëpinë e vet në organizatën e tij dhe të mos ketë asnjë druajtje për të kritikuar drejt cilindo funksionar e organ të Partisë, ku të çelënikoset disiplina e hekurt dhe e ndërgjegjshme në bazë të demokracisë së brendshme të Partisë nga e cila ajo buron».¹

Sigurisht që në këto drejtime ka përmirësime të dukshme, por sa dhe qysh, shoku Tuk dhe shoqja Liri, nuk i kanë ndjekur si duhet këto vendime dhe nuk kanë qenë në gjendje të na vinin në korrent. Byroja Politike informohej prej tyre në mënyrë të shkëputur, jo të plotë, rastësisht dhe për ndonjë problem që ishte i lidhur me shkelje flagrante të Statutit. Ndihma e shoqes Liri duhej të ishte më e madhe në drejtim të organizatave të Partisë dhe të instruktorëve të Komitetit Qendror, pse me gjithë përpjekjet e tyre dhe ndihmën që kanë dhënë poshtë, instruktorët e Komitetit Qendror, akoma nuk e kanë kuptuar sa duhet funksionin e madh të tyre. Ata bëjnë deri diku një punë mekanike dhe e humbasin kohën për gjëra që u përkasin instruktorëve të pushtetit, kështu që ka rrezik të bëhen një aparat paralel me atë. Duke qenë e shkëputur nga jeta e gjallë

¹ «Dokumenta Kryesore të PPSH». Vëll. I, f. 459—460.

e Partisë, shoqja Liri nuk e kishte bërë zakon shkuarjen poshtë, gjë që ka shkaktuar që jetën e Partisë, rritjen e saj, të metat dhe sukseset t'i njohë vetëm nëpërmjet raporteve të instruktorëve. Kjo ka shkaktuar gjithashtu që shokët instruktorë të mos ndihmohen dhe të kujtojnë se çdo raport i tyre është i drejtë. Kështu as kritikohen as ndreqen. Krijohet vetëvetiu për ta një situatë e privilegjuar ndaj komiteteve të rretheve dhe organizatave ku ata venë inspektojnë dhe ndihmojnë. Përsa u përket drejtorive të tjera të Komitetit Qendror, si ajo e industri-financës, mund të themi se ato gati s'kanë ekzistuar dhe nuk e kanë ndihmuar Sekretariatit dhe Byronë, për arsye se shoku Tuk është interesuar fare pak për to.

Përsa i përket shokut Theodor Heba, i cili ka udhëhequr Drejtorinë e kuadrit, ai ka bërë një punë gati kryesisht zyre dhe tepër mekanike. Ai e ka parë shumë ngushtë problemin e kuadrit, nuk është thelluar në këtë problem kaq delikat dhe të rëndësishëm. Kjo metodë pune dhe mungesa e një perspektive më të gjerë në politikën e kuadrit ka shkaktuar dëme të ndieshme në ngritjen dhe edukimin e kuadrove.

3. — DËMET QË I KANË SJELLË KËTO GABIME PARTISË NË BAZË DHE MASAT PËR EVITIMIN E TYRE

Patjetër këto gabime e kanë penguar e dëmtuar punën. Të metat që kanë ekzistuar lart janë reflektuar deri poshtë në bazë, në forumet e Partisë dhe në ato të pushtetit.

Cilat janë të metat kryesore që ne konstatojmë në punën e Partisë dhe të forumeve udhëheqëse poshtë?

Udhëheqja në rreth punon ashtu sikurse punon edhe udhëheqja lart. Problemet në bazë janë të shumta, të rënda dhe kryhen me përpjekje dhe me luftë. Por, disa nga komitetet e rretheve nuk janë sa duhet në krye të detyrës, punojnë pa një plan të studjuar mirë, ata problemet i tërheqin zvarrë dhe s'mundin dot t'i kryejnë ato me kohë dhe sipas rëndësisë së tyre. Ato s'janë akoma në gjendje ta lidhin ngushtë punën e Partisë me atë të pushtetit dhe të mobilizojnë si duhet dhe sa duhet Partinë dhe rreth saj gjithë masat e punonjësve në realizimin e detyrave që na vë përpara Partia me planin e shtetit. Ka punë mjaft mekanike dhe mjaft burokratike. Shumë herë çështjet nuk bëhen probleme të udhëheqjes, nuk studjohen hollësisht nga udhëheqja dhe kjo të nxjerrë detyra të qarta dhe t'i kontrollojë këto detyra. Shumë çështje, pa kaluar fare nga udhëheqja e Partisë në rreth, bëhen vetëm probleme të aparateve të komiteeve. Natyrisht fati i këtyre problemeve është i errët dhe ka raste që ato flenë nëpër sirtare, ose edhe kur dërgohen në organizatat bazë, harrohen.

Shumë kërkojmë nga Partia në bazë, por nuk i japim dhe nuk e ndihmojmë sa duhet që të na japë edhe ajo. Ne jemi në vështirësi të mëdha për të ditur rrënjësisht problemin e fshatarësisë e të punëtorisë, në të gjithë kompleksitetin e tij. Këto gjëra ja kërkojmë Partisë në bazë, por akoma ne vetë lart nuk i kemi të qarta sa duhet se çfarë kërkojmë. Kjo gjë, natyrisht, sjell konfuzion, javashllëk e burokratizëm të patolerueshëm dhe

më në fund rezultati i dëshiruar del i çalë. Një gjë e tillë komplikon jashtëzakonisht punët tona se njerëzit lodhen dhe nuk mësohen në rrugën e shëndoshë të punës.

Është e zorshme të kërkohet llogari si duhet nga komitetet e Partisë, kur problemet që u janë shtruar atyre për t'i zgjidhur nuk janë të thelluara e të studjuara mirë që nga lart. Si mund ta ndjekim si duhet zbatimin e detyrave, kur këto nuk u janë bërë të qarta forumeve dhe Partisë në bazë? Metoda jo e shëndoshë në punën me plan nga lart, shkakton që edhe poshtë të punojnë fare pa plan ose me plane konfuze. Pra, ne shohim se poshtë ka burokratizëm, javashllëk, neglizhencë, mungesë përgjegjësie personale. Kuadrot në bazë ngarkohen me shumë probleme që u zënë këmbët dhe që s'u japin dot zgjidhje të shpejtë dhe të drejtë. Në këto kushte ata bëjnë gabime, shtrembërojnë vijën, shtrembërojnë format organizative. Lenini për rëndësinë e kryerjes së detyrave thotë:

«... thelbi i gjithë gjendjes nuk janë rezolucionet, nuk janë institucionet, nuk është riorganizimi... por zgjidhni njerëzit e nevojshëm dhe kontrolloni zbatimin praktik...»¹.

Ne nuk vuajmë për format organizative, pse ato i kemi, ne nuk vuajmë pse vija jonë e Partisë nuk është e drejtë. Jo, ne vuajmë ngaqë nuk dimë të përfitojmë sa duhet nga këto forma të drejta organizative, vuajmë

¹ V. I. Lenin, Veprat, vëll. 33, f. 336.

nga mosverifikimi si duhet dhe në kohën e përshtatshme të detyrave, që janë caktuar dhe kështu bëhen shtrembërime në vijë, shkelet disiplina e planit, thyhet disiplina e çelniktë e Partisë, shkelet demokracia e brendshme e Partisë, dobësohet vigjilenca revolucionare dhe kritika e autokritika në Parti. Këtej pastaj rrjedhin të gjitha ato për të cilat bëjnë fjalë raportet e Byrosë si: mungesa e mobilizimit në punë, vjedhjet, abuzimet, shkatërrimi i pasurisë së shtetit nga njerëz armiq dhe të pandërgjegjshëm etj.

Partia jonë është e fortë dhe luftëtare, kuadrot tanë janë të vendosur dhe besnikë të komunizmit dhe janë në gjendje t'i shporrin prej vetes të gjitha këto të meta. Fakti është se Partia jonë ka ecur përpara me vendosmëri dhe guxim, ka kryer detyra kolosale, ka kapërcyer vështirësi të mëdha dhe ka korrur suksese të konsiderueshme. Lufta e madhe e Partisë i ka çelnikosur kuadrot tanë, të cilët kanë bërë përparime, kanë fituar eksperiencë, janë ngritur. Por me gjithë këto suksese të arritura ne kemi akoma shumë e shumë punë për të bërë. Ne duhet ta bolshevizojmë Partinë tonë. Një nga mësimet më të rëndësishme që nxjerrim nga eksperiencia e Partisë Bolshevike është se për të shtuar vigjilencën, është e domosdoshme të sundojë rendi bolshevik në shtëpinë tonë të Partisë. Kështu që, për të zhdukur dobësitë dhe të metat që ekzistojnë, të cilat ne i analizuam sot, duhet t'u vëmë kujdesin më të madh rritjes dhe forcimit të Partisë, bolshevizimit të saj. Ne mund të flasim shumë për moszbatimin e detyrave, po në rast se nuk forcojmë demokracinë e brendshme të Partisë, në rast se kritikën dhe autokritikën nuk e bëjmë armën

më të shëndoshë të saj, nuk do të mundim dot t'i verifikojmë vendimet tona. Këtej lind çdo gjë e mirë. Kështu ruhet disiplina e fortë e Partisë, këtu lind dhe forcohet përgjegjësia personale, dhemshuria për pasurinë e shtetit, forcohet vigjilenca revolucionare. Stalini thotë:

«Të kontrollosh zbatimin e detyrave, do të thotë t'i kontrollosh ata jo vetëm në zyrë dhe jo vetëm në bazë të raporteve zyrtare, por para së gjithash t'i kontrollosh ata në vendin e punës; në bazë të rezultateve reale të zbatimit.»¹

Një e metë serioze në Partinë tonë, për të cilën duhet të japim alarmin e të marrim masat më të rrepta që të zhduket, është niveli akoma i ulët ideologjik i anëtarëve të Partisë duke filluar që nga anëtarët e Komitetit Qendror. Në rast se ne nuk e zgjidhim drejt këtë problem kryesor, Partia jonë do të dobësohet dhe ndërtimi i socializmit nuk do të bëhet me ritmin që duhet. Këtë detyrë të madhe që na ka vënë kongresi ne nuk po e zbatojmë si duhet dhe jemi të parët përgjegjës. Ne kemi hapur Shkollën e Partisë, që ka dhënë rezultate dhe vazhdon me sukses, kemi shkollat politike, rrethet e studimit dhe kurset mujore, të cilat po japin rezultate, po që kanë edhe të meta të shumta. Njerëzit nuk venë në rregull në këto forma studimi dhe ne duhet të jemi të ashpër kundër lëshimeve në këtë drejtim. Kurset me korrespondencë nuk shkojnë aspak mirë. Mjaft nga

¹ J. V. Stalin, Veprat, vëll. 14, f. 126.

shokët kryesorë të Partisë në rrethe nuk mësojnë. Edhe disa nga anëtarët e Komitetit Qendror nuk interesohen për të studjuar. Kjo është preokupante për Partinë. Në Partinë tonë ka mjaft analfabetë dhe një sëmundje e tillë akoma nuk po zhduket. Si mundet ata, që, të paktën s'dinë të shkruajnë dhe të lexojnë, të kryejnë detyrën e pararojës? Në Partinë tonë ka njerëz që mbajnë ramazan. Disa shokë sekretarë lejojnë sharlatanët hoxhallarë të bëjnë nuska dhe duvara për të rjepur fshatarët. Ka shokë të mirë, luftëtarë e besnikë që bëjnë gabime trashanike në vijë, pse ata nuk kapin asnjë libër me dorë. Ka shokë që mendojnë se vetëm me praktikë dhe «me një të hedhur sy librave» mund t'u dalin mbanë barrëve kaq të rëndësishme që u ngarkohen. Jo, kjo nuk mund të ecë kështu. Përsa i përket kulturës së përgjithshme, nën pretekstin e punës së madhe, me qindra komunistë, që s'kanë mbaruar shkollën fillore, nuk bëjnë përpjekje të mbarojnë shkollat e natës. Sidomos në fshat gjendja është më alarmante. Partia atje është e dobët edhe për arsye të nivelit të ulët ideologjik e kultural. Ky është një nga problemet më të rëndësishme të Partisë dhe Byroja Politike do t'ja paraqesë për së shpejti plenumit për studim këtë çështje, ku duhet të merren vendime të prera. Byroja Politike propozon që përveç detyrave të tjera që Komiteti Qendror na ka ngarkuar për ngritjen ideologjike, ai të marrë vendim të veçantë për anëtarët dhe kandidatët e Komitetit Qendror dhe t'u caktojë atyre detyra të prera për të mësuar. Për këtë gjë Komiteti Qendror të ngarkojë Sekretariatit të bëjë programet e studimit e rregulloret përkatëse që pa humbur kohë të fillohet nga puna.

Përveç kësaj të gjithë shokëve e veçanërisht shokëve të Komitetit Qendror t'u vihet si detyrë të gjejnë kohën e mundësinë të lexojnë dhe të pajisen me kulturë të përgjithshme.

Lufta e klasave nuk po zhvillohet ashtu si na e kanë përcaktuar kongresi dhe rezolucionet e plenumeve të Komitetit Qendror. Kjo luftë nuk po bëhet sa e si duhet as në fshat as në qytet. Në fshat elementi kulak nuk po kufizohet si duhet ekonomikisht e nuk goditet me ashpërsinë e nevojshme. Ai po na lufton urdhëresat, pengon punimin e mirë të tokave, fsheh bereqetin, prodhimet, alarmon situatën, hedh parulla të helmatisura, pengon grumbullimet etj. Shokët në bazë lëkunden në direktivat e qarta që ka në lidhje me luftën për kufizimin e kulakut dhe bëhen gabime. Komunistët e fshatit nuk janë të mobilizuar sa duhet për këtë luftë dhe nuk mobilizojnë sa duhet fshatarët e varfër e të mesëm në një luftë të pamëshirshme kundër kulakëve. Në disa raste atje ka oportunitizëm, hatëre, hezitime dhe, në disa raste të tjera, sektarizëm dhe kalohet në likuidimin e plotë të bazës ekonomike të kulakut. E njëjta gjë ndodh edhe në qytete. Të gjitha vjedhjet e sabotimet në pasurinë e shtetit, që janë të padurueshme, rrjedhin nga mungesa e vigjilencës revolucionare, nga mungesa e një lufte klase të pamëshirshme kundër elementit reaksionar, dallaveraxhi, spekulator, sabotator. Mjaft elementë të shpronësuar, armiq, punojnë në tregëti dhe mbajnë çelësat, regjistrat, kontabilitetet e dyqaneve, të kooperativave etj. Kjo gjendje duhet parë dhe, ndaj këtyre elementëve të mësuar me spekulime, duhet të jemi tepër vigjilentë.

Nuk është e lejueshme as për udhëheqësit e as për komunistin e thjeshtë që ta dobësojnë vigjilencën revolucionare. Shumë herë harrohet realiteti dhe shkohet qorras. Ka shokë që janë naivë, besojnë lehtë ç'u thonë njerëzit. Lufta me armikun e Partisë dhe të popullit duhet të bëhet jashtëzakonisht e ashpër. Ai përpiqet të maskohet me lloj-lloj mënyrash. Ai fshihet nën maskën e njeriut aktiv në dukje, e njeriut «të bindur», «të disiplinuar», por prapa krahëve të bën njëmijë e një të këqia. Sjelljet e këtyre armiqve bëjnë që disa shokë të harrojnë se duhet t'i kemi sytë katër ndaj tyre. Këta shokë lëshohen. Por armiku krijon rreth, lidhet, korrup-ton njerëz, komprometon njerëz të thjeshtë dhe të mirë dhe fshihet prapa tyre për të goditur. Vigjilenca revolucionare duhet të jetë e mprehtë te çdo komunist dhe ndaj çdo njeriu. Me qenë vigjilent ndaj armikut, nën çdo maskë që ai fshihet, me e goditë ashpër që të mos marrë frymë, me qenë vigjilent në mënyrë revolucionare ndaj shokëve që gabojnë, me i ndreqë, me i kritikue, me qenë të ashpër, kur këta shokë vazhdojnë të gabojnë — vetëm kështu do të shërohen dhe do t'i shpëtojmë shokët e Partisë. Mos me i neglizhue sinjalizimet, as mos me i grumbullue sa të bëhen mal, por me marrë shpejt masa, me korrigjue njerëzit nëpërmjet kritikës dhe autokritikës së hapët dhe të ndershme.

Të mbrohen me guxim më të madh parimet dhe vija e Partisë, të mos i lëmë këto parime të shtrembë-rohen e të shkelen. Presioni i armikut dhe i borgjezisë është i madh dhe në qoftë se në çdo kohë nuk qëndrojmë të gatshëm me grushtin e ngritur, ai do të na e dëmtojë Partinë tonë. Të bësh hatëre, të mos i prishësh

qejfin tjetrit, të mos pranosh ndershmërisht kritikën e drejtë — këto pa asnjë dyshim ta turbullojnë situatën, ta komplikojnë gjendjen, të heqin zvarrë në një terren të dobët që s'është i Partisë ku të rrethon armiku me rrjetin e tij prej merimange dhe të helmatis.

Kundër mbeturinave të shoqërisë kapitaliste borgjeze dhe mikroborgjeze komunistët duhet të bëjnë një luftë të ashpër, të pamëshirshme e të vazhdueshme dhe në radhë të parë ata komunistë që rrjedhin nga origjina e këtyre shtresave.

Ka injorancë dhe prapambetje të madhe në masat e popullit tonë, ka fanatizëm. Kjo reflektohet edhe në Parti, pse njerëzit e Partisë vijnë nga populli. Përveç njerëzve analfabetë, që ne kemi në radhët e Partisë, kryesisht nga koha e luftës, përveç mungesës së kulturës së përgjithshme, gjë që është shumë preokupante, përveç nivelit të ulët ideologjik, që është shumë i theksuar dhe që këtej rrjedhin shumë të këqia, ne kemi edhe shokë që mbajnë ramazan. Kishat në Shkodër e në Durrës e në disa vende të tjera janë plot me njerëz. Ne kemi komunistë që ndajnë gratë, pse nuk ju lind djalë, ose që mbajnë gratë e tyre të mbuluara me perçe. Ka komitete partie të cilat, në vend që të jenë të ashpra ndaj zakoneve prapanike dhe të mbrojnë vijën e Partisë e ligjet e saj revolucionare, qëndrojnë në pozita të itifakeve të vjetra, sidomos ndaj hakmarrjes. Prandaj, shokë, duhet të jemi vigjilentë në këtë drejtim, pse armiku nuk fle e duhet të luftojmë me vendosmëri dhe të mbrojmë Partinë.

Këto çështje duhet të bëhen probleme të mëdha të Partisë, të mobilizohet e gjithë Partia, të bëhet luf-

tëtare si në kohët më heroike të Luftës sonë nacional-çlirimtare, pse sot lufta kundër armikut është jo më pak e ashpër dhe duhet të zhvillohet dita-ditës pa lëshime dhe pa ndërprerje. Shokët e Partisë, që nga anëtarët e Komitetit Qendror, duhet të jenë vigjilentë, të mos i zërë gjumi dhe të jenë të ashpër kundër atyre që nuk marrin masa, që nuk e rrethojnë armikun me një vigjilencë të fortë dhe që nuk e godasin atë pa hezitar, të jenë të ashpër ndaj vjedhësve e shkatërruesve të pasurisë së shtetit, cilëdo qofshin këta, komunistë ose jo. Kjo të bëhet jo vetëm nga Ministria e Kontrollit, po nga e gjithë Partia, nga të gjitha instancat e saja, nga të gjithë komunistët dhe patriotët, nga të gjitha masat e popullit, kudo që ato punojnë. Për këtë të kërkohet llogari kurdoherë dhe kujtdo, pa hezitim, pa drojtje. Vetëm kështu do ta bëjmë Partinë tonë luftëtare, do ta bolshevizojmë, do të zhdukim të metat e gabimet dhe do të ecim përpara.

Të luftojmë me ashpërsi burokratizmin në aparatet tona të Partisë dhe të pushtetit. Me qindra shkresa në muaj shkojnë nga një dikaster në tjetrin, nga një dikaster në një komitet rrethi. Mendohet se çdo gjë e zgjidh shkresa, ndërsa puna operative, e gjallë, konkrete, s'praktikohet sa duhet as nga funksionarët e Partisë, as nga ata të shtetit. Udhëheqësit kryesorë vetëm thërrisin në zyrë njerëzit, por nuk shkojnë poshtë t'i shohin në punë se si janë kuptuar dhe zbatuar urdhëresat, direktivat ose këshillat që u jepen. Ka shokë udhëheqës të tjerë, që dinë kur dhe sa duhet të rrinë në zyrë dhe gjithë kohën tjetër ata janë në lëvizje, ndihmojnë, kontrollojnë, inspektojnë.

Kuadri është thesar i çmueshëm për Partinë, prandaj Partia duhet t'i vërë kujdesin më të madh këtij problemi kaq të rëndësishëm. Në popullin tonë, në gjirin e klasës punëtore dhe të fshatarësisë ka vlera të mëdha dhe detyra e Partisë është t'i zbulojë, t'i ngrejë, t'u besojë punë kryesore. Këtu qëndron forca e Partisë sonë dhe e ardhshmja e saj. Prandaj me guxim dhe në mënyrë revolucionare të ngremë kuadrot tanë të rinj me plot besim, me perspektivë, me besnikëri për Partinë dhe për socializmin dhe të mos vërtitemi shumë rreth poçes. Duhet të bëjmë shumë më tepër se ç'kemi bërë deri tani. Nga shtresa e punëtorisë dhe e fshatarësisë ne do të nxjerrim organizatorë të shquar, njerëz të zot, praktikë, të durueshëm në punë dhe në luftë, njerëz që do të ecin përpara dhe do t'i japin forcë të madhe Partisë dhe gjithë punës. Puna me kuadrin të kuptohet drejt. Ajo është një detyrë e gjithë Partisë, e Komitetit Qendror, e organeve qendrore në qendër e në rrethe, ajo është detyrë kryesore e komiteteve të Partisë, e organizatës bazë, e dikastereve, e ndërmarrjeve dhe e të gjitha enteve e njerëzve ku punohet dhe luftohet. Secili nga këto forume dhe njerëz, kanë funksione dhe detyra të caktuara që duhet të zbatohen me rigorozitetin më të madh. Organizimi i ri i drejtorive të Komitetit Qendror dhe organizimi i seksioneve në komitetet e rretheve është një masë e mirë, që do të na ndihmojë në punën me kuadrin, vetëm po të dimë ta bëjmë si duhet këtë organizim. Çështja e kuadrit është problemi më delikat dhe nuk lejohet që të nënvleftësohet përpara problemeve të tjera. Në rast se çështja e kuadrit nuk zgjidhet drejt, atëhere s'ka punë që të zgjidhet mirë dhe

ne do të rrojmë me ëndrra. Duhet të kemi kujdesin më të madh për kuadrin, ta ndihmojmë, ta mësojmë, ta ndjekim këmba-këmbës në luftën dhe në punën që ai kryen. Në punë ta vlerësojmë kuadrin, në luftë dhe në përpjekje t'i vëmë «notën», në zbatimin drejt të vijës së Partisë, në vetëmohimin, në heroizmin e tij duhet të matim kapacitetin, zotësinë, besnikërinë e tij ndaj Partisë, ndaj popullit, ndaj socializmit.

Të dëgjojmë me kujdes dhe të përmbushim nevojat e drejta të kuadrove, të jemi të dashur dhe të thjeshtë me ta, të jemi intransigjentë ndaj gabimeve dhe të metave të tyre. Të mësojmë kuadrot të kenë iniciativë në punë, t'u hapim horizonte dhe perspektiva, t'u përmbushim nevojat që ata kanë. Nuk jemi më në kohën e luftës, kur detyrat e kuadrove ishin më të kufizuara. Tani kuadrot tanë që luftuan me heroizëm në luftë, po përballojnë detyra të mëdha, po luftojnë në frontin ku përplasen probleme të mëdha shtetërore, probleme që duhet të zgjidhen në mënyrën më të drejtë. Pra, kuadrot duhet të ndihmohen e të edukohen, ata kanë nevojë të mësojnë e të ngrihen nga ana ideologjike, kulturele e profesionale.

Situata jonë, kur ne ndërtojmë bazat e socializmit, është e tillë që, ashtu si duhet të luftojmë për zhvillimin e kulturës marksiste-leniniste, ashtu si luftojmë kundër analfabetizmit, të luftojmë po në një shkallë të tillë kundër «analfabetizmit» në ekonomi, kundër mosnjohjes në shkallën e duhur të problemeve ekonomike. Kaloj koha kur një drejtor uzine, kombinati ose ndërmarrjeje mund ta konsiderojë veten vetëm si një komisar politik. Në qoftë se qëndrojmë në këtë stad, atëhere s'kemi

realizime planesh. Çdo njeri, në çdo punë që caktohet, duhet ta zotërojë detyrën deri në burgjitë më të vogla. Po të jesh shofer, duhet të dish me hollësi motorin, ashtu është edhe për drejtorin e kombinatit, të uzinës, për drejtorin e kuadrit a për ministrin ose për shitësin në dyqan dhe për policin që rregullon qarkullimin rrugor. Cilido duhet të dijë me rrënjë zanatin e tij dhe duhet të zhduket formalizmi. Por që ta dijë kushdo mirë zanatin, duhet t'i krijojme konditat ta mësojë. Ky është kujdesi që duhet të kemi me kuadrin dhe këtu e kam fjalën kur them se duhet t'i përmbushim nevojat e tija që janë të mëdha. Kurseve, shkollave, instituteve, duhet t'u vëmë kujdesin më të madh, pse në këtë drejtim po bëhen lëshime serioze nga Komiteti Qendror, nga Ministria e Arësimit, nga dikasteret, nga vetë ndërmarret. Të ndiqen me kujdesin më të madh nga të gjitha këto forume dhe nga udhëheqësit në këto qendra të rëndësishme ku edukohen me mijëra kuadro të rinj, bij punëtorësh dhe fshatarësh, shpresa më e madhe e Partisë dhe e popullit. Është i dënueshëm qëndrimi i shokëve kryesorë të Ministrisë së Arësimit ose të dikastereve të tjera, që nuk shkojnë sa duhet në bazë të kontrollojnë, të ndihmojnë njerëzit, të shohin nxënësit si mësojnë e si edukohen. Ka dikastere, bile që neglizhojnë punën në teknikumet e tyre, duke ngarkuar mësuesit me punë të pambaruara dhe harrojnë se në teknikumet e tyre nxënësit rrinë me duar lidhur. Nga njëra anë ata bërtasin për mungesë kuadrosh dhe në të njëjtën kohë mbajnë në punë dhe në vende të rëndësishme, njerëz armiq, të ligj, dembelë, pa perspektivë, që fare lehtë mund t'i zëvendësojmë me njerëz të popu-

llit, besnikë, të zgjuar, revolucionarë dhe nga ana tjetër nuk kujdesen fare për përgatitjen e këtij kuadri. Kuadri nuk edukohet vetëm në shkollë. Mësimi duhet të jetë i vazhdueshëm, i paprerë edhe me mbarimin e shkollës. Shkenca s'ka fund. Të mos prehemi me mend se mbaruam një shkollë, ose morëm një gradë a një post dhe i dimë të gjitha e nuk kemi më nevojë për mësim. Kjo është një vetëkënaqësi e tepërt, një ves i dëmshëm dhe i rrezikshëm, kundër të cilit duhet të luftojmë pa pushim. Një e metë e tillë na fryn kokën, na bën megalomanë, dembelë, përbuzës ndaj të tjerëve, na largon nga rruga e Partisë. Kjo është karakteristikë veçanërisht e intelektualëve, që Partia duhet t'ua luftojë ashpër dhe që ata vetë duhet në çdo minutë të jenë me armë në dorë kundër këtij rreziku. Ka shokë të tjerë që bëhen prakticienë të pakorrigjueshëm. Praktika është vërtet një gjë e domosdoshme, po kjo duhet të jetë motër e vëlla me teorinë, me mësimin, me edukimin. Duhet që udhëheqja të japë shembullin për të mësuar dhe të bëjë përpjekje të mëdha për ngritjen ideologjike e kulturele, pse vetëm atëhere do të jetë rigorozë për këtë çështje dhe do t'u kërkojë llogari edhe shokëve të tjerë. Eksperienca fitohet jo vetëm me anë të konsultimit me specialistët miq sovjetikë etj., por edhe duke studjuar libra shkencore, teorike, ekonomike, sociale, juridike, teknike që çdo dikaster ka plot prej tyre, por që nuk shfrytëzohen dhe ky është një krim i rëndë. As konferenca periodike të detyrueshme për kuadrot ose leksione ose studime individuale nuk po organizohen. «Jo s'kemi letër» thonë, «jo s'kemi përkthyes, jo s'kemi shtyp o letër dylli». Të gjitha këto s'janë serioze. Ne

sot jemi një shtet, të gjitha i kemi kur duam t'i gjejmë. Në kohën e luftës mbushnim Shqipërinë me trakte me një maqinë ose shaptilograf të shkatërruar dhe jo tani. Këto gjëra menjëherë duhet të marrin fund dhe ta ndryshojmë situatën. Njerëzit të racionalizojnë punën, të organizohen konferenca, leksione dhe të ndiqen me rigorozitet se këto janë format e edukimit të kuadrit e të rritjes së tij. Të studjohen shtypi, revistat kulturore dhe shkencore, të frekuentohen biblioteka e qendra si ato të Lidhjes kulturore me Bashkimin Sovjetik, ku të merret eksperiencë e vlefshme, të studjohet individualisht.

Komiteti Qendror me organet e tij qendrore, komitetet e rretheve e organizatat bazë të drejtojnë këtë punë kaq të madhe për ngritjen e nivelit ideologjik, kultural e profesional dhe gjithë politikën e drejtë me kuadrin, të jenë vigjilentë për zbatimin e vijës në këtë drejtim. Të evitohen lëvizjet e shpeshta horizontale të kuadrit, pse duke mos qëndruar në një vend derisa të fitojë një farë eksperience, kuadri bëhet si ai guri, që rrokulliset dhe s'grumbullon kurrë bar mbi vete. Ai mbetet i pakualifikuar në punë dhe me «lecka në krahë», siç thotë populli. Siç kemi vepruar deri tani kemi kujtuar se po ndreqim punë, po në të vërtetë kemi prishur.

Ne kemi në vendin tonë specialistë të mirë sovjetikë, që s'kursehen dhe janë gati në çdo moment të na ndihmojnë me eksperiencën dhe njohuritë e tyre. Njerëzit tanë i duan si shokët më të dashur këshilltarët e teknikët sovjetikë. Ata mësojnë me etje të madhe dhe përfitojnë prej tyre.

Një politikë e shëndoshë me kuadrot, edukimi dhe ngritja e tyre e shumanshme do të zhdukë shumë të meta që ekzistojnë, do të zhdukë edhe të metën tjetër të theksuar si ç'është problemi i konstatimeve. Shumë konstatime bëhen: «këtu s'ecën mirë puna, ky s'punon mirë, ky bëri kështu, ai tjetri tha ashtu», por ç'masa u morën në vend për ta ndryshuar atë situatë, ose për ta korigjuar atë njeri, kjo nuk thuhet, se nuk bëhet. Konstatimet janë të mira, por shokët udhëheqës s'duhet të qëndrojnë në konstatime; ata duhet që çdo konstatimi t'i gjejnë edhe zgjidhjen e drejtë e të menjëhershme dhe të marrin masa në bazë të vijës, të direktivave e të urdhëresave në fuqi.

Një problem tjetër i rëndësishëm për udhëheqjen e Partisë që poshtë e deri lart është çështja e drejtimit kolegjial. Kjo është e lidhur ngushtë edhe me demokracinë e brendshme, me kritikën dhe autokritikën e shëndoshë bolshevike. Dihet që s'janë vetëm shokët sekretarë të celulave, të komiteteve të rretheve ose të Komitetit Qendror ata që e përbëjnë udhëheqjen e Partisë sonë, ajo përbëhet prej të gjithë pjesëtarëve të forumit ku secili prej tyre ka të njëjtat të drejta: të shfaqë pa drojtje mendimin, pikëpamjet e tija për çdo problem, të kritikojë dhe të kritikohet. Zgjidhja e një problemi që merret në analizë vendoset sipas mendimit të shumicës dhe jo sipas mendimit të sekretarit në rast se ai nuk është i drejtë.

Mjaft lëshime ka në këtë drejtim dhe sidomos në bazë. Gabime të tilla thyejnë Statutin dhe rregullat e tij, krijojnë situata të padurueshme dhe të dënueshme dhe e çojnë Partinë në rrugën e shtrembër. Kjo gjë

reflektohet dhe në pushtet, në disa komitete ekzekutive, këshilla popullore etj., ku kryetari bën ligjin, ai vulos, ai zhvulos pa u këshilluar fare me komitetin dhe komiteti me këshillin. Kështu krijohet një instancë që e shndërron karakterin demokratik të pushtetit tonë popullor në një aparat burokratik ku ekskludohet kontrolli i masave, kritika dhe autokritika. Komiteti Qendror duhet të tregojë kujdesin më të madh në këtë drejtim në respektimin e Statutit, në drejtimin kolegjal në Parti dhe në organet e pushtetit popullor (këtu nuk është fjala për kolegjiunet e dikastereve).

Një lëshim tjetër serioz që ka bërë Komiteti Qendror në lidhje me verifikimin e dokumentave dhe që kjo duhet të na shërbejë si mësim për herë të tjera, është se ky verifikim duhej të ishte bërë më përpara nga lart, në Komitetin Qendror e në aparatën e tij, në komitetet e Partisë, pastaj të shkonte poshtë në bazë, sepse që të verifikohesh si duhej baza, ishte e nevojshme të verifikoheshin më parë dokumentat e atyre që do ta bënin atë verifikim, pse nuk ekskludohet që edhe në komitete të ketë njerëz me çështje që duhen sqaruar më parë. Kështu verifikimi do të ishte plotësisht i saktë.

Për përmirësimin e mëtejshëm të punës dhe për zhdukjen e këtyre të metave që kanë ekzistuar, janë urgjente dhe na vihen si detyra:

1. — Të forcojmë edhe më shumë punën organizative dhe politike të Partisë, të forcojmë demokracinë e brendshme dhe kritikën e autokritikën bolshevike nga poshtë-lart e nga lart-poshtë.

2. — Të përmirësojmë metodën e punës në Parti,

në forumet e Partisë deri në Komitetin Qendror. Të zhduken rrënjësisht të metat dhe gabimet e deritanishme. Të luftojmë pa mëshirë pikëpamjet oportuniste dhe sektare që shfaqen në njerëzit e Partisë. Të forcohet vigjilenca revolucionare në Parti.

3. — Të forcojmë punën ideologjike në Parti për të ngritur nivelin ideologjik dhe kultural të anëtarit të Partisë.

4. — Të përmirësojmë shtypin dhe propagandën dhe këto të bëhen armë e fortë për edukimin politik dhe kultural të masave të gjera të popullit. Të shpërndahet si duhet shtypi dhe të lexohet në radhë të parë prej komunistëve dhe prej të gjithë popullit.

5. — Të luftojmë me ashpërsi burokratizmin në aparatet tona të Partisë dhe të shtetit. Të goditen ashpër vjedhësit, sabotatorët dhe shkatërruesit e pasurisë së shtetit.

6. — Të vihet në jetë dhe të zbatohet me rigorozitet kontrolli i zbatimit të vendimeve që merren dhe të kërkohet llogari deri në një. Të forcohet përgjegjësia personale te komunistët dhe te punonjësit.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në AQP me ndonjë shkurtim

**KONKLUZIONE DHE VËREJTJE RRETH DISA
DISKUTIMEVE NË LIDHJE ME RAPORTIN
«MBI GJENDJEN POLITIKE DHE PUNËN E PARTISË»**

20 shkurt 1951

Këto probleme që shtroi Byroja Politike kanë një rëndësi jetike për Partinë dhe patjetër bëjnë një përshtypje të madhe në të gjithë ne shokët e plenumit. Mundet që gabohem, por mendoj se rëndësia e këtyre problemeve është kuptuar pak nga disa shokë, të cilët janë përpjekur më shumë për hartimin e diskutimit në lidhje me autokritikën e tyre, duke menduar: «të bëj edhe unë diskutimin e autokritikën rreth punës sime», se sa për çështjet themelore që u shtruan këtu.

Së pari, mua më duket se nuk duhet të kuptohet kaq ngushtë kjo çështje nga disa shokë, të cilët të preokupohen vetëm për të bërë diskutim rreth vetes e punës së tyre. Kjo sjell, siç konstatoj unë, që ndonjëri t'u shkojë përciptas çështjeve të rëndësishme që ngrihen, kurse ndonjë tjetër, t'i harrojë krejtësisht ato dhe në përgjithësi kritika e tyre në drejtim të forumeve dhe sidomos të Byrosë Politike e të Sekretariatit të mos jetë në lartësinë e duhur.

Jam dakord që Komiteti Qendror e shokët që e

përbëjnë atë, kanë bërë lëshime dhe gabime dhe për këtë ata kanë përgjegjësi, por si forum dhe si udhëheqje kanë përgjegjësi në radhë të parë anëtarët e Byrosë Politike. Prandaj ishte e domosdoshme dhe urgjente që Komiteti Qendror ta kritikonte më tepër Byronë Politike për të metat e saja, pse vetëm kështu ajo do të nxirrte si duhet mësim, do të vihej përpara përgjegjësisë dhe në këtë mënyrë do të përfitonte gjithë Partia. Në punën tonë ka një përparim në lidhje me kritikën, por ajo nuk është bërë në atë frymë që e ka analizuar dhe shtruar gjendjen vetë Byroja Politike. Po s'u bë kështu, është e zorshme që të metat tona të korrigjohen.

Së dyti, duhet të kuptohet mirë çështja e drejtimit kolegjial në Parti. Le të fillojmë një herë nga raporti. Këtu nuk është çështje shprehje, kur të gjithë shokët thonë se ky raport, që është bërë nga Sekretari i Përgjithshëm, është një analizë e mirë e dobësive tona. Sekretari i Përgjithshëm ka punuar për këtë, po raporti është meritë e Byrosë Politike. Prandaj kjo duhet kuptuar mirë, sepse ishte Byroja Politike ajo që e mori në shqyrtim këtë çështje, i analizoi problemet thellë dhe doli me konkluzionet që ju shtruan këtij plenumi. Në të ardhshmen do të ketë raporte akoma më të mira si rezultat i analizave më të thella marksiste-leniniste të situatave. Këtë e them që të mos qëndrojmë prapë në pozitë e para me disa ndryshime të vogla. Disa mendojnë: «Mirë, ka të meta Byroja Politike dhe shokët që nga Sekretari i Përgjithshëm, bënë autokritikën e tyre, por meqenëse edhe ne kemi të meta e dobësi, neutralizojmë ato të shokëve lart». Të mendohet kështu është mjaft gabim, pse të metat e Byrosë Politike dhe

tonat, veç si individë, kanë pasur reperiukione të rënda jo vetëm në punët e Komitetit Qendror dhe në ato të shokëve që drejtojnë sektorët e ndryshëm, por në të gjithë jetën e Partisë. Prandaj nga kjo analizë ne të gjithë duhet të mësojmë.

Të metat e Byrosë Politike ne i kemi analizuar. Byroja Politike ka bërë mjaft mbledhje. Tani ka një kohë që bëjmë nga dy herë në javë, por më parë bënim dhe natë për natë. Atëhere, nga të gjitha këto mbledhje përse nuk e kemi përmirësuar punën tonë, përse të mos ishim më të rregullt, më vigjilentë, përse të mos kishim një kontroll më të madh në punë dhe të bënim një kritikë dhe autokritikë më të shëndoshë kundër gabimeve dhe të metave tona? Natyrisht edhe format e organizimit luajnë një rol mjaft të madh në kryerjen e punëve. Po çështja është se nuk janë vetëm format dhe mbledhjet e shumta ato që luajnë rolin kryesor. Ne mund të bënim mbledhje edhe një herë në javë, edhe natë për natë dhe prapë do të kishim të meta. Çështja kryesore është se ne nuk kemi qenë në gjendje, si duhet, të studjonim mirë problemet e mëdha që na dilnin përpara, t'i analizonim ato thellë, të merrnim vendime dhe t'i ndiqnim ato deri në fund. Ne nuk kemi bërë përpjekje sa duhet, që të mësonim nga eksperiencia e Partisë sonë dhe nga eksperiencia e vlefshme e Partisë Bolshevike. Ne kemi një përgjegjësi dhe një barrë të rëndë para Partisë dhe popullit që nuk kemi studjuar si duhet problemet. Do të ishte më mirë që të kishim marrë në shqyrtim më pak probleme, por ato t'i studjonim më thellë. Në këtë çështje më bie edhe mua përgjegjësi, ashtu si çdo shoku që është përgjegjës për

sektorin e tij. Interesimi, vigjilenca në punë, kërkimi i llogarisë dhe metoda e punës nga ne nuk kanë qenë në lartësinë e duhur. Po të kishte qenë ndryshe, nuk do të ishte e mundur që shokët të sillnin përpara Byrosë Politike ose Sekretariatit të dhëna që nuk kanë qenë të thelluara mirë. Ne duhej të bënim më tepër përpjekje që të mësonim më shumë e të ushtronim një kontroll sistematik për zhdukjen e të metave; të shikonim se si i zgjidh Partia në bazë detyrat që i ngarkonim ne dhe të mësonim prej saj. Pra, lëshimet, kontrolli dhe metoda e dobët në punë janë gabime të rënda. Kjo punë është reflektuar edhe poshtë në bazë. Në qoftë se Byroja Politike dhe shokët, që drejtojnë sektorët e ndryshëm në bazë, do t'i ndihmonin më mirë vartësit e tyre, edhe punët do të kontrolloheshin e do të kryheshin si duhet.

Ka ngjarë edhe kjo te ne, fjetja e mendjes për një problem që i është caktuar një personi duke menduar: «Ai që është ngarkuar, ai le të interesohet». Shoku i Byrosë Politike, i ngarkuar me një punë, është me të vërtetë përgjegjës dhe duhet ta kryejë detyrën, por në qoftë se puna nuk kryhet nga ky shok, atëhere Byroja Politike nuk shkarkohet nga përgjegjësia. Çështjet e mënyrës së drejtimit dhe të organizimit të punës në Komitetin Qendror ose në aparatën e tij, i shikonim që nuk ecnin, por këtu kemi pasur disa konsideracione jo të drejta. Rrëmbimi pas çështjes «ku ta vëmë këtë ose atë shok», ka bërë që puna të ngadalësohet dhe të pengohet gjetja e formave të përshtatshme të drejtimit, sidomos në qeveri, ku nuk u morën masa më përpara për të krijuar Kryesinë e Këshillit të Ministrave. Përsa

i përket mbarëvajtjes së punës së Partisë nuk ka vetëm përgjegjësi Byroja Politike, por kam edhe unë vetë, që duhet të isha më në krye të kësaj pune, pse jam Sekretar i Përgjithshëm e duhet të shikoj edhe si shkojnë punët në Parti edhe në qeveri, po sidomos në Parti, sepse Partia mund t'i zgjidhë çështjet si duhet. Po të kemi Partinë të fortë, çdo gjë do të kryhet. Fakti është se ne kemi një Parti heroike, por punën nuk e kanë kryer si duhet në radhë të parë Tuku, Bedriu dhe Liria, të cilën e kanë skllavëruar format dhe metodat. Liria ka gabime dhe duhet të thellohej në diskutimin e saj përpara Komitetit Qendror dhe të mos kapej vetëm me format organizative, por të analizonte si punojnë organizatat e Partisë, si reagojnë ato. Këtë gjë ajo e ka lënë mënjanë dhe kjo nuk është mirë, pse Partia Bolshevike na mëson se vetëm format nuk japin fruit. Gjithashtu për Tukan, Liria nuk tha asnjë fjalë, që ai ka fajet kryesore dhe që ishte në kontakt të përditshëm me të. Këto që konstatojmë, duhet t'i themi patjetër, pse ndryshe, dalim këtej po me atë frymë e po me ato mentalitete që erdhëm dhe bëjmë gjithë këtë plenum e pas dy javësh i harrojmë këto çështje dhe shkojmë në rutinën e vjetër. Plani që nuk është realizuar, do të realizohej patjetër, pse ai nuk është gjë përpara vrullit të Partisë, po kanë qenë dhe gabimet tona një shkak që të mos zgjidhen disa nga problemet e planit.

Këto të meta kanë ardhur edhe për shkak të mungesës së kritikës e autokritikës si dhe të mungesës së demokracisë së brendshme të Partisë. Le të shikojmë tani si paraqiten këto çështje në Komitetin Qendror. E meta jonë është këtu, që Komitetit Qendror

nuk i kemi shtruar rregullisht probleme dhe kjo ndodhte për faktin se ne nuk i zotëronim si duhet ato. Dhe pikërisht për këtë çështje kritika nga shokët duhet të ishte më e ashpër, që të mos përsëriten më të tilla gjëra. E në rast se përsëriten, Komiteti Qendror të marrë masa të rrepta duke filluar që nga lart dhe deri te shokët më me pak përgjegjësi, se njerëz me pozita formale dhe false nuk duhet të lejohen më. Në qoftë se një shok nuk e bën punën, të vendoset në një vend tjetër dhe të mos shikojmë se dëmtohet shoku. Shoqëri dhe vëllazëri të kemi, por kur të vijë çështja për të mbrojtur interesin e Partisë dhe të popullit, ato të fshihen të gjitha dhe, ndaj atij që nuk e kryen mirë detyrën, duhet mbajtur qëndrim. Mbi këto baza, pra, ne duhet të bëjmë kritikë dhe autokritikë të shëndoshë. Në rast se unë shoh një gjë, ose konstatoj një gabim, duhet ta ngre menjëherë në Parti. Kur një anëtar i Komitetit Qendror sinjalizon një çështje dhe nuk merr masa, atëherë do të vijë puna që të mblidhet Komiteti Qendror, ku ai t'u kërkojë llogari shokëve përgjegjës se çfarë masash kanë marrë në lidhje me vërejtjet që ka bërë. Pra, të ushtrohet kërkimi i llogarisë me forcë e të luftohen të metat dhe gabimet, pse kështu si kemi vepruar deri tani, fajet mbeten në vija të përgjithshme dhe nuk del përgjegjësia personale. Mua më duket se kjo çështje nuk u shtrua drejt nga disa shokë, kur thanë se jo «nuk kemi kontakte», jo «s'më ka thirrur Sekretari i Përgjithshëm» jo «duhet të më thërriste më shumë» etj. Kështu nuk është e drejtë të shtrohet problemi. Shoku i Komitetit Qendror në radhë të parë duhet ta kryejë mirë detyrën që i ka ngarkuar

Partia dhe veç kësaj, ai duhet të kryejë mirë detyrën edhe si udhëheqës. Çështja nuk është këtu që të vijë të gjithë te unë çdo ditë. Kjo, bile, nuk mund të jetë edhe e mundur. Por në rast se bëhen të gjitha përpjekjet që detyra të kryhet mirë, në rast se studjohet si duhet situata rreth një problemi e nxirren konkluzione të drejta, dhe megjithatë haset në vështirësi, atëhere mundet që ky ose ai shok të vijë te unë. Po këtu nuk është çështja vetëm nga ana formale. Liria thotë se «nuk më ka thirrur Sekretari i Përgjithshëm». Kjo nuk është e drejtë. Ne kemi pasur takime të shumta, të paktën dy herë në javë, bile në shumë raste edhe ditë përditë. Prandaj, po të kishte çështje për të shtruar, Liria kishte plot kohë që ta bënte këtë dhe t'i sqaronte. Po puna nuk është këtu, ato janë justifikime.

Këto çështje Byroja Politike i ka parë qartë dhe unë them se të metat, që janë vërtetuar në Sekretariat dhe në Byronë Politike, duhet të marrin fund. Ne jemi të bindur se gabimet do të ndreqen dhe puna do të forcohet më shumë.

Por në këto gabime ka dhe përgjegjësi personale. Në radhë të parë Tuku ka një përgjegjësi të rëndë, sepse nuk e ka kryer punën dhe kështu nuk e ka merituar detyrën e madhe që i ka ngarkuar Partia si sekretar i Komitetit Qendror për punën me kuadrot. Tuku nuk është interesuar për punët e Partisë dhe kjo nuk është një çështje e thjeshtë, por një gabim i rëndë në vijë të një sekretari që drejton jetën e Partisë. Unë e them përsëri se nuk duhet t'ua hedhim fajin formave, ashtu siç kërkon Liria ta paraqesë çështjen. Drejtoria e organizimit është kryesore në aparatit e Komitetit

Qendror, pse ajo është e lidhur me jetën e brendshme të Partisë, prandaj pikërisht për këtë, Tuku ka përgjegjësi në radhë të parë, që punët nuk kanë ecur mirë në këtë sektor. Nga kjo është shkaktuar që të dobësohet puna e Partisë. Rezultatet tregojnë qartë se Tuku ka bërë një punë jashtëzakonisht të paktë dhe të përciptë. Të lësh organizatat e Partisë të ecin kuturu, është një lëshim, është një qëndrim thjesht oportunist, është një gabim i rëndë. Derisa Tuku nuk e vlerëson sa duhet këtë përgjegjësi dhe nuk bën përpjekje të mëdha për këtë çështje jetike të Partisë, ai patjetër do të bënte gabime edhe në futjen në Parti të njerëzve që nuk meritojnë të jenë në radhët tona, të njerëzve të dyshimtë. Një veprim i tillë do të thotë ta minosh Partinë dhe ta dobësosh atë. Jo vetëm që Tuku nuk punon për ta forcuar Partinë, por, nga ana tjetër, sjell edhe të tjerë për ta dobësuar edhe më tepër Partinë. Tuku nuk mund të justifikohet me butësinë që ka. Puna armiqësore e Koçi Xoxes dhe e trockistëve jugosllavë, që e dëmtuan rëndë Partinë tonë, duhet të ishte një mësim i madh për të gjithë ne, për ta ruajtur atë nga armiqtë. Zbulimi i Koçi Xoxes dhe i tradhëtarëve jugosllavë bëri që armiqtë ta sulmonin nga të katër anët Partinë, duke pretenduar se ata i ka goditur Koçi dhe janë viktimat e trockizmit jugosllav. Kështu Tuku fut njerëz në Parti pa i parë mirë ata se cilët janë. Është e vërtetë që puna armiqësore e trockistëve i ka bërë dëme të jashtëzakonshme Partisë sonë, por ata që kërkojnë të rifuten në Parti duhet të kontrollohen mirë. Kjo gjë s'është bërë mirë nga Tuku dhe prandaj rrezikohej Partia. Edhe pse është kritikuar shumë herë për këto

gjëra që u thanë, Tuku nuk arriti që t'i realizonte si duhet. Doli Kadri Hoxha nga burgu dhe Tuku e priti në shtëpinë e tij menjëherë. Ai ka qenë anëtar i Komitetit Qendror, po ne kemi pasë arësye të forta që e kemi përjashtuar dhe Tuku e di mirë punën e Kadri Hoxhës. Kjo ka ardhë pse në drejtim të ruajtjes së Partisë, për forcimin e vigjilencës, Tuku kurrë nuk ka menduar si duhet. Ai asnjëherë nuk ka dalë jashtë zyrës dhe të thellohet në jetën e Partisë, si reagon Partia e si punojnë komitetet e Partisë. Këtë gjë Tuku nuk e ka bërë fare, por ai as punën e zyrës nuk e ka bërë si duhet. Mënyra e organizimit, rregullat, direktivat nuk i ka thelluar dhe nuk i ka studjuar si duhet. Gabime të tilla për një sekretar të KQ të Partisë janë shumë të rënda. Me punën e tij Tuku e ka dëmtuar rëndë Partinë dhe kjo punë e dobët është reflektuar edhe në punën e Byrosë Politike.

Në këtë mbledhje unë konstatova se disa shokë nuk i ngritën me forcë këto gabime e dobësi serioze, që kanë lidhje me vetë jetën e Partisë dhe ta kritikonin Tukun ashpër dhe drejt. Kjo është e domosdoshme, pse ndryshe Tuku nuk mund të shërohet. Pa e kritikuar ashpër as ai dhe as ne nuk mësojmë prej gabimeve. Këto gjëra janë shumë të rëndësishme dhe në radhë të parë këtë kritikë duhet ta bënin shokët që kanë punuar më afër me Tukun si Liria dhe sidomos Theodhor Heba.

Autokritika e Theodhorit nuk më bëri përshtypje të mirë, pse nuk i analizoi thellë gabimet e tij, por doli me një autokritikë, që për mua është zero. Ai nuk kritikoi as Tukun për gabimet e tij të rënda. Theodhori thotë se nuk paska lexuar asnjë vepër të klasikëve të

marksizëm-leninizmit, bile as «Historinë e Partisë Bolshevike». Po a mund të ketë anëtar partie që të mos ketë lexuar një faqe të «Historisë së Partisë Bolshevike»? Unë mendoj se një njeri të tillë nuk mund të ketë në Parti. Në qoftë se është ashtu, atëhere çfarë lexon dhe çfarë bën Theodhori? Le të marrim anën që Theodhori thotë se është i paaftë. Atëhere, po ta shikojmë kështu, ne kemi bërë shumë gabim që i kemi dhënë drejtimin e Drejtorisë së kuadrit në KQ të PPSH një njeriu kaq të paaftë dhe që nuk lexon fare, që nuk bën përpjekje të ngrihet. Nga një njeri i tillë çfarë mund të presim ne për edukimin e kuadrit. Edhe ajo që u tha këtu se Theodhori i ka pasur të gjitha mundësitë për të ecur drejt në çështjet e kuadrit është e vërtetë. Theodhori ka marrë pjesë në shumë mbledhje të Sekretariatit dhe të Byrosë dhe, në diskutimet që kemi bërë ne, kemi shtruar parime të drejta si duhej të bëhej politika e kuadrit. Pra, Theodhori nuk është lënë të ecë në tym, apo gjërat që dëgjonte Theodhori nga një vesh i kanë hyrë dhe nga tjetri i kanë dalë? Sa për atë që tha për Tukun, se Byroja Politike nuk ka bërë punë me të, s'është e vërtetë. Byroja ka gabimet e veta, po ajo ka punuar e nuk ka shkuar në tym. Ajo ka bërë punë pozitive, prandaj të dimë t'i dallojmë gjërat dhe atje ku fajin e kemi të tërë, ta mbajmë përgjegjësinë kolektive dhe atje ku e kemi veç e veç, prapë të mbajmë përgjegjësitë personale e të shpjegojmë gabimet dhe shkaqet e tyre. Byroja Politike do ta shtrojë edhe në referatin tjetër që ka për Tukun në lidhje me politikën e kuadrit, që nuk është bërë e shëndoshë si nga Tuku, ashtu dhe nga Theodhori. Prandaj këta duhet të thello-

hen mirë për këtë çështje, t'i analizojnë gabimet e tyre, të tregojnë edhe shkaqet.

Edhe për çështjen e Manolit [Konomi] unë nuk jam i qartë. Ai ka thënë se edhe tani nuk e meriton të jetë anëtar i Komitetit Qendror. Për mua kjo është një çështje e çuditshme, që ai duhet të na e shpjegojë, sepse ne nuk mund të pranojmë një autokritikë të përciptë, si ajo që bëri Manoli. Edhe shokët e tjerë thanë se kanë bërë gabime dhe bënë autokritikë. Ne jemi luftëtarë, anëtarë të Komitetit Qendror që e kemi kup-tuar rëndësinë e punës sonë dhe përgjegjësinë tonë. Ne, në praktikën e punës, kemi bërë dhe gabime, të cilat do t'i zhdukim me përpjekjet tona. Por fjalët e Manolit nuk janë aspak bindëse. Ai duhet të thellohet më tepër. Edhe në funksionin e tij si ministër i drejtësisë ai ka kërkuar dy-tri herë dorëheqje duke thënë se nuk e bën dot atë detyrë. Për këto mendime të tij, ne e kemi thirrur Manolin dhe i kemi kërkuar arësytet. Por ato që na ka thënë ai nuk kanë asnjë bazë. Por mendoj se diçka tjetër e rëndësishme ngjet te ai, kur thotë se është i paaftë, sepse në fakt ai ka aftësi profesionale, bile të mira, prandaj justifikimi ose preteksti i tij nuk qëndron. Atëhere cili është shkaku i vërtetë? Ne duhet ta dimë këtë. Insistimi i Manolit nuk është për modesti, sepse kongresi dhe Komiteti Qendror i kanë peshuar mirë aftësitë e tija kur e kanë ngarkuar me këtë punë. Nga ana profesionale Manoli është në gjendje ta kryejë punën. Prandaj ato që thotë ai nuk janë komuniste. Unë e njoh mirë atë, ai është i mbyllur në vetëvete, nuk flet shumë, por tani ka një jetë të gjatë partie, njihet mirë me shokët e Komitetit Qendror

dhe të qeverisë, prandaj nuk ka arësye, pse të jetë i mënjanuar e gjithnjë nëpër qoshe. Prandaj këto qëndrime të tij, ai duhet t'i analizojë mirë me qëllim që Komiteti Qendror të jetë i qartë. Manoli na tha këtu se e ka kuptuar drejt çështjen e oportunitetit në sektorin e drejtësisë, po unë them se ai akoma nuk e ka kuptuar. Në qoftë se ai e ka kuptuar, atëhere pse mban një qëndrim të tillë para Byrosë Politike, ku mbron njerëzit me pikëpamje të vjetra? Në vend që të jenë në drejtësi njerëzit e Partisë, megjithëse ata mund të jenë tani për tani pak më të ulët nga ana profesionale, ai ka tendencë që t'i mbrojë njerëzit që punojnë tani në drejtësi, edhe pse nuk kanë asnjë garanci. Atëhere, si e ka kuptuar ai oportunitetin? Nga kjo tendencë e tij del se e ka kuptuar oportunitetin vetëm në teori. Kjo është e gabuar. Kur e kemi thirrur Manolin, ai u zgjerua në autokritikën e tij, të cilën këtu duhet ta kishte thelluar edhe më shumë. Ai na tha neve si njeri i karrierës se ka pasur pikëpamje të gabuara dhe se duhej të punohej akoma me njerëzit me pikëpamje të vjetra që punojnë në sektorin e drejtësisë, të cilët, sipas tij, nuk kemi me kë t'i zëvendësojmë. Këto pikëpamje të Manolit nuk janë të drejta. Ai është komunist, anëtar i Komitetit Qendror dhe duhet t'i kuptojë mirë çështjet. Komiteti Qendror duhet të përpiqet ta shërojë atë nga këto gabime, por dhe ai duhet të bëjë përpjekje që t'i luftojë këto pikëpamje, duke bërë autokritikë para Komitetit Qendror dhe para organizatës bazë, përndryshe me qëndrimin e tij të heshtur, nuk do të ndihmojë as veten as Partinë.

Këto çështje janë jetike për Partinë tonë, prandaj

nuk mund të shkojnë me një autokritikë të thjeshtë. Pra, këtë situatë ne duhet ta ndryshojmë, sepse disa anëtarë të Partisë po bëhen si zyrtarët e dikurshëm të paprekshëm. Kjo është serioze. Po si mund të kryhen detyrat, në rast se në Parti ekzistojnë gjëra të tilla serioze dhe në rast se nuk përfitohet sa duhet nga eksperiencia e madhe e Bashkimit Sovjetik në punët tona dhe nga mësimet e mëdha të shokut Stalin?

Përsa i përket Drejtorisë së agjitacionit e të propagandës, sipas mendimit tim dhe të Byrosë Politike Bedriu duhet t'i vërë krahët dhe të ketë kujdes më të madh, pse me gjithë përmirësimet që janë bërë në këtë sektor, ka lëshime serioze. Problemi që të armatosim Partinë me kulturë dhe me teorinë marksiste-leniniste është një çështje kryesore për Partinë tonë. Bedriu duhet të jetë i ndërgjegjshëm për këtë barrë të rëndë që i është ngarkuar, prandaj duhet të ndërrojë kursin dhe metodën e punës, pse kjo te ai lë shumë për të dëshiruar. Byroja Politike do ta ndihmojë Bedrinë në këtë punë të vështirë, po edhe ai është përgjegjës para Partisë dhe Byrosë Politike për sektorët që drejton. Të gjithë neve shokëve të Komitetit Qendror, po në radhë të parë Bedriut i bie barra më shumë të studjojë, përndryshe këto punë, kaq të mëdha, do të kryhen në mënyrë të përciptë. Nuk mund të shkosh të kontrollosh shkollën, po të mos dish mirë problemet e saj. Unë them se 40-50 për qind e arësyes që shokët tanë nuk venë poshtë në bazë, është se ata kanë frikë se mos njerëzit atje u nxjerrin paaftësinë e tyre në shesh. Pse ne vinim më shumë në bazë në kohën e luftës? Ç'janë ato forma që na thuhën, ku i dinim ne ato? Ne vinim shpeshherë

atëhere në komitetet e Partisë dhe në celulat, kurse sot kjo mosvajtje është një neglizhencë e madhe dhe kjo do të thotë se ne nuk jemi në krye të problemeve. Nuk është e nevojshme për udhëheqjen që të dijë gjërat në hollësi, siç mund t'i dijë ai që punon ditë e natë në atë vend dhe me ato probleme, por shokët tanë duhet të dinë mirë një gjë: vijën e Partisë dhe frymën e saj revolucionare. Kjo do të thotë se mosnjohja e çështjeve i pengon ata të shkojnë poshtë për të kontrolluar e për të ndihmuar shokët dhe njerëzit e tjerë. Në qoftë se je në krye të punës dhe nuk e di një problem, kërko shpjegime dhe pastaj me vijën e Partisë ti do ta vësh punën në rregull patjetër. Por nga mosinteresimi dhe nga mosditja e çështjeve bëhen edhe lëshime, prandaj duhet të bëjmë përpjekje që të ngrihemi dhe të mësojmë. Dhe po të mos e bëjmë këtë gjë çdo ditë, nuk do të jetë e mundur që ne të kontrollojmë dhe të ndihmojmë vartësit tanë. Ne problemet nuk i kemi thelluar dhe nuk i kemi zotëruar si duhet, prandaj disa vendime që kemi nxjerrë, nuk kanë qenë në lartësinë e duhur. Nga ky shkak nuk u kemi kërkuar as llogari njerëzve tanë në bazë.

Puna e agjitacionit dhe e propagandës është me një rëndësi të madhe. Bedriu po të bëjë më shumë përpjekje, do ta zotërojë si duhet këtë sektor, do të ngrihet edhe vetë dhe do t'i shohë më mirë çështjet. Çështjet e agjitacionit e të propagandës lidhen ngushtë me vijën e Partisë. Ne duhet ta armatosim me një vijë të shëndoshë Partinë tonë. Dhe me këtë vijë Bedriu duhet të ecë dhe të jetë rigoroz me njerëzit që ka në vartësinë e tij. Kështu mund të thuhet edhe për shokët

e tjerë. Ndryshe shokët do të ecin në rrugë të gabuar, do t'i mbulojë rehatllëku duke vajtur nga shtëpia në zyrë dhe nga zyra në shtëpi. Kështu puna nuk mund të shkojë aspak mirë.

Ne duhet të luftojmë kundër shfaqjeve të kënaqësisë te njerëzit tanë. Të jesh i kënaqur si Tuku, që nuk ka bërë përpjekje për të kryer punën, është një gjë e palejueshme. Por nuk është vetëm kjo gjë, po është edhe çështja e rehatllëkut, që i ka bërë këta të mos tunden nga zyra. Nuk duhet të mendohet se «unë tani jam anëtar i Komitetit Qendror, mjafton të shkoj në zyrë dhe mbaroi puna». Ky mendim duhet të luftohet. Ka te ne inspektorë, që nuk shkojnë në fshat. Ka edhe komunistë që nuk duan të punojnë në fshat. Përse nuk duan disa anëtarë partie të shkojnë në fshat mësues? Kjo tregon se te komunistët ka filluar të duket ndjenja e rehatllëkut, që është serioze për Partinë tonë. Një frymë të tillë duhet ta luftojmë me ashpërsinë më të madhe. Kush e ka ndaluar Tukan të shkonte në bazë? Unë shumë herë i kisha thënë, po ai vazhdonte të merrej gjithnjë me shkresa. Pra, te Tuku ka ekzistuar kjo gjë, po një gjë e tillë ekziston edhe te disa të tjerë, prandaj duhet që shokët të kenë kujdes e t'i luftojnë këto gjëra.

Problemet e tjera që ka ngritur Byroja Politike si për çështjen e edukimit, për kritikën e autokritikën, për demokracinë e brendshme, për luftën e klasave, nuk janë bërë edhe probleme të mbledhjeve të Komitetit Qendror dhe kjo është një e metë e madhe e jona. Mehmeti dhe Shefqeti ngritën çështje që duhet të na preokupojnë jashtëzakonisht. Në radhë të parë ne duhet të mbrojmë Partinë nga armiku, pse ai bën gjithnjë përpjekje që

të na futet brenda radhëve tona për të na dëmtuar më mirë. Partinë e mbrojmë më mirë, duke respektuar Statutin dhe rregullat e saj, demokracinë e brendshme, duke forcuar kritikën dhe autokritikën. Këto probleme duhet të ngrihen në Parti me forcën më të madhe, pse vetëm kështu do të korrigjohen njerëzit dhe, ajo që ka më tepër rëndësi do të mund të diktojmë edhe ku është armiku, pse ky fshihet fare lehtë. Prandaj shokët nuk duhet të besojnë pa fakte. Besimi duhet të jetë i shëndoshë, por të mos kuptohet se tani nuk duhet të kemi besim, këtë duhet ta krijojmë me punën që bën secili, me zbatimin e vijës, me kryerjen e detyrave. Shokët të korrigjohen e të kritikohen në rast se do të bëjnë gabime. Prandaj vigjilenca revolucionare duhet të jetë edhe më e madhe në shokët tanë. Një njeri, që, megjithëse kritikohet e ndihmohet dhe prapë vazhdon të bëjë gabime, edhe po të mos kemi ndonjë dyshim se ai është armik, duhet të shihet çështja e tij. Pse mbas një, dy e tri gabimeve dhe ndihmës që do t'i jepet, të mos i korrigjojë ai këto gjëra? Kjo vigjilencë duhet të bëhet e masave të Partisë. Ndryshe edhe masat e popullit nuk mund të edukohen, pse Partia lufton bashkë me popullin dhe në qoftë se ne shkëputemi nga populli, bëjmë gabimin më të madh. Forca e Partisë qëndron në mobilizimin e popullit në rrugën e saj. E si mund të pretendohet të ketë kritikë dhe autokritikë në mbledhjet e këshillit popullor të fshatit, si mund të kritikohet kryetari i këshillit, kur nuk bëhet një gjë e tillë në Parti? Atëhere, kur nuk i kemi këto gjëra në Parti, ne flasim kot për pushtetin popullor, që duhet të bëhet i masave. Kjo do të jetë me të vërtetë kështu,

kur në vetë Partinë të ketë demokraci të brendshme. Prandaj duhet t'i vëmë mirë në vend këto gjëra.

Pastaj edhe për luftën e klasave më duket se flasim shumë e bëjmë pak. Vazhdimisht po na thonë se ka dëmtime e abuzime. Po shokët e Partisë çfarë bëjnë, ku është vigjilenca e Partisë, pse nuk i kapin dëmtuesit e vjedhësit, pse nuk përpiqen të njohin metodat e punës së tyre dhe t'u hedhin duart në grykë? Edhe këta janë armiq të klasës, të socializmit dhe të Partisë sonë. Në goftë se nuk ka vigjilencë Partia, si mundet t'ja dalim mbanë punës? Armiku na lufton me njëmijë mënyra, ai organizon tërë reaksionin, e grumbullon, e armatos. Armiku nuk fle, prandaj duhet ta shumëfishojmë vigjilencën. Në rast se ne bëjmë lëshime ndaj elementëve që futen kontrabandë në Parti, do të na e shkatërrojnë nga brenda Partinë. Prandaj ne duhet të tregojmë zgjuarësi kudo e kurdoherë dhe ta mbrojmë si duhet Partinë, të jemi të ashpër dhe të pamëshirshëm kundër armiqve.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**KONKLUZIONE NË LIDHJE ME RAPORTIN E
MBAJTUR NË PLENUMIN IX TË KQ TË PPSH
«MBI REALIZIMIN E PLANIT DYVJEÇAR»
DHE DISKUTIMET QË U ZHVILLUAN RRETH TIJ**

21 shkurt 1951

Do të përpiqem edhe unë të nxjerr disa konkluzione nga raporti «Mbi realizimin e planit dyvjeçar» dhe diskutimet që u zhvilluan rreth tij prej shokëve të Plenumit të Komitetit Qendror. Përveç raportit edhe diskutimet vunë në dukje gjëra të tjera të rëndësishme që na ndihmuan në punimet e këtij plenumi.

Ne bëjmë mbledhjen e plenumit për të marrë ndihmën e Komitetit Qendror, prandaj ato që thuhën këtu nuk duhet t'i nënvleftësojmë. Ndhimën që marrim nga plenumi duhet ta kuptojmë dhe ta vlerësojmë realisht. Kritikën dhe vërejtjet që na bëjnë shokët këtu, duhet t'i marrim si kritikë dhe vërejtje të shokëve të Komitetit Qendror. Sigurisht që ato duhet të bëhen të thelluara mirë e të matura, por derisa nëntë të dhjetat e kritikave janë të drejta, nuk prish ndonjë punë edhe sikur një e dhjeta e tyre të jenë të tepruara. Kritika e drejtë bolshevike dhe e hapët na bën mirë. Por nuk duhet të vijmë në mbledhje sa për të bërë shpejt e

shpejt një kritikë e autokritikë, që «të mos mbetem edhe unë pas nga shokët, e mos e kuptojnë ndryshe shokët e Komitetit Qendror atë që thuhet». Shokët e Komitetit Qendror kanë një eksperiencë partie dhe dinë ta dallojnë menjëherë çështjen. Por një ndërhyrje në kohën e duhur, jo vetëm ndihmon anëtarin e Komitetit Qendror, po ajo shërben edhe për të tjerët, pse nga gabimet e njërit do të mësojnë edhe të tjerët. Ne në Komitetin Qendror çdo ditë po mësohemi, po edukohemi dhe po ndreqim gabimet. Ne paraqitëm këtu raportin e Byrosë Politike, po shumë gjëra të tjera dolën gjatë zhvillimit të mbledhjes. Kështu ne mësojmë gjithnjë nga shokët. Byroja Politike ka dalë përpara plenumit edhe me propozime që ai mund t'ja korrigjojë dhe t'i thotë: ndaluni pak këtu, se kjo situatë duhet parë kështu ose ashtu.

Për realizimin e planit të shtetit ne jemi vënë përpara përgjegjësive. Shkaqet e mosrealizimit ne i analizuam, pamë të metat tona që janë serioze. Për këtë gjendje kemi përgjegjësi që të gjithë, duke filluar nga ne, shokët e Byrosë, të qeverisë dhe deri te shokët e Komitetit Qendror që punojnë në aparatën e tij. Kjo punë, që bëme këtu, duhet të na shërbejë për të forcuar më shumë punën tonë e të ecim përpara me hapa më të mëdhenj. Nga të gjitha këto gjëra që pamë këtu duhet të mendojmë që të nxjerrim edhe disa mësimë e konkluzione.

Pikësëpari duhet të shohim problemet e kohës. Ne si udhëheqës duhet që, me situatat që po krijohen, të marrim masa të reja. Po a e ka bërë këtë Komiteti Qendror? Unë them se problemet e kohës ai i ka parë

dhe nuk ka ndenjur pa dhënë orientimet e duhura, të cilat bashkë edhe me direktivat e tjera të Partisë duhet të zbatohen patjetër nga njerëzit e Partisë dhe nga udhëheqësit. Lufta e klasave do t'i forcojë njerëzit e Partisë dhe radhët e saja. Ajo do të bëjë diferencimin edhe brenda Partisë, duke nxjerrë përjashta saj njerëzit e papërshtatshëm për situatat që krijohen; këtë gjë ne e mësojmë edhe nga eksperiencia e Partisë Bolshevike. Ka në Parti njerëz që ecin përpara, ka të tjerë që qëndrojnë në vend, po ka dhe nga ata, që nuk kuptojnë as situatën as vijën e Partisë, veçse nuk hidhen kundër Partisë, por e pengojnë atë në rrugën e saj të drejtë.

Këto probleme Komiteti Qendror i ka parë, po mua më duket se nuk mjafton që t'i shohësh, po edhe duhet t'i ndjekësh, të jesh vigjilent dhe të vësh në krye të punëve njerëzit e përshtatshëm. Ata që ecin më ngadalë të edukohen të ecin me vrullin e Partisë, ndërsa ata që janë armiq të spastrohen. Partia jonë ka thënë vazhdimisht se duhet të mbështetemi në popull dhe në radhë të parë në klasën punëtore e në fshatarësinë e varfër. Nuk mund të themi se ne nuk e kemi bërë këtë gjë, pse në fakt, ne jemi mbështetur në popull, ndryshe nuk mund të rronte Partia. Por ne themi se këtë gjë nuk e kemi bërë si duhet dhe aq sa duhet. Komiteti Qendror ka dhënë direktiva që njerëzit e klasës punëtore të ngrihen në përgjegjësi me kurajë. T'i edukojmë ata me vullnet që të marrin çdo gjë në dorë. Këtë gjë ne e kemi bërë deri në një farë shkalle, po jo si duhet e vazhdimisht. Analiza që u zhvillua në këtë plenum, na e bën më të qartë këtë situatë. Përsa i përket bolshevizimit të Partisë, demokracisë së saj të brendshme,

kritikës dhe autokritikës, ne këto çështje i kemi shtruar vazhdimisht, por megjithkëtë, kemi të meta dhe gabime shumë serioze. Përse po i theksoj këto çështje? Këto çështje i theksoj pse dua të tërheq vëmendjen në faktin se mësimet e tilla të mëdha që morëm këtu, të cilat jeta e puna do të na i vërë edhe më shumë përpara, nuk duhet të na mbeten si deri më sot, të pazbatuara plotësisht, por të mobilizohemi që t'i vëmë më mirë në jetë. Nga ana tjetër, të njohim se punimet e këtij plenumi nuk mund të barazohen me ato të plenumeve të mëparshme, kjo është një anë pozitive e udhëheqjes, e Komitetit Qendror për ta shpurë Partinë tonë gjithmonë e më shumë në rrugën e bolshevizimit të saj dhe për të bërë një përparim më të madh në udhëheqje. Çështja është se ne si Komitet Qendror dhe si qeveri e analizuam gjendjen e planit ekonomik, pamë dobësitë që kanë sjellë mosrealizimin e tij, të cilat duhet t'i kapërcejmë medoemos. Në këtë çështje unë dua të ndalem pak.

Që të mos e përsëritim edhe një herë, duhet që çdo anëtar i Komitetit Qendror atje ku punon, të jetë përgjegjës qind për qind për punën e tij. Në rast se do të ketë shok që i shmanget kësaj gjëje, atëhere Komiteti Qendror duhet të marrë masa. Por, kur të vijë puna që të merren masa në Komitetin Qendror, çështja duhet të ketë shkuar më parë në Byronë Politike për t'i dhënë gjithë ndihmën këtij ose atij shoku. Pra, Byroja Politike ka studjuar mirë problemin, ka caktuar mirë vijën e detyrat, e ka ndihmuar këtë shok dhe e ka drejtuar në rrugën që duhet. Në rast se ky shok ecën kurdoherë në rrugë të shtrembër, nuk zbaton

vendimet që merren, nuk kontrollojnë punën e tij që të shkojë në rrugën e drejtë të Partisë, atëhere çështja e tij duhet të shtrohet në Komitetin Qendror, ku pa asnjë hezitim ky shok duhet të vihet përpara përgjegjësisë. Kështu duhet vepruar edhe për shokët që do të ngarkohen me funksione në Parti. Vetëm kështu do të shohim që problemet nuk do të zvarriten dhe nuk do të mjaftohemi gjithnjë me konstatime e justifikime. Si do ta bëjmë këtë gjë? Në rast se ne nuk mbështetemi te Partia, në rast se nuk kërkojmë ndihmën e saj, atëhere këto gjëra nuk do të realizohen. Vërtet kundër armiqve ka masa administrative dhe represive, po edhe Partia me punën e saj duhet të veprojë. Në rast se Partia nuk mobilizohet dhe ne nuk punojmë në ato caqe që na cakton kongresi i Partisë sonë, këto të meta nuk do të eliminohen. Pra, nga sa del, te ne mbështetja në Partinë nuk është në lartësinë e duhur. Ne duhet të mbështetemi te Partia për zgjidhjen e problemeve që na paraqiten dhe ajo duhet të mbështetet në masat e popullit. Por derisa në bazë ka akoma komunistë, të cilët nënvleftësojnë dhe ngurrojnë që njerëzit e klasës punëtore të vijnë dhe të marrin punët në dorë, është e kotë që ne të themi se mbështetemi si duhet te Partia.

Në analizën që bëmë pamë se te ne ka shumë vjedhje e sabotime. Ne duhet të përpiqemi të gjejmë shkaqet pse ndodhin këto gjëra. Unë mendoj se këto ndodhin pse Partia nuk është vigjilente sa duhet, se në Parti kritika dhe autokritika nuk janë në lartësinë e duhur.

Po ç'duhet të bëjmë që Partia të fitojë me të vërtetë dashurinë dhe besimin e masave të popullit plotë-

sisht dhe të thithë në masat forcën për veten e vet? Kjo përbën të gjithë rrugën për bolshevizimin e Partisë. Nga gjithë këto që u thanë këtu, mendoj se jeta e Partisë është bërë deri diku e mbyllur, sekrete, ku bëhet kritikë dhe autokritikë vetëm brenda këtij rrethi. Kurse të tjerët, që nuk janë anëtarë partie, edhe kur kritikojnë, nuk ua vë veshin njeri. Kjo është shumë e rrezikshme për Partinë, një gjë të tillë ne duhet ta luftojmë.

Kemi edhe çështjen e revizionimit, ku na dalin njerëz që nuk meritojnë të jenë në Parti, kurse nga ana tjetër, kemi me mijëra të tjerë që e duan me zemër Partinë, por që janë jashtë saj. Çfarë fshihet prapa këtyre? Shumë gjëra. Prandaj ne duhet të përfitojmë nga eksperiencia e madhe e Partisë Bolshevike dhe celulat e Partisë e Partia jonë në asnjë mënyrë të mos bëhen si organizatë fronti, pse Partia jonë është para-voja, e cila ka në gjirin e vet elementët më të ndër-gjegjshëm të klasës punëtore dhe të fshatarësisë, që udhëheqin popullin tonë. Përsa i përket punës në celula ne duhet të marrim shembull nga jeta e Partisë Bolshevike. Shumë herë në Partinë tonë diskutohen çështje organizative; në këto mbledhje duhet të marrin pjesë vetëm anëtarë partie dhe kandidatë për anëtarë partie, por te ne bëhen edhe mbledhje të organizatave bazë, ku diskutohen herë pas here çështje që i përkasin gjithë kolektivit punonjës, anëtarë partie ose joanëtarë partie. Mbledhje të tilla ku rrihen probleme të disiplinës në punë, çështje vjedhjesh ose abuzimesh që ndodhin në një qendër pune, çështje të mosrealizimit të planit etj., është mirë që të bëhen bashkë me të gjithë kolektivin

punonjës me të drejtë fjale dhe kritike. Sigurisht që do të jetë celula ajo që do të vendosë për një çështje, por edhe punonjësit jokomunistë duhet të kenë të drejtë të thonë mendimin e tyre.

Edhe çështja e pranimit në Parti mund të bëhet në mbledhje të hapëta përpara të gjithë kolektivit punonjës. Ai që do të pranohet si anëtar ose kandidat partie duhet të dalë përpara të gjithëve, të bëjë autobiografinë e tij dhe t'u përgjigjet të gjitha pyetjeve dhe kritikave që do t'i bëjë mbledhja. Pastaj edhe ata që e rekomandojnë të ngrihen e të flasin, duke treguar arësyet që i shtyjnë ta bëjnë këtë rekomandim ose pse duan që ky ose ai të futet në Parti. Dhe këta, pra, duhet t'u përgjigjen të gjitha pyetjeve dhe kritikave që do t'u bëhen nga i gjithë kolektivi. Mbas kësaj pune njerëzit të futen në Parti. Një punë e tillë do ta forcojë jashtëzakonisht dhe do ta bolshevizojë Partinë. Unë them se kritika dhe autokritika në Parti nuk është në lartësinë e duhur dhe kjo ndodh sepse ka liberalizëm e familjaritet.

Njerëzit e Partisë punojnë, po ata bëjnë edhe gabime. E në qoftë se problemet që lindin në lidhje me planin ose me disiplinën në punë do të shtroheshin në mbledhje të hapëta të celulës, përpara gjithë kolektivit, që është i interesuar për ato probleme, do të zhduket familjariteti dhe oportunizmi, sepse nuk do të jetë më e mundur për një anëtar partie të mbrojë njërin ose tjetrin në celulë për çështje që i përkasin të gjithë kolektivit, pse do të dalin njerëzit e masës dhe do të thonë të vërtetën. Patjetër që e di dhe e kupton masa e punëtorëve të kombinatit për shembull

se kush vjedh, kush është dembel, bile mundet që ajo t'i njohë akoma më mirë disa njerëz që janë në celulë, por që flenë. Kjo duhet të bëhet sepse ka raste që nën autoritetin e Partisë fshihet ndonjë njeri i sëmurë, që nuk punon dhe që i mungon shpirti i vetëmohimit. Kjo ka edhe një anë tjetër të mirë: Ajo do të bëjë që anëtari i Partisë, për të folur në një mbledhje të tillë, ku merr pjesë i gjithë kolektivi, do të përgatitet të flasë me kompetencë për problemet e sektorit ku ai punon, se nuk mund të flasë përpara të gjithëve ashtu si flet kur është vetëm, po do t'i futet thellë punës, pse në rast se nuk flet mirë dhe me kompetencë, ka njerëz të tjerë që e dinë mirë zanatin e punës, që e duan Partinë dhe popullin dhe duke qenë kështu ata do të dalin ta kritikojnë e ta korrigjojnë anëtarin e Partisë. Në këtë mënyrë përgjegjësia e anëtarit të Partisë do të rritet më shumë dhe Partia fiton një besim më të madh te punëtorët, te populli. Kështu që kur organizata bazë e qendrës së punës do të bëjë mbledhje me të gjithë punëtorët e ndërmarrjes, kjo do të jetë një ngjarje e madhe për ta. Ata do të kenë besimin më të madh në mbledhjen që bën Partia në qendrën e punës, ku janë njerëzit më të mirë, më të ndërgjegjshëm, më punëtorë, njerëz që punëtorët i kanë parë në autokritikat e hapëta që bëjnë kur kanë gabime si dhe në vendosmërinë e tyre, kështu punëtorët do të kenë edhe respektin e besimin më të madh për ta. Prandaj, kur organizata bazë do të dalë me vendime, punëtorët do t'i zbatojnë ato me ndërgjegje të plotë, pse ato janë vendime të Partisë të dala nga njerëzit më të mirë të ndërmarrjes. Kështu punëtorët do të kuptojnë se ai që

është futur në Parti e ka merituar plotësisht atë nder dhe më mirë se ndonjë tjetër, prandaj punëtori do t'i thotë vetes: «duhet të bëj edhe unë përpjekje për të hyrë në Parti si ka hyrë edhe shoku im». Duke vepruar kështu nuk do të na ngjasë si deri tani që në Parti na kanë hyrë edhe njerëz që nuk vlejné për të qenë anëtarë të saj. Në këtë mënyrë ne do të kemi një Parti të fortë, të shëndoshë, me njerëz që e meritojnë dhe janë të kalitur.

Duhet të shohim gjithashtu mirë se cilët janë ata që sabotojné ose që abuzojné dhe të ndiqet me kujdes çdo shfaqje e tillë, kështu do të dridhen armiqtë e Partisë, kështu ata do të shohin se nuk mund të fshihen nga masa e Partisë. Në këtë mënyrë ne ngremë edhe më shumë përgjegjësinë, e cila rritet çdo ditë në një shkallë më të lartë si për njerëzit që janë udheheqës dhe për ata që punojné poshtë në bazë. Unë mendoj se të gjithë ata që nuk punojné mirë, qofshin drejtorë, ndihmësministra, ministra ose anëtarë të Komitetit Qendror, duhet me i kritikue haptas. Nuk kemi pse t'i ruajmë ata që nuk bëjnë detyrën, po të veprojmë ndryshe, kemi dëmtuar Partinë. Deri tani ne kështu kemi vepruar. Prandaj mendoj se është e domosdoshme ta bëjmë këtë gjë akoma më mirë edhe në të ardhshmen, pse kështu do të evitojmë në minimum të gjitha të metat dhe gabimet tona. Ne duhet të përpiqemi me të gjitha forcat tona që njerëzit t'i korrigjojmë po dhe kjo ka një kufi, prandaj kundër atyre, që nuk korrigjohen, duhet të marrim masa, kurse kundër armikut duhet të jemi të pamëshirshëm dhe, kur është nevoja, të marrim edhe masa të rrepta. Të luftojmë familjari-

tetin në mes tonë, sepse një gjë e tillë aty-këtu ekziston edhe te ne dhe na dëmton. Ne duhet t'i shohim me hollësi situatat që krijohen brenda dhe jashtë vendit tonë. Gjithashtu duhet të kemi mendjen për të ruajtur me çdo mënyrë interesat e Partisë, ndryshe do të shkasim në lëshime, në butësi, në liberalizëm. Shoku Stalin na mëson se në momentet më të rënda, masat duhet të jenë të ashpra kundër armikut.

Duhet të jemi të vendosur edhe në masat kundër një kuadri të padisiplinuar. Partia gjithnjë ecën përpara; por gjatë kësaj rruge, bashkë me njerëzit e vendosur të saj, të cilët e ndjekin atë deri në fund, ka edhe disa që do të mbeten në rrugë, po Partia do të shkojë përpara. Armiku do të përpiqet t'i shfrytëzojë këto raste dhe do të thotë çdo gjë, por ne nuk duhet të dëgjojmë ç'thotë ai. Ne s'duhet të hezitojmë në rrugën tonë.

Ne në Komitetin Qendror kemi thënë shumë herë se Partia duhet të drejtojë çdo gjë e kudo dhe të mos e marrim të thjeshtë, sikur këtë drejtim të punëve do ta bëjë celula. Unë them se njerëzit anëtarë partie, që jetojnë në këto celula, duhet t'i kenë të gjitha frenat e punës në dorë. Pra, edhe ata të celulës drejtojnë në këtë mënyrë, sikurse edhe ne këtu në Komitetin Qendror ose në organet qeveritare. Kjo gjë nuk kuptohet drejt nga disa dhe vihet në diskutim se tjetër punë ka celula dhe tjetër punë ka pushteti. Në celulë forcohen njerëzit, bëhet kritikë dhe autokritikë që komunistët të luftojnë të metat dhe gabimet në punët e tyre për t'i drejtuar ato më mirë. Pra, në krye të punëve ne kemi komunistët që i edukojmë në celulë dhe që

kundër atyre që bëjnë gabime marrim masa edhe nga ana e Partisë, edhe nga ana shtetërore. Ne duhet të gjejmë metodat më të mira bolshevike që kritika dhe autokritika të bëhen reale, të goditen dhe të kritikohen pa drojtje e pa frikë të gjithë ata që bëjnë gabime. Ata që nuk do të ndreqen, t'i zëvendësojmë me elementë punëtorë e fshatarë të varfër, të cilët do ta bëjnë më mirë punën. Kështu ne nuk do të mbetemi rreth magjes.

Pikëpanjjet jo të drejta të Theodorit dhe të Tukut. përsa i përket politikës me kuadrin, oportunizmi i tyre, lëshimet e liberalizmi, të gjitha këto tregojnë se ata nuk kanë punuar në vijën e drejtë të Partisë në këtë çështje, po janë mbështetur në elementin mikro-borgjez e intelektual për shkak se «ata kanë nga pak shkollë». Klasikët na mësojnë se në çdo revolucion violent ngrihen dallgët, po bashkë me këto dallgë ngrihen edhe disa dallgë me bar që i qepen elementit përparimtar. Këta janë elementët e borgjezisë, të cilët përpiqen të godasin në këto situata elementin përparimtar për të kthyer gjendjen në favorin e tyre. Në fillim ne kemi nevojë për ata, pse dinë diçka dhe pikërisht për këtë fshatarët dhe punëtorët i drejtojnë dhe i respektojnë. Po partia, duhet t'u japë mësim këtyre punëtorëve dhe fshatarëve, t'i edukojë që të shohin mirë punët e tyre. Nga ana teknike ata duhen t'i dëgjojnë derisa të ngrihen njerëzit e rinj dhe pastaj t'i përzenë për t'u lënë vendin njerëzve të rinj. Ata duhet të goditen ashpër kur kërkojnë të na pengojnë dhe të na prishin punët tona.

Në këtë drejtim ne nuk e kemi bërë këtë gjë dhe prandaj vazhdohet të kemi dëme në punët tona. Për

ne është më mirë të kemi edhe dy herë më shumë humbje, në miliona lekë, po ta dimë se këto humbje vijnë jo me qëllim nga njerëzit e popullit që janë besnikë të Partisë, por që nuk e zotërojnë akoma teknikën dhe që do të mësohen patjetër. Më mirë këto dëme të na vijnë kështu se sa nga armiqtë e Partisë dhe të popullit. Kjo gjë duhet kuptuar mirë. Në rast se do të ishte ndjekur politika e drejtë me kuadrin sipas vendimeve të Kongresit I të Partisë, që atëhere e deri tani ne do të kishim tri-katër herë më shumë kuadro nga sa kemi sot. Ky është një dëm i madh që i kemi bërë Partisë. Prandaj, Byroja Politike, çështjen e kuadrit, që është një problem serioz për Partinë, duhet ta marrë me seriozitetin më të madh dhe ta shohë me imtësi. Detyrë kryesore është me forcë Partinë, d.m.th. Partia të jetë e organizuar mirë dhe jo kështu, me këto të meta e lëshime që kanë ndodhur deri tani. Po nuk e bëjmë këtë gjë, është e zorshme t'i luftojmë këto gabime dhe të meta dhe këto që po themi këtu do të na mbeten vetëm fjalë në kartë.

Kisha edhe një gjë tjetër: Shokët udhëheqës me funksione partie dhe shtetërore, që janë anëtarë të Komitetit Qendror dhe në qeveri, çështjen e ndjekjes së vendimeve nuk duhet ta kuptojnë si një gjë të thjeshtë. Duhet të kemi kujdes, sepse jemi udhëheqës kryesorë, prandaj edhe vendimet e urdhërat që japim ne duhet të jenë të studjuara mirë. Çdonjëri nga ne nuk duhet të harrojë se është një drejtues që zbaton vijën e Komitetit Qendror në pushtet, se ka disa që shikojnë vetëm problemet e sektorit të tyre. D.m.th. cilido nga ne që punon në një sektor, të mos i shohë problemet

në mënyrë të ngushtë: «hajde të realizojmë planin», pa se ç'bëhet për normat p.sh. ose për koston, nuk mendon fare në vend që të bëjë të mendojnë për këto çështje edhe të tjerët, që janë vartësit e tij. Prandaj çdo shok udhëheqës duhet të ketë parasysh që çdo problem ta studjojë mirë dhe të nxjerrë konkluzione përpara Partisë e qeverisë dhe të mos presë që këto konkluzione të bien nga qielli, ndryshe, si do të drejtojmë ne si Byro Politike ndërmjet dy sesioneve të Komitetit Qendror? Pa bërë një punë të tillë do të jetë e vështirë të nxjerrim konkluzione. Prandaj, anëtarët e qeverisë nuk duhet të mendojnë në mënyrë të përceptë dhe të na dërgojnë në qeveri shkresa pas shkresash dhe ne të nxjerrim një varg urdhëresash. Merreni me mend si mund t'ja dalin një pune të tillë njerëzit tanë në bazë, kur vetë ne na vjen rëndë që na vijnë për firmë kaq shumë shkresa e aq më tepër shokëve, të cilëve këto materiale u venë të gjitha për t'i lexuar e për t'i zbatuar. Po pse ndodhin këto gjëra? Unë mendoj se tri të katërtat e këtyre gjërave ne duhet t'i eliminojmë medoemos, sepse nga mosstudimi i çështjeve ne shtërngohemi të nxjerrim dhjetë ose pesëmbëdhjetë dekretligje, ku çdonjëri prej tyre rrezon të parat. Pra këto ndodhin, sepse shokët tanë nuk janë në krye të detyrës e nuk i njohin çështjet. Me këtë nuk dua të them se ligjet që nxjerrim ne duhet të jenë të përvetshme, po dhe të ndryshohen kaq shpesh nuk duhet, sepse kjo tregon se te ne ka gjëra që dalin të papjekura. Kjo është një punë me përgjegjësi të madhe pse këtu luhet me autoritetin e Komitetit Qendror të Partisë dhe të qeverisë sonë.

Kështu na ka ndodhur edhe në qeveri; nxirr një urdhër e hiq një tjetër. Një punë e tillë e ul autoritetin e qeverisë në popull, prandaj këtyre gjërave ne duhet t'u presim rrugën.

Këto çështje që po analizojmë ne kanë një rëndësi mjaft të madhe. Me këtë mënyrë pune, anëtarët e Partisë që punojnë në bazë kanë plotësisht të drejtë të thonë: «ç'po bëjnë kështu ata shokët atje lart në Komitetin Qendror, një herë kritiko njërin, një herë tjetrin». Por kjo që ndodh te ne, shokë, është luftë klasash, që pasqyrohet edhe në Parti, vetëm se është e domosdoshme që këto gjëra të ngjasin sa më pak në Komitetin Qendror. E kjo do të ndodhë kështu kur ne të mendojmë më thellë dhe të punojmë më mirë nga sa është punuar deri më sot.

Sikundër u përmend më parë, ne do të kemi planin pesëvjeçar dhe kemi filluar zbatimin e planit të vitit 1951, të cilin duhet ta realizojmë dhe ta tejkalojmë patjetër. Një kujdes të madh duhet të tregojmë për sektorin e industrisë e të minierave, sidomos për sektorin e naftës që nuk e kemi rimëkëmbur akoma si duhet. Prandaj shokët drejtues të këtyre sektorëve duhet të kenë besim të plotë në realizimin e planit, po jo një besim pa baza. Ata duhet të studjojnë dhe të organizojnë mirë punën e tyre. Po t'i kemi të qarta problemet, lind edhe besimi për t'i kryer ato më mirë. Le të marrim shembull nga shokët që e kryejnë detyrën si duhet dhe të gjithë shokët duhet të mësojnë prej tyre dhe të zotërojnë problemet e sektorëve ku punojnë ose drejtojnë. Po të bëjnë këtë, do të dinë të marrin edhe masat, do ta luftojnë më lehtë armikun, të lëkundurit do

të edukohen dhe Partia do të forcohet akoma më shumë. Por besimi në realizimin e planit duhet të jetë i plotë dhe me baza. Shokët drejtues duhet të jenë në krye të punës, duhet të besojnë po edhe të kontrollojnë.

Të gjithë e thanë se nuk kanë vajtur sa duhet poshtë, po asnjëri nuk e tha shkakun. Ju doni të veni poshtë, kjo është një gjë e mirë, por puna është se ka nga shokët tanë që kanë frikë të shkojnë në bazë. Kjo ndodh sepse këta, duke mos i ditur dhe zotëruar mirë punët, druhen se mos u del paaftësia në shesh. Kështu, mendojnë ata, do t'u ulet prestigji dhe autoriteti që kërkohet të mbahet në mënyrë false. Le ta themi hap-tas: kjo është mbeturinë mikroborgjeze që ekziston te disa dhe të mos kërkohet qimen në vezë. Prandaj të kritikojmë veten më parë, pastaj të tjerët.

Kështu është edhe çështja e industrisë. Ne duhet t'i instruktojmë mirë komitetet e Partisë për këtë problem, pse ato janë përgjegjëse për industrinë e ndërmarrjeve nacionale, të cilën ato e njohin nëpërmjet celulave se si vete puna në to. Ndërmarrjet e industrisë punojnë nën udhëheqjen e Partisë në rreth. Pra Partia atje duhet të forcohet, të drejtojë mirë, me qëllim që të zbatohen të gjitha urdhërat dhe direktivat e qeverisë ose të Ministrisë së Industrisë. Përgjegjësia udhëheqëse e Partisë, pra, është e madhe në këtë sektor dhe të mos na ndodhin më gjëra, si ato që po na përsëriten në Kombinatin e naftës.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

RAPORT «MBI GABIMET DHE TË METAT E TUK JAKOVËS»

Mbajtur në Plenumin IX të KQ të PPSH

21 shkurt 1951

Puna e kryer prej shokut Tuk Jakova si sekretar i Komitetit Qendror, që drejtonte organe kryesore të Komitetit Qendror, ka qenë shumë e dobët, me të meta të mëdha dhe në pikëpamjet e tija politike ka pasur shfaqje oportunizmi të theksuar.

Komiteti Qendror i ngarkoi atij funksionin e rëndësishëm të sekretarit të Komitetit Qendror dhe e caktoi të drejtonte sektorin me rëndësi të Partisë, siç është ai i organizimit, i kuadrit dhe i organizatave të masave si dhe disa drejtori të tjera të Komitetit Qendror, me përjashtim të asaj të agjitacion-propagandës dhe të bujqësisë. Siç shihet, detyra shumë të mëdha dhe të gjera. Shoku Tuk nuk ishte marrë me çështje thjesht partie, qoftë në kohën e luftës, qoftë pas çlirimit dhe këtu ka qenë e meta jonë që nuk patëm parasysh se për të drejtuar një sektor të tillë, siç ju ngarkua Tukut, duhet dhe është e domosdoshme të caktohen shokë që kanë eksperiencë në organizimin dhe drejtimin e punëve të

Partisë, dua të them që janë marrë kryesisht me punë partie, duke punuar për shumë kohë në funksionet e komiteteve të Partisë, si sekretarë politikë ose organizativë, siç i quanim në kohën e luftës. Ai nuk e ka pasur këtë stazh dhe këtë eksperiencë. Por situatat kanë qenë të atilla dhe ne nuk jemi thelluar shumë në këtë problem, po kemi pasur bindjen se, me përpjekje të mëdha nga vetë Tuku dhe me ndihmën e paprerë që do t'i jepej nga Byroja Politike dhe nga Komiteti Qendror, ai do të ngrihej, do të mësohej dhe do ta kryente këtë detyrë kaq të madhe. Por puna dhe përpjekjet e tija kanë qenë të pakta në kryerjen e detyrës, megjithëse ky ka qenë një sektor i gjerë dhe i vështirë.

Ju bënë dy vjet shokut Tuk në këto funksione. Puna intensive dhe heroike e Partisë sonë duhej ta kishin ndihmuar atë më shumë dhe të jepte rezultate më të kënaqshme në punën e tij. Tuku nuk ka përfituar si duhet dhe sa duhet nga kjo eksperiencë e madhe e Partisë. Për këtë, në radhë të parë, ka faj ai vetë, që nuk është përpjekur e nuk e ka ndihmuar si duhej Partinë, duke u bërë dhe pengesë për mbarëvajtjen e punës në sektorët që drejtonte ai.

Partia ka korrur suksese qoftë në organizimin, qoftë në forcimin dhe në edukimin e saj. Ne kemi ndryshuar gjendjen e mëparshme kaotike, ku e kishte futur Partinë puna armiqësore e tradhëtarit Koçi Xoxe dhe e trockistëve jugosllavë. Ne kemi riorganizuar aparatin e Komitetit Qendror dhe aparatet e komiteve në rrethe, ne kemi vendosur një sërë rregullash e normash në Partinë tonë, të bazuara në eksperiencën e lavdishme të Partisë Bolshevike dhe kemi bërë për-

mirësime në lidhje me kuadrin, i cili është ngritur, ka fituar eksperiencë në punë dhe në drejtim. Por këto nuk justifikojnë punën e dobët të shokut Tuk dhe mosinteresimin e tij për këto probleme kaq të rëndësishme të Partisë. Përkundrazi, sukseset e Partisë do të ishin shumë më të mëdha, Byroja dhe unë do të punonim më intensivisht në këtë drejtim, në rast se Tuku do të punonte më mirë dhe do ta kishte më të qartë situatën e organizatave të Partisë. Por Tuku nuk e ka pasur dhe akoma nuk e zotëron si duhet situatën në Parti. Kjo gjë reflektoi negativisht në njohjen e situatës në Parti nga ana e Sekretariatit, e Byrosë dhe e Komitetit Qendror. Nga një gjendje e tillë ne nuk kemi mundur t'i kemi të qarta të gjitha problemet kyçe të Partisë dhe nuk e kemi ndihmuar sa duhet Partinë në përpjekjet e saja madhështore që ajo po bën për kryerjen e detyrave në luftë me vështirësitë e panumërta. Do të jetë gabim i madh të nënvleftësojmë luftën e pareshtur të Partisë, të komunistëve, të komiteteve dhe të njerëzve që e drejtojnë Partinë, por fakti është se, nga mungesat tona, Partia dhe komunistët, nuk janë aq sa duhet në pararojë dhe të ecin me ritmin bolshevik që lypset dhe që e kërkojnë rrethanat. Këtu kemi përgjegjësi të gjithë, por ka edhe përgjegjësi të madhe personale shoku Tuk. Në ata sektorë ku interesimi dhe kujdesi ka qenë më i madh, Partia ecën me vrull përpara. Ne shohim Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Mbrojtjes Popullore, Ministrinë e Komunikacioneve, ku megjithëse situatat kanë qenë shumë të vështira, ato janë forcuar, pse Partia ecën përpara, forcohet dita-ditës dhe shokët që

drejtojnë këta sektorë e zotërojnë si duhet situatën dhe udhëheqin me aftësi. Ne mund të themi se nuk shohim e nuk kemi asnjë ndihmë nga drejtoritë ekonomike të Komitetit Qendror që drejtohen nga Tuku.

Shoku Tuk ka kujtuar se me pak punë dhe përpjekje mund të shkohej përpara dhe është formuar te ai një vetëkënaqësi për aftësitë e veta, aspak e justifikueshme duke pasur parasysh rezultatet e punës. Këtë patjetër lindin dhe shenjat e para të një mendjemadhësie e besimi të tepruar në vete, që nuk kanë themeli të shëndosha.

Shoku Tuk është marrë më shumë, për të mos thënë kryesisht, me Drejtorinë e kuadrit dhe në këtë sektor ai ka pasur bindjen se atje çështjet janë zgjidhur drejt dhe është bërë një punë e madhe. Ai nuk ka pranuar kritikën që i janë bërë në këtë drejtim, ose i ka pranuar pa qenë i bindur. Është e drejtë të thuhet se shumë kuadro janë stabilizuar, një pjesë ka gjetur vendin, një pjesë akoma jo. Tuku ka kujtuar dhe akoma është i bindur se kjo punë me kuadrin, vetëm në këtë drejtim, ka qenë e mjaftueshme. Ky ka qenë një gabim i rëndë, pse krijonte një kënaqësi të dëmshme dhe i mbyllte rrugën e pamjes më gjerë të këtij problemi kaq të rëndësishëm dhe jetik të Partisë. Por edhe kjo anë e kuadrit nuk ka qenë e studjuar mirë, ajo ka pasur shumë të meta dhe gabime që duhej ta bënin Tukun më realist dhe të mos kënaqej me ato rezultate. Edhe puna që është bërë në një përqindje të madhe ka qenë mekanike dhe kjo për faktin se lëvizjet për këta kuadro janë bërë nga zyra dhe me të dhëna jo shumë të vërtetuara nga jeta, nga lufta e

gjithë Partisë dhe e kuadrove veç e veç. Ne kemi disa të dhëna në Drejtorinë e kuadrit për njërin e për tjetrin, por ato janë mjaft lakonike. Tuku është kënaqur me një biografi të shkurtër, të cilën ja ka sjellë Theodhor Heba mbi kuadrin që do të emërohej, do të transferohej etj. Shoku Tuk ishte mbështetur qorrazi te puna që i pregatiste Theodhori duke mos u thelluar në punën dhe në pikëpamjet jo të drejta të këtij mbi kuadrin dhe duke mos gjykuar se vetë Theodhori nga ana e tij është kënaqur me një biografi të shkurtër që i ka dhënë shoku që merret me personelin në komitetet, në dikasteret ose në ndërmarrjet. Ai vazhdimisht është shprehur se Theodhori punon mirë me kuadrin, kurse në realitet në punën e tij me kuadrin s'ka pasë vigjilencë revolucionare, ka pasë oportunitizëm të dukshëm, ka pasë burokratizëm, ka pasë dhe sektarizëm të dëmshëm në drejtim të ngritjes në përgjegjësi të kuadrit të ri punëtor dhe të vendosur për Partinë dhe pushtetin.

Kjo s'është një punë e mjaftë, por mekanike dhe këtej lindin shumë gabime në politikën e kuadrit. Këto veprime mekanike nga Tuku dhe nga Theodhori janë bërë vetëm kur ka ardhur puna për emërimë e transferime dhe jo të ndiqej kuadri në punë, në jetë, në luftë dhe të shiheshin të mirat dhe të metat e tija në përpjekje me vështirësitë, të shihej përparimi dhe qëndrimi i tij ndaj punës, ndaj detyrave etj. Nga Tuku nuk kishte përpjekje dhe inisiativë që të kërkoheshin raporte të veçanta për njërin e për tjetrin, të shkonte me i pa dhe me i studjue në vend kuadrot si mendonin, si punonin, të këshillohej veçanërisht me instruktorët,

të thellohej mbi një kuadër ose mbi një tjetër, të merreshin vazhdimisht në këshillime dhe të mbaheshin afër njerëzit që merreshin me kuadrin në të gjithë sektorët dhe jo vetëm për t'u dhënë disa udhëzime si duhet të mbajnë regjistrat etj. Këto udhëzime kanë rëndësi, por s'është e tërë puna. Asnjëherë s'janë thirrur kuadrot personalisht nga Tuku, që të bisedonte me ta, të shkonte në celula, në komitete, të studjonte si punon Partia me kuadrot veç e veç dhe kuadrin për të cilin ata kanë pasur në mend ta ngrenë ose ta ulin. Mund të zgjatem orë të tëra në këtë drejtim. E këtë punë Tuku nuk e ka kryer, por e ka neglizhuar. Politika e kuadrit është e lidhur ngushtë me tërë punën e Partisë dhe, pavarësisht nëse nuk i kishim ato forma që po vendosim sot, prapëseprapë format e mëparshme nuk justifikojnë mungesat dhe gabimet e Tukat.

Tuku kishte njëkohësisht nën drejtimin e vet drejtoritë e tjera, të cilat janë të lidhura me problemet konkrete — me industrinë, me minierat, me tregëtinë, me drejtësinë e kështu me radhë. Tuku i ka neglizhuar këto, as i ka drejtuar, as i ka ndihmuar si duhej dhe as ka bërë përpjekje që punën e tyre ta lidhte ngushtë me politikën e kuadrit. Nëse një kuadër punon mirë ose keq, ai duhet parë në punë e sipër. Dhe në rast se industria, minierat ose ndonjë sektor tjetër, nuk shkon mirë, kjo rrjedh se kuadri duhet ndihmuar, pse është i dobët, ose s'ka gjetur vendin e tij, ose pse ka vepruar armiku në mënyrë të hapur apo të mbuluar. Nga një punë e shëndoshë do të dalë edhe një politikë e drejtë e kuadrove e një shpërndarje e drejtë e tyre. Nga një punë e tillë do të dalin dhe studime të veçanta për

masat që duhet të marrë Komiteti Qendror, Byroja ose Sekretariati për ngritjen e kuadrit, për edukimin e për specializimin e tij. Kështu mund të shohë udhëheqja, ku i dhemb dhe çfarë ilaçi duhet të përgatitë. Këto gjëra shoku Tuku nuk i ka parë drejt dhe nuk ka bërë përpjekje të thellohet dhe të përmirësojë punën e tij dhe të Partisë. Këto i janë vënë në dukje shumë herë Tuku, por puna ka ecur kurdoherë njësoj. Shtrembërohet vija në Drejtësi dhe në Prokurori, sinjalizimi vjen nga Ministria e Punëve të Brendshme; shtrembërohet vija në Tregëti, asnjë sinjalizim nga ana e Partisë. Ngjanë gjithë ato gjëra me punën armiqësore të Abedin Shehut, të Niazi Islamit, por nga organet e Komitetit Qendror, nga Tuku dhe nga drejtoritë e Komitetit Qendror, nuk patëm sinjalizime. Ngjet çështja e Nexhip Vinçanit ose e Hamit Keçit por nga burimet e Partisë dhe aparati i Komitetit Qendror, s'na jepen shumë gjëra. Atëhere vihet pyetja: Çfarë bëjnë drejtoritë e Komitetit Qendror, ç'kontroll i bëjnë zbatimit të vijës së Partisë, ku është vigjilenca revolucionare, ku është politika e drejtë e kuadrove, ku jemi me zbatimin e një sërë vendimesh të drejta që ka marrë Komiteti Qendror dhe Byroja Politike? Si mund të lejohet një gjendje e tillë?

Të vijmë te Drejtoria e organizimit. Problemet kyçe të jetës së organizatave të Partisë përqëndrohen atje. Por Tuku shumë pak është interesuar. Ai ka kujtuar dhe e ka pasë fjetur mendjen se atje ishte Liria. Kjo s'është as e drejtë as e lejueshme, pavarësisht se Liria është anëtare e Byrosë Politike. Tuku ka pasë përgjegjësinë kryesore. Por nuk mund të jetë vetëm ajo arësyeja që e ka shtyrë Tukan të mos interesohet për

këtë sektor kaq të rëndësishëm të Partisë ku lidhen si rreth strumbullarit shumë çështje. Atje pasqyrohet veprimtaria e Partisë me sukseset dhe të metat e saja, pasqyrohet vija e drejtë e Partisë, zbatimi në jetë i saj, gabimet dhe të-metat që shfaqen e që duhen spastruar shpejt. Nga sektori i organizimit ka mundësi të njihen cilësitë e komunistëve, vendosmëria e tyre, si shfaqet presioni i madh i armikut që përpiqet të dëmtojë Partinë e ta largojë atë nga jeta dhe veprimtaria revolucionare. Atje gjen të dhënat si ecën Partia përpara nga suksesi në sukses, si shtohen radhët e saja me elementë të klasës punëtore që rritet çdo ditë, si zhvillohet jeta e brendshme e Partisë, demokracia e saj e brendshme, kritika dhe autokritika. Si mundet shoku Tuk të mjaftohet vetëm me një autokritikë të lehtë, duke thënë se e kishte fjetur mendjen pse atje ishte shoqja Liri. Përkundrazi, në qëndrimin e shokut Tuk ndaj këtij problemi të madh të Partisë ka lëshime serioze në vijë, ka moskokëçarje të dëmshme, ka mungesë përpjekjesh për të mësuar nga Partia dhe për ta mësuar atë, ka thjeshtësisht oportunizëm, ashtu siç ka oportunizëm në vijën e kuadrit. Tuku përveçse nuk ka mbajtur si duhet nën drejtimin e tij drejtorët dhe drejtoritë, përveçse atyre nuk u ka caktuar dhe nuk u ka kontrolluar planet e punës së tyre, përveçse nuk ka kërkuar dhe nuk ka kontrolluar zbatimin e vendimeve, ai nuk është interesuar të studjojë as raportet e delegacionit të Partisë sonë që ishte në Bashkimin Sovjetik për të studjuar eksperiencën e Partisë Bolshevike, që është një ndihmë e madhe për gjithë punën e Partisë. Tuku është kënaqur me disa fletë përmbledhëse të gjithë kësaj

eksperience të madhe. Por s'mjafton me kaq. Kjo eksperiencë e Partisë Bolshevike, akoma nuk po shkon poshtë, te punëtorët e Partisë, që ata të përfitojnë e ta zbatojnë sipas kushteve tona. Kjo është e patolerueshme dhe një gabim shumë serioz që i shkakton dëme të mëdha Partisë. Tuku duhet të thellohet mirë në këto faje të tij të rënda.

Në marrëdhënjet me drejtorët si dhe me Lirinë, Tuku është kënaqur me informacionet e shkurtëra ose me raportet gojarisht të tyre për probleme kaq të mëdha. Ky është një lëshim dhe një gabim i palejueshëm. Jo vetëm që ai duhej t'i lexonte me vërejtje raportet, por edhe me këto raporte ai nuk duhej të mbetej i kënaqur e ta konsideronte të kryer detyrën. Ai duhej të nxirrte deduksione të vlefshme për Partinë, duhej të bënte hetime për një çështje ose për një tjetër që nuk i dukej e qartë dhe tok me shoqen Liri të lexonte deri dhe protokolle të organizatave bazë, vazhdimisht dhe me një plan të caktuar, sepse në ato protokolle pasqyrohet më mirë gjithë jeta e Partisë. Këtë punë Liria s'e ka bërë ashtu si duhej, kurse Tuku e ka neglizhuar fare. Atëhere si mund të dilet me konkluzione për Byronë ose Sekretariatit dhe këto të dalin me studime e propozime për Komitetin Qendror, kur çështjes së demokracisë së brendshme, për të cilën janë marrë vendime nga kongresi, nga Komiteti Qendror dhe nga Byroja, nuk i është kushtuar një kujdes i veçantë për ta studjuar këtë në gjithë Partinë? Si mund të dilet me konkluzione të studjuara në mënyrë marksiste-leniniste për çështjen e kritikës e të autokritikës, kur këtij problemi kaq të madh nuk i është kushtuar nga Tuku një punë e the-

lluar? Si mund të dilet me konkluzione dhe me masa për bolshevizimin e Partisë, për shtimin e radhëve të saja me elementë të klasës punëtore që do t'i japin hov Partisë, do t'i japin forcë dhe gjallëri, kur Tuku dhe Liria nuk po bëjnë studime të vazhdueshme e të thella, si rritet klasa punëtore, si futet ajo në Parti, si merr ajo drejtimin në udhëheqje të Partisë dhe të shtetit? Nga të gjitha këto studime Komiteti Qendror dhe Byroja do të mund të dilnin me masa dhe vendime më të mira që do të kishin një reperkusion të thellë në Parti. E thashë edhe më lart se Byroja Politike, Sekretariati dhe unë kemi përgjegjësi që nuk e kemi ndihmuar edhe më shumë shokun Tuk në këtë drejtim, megjithëse nuk mund të thuhet se i ka munguar ndihma dhe se nuk i janë hapur perspektiva në punë. Kjo nuk e lan Tukun nga përgjegjësia personale në kryerjen e detyrës dhe për mungesat serioze dhe përpjekjet e pakta nga ana e tij për ta kryer si duhej detyrën.

Në lidhje me organizatat e masave siç janë organizata e rinisë, e gruas, e bashkimeve profesionale dhe e Frontit, fare pak është preokupuar Tuku. Këto janë leva të rëndësishme të Partisë dhe në radhë të parë bashkimet profesionale dhe rinia. Në këto organizata ka përmirësime, po jo sa duhet. Rinia duhet të na preokupojë më tepër, pse në këtë sektor ka lëshime, ka sektarizëm, ka mungesa organizative. Me gjithë vërejtjet e shpeshta të Byrosë Politike për ta pasur më afër rininë, për ta ndihmuar më shumë, Tuku me zor e vuri një herë ujët në zjarr, bile dhe kur e morën në raport përpara Byrosë këtë problem, shokët e rinisë nuk ishin konkretë në raportimin e tyre. Një gjë analoge ngjet

edhe për organizatat e tjera të masave. Shoku Tuk, si përgjegjës kryesor për çështjet e Partisë në aparatën e Komitetit Qendror dhe në Byro as nuk ka shkuar në organizatat bazë, të shohë dhe të marrë eksperiencë nga Partia, të ndihmojë njerëzit vetë, të kontrollojë në jetë zbatimin e vendimeve. Shumë pak ka shkuar në komitetet e rretheve të jetojë me njerëzit, të fitojë eksperiencë për vete, të ndihmojë udhëheqësit me tërë eksperiencën e Partisë dhe t'u lehtësojë kështu punën shokëve në bazë, që luftojnë me njëmijë pengesa, me kaq vështirësi, që kanë mbi supe kaq shumë halle dhe që kurrë nuk dëshpërohen, por luftojnë dhe e nxjerrin punën në vijë. Më tepër se gjysmën e kohës Tuku duhej ta kalonte në bazë, me jetën e gjallë të Partisë, me komunistët nga çdo anë që ata janë. Këtë s'e ka bërë. Kjo natyrisht ka frenuar punën në aparatën e Komitetit Qendror, në Sekretariat dhe në Byro.

Tuku është i butë prej natyre, por komunistët e ndërrojnë natyrën dhe e gdhendin, farkëtohen në luftën e Partisë, e cila i ndreq komunistët, u spastron të metat dhe gabimet, i korrigjon nëpërmjet kritikës e autokritikës bolshevike, nëpërmjet rregullave dhe ligjeve të saj. Tuku ka bërë pak përparime në këtë drejtim dhe nga butësia e tij ka kaluar në qëndrime oportuniste ndaj vijës politike. Tuku nuk i jeton si duhet momentet e rëndësishme nga ku kalon Partia, vendi ynë, kampi i socializmit. Ai nuk e realizon si duhet luftën e ashpër të klasave që po zhvillohet, nuk e realizon si duhet presionin e armikut të jashtëm dhe të brendshëm kundër Partisë dhe pushtetit tonë popullor. Vigjilenca revolucionare për të mbrojtur Partinë nga rreziqet e

brendshme dhe të jashtme, për të mbrojtur pushtetin popullor, nuk është në lartësinë e duhur të Tuku dhe kjo është shumë e rrezikshme jo vetëm te një sekretar i Komitetit Qendror që drejton gjithë jetën e Partisë, por edhe te një komunist i thjeshtë, te një element pa parti dhe patriot. Në ka çështje që çdo orë dhe çdo minutë e ngre me forcë e gjithë Partia, kjo është çështja e vigjilencës së madhe, e luftës kundër armiqve të brendshëm dhe të jashtëm të Partisë, kundër imperializmit dhe agjentëve të tyre. Sa më shumë shkon Partia jonë përpara, sa më shumë ne korrim suksese në ndërtimin e socializmit dhe në mbrojtjen e vendit, aq më tepër imperializmi, titistët, monarko-fashistët, fashistët italianë dhe agjentët e spiunët e tyre brenda e egërsojnë luftën kundër Partisë dhe pushtetit tonë popullor. Tukat vazhdimisht i janë bërë kritika në këtë drejtim për të korigjuar butësinë e tij, qëndrimet jokorrekte ndaj vijës, të cilat, në fillim dhe me një të parë të shpejtë, mund të duken si të parëndësishme, por që për një anëtar të Byrosë Politike dhe sekretar të Komitetit Qendror janë të palejueshme. Tukat nuk i kanë shërbyer këto vërejtje dhe kritika shoqërore dhe nuk është korigjuar nga këto të meta serioze, bile ai ka shkuar edhe më tej. Një sërë ndodhirash, që nuk mund të merren në asnjë mënyrë të shkëputura nga qëndrimi i tij ndaj punës dhe detyrave që i ishin ngarkuar, e kanë çuar Tukan në pikëpamje oportuniste dhe në fërkime serioze me vijën e Partisë. Tuku duhet të ndihmohet seriozisht t'i spastrojë këto pikëpamje sa më parë, të jetë vigjilent se këto pikëpamje e largojnë nga rruga e Partisë.

Tuku dëshiron të jetë popullor, por përpara armikut të klasës, s'ka pse të jesh popullor; ai nuk është i ashpër, përkundrazi ai bën lëshime. Të jesh popullor dhe i butë ndaj armikut të klasës, të Partisë dhe të socializmit, është gabimi më i madh që mund të bëhet. Po të jesh i tillë, e çarmatose Partinë, i ke bërë asaj dëmin më të madh. Me qenë i thjeshtë, popullor, i dashur me njerëzit e Partisë, me popullin, duhet të jetë vetia e parë jo vetëm e sekretarit të Komitetit Qendror, por e komunistit më të thjeshtë. Kjo s'vihet në diskutim, kështu na mëson të jemi Partia jonë, Partia Bolshevike dhe shoku Stalin. Por gabimi i Tukat është se ai s'bën asnjë dallim në mes të anëtarit të Partisë dhe të një elementi që s'është në rregull me Partinë, të një të përjashtuari nga Partia, të një të dënuari nga gjyqet e popullit, të një armiku të Partisë. Të gjithë i pret njësoj, të gjithëve u thotë fjalën e mirë, të gjithë i ndihmon. Kjo është e palejueshme dhe e dënueshme. Kushdo dëshiron të takohet me shokë udhëheqës, edhe armiqtë bëjnë shumë tentativa të takohen me udhëheqësit, sigurisht me qëllime të tjera, për të parë pulsën, për të parë nëse qëndron ndonjë e çarë gjëkund për të futur spicën dhe helmin ose për ndonjë qëllim tjetër. Tuku as i vëren me kujdes këto gjëra. Këtë e them ta ketë parasysh jo vetëm Tuku, por edhe shokë të tjerë, të cilët duhet të jenë vigjilentë ndaj përpjekjeve të pareshtura që bën armiku për të çarë unitetin e Partisë ose për të njollosur a kërcënuar jetën e shokëve tanë.

Pas kongresit dhe pas zbulimit të punës armiqtësore të trockistëve jugosllavë dhe të Koçi Xoxes, të mirë e të ligj, sulmuan me kërkesa Partinë. Kjo ishte e natyr-

shme. Por kongresi na e dha vijën si duhej të vepronim në këtë drejtim. Kjo ishte e çartë për Tukul dhe për të gjithë. Në Kolegjumin e Komitetit Qendror¹ shqyrtoheshin lutjet dhe Tuku me një lehtësi të madhe dhe pa konsultime paraprake me shokët e tjerë të Sekretariatit, e lëshoi dorën dhe një numër njerëzish, që nuk e meritonin të riktheheshin në Parti, u futën. Kur në mungesë të Tukul u desh ta zëvendësonte Mehmeti, ky i pa lëshimet që po bëheshin dhe na njoftoi për këtë praktikë të dëmshme për Partinë. Kjo ka qenë një pikëpamje e rrezikshme oportuniste ndaj Partisë dhe ndaj kuadrit. Me qenë hatër paprishur ndaj njerezëve me të kaluar dhe veprimtari të dyshimtë, në çdo moment, por sidomos në ato momente krize nga ku kalonte Partia, do të thoshte me e dëmtue rëndë Partinë. Kjo duhej të ishte një mësim i madh për Tukul. Mjerisht kjo nuk u bë mësim për të. Një sërë çështjesh të këtij karakteri vazhduan të ngjajnë në punën e Tukul, që në praktikë e vinin atë në fërkim me vijën politike dhe organizative të Partisë.

Pas gjithë kritikave dhe shkarkimit që i bëme Niazi Islami, si nënministër i komunikacioneve, dhe megjithëse Niazi Islami nuk i pranoi, po kundërshtoi kritikën e Byrosë, Tuku pa e shtruar dhe pa marrë fare aprovimin e Byrosë, e emëroi Niazinë në postin e drejtorit të Drejtorisë së industrisë në aparatën e Komitetit Qendror.

¹ U krijua pas Kongresit I të Partisë për të shqyrtuar ankesat dhe kërkesat e komunistëve, vendimet e të cilit i aprovonte Sekretariati i KQ të PPSH.

Nga ana tjetër shohim të përkrahë V. Sh., që vetë pohoi se ishte rekrutuar agjent prej jugosllavëve. Turlinjerëzish kalonin me lehtësi në zyrën e Tukut dhe në shtëpinë e tij për të kërkuar ndërhyrjen e ndihmën e tij. Dhe Tuku ndërhynte.

Ndërhyrjet e Tukut pranë Armës së Sigurimit kanë qenë në një sërë rastesh dhe të atilla, që tregojnë mungesën e palejueshme të vigjilencës dhe mosvlerësimin e armikut.

Tuku ndërhyr për lirimin e tre elementëve armiq në burgun e Shkodrës, ndërhyr për lirimin nga burgu të një prifti nga Durrësi, për lirimin nga ushtria të një prifti armik, për lirimin nga burgu të një armiku, i cili porsa doli nga burgu u arratis bashkë me të jatin dhe dy të tjerë. Kjo u bë pasi i ati i këtij të burgosuri i shkoi dhe u prit në shtëpi prej Tukut. Ai pret në shtëpi një kulak, i cili i «qan hallin» dhe Tuku e beson se çfarë i thotë ai, duke akuzuar një oficer të Sigurimit të Shtetit në degën e Krujës. Tuku pret në shtëpi pa menduar aspak njerëz dallaveraxhinj që arrijnë t'i thonë si me shaka: «edhe sa ditë do të qëndroni në fuqi?» Ai pret me lehtësi të madhe Kadri Hoxhën me të cilin, me të dalë nga burgu, bisedon me të, sikur Kadri Hoxha është krejtësisht i rehabilituar nga Partia. Ai u suall butë dhe me shpirtgjerësi, kur u takua në burg me Hamit Keçin. Qëndrimi i Tukut ka qenë kurdoherë i butë dhe i papërcaktuar si duhet ndaj Dali Ndreut, kur ky ka vajtur për punën e tij, pasi u hoq nga Ministria e Industrisë e të tjera qëndrime, që Tuku do t'i përmendë vetë në autokritikën e tij. Ai as nuk thellohej në këto demarshe, as i kontrollonte më parë

thënjet e tyre, as nuk informohej më parë për të kaluarën e këtyre njerëzve, ose për arësyet që i shtynin këta të vinin te Tuku dhe jo drejtpërdrejt te ata shokë, që kishin po ato përgjegjësi si dhe Tuku dhe që ishin më të lidhur me çështjet që ata kërkonin t'ua rregullonte Tuku. Mjaft nga këta njerëz kanë qenë dallaveraxhinj, hipokritë, armiq. Pse shkonin këta njerëz te Tuku dhe nuk shkonin te shokët e tjerë udhëheqës? Sepse atje e gjenin portën të hapët, pse atje priteshin me lehtësi. Te Tuku kishin shpresa se do t'ua plotësonte qëllimet. Ata shihnin mirë se Tuku nuk ishte i ashpër në zbatimin e vijës së Partisë, prandaj vinin. Në fakt, kjo ishte arësyeja dhe këta njerëz nuk gabonin, po Tuku gabonte që nuk bënte përpjekje që të korigjohet nga kjo e metë e madhe, po i quante si gjëra të lehta, të mundshme, të domosdoshme në sjelljet dhe në qëndrimet e një udhëheqësi. Kjo pikëpamje e çonte Tukun në gabime edhe më të rënda.

Është çështja në lidhje me klerin katolik të Shkodrës. S'është nevoja të bëj historikun e klerit të këtij qyteti, të punës armiqësore të tij dhe qëndrimin e drejtë të Partisë sonë. Ashtu si e merituan, ua dhamë grushtin. Tani duhet që kleri katolik të rregullojë situatën e tij dhe të kishës në përputhje me ligjet e shtetit. Për këtë gjë ata bënë demarshet e tyre përpara qeverisë. Priftërinjtë kërkojnë t'i shpëtojnë ligjit të shtetit tonë që rregullon marrëdhënjet në mes të shtetit dhe të komuniteteve fetare, ata kërkojnë të ruajnë pavarësinë e tyre, të mos kenë asnjë përgjegjësi ndaj pushtetit popullor, të jenë një shtet në shtet me ligjet dhe zakonet e tyre mesjetare kundër popullit dhe të

ruajnë lidhjet me Vatikanin, agjenturë e imperializmit dhe armik shekullor i vendit tonë. S'ka asnjë dyshim se ata s'ja hedhin dot Partisë sonë. Për Tjukan duhej të qe e qartë vija e Partisë. Tuku u ngarkua herën e parë të bisedonte me cilësinë e nënkryeministrit, pas takimeve që priftërinjtë patën me sekretarin e Partisë të Shkodrës. Është këshilluar Tuku prej meje që të ecte me kujdes dhe me vigjilencë të madhe, pse pastaj do të vinin veprimet e mëvonshme njëra pas tjetrës. Kjo fazë kaloi pa ndonjë gabim. Me caktimin e Mehmetit si nënkryeministër dhe ministër i punëve të brendshme, çështjen e mori ai në dorë meqenëse kjo punë i përkiste atij. Vazhduan kështu një sërë takime pas takimesh. Priftërinjtë paraqitën statutin e tyre të poshtë, ne përsëri s'ua pranuan; kërkuan sugjerimet e qeverisë dhe ne u dhamë një projektstatut si e mendonim ne. Statuti ynë i ri dhe puna e Partisë në rrethin e Shkodrës, të Lezhës e gjetkë, ku ka priftërinj katolikë, krijoi një ndarje midis klerikëve: një pjesë pro statutit tonë dhe që përbëhej nga kleri i ulët i fshatrave dhe një pjesë kundër statutit tonë i përbërë nga kleri i lartë me në krye një farë Marin Serdani, i cili është armiku ynë më i egër në gjirin e priftërinjve katolikë. Ky mbante bajrakun e reaksionit më të zi. U provokua mbledhja e priftërinjve dhe prapë u shkaktua një çarje në mes të tyre, kjo qe një sukses i madh për ne. Ata u detyruan të pranonin statutin tonë, me përjashtim të disa klerikëve reaksionarë, të cilët nuk pranuan që kisha të mos ketë lidhje me Vatikanin nëpërmjet formave që i caktonte statuti ynë, por u përmbaheshin pikëpamjeve të tyre. Çështjet kanë mbetur pezull, pse ne po e studjojmë akoma këtë

punë. Patjetër një situatë e tillë i ka shqetësuar priftërinjtë, sidomos pjesën reaksionare, ndaj së cilës qëndrimi ynë është i vendosur dhe i ashpër. Tuku ka qenë në dijeni të plotë të të gjitha këtyre ngjarjeve, por ai ka vepruar në kundërshtim me vijën e caktuar nga Partia.

I famshmi prift Mariq Serdani për të matur pulsën dhe për të hetuar terrenin, ngrihet dhe troket në derë të shtëpisë së Tukat. Tuku, në vend që t'ja mbyllë derën, përkundrazi, e pret, bisedon me të dhe më në fund pas kërkesës së tij, pse gjoja kishte ngelë pa parë për t'u kthyer në Shkodër, i kërkon ndihmë Tukat. Tuku i thotë: «kur të rregulloni situatën me qeverinë, atëhere do të keni ndihma, por tani po të jap unë nga xhepi im 1 000 lekë».

Një veprim i tillë i Tukat, që e ka burimin jo më në butësinë, por në pikëpamjet e tija oportuniste ndaj vijës dhe qëndrimit të Partisë, është shumë i rëndë dhe i dënueshëm. Këto pikëpamje e vënë Tukan në kundërshtim me vijën e Partisë. Në asnjë mënyrë nuk mund t'i lejohet të sillet në një mënyrë të tillë ndaj vijës së Partisë, jo vetëm një sekretari të Komitetit Qendror por asnjë komunisti të thjeshtë. As filantropi, as mëshirë nuk ka për armiqtë e Partisë dhe të popullit. Tuku nuk duhet të kënaqet duke thënë se nuk ja preu, kur e bëri këtë gjë, ose kur kujtoi se «bënte politikë të lartë»; ai duhet ta thellojë këtë çështje. Tuku nuk ka qenë i bindur në vetëvete për qëndrimin e drejtë që kemi mbajtur ndaj kishës dhe priftërinjve katolikë. Tuku s'i dha fare rëndësi gjestit të tij, pse ai gjest s'ishte në fakt në kundërshtim me pikëpamjet e Tukat, por pikëpam-

jet e Tukut ishin në kundërshtim me vijën e Partisë dhe gjesti ishte vetëm një manifestim i pikëpamjeve të tija.

Këto veprime të Tukut, të kësaj natyre, tregojnë se te ai po kristalizohej një vijë e tillë oportuniste. Unë do të ndalem në një rën nga këto më të rëndësishmet.

Është çështja e Niazi Islamit, të cilën e kemi jetuar të gjithë, e kemi analizuar dhe kemi marrë vendime të qarta dhe të drejta. Në mbrëmjen që kishin mbaruar punimet e plenumit mbi dënimin e grupit antiparti të Abedin Shehut, të Niazi Islamit dhe të Shyqri Këllezit, na lajmëruan se Niazi Islami vrau veten. Vetëvrasja e Niazi Islamit vërtetoi edhe më tepër punën armiqësore të tij, të cilën e kishte analizuar atëherë Plenumi i Komitetit Qendror. Për të gjithë që e qartë se Niazi Islami vrau veten, pse ishte armik i Partisë. Tuku që atë natë shfaqti mendimin se «Niazi Islami vrau veten nga kokëfortësia, nga megalomania, nga inati». Kjo pikëpamje ju kundërshtua. Pas vetëvrasjes së Niazi Islamit, u mblodh përsëri Plenumi i Komitetit Qendror dhe e cilësoi veprën e Niazi Islamit dhe vetëvrasjen e tij ashtu sikundër ishin: «Niazi Islami vrau veten si armik i Partisë». Kjo doli dhe në rezolucion. Gjithë Komiteti Qendror ishte i një mendjeje, Tuku gjithashtu. Por në realitet Tuku nuk ka qenë i solidarizuar në këtë çështje. Kur Byroja Politike bëri këtë analizë, që po shtrojmë përpara plenumit dhe u kritikua Tuku për gabimet e tij oportuniste, ju përmend edhe pikëpamja e tij e dikurshme e shfaqur në lidhje me vetëvrasjen e Niazi Islamit, në mbrëmjen që u mësua vetëvrasja e këtij armiku. Ju vu qartë në dukje Tukut që edhe ajo pikëpamje e shfaqur që atëherë, s'është gjë tjetër veçse

një pikëpamje tjetër oportuniste e tij në vijën e Partisë. Në autokritikën e tij, që bëri përpara Byrosë Politike, ai tha se «deri tani që thoni se janë zbuluar disa fakte që provojnë se ai ka qenë agjent titist, unë kam pasur mendimin se ai e ka vrarë veten nga kokëfortësia, nga inati, por jo se unë nuk isha solidar me vendimet e Komitetit Qendror». U diskutua kjo çështje në Byro: ishte solidar apo s'ishte solidar Tuku me vendimet e Komitetit Qendror; mua dhe disa shokëve të tjerë të Byrosë, në këtë pikë, na dukej e çuditshme që Tuku të kishte rënë në opozicion me vijën e Partisë në këtë çështje parimore, kur e gjithë Partia ishte e bindur se Niazi Islami e vrau veten si armik i Partisë. Na u desh të bënim edhe një mbledhje tjetër të Byrosë, ku Tuku bëri një autokritikë më të avancuar dhe doli qartë se me të vërtetë Tuku ka qenë në kundërshtim me vijën e Partisë. Vetë fakti që Komiteti Qendror dhe gjithë Partia ishin të bindur se Niazi Islami vrau veten si armik i Partisë, tregon se Tuku ka menduar në heshtje të kundërtën. Pikëpamjet e tija oportuniste në vijë e kishin vënë, në realitet, Tukan në kundërshtim me vendimin e Komitetit Qendror.

Të gjitha këto gabime të Tukat, vënë në dukje shumë të meta që ekzistojnë te ai si komunist dhe si udhëheqës. Te Tuku nuk ekziston sa duhet nuhatja dhe vigjilenca revolucionare e klasës dhe e Partisë. Presioni i borgjezisë gjen lehtësisht terren te ai dhe e bën atë të ketë lëkundje serioze në kuptimin dhe në zbatimin drejt dhe pa kompromis të vijës së Partisë. Zhdanovi thotë:

«Burimi i forcës së partisë sonë, burimi i fitoreve të saja qëndron në faktin se ajo është një parti e tipit të ri,

e tipit leninist-stalinian, një parti e papajtueshme me oportunistët dhe me gjithë armiqtë e klasës punëtore»¹.

Tuku nuk e ka kuptuar si duhet dhe nuk e ka pasë zbatuar si duhet armën e kritikës dhe të autokritikës dhe fakti është se shumë herë ai është i ashpër, kur s'duhet, dhe i butë, kur duhet të jetë i ashpër. Atij i janë bërë kritika për punën e tij, të cilat i ka pranuar, por ai i ka përsëritur gabimet. Kjo tregon se autokritika e tij ka qenë e përciptë dhe kritikës nga shokët s'i ka dhënë shumë rëndësi. Tuku është i përciptë në mendime, nuk bën përpjekje të mëdha t'i studjojë problemet dhe të thellohet në to për të gjetur zgjidhjen e vërtetë. Tuku është i javashëm në punë dhe në mendime, i mungon operativiteti dhe s'bën përpjekje të mësojë marksizëm-leninizmin. Për këto të meta shoku Tuk duhet të bëjë përpjekje të mëdha që t'i zhdukë sa më parë.

Të gjitha këto gabime të shokut Tuk janë serioze dhe ai i njohu dhe i pranoi. Ai u përpoq dhe bëri autokritikë dy herë rresht dhe sigurisht ka pasur një përmirësim në autokritikën e tij. Këto gabime të Tukut nuk janë të rastit dhe të shkëputura, por janë vazhde në punën e tij. Prandaj u këshillua nga Byroja Politike që të thellohej më shumë, t'i analizonte më thellë gabimet e tij dhe të dilte përpara plenumit me një autokritikë të hapët, bolshevike, pse vetëm me këtë mënyrë ai do të korrigohej përgjithmonë. Shoku Tuk i premtoi Byrosë se do t'i korrigojë këto gabime dhe do të bëjë autokritikë përpara Plenumit të Komitetit Qendror.

¹ A. A. Zhdanov. Raport në Kongresin XVIII të PK (b) të BS. «Pravda» Nr. 78 (7763), 20 mars 1939.

Duke gjykuar gabimet oportuniste në vijën politike dhe organizative të shokut Tuk, duke marrë parasysh gjithnjë punën e tij të dobët në kryerjen e detyrës që i ishte ngarkuar si sekretar i Komitetit Qendror dhe në drejtimin e drejtorive nga më kryesoret të Komitetit Qendror, duke gjykuar se vazhdimi i tij në ato funksione bëhet pengesë për shkuarjen e punës përpara, Byroja Politike vendosi për të gjitha këto t'i propozojë Komitetit Qendror që shoku Tuk Jakova të shkarkohet nga funksionet e tij si sekretar i Komitetit Qendror dhe të largohet nga drejtimi i organeve qendrore të KQ. Byroja Politike mendon se shoku Tuk, duke qëndruar anëtar i Byrosë Politike¹ dhe nënkryeministër, të ngarkohet me disa sektorë të aktivitetit qeveritar si pjesëtar i Kryesisë së Këshillit të Ministrave. Byroja Politike shpreson, duke pasur parasysh dhe të kaluarën e tij, se ai do t'i ndreqë gabimet e tij dhe do të bëjë përpjekje më shumë për t'i kryer detyrat e rënda që atij do t'i ngarkohen dhe Komiteti Qendror, Byroja Politike dhe qeveria s'do të kursejnë asnjë ndihmë që të ecë përpara. Byroja Politike i rekomandon shokut Tuk, veçanërisht, të jetë vigjilent që të mos i përsërisë më gabimet e tij dhe të bëjë përpjekje të ngrihet ideologjikisht duke studjuar marksizëm-leninizmin, duke studjuar Leninin dhe Stalinin.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

¹ Plenumi e përjashtoi edhe nga Byroja Politike.

**KONKLUZIONE MBI DISKUTIMET
QË U ZHVILLUAN RRETH RAPORTIT
«MBI GABIMET DHE TË METAT E TUK JAKOVËS»**

23 shkurt 1951

Diskutimet e shokëve në këtë plenum kanë qenë në lartësinë e duhur. Plenumi analizoi gjithë këtë situatë të sëmurë që ka ekzistuar në udhëheqjen e Partisë që nga Byroja Politike e deri në Sekretariat. Këtu u fol edhe për reflekset e kësaj situatë në gjithë Partinë. Çështjet u analizuan më së miri dhe konkluzionet e plenumit dhe të të gjithë shokëve janë shpëtimtare për Partinë tonë. Çështja është që këtë frymë luftarake revolucionare, që u shfaq në këtë plenum, duhet ta çojmë poshtë. Kjo është e domosdoshme edhe urgjente, por nuk duhet të bëhet në mënyrë formale, po në mënyrë të tillë, që të ngremë peshë të gjithë Partinë për t'i zhdukur deri në fund ato të meta, që ekzistojnë edhe poshtë. Ndryshe do të jetë e zorshme që ne të përballojmë rrethimin kapitalist, të fitojmë mbi luftënxitësit dhe të ndërtojmë socializmin.

Është me të vërtetë një moment nga më të rëndësishmit për Partinë tonë ky plenum dhe këtë e thanë edhe shokët e tjerë që diskutuan. Këtu nuk është çështje

krize, pse te ne nuk ka krizë, po ka shokë që nuk kanë qenë dakord me vijën e Partisë dhe mosqenja dakord me vijën e Partisë në mënyrë të hapët ose të heshtur, natyrisht, e dëmton Partinë, prandaj në asnjë mënyrë nuk duhet të lejohet, po të luftohet ashpër kundër këtyre gabimeve të rënda. Ne nuk duhet të influencohemi se ç'do të thotë njëri apo tjetri. Njerëzit e Partisë e në radhë të parë komunistët, që e duan Partinë dhe popullin, rezultatet e këtij plenumi patjetër do t'i mirëpresin, sepse ata kështu do të armatosen për ta ngritur Partinë edhe më lart në rrugën e saj të bolshevizimit. Vendimet e këtij plenumi edhe masat e popullit do t'i mirëpresin dhe do t'i mbështetin, sepse ato i shohin dëmet që i kanë sjellë këto dobësi e të meta që kanë ekzistuar. Populli i ka ndjerë në kurriz dhe tani do të shohë konkretisht se si Partia është vigjilente, si godit me ashpërsi cilindo qoftë kur nuk ecën në rrugën e drejtë të Partisë. Prandaj këto analiza e vendime do të bëjnë pjesë në arsenalin e luftës sonë për të ecur përpara. Kjo nuk e dobëson shpirtin revolucionar të komunistëve dhe nuk i largon ata nga masat e popullit ku mbështetet Partia. Më përpara Koçi Xoxe njihej ndryshe, po kur Partia e zbuloi punën e tij armiqësore, u ngritën në këmbë të gjitha masat dhe përkrahën Partinë, ashtu si në kohën e Luftës nac.-çl. sepse e donin dhe e ndjenin me zemër. Prandaj nuk duhet të trembemi nga zbulimi i të metave e i gabimeve, megjithëse armiku do t'i përdorë për të na luftuar. Por ne nuk kemi frikë nga masa të tilla që e forcojnë Partinë; frikë duhet të kemi kur Partinë e kemi të dobët, pse atëhere ka mundësi të na dëmtojë armiku më lehtë dhe propaganda e tij të zërë vend më

mirë. Këto çështje, pra, duhet të revolucionarizojnë Partinë, që do t'ua thyejë qafën armiqve dhe gjithë atyre që krijojnë dyshime rreth Partisë sonë.

Nxjerrja në shesh e këtyre gabimeve është në rrugë të drejtë të Partisë, pse kështu luftohet oportunizmi, që për fat të keq është shfaqur herë pas here në Partinë tonë. Por çështja është se, kur hiqen dy-tri vetë nga Komiteti Qendror, nuk duhet të mendohet se dobësohet Partia. Nuk është kështu, Partia do të forcohet më shumë dhe do ta njohë rrezikun e madh të oportunizmit. Çështja e Sejfulla Malëshovës, që u shqyrtua në Parti për një kohë të gjatë, ishte shumë e rrezikshme, sepse ajo rrezikonte forcimin e diktaturës sonë. Po t'i shohim thellë problemet, siç u tha këtu, fajet dhe gabimet e Tukurit në praktikë u ngjasin pikëpamjeve të Sejfulla Malëshovës dhe veprimeve të tij. Nuk është nevoja të zgjatemi e t'i përsëritim çështjet, po edhe fajet e Tukurit kanë po atë ngjyrë. Tuku gjatë kohës së luftës është hequr zvarrë. Gabimet e Tukurit ilustrohen dhe nga situata. Ai nuk e kishte kuptuar mirë oportunitetin e Sejfulla Malëshovës. Dhe përse i përket çështjes së Mukjes për herë të parë dëgjoj që Tuku nuk ka qenë i qartë. Ky është një gabim jashtëzakonisht i rëndë për të, pse ka qenë në kundërshtim me vijën e Partisë dhe jo për një vit, po për më shumë se 7 vjet. Por ajo që ka më shumë rëndësi në këtë mes është se Tuku nuk e ka shprehur këtë pikëpamje më përpara, po e ka mbajtur të mbuluar. Të gjitha këto gabime të Tukurit, Komiteti Qendror i ka analizuar dhe ky plenum na ka ndihmuar jashtëzakonisht, sepse fajet që ju vunë në dukje Tukurit, janë shumë të rënda dhe kanë përsë-

ritur një situatë jashtëzakonisht të vështirë në Byronë Politike. Pikëpamjet e Tukul janë në kundërshtim me vijën e Partisë. Ajo më e keqja është se këto shfaqje të sëmura dhe gabime të mëdha në Partinë tonë i kemi zbuluar me ngadalësi. Sidoqoftë i kemi zbuluar, po ajo që ka mjaft rëndësi, është çështja se sado që presioni i armikut mbi Partinë tonë është shtuar, nuk ka dhënë rezultate. Ne kemi ngritur çështjen e Lushnjës¹ që ishte një paralajmërim për Partinë për të luftuar presionin e armikut. Letra e Komitetit Qendror u punua në gjithë Partinë, po në vend që të kishim një përparim në këtë çështje, përkundrazi, si duket, disa shokë nuk u thelluan sa duhet. Pra, mund të themi se letra që ngre çështjen e Lushnjës nuk e ka bërë efektin që duhej.

Tuku duhet ta kuptojë mirë këtë situatë që u krijua në Parti dhe në udhëheqje të saj, pse, si e tillë, ne kemi përgjegjësi të rëndë që këtë çështje nuk e diktuam dhe ta ndreqnim me kohë në mënyrë bolshevike. Por do të ishte gabim të thoshnim se kemi qenë në gjumë për këto situata, pse ne i kemi pasur parasysh, kemi bërë dhe disa autokritika, po ato nuk kanë qenë të mjaftueshme dhe të ashpra.

Armiqtë luftojnë Partinë dhe njerëzit tanë herë pas here flenë. Si mund, atëhere, ta zhvillojmë luftën e klasës dhe t'i bëjmë ballë presionit të madh kapitalist? Në këtë luftë, po nuk pastruam Partinë nga elementët armiq dhe të forcojmë të lëkundshmit për vijën e Partisë, puna nuk mund të vejë mirë. Tuku ka bërë gabime të rënda në këtë drejtim dhe pikëpamjet e tija në vijën

¹ Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 6, f. 217.

politike dhe organizative kanë qenë të errëta. Tuku ka qenë në pozita shumë të dobëta dhe po të mos ishte dora e Partisë, ai do të kishte rënë me kohë në llum. Ne kemi folur kurdoherë për luftën e klasave, po tani jemi më shumë të ndërgjegjshëm se më parë, pse gabimet që analizojmë na kanë vënë përpara fakteve të hidhura. Kështu si deri tani nuk mund të bëhet lufta e klasës. Kjo për Tukur ka qenë shumë e turbullt, për të mos thënë se për të pothuaj s'ekzistonte fara. Tuku nuk ka bërë luftë klase dhe s'ka luftuar kundër armikut e presionit të tij. Gjithë sa dolën këtu e vërtetojnë këtë gabim dhe Tuku duhet të reflektojë rreth tij. Ne e njohim Tukur dhe, megjithëse thotë se i kupton këto çështje, kemi frikë se mos i përsëritë këto gabime. Ne do ta ndihmojmë, po ai duhet të ndihmojë më parë veten e tij dhe të realizojë mirë gabimet. Kam frikë se pasi ai ta kalojë këtë presion të madh që do të krijojë një lëvizje të thellë në Partinë tonë, analizë që duhet të na preokupojë të gjithëve, do të zbutet kujdesi i Tukut e do të bjerë përsëri në rutinë. Te Tuku duhet të vazhdojë kurdoherë për një kohë të gjatë ky preokupacion, se te ai, bile dhe në disa shokë të tjerë, kam vënë re që, kur bëjmë një kritikë dhe vendosim mbi çështjen, në atë kohë janë dakord, por më vonë sheh lëkundje për vendimin që është marrë më parë, dhe Tuku si pa gjë të keqe vjen e të thotë: «si do ta bëjmë këtë çështje» etj. Në këtë drejtim ai duhet të ketë shumë kujdes. Ne themi për shembull se ky ose ai shok ka gabim për një çështje, në atë kohë me atë mendim është dakord dhe Tuku, por më vonë, ky thotë të kundërtën. Kjo lëkundje ekziston në karakterin e

Tukut, prandaj kanë shumë të drejtë shokët kur thonë se Tuku duhet të bëjë një autokritikë më të gjerë e më të thellë, për çdo gjë dhe për çdo kritikë të drejtë që ju bë këtu. Ai duhet të thellohet më shumë në kritikën që ju bë nga shoku Pilo Peristeri, që ishte kritika e një punëtori të vjetër komunist, që ishte një kritikë konsekuente, kritikë e një shoku që i sheh thellë problemet. Me propozimin që bëri Pilua për përjashtimin nga Komiteti Qendror unë nuk jam dakord, pse ishte një propozim i avancuar, po me kritikën e tij jam plotësisht dakord. Pra, kështu duhet t'i shohë çështjet Tuku.

Edhe çështja e pritjes së priftit reaksionar në shtëpi, që u ngrit dhe u analizua këtu, nuk është një gjë e shkëputur. Këtë ja shpjegua dhe në Byro, kur e thirrëm, po për këtë ai u shpreh «ç'm'u desh mua që ta prisja». Po ai do ta priste njëmijë herë priftin, sepse në ato pozita ishte. Prandaj Tuku duhet të thellohet mirë dhe të kuptojë se në lidhje me kishën katolike ai nuk ishte dakord me vijën e Partisë. Të mos jesh dakord me vijën e Partisë për politikën ndaj Vatikanit, ndaj kishës katolike që është agjunkturë e tij dhe që e ka dëmtuar jashtëzakonisht popullin tonë, kjo është shumë e rëndë jo vetëm për një udhëheqës, po bile dhe për një komunist të thjeshtë. Kështu devijon nga parimi që ka vendosur Byroja Politike. Si komunistë, ne jemi armiqtë më të egër të fesë, jemi antifetarë. Prandaj Partia bën një luftë të ashpër kundër klerikëve reaksionarë, kurse ndaj besimtarëve ecën me kujdes. Por ne kurrë nuk duhet ta zbutim luftën kundër krerëve të klerit, që janë kundër Partisë dhe pushtetit tonë.

Ata nuk duhet t'i harrojmë asnjëherë dhe atyre që veprojnë si armiq, t'u hedhim dorën në zverk, ndërsa ndaj atyre që nuk bëjnë gjë, të veprojmë me takt, por të mos harrojmë kurrë se ata nuk bëhen miq me Partinë. Kurse njerëzit e popullit, qofshin dhe besimtarë, janë miq të Partisë, prandaj Partia do të punojë dalëngadalë dhe me bindje, derisa t'ua shkulë besimin ndaj zotit, kishës e fesë. Tuku gënjehet në bindjen e tij që shumë nga priftërinjtë katolikë gjoja mbajnë qëndrim të mirë e i duken si miq. Ai s'e kupton se këtë gjë ata nuk e bëjnë nga dashuria për Partinë, pse me këtë janë të papajtueshëm, po e bëjnë për oportunitet derisa të gjejnë kohën dhe t'i futin thikën pas shpine. Këtë duhet ta kuptojë mirë Tuku, se me pikëpamjet e tija, duke qenë sekretar për kuadrot dhe drejtues i çështjeve organizative, e ka dëmtuar Partinë.

Mosvajtja poshtë në bazë nuk është një gjë e thjeshtë. Sekretari për kuadrot duhet ta njohë Partinë fill e për pé, kurse ai e ka neglizhuar këtë. Ka dashur Tuku të dobësohej Partia? Veprimtaria e tij atje të çon. Këto gabime ai nuk duhet t'i quante aq të thjeshta e të thotë: «ja, i bëmë dhe do të korrigjohemi». Mund të korrigjohet gabimi, po të kuptohet thellësisht dëmi që ka sjellë ai.

Në këto momente mendoj se duhet ta forcojmë edhe më tepër luftën kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm të Partisë. Kjo duhet të bëhet një preokupacion i madh, për të qenë të pamëshirshëm e të mos hezitohet kundër armikut. Armiku është armik, prandaj të goditet në minutë, pse po ta lësh të veprojë, qoftë edhe pak, ai do të të dëmtojë patjetër. Prandaj

armiku nuk duhet të lihet të veprojë as brenda dhe as jashtë Partisë. Kështu ne duhet të bëjmë një kthesë të madhe në punën tonë të përditshme të Partisë dhe të pushtetit, të jemi vigjilentë, rigorozë e të ashpër për ruajtjen e vijës së Partisë. Në fakt gabimet e Tukat janë një shtrembërim i vijës së Partisë, ashtu siç janë dhe gabimet e Manolit e të Theodorit. Edhe ne kemi bërë lëshime e gabime, nuk kemi qenë në gjendje që t'i kapim shpejt shfaqjet e sëmurës, t'i zbulonim e t'i godisnim ashpër gabimet dhe sa më parë. Gabimet e Tukat duhet të na bëhen mësim. Ne do t'i korrigjojmë këto gabime dhe do të ecim përpara në rrugën e Partisë. Kështu na mëson Partia.

Ne, në udhëheqje, marrim çështje në diskutim dhe nuk i zgjidhim deri në fund, pastaj kthehemi e rikthehemi dhe kështu vazhdojmë. Kjo tregon se duhet të punojmë dhe të mësojmë akoma më shumë. Ky plenum ka qenë një shkollë e madhe për ne. Tuku ka bërë faje shumë të rënda, të cilat e kanë dëmtuar Partinë jashtëzakonisht. Ai duhet të ndërrojë konceptin që ka për Partinë dhe të kuptojë mirë se si duhet ta dojë Partinë, d.m.th. të korrigjojë të gjitha pikëpamjet e tija të gabuara e të rrezikshme që ka pasur dhe t'i vihet punës konkretisht. Autokritika e tij do të na bindë se i ka kuptuar thellësisht gabimet, kur ajo të vihet plotësisht në rrugë e në zbatimin praktik të vijës së Partisë. Ne duhet t'i japim gjithë përkrahjen për të ecur me Partinë, po kjo do të varet së pari nga ai.

Përsa i përket Manolit e Theodorit jam plotësisht i bindur se që të dy këta kanë kapitulluar me tërë kuptimin e fjalës përpara detyrave që u ka vënë Partia.

Autokritika e tyre jo vetëm që s'është në lartësinë e duhur të një anëtari të Komitetit Qendror, po as të një anëtari të thjeshtë të Partisë. Asnjërit prej shokëve nuk mund t'i mbushet mendja përsa thanë ata. Veprimtaria e tyre dhe mungesa e autokritikës tregojnë se ata nuk janë dakord me vijën e Partisë. Pse ka kërkuar Manoli të largohet nga detyra si ministër? Kjo mbetet e pashpjegueshme. Unë e njoh Manolin. Ai ka mësuar për drejtësi, ka 6-7 vjet eksperiencë dhe e di mirë zatin. Atëhere pse gjithë kjo «modesti» te ai? E vërteta është se Manoli ka frikë nga drejtësia dhe ashpërsia e Partisë kundër armiqve të klasës, të brendshëm ose të jashtëm. Unë kështu e kuptoj autokritikën e tij, megjithëse Manoli nuk na sqaroi për këtë çështje. Si mund të jetë Manoli në udhëheqje me një frymë të tillë disfatiste që shfaqet te ai? Mos vallë mendon Manoli t'i ketë këmbët dhe këtej dhe andej dhe të thotë se fundi i fundit nuk është ai, që i ka vrarë elementët armiq të popullit, po të tjerët? Prandaj t'i mendojë mirë këto gjëra, pse nuk janë të thjeshta. Dhe unë jam dakord me gjithë shokët e tjerë që Manoli të mos jetë në Komitetin Qendror, po të mbetet në Parti¹ e të përpiqemi ta ndreqim, t'i japim dorën të korrigjohet, të thellohet mirë dhe të bëjë një autokritikë të ndershme përpara Partisë.

Për Theodhorin, e thashë edhe më parë, se autokritika e tij s'ka qenë e ndershme dhe e sinqertë, por autokritikë me akrobacira për të fshehur pikëpamjet e

¹ Plenumi e përjashtoi Manol Konomin nga Komiteti Qendror.

tija që nuk përputhen me vijën e Partisë. Unë mendoj se ai duhet t'i realizojë mirë fajet që ka bërë dhe shkaqet që e kanë shtyrë të bëjë gabime. Theodhori është për-pjekur të dalë nga këto situata me dy-tri autokritika, që kundërshtojnë njëra-tjetrën. Kjo tregon se ai është për-pjekur si t'i dalë mbanë kësaj situatë më me pak gërvishje. Gabimet e tij në Drejtorinë e kuadrit janë shumë të rënda. Një shok që ka qenë nën presionin e borgjezisë dhe të armikut, merret me mend se ç'gabime mund të ketë bërë atje. Për këtë kemi edhe ne përgjegjësi, po duhet kuptuar mirë se Sekretariati nuk është kartotekë, prandaj ne kemi pasur besim te ata shokë që kanë punuar me kuadrin, pse ata kishim caktuar në krye të kësaj detyre. Prandaj u binte atyre detyra të na paraqitnin si duhet situatën e kuadrit. Por me pikë-pamjet oportuniste dhe nën influencën e presionin që ka ushtruar armiku mbi këta shokë, shumë gabime të tjera mund të ketë. Kjo politikë kuadri, e zbatuar prej tyre, është një nga shkaqet kryesore që janë bërë gabime në punën me kuadrin. Këto gabime ne do t'i shohim dhe do t'i ndreqim.

Çështja që Theodhori nuk e ka kuptuar mirë nevojën e ngritjes së elementëve të rinj, është një dëm që i ka bërë Partisë, pse nga kjo neglizhencë dhe nga ky faj është penguar ngritja e elementit të ri. Ne, njëmijë herë e kemi thënë se kuadro kemi plot, prandaj duhet t'i ngremë. A të është thënë kjo shoku Theodor ta bësh?¹ Atëhere përse nuk e ke bërë? T'i marrim një çikë mirë këto përgjegjësi dhe të mos i lëmë të kalojnë

¹ Pyetjes ju përgjegj se i është thënë.

kështu, me një autokritikë të lehtë duke thënë se «unë nuk di, se s'kam lexuar as «Historinë e Partisë Bolshevike»». Po udhëzimet e direktivat e Partisë ç'i ke bërë? Për këto gjëra duhet të përgjigjesh këtu. Puna është për ta kuptuar thellë fajin dhe t'i njohësh mirë gabimet. Prandaj edhe unë them që Theodhori të përjashtohet nga Komiteti Qendror¹ dhe t'i drejtojë këtij një autokritikë me shkrim. Theodhori ashtu edhe Manoli të thërriten në Sekretariat dhe të sqarohet mirë çështja e tyre dhe rezultatet mund t'i jepen plenumit në një mbledhje të ardhshme, ku të tregohet se si këta i kanë realizuar gabimet e tyre dhe sa të thella kanë qenë këto gabime. Pse po t'i njohin mirë gabimet, vetëm ashtu mund të ndreqen dhe ne do të dimë që t'u japim ndihmë më mirë, të ecin përpara dhe të ngrihen pak nga kjo situatë ku kanë rënë.

Desha të thoshja edhe nja dy fjalë në lidhje me politikën e kuadrit.

Në politikën me kuadrot ne duhet të shtrojmë me forcë çështjen e atyre që mbarojnë universitetet dhe në radhë të parë ata që kanë kryer studime në BRSS, pse atje kemi dërguar kuadro të shëndoshë partie që kanë luftuar e tani kanë një kulturë të lartë. Po ka dhe kuadro të tjerë që kanë mbaruar këto shkolla të larta e që po mbarojnë dhe luftën tonë e kanë simpatizuar. Këta njerëz, me këtë kulturë të lartë përparimtare,

¹ Plenumi e përjashtoi Theodhor Hebën nga KQ; me ndihmën që i dha Partia, ai i luftoi gabimet e të metat e tija dhe vazhdoi të punojë me devotshmëri për popullin dhe Partinë.

duhet të marrin vendet e merituar si kryetarë dege etj. Të tillë kuadro kanë dy anë pozitive: kanë bërë luftën, kanë edhe shkolla të larta. Këtë vijë duhet ta shohim drejt. Nëse ndonjëri nga këta meriton të bëhet drejtor ose ministër, të vihet në këtë vend dhe të mos qëndrojmë me pikëpamjet e vjetra për kuadrin. Sigurisht, që në radhë të parë, duhet të shohim besnikërinë e tyre ndaj Partisë. Kjo është çështja e parë dhe këtej duhet të nisemi për çështjet e kuadrit për të njohur atë dhe vlerat e tija, d.m.th., sa lufton për mësimet e Partisë, të Leninit dhe të Stalinit. Në qoftë se këto i ka të forta, të vihet atje ku meriton. Mund të bëjë dhe gabime, mundet dhe horizontin të mos e ketë të gjerë, po ai duhet të qëndrojë atje. Mund të bëjë në fillim dhe disa gabime, po e dimë se kemi një njeri me perspektivë, prandaj puna do të na shkojë përpara. Pastaj duhet të bëjmë politikën e kuadrit duke marrë parasysh edhe konditat e tija. Ne duhet të ngremë elementë të rinj, po kjo nuk do të thotë të ulim, pa dallim, të vjetrit, se dhe këta kanë kapacitetin e tyre, besnikëri dhe eksperiencë. Po ka dhe të vjetër që e pengojnë vijën e Partisë. Të vjetrit, «që rrojnë me të vjetrat» dhe tani nuk bëjnë përpjekje për të ecur përpara, duhet t'u lënë vendin të rinjve. Nga ana tjetër e në radhë të parë ne duhet të spastrojmë elementët armiq e t'i zëvendësojmë me njerëzit tanë.

Zhvillimi ynë ekonomik lyp mijëra kuadro dhe po të ecet me ngadalësinë e Tukut e të Theodorit në punën me kuadrin, do ta dëmtojmë Partinë. Ne duhet të ngremë kuadro me guxim. Po të mos bëjmë kështu, siç thashë, atëhere kemi gabuar rëndë. Ne duhet t'ua japim

punët në dorë punëtorëve dhe fshatarëve. Intelektualët le të dinë dhe le të punojnë, por, nën drejtimin e punëtorëve. Ne duhet të bëjmë që punëtorët dhe fshatarët të marrin zanatin e të bëhen drejtues. Ne do të bisedojmë dhe për çështjen e shtrimit të këtij problemi në gjithë Partinë.

Kjo punë, që bëmë këtu dhe që na dha rezultate jashtëzakonisht të mëdha, duhet të vlejë që të përfitojnë edhe shokët në bazë. Të gjejmë metodën më të mirë që komitetet e Partisë, aktivet, celulat, të aktivizohen në këtë rrugë dhe të luftojnë për të. Ne jemi të bindur se kjo do të arrihet, sepse Partia jonë është e fortë dhe do t'i zhdukë të gjithë ata që janë futur kontrabandë, do të korrigjojë të lëkundshmit dhe do të ecë përpara. Plani që po bëjmë do të realizohet e do të tejkalohet, po të mobilizohet Partia. Është bërë një punë e madhe, megjithëse kanë qenë gjithë këto gjëra që rrahëm në këtë mbledhje. Ne kemi pasur gjithë ato suksese dhe në rast se do ta kemi Partinë të fortë, ashtu siç e shtruam në këtë plenum, planin do ta realizojmë patjetër, pse Partia jonë është revolucionare dhe korrigjimi i të metave që kemi në Parti, do ta forcojë këtë akoma më shumë. Kështu do të shtohet më shumë edhe besimi i popullit te Partia jonë. Vetëm duhet që të bëjmë çmos që të gjitha këto që u thanë në këtë plenum, t'i vëmë në jetë me përpjekje. Ne me fjalë i kemi thënë shumë herë këto gjëra, po këtej e tutje duhet që t'i kontrollojmë ashtu si duhet punët tona dhe punët e shokëve tanë.

Ne duhet të bëjmë që në Parti të zhvillohet një kritikë dhe autokritikë e hapët nga të gjithë anëtarët

e Partisë, t'i bëjmë shokët e Partisë që të mos kenë druajtje në të kritikuarit e cilitdo shoku qoftë, kur është i bindur se kritika e tij është në të mirën e Partisë dhe të atij shoku, pse kështu forcohet Partia. Pra, të forcojmë demokracinë e brendshme në Parti, që është jetike për Partinë tonë.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

FJALIM NË KONFERENCËN E PARË NACIONALE TË SULMUESVE DHE TË NOVATORËVE

2 mars 1951

Shokë e shoqe sulmues dhe novatorë,

Rëndësia e kësaj konference është e madhe për vendin tonë. Unë jam më se i sigurtë se ju jeni të ndër-gjegjshëm për këtë. Punimet në këtë mbledhje tregojnë qartë se lëvizja sulmuese në vendin tonë ecën përpara me hov të madh dhe se ekzistojnë të gjitha konditat që kjo të zgjerohet më shumë. Kjo është një perspektivë e shkëlqyer për atdheun tonë, pse pa një lëvizje të tillë nuk mund të përparojmë, nuk mund të realizohen planet e shtetit, që përfaqësojnë ndërtimin e socializmit në Republikën tonë Popullore. Lëvizja sulmuese, që ka lindur dhe që po merr përpjesëtime të gjera, është një lëvizje revolucionare, pse ajo është një lëvizje që lindi nga klasa punëtore, që është klasë revolucionare deri në fund dhe që udhëheq popullin tonë drejt socializmit. Kjo lëvizje sulmuese, që është shprehja më e gjallë e emulacionit socialist, do të përmbysë metodat e vjetra të punës, do të shpartallojë mbeturinat e metodave dhe të pikëpamjeve kapitaliste-borgjeze që, për fat të keq, ekzistojnë akoma në punë dhe në mentalitetin e mjaft

njerëzve. Ajo do të thyejë normat e deritashme, do të vendosë norma të reja, do të rritë rendimentet e reja në punë dhe do të ngrejë me mijëra dhe me mijëra kuadro të rinj të dalë nga gjiri i klasës punëtore dhe i fshatarësisë punonjëse, do të zhvillojë kapacitetin mendor, teknik dhe aftësinë drejtuese të punëtorëve dhe të fshatarëve, do t'i bëjë këta të guximshëm, të aftë të realizojnë dhe të tejkalojnë planet dhe të mbajnë mirë në duart e tyre fatin e ndërtimit të socializmit dhe të popullit tonë.

Unë i ndoqa me vëmendje punimet e kësaj konference, dëgjova një sërë shokësh sulmues e novatorë që dolën dhe folën këtu, për përpjekjet, për luftën që kanë zhvilluar me vështirësitë dhe për sukseset e tyre të shkëlqyera. Kjo është një gjë e mrekullueshme. Kjo tregon sa thesarë të çmueshëm, sa njerëz me talent, sa organizatorë të shquar gjenden në gjirin e klasës punëtore dhe të fshatarësisë sonë. Këta njerëz të thjeshtë e punëtorë janë me mijëra dhe me qindra mijëra, të cilët i zbulon, i rrit e i ngre Partia, pse këtu dhe vetëm këtu qëndron forca e saj. Kjo tregon forcën e madhe të klasës punëtore që rritet, që forcohet e përparon çdo ditë.

Shokë sulmues, novatorë e racionalizatorë që ndodheni në këtë sallë dhe shokët tuaj që punojnë në kantiere, në kombine, në uzina, në ara, në kooperativa, populli dhe Partia ju duan dhe ju nderojnë. Ju jeni pionierët e kësaj lëvizjeje të madhe revolucionare, që do të shpejtojë ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

Shokë dhe shoqe, në thjeshtësinë tuaj prej punëtori, të jeni kryelartë për përparimet e mëdha që keni bërë në punë dhe për shërbimet që i sillni popullit. Kjo të

mos ju rritë mendjen, por t'ju shtojë forcat dhe vullnetin tuaj për të ecur me guxim përpara drejt fitoreve të reja dhe me shembullin tuaj, të bëni që masat e gjera punonjëse të përfshihen në lëvizjen e madhe sulmuese dhe të ecin në rrugën e lavdishme të punëtorëve sovjetikë, në rrugën që na ndrit Stalini i madh.

Çka është shumë e rëndësishme dhe që vetë punimet e kësaj konference e treguan, detyrat që Partia i ka vënë përpara klasës punëtore, fshatarësisë dhe të gjitha masave punonjëse të vendit tonë, po zbatohen me entuziazëm të madh. Kjo tregon drejtësinë e vijës së Partisë, që u përgjigjet konditave dhe kërkesave të kohës. Ju, shokë punëtorë, jeni nga ata që i keni zbatuar me vendosmëri dhe me entuziazëm direktivat dhe vijën e Partisë, që ndiqni dhe zbatoni me përpikmëri mësimet dhe këshillat e mësuesit të shtrenjtë të popullit tonë, të klasës punëtore dhe të të gjithë proletariatit botëror, Stalinit të madh. Ja ç'u ka thënë në mes të tjerave, stakanovistëve sovjetikë shoku Stalin më 17 nëntor 1935:

«Njerëzit në vendin tonë nuk punojnë për shfrytëzuesit, për të pasuruar parazitët, por për vete, për klasën e vet, për shoqërinë e vet sovjetike, ku në fuqi janë njerëzit më të mirë të klasës punëtore. Pikërisht kjo është arsyeja që në vendin tonë puna ka rëndësi shoqërore, ajo është nder dhe lavdi»¹.

Të tilla janë konditat edhe në vendin tonë. I tillë është pushteti në vendin tonë, ku klasa punëtore është

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 21—22.

në fuqi, i tillë është edhe qëndrimi i njerëzve tanë ndaj punës. Në vendin tonë nuk ekzistojnë më shfrytëzues. Revolucioni ynë popullor ata i përllau përgjithmonë dhe njerëzit e vuajtur dhe të shtypur të klasës punëtorë dhe të fshatarësisë së varfër kanë marrë frenat e shtetit në dorë. Çdo gjë është e popullit, çdo gjë vihet në shërbim të popullit. Tani atdheu është i yni, pse tani pushteti është i popullit punonjës dhe jo më i pasanikëve, i bejlerëve dhe i agallarëve. Shumë shokë, punëtorë sulmues, që folën këtu me fjalë të thjeshta, por që shprehin gjallërisht ndjenjat e klasës sonë punëtorë, treguan jetën e tyre të mjeruar nën regjimet shtypëse të së kaluarës, ku s'mund të fitonin as bukën e gojës e as opingat e këmbës. Por tani në regjimin e demokracisë popullore ku klasa e tyre është në fuqi, ata me punë, me luftë, me përpjekje u bënë njerëz të vërtetë, njerëz të dashur dhe të nderuar të popullit, ata u ngritën, u zhvilluan, janë bërë drejtues, teknikë, sulmues e novatorë. Të gjithë e shprehën me gojën e tyre ndryshimin e madh që është bërë në vendin tonë. Ata treguan përmirësimin e madh të jetës së punëtorëve tanë dhe të të gjithë punonjësve të Shqipërisë.

«Jam i lidhur për jetë me planin e shtetit», tha, nga kjo tribunë, sulmuesi i shquar I. P, «ekskavatori i Myzeqesë», i cili si revolucionar, megjithëse një dorë e ka të prerë, ka arritur të gërmojë 17 m³ dhë nga 5 m³ që është norma e zakonshme.

Punëtorja sulmuese e tisazhit të Shkodrës Nexhmije Kazazi me diskutimin e saj ishte një shembull për të gjithë. Ajo tha:

«Partia më rriti, më nxori në dritë, shporri prej

meje fanatizmin dhe tash unë jam një punëtorë e dallueme».

Me sa dashuri ajo foli për punën, për fabrikën, për popullin! Për këtë bijë të popullit, sekondat e orës janë flori, ajo nuk i lë të humbasin, pse mendon dëmin që mund të ketë populli nga neglizhenca e saj. Më lejoni, shokë, t'ju rilexoj një pjesë të vogël të diskutimit të saj, të cilës i lutem të më falë, në qoftë se bëj ndonjë gabim në riprodhim:

«Para se me fillue punën kontrolloj për gjysë ore maqinat dhe pyes punëtooren e turnit a ka pasë ndonji difekt mbrenda kohës që ka punue ajo. I ndigjoj krismat a janë në rregull, i vojatis maqinat dhe filloj punën. Kam kujdes për maqinën, vazhdimisht kontrolloj fijet mbrapa se mos më ngatërrohen, sepse po u këput një fije, mund të shkaktojë këputjen e shumë fijeve të tjera e kështu për gjysë ore që t'i ndreq, le 3 metra beze pa ba. . . Rri e rrej meqikun kur të mbarohet për mos me pasë nevojë me lirue gradën, se me lirue gradën, duhet me harxhue të paktën 5 sekonda. . . dhe sekondat kurrësesi s'duhet me i humbë. . .».

Ja qëndrim bolshevik ndaj punës, ja dashuria dhe besnikëria ndaj Partisë, ndaj atdheut dhe popullit të shprehura në punë.

E njëjta gjë ndodh dhe me sulmuesin e shquar Negri Nikolla, që duke vënë në jetë një metodë të re në ndërtime, i dha një hov të madh ritmit të ndërtimeve. Negri Nikolla është një murator i ri, ai është djalë populli, që e do popullin e Partinë e tij me të gjitha forcat e shpirtit. Negri Nikolla me të drejtë tha:

«Vallë do të ecim me ritmin që kanë ecur baba-

llarët tanë për të ndërtuar kombinatet madhështore? Vallë do të lejojmë që shumë nga punonjësit tanë të mos kenë akoma sa duhet banesa? Jo, duhet t'i japim fund metodës së vjetër të punës».

Shqipëria ka ndryshuar, njerëzit kanë ndryshuar. Detyra të reja njerëz të rinj — ka thënë Stalini. Dhe ja njerëzit e rinj që farkëton Partia jonë, të cilët po i ndërrojnë faqen Shqipërisë dhe po ndërtojnë socializmin. Të tillë janë Minella Sava, njeriu i ri i naftës, shoferi Nasho Badjava, i cili ka bërë 90 mijë km. me maqinën Zis pa e çuar asnjëherë për riparim, të tillë janë Ndreko Nakuçi, Todo Kavaja, minatori Sali Vata, e qindra e qindra të tjerë sulmues, novatorë e racionalizatorë të vendit tonë.

Klasa jonë punëtore është e vendosur të ecë përpara. Lëvizja sulmuese është një zjarr i madh që po ndizet dhe detyra e Partisë sonë, e gjithë komunistëve shqiptarë, është që me të gjitha forcat ta zhvillojmë këtë lëvizje revolucionare në shembullin dhe në gjurmat e lëvizjes stakanoviste sovjetike. Ne duhet, me të gjitha forcat tona, të zhvillojmë emulacionin socialist kudo. Konditat janë të gjitha dhe do të jetë një faji rëndë për ne, në qoftë se këtë hov dhe këtë entuziazëm që ekziston në klasën tonë punëtore dhe në fshatarësinë punonjëse për lëvizjen sulmuese, do ta lëmë të shuhet si një zjarr prej kashte. Këtë gjë nuk do ta lejojë kurrë Partia dhe kjo do të jetë e ashpër kundër të gjithë atyre që kësaj çështjeje kaq vitale, do të përpiqen t'i vënë gurë në rrota. Lëvizja sulmuese, emulacioni socialist dhe baza e kësaj lëvizjeje, që është angazhimi individual, shkojnë të lidhura ngushtë me realizimin e

planit të shtetit, nga ku varet ndërtimi i socializmit dhe sigurimi i lirisë e i fitoreve të popullit. Angazhimet individuale, natyrisht, konsistojnë në ndarjen si duhet të detyrave të planit. Prandaj, e para e punës, plani, mbasi të aprovohet nga lart, duhet të dërgohet menjëherë në bazë. Në këtë drejtim ka pasur të meta, në radhë të parë, nga drejtuesit lart. Kjo ka shkaktuar që plani të mos shkojë në kohën e caktuar në bazë dhe atje janë marrë masa të ngadalshme për ta ndarë atë në çdo punëtor. Duhet që çdo punëtor të dijë me saktësi në se konsiston puna e tij, duhet të dijë sa punë duhet të kryejë në ditë dhe për çdo orë. Gjithashtu ai duhet të dijë kur e kapërcen normën e tij ditore dhe sa e kapërcen. Në këtë mënyrë interesat e punëtorit lidhen me interesat e prodhimit, interesat e tij me ato të të gjithë popullit, me interesat e socializmit. Përmirësimi i jetës së punëtorëve si individë forcon dhe shpejton ndërtimin e socializmit, shton dhe mirëqenjen e të tjerëve dhe punëtori kupton qartë lidhjet që ekzistojnë në mes punës së tij personale dhe ndërtimit të socializmit në vendin tonë. Para disa vjetësh normat ishin vendosur vetëm në disa sektorë; në këtë drejtim tani janë bërë hapa shumë të mëdhenj. Por prapëseprapë është e domosdoshme që normat jo vetëm të vendosen kudo ku mund të punohet me to, por duhet të bëhen të gjitha përpjekjet që punëtorët ta kuptojnë rëndësinë e normës dhe të bëjnë përpjekje që këto të kapërcehen. Disa norma të deritashme nuk kanë qenë të studjuara mirë as nga ana e ministrive as nga ana e ndërmarrjeve. Disa teknikë dhe inxhinierë që kanë mësuar në shkollat borgjeze jo vetëm që janë transmetuesit e

normave të vjetëruara, por nuk kanë bërë as përpjekje të studjojnë sistemin e normave sovjetike dhe mundësitë e zbatimit të tyre në konditat e punës dhe të punëtorëve tanë. Një praktikë e tillë duhet të marrë fund. Normat në asnjë mënyrë nuk duhet të kenë tendenca të ulen, përkundrazi ato duhet vazhdimisht të ngrihen, pse fakti është që punëtorët tanë dita-ditës po përvetësojnë eksperiencën e madhe sovjetike, mësojnë zanatin, perfeksionohen dhe normat e vjetra nuk i rezistojnë hovit të madh të punës krijuese të klasës punëtore. Natyrisht, do të jetë vështirë tani për tani që të zbatohen automatikisht normat e një shpikësi ose të një sulmuesi të dalluar, por duhet kurdoherë të gjendet mesatarja dhe të shkohet vazhdimisht duke u ngjitur. Interesi i ndërtimit të socializmit dhe vetë interesi individual i punëtorit e lyp këtë. Drejtoritë e ndërmarrjeve dhe bashkë me ta edhe shokët sulmues duhet të kenë kujdes më të madh për t'i dhënë ndihmën e nevojshme masës së punëtorëve që këta të arrijnë normat e caktuara dhe t'i tejkalojnë ato. Të mos harrojmë se çdo punëtor me gjithë zemër dëshiron të bëhet një sulmues. Detyra e organizatës së Partisë, e bashkimeve profesionale dhe e pushtetit është që këta t'i ndihmojnë me çdo kusht. Duhet me pasë kujdes që Partia, bashkimet profesionale dhe drejtoritë e ndërmarrjeve, të mos vënë në dukje vetëm punën e sulmuesve dhe të harrojnë shumicën e punëtorëve, të cilët me ndërgegje edhe ata kapërcejnë normat. Këtej, nga këta do të lindin sulmuesit e rinj. Nga ana tjetër, shokët sulmues duhet të ruajnë thjeshtësinë e tyre prej punëtori, të luftojnë shfaqjet mikroborgjeze, pse këto shfaqje janë të dëm-

shme dhe të huaja për klasën punëtore. Ata, përkundrazi, shpikjet, novacionet, metodat e reja në punë duhet t'ua mësojnë me çdo kusht sa më shumë punëtorëve të tjerë dhe të mos u shkojë për asnjë çast në mend se këto duhet t'i mbajnë për vete, për ambicie të sëmurë, për të ruajtur «prestigjin dhe nderin» që ata kanë fituar. Përkundrazi, ata do të nderohen, do të respektohen më shumë nga populli, nga Partia, nga shokët e tyre punëtorë, kur përpjekjet e tyre t'i vënë në shërbim të kauzës së përgjithshme.

Shokë dhe shoqe sulmues,

Shoku Gogo Nushi vuri në dukje në raportin e tij sukseset e arritura në realizimin e planit të shtetit. Këto suksese u arritën në saje të luftës heroike të Partisë sonë, në saje të vijës së saj të drejtë marksiste-leniniste e staliniane, në saje të punës heroike të klasës sonë punëtore, të fshatarësisë punonjëse, në saje të ndihmës së Bashkimit të madh Sovjetik, në radhë të parë dhe të demokracive popullore motra. Të gjitha konditat objektive për realizimin e planit tonë dyvjeçar të shtetit kanë ekzistuar.

Kondita kryesore për realizimin me sukses të planit,

«në radhë të parë duhet që vendi të ketë pasuri natyrore...»¹ —

na mëson shoku Stalin.

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 13, f. 31.

Vendi ynë është i pasur dhe kjo pasuri në të kaluarën ka qenë pronë e bejlerëve, e agallarëve dhe e koncesionarëve të huaj fashistë. Tani e gjithë kjo pasuri është e popullit. Lufta na e kishte shkatërruar, por populli nën udhëheqjen e Partisë e rindërtoi të gjithë. Tani të gjitha burimet tona minerale të naftës, të bakrit, të kromit, të serës, të qymyrit janë të pajisura me maqineri dhe me vegla të ndryshme moderne. Ato punojnë me rendiment të plotë. Të gjitha fabrikat, uzinat, punishtet janë rindërtuar dhe punojnë, kombinatet e reja madhështore po ndërtohen sivjet dhe në vitin e ardhshëm do të japin frutet e tyre. Në vendin tonë po ndërtohen hidrocentrale, janë ndërtuar dhe do të ndërtohen hekurudha, do të ngrihen fabrika të reja, do të hapen miniera të reja për të nxjerrë burime pasurish të tjera edhe më të mëdha që do të vihen në shërbim të popullit. Toka s'është më e bejlerëve dhe e agallarëve, por është e fshatarit, i cili e punon për veten e tij. Fshatari ka kuptuar rëndësinë e kolektivizimit dhe po bashkohet në kooperativa bujqësore, të cilat po shtohen, po forcohen.

Kondita e dytë për realizimin e planit, sipas mësimëve të shokut Stalin:

«Duhet një pushtet i tillë, i cili të ketë dëshirën dhe forcën për t'i shfrytëzuar këto pasuri...»¹

A e kemi ne këtë konditë? Po e kemi. Pushteti është në duart e popullit. Në fuqi është klasa jonë

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 13, f. 32.

punëtore dhe pararoja e saj, Partia e Punës. Në pushtet janë njerëzit më të mirë të klasës punëtore, të fshatarësisë punonjëse që e drejtojnë vendin në rrugën dhe në shembullin e miqve tanë, popujve sovjetikë.

Kondita e tretë,

«duhet që ky pushtet — thotë shoku Stalin — të gëzojë përkrahjen e masave milionëshe të punëtorëve dhe fshatarëve»¹.

Edhe këtë konditë ne e kemi. Pushteti ynë popullor është pjella më e dashur e popullit. Ky e krijoi atë në luftë të përgjakshme kundër fashizmit dhe tradhtarëve. Populli e shkatërroi nga themelet pushtetin e vjetër të borgjezisë, ndërtoi pushtetin e tij nga më demokratikët, nga më përparimtarët. Ky pushtet gëzon përkrahjen e klasës punëtore dhe të fshatarësisë, pse janë këta që e përbëjnë, janë njerëzit më të mirë të tyre, më të vendosurit, më trimat, më të zotët. Pushteti ynë po forcohet çdo ditë, po modernizohet.

Kondita e katërt,

«duhet edhe një rend i tillë, i cili të mos vuajë nga sëmundjet e pashërueshme të kapitalizmit . . . Kriza, papunësia, shpërdorimi, varfëria e masave të gjera — ja sëmundjet e pashërueshme të kapitalizmit»² —

thotë shoku Stalin.

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 13, f. 32.

² Po aty, f. 32—33.

Edhe këtë konditë ne e kemi. Në vendin tonë nuk ekzistojnë as kriza as papunësia, ato janë zhdukur, është zhdukur edhe varfëria. Jeta e popullit tonë është përmirësuar, populli ynë rron më mirë, vishet më mirë, edukohet më mirë. Gjendja e popullit tonë në të tashmen është si dita me natën në krahasim me të kaluarën. Sa ditë që shkojnë, aq më e mirë bëhet jeta e popullit.

Kondita e fundit,

«duhet një parti, që të jetë mjaft kompakte... për të zbatuar sistematikisht një politikë të drejtë, revolucionare, bolshevike»¹.

Partinë tonë ne e kemi të pamposhtur e heroike, të dalë nga lufta dhe të edukuar me mësimet e Leninit dhe të Stalinit. Ajo ecën në rrugën e bolshevizimit, ajo është besnike e popullit, e socializmit, e Bashkimit Sovjetik, e Partisë Bolshevike dhe e internacionalizmit proletar, ajo është besnike deri në fund e marksizëm-leninizmit.

Por ne kemi edhe një konditë tjetër për të ndërtuar socializmin: ne kemi ndihmën e Bashkimit Sovjetik, të Partisë Bolshevike dhe të Stalinit, kemi eksperiencën e tyre të lavdishme që na jepet në çdo lëmë të aktivitetit ekonomik, kultural dhe shoqëror. Ne kemi gjithashtu ndihmën e demokracive popullore motra.

Këto janë konditat objektive që duhen për të realizuar planet ekonomike të shtetit. Këto i kemi pasur, i kemi dhe do t'i kemi edhe më të forta në të ardhsh-

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 13, f. 34.

men. Kjo varet nga ne që t'i përforcojmë, t'i shëndoshim në rrugën që na mëson Partia.

Por për realizimin e planit duhet të kemi dhe një konditë tjetër që na mëson shoku Stalin, dhe kjo është «zotësia për të drejtuar»¹. Këtu kemi të meta dhe gabime, këtë duhet ta themi hapët se kështu do të korrigjohemi. Partia jonë, njerëzit e Partisë dhe të klasës punëtore s'kanë frikë t'i shohin në sy gabimet dhe t'i korrigjojnë. Në disa degë të industrisë, si në fabrikën e gomës, në Stabilimentin e sharrave të Pukës, në fabrikën e këpucëve, në disa degë të minierave si në atë të naftës, plani dyvjeçar nuk është realizuar qind për qind. Atje ka pasur të meta dhe këto kanë rrjedhur pse nuk është drejtuar si duhet e në mënyrë operative realizimi i planit, atje ka punuar armiku titist dhe agjentët e tij të maskuar, atje drejtuesit e ndërmarrjeve s'kanë qenë si duhet në krye të detyrës. Ekziston një burokraci e dëmshme në aparatit e shtetit tonë që nga ministritë e deri në ndërmarrjet poshtë. Na kanë mbuluar kartërat e shkresat dhe shumë njerëz janë bërë ca burokratë dhe zyrtarë të sëmurë, që s'i ngrenë hundët nga kartërat. Ata kujtojnë se çdo gjë do ta zgjidhë raporti ose shkresa. Kjo sëmundje ka refleksin e saj dhe në aparatet e Partisë si në qendër dhe poshtë. Nuk i është dhënë ndihma që duhej t'i jepej bazës. Nuk janë ndjekur njerëzit në punë si dhe problemet dhe t'u jepej këtyre zgjidhja më e mirë dhe më e shpejtë. Shumë probleme janë zvarritur dhe kjo ka shkaktuar ngadalësim, konfuzion, çrregullime. Armiku i klasës dhe i

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 13, f. 30.

popullit tonë ka përfituar nga këto dobësi. Janë shtrembëruar direktivat e Partisë dhe të qeverisë nga njerëz të pandërgjegjshëm dhe armiq. Por kjo do të marrë fund sa më parë. Ne duhet të forcojmë kontrollin në punë, kontrollin e zbatimit të detyrave dhe të jemi të ashpër dhe të pamëshirshëm kundër atyre që u shmangen detyrave. Të luftojmë thyerjen e disiplinës dhe konfuzionin. Duhet të forcojmë organizimin dhe të zhvillojmë në maksimum inisiativën dhe kontrollin nga ana e punëtorëve dhe e fshatarëve të varfër, pse vetëm kështu do të zhduken të metat dhe gabimet dhe do të ecim përpara. Disa shokë drejtues janë bërë njerëz që s'u flitet dot me gojë, i ka mbuluar mendjemadhësia dhe fodullëku. Ata mundohen të dalin mbi ujë me pesë para në xhep dhe, për të fshehur pazotësinë e tyre, përdorin arrogancën dhe duke shfrytëzuar postin që u është besuar, pengojnë punën, pengojnë hovin madhështor të klasës sonë punëtorë. Ata të mbulojnë me fjalë boshe. Njerëz të tillë jo vetëm që s'vlejnë, por janë dhe të dëmshëm prandaj duhet të gjejnë vendin sa më parë. Disa të tjerë kujtojnë se janë të pazëvendësueshëm, kanë frikë se u ndoten këpucët me llucë ose duart me vaj dhe mendojnë se vetëm duke dhënë urdhëra nga lart e kryejnë punën. Njerëz të tillë s'kanë ç'na duhen. Vlera e çdo njeriu të matet në punë, në luftë, në përpjekje, në qëndrimin e tij ndaj vijës së Partisë, në dashurinë dhe besnikërinë që ai tregon ndaj popullit, ndaj socializmit, jo me fjalë, por konkretisht me punë, me vepra. Unë jam i bindur, shokë punëtorë, se shumë prej jush kishin akoma mjaft gjëra për të thënë këtu në këtë konferencë, kishin kritika për të bërë kundër

mjaft njerëzve të pandërgjegjshëm që ju kanë penguar në punën tuaj të madhe. Këtë ju nuk e bëtë, jo se ju mungon guximi, se guximi dhe heroizmi juaj theu banditët fashistë, përmbysi borgjezinë dhe tani çan malet, por ju keni menduar në vetëvete «të mos ta prishim harmoninë e kësaj konference kaq me rëndësi». Të mendosh kështu është gabim. Përkundrazi, po të kishit bërë kritikë më të ashpër ndaj gabimeve dhe njerëzve që i bëjnë këto gabime, atëhere kjo konferencë do të ishte akoma më madhështore. Kështu na mëson Partia.

Shokë punëtorë, Partia ju mëson ta përdorni me forcë dhe drejt armën e mprehtë të saj, kritikën dhe autokritikën bolshevike, pse vetëm kjo i ndreq njerëzit, zbulon të këqiat, spastron qelbësiat. Ju lani fytyrën kur ktheheni nga puna dhe spastroheni. Ja, kështu është dhe me kritikën e autokritikën bolshevike, ajo spastron të metat dhe gabimet në njerëzit. Ju s'rroni dot në një dhomë me pluhur dhe me ndyrësira, por merrni fshesën dhe i fshini këto. Ja, kështu bën dhe kritika e autokritika bolshevike; ajo spastron njerëzit, spastron Partinë tonë, spastron pushtetin dhe vendin tonë nga «... pleshtat — spekuluesit, nga tartabiqet...»¹, siç i quan Lenini njerëzit e këqinj që futen kontrabandë në radhët tona. Partia ju thotë juve t'i bëni sytë katër kudo. Çdo gjë të jetë nën kontrollin tuaj, punëtorë e fshatarë të varfër, dhe pastaj do të shohin sa u vlen lëkura atyre që s'punojnë, atyre drejtorëve ose shefave që s'bëjnë detyrën, atyre që, kur vjen ndo-

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 26, f. 459.

një i madh nga lart, bëhen vaj e gjalpë, por që sa kthen ai krahët, ata fillojnë të sillen me brutalitet, do të shohin sa u vlen lëkura atyre që lënë punëtorët dhe kantieret pa furnizuar me ushqime, duke gjetur njëmijë pretekste, duke krijuar vetë konfuzion, ose atyre që, nga pakujdesia ose me qëllim, nuk marrin parasysh propozimet tuaja, duke penguar kështu vënjen në zbatim të shpikjeve e novacioneve tuaja etj., ose atyre që u hanë hakën. Partia është e juaja, pushteti është i juaji, shokë punëtorë dhe fshatarë; çdo armë e pushtetit është në duart tuaja dhe i përdorni këto armë për të shpartalluar pa mëshirë armiqtë dhe mbeturinat e tyre. Lufta e klasave në qytet dhe në fshat duhet të jetë e ashpër dhe të jemi të pamëshirshëm ndaj kulakut, vjedhësit, sabotatorit. Të gjithë këta janë bastardët e kapitalizmit dhe të borgjezisë, këta kanë një fytyrë dhe një qëllim, të shkatërrojnë dhe të dëmtojnë punën madhështore të popullit tonë, të dobësojnë pushtetin tonë nga brenda dhe të krijojnë konditat e dëshiruara prej tyre për të rrëmbyer pushtetin nga duart e klasës punëtore dhe të fshatarësisë së varfër. Por kjo nuk do të ngjasë kurrë. Po kështu spiunët e amerikanëve e të anglezëve, të banditëve të Beogradit, të Athinës dhe të Romës e hëngrën grushtin e tmerrshëm të pushtetit tonë dhe le të vazhdojnë po t'ua mbajë. E zeza i pret.

Sho' ë dhe shoqe punëtore,

Mbeturinat e kapitalistëve dhe të borgjezisë kanë kujtuar se nuk mund të bëhej dot pa ta, nuk mund të drejtoheshin këto punë kaq të mëdha, pa «zotësinë e

madhe» të tyre. Ata mendonin se kishin lindur për të qeverisur dhe për të dhënë urdhëra. Revolucioni popullor i qëroi hesapet me ta. Partia ua tregoi sa u vlente lëkura, ajo u tregoi se bëhet shumë mirë pa ta dhe në luftë me ta. Nga gjiri i klasës punëtore dhe i masave punonjëse dolën njerëz me vlera të mëdha, organizatorë të shquar, që drejtojnë fatet e popullit. Por sa vlera ka akoma të pazbuluara! Detyra jonë është t'i nxjerrim ato në dritë. Thesari i popullit është i pashteruar. Prandaj, shokë punëtorë, Partia ju drejton thirrjen: të mësoni, të mësoni, të mësoni sa më shumë, të zotëroni teknikën, të zotëroni shkencën e përparuar, të përvetësoni eksperiencën sovjetike. Shkenca dhe teknika e përparuar të bëhen gjaku dhe mishi juaj dhe çdo gjë të jetë në duar të punëtorëve dhe të fshatarëve të varfër, në duar të njerëzve të popullit.

Stalini thotë:

«Duhet të bëhemi vetë specialistë, zotër të punës, duhet të drejtojmë sytë nga dijet teknike, — ja se në ç'drejtim na shtynte jeta»¹.

«Sigurisht, kjo nuk është një punë e lehtë, por mund të bëhet fare mirë. Shkenca, eksperiencia teknike, dituria — të gjitha këto janë gjëra që fitohen. Nuk i ke sot, do t'i kesh nesër. Gjëja kryesore këtu është që të kemi dëshirën e zjarrtë bolshevike për të zotëruar teknikën,

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 13, f. 37.

për të zotëruar shkencën e prodhimit. Mund të arrihet çdo gjë, mund të kapërcehet çdo gjë, kur është dëshira e zjarrtë»¹

I futni mirë në kokë këto fjalë të arta të Stalinit dhe t'i vëmë në zbatim. As zgjuarësia s'i mungon punëtorit tonë as dëshira e zjarrtë prej bolsheviku; çdo gjë mund të mësojë ai; të gjitha mundësitë i janë krijuar; të gjitha portat ja ka çelur Partia e tij e dashur e Punës.

Përpara, pra, çdo gjë të jetë në duart tona!

A do të durojmë akoma ne, që kusarët dhe vjedhësit borgjezë, të mbajnë postet e llogarive të ndërmarrjeve tona? Në asnjë mënyrë! Atje duhet të jenë njerëzit e popullit. A do të lejojmë më ne, që në aparatet tona të shtetit, në dyqanet, në kooperativat të mbajmë njerëz armiq që gjoja dinë zanatin dhe gramën, por që në realitet ata dinë vetëm të vjedhin? Në asnjë mënyrë jo. Ne duhet t'u vëmë fshesën. Politika e Partisë sonë është nga më të drejtat dhe kjo ka bërë që një numër i madh intelektualësh të ndersnëm, teknikë, inxhinierë janë bashkuar me ne dhe punojnë. Ky është interesi i tyre dhe yni. Ne u japim të gjitha mundësitë atyre njerëzve që sillen ndershmërisht, por kundrejt atyre që na luftojnë e na sabotojnë, ne jemi të pamëshirshëm. Dhe kjo është rruga e drejtë.

Lenini ka thënë se

«Midis gabimeve, të metave, lëshimeve të revolucionit tonë, lozin një rol mjaft të rëndë-

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 13, f. 37—38.

sishëm ato gabime etj., që lindin nga këto cilësi të vajtueshme, — por të pashmangshme në çastin e tanishëm, — të intelektualëve të ambientit tonë dhe nga mungesa e një kontrolli të mjaftueshëm mbi punën organizative të intelektualëve nga ana e punëtorëve.

Punëtorët dhe fshatarët «ndruajnë» akoma; nga kjo e metë ata duhet të çlirohen dhe pa dyshim do të çlirohen. Pa këshillat, pa udhëzimet e njerëzve me kulturë, të intelektualëve, të specialistëve, nuk mund të bëjmë. Çdo punëtor dhe fshatar sadopak i arësyeshëm e kupton këtë fare mirë, dhe intelektualët e ambientit tonë nuk mund të ankohen për mungesë kujdesi dhe respekti shoqëror nga ana e punëtorëve dhe e fshatarëve. Por tjetër janë këshillat dhe udhëzimet, tjetër është organizimi praktik i llogarive dhe i kontrollit. Intelektualët japin vazhdimisht këshilla dhe udhëzime shumë të mira, por bëhen fare qesharakë, absurdë dhe mbulohen me turp, kur del në shesh sa «të pafuqishëm», sa të paaftë janë ata për t'i vënë në jetë këto këshilla dhe udhëzime, për të zbatuar një kontroll praktik në mënyrë që fjalët të kthehen në vepra»¹

Kështu na mëson Lenini. Prandaj shokët inxhinierë, teknikë e drejtorë të vendit tonë duhet të shtrohen ca më mirë me punëtorët, të dëgjojnë me vërejtje sugjerimet e tyre, pse është e vërtetë se këshillimet e tyre janë

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 26, f. 457.

të vlefshme, por edhe praktika e punëtorëve është një gjë shumë e madhe.

Lenini na mëson:

«Nuk i pjek zoti poçet» — këtë të vërtetë duhet ta rrënjosin mirë në mendje punëtorët dhe fshatarët. Ata duhet ta kuptojnë se tani gjithë puna qëndron te praktika, se ka ardhur pikërisht ai çast historik, kur teoria kthehet në praktikë, gjallërohet nga praktika, ndreqet nga praktika, verifikohet nga praktika. . .»¹.

Këto fjalë të arta të Leninit të madh të mos i harrojnë as punëtorët tanë as inxhinierët dhe teknikët. Dhe po të ecim në këtë rrugë dhe me siguri në këtë rrugë do të ecim, nuk do të na dalin më ato pengesa që na kanë ndaluar në punën tonë. Shpikjet dhe novacionet e punëtorëve tanë nuk do të flenë më në çantat ose në sirtarët e drejtorëve e të inxhinierëve, por do të studjohen menjëherë, do të vihen në praktikë, do të ndihmohen punëtorët që vazhdimisht t'i përmirësojnë shpikjet e tyre.

Shokë punëtorë dhe punëtoresulmues,

Është i dukshëm e shpëtimtar hovi juaj i madh në punë, entuziazmi juaj për të mësuar e për të përparuar. Ushqehuni sa të jetë e mundur më shumë me eksperiencën e punëtorëve të Bashkimit Sovjetik. Kjo eksperiencë

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 26, f. 457.

na jepet pa kursyer nga Partia Bolshevike, nga shoku Stalin, nga inxhinierët, specialistët sovjetikë. Shihni ç'përparime po bëhen te ne, si përtërihen njerëzit tanë, si perfeksionojnë teknikën, si adoptojnë shpikjet dhe novacionet e stakanovistëve sovjetikë dhe si shkon puna jonë përpara!

Stalini na mëson se s'mjafton vetëm të fitojnë lirinë. Të mirat e lirisë politike duhet të plotësohen me të mirat materiale. Popullit duhet t'i japim më shumë bukë, më shumë yndyrna, më shumë këpucë, më shumë manufakturë, më shumë shkolla, teatro, libra etj. Partia jonë do t'ja krijojë bollëkun e madh popullit tonë, pse ajo është një parti e tipit Lenin-Stalin. Komiteti Qendror dhe qeveria më kanë porositur t'ju them juve, punëtorëve heroikë, sulmues e novatorë dhe nëpërmjet jush, gjithë klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse se për së shpejti qeveria jonë do të dalë me planin ekonomik pesëvjeçar. Kjo është një fitore e madhe për popullin tonë që do t'i ndërrojë faqen Shqipërisë. Fabrika të reja do të ndërtohen, hidrocentrale e hekurudha; bujqësia do të përparojë dhe do të pajiset me vegla të tjera moderne, do të shtohet kolektivizimi i tokës; kultura dhe arti do të zhvillohen, arësimi do të përparojë. Do të krijohet bollëku, do të forcohet Republika jonë Popullore.

Popujt vëllezër të demokracive popullore na e dhanë ndihmën e çmueshme që Partia dhe qeveria jonë u kërkoi. Prandaj ne i kemi të gjitha mundësitë që vendi ynë të bëhet i begatshëm, të lulëzojë jeta e punonjësve tanë.

Të hidhemi, pra, në punë me sulm dhe të korrим

fitore të reja për popullin tonë heroik, për popullin tonë të shtrenjtë dhe në këtë mënyrë, me rezultate konkrete në punë, t'u tregojmë Partisë sonë të Punës, popujve të dashur sovjetikë dhe shokut Stalin, popujve të demokracive popullore, dashurinë dhe mirënjohjen tonë të thellë që kemi për ta, besnikërinë tonë të pafund për kauzën e socializmit e të komunizmit dhe të paqes.

Lufta jonë për ndërtimin e socializmit është njëkohësisht lufta e vendosur për mbrojtjen e paqes në botë. Populli ynë është i ndërgjegjshëm për rrezikun e madh të luftës grabitqare që kërkojnë të shpërthejnë imperialistët gjakatarë amerikanë, anglezë dhe shërbëtorët e tyre trockistët e Beogradit, fashistët e Athinës dhe të Romës. Ata kërkojnë të hedhin botën në zjarr, ata i kanë vënë zjarrin Koresë dhe kanë kaluar nga pregatitjet e luftës, në agresion të hapët. Ata po armatosen me shpejtësi. Shoku Stalin, në përgjegjen e tij dhënë korrespondentëve të shtypit, kohët e fundit, tha:

«Paqja do të ruhet dhe do të forcohet, në goftë se popujt do ta marrin në duart e veta çështjen e ruajtjes së paqes dhe do ta mbrojnë atë deri në fund»¹.

Fjalët e shokut Stalin kanë prekur thellë popujt e botës që shohin te ai përkrahësin më të madh të tyre dhe që të gjithë janë mobilizuar në një luftë aktive të pashembullt në historinë e njerëzimit për ta mbrojtur

¹ J. V. Stalin. Bisedë me korrespondentin e gazetës «Pravda». «Pravda», Nr. 48 (11885), 17 shkurt 1951.

paqen. Kampi i partizanëve të paqes, që përfshin me qindra milion njerëz të botës, është bërë një forcë e madhe që do t'ua ndalojë dorën kriminelëve amerikanë, anglezë dhe satelitëve të tyre. Populli ynë nën udhëheqjen e Partisë së tij heroike, do të intensifikojë çdo ditë e më tepër luftën e tij për mbrojtjen e paqes.

Populli ynë duhet të jetë vigjilent kundër luftënxitësve imperialistë dhe tradhëtarëve të Beogradit, fashistëve të Athinës dhe të Romës, që punojnë pareshtur për të rrëzuar pushtetin tonë popullor, për të skllavëruar popullin dhe për të copëtuar Shqipërinë. Populli ynë të godasë pa mëshirë spiunët dhe tradhëtarët e shitur kokë e këmbë te klika tradhëtare e Beogradit, te monarko-fashistët e Athinës dhe të Romës, t'u bëjë atyre një luftë të pamëshirshme e të vazhdueshme, që të mos u zërë këmba dhë, t'i demaskojë ata dhe padronët e tyre të Beogradit, të Romës e të Athinës, të shpartallojë manevrat e tyre dhe t'i vihet në dukje qartë popullit se ç'krime të tmerrshme bëjnë amerikanët, anglezët dhe shërbëtorët e tyre në Kore e gjetkë e ç'kasaphanë pregatitin ata për njerëzimin.

Populli ynë të shtojë vigjilencën dhe të forcojë mbrojtjen e vendit të tij. Armiqtë tanë do të dështojnë në veprën e tyre kriminale. Ata e dinë mirë se me ç'popull kanë të bëjnë, ata e dinë mirë se Shqipëria s'është as vetëm dhe as e izoluar. Populli ynë është një popull paqësor që e do dhe lufton për paqen; ai është pjesëtar i kampit të madh dhe të fuqishëm të paqes që ka në krye Bashkimin Sovjetik dhe të madhin Stalin. Kampi i paqes është i pathyeshëm, pse të pathyeshëm janë popujt që e përbëjnë atë.

Një entuziazëm i madh përshkoi popullin tonë dhe gjithë popujt e botës dje, kur dëgjuan nga Moska heroike e Stalinit që në Bashkimin Sovjetik u ulën përsëri çmimet për të katërtën herë. Ç'fitore e madhe, shokë, për të gjithë ne, për të gjithë popujt e botës! Në një kohë, kur në vendet kapitaliste po ngrihen në qiell buxhetet e luftës dhe çmimet, në një kohë kur në vendet kapitaliste mbretëron varfëria dhe mjerimi për masat punonjëse, në Bashkimin e madh Sovjetik ndërtohen hidrocentrale elektrike gjigande e hapen kanale madhështore, ulen çmimet për të katërtën herë dhe populli fiton nga kjo ulje e fundit 27 miliard rubla. Po në këtë kohë në demokracitë popullore po korren suksese dhe fitore të mëdha nga popujt e këtyre vendeve, këtu ndërtohet socializmi, përmirësohet çdo ditë mirëqenja e popujve. Ç'tregon kjo? Kjo tregon forcën e madhe të Bashkimit Sovjetik, forcën e madhe të kampit të socializmit dhe të paqes, tregon triumfin e politikës së lavdishme paqësore staliniane. Nga ana tjetër, duket qartë falimentimi dhe kalbëzimi i kapitalizmit që jep shpirt dhe që kërkon të zgjatë edhe ca jetën, duke përdorur mjetin e saj të vetëm për t'i shpëtuar katastrofës, luftën. Por forca e pamposhtur e popujve do t'ua ndalojë dorën hitlerianëve të rinj dhe luftënxitësve të tjerë të çdo kallëpi.

Shokë dhe shoqe sulmues e novatorë,

U zgjata shumë, në fund dua të theksoj se sivjet, si e dini, Partia jonë heroike mbush dhjetë vjet. Dhjetë vjet lufte, përpjekje, heroizma të pashembullta në shër-

bim të popullit tonë. Ajo u hodh në zjarr e në flakë dhe e shpëtoi popullin tonë për jetë nga robëria e rëndë, nga mjerimi. Ajo i dha popullit lirinë, pavarësinë dhe sot e udhëheq me lavdi drejt socializmit në rrugën që i ndrit marksizëm-leninizmi. Për nder të këtij 10-vjetori të madh, të lavdishëm të historisë së popullit tonë, të mobilizohet e gjithë Partia, e gjithë klasa punëtore, e gjithë fshatarësia punonjëse. Mbarë populli ynë, kudo që punon, të hidhet në sulm për realizimin e detyrave që na vë përpara viti i parë i planit tonë pesëvjeçar. Vrulli, entuziazmi, puna të valojë kudo, të kapërcehet plani, të thyhen normat, të rritet rendimenti, të ulet kostua, të bëhen kursime, të shtohet prodhimi, të zhduken të metat, të zhvillohet emulacioni socialist në punë, të zgjerohet dhe të forcohet lëvizja sulmuese, të forcohet ushtria jonë, të forcohen armët e tjera të mbrojtjes së shtetit.

Shokë dhe shoqe, të forcojmë unitetin e popullit rreth Partisë, të çelnikosim dashurinë për Partinë tonë të lavdishme, ta bolshevizojmë atë dhe ta mbrojmë nga armiqtë!

Në fund dua t'ju njoftoj se ne biseduam me shokët dhe vendosëm në qeveri e i propozuam Presidiumit të Kuvendit Popullor të dekorojmë një numër sulmuesish, novatorë e racionalizatorë, për meritat e tyre të shquara në punë, për shërbimet e tyre të mëdha që i kanë sjellë kauzës së popullit dhe të socializmit. Dhe Presidiumi e ka pranuar propozimin tonë. Unë ju uroj nga zemra për fitore të reja të gjithë ju dhe gjithë shokët tuaj.

Rrofshin punëtorët dhe punëtoret sulmues, novatorë e racionalizatorë të vendit tonë!

Rroftë klasa heroike punëtore e vendit tonë!

Rroftë fshatarësia jonë punonjëse!

Rroftë Partia jonë heroike e Punës dhe Komiteti
Qendror i saj!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 53 (758), 3 mars 1951*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**TELEGRAM PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR
KQ TË PP RUMUNE ME RASTIN E 30-VJETORIT
TË THEMELIMIT TË SAJ**

10 maj 1951.

KOMITETIT QENDROR TË PARTISË PUNËTORE RUMUNE

Bukuresht

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe në emrin tim, ju dërgojmë urimet më të përzemërta me rastin e 30-vjetorit të themelimit të Partisë suaj, trashëgimtare e traditave më të mira të popullit rumun, luftëtare e vendosur dhe konsekuente për paqen, demokracinë dhe socializmin.

I udhëhequr nga Partia Punëtore, me ndihmën e çmueshme të Bashkimit Sovjetik, populli rumun ka realizuar suksese të shkëlqyeshme në ndërtimin e jetës së re, në luftën për paqen, demokracinë dhe socializmin që udhëhiqet nga Bashkimi i lavdishëm Sovjetik dhe nga Stalini i madh, kundër nxitësve të luftës, amerikano-nëve, anglezëve dhe satelitëve të tyre.

Partia dhe populli ynë i urojnë Partisë suaj dhe popullit rumun suksese përherë e më të mëdha.

Komiteti Qendror i Partisë
së Punës të Shqipërisë
Sekretari i përgjithshëm

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 111 (816), 10 maj 1951*

*Botohet sipas tekstit të gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 111 (816),
10 maj 1951*

NGA FJALA NË PLENUMIN E JASHTËZAKONSHËM TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH¹

14 maj 1951

Shokë,

Byroja Politike vendosi të thërresë këtë Plenum të Jashtëzakonshëm të Komitetit Qendror, për arsye se do t'i propozojë këtij që të rishqyrtohet prapë vendimi i marrur në Plenumin X për një çështje shumë të rëndësishme që ka lidhje me ekonominë tonë, sidomos me kolektivizimin. Çështja është në lidhje me kooperativat bujqësore. Kjo është arsyeja kryesore, gati e vetmja për të cilën thirret ky plenum.

Byroja kur vendosi të thërriste këtë plenum, kishte plot arsye. Këtë e treguan edhe problemet që u rrahën këtu në lidhje me referatin e paraqitur nga Byroja

¹ Ky plenum shqyrtoi edhe një herë çështjen e kolektivizimit të bujqësisë dhe doli me konkluzionin se orientimi i dhënë për këtë problem nga Plenumi X i KQ të PPSH, mbajtur më 9 dhe 10 prill 1951, nuk ishte i drejtë. Detyra kryesore e kohës nuk ishte zgjerimi i numrit të kooperativave bujqësore, por forcimi i atyre ekzistuese. Plenumi i bëri korrigjimet e nevojshme Rezolucionit të Plenumit të Prillit.

Politike. Ato kishin lidhje me problemet e bujqësisë, një nga problemet më kryesore të vendit tonë. Konstatimet e Byrosë Politike ishin të drejta, pse bujqësia jonë është prapa, fshatarësia nuk është ndihmuar sa duhet, nuk ishin studjuar mirë marrëdhënjet midis fshatit dhe qytetit, pse nuk i ishte dhënë rëndësia e duhur nga Partia e qeveria këtij problemi kaq të rëndësishëm. Prandaj paraqitej urgjente të merreshin një sërë masash si ato që ju parashtuan dhe që vendosi Komiteti Qendror, një pjesë nga të cilat kanë hyrë edhe në jetë.

Por punimet përgatitore të Byrosë Politike kishin edhe një të metë dhe gabim, se në përparimin e bujqësisë, zgjerimi i kolektivizimit shihej si i vetmi mjet dhe, me dashje ose pa dashje, përgatitëm plenumin në këtë frymë. Pra këtu ne u shpejtuan dhe u gabuam. Gabimi ynë bëri që të futej edhe Komiteti Qendror në këtë gabim në lidhje me kolektivizimin. Ju e dini se Komiteti Qendror e ka përcaktuar vijën e Partisë sonë në lidhje me kolektivizimin, prandaj ne tani duhet të forcojmë kooperativat fshatare që ekzistojnë nga ana ekonomike, politike dhe organizative. Ato të bëhen të tilla që, me shembullin e tyre konkret, të tërheqin fshatarësinë në rrugën e kolektivizimit. Ky orientim i Komitetit Qendror nuk ka qenë aspak i gabuar, po i drejtë. Këtë orientim të drejtë ne na e ka dhënë Partia Bolshevike, eksperiencia e madhe e BRSS dhe veçanërisht shoku Stalin me këshillat e tija.

Byroja Politike ka vendosur të bëjë një studim të shumanshëm të çështjes fshatare dhe puna ka filluar. Ky do të jetë një gur themeltar dhe me rëndësi të madhe për politikën e Partisë sonë për zhvillimin më

të drejtë dhe me baza të politikës sonë kundrejt fshatit. Në këtë drejtim po punohet dhe këtu çapat do t'i hedhim më të matur.

Po pse u gabua Byroja Politike, pse u lëkund në këtë direktivë të rëndësishme për ekonominë tonë? Kjo ndodhi për të metat tona, për gabimet dhe për mungesën e kontrollit e të studimit të çështjeve, për mosinteresimin e vërtetë nga ana e Partisë për çështjet e bujqësisë dhe veçanërisht për çështjet e kooperativave. Por megjithëse Partia nuk është interesuar, ashtu si interesohet nëna për djalin e vet, për këto 40-50 a më tepër kooperativa që kemi, ne e shohim që jeta në fshatin tonë ka bërë hapa përpara. Nuk është më ekonomia e parë në fshat, jeta e fshatarit është përmirësuar dhe kooperativat tona ekzistuese janë forcuar dhe ka rezultate konkrete dhe, në barazim me ekonominë private, duket se ka një diferencë. Byroja Politike, duke marrë parasysh këtë fakt, është bazuar në të dhënat e Ministrisë së Bujqësisë përse i përket përmirësimit dhe zhvillimit të kooperativave deri në shkallën që ekzistojnë sot. Mirëpo ka pasur edhe gjëra të tjera që i janë shtuar asaj paraqitjeje dhe këtij koncepti që formoi Byroja Politike që këto kooperativa janë forcuar dhe gjendja në to është përmirësuar. Nga ana tjetër, dëshira që ekziston në fshatarësinë për t'u kooperuar, është një anë pozitive. Por këto nuk duhej të na bënin ne të harrojm fjalët e Leninit se fshatarësia nuk mund të bindet me fjalë që të kooperohet, po me fakte të shohë se, duke bërë këtë, gjendja e saj do të përmirësohet. Po ta kishte analizuar mirë këtë çështje, Byroja Politike nuk do të kishte rënë në këtë gabim, pse dëshira e fshatarëve

tanë për t'u kooperuar nuk ka ardhur nga bollëku i arritur në kooperativat ekzistuese. Edhe çështja e bukës që është një problem i madh, është një arsye që ka influencuar në fshatarësinë. Ne dimë se me një ekonomi private është e zorshme të punohet me një plan të caktuar si duhet dhe të zbatohen planet qind për qind ashtu siç mund të zbatohen në fermat dhe në kooperativat. Por fakti është se si në fermat edhe në kooperativat ne jemi larg situatës që edhe atje planet të realizohen e të tejkalohen. Prandaj për moskujdesinë tonë të mjaftueshme në lidhje me ndihmën që duhet t'i jepnim bujqësisë gjendja e ekonomisë fshatare individuale ka mbetur prapa. Problemi i bujqësisë është i madh për vendin tonë dhe Byroja Politike e di këtë gjë. Por, duke menduar se dalja e vërtetë definitive nga kjo situatë është kolektivizimi, duke u bazuar në pasqyrimin jo aq të thelluar të kooperativave ekzistuese, dhe duke mos gjykuar si duhet situatën politike në ngritjen e kooperativave të reja në fshatra ku ka fanatizëm, prapambetje, shpirt të theksuar individualist në një shkallë të theksuar, siç ndodh që në kooperativën më të mirë — në Maminas, ku ka një frymë që të mos futen të tjerët në kooperativë, duke pretenduar se u pakësohen të ardhurat etj., ne ramë në këtë gabim. Ose mund të ndodhë si në Dobraq të Shkodrës ku kooperativistët, duke pasur të ardhura shumë, nuk i lejojnë gratë e tyre të dalin në punë. Kjo vjen se gjendja ekonomike e tyre është ngritur dhe nga ana tjetër ata janë edhe fanatikë. Por kjo situatë krijohet atje sepse kooperativa ka të ardhura, por po të ishin anëtarët në gjendje të keqe, nuk do t'i largonin gratë nga puna dhe fanatizmin.

do ta kishin luftuar në këtë drejtim. Edhe në Krutje ka mjaft gjëra të kësaj natyre. Kështu, çështja e bukës na bëri të lëkundemi siç ndodhi me vendimin që morëm për kolektivizimin e fushës.

Por në këtë problem ne kemi qenë të influencuar edhe nga përparimi që kanë bërë në këtë çështje demokracitë popullore motra. Shtypi tregon se atje çështjen e kolektivizimit e shtrojnë me forcë të madhe, se atje luftojnë për numrin. Ne me kolektivizimin jemi 3-4 për qind, kurse demokracitë e tjera popullore janë mjaft përpara, 35-40 për qind. Kjo na influenoi mjaft. Mos vallë ne ecëm shumë ngadalë? Jo. Në këtë gjë ne na detyron më shumë çështja e sigurimit të bukës në vend dhe kështu u lëkundëm dhe adoptuam vijën e Plenumit X.

Këto kanë qenë shkaqet që ne u lëkundëm në këtë çështje dhe ramë në këtë gabim. Por gabimi ynë është gjysmëgabim, se po ta kishim zbatuar vendimin, do të bënim një gabim shumë më të madh. Ne e botuam në shtyp rezolucionin, atë e lexoi Partia dhe populli. Sidoqoftë, Byroja Politike, me të drejtë, e ndaloi punimin e Rezolucionit të Plenumit X, sepse duhej bërë ky korigjim në lidhje me kolektivizimin. Po të mos kishte dalë ky, do të ishte më mirë dhe mund të mos kishte dalë në qoftë se do të kishte ardhur një ditë më parë komunikimi im¹, që për arësye teknike u vonua.

Detyra jonë tani është që ta korigjojmë këtë rezolucion, d.m.th. t'i vihet si detyrë Partisë forcimi i

¹ Shoku Enver nuk merrte pjesë në Plenumin X, sepse ndodhej në BS.

gjithanshëm i kooperativave ekzistuese që këto të bëhen shembull për fshatarësinë punonjëse në çdo drejtim; vetëm kështu ajo do të tërhiqet në rrugën e kolektivizimit. Por nuk duhet të shtrohet pyetja të ngremë apo jo kooperativa të reja, pse çështja e kolektivizimit është perspektiva e fshatarësisë sonë, veçse në këtë situatë që jemi, nuk duhet të shpejtohemi, ndryshe komprometohet çështja e kolektivizimit.

Ne çështjen e forcimit të kooperativave e kemi shtruar kurdoherë, vetëm se nuk kemi treguar kujdesin e duhur, se komitetet e Partisë nuk i kanë vënë kujdesin e mjaftueshëm dhe deri diku mund të themi se i kanë lënë në fatin e tyre, në rrugën spontane. Megjithatë ca ndihmë u ka vajtur, por vetëm nga ana e ministrisë, nga ana shtetërore, kurse kujdesi i komiteteve të Partisë dhe i vetë sekretarëve të parë në rrethe për ato pak kooperativa që kanë, duhet të jetë i vazhdueshëm, i madh, i jashtëzakonshëm; kjo është e reja, kjo është rruga jonë për socializimin e fshatit. Unë nuk di ndonjë kooperativë që të jetë bërë shembull për fshatrat e tjera në lidhje me shtimin e prodhimeve në sasi shumë të mëdha dhe as t'u ketë dhënë ndihmë fshatarëve të tjerë, që të shohin si jetojnë e si ushqehen kooperativistët, se si kanë klube etj. Unë nuk di ndonjë rast që kooperativistët, si të kenë mbaruar punën e tyre shpejt, të shkojnë dhe të ndihmojnë fshatarët individualë të një fshati afër, t'u huajnë atyre farë, bukë, vegla që kështu fshatarët individualë të shohin të mirat që sjell kooperativa dhe të shohin si kooperativistët jo vetëm që marrin prodhime më shumë, rrojnë më mirë, kanë klube, kinema, e bëjnë punën më shpejt, por u

japin ndihmë edhe të tjerëve. Pastaj, komitetet e Partisë nuk janë interesuar për jetën kulturele në kooperativat dhe për forcimin e organizatave të Partisë në to dhe të bëjnë që organizata bazë atje të jetë udhëheqësja e kooperativës. Pra, tani detyra e Partisë duhet të jetë forcimi i kooperativave që kemi dhe këto të ndihmohen nga afër. Nga ana tjetër, në rrugën shtetërore, Ministria e Bujqësisë duhet t'u kushtojë një kujdes më të madh kooperativave për përgatitjen e kuadrove më të mirë për ato, për punimin e tokave të tyre me traktorë dhe t'i mësojnë si të seleksionojnë farën, ose t'u jepet atyre fara më e mirë nga ana e shtetit. Shumë favore që kemi vendosur për bujqësinë, t'u bëhen në radhë të parë atyre...

Mua më duket se për çështjen e fshatarësisë, për të cilën u mbledh plenumi, kjo është kryesorja, d.m.th. me i dhënë përsëri orientimin Partisë që në lidhje me kolektivizimin, detyra jonë e tashme është forcimi i kooperativave ekzistuese dhe jo zgjerimi i tyre, d.m.th. jo sasia, por cilësia. Shtimi i shpejtë i numrit sjell rreziqe të mëdha, në rast se ne nuk përgatitim si duhet terrenin dhe nuk hedhim baza të shëndosha për këtë çështje. Dhe ky orientim nuk është vetëm për bujqësinë, po për të gjithë sektorët e tjerë.

Në këtë rezolucion ne kemi bërë edhe disa korrigjime të tjera, që nuk janë të një rëndësie të dorës së parë. Përsa i përket çështjes së planit pesëvjeçar, aty ishte dhënë një perspektivë e shkurtër. Është mirë që atë perspektivë ta japim së toku¹. Këtu është çështja

¹ KQ i PPSH kishte filluar përgatitjet për projekt-direkti-

për disa detyra që i vihen Partisë, që ajo i di, po që duhen përcaktuar mirë, duhen kuptuar e asimiluar si duhet nga vetë ne në krye e pastaj nga gjithë Partia e pushteti.

Cilat janë këto?

Pikësëpari është çështja e misrit. Tani, nga pikë-pamja e jugosllavëve që na thoshnin të hiqnim misrin dhe të mbillnim grurin në kurriz të misrit, ka mbetur pak. Misri është një kulturë që ka leverdi për ne, sepse e ha populli. Ne nuk jemi në gjendje që t'i themi popullit: lëre misrin. Kur e ha misrin dhe i leverdis, le ta mbjellë.

Për çështjen e bimëve industriale dhe në radhë të parë për pambukun, këtë orientim e ka dhënë Komiteti Qendror edhe me referatin e Mehmetit, por përsëri duhet ta theksojmë se pambuku ka një rëndësi shumë të madhe për vendin tonë, sepse ai është flori dhe do të na shërbejë për industrinë që po ngremë. Prandaj duhet të vëmë forca që këtë bimë ta sigurojmë, pse do të jetë antiekonomike të sjellim pambuk nga jashtë për të plotësuar nevojat tona dhe për të vënë në lëvizje industrinë tonë, kur ne i kemi të gjitha mundësitë natyrore që ky të bëhet në vendin tonë. Pra, duhet t'i vëmë rëndësi të madhe pambukut se për ne, për fat të keq, është një kulturë e re që duhet t'i kushtojmë kujdes e punë të palodhur, sepse prodhimet e këtyre viteve nuk kanë qenë të kënaqshme dhe kemi shumë mungesa. Jam dakord që kultivimi i pambukut do edhe specia-

vat e planit të parë pesëvjeçar, që i mori në shqyrtim Plenumi XI, në shtator 1951.

listë, por edhe ne nuk i kemi vënë kujdesin e duhur këtij problemi. Pastaj pambuku është një bimë që do diell dhe ujë. Ne ujëra kemi, por duhet t'i kanalizojmë ato. Në lidhje me këtë dua të kritikoj edhe çështjen e papjekurisë së Ministrisë së Industrisë që thotë se gjoja nuk bën pambuku ynë dhe të sjellim nga BRSS për kombinatin e tekstilit. Kjo s'është e vërtetë. Pambuku ynë, po të kujdesemi seriozisht për të, është i mirë.

Po kështu edhe për çështjen e panxharit të sheqerit ne duhet të vëmë forca që të prodhojmë tërë sasinë që duhet për fabrikën e sheqerit.

Për rëndësinë e ullinjve dhe të agrumeve, megjithëse ne e kemi theksuar që Partia e pushteti t'u vënë rëndësi të madhe këtyre, përsëri duhet të theksojmë që ato janë një pasuri shumë e madhe për vendin tonë, prandaj të punohet më mirë për to.

Përsa u përket gjithë orientimeve të tjera të Plenumit X ato janë të drejta plotësisht, janë direktiva të Byrosë Politike dhe të Komitetit Qendror dhe që duhet të zbatohen edhe në qoftë se përmenden me një radhë në rezolucion, prandaj organet e bujqësisë dhe të Partisë që merren me bujqësi, të bëjnë përpjekje që të zbatohen, të vihen në jetë. Pra, këto direktiva janë të drejta, të domosdoshme për forcimin e ekonomisë sonë. Duhet të kemi parasysh një gjë që ne e kemi ekonominë të dobët dhe kjo sepse ne nuk punojmë mirë për çështjet ekonomike, nuk i kemi vënë kujdesin e duhur, nuk e kemi ndihmuar sa duhet fshatarësinë.

Këto janë ndryshimet që propozon Byroja Politike të bëhen në rezolucion. Për kolektivizimin është një kapitull i gjithë që duhet të ndreqet, prandaj si të

lexohet, po të ketë vërejtje, të bëhet dhe kështu t'i japim fund këtij problemi.

Rezolucionin¹ e Plenumit X ne nuk e rrëzojmë, por i bëjmë vetëm korrigjime, prandaj duhet të lëshojmë edhe një komunikatë, pse rezolucioni i parë është botuar e lexuar nga populli dhe Partia, megjithëse nuk është thënë gjë zyrtarisht. Prandaj në komunikatë të thuhet se këtij ju bënë disa ndryshime. Partisë t'i jepet për t'u punuar rezolucioni i korrigjuar. Që të mos konfondohen njerëzit, po të ketë mundësi, anëtarët e Partisë që e kanë gazetën ku është botuar rezolucioni i parë, ta dorëzojnë dhe të marrin këtë tjetrin. Përveç kësaj këtë rezolucion të korrigjuar, ne mund ta shtypim edhe në broshurë të veçantë, pse do t'i shërbejë mjaft Partisë dhe popullit.

Në radhë të parë anëtarët e Komitetit Qendror dhe të qeverisë, kur del një rezolucion i Komitetit Qendror, duhet ta studjojnë dhe të bëjnë planin e zbatimit për pjesën që i takon secilit, sepse është bërë një zakon i keq, i cili duhet të marrë fund një herë e mirë, që Komiteti Qendror lëshon urdhëra e direktiva dhe ato koncentrohen nga shokët ashtu siç janë të koncentruara. Nuk mund të akuzojmë Byronë dhe Komitetin Qendror se nuk kanë dhënë direktiva, po jemi ne që nuk i kemi zbatuar ato sepse edhe ne, për direktivat e vendosura, flasim ashtu në përgjithësi dhe nuk i zhvillojmë e nuk i detajojmë ato për t'ua bërë më të kuptueshme e më të qarta shokëve.

¹ Fjalët e mëposhtme shoku Enver i tha pas leximit e aprovimit të ndryshimeve në rezolucion.

Tani e kam fjalën në zbatimin e vendimeve që përmban rezolucioni. Në qoftë se nuk merr masa Ministria e Tregëtisë dhe të dërgojë mallra që të kenë ç'të shesin kooperativat e shitblerjes, atëhere na rroftë gazi që këto gjëra po i vëmë edhe në vendime. Po kështu edhe për grumbullimin dhe realizimin e ndërtimeve në kohën e duhur. Prandaj këto gjëra duhen realizuar dhe medoemos duhen realizuar. Ne duhet të jemi të gjerë ndaj shokëve, pse të gjithë nuk jemi njerëz me një eksperiencë të madhe, po edhe nuk mund të themi se nuk kemi fare eksperiencë. Megjithatë edhe gjerësia duhet të ketë një kufi dhe logjikë. Prandaj rezolucioni në Parti të punohet me kujdesin më të madh dhe shokët që do të venë në bazë, ta studjojnë e ta punojnë mirë dhe të flasin për rëndësinë e tij jetike që ka për Partinë. Kështu të veprohet edhe në organizatat bazë dhe të bëhet që të kuptohet drejt vija politike e Partisë në drejtim të fshatarësisë.

Ne jemi përgjegjës përpara popullit dhe Partisë për zbatimin e këtyre detyrave.

*Botohet për herë të parë, sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Plenu-
mit të Jashtëzakonshëm
që gjendet në AQP*

**TELEGRAM PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR
KQ TË PK ÇEKOSLLOVAKE ME RASTIN E
30-VJETORIT TË FORMIMIT TË SAJ**

15 maj 1951

**KOMITETIT QENDROR TË PARTISË KOMUNISTE
ÇEKOSLLOVAKE**

SHOKUT KLEMENT GOTVALD

Pragë

Me rastin e 30-vjetorit të themelimit të Partisë suaj, në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe në emrin tim personal ju dërgojmë përshëndetjet tona më të përzemërta.

Partia jonë e Punës dhe mbarë populli punonjës i Shqipërisë e njohin dhe e çmojnë shumë luftën heroike të Partisë Komuniste Çekosllovake dhe të popullit çekosllovak për çlirimin e Çekosllovakisë nga thundra naziste, për vendosjen e regjimit të demokracisë popullore dhe ndërtimin e socializmit, kundër borgjezisë reaksionare të vendit dhe padronëve të saj imperialistë.

Partia dhe populli ynë urojnë nga zemra që edhe

në të ardhshmen Partia Komuniste Çekosllovake ta udhëheqë me sukses popullin vëlla çekoslllovak drejt fitoreve të reja, për triumfin e kauzës së paqes e të socializmit, flamurtari i së cilës është Bashkimi i lavdishëm Sovjetik dhe shoku i madh Stalin.

Komiteti Qendror i Partisë
së Punës të Shqipërisë

Sekretari i përgjithshëm

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 115 (820), 15 maj 1951*

*Botohet sipas tekstit të
gazetës «Zëri i Popullit»,
Nr. 115 (820), 15 maj 1951*

MINISTRITË TË INTERESOHEN MË SHUMË PËR PLANIFIKIMIN E DREJTË TË INVESTIMEVE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

17 maj 1951

Në pasqyrat që na janë paraqitur për buxhetin shikoj përveç të tjerave se ka dy shifra të ndryshme: shifrat që propozohen nga ministrinë nga njëra anë dhe ato të Ministrisë së Financave nga ana tjetër. Diferenca midis këtyre shifrave është me miliona. Ne kemi thënë se duhet të përpiqemi që disa shpenzime të mos bëhen, me qëllim që të mund të realizohen kursime. Por këto diferencat tregojnë se ministrinë nuk e kanë pasur parasysh këtë gjë. Kjo tregon gjithashtu se llogaritë financiare të planit nuk shihen dhe nuk bëhen me seriozitetin e duhur nga ministrat dhe nga përgjegjësit kryesorë që

¹ Në këtë mbledhje ku u shqyrtuan aspekte të planit të parë pesëvjeçar, u diskutua edhe rreth disa vështirësive që dilnin për realizimin e tij, të cilat kërkonin, përveç të tjerave, edhe forcimin e anës financiare.

kanë në vartësinë e tyre seksionet financiare, të cilët nuk bëjnë sa duhet kontroll mbi njerëzit e financës. Një gjë e tillë ndodh pse ata vetë nuk e kanë kuptuar mirë rëndësinë e anës financiare, kështu që shefat e financës mund të themi se shpeshherë bëjnë si duan. Natyrisht, kjo rrjedh edhe nga pasaktësia e projekteve, të cilat disa herë hartohen me gabime, por kjo nuk duhet të bëhet shkak për të mbuluar neglizhencat e tjera që vërehen në këtë drejtim. Kur bëhet plani, ministrat jo vetëm që duhet t'i kontrollojnë një për një objektet, por ata duhet të shohin medoemos edhe anën financiare të tyre. Po të ishte bërë kjo, shumë gjëra të pavlefshme, porosira të tepërta materialesh etj., do të evitoheshin. Më e keqja është se edhe vetë Komisioni i Planit nuk e sheh thellë anën financiare, për të arritur në përfundim të saktë nëse i intereson apo jo shtetit një investim që propozohet të bëhet. Prandaj edhe ai duhet të nxjerrë mësimet e detyra. Çdo dikaster për investimet që bën duhet të arësyetojë sa kushtojnë, ç'rendimente japin dhe ç'fitime do t'i sjellin shoqërisë objektet për të cilat investohet. Këtë gjë as ministratë dhe as Komisioni i Planit nuk e bëjnë, prandaj me të drejtë këto na vijnë nga ana e Ministrisë së Financave, e cila detyrohet të kryejë një punë shumë të madhe duke bërë edhe llogaritë e dikastereve e të Komisionit të Planit të Shtetit. Kështu që duke mos menduar seriozisht ka diferenca të mëdha midis llogarive që propozon Ministria e Financave nga ato që propozojnë ministratë e tjera.

Një ditë i thashë ministrit të financave se çfarë kundërshtimesh bëjnë ministrat e tjerë për këto ulje që

bëni ju për kursime. Ai më tha se nuk bëjnë kundërshtime. Kjo është shumë serioze. T'i bëhen ndryshime planit financiar të ministrive nga Ministria e Financave dhe të mos ketë kundërshtime nga ana e tyre, do të thotë që në buxhet të caktohen fonde fare të pallogaritura dhe vjen koha që ose dalin teprica fondesh ose kërkohen shtesa të reja, pra, një punë të dalë si të dalë. Të gjitha këto tregojnë se ministrat, kryetarët e degëve dhe shefat e financës në dikastere tërë këtë punë e kanë mbështetur në Ministrinë e Financave. Po kush na siguron ne që duke punuar vetëm Ministria e Financave, mund të bëhen drejt studimet? Ministrinë e tjera nuk duhet ta flenë mendjen për anën financiare dhe të mendojnë se qeveria do t'ua pranojë automatikisht planet financiare, përkundrazi, ato vetë duhet të punojnë e të luftojnë që planet e tyre financiare të jenë sa më të sakta. Qeveria nuk ka mundësi t'i shikojë planet financiare në detaje, po merr vendime globale. Prandaj duhet që ministrat dhe nënkryeministrat të ushtrojnë kontroll të rreptë poshtë. Kur ka dy mendime, natyrisht, ato do të diskutohen në qeveri për të arritur në një mendim të vetëm. Gjithashtu aty mund të diskutohet në mënyrë të veçantë edhe për disa objekte të rëndësishme. Për analogji kështu mund të veprojmë edhe për çështjen e planit. Byroja Politike vendos gjërat kryesore, po çështjet materiale janë në dorën e atyre që bëjnë porosinë, prandaj pa një interesim të vazhdueshëm dhe pa një kontroll të fortë nga dikasteret, nuk mund të ketë as planifikim të drejtë dhe as disiplinë.

Edhe një çështje tjetër. Propozimet nga ministrinë deri tani i janë dërguar Komisionit të Planit dhe prej

andej na kanë ardhur neve. Këtë sistem ne duhet ta ndryshojmë se nuk ja dalim dot, ato duhet të kalojnë më parë në qeveri dhe ajo t'ja paraqesë Byrosë Politike.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

SHËNIME RRETH STUDIMIT «MBI MASAT PËR
SHTIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E BLEGTORISË
GJATË VITEVE 1951—1955»¹

[Maj 1951]

1. — *Studim shumë i rëndësishëm:*

Në këtë studim janë shënuar se çfarë duhet të bëjmë, por mungon kryesorja: cilat janë bazat ekzistuese mbi të cilat do të mbështetemi për t'i bërë këto gjëra.

1) *Kemi deri diku të qartë punën që ka bërë Qendra zooteknike e kërkimeve. Duhet të na bëhet relacion për rezultatet e saj, rekomandimet, propozimet në bazë të eksperiencës. Të na jepen arësyet për çdo gjë që propozohet. Kështu të dimë se kur vendosim të përhapim këtë racë, të jemi të bindur për përfitimet që do të kemi.*

2) *Ç'raca ekzistojnë në Shqipëri? Si janë të shpërndara? Ç'prodhime japin?*

3) *Racat e huaja që s'bazohen në asnjë eksperiment në vend, a janë vënë në relacion dhe ku janë mbështetur studimet që na paraqiten?*

¹ Këto shënime janë përgatitur për të diskutuar rreth studimit të paraqitur nga Ministria e Bujqësisë, të cilin Byroja Politike e mori në shqyrtim më 21 maj 1951.

4) *Shpërndarja e gjësë së gjallë në vendin tonë.*
Si duhet ta rregullojmë këtë anomali.

Cili duhet të jetë orientimi që duhet t'i japim ne blegtorisë në lidhje me përmirësimin dhe zhvillimin e racave të ndryshme: sipas klimës, tokës (mal-fushë-pyll).

- Problemi i deles rudë;
- Problemi i kullotave verore;
- Problemi i kullotave dimërore;
- Problemi i barit të thatë;
- Problemi i ushqimit koncentrat;
- Tufat e shtetit;
- Blegtoria private;
- Tufat e kooperativave;
- Detyrat e fermave shtetërore.

Projektplani ynë a është bërë i lidhur me planin ekonomik të shtetit — në planin e pyllëzimit apo i veçuar?

Në se konsiston ky harmonizim planesh?

Me prodhueshmërinë dhe me nevojat e popullsisë:
qumësht

mish

lesh

vezë

lëkurë

brirë

pendë

mjaltë

kafshë pune

kafshë ngarkese

kafshë për ushtrinë

Se këtej do t'i dalin detyra konkrete:

- Ministrisë së Bujqësisë
- Ministrisë së Industrisë
- Ministrisë së Tregëtisë
- Ministrisë së Grumbullimit
- Ministrisë së Tregëtisë së Jashtme.

Tri orientime:

- 1) Ushqimi i kafshëve dhe fuqizimi i tyre për prodhim më të madh.
- 2) Përmirësimi i racës në përgjithësi dhe veçanërisht i rudës.
- 3) Shtimi i blegtorisë.



1. Bari. Mbrojtja e mirë dhe depozitimi.
2. Jonxha, bimë të tjera foragjere dhe leguminoze. Plan ku do mbillet, si do të koncentrohet. Si duhet të punojnë për grumbullimin, ruajtjen, shpërndarjen e farës.
3. Plan për koncentratet e panxharit dhe të bimëve të tjera industriale.
4. Lendet dhe ushqimet e tjera për derrat, berrat etj.

Ndërtimet për blegtorinë:

Stacionet; të studjohen mirë vendet.

Çdo ndërtim shtetëror dhe kooperativist të jetë i thjeshtë. Kooperativave t'u japim kredi.

Në lidhje me studimin

Si është studjuar rudizimi i bagëtisë?

Si janë nxjerrë përqindjet?

Çfarë masash janë marrë që eksperiencia e Qendrës së studimit të zooteknisë të përhapet.

Qethja dy herë e deleve?

Mjelja tri herë e lopëve?

Pjellja tri herë e dosave?

Shtimi i sipërfaqeve të mbjella me jonxhë etj., si do të bëhet? Ka studim? Ku do të bëhet, përse do t'i japim rëndësi më të madhe? Në ç'krahina, sa kohë? Në kurriz të ç'bime do të mbillen këto toka. Fara e tyre, plani i kësaj a është studjuar?

1) Përse na duhet të marrim në bujqësi si bazë 1938-n? Të marrim për bazë vitin e pasçlirimit, ku ne kemi një statistikë mbi blegtorinë.

2) Vënja në dispozicion e tagjisë është zgjidhja më e lehtë dhe më e zorshme për ta siguruar, por duhet të mendohet për masat e tjera të mundshme.

3) Cilët damazë do të shpërndahen në kooperativat bujqësore dhe cili është plani i ndërtimit të stacioneve të ndërzimit.

4) Cila do të jetë politika dhe masat që duhet të marrë shteti ndaj fshatarëve që këta të zgjedhin damazët për përmirësimin e racës, pse anëtarët e kooperativave bujqësore nuk kanë kafshë në ekonomitë e tyre? Gjendja e varfër.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

BLEGTORIA NUK MUND TË SHTOHET PA SIGURUAR BAZËN E SAJ USHQIMORE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

21 maj 1951

Një nga çështjet kryesore që ne duhet të zgjidhim për shtimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të blegtorisë mendoj se është sigurimi i bazës ushqimore. Që të shtojmë bagëtitë dhe të përmirësojmë racat e tyre, që ato të prodhojnë më shumë mish, qumësht e lesh, del e domosdoshme të sigurojmë në radhë të parë ushqimin e mirë të tyre. Po të marrim masat e duhura si për sigurimin e bazës ushqimore ashtu edhe për përmirësimin e racës, rritja e numrit të bagëtive do të vijë vetëvetiu. Prandaj është e nevojshme që, për çështjen e sigurimit të bazës ushqimore të bagëtive, të bëhet një studim i mirë dhe i veçantë. Një punë e tillë duhet bërë me kujdes dhe me kontroll.

¹ Në këtë mbledhje u shqyrtua studimi «Mbi masat për shtimin dhe përmirësimin e blegtorisë gjatë viteve 1951—1955», paraqitur nga Ministria e Bujqësisë.

Ministria e Bujqësisë duhet t'i ketë mirë në evidencë të gjitha kullotat dhe të llogaritë mirë e në detaje për çdo rajon numrin e bagëtive. Nga këto evidenca, llogari e detajime do të rrjedhin edhe detyra konkrete, si për Partinë edhe për pushtetin. Pa bërë këto, puna nuk do të ecë përpara dhe ne do të mbetemi vetëm në orientime. Edhe baza nga ana e saj duhet të marrë masa për sigurimin e barit të thatë që ka rëndësi të madhe sot për sot për ushqimin e bagëtive, sepse ne nuk mund ta zgjidhim menjëherë këtë problem vetëm me tagji. Po kështu duhet studjuar mirë edhe çështja e sigurimit të jonxhës dhe të koncentreve. Në plan duhet të parashikohet edhe fara e jonxhës, e foragjereve etj., sidomos për malësitë. Me pak fjalë, të gjitha llojet e ushqimeve të bagëtive duhet të studjohen me qëllim që të sigurohen medoemos në të ardhshmen. Ministria e Bujqësisë duhet të bëjë një studim të plotë që të ketë një plan të detajuar për numrin e bagëtive që mund të mbahen me këto rezerva si dhe ç'masa të tjera duhen marrë për të siguruar në të ardhshmen të gjithë bazën e nevojshme ushqimore.

Kujdes të veçantë duhet treguar për lopët, jo vetëm për sigurimin e bazës ushqimore të tyre, por të arrihet deri atje sa të ketë për çdo lopë një pasqyrë, që të tregojë se si është mbajtur ajo, si është mbikëqyrë për kaq vjet, ç'prodhim ka dhënë, si është zhvilluar etj.

Duhet menduar që atje ku ka kullota verore dhe ne akoma nuk kemi ferma shtetërore, të krijojmë bërthamën e një ferme që t'i shfrytëzojmë si duhet edhe këto kullota. Sektori shtetëror i blegtorisë ka detyra të mëdha. Përveç të tjerave ai duhet që me shembullin e

tij të ndihmojë edhe sektorin privat, pse këtu është shumica e blegtorisë së vendit tonë. Prandaj shteti duhet të bëjë një politikë të tillë që edhe bagëtitë e këtij sektori të ushqehen mirë, kjo është çështje kryesore, prandaj të mbahet shumë parasysh nga ana e pushtetit.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TË KUPTOHET DHE TË ZBATOHET DREJT POLITIKA E PARTISË NË LIDHJE ME KUFIZIMIN EKONOMIK TË KULAKËVE

Letër udhëzuese dërguar komiteteve të Partisë në rrethe.

21 maj 1951

KOMITETEVE TË PARTISË NË RRETHE

Dihet se metoda e tatimit individual të kulakut është një nga masat kryesore që merr Partia dhe pushteti për kufizimin ekonomik të kulakut në fazën e sotshme të luftës së klasave në fshat. Por shumë organe të Partisë nuk e kanë të qartë se në ç'masë duhet të tatóhet individualisht kulaku. Për ta bërë të qartë se deri në ç'masë duhet të tatóhet individualisht ai, është e nevojshme të veprohet si më poshtë:

1. — Para se t'i lëshohet fletëdetyrimi kulakut për tatimin në natyrë të detyrueshëm si të gjithë fshatarët e tjerë, duhet të llogaritet sasia që ka mundësi të prodhojë kulaku. Kjo llogari bëhet nga i plotfuqishmi i grumbullimit duke marrë parasysh klasën e tokës së

kulakut dhe sipërfaqen efektive që ai do të mbjellë. Mbi këto kritere llogaritet sasia e drithit që do të mund të prodhojë kulaku. Nga kjo sasi hiqet detyrimi i rregullt ndaj shtetit, lihet buka dhe fara e nevojshme për kulakun dhe nga tepricat reale që i mbeten atij, i merret një pjesë në formë të tatimit individual me qëllim kufizimi. Porse duhet pasur kurdoherë parasysh që llogaritja e tepricave të kulakut duhet të bëhet kurdoherë në bazë të sipërfaqeve reale që mbjell ai dhe jo thjeshtësisht në bazë të kadastrës, pasi mund të ndodhë që një kulak të ketë edhe sipërfaqe të mbuluara me pyll që nuk i mbjell dhe në rast se do të tatóhet edhe mbi këtë sipërfaqe në formë individuale, mund të ndodhë, që atij, për të larë tatimin individual t'i duhet të dorëzojë fondin e bukës dhe të farës, në këtë mënyrë masa e kufizimit kalon në masë likuidimi. Përqindja e tatimit individual mbi tepricat e kulakut caktohet nga vlerësimi i të gjithë fuqisë ekonomike të kulakut dhe kjo përqindje shkon nga 10 deri 75 për qind mbi tepricat reale të kulakut. Duhet mbajtur parasysh se qëllimi i këtij tatimi individual mbi kulakun është për ta kufizuar ekonomikisht atë, për të mos i lënë atij teprica të shumta që të pasurohet, por jo për t'ja marrë të gjitha tepricat dhe për ta detyruar qysh sot që të shpërngulet nga fshati nga kufizimi jashtë masës që mund t'i bëhet. Japim këtu një shembull konkret mbi mënyrën se si tatóhet kulaku individualisht.

Kulaku x, ka 10 ha. tokë¹ të klasit të parë. Nga kjo

¹ Shoku Enver këtë shembull e merr më tepër për lehtësi llogaritjeje, në fakt duhet mbajtur parasysh se sipas ligjit të

sipërfaqe ai ka një ha. pyll, një gjysmë ha. moçal, një gjysmë ha. e ka mbjellë me perime dhe një ha. e ka mbjellë me jonxhë. Kjo sipërfaqe prej 3 ha., në bazë të ligjit përjashtohet nga tatimi. Pjesa tjetër e sipërfaqes është mbjellë: 3 ha. të lashta dhe 4 ha. janë të destinuar që të mbillen misër. Për këto 7 ha. kulaku tatohet si të gjithë fshatarët e tjerë, pa marrë parasysh nëse do t'i mbjellë ose jo të 7 ha. Për t'i lëshuar fletëdetyrimin kulakut për misrin, veprohet kështu: për 4 ha. misër tokë të klasit të parë, kulaku i detyrohet shtetit 18,8 kv. (koeficienti i tatimit për tokën e klasit të parë në misër është 4,7 kv. për ha.; $4 \times 4,7 = 18,8$ kv.). Porse të 4 ha. e këtij kulaku prodhojnë më shumë. Të themi se rendimenti i kësaj toke të kulakut është 15 kv. për ha., siç është parashikuar nga shteti. Atëhere nga 4 ha. kulaku prodhon 60 kv. misër. Po t'i heqim atij detyrimin kundrejt shtetit në masën 18,8 kv., i mbeten 41,2 kv. Kësaj teprice, i heqim bukën dhe farën e kulakut. Të themi se kulaku ka 10 persona në shtëpi. Kështu, për bukë atij do t'i duhen 20 kv. (duke llogaritur normën e rregullt prej 2 kv. për frymë në vit) dhe 4 kv. farë (duke llogaritur normën 1 kv. për ha.), d.m.th. gjithsej kulakut i duhen për bukë dhe farë 24 kv. Po ta heqim këtë sasi nga teprica gjejmë se kulakut i mbeten edhe 17,2 kv. misër. Mbi këtë sasi (teprica reale) ushtrohet tatimi individual. Është e logjikshme që këtij kulaku t'i marrim 10 kv. të tjerë përveç tatimit të rregullt. (Kjo masë

reformës agrare, si rregull, çdo ekonomie i lejoheshin 5 ha. tokë, kurse vetëm familjeve të mëdha u bëhej një shtesë e vogël për çdo kurorë.

tatimi, siç u tha, bëhet duke vlerësuar të gjithë fuqinë ekonomike të kulakut). Në këtë mënyrë fletëdetyrimi i lëshohet kulakut për 28,8 kv. misër (18,8 kv. që është tatimi i detyrueshëm dhe 10 kv. që është tatimi individual). Në rast se parashikohet që kulaku mund të prodhojë përmbi 15 kv. për ha., atëhere masa e tatimit individual shtohet dhe në rast se parashikohet të prodhojë më pak, pakësohet. Porse duhet pasur parasysh që sasia e bukës të mos i zbritet dy herë kulakut, të mos i zbritet edhe për misër edhe për grurë, por t'i zbritet vetëm për misrin, ndërsa fara zbritet për të gjitha prodhimet. Ky shembull duhet të vlejë si orientim i përgjithshëm dhe jo të merret në mënyrë mekanike.

2. — Në ato raste ku llogaria e mësipërme nuk është bërë me kohë dhe tatimi individual nuk është shënuar në fletëdetyrimet që janë lëshuar, kulakut i lëshohet fletëdetyrimi tjetër për tatimin individual. Porse duhet të bëhet rregull që fletëdetyrimi, si për tatimin e rregullt, ashtu edhe për tatimin individual, duhet të bëhet një herë e mirë, me anën e një fletëdetyrimi.

3. — Duhet mbajtur parasysh se tatimi individual i imponohet kulakut jo vetëm për misrin dhe grurin, por për të gjitha drithërat që taten dhe jo vetëm për drithërat, por edhe për prodhimet e tjera që taten, si mishi, fasulja, veza, leshi. Tatimi individual në këta artikuj bëhet po me kriterin e mësipërm, duke llogaritur tepricat reale të kulakut. Kulakut i hidhet tatimi individual edhe me rastin e tatimit të ekonomisë bujqësore (tatimi financiar).

Në këtë mënyrë duhet të veprohet për tatimin

individual të kulakut. Për çdo paqartësi, komitetet e rretheve duhet të kërkojnë shpjegime në aparatën e Komitetit Qendror.

Sekretari i Përgjithshëm i PPSH

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**MBI TË METAT DHE DOBËSITË NË PUNËN E
KOMITETIT TË PARTISË DHE TË DREJTORISË SË
KOMBINATIT TË NAFTËS «STALIN»**

24 maj 1951

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

Në punën e Kombinatit të naftës «Stalin» ka shumë të meta, faje dhe përgjegjësi. Nuk është nevoja të futem në të gjitha hollësitë e tyre, sepse raporti që na u paraqit dhe diskutimet që bënë shokët e Byrosë Politike janë mjaft të qarta, kurse ekspozetja që na bëri këtu Pajo Islami nuk është e mirë.

Gjendja në Kombinatin e naftës nuk është e panjohur për ne, tani duhet të nxjerrim shkaqet e vërteta

¹ Në këtë mbledhje, që zgjati nga 22—24 maj, në bazë të raportit të paraqitur nga një grup shokësh të KQ të PPSH që ishin ngarkuar të studjonin situatën e krijuar në Kombinatin e naftës «Stalin», u analizuan thellë të metat dhe dobësitë në punën e komitetit të Partisë dhe të drejtorisë atje. Në fund shoku Enver Hoxha dha konkluzionet dhe u caktuan masat përkatëse për përmirësimin e situatës.

të kësaj gjendjeje jo të mirë. Unë dhe gjithë shokët e tjerë të Byrosë Politike kemi arritur në konkluzionin se për gjendjen e krijuar në Kombinatin e naftës kemi edhe ne faj, pa shkuar shumë larg në vitet 1945 e 1946 dhe pa folur për punën armiqësore të jugosllavëve dhe të Shyqri Këllezit, por sidomos për periudhën pasi morëm masat e reja. Kemi faj më duket mua, pse masat që morëm atëhere nuk i kemi konkretizuar si duhet. Atje ne kurdoherë kemi vuajtur për çështje organizative dhe teknike. Organizimi i punës në këtë kombinat duhej të ishte bërë nga lart e Partia të forcohej organizativisht për të përmirësuar gjendjen, gjë që nuk e kemi bërë mirë deri në fund. Për shembull kur ishte drejtor Shyqriu, ne e pamë që drejtoria e kombinatit pothuajse nuk ekzistonte, ajo nuk ishte në gjendje të drejtonte dhe kjo për gabimet e ish-drejtorit. Por ne nuk e kemi marrë seriozisht organizimin e drejtorisë së kombinatit, nuk ja kemi vënë këtë si detyrë kryesore ministrisë dhe t'i kërkonim llogari asaj për këtë problem. Pa një drejtori të fortë, nuk mund të ecin përpara punët në Kombinatin e naftës. Këtë gjë ne duhet ta bëjmë dhe do ta bëjmë medoemos dhe me këta kuadro që kemi. Prandaj të caktojmë sa më shpejt kuadrot e nevojshëm, t'u shpjegojmë atyre veçanërisht dhe qartë kompetencat dhe detyrat e tyre dhe të bëjmë që të ngrihet autoriteti i drejtorisë, i cili nuk ka ekzistuar dhe akoma nuk ekziston. Po të mos kemi një drejtori të fortë, ne nuk mund të kemi një punë me rezultate të mira, një punë të organizuar; të mos lëmë që njerëzit të bien në pozitë antiparti të Pajo Islamit, i cili nën maskën se drejton Partia, punon sistematikisht për të

prishur punë dhe për të mos drejtuar as Partia dhe as drejtoria e kombinatit. Partia atje duhet të kërkojë me këmbëngulje që drejtoria e kombinatit të jetë e organizuar dhe e fortë dhe të realizojë plotësisht planin e naftës. Për këtë qëllim duhet që atje të mobilizohet e gjithë Partia.

Gabimi tjetër i ynë është se akoma Kombinati i naftës nuk është organizuar në baza «hozrashoti». Deri më sot puna atje është organizuar në mënyrë të shturur. Ky është një faj i rëndë, aq më tepër për Ministrinë e Minerave, së cilës duhet t'i tërheqim vëmendjen për këtë neglizhencë. Mungesat në organizimin e punës së kombinatit janë një nga plagët kryesore të tij, pse me këtë çorganizim atje nuk mund të ecet përpara, ndërsa me një punë dhe organizim të mirë, ne do të bëjmë që në këtë kombinat të rriten edhe kuadro të rinj, për të cilët ka nevojë ekonomia jonë. Pra, duhet t'i organizojmë sa më parë këto ndërmarrje ashtu sikurse janë organizuar edhe ndërmarrjet e sektorëve të tjerë ekonomikë.

Këto dy gjëra: forcimi i drejtorisë së kombinatit dhe organizimi i ndërmarrjeve në baza «hozrashoti», janë dy detyra që ne duhet t'i zbatojmë sa më parë dhe të vendoset kudo rregulli dhe disiplina shtetërore, të mos ngatërrohet dhe të mos konfondohet disiplina e Partisë dhe e shtetit se ato janë një dhe të pandara. Punëtorët dhe çdo shok tjetër në Kombinatin e naftës, jo vetëm duhet të kenë respekt për drejtorinë, por edhe për drejtuesit e drejtëpërdrejtë të tyre.

Përveç këtyre detyrave që thashë më lart ne duhet të plotësojmë sa më parë me kuadro vendet vakante

dhe t'u caktojme atyre kompetencat. Kuadrin që kemi, duhet ta mësojmë e ta ndihmojmë dhe të rishikojmë shpejt masat konkrete që duhet të marrim për trajtimin e furnizimin e mirë të tij. Deri tani jemi tërhequr nga momentet dhe konfuzioni që ka ekzistuar atje. Masat që kemi marrë deri tani për edukimin e kuadrit kanë qenë të rastit dhe në këtë drejtim nuk është punuar në mënyrë sistematike. Prandaj këtej e tutje edukimin e kuadrove duhet ta marrim seriozisht. Vetë puna më e organizuar, forcimi i disiplinës, përpjekjet që do të bëjnë kuadrot për realizimin e planit, të gjitha këto përbëjnë një edukim në punë e sipër të kuadrit, i cili atje mëson maqinën dhe bëhet zot i punës së tij. Por edhe organizimi i shkollës dhe i kurseve ka një rëndësi të madhe për ngritjen e kuadrit. Këto ne mund t'i bëjmë me forcat tona dhe t'i ndjekim deri në fund, sepse kështu ne fillojmë të përgatitim specialistë për të cilët kemi shumë nevojë. Të mos pretendojmë të bëjmë programe të mëdha, po të punojmë në bazë të forcave dhe mundësive që kemi, ndërsa më vonë, mund të hapim edhe ndonjë shkollë për degë të tjera të naftës.

Gabimet që ekzistojnë në Kombinatin e naftës, siç thuhet edhe në raportin që na paraqitet nga aparati i Komitetit Qendror, nxjerrin mirë përgjegjësinë e udhëheqjes së Partisë atje dhe personalisht të Pajo Islamit.

Unë kam ardhur në konkluzionin se puna dhe pikëpamjet e Pajo Islamit, mosbindja ndaj vendimeve të Komitetit Qendror, e kanë burimin te mendjemadhësia e tij. Pajua e sheh Partinë nën prizmin e pikëpamjeve të tija të gabuara. Ai ka punuar që Partia atje të mos ecë në rrugën e saj, po në rrugën e koncepteve të tij

duke krijuar kështu një situatë jashtëzakonisht të vështirë në Kombinatin e naftës.

Nga ana e Komitetit Qendror, Pajos ndihma i është dhënë si në mbledhjet që e kemi thirrur këtu ashtu edhe nga vajtja e shokëve të Komitetit Qendror atje, në vend. Ai ka punuar që Partia të mos jetë udhëheqëse e gjithë punës në kombinat, po përkundrazi, ajo të drejtohet nga Pajo. Nën maskën e autoritetit të Partisë ai kërkon që Partinë ta përdorë për punën e tij, ta ketë në këmbët e tija dhe nuk vepron që ajo të jetë në krye të situatës në Kombinatin e naftës. Partia atje, që nga organizata e deri në komitet e në byronë e tij, duhet të jetë në krye të punës, përndryshe, në vend të autoritetit të vërtetë të Partisë, krijohet një autoritet fals, autoritet frike, si ai që ka krijuar Pajua, i cili këtë gjë e ka bërë për të ruajtur pozitat e tija. Thuhet se në kombinat drejton Partia, por në fakt nga analiza del se ky është një drejtim formal.

Në drejtimin e punës së Kombinatit të naftës vihet re një konfuzion dhe anarki saqë njëri flet dhe tjetri nuk e dëgjon. Atje edhe në Parti ka punë burokratike. Një njeri i tillë «autoritar», si Pajua, që mbyl kritikën dhe që në veprimet e tij tregon se është burokrat, bën tamam një punë trockiste. Puna që ka bërë Pajua në Kombinatin e naftës «Stalin» na ka dëmtuar kuadrin, na ka demoralizuar shumë njerëz të mirë. Këto rrethana i kanë detyruar disa shokë atje që të gabojnë, por gabimet e tyre janë të ndreqshme.

Pajua nuk e ka marrë aspak me seriozitetin e duhur vajtjen e shokëve të Komitetit Qendror për të parë e analizuar punën e kombinatit. Ai nuk e kupton këtë si

ndihmë, përkundrazi, e merr si persekutim ndaj tij nga ana e Komitetit Qendror.

Ekspozeja që na paraqiti Pajo Islami nuk ishte gjë tjetër veçse një mbrojtje e vetes së tij dhe njëkohësisht akuzë për të tjerët. Ai ka dy vjet që punon në kombinat dhe nuk na tha asgjë të re dhe këtë e bën sepse ai nuk do që ne të nxjerrim shkaqet e vërteta të mosrealizimit të planit. Ai ka ardhur përpara Byrosë Politike me paramendim që të fshehë gabimet dhe të shpëtojë nga kjo situatë e rëndë që është krijuar atje, për të cilën ai është përgjegjës. Ne jemi në gjendje të kuptojmë se Pajua, duke folur këtu me të shkruar, ka menduar më përpara se «unë do të mbrohem» se «unë nuk kam gabime» dhe se «gabimet i kanë të tjerët, ndërsa unë kam punuar mirë». Ardhja këtu me koncepte të tilla e rëndojnë më shumë fajin e Pajo Islamit dhe vetë komitetin e Partisë të Kombinatit, i cili duke rënë nën influencën e plotë të Pajos dhe të gabimeve të tij nuk ka drejtuar si duhet punën e Partisë në kombinat.

Është karakteristike dhe serioze se atje pothuajse është shuar entuziazmi te punonjësit. Në një situatë kaq të sëmurë, ku armiku ka bërë punën e tij, entuziazmin e duhur në punonjësit nuk mund ta rikthejmë shpejt, në rast se ne nuk e shëndoshim sa më parë gjendjen. Prandaj, përveç të tjerave, ne duhet të ngarkojmë edhe shokë të Byrosë Politike, të cilët ta ndjekin vazhdimisht forcimin e punës në kombinat dhe në komitetin e Partisë, ku ne duhet të marrim disa njerëz të rinj, që të luftojnë për t'i zhdukur të gjitha gabimet që janë vërtetuar deri tani dhe të shpëtojë Partinë atje dhe masën e punëtorëve nga fryma e rëndë që është krijuar.

Byroja Politike ka arritur në konkluzion se shkak u gjithë dobësive që ekzistojnë në Kombinatin e naftës është dhe rëndon në drejtuesit e komitetit të Partisë dhe në radhë të parë përgjegjësia bie mbi Pajo Islamin si sekretar i parë. Byroja Politike ka bërë disa herë analiza për punën në këtë kombinat, shumë herë Pajos i është tërhequr vërejtja nga ana e Komitetit Qendror për punën e dobët atje. Po të gjitha këto atij nuk i kanë shërbyer. Përkundrazi në kombinat situata ka vajtur gjithnjë duke u keqësuar dhe nga ana e Pajos janë manifestuar shfaqje që janë të rrezikshme:

Pikësëpari ai nuk ka sa duhet besim në udhëheqjen e Partisë, në Komitetin Qendror dhe këtë nuk e them kot. Mundet që ai e bën këtë me ndërgjegje ose pa ndërgjegje, po fakti është se besimi i tij ndaj Komitetit Qendror nuk është i plotë. Të gjitha këto kritika që i janë drejtuar Pajos nga Komiteti Qendror, duhet ta kishin shkundur, ta bënë atë që të njihte më afër gabimet e tij dhe të arrinte që të ndreqte situatën në komitetin dhe në të gjithë organizatën e atjeshme të Partisë. Po ai këtë s'e ka bërë. Duke gjykuar punën e Pajos mbi këtë bazë, ne kemi të drejtë të themi se ai është mendjemadh, egoist, njeri që ka përçmim për të tjerët. Dhe në këtë rrugë atë e çojnë pikëpamjet e tija. Partia i ka analizuar shumë herë këto çështje, por atij nuk i kanë bërë përshtypje.

Ti, Pajo, the se ke punuar me shokët e komitetit të Partisë, i ke ndihmuar e kritikuar ata, po ata nuk të paskan mbështetur. Ç'do të thuash me këtë? Mos do të thuash që ata të të mbështetin për çdo gjë që mendon e thua ti? Kjo nuk është e drejtë. Të kërkosh që shokët

të të mbështetin në çdo veprim tëndin, sido që të jetë ai, është karakteristikë e një megalomani që do të sundojë mbi të tjerët, jashtë rregullave të Partisë. Megalomania jote ka sjellë që shokët e atjeshëm të mos flasin, se kanë pasur frikë prej teje; kështu duhet ta analizosh problemin dhe jo të thuash se «nuk më mbështetin mua». Po, ata nuk flasin, pse ti atje ke krijuar një gjendje të atillë jo të shëndoshë që ata nuk guxojnë të të kritikojnë. Ky është një faj i rëndë i yti.

Në komitetin e Partisë ka edhe shokë të mirë, po në situatën e krijuar prej teje nuk kanë folur, pse, veç të tjerave, ti atje ke krijuar edhe një familjaritet të sëmurë. Në komitet ka disa shokë që janë më të preferuar nga ana jote dhe ata nuk kritikohen për gabimet e tyre, ose kritikohen më lehtë. Ky dallim që ke bërë në shokët e komitetit ka dëmtuar punën e Partisë atje, gjë që ti nuk e pranon dhe kjo vjen pse ke pikëpamje, që në praktikë të çojnë në drejtim të kundërt me vijën e Partisë. Këtë gjë ti duhet ta realizosh mirë.

Te ti, Pajo Islami, ka shturje, ti nuk ke besim as në komitetin e Partisë, në shefat e sektorëve dhe as në brigadierët. Ky mosbesim që ke krijuar ti për shokët ka sjellë situatën që është krijuar atje. Natyrisht, në një situatë të tillë nuk mund të ketë zhvillim dhe forcim të jetës së Partisë.

Të gjitha këto metoda pune, sjellje dhe pikëpamje të tuat me siguri e kanë penguar dhe e pengojnë punën. Ti thua se Partia atje ka bërë përparime; po, Partia ka bërë patjetër përparime dhe ajo që është realizuar atje, është bërë nga Partia, po metoda burokratike e punës tënde, që është tipike për njerëz, të cilët nuk

mund të rrojnë dot me rregulla, frymë dhe disiplinë të Partisë ka sjellë dëme serioze. Puna që ke bërë ti është një punë burokratike dhe këtë e tregojnë faktet dhe një nga këto është që ti ke kërkuar që të bëhen mbledhje për mbledhje. Pyetjes së shokëve, se çfarë masash janë marrë për thyerjet, avaritë e dëmtimet e ndryshme, ti nuk ju përgjegje drejt; fakti është se atje nuk është marrë asnjë masë në këtë drejtim. Jo vetëm kaq, po edhe atëhere kur drejtorja ka vendosur të marrë masa, komiteti i Partisë i ka kundërshtuar. Atëhere ç'bëri Partia? Si është e mundur që ajo të shkojë në kundërshtim me drejtorinë? Si është e mundur të hidhen poshtë urdhërat? Çfarë ndihmë i është dhënë drejtorisë së kombinatit për realizimin e planit? A nuk është gabim i rëndë të kërkosh që shokët e Partisë të bëjnë mbledhje brenda kohës së punës dhe, për më keq, pa u marrë vesh me drejtorinë? Këto forma pune sistematike, që nuk i shërbejnë aspak realizimit të planit, bëhen për të hequr njerëzit nga puna dhe për t'i bërë ata që t'u binden formave të tua burokratike. Ti bërtet se drejtori i kombinatit merr drejtimin e punës së Partisë. Po çfarë është drejtori ose çdo shok tjetër përpara Partisë dhe forcës së saj? Me këtë punë ti mbron tezën se «Partia drejton», por kështu si ke punuar ti, jo vetëm që Partia nuk drejton, por lihet shteg që njerëzit të demoralizohen e të flasin poshtë e përpjetë. Format dhe metodat që ti ke përdorur dhe që i quan se janë në rregull nuk e kanë forcuar Partinë, po përkundrazi, e kanë dobësuar atë. Puna jote është në rrugë të gabuar dhe kundër Partisë.

Pastaj është edhe çështja e zbatimit të metodave të

reja sovjetike në punë. Ti erdhe nga Bakuja dhe fole për BRSS. Po Partia nuk na mëson që të kënaqemi vetëm duke folur për BRSS, po të punohet konkretisht për të zbatuar eksperiencën e Bashkimit Sovjetik dhe të Partisë Bolshevike. Ti e kundërshton dhe e përbuz eksperiencën sovjetike. Ti nuk ke ardhur në atë shkallë sa ta thuash hapët këtë gjë, po duke nënvleftësuar eksperiencën sovjetike, ti tregon në praktikë se je kundër metodave të reja. Këto janë shfaqje antisovjetike, megjithëse ti nuk thua se je kundër BRSS, po faktet këtë tregojnë. Ti mundet edhe të mos jesh kundër brigadës së V. A., po derisa nuk punon që Partia të mobilizojë të gjithë njerëzit për ta përhapur këtë eksperiencë, nuk je si duhet në rregull. Ti nuk ke bërë asnjë përpjekje për të vënë në zbatim ato që përfitove kur ishe në Baku.

Te ti vihen re tendenca të rrezikshme, të cilat manifestohen edhe në disa njerëz të tjerë që janë atje. Një nga këto është dhe ajo me goditë njerëzit e rinj, gjë që është karakteristikë e punës tënde. Njerëzit mundet edhe të gabojnë, po duhet me u sjellë në rregull me ta, me i matë gabimet e tyre dhe jo t'i demoralizosh. Tendanca jote është se ata, që nuk janë dakord me mendimet e tua, ose përpiqesh t'i bësh që të mendojnë edhe ata siç mendon ti, ose i cilëson se nuk janë elementë të mirë. Këto janë gabime të rënda nga ana jote.

Gjithashtu edhe komiteti i Partisë nuk ka punuar mirë. pse nëse sekretari i Partisë mund të jetë i keq, është komiteti i Partisë ai që duhet t'i vërë fre atij dhe ose ta sjellë në rrugën e drejtë të Partisë, ose t'i thotë: «Shko gjetkë, në një punë tjetër, pse nuk mund

të lejohet që sekretari i parë i komitetit të Partisë të veprojë si të dojë». Por komiteti i Partisë ka vepruar ashtu sikurse e ke mësuar ti dhe prandaj kanë faj edhe disa shokë të tjerë të komitetit.

Komiteti i Partisë duhet ta dojë sekretarin e parë, kur ai punon mirë, po kur punon keq, duhet t'i tregojë vendin. Ti ke krijuar vështirësi të mëdha në punën e organizatës së Partisë atje, shthurje disipline, anarki e frikë në njerëzit. Natyrisht, kur shokët e kombinatit të marrin vesh masën që do të marrë Byroja Politike për ty, patjetër që kritika dhe autokritika nga ana e të gjithë punëtorëve do të shpërthejë e fortë. Kjo do të jetë një shtytje e madhe si për ndreqjen e të metave, ashtu edhe për realizimin e planit. Kjo do t'i kalitë komunistët dhe punonjësit atje, po puna është që të mos ishte krijuar kjo situatë.

Të gjitha këto gabime të së kaluarës duhet të na shërbejnë për të ardhshmen. Ne i shohim gabimet e Pajos, po nuk e hedhim poshtë, përkundrazi do të përpiqemi që ta shpëtojmë, ashtu sikurse jemi përpjekur për të shpëtuar çdo kuadër tjetër që ka gabuar. Por ta ketë të qartë se në rast se ai nuk do t'i realizojë këto gabime të rënda, ai nuk ka për t'u ndrequr. Prandaj, si komunist, ai duhet të mendojë e të thellohet mirë. Dhe ne këtë duam që ai të ndreqet dhe do të bëjmë çmos që ta ndreqim. Po në rast se ai nuk do t'i kuptojë gabimet e tij, ka për të shkuar në gabime edhe më të rënda, pse armiku nuk fle, por punon, ai i ka analizuar njerëzit dhe atje ku mundet, lëshon ganxhat e tija. Armikut i bëhet puna kur shikon se politika e Partisë në një sektor nuk vihet në zbatim dhe ai mendon: «Pajua nuk është

njeri i rrezikshëm për mua, ashtu sikurse është V. A.».

Për armikun, V. A. dhe brigada e tij janë me të vërtetë të rrezikshëm, sepse janë përkrahës të së resë, luftëtarë të realizimit të politikës së Partisë, kurse Pajua është më pak i rrezikshëm për të, bile i lëkundur ose i predispozuar, prandaj i hedh ganxhën. Në rast se ti Pajo, nuk do t'i realizosh këto gabime, do të përfundosh keq, armiku do të të kapë në rrugë, përkundrazi në rast se ti i realizon, nuk ka se çfarë të të bëjë. Mos pandeh se armiku do vijë të të flasë kundër Partisë. Jo, ai ka gjithfarë mënyrash si t'i kapë njerëzit. Dhe një njeri që nuk i realizon gabimet, bie lehtë në prehërin e tij. Prandaj gabimet e rënda që të përmenda t'i kuptosh mirë dhe ta ndjesh thellë se sa shumë e kanë dëmtuar punën e Partisë dhe që kanë qenë një nga arësyet kryesore që në Kombinatin e naftës është krijuar një situatë kaq e rëndë dhe që plani atje nuk është realizuar.

Ne shohim se në kombinat na ndodhin avari dhe sabotime jo vetëm në maqineritë e vjetra, po edhe në të rejat. Kjo tregon se atje armiku vepron. Por sikur të ishte mobilizuar si duhet Partia, puna do të kishte shkuar mirë; po të ishte ajo në pozita luftarake, në kombinat armiku nuk do të kishte se ç'të bënte. Por Partia nuk është vënë në pozita të tilla; ajo do t'i kishte kapërcyer të gjitha këto vështirësi shumë të mëdha dhe plani do të kishte shkuar përpara, po të që se nga drejtuesit e Partisë atje do të ishte punuar brenda rregullave të Partisë, por nuk është vepruar kështu dhe për këtë përgjegjësi të madhe ka në radhë të parë Pajua dhe Komiteti i Partisë i Kombinativit të naftës.

Byroja Politike ka arritur në konkluzion dhe është

e bindur se në Kombinatin e naftës ka anëtarë partie të mirë, ka punëtorë heroikë, ka kuadro me vlerë që janë në gjendje të drejtojnë dhe që kanë besim te Partia e që punojnë me të gjitha mundësitë për të. Këto janë forcat që do ta përmbysin në dobi të punës situatën në kombinat, pse përveç të metave teknike dhe gabimeve organizative, atje ka baza mjaft të shëndosha për ta përmirësuar shpejt gjendjen sado që gabimet e Pajos dhe të komitetit të Partisë e kanë dëmtuar punën në kombinat. Gjithashtu Komiteti Qendror do të vërë të gjitha forcat që kjo frymë e sëmurë të zhduket, që gjithë punonjësit të hidhen me vrull përpara dhe që komiteti i Partisë dhe drejtoria e kombinatit të kuptojnë mirë detyrat e tyre.

Lidhur me të gjithë punën në kombinat, Byroja Politike ka marrë edhe masa. Këto masa janë: Së pari, të shpërndahet komiteti i Partisë i kombinatit për gabimet që ai ka lejuar të bëhen, dhe për përgjegjësitë që ka në lidhje me këto gabime. Së dyti, ti Pajo Islami, të shkarkohesh nga detyra e sekretarit politik të Komitetit të Partisë të kombinatit dhe njëkohësisht të të jepet vërejtje me shënim në kartën e regjistrimit dhe për tre vjet rresht të mos kesh të drejtën për të mbajtur një vend drejtues në Parti¹. Ky dënim duhet të të bëjë që të ndreqesh dhe jo të të vrasë. Duhet të reflektosh dhe të mendosh se ky dënim nuk është as i rëndë e as i lehtë, po në bazë të gabimeve që ke bërë, dhe ky nuk është një gabim i parë i yti dhe vërejtja e parë që të hiqet

¹ Pajo Islami për veprimtari antiparti në maj 1956 u përjashtua nga Partia.

për këtë çështje. Ti i ke përsëritur dy-tri herë këto gabime. Megjithkëtë Byroja Politike është treguar zemërgjerë edhe këtë radhë, pse ka shpresë se ti do të ndreqesh. Duhet të reflektosh dhe të bësh autokritikë, pse pa bërë një autokritikë të sinqertë, do të biesh përsëri në këto gabime. Ti ke nevojë që të ndreqesh dhe Partia atë dëshiron. Byroja Politike ka dhënë porosi që të të gjejnë shpejt një detyrë të përshtatshme dhe atje të japësh prova konkrete se i ke ndrequr gabimet dhe pikëpamjet e tua të shtrembra.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TË NDIHMOHET MË SHUMË ORGANIZATA E GRUAS

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

1 qershor 1951

Organizata e gruas në punën e saj ka suksese, por ka edhe të meta, të cilat duhen luftuar. Partia dhe vetë organizata e gruas duhet të kenë parasysh që punën kryesore ta përqëndrojnë në fshat, pse atje është forca më e madhe e grave dhe atje ka më shumë fanatizëm e zakone të tjera të këqia, që, siç dihet, e pengojnë mjaft gruan të zhvillohet, të përparojë e të marrë pjesë në prodhim. Gruaja në fshat është gjysma e popullatës që banon atje dhe po të marrë pjesë si duhet në bujqësi, jo vetëm që ajo vetë do të përparojë, por njëkohësisht do të shtohet dhe prodhimi.

Më ndryshe është në qytete. Këtu gruaja ka më

¹ Në këtë mbledhje midis çështjeve të tjera u diskutua edhe për punën me organizatën e gruas dhe detyrat e saja, sidomos në fshat.

shumë mundësi të futet në punë dhe është në kontakt me njerëz më të zhvilluar e më të kulturuar.

Organizata e gruas ka detyra të mëdha politike, që duhet t'i kryejë sidomos në luftën kundër zakoneve prapanike. Por, sipas mendimit tim, problemi i emancipimit të gruas nuk mund të zgjidhet po qe se ky nuk bëhet problem kyç i gjithë Partisë dhe i pushtetit, po nuk e kuptoi vetë Partia se ajo në radhë të parë duhet të interesohet edhe për gruan, që atë ta përkrahë, ta futë në prodhim, të ngrihet e të zhvillohet. Organizata e gruas vetëm nuk mund t'i bëjë këto gjëra pa ndihmën e Partisë. Kjo ndihmë nuk duhet të kuptohet që të dërgohen një ose dy anëtare partie për të mbajtur konferenca me gratë, detyra e Partisë është që vendimet e saj e ligjet e shtetit për gruan, të zbatohen dhe të mos lejohet në asnjë mënyrë shkelja e tyre si nga ana e organeve të pushtetit ashtu dhe nga organizatat profesionale. Këtu janë vënë ligje, atëhere përse nuk zbatohen këto? Janë marrë vendime që të krijohen kopshte, atëhere përse nuk zbatohen?

Organizata e gruas duhet të bëjë propagandë në masat e grave për t'i nxitur ato të venë në punë, t'u flasë kundër fanatizmit, prapambetjes, kundër lindjeve primitive, mirëpo të gjitha këto, po nuk qe mbështetja e Partisë dhe e pushtetit, nuk mund të realizohen. Dhe ky problem nuk është marrë seriozisht përderisa ka njerëz në Parti që e nënvleftësojnë organizatën e gruas. Të kemi parasysh që gruaja duhet të ndihmohet, jo për filantropi, po pse kështu është vija e Partisë, pse pa gruan nuk mund të ecet, pse ajo është një forcë e madhe. Prandaj unë them t'i vëmë detyra më konkrete Partisë

dhe organeve të pushtetit për realizimin e politikës së Partisë në lidhje me trajtimin e gruas. Po në radhë të parë ne duhet të punojmë që shokët drejtues dhe var-tësit e tyre ta kuptojnë mirë se çështja e gruas është me rëndësi të madhe politike dhe ekonomike.

Përsa u përket kurseve të edukimit të grave, ato janë punë që duhet t'i bëjnë Ministria e Arësimit dhe ajo e Shëndetësisë e jo të mbeten vetëm në dorë të organizatës së gruas. Kjo mundet dhe duhet të ndihmojë për pjesëmarrjen e grave në këto kurse.

Këshillat e grave në fabrika e ndërmarrje duhet të mos mbeten formale, po të aktivizohen dhe për to të interesohen më shumë jo vetëm Partia, por edhe bashkimet profesionalc. Ka raste që interesimi nga njerëzit tanë bëhet në forma sentimentale. Ka moskujdesi të mëdha në lidhje me çështjen e pjesëmarrjes së gruas në prodhim. Ka sektorë si ai i tregëtisë, ku duhet të jenë akoma më shumë gra, pse ato janë më të ndërgjegjshme dhe më të pastra, prandaj në këtë sektor, ku ka mundësi të hiqen burrat dhe në vend të tyre të vendosen gra. Të gjitha këto duhet t'i ketë shumë parasysh Partia me qëllim që organizata e gruas të ndihmohet më tepër.

Përsa i përket bujqësisë në fshat, gruaja ka disa detyra të rëndësishme. Prandaj në kurset agroteknike duhet të marrin pjesë sa më shumë gra, pse pjesëmarrja e tyre nuk është në shkallë kaq të gjerë. Përveç kësaj, organizata e gruas në fshat duhet të luajë një rol të madh edhe për çështjen e pastërtisë, për të luftuar kundër fanatizmit, për t'u mësuar grave se ku të venë të linden, si t'i rritin pastër e me shëndet fëmijët etj. Shteti

nga ana e tij, sipas mundësisë, duhet t'u japë ndihmë grave me shumë fëmijë.

Natyrisht fanatizmi do të zhduket me propagandë, po futja e grave në prodhim do ta luftojë në mënyrë më efikase atë, pse këto gjëra janë të zorshme të luftohen me dekrete. Jam dakord që familjet e komunistëve të bëhen shembull dhe të mos ndodhë si deri tani që gratë e disave prej tyre mbajnë perçe. Në qytet, por sidomos në fshat, duhet të bëhet një punë më e madhe dhe komunistët të vihen përpara përgjegjësisë që të mos lejojnë më gjëra të tilla në radhë të parë në familjet e tyre.

Sa për revistën¹ edhe unë them të dalë jo dy, po një herë në muaj, por përveç asaj, të nxirren edhe broshura të tjera për gratë. Organizata e gruas në fshat duhet të bashkëpunojë sa më ngushtë me atë të rinisë, sidomos për problemet që u interesojnë të dy palëve.

Kam edhe një çështje lidhur me veshjen e grave. Kur gruaja punon në sektorë që kanë të bëjnë me vajëra e me maqineri, në fabrika, në dyqane etj., ajo duhet të ketë veshjen e punës, e cila mund të mos jetë edhe aq e hijshme, por kur të dalë nga puna, ajo duhet të mësohet të vishet mirë dhe pastër.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

¹ Është fjala për revistën «Shqiptarja e Re».

MBI ROLIN DHE DETYRAT E KËSHILLTARIT DHE TË DEPUTETIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

8 qershor 1951

Çështja e organizimit të mirë dhe e forcimit të organeve të pushtetit, siç dihet, ka një rëndësi shumë të madhe. Rëndësia që kanë organet e pushtetit popullor, organizimi e forcimi i tyre nuk janë kuptuar si duhet nga të gjithë anëtarët e Partisë, megjithëse Partia e ka shtruar shumë herë këtë çështje. Puna që bëhet në këtë drejtim ka më tepër një karakter propagandistik dhe nuk zhvillohet sa duhet një punë e thellë teorike dhe praktike. Duke u nisur nga rëndësia që ka organizimi i mirë dhe forcimi i organeve të pushtetit, mendoj se del e nevojshme që ne të përgatitim një mbledhje të posaçme të Komitetit Qendror për të analizuar, për të

¹ Diskutim rreth raportit «Mbi udhëheqjen e Partisë në këshillat popullore të lokaliteteve», ku trajtohen probleme të tilla si zgjedhja, ngritja dhe shpërndarja e kuadrove të pushtetit, kujdesi i Partisë për organet e pushtetit, shembulli i komunistëve që janë zgjedhur në këto organe etj.

diskutuar dhe për të rrahur këto probleme, për të goditur të metat dhe për të vënë mirë në vijë detyrat dhe kompetencat e organeve lokale të pushtetit tonë popullor.

Parimi, që në qeverisjen e pushtetit të marrë pjesë populli, që ai të kontrollojë organet që ka zgjedhur duke filluar që nga Kuvendi Popullor e deri poshtë në bazë, në praktikë nuk po zbatohet ashtu si duhet. Ky është një parim themelor marksist-leninist, i cili duhet të zbatohet plotësisht në praktikë. Natyrisht, ai nuk mund të vihet plotësisht në zbatim kur te disa shokë nuk ekzistojnë koncepte të qarta marksiste-leniniste për të dhe për rëndësinë që kanë zgjedhjet, kur nuk kuptohet drejt që deputetët zgjidhen nga populli, ministrat dalin nga gjiri i Kuvendit Popullor, që këshilli zgjidhet nga populli dhe komiteti ekzekutiv zgjidhet prej këshillit dhe, si rrjedhim, kush nuk punon mirë, hiqet prej vetë popullit. Pa pasur të qarta këto koncepte, nuk ka se si të vejë puna mirë. Ka shokë, bile edhe ndonjë anëtar të Komitetit Qendror, që thonë se «Kuvendi Popullor na merr shumë kohë». Ky është një koncept i gabuar. Prandaj duhet të punohet që ky problem të kuptohet mirë nga shokët me përgjegjësi në radhë të parë si dhe nga çdo komunist, sepse, po nuk u zbatua drejt parimi i mësipërm, ne kemi përgjegjësi të rëndë para Partisë dhe popullit.

Që kur zgjidhet deputeti, duhet të ketë të qartë nderin dhe detyrat që ka përpara popullit. Ai duhet jo vetëm të ngrihet të flasë dhe të sjellë zërin e zgjedhësve të tij në mbledhjet e Kuvendit Popullor, por të japë herë pas here dhe llogari para popullit. Këtë e theksoj, pse ka nga ata që nuk veprojnë kështu, që nuk japin

llogari para popullit dhe nuk sjellin zërin e masës në Kuvendin Popullor. Kritikrat që i bëhen deputetit mund të botohen edhe në shtyp, që të marrë vesh populli. Ndonjëri mendon se «aq më bën mua nëse më zgjedh ose jo populli, mua më zgjedh Byroja Politike»! Ky është një mendim i gabuar. Një person me mentalitet të tillë nuk e kupton fare demokracinë tonë.

Deputetët duhet të venë në zonat e tyre ku janë zgjedhur dhe të japin llogari, të jetojnë me popullin, të shohin hallet e tij dhe po qe nevoja, të vijnë në qeveri qoftë edhe te Kryeministri dhe të shprehin mendimet e tyre për gjithshka kanë konstatuar. Ata duhet ta ngrenë me të madhe, kudo, në qoftë se shikojnë që një vendim, që është marrë për të mirën e popullit nuk po zbatohet, aq më tepër kur për moszbatimin e tij nuk kërkohet llogari. Mua nuk më ka ndodhur që të vijë ndonjë deputet për të kërkuar shpjegime për çështje të pushtetit. Nga lart kjo çështje nuk është aq në rregull, kurse poshtë është akoma më keq. Një deputet më tha një ditë se kishte shkuar te kryetari i komitetit ekzekutiv të një rrethi për ta sinjalizuar mbi disa gjëra që i shikonte se nuk ishin të drejta dhe kryetari nuk e kishte pranuar në zyrë. Shikoni ç'sjellje! Deputeti i popullit ka të drejtë të shkojë edhe në një ministri dhe të kërkojë zbatimin e këtij ose të atij vendimi dhe jo më në një komitet ekzekutiv. Por ky kryetar komiteti ekzekutiv nuk e konsideron si detyrë të madhe atë që i ka ngarkuar populli deputetit, pra, ai nuk kupton ligjet dhe as se këto ligje i vendos dhe i heq populli. Ky kryetar ka frikë nga masat dhe nuk ka idenë e demokracisë sonë. Ne nuk duhet të kemi frikë nga kritikrat e popullit,

se po patëm frikë nga kritikata e popullit, atëhere shkëputemi nga ai, shkojmë në kundërshtim me të dhe e humbasim davanë.

Në disa kuadro drejtues të komiteteve ekzekutive vihet re edhe sektarizëm i theksuar në lidhje me aktivizimin e njerëzve të zgjedhur nga populli. Harrojnë që ata vetë janë zgjedhur nga këshilli popullor dhe nuk aktivizojnë as anëtarët e komitetit ekzekutiv dhe aq më keq anëtarët e këshillit popullor. Kjo është e shtrembër.

Në qoftë se nuk i kuptojmë drejt këto çështje që janë parimore, format organizative do të mbeten forma. Ne i kemi theksuar gjithmonë këto probleme, por puna është se ato nuk po zbatohen si duhet. Gati të gjithë anëtarët e këshillit popullor duhet të jenë në komisione dhe të aktivizohen, kjo do të rritë kontributin e secilit në kryerjen e detyrës që i është ngarkuar këshillit popullor.

Kërkohet që në komitetet ekzekutive të lokaliteteve të shtohet organika «për ta kryer punën më mirë». Kjo nuk është kërkesë e drejtë. Që të veprosh kështu, do të thotë që t'i zgjidhësh punët në mënyrë burokratike. Përse të shtohet organika kur në këshillin popullor të lokalitetit janë 20 vetë? Në qoftë se punohet mirë me këta 20 vetë, në qoftë se ata i aktivizojmë si duhet, nuk ka pse të mos ecë mirë puna dhe s'ka pse të lindë nevoja për shtesë organike.

Është dhe një anë tjetër. Këshilli popullor duhet të njohë mirë kompetencat që ka dhe në bazë të tyre të kërkojë llogari. Këshilli popullor ka të drejtë, veç të tjerave, të thërrisë edhe drejtorin e ndërmarrjes nacionale dhe t'i kërkojë atij llogari pse nuk po e realizon

planin, pse nuk sillet mirë me punëtorët dhe ta porositë që të marrë masa për të përmirësuar punën.

Partia duhet të kuptojë mirë se populli është lëvruesi i shëndoshë për zbatimin e vijës së saj. Ajo të preokupohet më shumë për çështjet e organeve të pushtetit. Ajo duhet të punojë që anëtari i këshillit popullor, me punën e tij dhe me ndihmën e saj, të fitojë autoritet, por nga ana tjetër t'ja bëjë të qartë se në qoftë se do punojë keq, do të hiqet. Edhe drejtoritë e Komitetit Qendror duhet që të punojnë më mirë në këtë drejtim dhe t'u vënë rëndësinë e duhur problemeve të pushtetit, prandaj duhet që edhe këto t'i forcojmë me kuadro të aftë e me eksperiencë. Drejtoritë e Komitetit Qendror duhet të përgjithësojnë eksperiencën dhe të udhëzojnë komitetet e Partisë të rretheve si të forcojnë gjithnjë e më shumë pushtetin.

Detyra të mëdha ka edhe Dega e pushtetit lokal në Kryeministri. Ajo duhet të mobilizohet më shumë dhe të udhëzojë e të ndihmojë më tepër pushtetin lokal. Partia duhet të përpiqet që të gjitha këto organizma të bëjnë mirë punën e tyre dhe të mos mbeten formale, por të kontrollojnë mirë zbatimin e vendimeve të Partisë në lidhje me pushtetin.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TREGËTIA TË KOMBINOJË MIRË PLANIFIKIMIN ME KËRKESAT E POPULLIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

11 qershor 1951

Tregëtia është një sektor me shumë rëndësi dhe duhej analizuar, ashtu sikurse veprimi sot Byroja Politike. Por, duke paraqitur për shqyrtim në një kohë gjithë sektorët e tregëtisë, është e zorshme me u përqëndruar dhe me nxjerrë konkluzione e detyra konkrete për çdo sektor veç e veç. Në këtë mënyrë zvogëlohen edhe të metat kryesore që, sikurse e dini, ka shumë si Ministria e Tregëtisë ashtu dhe Bashkimi i Kooperativave të Konsumit. Ndoshta nuk përjashtohet që të ketë edhe punë armiqësore përderisa ka shumë çrregullime dhe konfuzion.

Sipas mendimit tim, shokët tanë, që drejtojnë tregëtinë, nuk kanë mundur të evitojnë shumë nga gabimet që ekzistojnë në këtë sektor. Përgjegjësi për këtë në

¹ Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti «Mbi tregëtinë shtetërore dhe kooperativiste», paraqitur nga Ministria e Tregëtisë.

radhë të parë ka Ministria e Tregëtisë, e cila nuk ka kontrolluar dhe nuk ka zbatuar urdhëresat në fuqi. Prandaj, Byroja Politike i tërheq vëmendjen ministrit dhe gjithë ministrisë për këto të meta shumë serioze.

Unë pyeta për çështjen e planifikimit, sepse në tregëti kjo është kryesore, prandaj Partia e ka ngritur me forcë. Është e vërtetë se planifikimi në tregëti është një çështje shumë e koklavitur, por po që se plani nuk është i drejtë, nuk mund të kemi tregëti të mirë që të kënaqë kërkesat e popullit. Këtu dolën shumë gjëra, për ndreqjen e të cilave, në përgjithësi, unë jam dakord me propozimet që u bënë. Vetëm për çështjen e planit dëshiroj të them disa fjalë.

Në tregëti ne punojmë me një plan dhe tregëtia jonë shtetërore dhe kooperativiste hedh mall mbi këtë bazë. Por ne duhet të perfeksionojmë më tej punën e planifikimit, të kuadrit etj. Plani i tregëtisë është i lidhur me planin e shtetit dhe nuk mund të kërkojmë nga tregëtia një plan neto pa pasur lidhje kjo me sektorët e tjerë dhe pa u zbatuar mirë edhe detyrat nga ana e vetë tregëtisë. Çështja është se në vendin tonë tregëtinë e bën shteti, kooperativat dhe privatët, të cilëve u janë dhënë orientime përkatëse.

Përsa u përket tregëtarëve privatë, ne nuk do ta ndryshojmë orientimin, domethënë tregëtia private do të vazhdojë të punojë dhe do të jetë akoma një ndihmëse për tregëtinë e shtetit. Udhëzimet e Kongresit I janë që tregëtia private nuk duhet të spekulojë, mirëpo që të mos ndodhë kjo, ne duhet të shikojmë se mos ajo i shet mallrat më shtrenjtë se sa shteti. Po u vërtetua kjo, duhet të marrim menjëherë masa; por të bëjmë dallim,

këto masa nuk duhet të merren kundër tregëtarëve të vegjël. Ne duhet të shohim dhe çfarë shet tregu privat. Në rast se ai shet për shembull pasta, të cilat mund t'i bëjë sektori i tregëtisë shtetërore, nuk është nevoja të lejohet që këto t'i bëjë sektori privat, sepse ai mund të shpërdorojë kot sheqerin e miellin dhe rrugët të mbushen me pastashitës. Këtë tregëti mund ta lëmë të lirë atëherë kur të kemi nevojë, kur dhe ku sektori i tregëtisë shtetërore s'ka mundësi të përballojë kërkesat. Në asnjë mënyrë mos ta lëmë që sektori privat të luftojë shtetin me mallrat tona. Gjithashtu ne nuk duhet t'i ndalojmë privatët që të shesin pazareve. Ne mund edhe t'i ndalojmë, por në kushtet e sotme, kur kooperativat nuk janë akoma në gjendje t'i përballojnë nevojat e popullit, kjo nuk është e drejtë, prandaj ne e lëmë privatin të zhvillojë tregëti dhe në të njëjtën kohë i heqim veshin kooperativës, që të prodhojë më shumë dhe të furnizojë tregëtinë shtetërore.

Të vijmë përsëri në çështjen e planifikimit: Tregëtia shtetërore blen dhe shet. Që të blejë, ajo duhet të dijë se ku i ka furnizuesit, të dijë se me çfarë malli do të furnizohet, çfarë malli duhet të porositë në sasi dhe cilësi, të dijë çmimin etj. Pasi t'i dijë të gjitha këto, atëherë ajo të mendojë mirë edhe se ku do ta çojë këtë mall. Që ta sigurojë këtë mall, ajo duhet të lidhë kontrata me ata që e furnizojnë si për shembull, me industrinë, me artizanatin, me kooperativat bujqësore, me ndërmarrjet e grumbullimit dhe me importin. Pra, tregëtia ka lidhje plani me shumë sektorë. Ajo, gjithashtu, i bën kërkesat e saja industrisë, e cila është ngritur që të punojë për të furnizuar popullin.

Industria nuk duhet të prodhojë për të prodhuar dhe plani i industrisë të bëhet jashtë nevojave e dëshirave të popullit, por ajo duhet ta bëjë planin në bazë të nevojave dhe të dëshirave të popullit. Mirëpo, në praktikë, ne shohim që na ngjasin gjëra të papëlqyera, joekonomike. Për shembull ne do të prodhojmë cigare aq sa janë nevojat, por në rast se ne bëjmë cigare, sepse nuk kemi ku t'i çojmë punëtorët, atëherë kjo industri, në vend që t'i shërbejë popullit, e dëmton atë. Prandaj kontratat që lidh industria me tregëtinë, duhet të zbatohen medoemos. Jam dakord që tregëtia të lidhë kontrata dhe të kontrollojë mallin në mënyrë preventive dhe kur ai nuk prodhohet sipas kontratës, t'i thotë Ministrisë së Industrisë që malli nuk është ashtu si e kemi porositur. Bile këto raste t'i referohen edhe qeverisë dhe çështja të shkojë edhe në arbitrazh. Prandaj ato që porosit tregëtia duhet të bëhen.

Po kështu duhet të veprohet edhe me artizanatin, i cili duhet t'u nënshtrohet nevojave të popullit dhe jo të niset nga parimi i gabuar se, meqë ka shumë samarpunues dhe hekurpunues, të prodhojë tepër në këtë drejtim. Çështja e prodhimeve të artizanatit u ngrit edhe në Këshillin e Ministrave dhe atje ju dha zgjidhja që sendet të prodhohen e të dorëzohen sipas nevojave të tregëtisë, e cila është më e lidhur me popullin dhe di më mirë nevojat e tija, prandaj ne nuk mund ta lëmë të lirë artizanatin të prodhojë çfarë të dojë; këtë politikë mund ta bëjë më mirë tregëtia. Tregëtia e di kur nuk shitet një plaçkë dhe ajo mund t'i thotë artizanatit që ta bëjë ashtu siç e kërkon populli. Ministria e Tregëtisë duhet të dijë çfarë dhe sa prodhon çdo fabrikë,

ku dhe kur do t'i çojë mallrat. Por fakti tregon se tregëtia nuk ka qenë në gjendje të dijë se çfarë ka në depo dhe çfarë ka në dyqan. Derisa ajo nuk i ka këto të dhëna, nuk ka se si të shkojë mirë puna.

Ne kemi seksionet e tregëtisë në rrethe, që bëjnë politikën e tregëtisë. Këto kanë në vartësi dyqane që mbajnë mall etj., po si është e mundur që këto seksione nuk janë në gjendje të paraqesin bilancin e tyre? Ato duhet ta kenë të caktuar afatin se kur duhet ta dërgojnë bilancin. Inventari i mallit duhet bërë e ndjekur rregullisht. Kjo gjë nuk duhet nënvleftësuar, ndryshe tregëtia do të çalojë. Plani që hartohet në krye të vitit nga ana e komiteteve ekzekutive, duke u mbështetur në dëshirat dhe në nevojat e popullit, do të jetë më i mirë se plani që bëjnë shokët e ministrisë që lart. Ju ju ka tërhequr rutina, konfuzioni: «Erdhi malli, hajde ta ndajmë në mënyrë proporcionale»; kështu nuk duhet punuar, prandaj që të mos ndodhë kjo, plani duhet të hartohet poshtë nga dyqanet, nga komitetet ekzekutive dhe pastaj ne të bëjmë standardizimin, të cilin nuk duhet ta bëjë Komisioni i Planit, por vetë tregëtia që bën porosinë e nevojshme pranë fabrikave si për këto ose ato lloj këpucësh etj. Të evitohen 50-60 për qind lëvizjet e mallrave. Ministria e Tregëtisë duhet të ketë grafikun e lëvizjes së tyre dhe të shohë ku shkon mirë e ku shkon keq, në mënyrë që të korrighohen gabimet.

Qeveria ka një kriter në lidhje me shpërndarjen e mallrave. Në radhë të parë duhet të furnizohen qendrat e punës, por është e domosdoshme të evitohen rrugët e gjata për disa artikuj që bëhen në vend. Pastaj duhet të shikojmë fuqinë blerëse të popullit, sepse ka vende

ku ne nuk mund ta nivelojmë fuqinë blerëse të tij, për shembull bujkun e Myzeqesë dhe të Korçës me atë të Skraparit. Në lidhje me shpërndarjen e mallrave duhet të dish fuqinë blerëse të popullit dhe gjërat e nevojshme që duhet të dërgohen. Një çështje tjetër është që të mos dërgojmë në ndonjë rreth, për shembull, birra e të lëmë pa dërguar bukën, mishin dhe gjalpin. Në lidhje me çështjen e shpërndarjes, të mos prodhohen sende që nuk do tregu; në këtë drejtim mund të ketë gabime edhe plani, prandaj t'i bëhen propozime Komisionit të Planit të Shtetit për të bërë korrigjimet e nevojshme.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

PËRGJEGJE LETRËS SË FSHATARËVE TË TURANIT¹

12 qershor 1951

E mora letrën tuaj që më drejtonit nga mbledhja juaj e përgjithshme e datës 4 qershor 1951, ku keni marrë në shqyrtim dhe keni vendosur përgatitjet për vitin e ri shkollor 1951—1952.

Kjo letër më ka gëzuar shumë, se në të shoh interesimin e madh që ju tregoni për një çështje kaq të madhe e kaq të rëndësishme siç është arësimi, që ndrit jetën tonë e na çon përpara në ndërtimin e socializmit.

Ju përgëzoj nga zemra për këtë inisiativë të bukur dhe ju uroj që të dilni faqebardhë në punë për kryerjen e zotimeve tuaja, për ta përgatitur sa më mirë vitin e ri shkollor 1951—1952.

Të gjithë e dimë, të dashur shokë fshatarë, se në çfarë errësire e patën lënë popullin tonë klikat e regjimeve antipopullore, me qëllim që ta shtypnin e ta ripnin akoma më shumë.

Në saje të luftës dhe të fitores së shkëlqyer mbi bishën naziste të popujve të lavdishëm sovjetikë, të udhëhequr nga Partia Bolshevike me në krye shokun

¹ Fshat në rrethin e Tepelenës.

e madh Stalin si dhe në saje të luftës heroike të popullit tonë trim, të udhëhequr nga Partia jonë e dashur, u vendos në Shqipëri pushteti popullor dhe, si çdo gjë tjetër, edhe arësimi u bë i masave punonjëse të qytetit e të fshatit. Krahas përparimeve të mëdha të bëra në vendin tonë brenda një kohe fare të shkurtër, në rrugën e ndërtimit të socializmit, arësimi ka marrë një zhvillim të paparë ndonjëherë. Këto suksese të mëdha në fushën arësimore, ashtu edhe në fushat e tjera të jetës sonë, janë korrur, pse populli është udhëhequr nga Partia jonë dhe pushteti popullor, të cilët kanë për qëllim e punojnë që arësimi e kultura të përfshijnë të gjitha masat punonjëse të vendit tonë.

Ju, shokë fshatarë, sigurisht do ta keni marrë vesh, me anën e shtypit që ju vjen në fshat, se këto ditë Kuvendi Popullor mori në shqyrtim dhe aprovoi buxhetin e shtetit për vitin 1951, viti i parë i planit pesëvjeçar që do t'ja ndërrojë faqen edhe më shumë atdheut tonë. Në këtë buxhet vetëm për arësimin janë caktuar 900 278 000 lekë, d.m.th. 276 552 000 lekë më shumë se në vitin 1950. Sivjet do të kemi më shumë shkolla fillore, shkolla 7-vjeçare, shkolla të mesme etj., ku do të mësojnë bijtë e bijat e popullit që të bëhen më të zot, ta ndërtojnë dhe ta lulëzojnë atdheun tonë të dashur dhe ta bëjnë atë të fortë, ta bëjnë një kala të vërtetë paqeje, ku të thyejnë kokën armiqtë e vendit tonë, imperialistët amerikano-anglezë dhe shërbëtorët e tyre, titistët, monarko-fashistët, neofashistët etj. që do të guxojnë të prekin punën tonë paqësore dhe përparimtare.

Jam shumë i gëzuar që ju, ashtu si i gjithë populli shqiptar, këtij kujdesi të madh që tregon Partia për të

përhapur kudo dritën e arësimit, po i përgjigjeni sot me zotime se do të vini të gjitha forcat tuaja për ta përgatitur vitin e ri shkollor 1951—1952 në të gjitha pikëpamjet, se do ta kryeni qind për qind detyrimin shkollor, se do të dërgoni në shkollën 7-vjeçare të Tepelenës të gjithë fëmijët që janë planifikuar, se do ta pajisni e do ta rregulloni shkollën me të gjitha ç'i nevojiten dhe do ta ktheni 1 shtatorin, ditën e fillimit të mësimëve, në një ditë feste e gëzimi për fëmijët tuaj dhe për gjithë fshatin.

Ky është një zotim për t'u lavdëruar dhe Komiteti Qendror i Partisë, qeveria dhe unë jemi të bindur se nën udhëheqjen e organizatës së Partisë, me mobilizimin total të organizatës së Frontit, të rinisë dhe të gruas në fshat dhe me ndihmën e pushtetit, do ta kryeni me nder këtë detyrë të madhe patriotike, ashtu siç keni kryer të gjitha detyrat e tjera që në kohën e luftës e deri sot, se kjo është për të mirën tuaj, të fëmijëve tuaj dhe për të mirën e atdheut.

Komiteti Qendror, qeveria dhe unë jemi të sigurtë që kësaj inisiative të bukur që morët ju, do t'i përgjigjen të gjithë punonjësit e qytetit e të fshatit të vendit tonë, se do të mobilizohet i madh e i vogël në mënyrë që viti i ri shkollor ta gjejë çdo gjë të përgatitur me kohë dhe dita e 1 shtatorit të kthehet në një festë të madhe në të gjithë Shqipërinë. Jam i sigurtë se nën udhëheqjen e organizatave të Partisë dhe me mobilizimin e bashkimeve profesionale, të rinisë, të gruas, të Frontit Demokratik, me ndihmën e pushtetit popullor dhe me punën e palodhur të të gjithë punonjësve të arësimit, duke e kuptuar secili arësimin si një nga çështjet më

kryesore të popullit, viti i ri shkollor 1951—1952 do të përgatitet, do të fillojë e do të vazhdojë me sukses të plotë deri në fund dhe jemi të bindur se edhe në vitet e ardhshme populli ynë do të mobilizohet i tëri për këtë qëllim të lartë.

Komiteti Qendror, qeveria dhe unë jemi të sigurtë se nxënësit e fshatit tuaj dhe nxënësit e të gjitha shkollave të Shqipërisë do ta ndjekin shkollën rregullisht e me zell, do të mësojnë mirë dhe do t'i përvetësojnë si duhet mësimet, në mënyrë që të kenë nota më të mira në të gjitha lëndët, se ata do ta forcojnë akoma më shumë dashurinë e tyre për popullin, atdheun dhe Partinë e tyre, për Bashkimin e lavdishëm Sovjetik dhe për mikun më të madh e më të shtrenjtë të tyre dhe të popullit tonë, Stalinin e madh. Jemi të sigurtë, gjithashtu se, edhe mësuesit nga ana e tyre do të mobilizohen akoma më shumë në kryerjen e detyrës së shenjtë që u ngarkon populli dhe Partia. Mësuesit duhet të nderohen, të respektohen dhe të ndihmohen nga nxënësit dhe nga populli. Ata i ka pasur dhe do t'i ketë përgjithmonë në kujdes shteti për të perfeksionuar përgatitjen e tyre kulturore, ideologjike dhe profesionale dhe për të përmirësuar gjendjen e tyre ekonomike.

Edhe një herë ju uroj që të dilni faqebardhë, si ju ashtu dhe i gjithë populli në qytetet e fshatrat e tjera të vendit tonë dhe ju përshëndes nga zemra.

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 139 (844), 12 qershor 1951

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 139 (844), 12 qershor 1951

PARTIA NUK E DREJTON DREJTPËRDREJT MINIERËN, POR E UDHËHEQ ATË NËPËRMJET DREJTORISË DHE ORGANIZATAVE TË MASAVE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

22 qershor 1951

Është e qartë se drejtorja e minierës është përgjegjëse për realizimin e planit dhe ajo duhet të drejtojë minierën. Por organizata e Partisë dhe drejtorja nuk duhet të konfundojnë detyrat dhe të marrin kompetencat e njëra-tjetrës. Partia nuk e drejton drejtpërdrejt minierën, por e udhëheq atë nëpërmjet drejtorisë. Kështu Partia kontrollon dhe ndihmon në plotësimin e planit me anën e drejtorisë së minierës, por që të realizohet kjo udhëheqje, Partia duhet të jetë në gjendje ta kontrollojë e ta ndihmojë drejtorinë jo vetëm në çështjet politike, po edhe në ato ekonomike. Kjo do të thotë

¹ Byroja Politike në këtë mbledhje kishte thirrur drejtuesit e Komitetit të Partisë të rrethit të Vlorës dhe disa quadro drejtues të Minierës së Selenicës, të cilët raportuan mbi gjendjen në këtë minierë, mbi realizimin e planit dhe mbi punën ideopolitike të Partisë dhe të organizatave të masave atje.

që sekretari i komitetit të Partisë të dijë e të jetë i fortë jo vetëm nga ana politike, po dhe nga ana profesionale. Po ta dish zanatin, mund ta udhëheqësh minierën dhe ta ndihmosh më mirë drejtorinë. Sekretari i Partisë së minierës duhet ta dijë procesin e punës, gjendjen e galerive, kualitetin e bitumit dhe nëse i di këto mirë, atëhere mund ta udhëheqë drejt minierën në realizimin e planit dhe mund të ndihmojë konkretisht; ndryshe Partia nuk mund ta luajë rolin e saj udhëheqës.

Mbledhjet që bëhen me punëtorët duhet të lidhen mirë me detyrat e planit. Stalini thotë:

«Nuk bën të ndajmë politikën nga ekonomia»¹.

Kur nuk shkon mirë puna në një sektor, të thirret menjëherë drejtori dhe t'i thuhet se «ju nuk e keni kryer mirë punën, prandaj duhet të merren masat e duhura». Përveç kësaj, të organizohen mbledhje dhe të thuhet se prodhimi nuk shkon mirë për këto e ato arsye. Të thuhet se nuk ka disiplinë, emulacion dhe pa këto nuk shkohet përpara. Të flitet se duhet të realizohet plani, se kjo ka rëndësi të madhe për ne, sepse me këtë serë që nxjerrim, do të importojmë fabrika, do të ndreqim shtëpi etj. Kështu lidhet politika me ekonominë. Partia, kur sheh se nuk vete mirë një problem, bën mbledhjen e organizatës dhe u thotë anëtarëve të saj se këtu nuk ka disiplinë e ndërgjegje, derisa na ngjasin këto gjëra të papëlqyeshme. Këto të meta rrje-

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 121.

dhin ngaqë Partia nuk është mobilizuar si duhet, prandaj ne duhet të punojmë që punëtorët të jenë të ndërgjegjshëm.

Çështja e edukimit, konferencat dhe kurset kanë për qëllim t'i bëjnë punëtorët të ndërgjegjshëm, luftëtarë, të realizojnë planin. Nga një anë puna e Partisë dhe nga ana tjetër puna e drejtorisë — këto e vënë në rrugë çështjen. Por këtu nuk duhet që udhëheqja e Partisë të përzihet dhe me gjërat, që i përkasin drejtorisë; secili ka detyrën e tij. Për çështjet e vogla, si p.sh. pse nuk erdhi sapuni etj. është çështje e drejtorisë dhe ajo të dërgojë në Tiranë njerëz që të kërkojnë sapun, sepse ky nuk vjen vetë. Partia ka rolin kryesor dhe në qoftë se do të merret me çështje që nuk i takojnë, atëhere ajo humb rolin e drejtimit.

Komiteti i Partisë në Vlorë duhet të interesohet më shumë për Minierën e Selenicës. Ai nuk mund të lajë duart duke menduar se atje është komiteti i Partisë i ndërmarrjes. Në qoftë se sekretari i komitetit të Partisë të ndërmarrjes është specialist për minierën, ai i rrethit duhet të jetë akoma më specialist. Shokët e komitetit të Partisë të rrethit duhet me u interesue për realizimin e planit dhe për nevojat e tjera që ka organizata e Partisë dhe drejtoria e minierës. Të ndihmojnë minierën me kuadro dhe të shkojnë atje edhe vetë. Kur konstatohet se nuk shkon mirë puna e bashkimeve profesionale, të thirret menjëherë përgjegjësi i tyre dhe t'i thuhet që të merren këto e këto masa për zbatimin e të cilave brenda kaq ditësh të kthehet përgjegje. Në qoftë se kjo përgjegje nuk kthehet, atëhere të shkohet menjëherë në vend dhe të bëhet mbledhje vetëm për

çështjen e bashkimeve profesionale. Kështu veprohet edhe kur nuk vete mirë çështja e agjitacionit dhe e propagandës, për të cilën duhet të njoftohet Komiteti Qendror. Në minierë kemi shokë të mirë, që mund ta bëjnë mirë punën. Dobësitë që thuhën në raport duhet të zhduken, sepse punëtorët megjithëse vijnë nga fshatarësia me kohë e fitojnë ndërgjegjen e klasës.

Në lidhje me masat praktike që duhet të marrim për çështjen e mekanizimit, kam këtë mendim: në qoftë se materialet janë në plan dhe ekzistojnë, duhet që t'ua japim, të tjerat që nuk janë, do t'ua japim kur të vijnë. Edhe teknikë ne kemi kërkuar që të na vijnë, por drejtorja duhet të ketë inisiativë, të mobilizojë punëtorët e vjetër e me eksperiencë që kanë punuar me vite të tëra në miniera dhe t'i vërë ata edhe në rol të teknikut.

Furnizimet duhet t'u venë rregullisht punëtorëve dhe të luftohet vazhdimisht për sigurimin e tyre. Për këtë çështje duhet të interesohet Partia. Dhe kur ndodh që plani i furnizimit nuk po realizohet, Komiteti i Partisë së Vlorës të thërrisë kryetarin e kooperativës së konsumit dhe t'i thotë e ta porositë që furnizimi t'i bëhet më parë Selenicës, pastaj të furnizohen të tjerët. Në rast se kjo nuk bëhet, atëherë të mblidhet organizata dhe të shtrohet çështja pse nuk janë zbatuar udhëzimet e Partisë.

Për emulacionin socialist ka përgjegjësi Partia; bashkimet profesionale e kryejnë këtë detyrë, por Partia i drejton ato.

Minierën duhet ta ndihmojmë me punëtorë, kjo detyrë i është ngarkuar Partisë. Ajo duhet të vërë në lëvizje komitetin ekzekutiv, të cilit t'i kërkojë herë pas

here llogari që të realizohet plani i fuqisë punëtore brenda afatit të caktuar. Nga ana tjetër Partia të mbledhë komunistët, të cilëve t'u thotë se do të vijë një i deleguar i komitetit ekzekutiv për të nxjerrë forca punëtore për minierën e Selenicës, sepse puna është e madhe dhe duhet realizuar plani¹. Mbasi është bërë puna përgatitore nga ana e Partisë, komiteti ekzekutiv, me anën e këshillit popullor, organizon mbledhje në bazë dhe shtron çështjen që të dalin punëtorë.

Kjo çështje të studjohet mirë dhe nëse janë teknikë, të mobilizohen, ndërsa në fshat për punët bujqësore të qëndrojnë gratë. Të studjohet gjithashtu kategorizimi i vagonistëve dhe organika. Të interesoheni për dëfrimin e çlodhjen e punëtorëve duke organizuar aktivitete sportive etj. Po të marrim gjithë këto masa, nuk ka pse të mos shkojë mirë puna në Minierën e Selenicës dhe s'ka pse të mos realizohet plani.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

¹ Atëhere miniera punonte vetëm me 45 për qind të planit të fuqisë punëtore.

**TELEGRAM PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR KQ TË
PK TË KINËS ME RASTIN E 30-VJETORIT
TË FORMIMIT TË SAJ**

30 qershor 1951.

**KOMITETIT QENDROR TË PK TË KINËS
SHOKUT MAO CE DUN**

P e k i n

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe në emrin tim personal, ju dërgojmë përshëndetjet më të nxehta me rastin e 30-vjetorit të formimit të Partisë Komuniste Kineze. Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli shqiptar kanë ndjekur me admirim përpjekjet dhe luftën shumëvjeçare që populli i madh kinez, nën udhëheqjen e Partisë heroike Komuniste Kineze dhe birit të shquar të popullit kinez, shokut Mao Ce Dun, ka bërë kundër reaksionit dhe imperialistëve të huaj agresorë.

I urojmë nga zemra Partisë Komuniste të Kinës dhe popullit kinez suksese edhe më të mëdha në punën e tyre ndërtimtare dhe paqësore, për lumturinë e popullit

të madh kinez e forcimin e kampit unik të paqes e të socializmit që kryesohet nga Bashkimi i lavdishëm Sovjetik dhe Stalini i madh.

Për Komitetin Qendror të Partisë së Punës
të Shqipërisë

Sekretari i Përgjithshëm

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 156 (861), 1 korrik 1951*

*Botohet sipas tekstit të gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 156 (861),
1 korrik 1951*

MBI DISA DETYRA TË VEÇANTA PËR ORGANIZATËN E PARTISË TË RRETHIT TË SARANDËS

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

6 korrik 1951

Unë do të them disa gjëra për rrethin e Sarandës, të cilat duhet t'i kemi parasysh. Për vendin tonë dhe për Partinë, Saranda ka një rëndësi të veçantë, si nga ana politike, ashtu dhe nga ana ekonomike. Partia duhet të mbajë parasysh faktin se Saranda është një rreth kufitar që ndodhet prej kohësh ballë për ballë me një armik, me Greqinë monarko-fashiste. Kulakët në minoritet e disa elementë të sëmurë janë të predispozuar të bëhen agjentë të monarko-fashizmit, kurse masa e fshatarëve punonjës janë për demokracinë popullore, për Shqipërinë e re demokratike, por dhe në radhët e tyre mund të influencohen njerëz nga propaganda fashiste greke dhe e armikut të brendshëm, në rast se Partia

¹ Në këtë mbledhje u mar në analizë puna e organizatës së Partisë në rrethin e Sarandës.

nuk lufton vazhdimisht kundër këtij rreziku. Mbi popullsinë e minoritetit grek në Gjirokastër dhe në Sarandë për qindra vjet kanë sunduar agallarët. Populli i kësaj zone ka qenë shtypur nga ana ekonomike dhe politike. Pretendimet e shovinistëve grekë dhe përkrahja e tyre prej imperializmit anglo-amerikan për të rrëmbyer Shqipërinë e Jugut, të cilëve u ka shërbyer edhe feja, vazhdojnë.

Pjesa dërmuese e minoritetit ka arritur në një shkallë të atillë që ta kuptojë ç'është monarko-fashizmi grek dhe ta urrejë atë. Në Republikën Popullore të Shqipërisë minoritarëve u janë siguruar të gjitha të drejtat, mbrojtja e zhvillimit kultural dhe përdorimi i lirë i gjuhës së tyre. Ata vetë e shohin se ç'bëhet sot në Greqinë monarko-fashiste dhe kjo i ka bërë ata që të lidhen ngushtë me Partinë tonë.

Gjendja ekonomike në këtë rreth mund të përmirësohet edhe më shumë, por në këtë drejtim në radhë të parë, duhet luftuar seriozisht propaganda e armikut, e cila synon të krijojë mosbesim në të ardhshmen. Për këtë arsye Partia duhet të mbështetet fort te rinia, sepse të rinjtë janë njerëz që e kuptojnë dhe e përqafojnë shpejt politikën e Partisë dhe janë mjaft të lidhur me punën. Kudo që i ka thirrur Partia ata janë përgjegjur me gatishmëri të plotë, prandaj duhet të tregohet një kujdes i veçantë për organizatën e rinisë. Mbështetja kryesore e Partisë në fshat janë fshatarët e varfër dhe parulla e Partisë «aleancë me fshatarët e mesëm në luftë kundër kulakëve» qëndron kurdoherë. Fshatarët e varfër janë për Shqipërinë demokratike dhe kundër monarko-fashizmit, prandaj Partia duhet të forcohet pikë-

risht me këta njerëz. Po kështu është e domosdoshme të zhduket frika dhe ngurtësia ndaj të rinjve, më të mirët e të cilëve t'i bëjmë anëtarë partie. Të gjitha këto dobësi do të zhduken, po të priten nga rrënjët me sopatë në radhë të parë në komitetin e Partisë, ku ka akoma shfaqje të familjaritetit të sëmurë.

Në qoftë se në Parti nuk ka kritikë e autokritikë, kjo e metë bëhet e rrezikshme. Por në rrethin e Sarandës, ku punon edhe armiku, kjo bëhet akoma më e rrezikshme. Familjariteti rrjedh nga mungesa e kritikës dhe e autokritikës, sepse kur unë shoh për shembull te ti një të metë dhe nuk ta vë në dukje, me qëllim që edhe ti të mos më nxjerrësh në shesh të metat e mia, kjo do të thotë që të ecim që të dy pa i likuiduar të metat, prandaj duhet luftuar ashpër kundër familjaritetit. Pa luftuar ashpër kundër lëshimeve, kundër familjaritetit, kundër gabimeve politike dhe pa forcuar kritikën e autokritikën, fryma luftarake e Partisë dhe vigjilenca ndaj armikut nuk mund të jenë në nivelin e duhur.

Kur një komunisti i arratiset një i afërt, ai këtë duhet ta ndjejë e, pa ja diktuar njeri, duhet të vejë në fshat dhe ta demaskojë. Në rast se nuk e bën këtë, ai nuk është komunist i mirë. Partia, pra, duhet t'i hedhë në aksione politike komunistët, siç është rasti që të demaskojnë njerëzit e tyre të arratisur. Zbatimi i mirë i vijës së Partisë kërkon që fshatarët e varfër, të rinjtë, njerëzit e ndershëm dhe patriotë, të edukohen drejt me frymën e Partisë.

Veçanërisht me mësuesit duhet të bëhet një punë e gjerë politike, sepse mësuesit kanë një rol me rëndësi

në jetën e vendit tonë, jo vetëm nga pikëpamja arësimore, por dhe politike. Partia të mbështetet fort në ta dhe duhet veçanërisht të interesohet që me mësuesit të bëhen herë pas here edhe konferenca të veçanta. Ka raste që ndonjë mësuesi nuk i jepet triska e Frontit, sepse «ka pasur xhaxhanë me «Ballin»», ndërsa në të njëjtën kohë atij i besohet edukimi i fëmijëve. Përveç të tjerave duhet të tregohet interesim edhe për sigurimin e konditave të tyre ekonomike. Komiteti Qendror, Drejtoria e agjitacionit dhe e propagandës dhe Ministria e Arësimit duhet të japin një ndihmë konkrete për mësuesit, pse në radhët e tyre mundohet të bëjë punë edhe armiku.

Edhe dy fjalë për çështjen e gjuhës. Në shkollat fillore të minoritetit mësimet të zhvillohen greqisht dhe gjuha shqipe të jepet lëndë e veçantë si gjuhë, ndërsa në shkollat 7-vjeçare mësimet të zhvillohen shqip dhe greqishtja të jepet si gjuhë e dytë.

Gjithashtu rëndësi të madhe kanë çështjet ekonomike, të cilat duhet të lidhen ngushtë me çështjet politike. Saranda, me përjashtim të Theollogos¹, është një vend bujqësor produktiv dhe ka toka shumë pjellore. Për këtë arsye, Ministria e Bujqësisë duhet t'i japë një rëndësi të veçantë këtij rrethi, por kjo s'do të thotë që, duke bërë ajo disa studime, komiteti ekzekutiv dhe Partia në rreth të lajnë duart. Përkundrazi, çështjet që ngre rrethi, të shikohen e të studjohen edhe një herë së bashku. Pas kësaj pune të bëhen propozimet, të cilat edhe ne do t'i shikojmë. Në rast se mendohet që kullotat të shndërrohen në toka buke, mirë, por, në rast se

¹ Sot quhet zona «Partizani».

bëhet kjo, atëhere duhet ecur me hesap e duhet shikuar ajo që na leverdis më tepër. Komiteti ekzekutiv dhe Partia duhet të marrin pjesë në mënyrë më aktive në hartimin e planit, sepse deri tani ato nuk kanë vepruar sa duhet. Në planin pesëvjeçar gjendja duhet të ndryshojë.

Çështja e pushtetit ka një rëndësi të madhe. Kryetari i komitetit ekzekutiv dhe kryesia janë përgjegjës përpara këshillit popullor, prandaj për çdo gjë duhet të vënë në dijeni këshillin popullor. Plani i orizit p.sh. nuk është një gjë e fshehtë, prandaj kur vjen koha e mbjelljes së tij, ky plan t'i shtrohet këshillit popullor. Komiteti ekzekutiv duhet t'i japë rëndësi të madhe këshillit popullor dhe mbledhjet e tija të bëhen në rregull. Në gjirin e këshillit duhet të ketë komisione si p.sh. për çështjet e arësimit, i cili duhet të shikojë punën e arësimitarëve, të shikojë a u venë në rregull rrogat e drutë për zjarr sipas vendimit të qeverisë dhe, pasi të bëjë kontroll, të shikojë e t'i thotë kryetarit të komitetit ekzekutiv që këto ose ato gjëra nuk janë në rregull e duhet të merren masa. Në qoftë se edhe pas kësaj detyrat nuk zbatohen, çështja të shtrohet në mbledhjen e këshillit popullor, ku t'i kërkohet llogari kryetarit të komitetit ekzekutiv që nuk ka marrë masat e nevojshme. Njerëzit e komisioneve duhet të aktivizohen dhe t'u jepen detyra. Këto probleme duhet të vihen në jetë nga Partia, pse parimi i madh i saj është «pushteti buron nga populli dhe i takon popullit». Po të zbatohet ky parim, atëhere atë që nuk e kryen mirë detyrën dhe bën gabime populli ka të drejtë që ta heqë. Kështu të kuptohet pushteti popullor.

Në lidhje me përmirësimin e metodës së punës, komiteti i Partisë duhet të zbatojë udhëzimet që ka dhënë Partia dhe në këtë drejtim nuk duhen bërë lëshime. Të punohet që të forcohet jeta e Partisë në organizatat bazë. Ato në rendin e ditës të vënë problemet që kanë lidhje me terrenin ku veprojnë dhe nuk duhet që të jenë shablone. Për shembull në Theollogo nuk ndihet aq shumë nevoja për të folur kundër ballistëve, ose kundër fesë muslimane, por duhet folur kundër monarko-fashistëve, kurse në Rrëzomë duhet të flasim patjetër kundër ballistëve dhe fesë muslimane. Gjithashtu në organizatat bazë mund të ngrihet vetëm një çështje, si ndjekja e shkollës ose çështja e atyre që merren me thashetheme ose propagandë armiqësore dhe në këtë drejtim të sqarohet populli e të mobilizohet t'i luftojë të metat ose shfaqjet e huaja.

Komiteti i Partisë kujdes të veçantë duhet të tregojë për punën me instruktorët. Me këta të bëhet një punë e vazhdueshme dhe konkrete, sepse instruktorët nuk janë letrarsjellës. Prej tyre ju do të merrni situatën e Partisë në bazë, prandaj, kur të vijnë andej, ata të thirren në raport, pa marrë parasysh se i kujt seksioni është ai instruktor dhe, në bisedim e sipër, udhëzohet si duhet të veprohet më tej. Të bëhen mbledhje me ta për shkëmbim eksperience dhe sekretarët e komitetit që, siç dihet, nuk kanë mundësi të shkojnë vetë në çdo vend, do të mësojnë kështu, shumë gjëra. Këto janë gjëra me rëndësi të madhe dhe që nuk duhen neglizhuar. Sekretarët janë përgjegjës përpara komitetit të Partisë në rreth dhe para Komitetit Qendror. Në radhë të parë duhet kuptuar mirë që drejtimi është kolegjal

dhe sekretarit të parë të komitetit i bie barra që të drejtojë mirë dhe të ndihmojë shokët që të bëhen luftarakë.

T'i vihet forcë realizimit të planit ekonomik; të realizohen në kohë korrjet, shirjet dhe grumbullimi i drithërave dhe i orizit si dhe vjelja e agrumeve etj. Në plotësimin e këtyre detyrave, e theksoj dhe një herë, të mbështetemi në të rinjtë dhe në fshatarët e varfër, sepse këta kanë dhënë prova si në luftë dhe tani.

Me qëllim që të zbatohen mirë këto detyra, duhet që komiteti i Partisë të jetë në krye të punës. Komiteti Qendror i ka shtruar drejt e qartë si detyrat e komitetit të Partisë në rreth, ashtu edhe të komitetit ekzekutiv, por ju po i konfondoni ato dhe si pasojë, ka shumë raste që komiteti i Partisë në vend që ta udhëheqë ekonominë, e drejton drejtpërsëdrejti atë, gjë që është një gabim i madh. Ne duhet të veprojmë ashtu si na mëson eksperiencia e Partisë Bolshevike dhe shoku Stalin, që Partia nuk duhet të drejtojë ekonominë, por ta udhëheqë atë. Për shembull kur themi që duhen statistikat, këtë duhet ta bëjë pushteti, kur themi që duhen kryer mbjelljet edhe këtë duhet ta bëjë pushteti. Megjithkëtë Partia këtu ka përgjegjësinë e saj, pse ajo duhet të drejtojë komitetin ekzekutiv, të mësojë, të udhëzojë dhe të edukojë njerëzit e tij. Të marrim një çështje konkrete: mbjelljet. Komiteti ekzekutiv ka planin e fushatës së mbjelljeve. Për këtë punë ai duhet të mobilizojë aparatën e bujqësisë me qëllim që mbjelljet të bëhen në kohën e duhur, por, që të kryhen në kohë këto, ai duhet të sigurojë shatat, parmendat dhe çdo mjet tjetër. Pra, komiteti ekzekutiv është përgjegjës

për të gjitha detyrat, kurse komiteti i Partisë shikon nëse janë në rregull punët, kontrollon, ndihmon, nxit dhe kur ka mungesa që s'varen nga rrethi, i thotë pushtetit, në qoftë se ai nuk kujdeset vetë, që të shkojë dhe të interesohet pranë Ministrisë së Bujqësisë. Këtu, pra, është çështja që Partia të mos i bëjë vetë këto gjëra, por të mësojë dhe të ndihmojë që shokët e pushtetit ta kryejnë mirë detyrën e tyre. Nga ana tjetër Partia mbledh komunistët, të cilëve u thuhet detyrat për mobilizimin e fshatarëve nën udhëzimet e komitetit ekzekutiv dhe, që të zbatohen këto detyra, bëhet kontroll i vazhdueshëm. Kështu duhet të ndahen përgjegjësitë dhe Partia të udhëheqë, të kontrollojë, kurse pushteti, me organizmat e tij, të drejtojë. Vetëm kështu secili kryen si duhet detyrën e tij.

Është koha që Partia të pregatitet mirë për zgjedhjet e saja të reja. Në konferencën e Partisë të rrethit, në raportin e saj byroja të dalë me një kritikë dhe autokritikë të shëndoshë ndaj gabimeve dhe Partia të zgjedhë vetë drejtuesit e saj.

Në Sarandë ka të meta, po ka edhe anë të mira, sepse populli i Sarandës është mobilizuar për zbatimin e vijës së Partisë, sado që armiku mundohet ta pengojë. Partia mund të bëjë edhe më shumë, në rast se ajo mobilizohet edhe më tepër dhe tregohet luftëtare, duke goditur ashpër kulakët dhe monarko-fashistët.

Të luftohet që në konferencë të vijnë nga organizatat bazë shokë dhe shoqe të mirë dhe të thjeshtë të Partisë. T'u thuhet celulave që çdo gjë që kanë për secilin, ta thonë hapët. Në përbërjen e komitetit duhet treguar kujdes që të mos i lëmë shteg propagandës së

armikut të thotë se «këtu e kanë në dorë vetëm këta apo ata njerëz». Për çdo shtrembërim që vihet re, të goditet pa dallim, në mënyrë që të gjithë të shohin realitetin se te ne ka drejtësi të madhe.

Aparati i Komitetit Qendror të Partisë duhet të tregojë më tepër kujdes për të ndihmuar Komitetin e Partisë të Sarandës.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

**TELEGRAM PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR
QEVERISË SË RP TË MONGOLISË ME RASTIN E
30-VJETORIT TË REVOLUCIONIT POPULLOR
MONGOL**

11 korrik 1951

**MARESHALIT ÇOIBALSAN
KRYETAR I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË RP TË MONGOLISË**

Ulan-Bator

Me rastin e 30-vjetorit të revolucionit popullor, festës kombëtare të RP të Mongolisë, më lejoni, shoku Kryeministër, t'Ju dërgoj përshëndetjet dhe urimet më të përzemërta të popullit shqiptar, të Qeverisë së RP të Shqipërisë si dhe të miat personale për popullin mongol, Qeverinë e RP të Mongolisë dhe për Ju personalisht.

Populli mongol me revolucionin e tij popullor përmbysi regjimin feudal dhe gjatë këtyre 30 vjetëve lirie, nën udhëheqjen e Partisë së tij Revolucionare Popullore dhe Tuajën personale si dhe me ndihmën e shum-

anshme të Bashkimit të lavdishëm Sovjetik dhe të shokut të madh Stalin, ka korrur suksese të mëdha në fushën e ndërtimit ekonomik e kultural të vendit dhe në ndërtimin e jetës së re dhe më të lumtur. Këto suksese gëzojnë sinqerisht popullin shqiptar, i cili bashkohet me gjithë zemër me popullin mongol për të festuar bashkërisht këtë ditë të rëndësishme duke i uruar suksese të tjera akoma më të mëdha, për përforcimin e RP të Mongolisë dhe për ruajtjen e paqes.

Rroftë miqësia e pathyeshme midis popullit mongol dhe shqiptar!

Rroftë Bashkimi Sovjetik dhe shoku Stalin, mbrojtësit më të vendosur të paqes dhe të të drejtave të popujve të vegjël!

Gjeneral-Armate

Enver Hoxha

Kryetar i këshillit të ministrave
të RP të Shqipërisë

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 164 (869), 11 korrik 1951

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 164 (869), 11 korrik 1951



**TELEGRAM FALENDERIMI DËRGUAR
ADMIRALIT MULEK**

14 korrik 1951

**ZOTIT ADMIRAL MULEK
PRESIDENT I SHOQATËS FRANCË—SHQIPËRI**

Paris

Ju falenderoj për urimet që më drejtuat me rastin e festës së Ushtrisë Popullore të RP të Shqipërisë dhe gjithashtu Ju uroj për festën e 14 Korrikut Ju dhe nëpërmjet Jush Shoqatën Francë-Shqipëri dhe popullin punonjës të Francës.

Gjeneral-Armate

Enver Hoxha

**Kryetar i këshillit të ministrave
të RP të Shqipërisë**

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 168 (873), 15 korrik 1951*

*Botohet sipas tekstit të gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 168 (873),
15 korrik 1951*

**TELEGRAM PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR
KQ TË PK BULLGARE ME RASTIN E 60-VJETORIT
TË KONGRESIT TË PARË SOCIALIST¹**

2 gusht 1951

**KOMITETIT QENDROR TË PARTISË KOMUNISTE
BULLGARE
SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM VËLLKO ÇERVENKOV**

S o f j e

E gjithë Partia jonë e Punës, Komiteti Qendror i saj dhe unë personalisht, përshëndesim nga zemra Partinë motër Komuniste Bullgare dhe Ju me rastin e përvjetorit të 60-të të Kongresit të parë Socialist në Bullgari.

Kujtimi i themeluesve të shquar të lëvizjes revolucionare të popullit bullgar e të Partisë Komuniste Bullgare, i Bllagoievit, i të madhit dhe i të dashurit

¹ Në këtë kongres, ku u përcaktuan karakteri dhe detyrat e lëvizjes socialiste në Bullgari, u krijua Partia Social Demokrate, nga e cila, më vonë, doli PKB.

Gjergj Dimitrov, i Vasil Kolarovit, është i gjallë dhe i paharrueshëm për komunistët shqiptarë.

Partia jonë i ndjek me admirim sukseset e mëdha të Partisë Komuniste Bullgare dhe të popullit vëlla bullgar me të cilin populli ynë është i lidhur ngushtësisht për jetë.

Partia jonë do ta çelnikosë këtë miqësi dhe besnikëri në mes të popujve tanë, pse ajo është miqësia më e kulluar dhe më e fortë, pse është e mbrujtur dhe e çelnikosur nga mësimet e Leninit e të Stalinit.

Rroftë dhe u forcoftë gjithmonë e më tepër miqësia në mes popujve tanë!

Për Komitetin Qendror të Partisë së
punës të Shqipërisë
Sekretari i përgjithshëm

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 183 (883), 2 gusht 1951*

*Botohet sipas tekstit të gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 183 (883),
2 gusht 1951*

MBI POLITIKËN E BLERJES DHE TË GRUMBULLIMIT TË TEPRICAVE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH*

17 gusht 1951

Fushata e grumbullimit të tepricave përbën një problem me rëndësi të madhe. Kjo çështje duhej të ishte mbështetur më mirë nga Partia. Drejtoria e bujqësisë pranë Komitetit Qendror duhej të kishte dërguar poshtë udhëzime të qarta si të shtrohej e të ndiqej ky problem nga ana propagandistike, sidomos për angazhimet dhe kontraktimet. Për këtë duhej të mblidheshin edhe sekretarët e organizatave bazë, por të shtrohej edhe nga ana shtetërore, pse duke mos e shtruar si duhet në rrugë partie e shtetërore, fshatari mund ta konsiderojë shitjen e tepricave si detyrim dhe ndonjëri mund të dalë edhe me parulla se gjoja tepricat nuk blehen në baza vullnetare.

Tepricat do të blehen dhe do të grumbullohen vetëm atëhere, kur të mobilizohet mirë Partia, kur në dyqane të ketë mallra, pse kjo është një çështje tre-

gëtare¹. Në rast se ne e bindim fshatarin jo vetëm me fjalë, po duke i nxjerrë edhe mallra, atëhere ka vend edhe kontraktimi. Mundet që një njeri të thotë se nuk do të shesë teprica, ky nuk mund të cilësohet armik, po të ndodhë kjo, del që nuk ka kuptim të drejtë për çështjen e shitjes së tepricave shtetit. Edhe në Parti ky problem nuk është shtruar drejt dhe kjo duket në disa raste, kur në mbledhje të Partisë i thuhet komunistit: «Ti duhet t'i shesësh shtetit kaq teprica dhe ti tjetri aq!» ose kur ai të thotë: «Unë do të shes 1 kv», ti i thua: «Jo, ti duhet të shesësh 5 kv». Gjëra të tilla nuk duhet të ngjasin. Plani i grumbullimit të tepricave realizohet vetëm duke i bindur njerëzit dhe duke ngjallë te ata emulacionin për t'i shitur shtetit sa më shumë teprica.

Çështja e tepricave është një çështje tregëtare shtetërore, por edhe partie. Komitetet e Partisë në rrethe të kenë vazhdimisht nën kontroll shpërndarjen e mallrave në bazë të kontraktimit për blerjen e tepricave, pse pa pasur mall për t'u përgjegjur nevojave që ka fshatari, e gjithë puna e Partisë për blerjen dhe grumbullimin e tepricave do të shkojë kot, sepse fshatari nuk të shet teprica, pa i dhënë mall. Këtë duhet ta kishte kontrolluar këmba-këmbës Drejtoria e bujqë-

¹ Me sistemin e ri të grumbullimit dhe të furnizimit, që u aprovua nga Komiteti Qendror i PPSH në janar 1949, fshatarit nuk i merreshin të gjitha tepricat e prodhimeve bujqësore e blegtorale, por vetëm një pjesë e tyre, ndërsa pjesën tjetër e përdorte vetë lirisht. Partia dhe organizatat e masave punonin që fshatari të bindej që këto teprica t'i shkëmbente me pro-

sisë, pse ky është një problem i madh. Po kështu është edhe çështja se kush do ta bëjë grumbullimin. Komiteti i Partisë nëpërmjet organeve shtetërore të kërkojë nga të plotfuqishmit e agjentët e grumbullimit që të interesohen e të mobilizohen jo vetëm për grumbullimin e detyrimeve, por edhe për blerjen e tepricave.

Problemi i grumbullimit të tepricave, mbasi të diskutohet në organizatat bazë të Partisë, të shtrohet dhe në popull, ku në mënyrë bindëse punonjësit e organeve shtetërore t'u flasin fshatarëve për përfitimet dhe aty të dalin në radhë të parë anëtarët e Partisë e të marrin angazhime duke i dhënë tonin mbledhjes. Në këto mbledhje të bëhet edhe një punë e organizuar propagandistike e agjitative, e cila do të nxiste sedrën kush do të shiste më shumë teprica dhe që aty, zjarr për zjarr, të bëhen edhe kontraktimet individuale, në radhë të parë nga komunistët. Krahas kësaj duhet të çohen mallra në dyqanet dhe kjo punë të shoqërohet me një propagandë të gjerë deri në fund. Të nxitet edhe emulacioni midis individëve, fshat me fshat, midis lokaliteteve dhe rrethet me njëri-tjetrin si i realizojnë tepricat. Shumë rrethe kanë marrë angazhime dhe nuk kanë bërë gjë, kurse të tjera si Tirana, Feshkopia etj. e kanë tejkaluar parashikimin në blerjen e tyre. Të gjitha këto që themi, mund të bëhen, sepse ka akoma kohë bile edhe për grurin, pse ka fshatra ku mund të grumbullohet edhe më shumë nga parashikimi ynë.

dhime industriale në kooperativat e shitblerjes, të cilat ishin hallka kryesore e tregëtisë midis fshatit dhe qytetit.

Mendoj ta përsëritim edhe një herë: ne duhet të rimobilizojmë aktivet e fshatit, të bëhet përsëri propagandë, të merren angazhime konkrete dhe të bëhen kontraktimet. Prandaj në kooperativat e shitblerjes duhet që të ketë jo vetëm sa më shumë mallra, po edhe shpërndarja e tyre të bëhet mirë. Problemi nga Partia të mbahet i ngritur derisa tepricat të venë në depo dhe komunistët të punojnë që fshati i tyre ta lajë angazhimin sa më parë; kjo të jetë një nga detyrat e organizatës bazë, që të nxitë fshatarët. Partia në fshat të mbledhë vullnetarisht edhe kafshë për të çuar tepricat në depot e shtetit. Si të mbarohet kjo, të fillohet nga misri, duke përfutur nga njohja e gabimeve që janë bërë për fushatën e grumbullimit të grurit. Ndryshe përpjekjet do të venë kot. Parimet e grumbullimit të mos shkelen. Partia të mos lejojë që të shikohen shtrembër ata që sjellin pak teprica, përkundrazi, të nxitin. Shembull të jenë në radhë të parë komunistët, sepse kjo do të bëjë që në këtë rrugë të ecin edhe fshatarët e tjerë. Kur komunisti të marrë mall me shkëmbime reciproke, të vejë në fshat dhe të bëjë propagandë konkrete.

Edhe në BRSS veprojnë për grumbullimin e tepricave, por atje janë kolkozet, kolektivat janë më të ndërgjegjshme dhe pushteti është më i fortë, kurse te ne kjo punë ka ca vështirësi, pse kemi të bëjmë me dhjetëra mijë fshatarë privatë. Megjithkëtë, po të mobilizohet si duhet Partia, mund të themi se edhe te ne do të bëhet mirë kjo punë. Gjithashtu kooperativat e shitblerjes duhet të bëhen baza grumbullimi direkt jo

vetëm për blerjen e tepricave, po edhe për grumbullimet e detyrueshme dhe kjo gjë duhet të studjohet mirë, sepse kemi të bëjmë akoma me ekonomi private.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

PARTIA TA NDIHMOJË MË SHUMË RININË NË KRYERJEN E DETYRAVE DHE NË FORCIMIN E ORGANIZATËS SË SAJ

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH*

17 gusht 1951

Armiku punon që në organizatën e rinisë ose në aktivet e saj të marrin pjesë sa më pak të rinj e të reja. Qëllimi i tij është që të shkëputë të rinjtë dhe të rejtat nga kjo organizatë e si rrjedhim edhe nga influenca e Partisë. Prandaj, si Partia ashtu edhe vetë rinia duhet të luftojnë që armiku të mos gjejë shteg, për këtë duhet punuar më shumë me rininë që ajo të ngrihet ideologjikisht e të forcohet. Por Partia, në përpjekjet e saja për të forcuar rininë, të ketë kujdes se mos organizatat e rinisë transformohen në organizata partie në kuptimin e disiplinës dhe të kërkesave.

Ne kemi thënë që në organizatën e rinisë nuk duhet të futen njerëz armiq. Po të rinjtë dhe të rejtat, që nuk janë të organizuara, duhet t'i mbajmë afër, të ftohen në mbledhjet e gjera të rinisë dhe të mobilizohen edhe ata për problemet që preokupojnë rininë dhe vendin.

Kjo është një detyrë si për rininë edhe për Partinë. Organizata e Partisë e fshatit nuk mund të punojë pa rininë dhe aktivin e saj; për këtë arsye Partia rekomandon me të madhe një bashkëpunim të tillë. Pasi merren vendime në organizatën e Partisë së fshatit, bëhet mbledhje me njerëzit më të mirë ku diskutohen me ta problemet që dalin nga ky vendim. Po këtu ekziston një rrezik se mos biem në sektarizëm ose shablonizëm dhe kjo mund të vijë, se ka komunistë që nuk janë akoma të ngritur aq sa duhet dhe duke qenë kështu, mund të shpien në rini pikëpamjet e tyre të ngushta duke kopjuar praktikën e organizimit të Partisë. Prandaj duhet të shihet mirë problemi i organizatës së rinisë. Këtu nuk është çështja vetëm te emri: ta quajmë aktiv apo organizatë bazë, por te funksioni, te kuptimi i drejtë në lidhje me punën që duhet të bëjë rinia. Kjo është kryesorja dhe pikërisht kjo gjë duhet parë mirë. A mund të bëhen mbledhje të hapëta me rininë? Pse jo. Ne kërkojmë që të praktikohen edhe në Parti mbledhje të hapëta, e pse të mos bëhen edhe në rini mbledhje të tilla, bile në një shkallë shumë më të gjerë? Vajzat, sidomos, duhet të mbahen më tepër në kujdes nga ana e organizatës së rinisë, që ato të gjallërohen e të aktivizohen më shumë.

Këtu u fol edhe për çështjen që në udhëheqje të rinisë të ketë sa më shumë punëtorë. Kjo është e drejtë, por këtu duhet të ruheni nga format e ngurta, se rinia është rini e nuk është Parti. Pse ka në rini 20 për qind fshatarë të mesëm, nuk është ndonjë krim. Fshatari i mesëm është aleati ynë, prandaj në asnjë mënyrë të mos shihet fshatari i mesëm me syrin që shihet kulaku.

Vërtet duhet të kemi më shumë punëtorë dhe fshatarë të varfër në rini, po nuk duhet të alarmohemi nëse në organizatën e rinisë hyjnë dhe fshatarë të mesëm.

Një kujdes i madh duhet të tregohet për seminarët me kuadrot e rinisë. Ato duhet të bëhen sa më konkrete e të lidhura ngushtë me punën praktike dhe me problemet e rinisë. Kështu do t'i tërheqim më lehtë dhe do t'i edukojmë më mirë të rinjtë. Të bëhen pak gjëra, po saktë dhe ato të lidhen e të përputhen me aspiratat e kësaj organizate. Sa për çështjen e statutit të rinisë, ne e kemi thënë edhe tjetër herë në mbledhje të Byrosë Politike që statuti i rinisë të punohet me kujdes. Por fakti që ka rrethe të tëra ku ai akoma nuk është punuar, veçanërisht në krahina të tilla si në Kelmend e Dukagjin, tregon se nuk është punuar seriozisht për të. Prandaj për këto probleme duhet me i vu mirë pikat mbi «i» dhe të punohet më me ndërgjegje.

Edhe një vërejtje tjetër për një çështje që mendoj se nuk është kuptuar mirë. Është fjala për mungesën e interesimit sa duhet nga ana e disa komiteteve të Partisë për rininë. Ky mosinteresim nga ana e këtyre komiteteve për rininë është i rrezikshëm. Gjithashtu e rrezikshme është edhe mungesa e besimit në rini nga disa komitete partie në rrethe. Ne duhet t'i analizojmë nga vjen e pse vjen gjithë ky mosinteresim e mosbesim. Fakti është që rinia ka dhënë dhe jep vazhdimisht prova besnikërie për Partinë. Vazhdimisht në raporte po na thuhet se Partia nuk interesohet. Si është e mundur të lejojmë që komitetet e Partisë të mos interesohen për rininë? Jo, në asnjë mënyrë s'duhet lejuar kjo. Për këtë duhen marrë masa konkrete. Rinia udhëhiqet nga

Partia, por, që Partia ta ndihmojë si duhet atë dhe ajo Partinë, duhet që edhe vetë komitetet e rinisë të jenë më luftarake si në zbatimin e vijës së Partisë, ashtu dhe në zbatimin e kërkesave të saj. Shoku i rinisë, që bën pjesë edhe në komitetin e Partisë, të jetë ekzigjent për detyrat që i janë caktuar. Ai, jo vetëm të çojë në rini frymën e Partisë, por gjithashtu të sjellë në Parti zërin e rinisë dhe kur është puna për çështje të Partisë ose dhe të rinisë, ai nuk duhet ta ndjejë veten e tij inferior. Nëse sekretari i parë ose sekretarët e tjerë neglizhojnë për ndonjë problem, shoku i rinisë duhet të ngrejë zërin dhe në rast se pikëpamjet e drejta të tija që janë dhe të udhëheqjes së rinisë do të përbuzen, të bëhet çështje deri në Byronë Politike të Komitetit Qendror. Udhëheqja e Partisë duke analizuar kontradiktat do të zbulojë e do të nxjerrë në shesh ku janë e nga vijnë të metat. Pra, kur të ketë kontradikta midis sekretarit të rinisë dhe atij të Partisë, çështja të vijë deri në Komitetin Qendror dhe këtu të shihet se kush e ka fajin. Rinia të punojë dhe të mbrojë Partinë dhe vijën e saj kundër të gjithë atyre që kërkojnë të dobësojnë rolin e rinisë si dhe kompetencat që asaj i ka dhënë Partia, pse po të veprohet kështu puna do të shkojë mirë. Pra, jo vetëm që vetë rinia të gjallërohet më shumë dhe të luftojë për t'i çuar deri në fund vendimet e Partisë si edhe kërkesat e saja, por edhe drejtuesit e Partisë në rrethe duhet që atë ta ndihmojnë dhe të interesohen më shumë për të si dhe të kenë besim më të madh te ajo.

Organizata e rinisë duhet ta ushqejë Partinë edhe me kuadro. Ajo duhet ta furnizojë me kuadro, pse Par-

tia ka vazhdimisht nevojë për ta. Prandaj duhet pasur vazhdimisht kurajë për t'i ngritur në përgjegjësi shokët që merren me punën e rinisë, natyrisht, ata që meritojnë.

Përsa i përket çështjes së përfundimeve të këtij viti mësimor, ngritjet e përqindjeve të kalueshmërisë në shkollat tona nuk janë të mëdha. Përqindja e kalueshmërisë në disa shkolla është shumë e ulët, kurse neve na duhet të arrijmë një përqindje më të lartë, pse të gjithë i kemi parasysh nevojat e mëdha të aparatit të shtetit për kuadro. Prandaj nga rinia kërkohet të shtohen më shumë përpjekjet për një përqindje më të lartë kalimi, pse tani ekzistojnë edhe mundësitë.

Një vërejtje tjetër e kam për një vendim që është marrë më parë nga Byroja Politike: për plotësimin e nevojave të rinisë është vendosur që t'i paraqiteshin kërkesat qeverisë. Qeverisë deri tani asgjë nuk i është paraqitur se ç'nevoja ka rinia. Një studim i tillë mua nuk më ka ardhur në qeveri dhe ky vendim i Byrosë Politike ka mbetur pa u zbatuar. Ky qe një vendim i Byrosë Politike, i cili duhej të ishte zbatuar, prandaj këtë çështje ne duhet ta shohim dhe të nxjerrim shkaqet e vonesës.

Dhe çështja e fundit që kisha, është se ç'duhet të bëjë rinia për blerjen e tepricave të drithit nga fshata-rësia. Organizata e rinisë duhet t'i mbështetë e t'i propagandojë vendimet e Partisë dhe të shtetit në fshat. Lidhur me blerjen e tepricave, si nga Partia, ashtu edhe nga pushteti, nuk është vepruar mirë pse rinia është lënë pa u mobilizuar për këtë problem. Si duhet të veprohet për mobilizimin e saj? Në një mbledhje të

veçantë rinia duhet të ngarkohet me detyra. Ajo duhet të marrë pjesë aktive në luftën për zbatimin e vendimeve të Partisë e të pushtetit. Të rinjtë, sidomos, duhet të diskutojnë, por për këtë qëllim ata kanë nevojë të vihen në korrent për problemet që më parë nga Partia. Në mbledhjen me masën e fshatit, ku Partia do të shtrojë problemin e tepricave, rinia, duke qenë dhe e-pregatitur, duhet të mbështesë vendimet e Partisë për këtë çështje.

Por puna e të rinjve dhe e të rejave nuk duhet të mbarojë me kaq; ata duhet të punojnë edhe me familjet e tyre duke bërë propagandë dhe duke influencuar në to që t'i shiten shtetit sa më shumë teprica. Ata duhet të ndihmojnë kooperativat në kohën e kontratave, që këto të nënshkruhen rregullisht nga ana e fshatarëve për tepricat. Më në fund të rinjtë duhet të jenë të gatshëm për të ndihmuar fshatarët që të shpien tepricat në depo ose të lajmërojnë kooperativat e shitblerjes për t'i blerë ato. Rinia të mobilizohet për të grumbulluar në fshat kafshë për transportimin e tepricave etj. Me një fjalë, rinia ka detyra të mëdha për të mbështetur direktivat e Partisë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

**TELEGRAM PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR
SHOKUT HO SHI MIN ME RASTIN E 6-VJETORIT
TË DITËS SË REVOLUCIONIT DHE TË PAVARËSISË
SË RD TË VIETNAMIT**

1 shtator 1951

**SHOKUT HO SHI MIN
PRESIDENT I REPUBLIKËS DEMOKRATIKE TË VIETNAMIT**

Në emër të popullit shqiptar, të Qeverisë së RP të Shqipërisë si dhe në emrin tim, më lejoni shoku President t'Ju dërgoj përshëndetjet më të përzemërta dhe urimet më të sinqerta popullit heroik vietnamez, Qeverisë së RD të Vietnamit si dhe Juve personalisht me rastin e festës kombëtare të 6-vjetorit të ditës së revolucionit dhe të pavarësisë së Republikës Demokratike të Vietnamit.

Populli shqiptar ndjek me simpati dhe me admirim të veçantë luftën çlirimtare që bën populli trim dhe heroik vietnamez nën drejtimin e Partisë së tij Punëtore, me në krye Ju, shoku President, kundër kolonizatorëve imperialistë francezë, padronëve të tyre amerikano-anglezë dhe tradhëtarëve të vendit.

Ne i urojmë popullit vietnamez fitore të shpejtë mbi armiqtë e tij për çlirimin e gjithë atdheut vietnamez, për lumturinë dhe mirëqenjen e tij dhe për ruajtjen e kauzës së përbashkët të paqes në botë, flamurin e së cilës e mban lart Bashkimi Sovjetik dhe i madhi Stalin.

Enver Hoxha

Kryetar i Këshillit të Ministrave të
RP të Shqipërisë

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 210 (914), 2 shtator 1951*

*Botohet sipas tekstit të gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 210 (914),
2 shtator 1951*

LETËR DËRGUAR DREJTORIT TË MUZEUMIT TË LUFTËS NACIONAL-ÇLIRIMTARE

1 shtator 1951

SHOKU DREJTOR I MUZEUMIT TË LUFTËS
NACIONAL-ÇLIRIMTARE

T i r a n ë

Më lejoni që me rastin e 10-vjetorit të Partisë sonë heroike të Punës, t'i dhuroj muzeumit të popullit një gjë të shtrenjtë: këtë vazo të mbushur me dhé nga Mamai Kurgani i Stalingradit të lavdishëm.

Në prillin e vitit 1951, kur vizitova Stalingradin, e mblodha këtë dhé me duart e mija mbi vorrezat e për-bashkëta të mijëra e mijëra heronjve sovjetikë që ranë të mbuluar me lavdi në majat e kodrës Mamai Kurgan që dominon Stalingradin.

Në këtë tokë që quhet Mamai Kurgan heronjtë ngadhënjyes e legjendarë, ushtarët e Stalinit të madh, e mbrojtën këtë kodër jo pëllëmbë më pëllëmbë, por milimetra për milimetra. Atje tanksat sovjetikë përplaseshin me tanksat e barbarëve fashistë gjermanë, aq i ngushtë

ishte vendi! Atje divizione të tëra luftuan në një përleshje që s'mund të ketë njohur historia dhe në një rrip toke aq të ngushtë saqë mahnite! Toka e Mamai Kurganit u lërua dhe ndërroi shumë herë formën nga bombardimet e tmerrshme, ajo u transformua nga një vend i bukur me bar e me lule që ishte, në një vend të mbuluar me hekur e çelik, me predha të çdo lloji, me tanksa të shkatërruar e të djegur, me kufoma të lavdishme të heronjve legjendarë sovjetikë dhe me kërma të bishave hitleriane.

Por mbi Stalingradin e lavdishëm, mbi Mamai Kurganin valoi kurdoherë ngadhnjimtar dhe i papërkulur kurrë, flamuri i Sovjetëve. Atje ndriti dielli i shpëtimit për të gjithë popujt, atje shkëlqeu si kurdoherë gjenia e Stalinit të madh dhe forca madhështore e Partisë së lavdishme Bolshevike. Në shekuj zemrat e të gjithë njerëzve të ndershëm e të thjeshtë në botë do të rrahin me dashuri dhe mirënjohje të pakufishme për ta dhe do të ndjekin me besnikëri mësimet e tyre, rrugën e tyre që është rruga e komunizmit, e lumturisë, e paqes.

Nga kodra e Mamai Kurganit duket i gjithë Stalingradi, duket lumi i gjerë, Vollga legjendare. Qyteti i lavdishëm u dogj dhe u rrënuar krejtësisht, po, krejtësisht. Ai u dogj, por s'u dorëzua. Ai u bë varri i ushtrive fashiste gjermane.

Por atë që pashë në Stalingrad në prillin e kaluar nuk mund ta përshkruaj dot. Ky qytet gjigand që me heroizmin e tij shpëtoi botën, ishte ndërtuar me një shpejtësi të jashtëzakonshme. Pallate të panumërta dhe madhështore, vila të bukura për punonjësit i kishin ndërtuar ose po i ndërtonin; fabrikat dhe uzinat gjigande

ishin rindërtuar më të bukura e më të fuqishme se më parë. Shkolla, universitete, teatro, kinema, çerdhe e kopshte fëmijësh ishin ndërtuar krejt të reja e të bukura. Rrugët ishin veshur me pemë të reja dhe gjelbëronin, kopshtet dhe parqet ishin plot me lule. Rreth monumenteve të Stalinit luanin e qeshnin të lumtur e të gëzuar fëmijët, sikur të mos kishte ngjarë gjë mbi atë tokë ku shpërtheu furtuna më e tmerrshme e luftës më barbare që është parë deri sot.

Në fabrikën e traktorëve, punëtorët e Stalingradit më thanë: «...ne, dhe shokët tanë që ranë, luftuam edhe për lirinë e popullit vëlla shqiptar, ky ishte vullneti i Stalinit, ne e duam shumë popullin shqiptar dhe tash në paqe punojmë, gjithashtu edhe për të; ne do t'u dërgojmë edhe më shumë traktorë fshatarëve shqiptarë, ky është vullneti dhe porosia e Stalinit...».

Atdheu ynë, Shqipëria, po lulëzon; populli ynë i lirë dhe sovran po ndërton bazat e socializmit nën udhëheqjen e urtë të Partisë së Punës dhe të Komitetit të saj Qendror; ditë më të lumtura e presin popullin tonë. Ne u detyrohemi shumë për këto udhëheqësit dhe mësuesit gjenial Stalinit të madh, Partisë Bolshevike dhe popujve të dashur sovjetikë.

E madhe, e pakufishme, e sinqertë është dashuria e popullit tonë për Stalinin. Atë do ta ruaj populli si sytë e ballit; atë do ta çelnikosë çdo ditë e më shumë.

Dhe ky dhé i Stalingradit, që po ju dërgoj, është i shenjtë për gjithë popujt, pse mbi këtë dhé të shenjtë u luajt fati i tyre dhe i popullit shqiptar.

Ky dhé i shenjtë, i vaditur me gjakun e bijve më heroikë të popujve sovjetikë, le të shërbejë si simbol i

miqësisë së pavdekshme me Bashkimin Sovjetik, le të jetë si simboli i luftës së këtyre për paqen në botë.

Populli shqiptar, që luftoi me heroizëm për jetën e tij, punëtori shqiptar, që derdhi gjak për të flakur përgjithmonë prangat e zgjedhës kapitaliste dhe që sot ndërton dhe drejton fabrika, uzina e kombinate madhështore, fshatari shqiptar që luftoi për tokën, për kashullën, për lirinë, rinia jonë heroike, që la nam në luftën e çlirimit, në luftën e rindërtimit, që lufton me vetëmohim për jetën e re që po gëzon, gratë e Shqipërisë, që luftuan pa pushuar për fitoren, që luftojnë për jetën e lumtur, mëmat shqiptare që nuk duan në asnjë mënyrë t'u vriten përsëri djemtë dhe kalamanët e tyre, drita e syve të tyre, të gjithë pra, si një trup, të luftojmë për paqen, ta mbrojmë paqen me të gjitha forcat tona, pse paqen po e kërcënojnë seriozisht fashistët e rinj, imperia-listët amerikanë dhe anglezë, titistët e Beogradit, monarko-fashistët grekë, fashistët italianë etj. Të mbrojmë paqen pse kështu kemi mbrojtur popullin e atdheun.

Nën udhëheqjen e lavdishme të Partisë heroike të Punës, në rrugën marksiste-leniniste që na tregon Stalini i madh, populli shqiptar kurdoherë do të ecë përpara, kurdoherë do të korrë fitore.

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 920 (226), 21 shtator 1951

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Muzeumin e Luftës nacional-çlirimtare të Tiranës

MBI LIGJSHMËRINË TONË SOCIALISTE DHE FORCIMIN E PUNËS NË ORGANET E DREJTËSISË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ
të PPSH¹*

14 shtator 1951

Ligjet tona pasqyrojnë vijën e Partisë. Nëpërmjet tyre Partia orienton dhe lufton kundër atyre që dëmtojnë interesat e popullit. Por këto ligje janë në një numër shumë të madh dhe në të gjithë sektorët gjendet një pyll letrash, ku përveç gjërave të mira, ka edhe mjaft çështje që kanë kaluar pa u studjuar si duhet. Prandaj ne duhet t'i rishqyrtojmë ato në dinamikën e tyre, duke i spastruar ligjet nga gjëra që s'janë të vlefshme. Edhe ato që do të mbeten, duhet t'i rishikojmë mirë. Pse e them këtë? E them për arsye se këto ligje nuk kanë vetëm një karakter represiv, por edhe edukativ. Kur gabon një njeri, nuk mund të hidhet poshtë menjëherë, po të edukohet që gradualisht të korrigjohet. Njerëzit tanë, që punojnë në gjyqe, kanë

¹ Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti mbi zbatimin e ligjeve nga organet e drejtësisë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 1951.

nevojë edhe për disa gjëra konkrete dhe të qarta, që të jenë më mirë në gjendje ta interpretojnë drejt dhe si duhet vijën e Partisë. Unë propozoj të krijohet një komision, i cili të punojë nën drejtimin e ministrit të drejtësisë, ku të bëjnë pjesë edhe kryetari i Gjykatës së Lartë e prokurori i përgjithshëm e disa juristë dhe brenda një afati të caktuar p.sh. 4-5 muajve, të marrë në shqyrtim të gjitha ligjet duke bërë një spastrim të atyre që nuk na vlejnë neve dhe të propozojë ç'duhet bërë për thjeshtimin e këtyre ligjeve. Ne, me ligjet që kemi nxjerrë, kishim për qëllim të luftonim burokracinë e vjetër, po më duket se kemi hyrë vetë në burokratizëm në këtë sektor, prandaj, me spastrimin e ligjeve e të dispozitave të pavlefshme, do t'u japim fund këtyre të metave. Është mirë që punën e komisionit ta udhëheqë një shok i Byrosë Politike, i cili të orientojë, të kontrollojë e të ndjekë nga afër gjithë këtë punë të madhe.

Përsa u përket kuadrove, që kryejnë studimet e larta për drejtësi, duhet që ministria përkatëse të interesohet për ta. Ne kemi menduar në Sekretariat që në drejtësi si inspektor mund të merret ndonjë prej tyre, por nga ky kontingjent u duhet dërguar edhe rretheve. Çështjen e trajtimit të tyre ne mund ta shohim në Byronë Politike, po rëndësi ka që këta njerëz të dërgohen edhe poshtë në terren. Përveç kësaj ndonjë prej tyre duhet t'ja japim edhe hetuesisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme si dhe Ministrisë së Tregëtisë së Jashtme. Këto kuadro jo vetëm duhet t'i japim, por edhe t'i ndihmojmë.

Kisha një çështje për ju, shokë të Gjykatës së Lartë: kur merrni vendime për burgime, duhet t'i kontrolloni

mirë, gjithashtu edhe kur ktheni vendime, t'u thoni vartësve tuaj poshtë, arësytet pse e bëni këtë gjë. Kështu në gjyqtarët e rretheve do të zhvillohet një sedër e tillë që secili, kur i priset një vendim nga lart, ta quajë këtë një gjë të madhe e të nxitet që të punojë më mirë. Kjo është një çështje e rëndësishme, të cilën Gjykata e Lartë duhet ta bëjë dhe ndaj atij që nuk punon mirë, sipas rastit, të merren edhe masa shtetërore.

Një problem tjetër është edhe ai i ndihmësgjyqtarëve popullorë, që rrinë nga 15 ditë dhe lënë çështje të papërfunduara. Kjo gjë është theksuar edhe herë tjetër, po, me sa duket, çalon akoma. Prandaj të ngrihet përsëri problemi si në rrugë partie, ashtu dhe në rrugë shtetërore dhe të jepen udhëzime nga ana e Ministrisë së Drejtësisë që ndihmësgjyqtarët popullorë, gjatë 15 ditëve të punës së tyre, të kenë patjetër një plan pune të caktuar ku të figurojnë cilat gjyqe do të fillojnë dhe ato, që do t'i fillojnë, duhet t'i mbarojnë, ndryshe gjyqet tona nuk do të marrin fund kurrë. Ndihmësgjyqtarët popullorë, në këto 15 ditë, duhet të harrojnë të gjitha detyrat e tjera dhe të punojnë në gjykatë me ndërgegje të plotë.

Përsa u përket vjedhjeve të pasurisë private, duhet të gjejmë mënyra që një person të mos e futin në burg edhe për një kapistër, siç ka ndodhur në Vlorë. Ne duhet të shohim me kujdes edhe çështjen e nomenklaturës që u propozua¹, e cila nuk i heq inisiativën prokurorit popullor.

Ju të Gjykatës së Lartë nuk duhet të lidhni duart

¹ Është fjala për kushtet e nevojshme që kërkohen lidhur me gjykimin e lirë ose në gjendje arresti të personave që kryejnë krime, të cilat nuk paraqitin rrezikshmëri shoqërore shumë të madhe.

e të thoni se «nuk kemi rregullore dhe kompetenca». Në gjykatë ka disa gjëra për të cilat duhet të mendohet e të punohet që të vendosen definitivisht, por derisa të bëhet kjo, nuk duhet të rrimë dhe të lëmë gjërat pezull, përkundrazi, duhet të bëjmë diçka më të studjuar dhe praktika do t'ju tregojë si do të punohet në të ardhshmen.

Rastet që na u thanë këtu, tregojnë se çështjet e drejtësisë dhe politika e goditjes duhet ta preokupojnë më shumë sekretarin e parë të Partisë në rreth, i cili të nxjerrë konkluzione, të mendojë pse bëhen gjithë këto krime dhe dënime. Ata duhet të kuptojnë mirë se ç'është drejtësia dhe ç'janë ligjet tona. Prandaj këtë gjë ne duhet t'ja theksojmë Partisë, pse organet e drejtësisë kanë rëndësi të madhe për Partinë. Në organet tona të drejtësisë duhet të luftohet kundër shfaqjeve të influencave borgjeze. Për këtë gjë shokët tanë duhet të punojnë e të mos thonë për çdo gjë se «kjo është borgjeze». Gjyqtarët tanë të rinj duhet të njohin mirë ligjet tona, frymën e tyre revolucionare dhe t'i zbatojnë ato me përpikëri të madhe.

Kur të dalë Kodi penal¹ të mos thuhet se kjo është burokraci, po të ecet në rrugën që tregon ai. Çdo zangat ka rregulloret e veta, prandaj nuk duhet të ecet me sy mbyllur.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

¹ Kodi penal hyri në fuqi më 1.9.1952.

R A P O R T
«MBI DIREKTIVAT E PLANIT TË PARË
PESEVJEÇAR 1951—1955» MBAJTUR NË PLENUMIN
XI TË KQ TË PPSH

21 shtator 1951

Shokë,

Në emër të Byrosë Politike, ju parashtroj për diskutim dhe aprovim direktivat e projektplanit të parë pesëvjeçar 1951—1955 si edhe shifrat orientuese të këtij plani. Këto pasi të aprovohen, të shërbejnë si orientim pune për të gjitha organet qeveritare dhe institucionet ekonomike në hartimin definitiv të projektplanit pesëvjeçar.

Plani pesëvjeçar i zhvillimit të ekonomisë sonë popullore do të jetë një program madhështor që do të shërbejë për ngritjen e mirëqenjes së popullit, për rritjen dhe forcimin e ekonomisë sonë popullore, të kulturës, të arësimit etj. Për herë të parë në historinë e tij shekullore, populli ynë arriti, në ditët e sotme, të zhvillojë ekonominë popullore në bazë të një plani të hartuar mbi themelitë e çelnikta të parimeve marksiste-leniniste e mësimet staliniane. Kjo u bë reali-

tet për arsye se populli shqiptar u çlirua përgjithmonë nga robëria e rëndë politike dhe ekonomike, ku e mbanin të lidhur me zinxhirë okupatorët e ndryshëm: imperialistët, fashistët dhe tradhëtarët e vendit, feudalët dhe borgjezia. Këtë fitore të madhe populli shqiptar e arriti, pse ai u çlirua përgjithmonë në saje të luftës së tij legjendare i udhëhequr nga Partia heroike e Punës, në saje të fitores mbi nazizmin gjerman të Ushtrisë heroike Sovjetike dhe në saje të përkrahjes së popujve vëllezër të Bashkimit Sovjetik e të Stalinit të madh. Në saje të këtyre faktorëve populli ynë mundi të marrë në duart e veta drejtimin politik dhe ekonomik të vendit, të ndërtojë në vendin e tij të pavarur demokracinë popullore, të ecë me hapa të sigurtë në rrugën e ndërtimit të bazave të socializmit dhe të hartojë planin e parë ekonomik pesëvjeçar.

Përpjekjet e popullit shqiptar për t'ua arritur këtyre ditëve të lumtura kanë qenë madhështore. Që prej ditës së çlirimit të vendit dhe deri më sot, populli ynë ka korrur në të gjitha lëmet ekonomike, politike, shoqërore, suksese të panumërta dhe të mëdha, të cilat i kanë ndërruar faqen e vendit, e kanë kthyer Shqipërinë nga një vend i prapambetur, në një vend të përparuar, ku janë ndryshuar si dita me natën mënyra e jetesës dhe raportet shoqërore e ekonomike në krahasim me të kaluarën e zezë. Shqipëria nuk është më ajo e kaluara, ku sundonte kërbëçi i feudalit dhe i borgjezisë, ku sundonte shfrytëzimi i tmerrshëm i tyre dhe i okupatorëve. Kjo gjendje e tmerrshme, që sot na duket si ëndërr, u zhduk përgjithmonë. Populli shqiptar tani është zot i fateve të tij dhe ai e ndërton jetën dhe

vendin e tij në shembullin e shkëlqyer të popujve sovjetikë, sipas mësimeve të Leninit dhe të Stalinit. Kjo gjë ka bërë që vendi ynë t'u rezistojë të gjitha furtunave të pasluftës, intrigave të panumërta të armiqve gjakatarë të popullit tonë dhe të të gjithë popujve të botës, imperialistëve amerikanë dhe anglezë, shantazheve dhe kërcënimeve të tyre direkte dhe të hapëta, t'u rezistojë me heroizëm shantazheve dhe kërcënimeve të titistëve të Beogradit dhe i ka dërmuar pa shpresa ringjalljeje të gjitha tentativat e agjentëve të tyre që vepronin brenda dhe jashtë Partisë sonë. Populli ynë u ka rezistuar me sukses monarko-fashistëve grekë dhe fashistëve italianë, të cilët s'ka ditë dhe javë që të mos kurdisin njëmijë e një shantazhe dhe provokacione. Kjo ka vënë qartë në dukje vitalitetin e madh dhe atdhedashurinë e pakufishme të njerëzve të vendit tonë, dashurinë e pakufishme për të rrojtur të lirë e në paqe dhe vendosmërinë e tyre për të mbrojtur me çdo kusht jetën e re dhe të lirë, atdheun e tyre të pavarur dhe sovran.

Por përpjekjet e imperialistëve amerikano-anglezë për luftë grabitqare janë shtuar jashtëzakonisht dhe përgatitjet e tyre për të hedhur përsëri njerëzimin në një luftë tjetër botërore po bëhen dita-ditës më kërcënuese. Bota po kërcënohet seriozisht nga imperialistët gjakatarë amerikano-anglezë dhe satelitët e tyre. Ata po përgatitin me shpejtësi luftën, ata kanë flakur çdo masë për t'ja arritur objektivit të tyre, luftës kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore.

Imperialistët amerikanë dhe anglezë janë bërë si qentë e tërbuar që kanë këputur zinxhirët. Ata po

armatosen me shpejtësi, po armatosin satelitët e tyre, vendet e marshallizuara, ata po krijojnë në të katër anët e botës baza ushtarake, po armatosin hitlerianët e Gjermanisë Perëndimore dhe po rikrijojnë Vermahtin gjerman për ta përdorur si forcë kryesore agresive në Evropë. Imperializmi amerikan i ka katandisur në koloni të tija të thjeshta të gjitha vendet e marshallizuara të Evropës Perëndimore si dhe Jugosllavinë, Greqinë, Turqinë e vendet e Lindjes së Mesme. Populli atje po shfrytëzohet çdo ditë e më tepër nga ndërhyrja e kapitalit amerikan. Në këto vende po përgatitet lufta në mënyrë intensive nën drejtimin direkt të ushtarakëve amerikanë. Me traktatin që lidhën banditët amerikanë dhe satelitët e përgjunjur të tij në San Françisko¹, ata konfirmuan edhe një herë qëllimet e tyre agresive dhe përgatitjet e tyre të hapëta për luftë. Traktati me Japoninë, nuk bie fare crë si një traktat paqeje që të ndihmojë vendosjen dhe mbrojtjen e paqes, por ai është thjesht një traktat që përgatit luftën. Ai e katandisi Japoninë një «place d'armes» amerikane, për një agresion të ri në Lindjen e Largme, kundër Bashkimit Sovjetik dhe Republikës Popullore të Kinës, e katandisi Japoninë një koloni thjesht amerikane. Me këtë traktat imperialistët treguan haptas se kanë qëllim të ringjallin dhe të organizojnë ushtrinë e vjetër fashiste dhe agresive japoneze për ta pasur si forcë për të sulmuar Bashkimin Sovjetik, Kinën dhe gjithë popujt e tjerë liridashës të Azisë.

¹ Më 8 shtator 1951, SHBA në mënyrë të njëanshme nënshkroi në San-Françisko Traktatin e Paqes me Japoninë.

Imperialistët amerikanë dhe anglezë si dhe satelitët e tyre kanë shkelur të gjitha traktatet ndërkombëtare të pasluftës, ata e kanë katandisur organizatën e Kombeve të Bashkuara një agjenci të thjeshtë të Departamentit të Shtetit Amerikan dhe nën flamurin e saj, ata kanë më tepër se një vit që kanë shpërthyer sulmin e poshtër mbi popullin heroik korean, ku si bisha të tërbuara po bombardojnë, po vrasin e po masakrojnë banorët e pafajshëm dhe paqësorë të këtij vendi martir e heroik. Barbarizmat e amerikanëve në Kore nuk kanë shembull në historinë e njerëzimit dhe ua kanë kaluar vandalizmave të hitlerianëve.

Më afër vendit tonë, në Jugosllavinë titiste, imperialistët amerikanë po hedhin kthetrat e tyre çdo ditë e më tepër; Tito e grupi i tij u kanë hapur dyert banditëve amerikanë. Jugosllavia e Titos po bëhet një fole e rrezikshme në Evropë dhe në Ballkan.

Jugosllavia është shndërruar në një kamp përqëndrimi dhe burgjesh për komunistët e vërtetë. UDB-ja është bërë tmerr për popullin. Borgjezëve të rinj të Beogradit, si Tito, Kardel, Rankoviç, Tempo, Gjilas e të tjerë u janë çjerrë të gjitha maskat dhe tani kanë dalë me fytyrat e vërteta prej agjentësh të amerikanëve e të anglezëve dhe luajnë hapët lodrën e tyre prej tradhëtarësh. Ata, nën drejtimin e amerikanëve, po lidhen në aleancë ushtarake me monarko-fashistët grekë dhe me reaksionarët turq për qëllime agresive kundër vendit tonë, kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore.

Por përballë armiqve të tërbuar të njerëzimit përparimtar e paqedashës, politika luftënxitëse e të cilëve

po dështon në çdo fushë, qëndron kampi i fuqishëm i paqes me Bashkimin e lavdishëm Sovjetik dhe Stalinin e madh në krye. Gjithë popujt e botës i urrejnë luftërat agresive dhe miliona e miliona njerëz në botë, kanë forcuar radhët e kampit të fuqishëm të paqes. Njerëzit e thjeshtë të të gjithë botës kanë shtërnguar radhët e tyre në kampin e paqes dhe luftojnë me heroizëm kundër luftënxitësve amerikanë, anglezë, kundër shërbëtorëve dhe spiunëve të tyre, kundër Paktit të Atlantikut Verior e traktateve të tjera agresive.

Shoku Stalin ka thënë:

«Paqja do të ruhet dhe do të forcohet, në qoftë se popujt do ta marrin në duart e veta çështjen e ruajtjes së paqes dhe do ta mbrojnë atë deri në fund»¹.

Këto fjalë largpamëse të shokut Stalin janë bërë fanar që ndrit rrugën e njerëzimit përparimtar. Me fjalët e Stalinit të madh frymëzohen qindra milion njerëz në luftën për mbrojtjen e paqes. Lufta e njerëzve të paqes po ua prish planet luftënxitësve. Njerëzit e ndershëm e të thjeshtë të të gjithë kontinenteve, në këtë luftë gjigante për mbrojtjen e paqes, për mbrojtjen e jetës së miliona njerëzve, të kulturës e të pasurive të popujve, janë grumbulluar rreth Bashkimit Sovjetik dhe Stalinit të madh. Politika tej pamëse dhe paqësore

¹ J. V. Stalin. Bisedë me korrespondentin e gazetës «Pravda». «Pravda», Nr. 48 (11885), 17 shkurt 1951.

e Bashkimit Sovjetik po ua gjerr maskën imperialistëve gjakatarë. Planet e tyre djallëzore po demaskohen pa mëshirë nga Bashkimi Sovjetik e vendet e demokracisë popullore dhe ata do të dështojnë në orvatjet e tyre të egra.

Lufta nuk është e paevitueshme, por populli dhe Partia jonë duhet të shumëfishojnë vigjilencën dhe përpjekjet për ta mbrojtur me heroizëm dhe me këmbëngulje lirinë, të jenë më të mëdha. Ne kemi nevojë për paqen dhe lirinë, sepse paqja dhe liria na janë të nevojshme si buka, si ajri, si dielli që na ngroh e na jep jetë.

Partia dhe populli ynë luftojnë për paqen dhe socializmin dhe një nga provat e shkëlqyera të kësaj lufte është plani ynë pesëvjeçar.

Në një kohë kur në vendet e marshallizuara, në një kohë kur në Jugosllavinë titiste, në Greqinë monarko-fashiste, në Italinë e neofashistëve, popujt vuajnë dhe rrojnë nën frikën e kërbaçit dhe të papunësisë, në një kohë kur në këto vende po bëhen përgatitje për luftë, në vendin tonë po ndërtohet një ekonomi e re për lumturinë dhe begatinë e popullit, po ngrihet niveli i jetesës së popullit, po çelen shkolla dhe universitete të reja, po ndërtohen kombinatë madhështore, po ndërtohen me dhjetëra e me dhjetëra fabrika të reja, po zgjerohen minierat dhe këto po mekanizohen e po modernizohen për të prodhuar sa më shumë për lumturinë e popullit; po ashtu bujqësia përparon, fshatari pasurohet dhe tok me të i gjithë populli shqiptar. Te ne po zhduket injoranca e po luftohen me sukses sëmundjet. Brezi i ri i vendit tonë po edukohet me një kulturë

të shëndoshë, kombëtare nga forma dhe socialiste nga përmbajtja, po edukohet me një patriotizëm dhe dashuri të madhe për atdheun, me një dashuri të pakufishme për popullin e Partinë e tij, për Bashkimin Sovjetik e të madhin Stalin.

Lumturinë dhe begatinë që kemi fituar duhet t'i ruajmë nga armiqtë e egër që na rrethojnë dhe që na kanë halë në sy; duhet të forcojmë fuqinë mbrojtëse të vendit tonë; duhet të shumëfishojmë vigjilencën ndaj armiqve të brendshëm e të jashtëm; të godasim ashpër dhe të shpartallojmë pa mëshirë të gjitha tentativat e atyre që mundohen të na dëmtojnë në rrugën tonë ndërtimtare. Të jemi të pamëshirshëm kundër armiqve të vendit tonë të pavarur dhe kurdoherë vigjilentë e të gashtëm për të bërë të dështojë çdo orvatje e tyre kundër jetës së popullit, integritetit e pavarësisë së atdheut tonë. Gjithashtu këtë pasuri dhe begati që ka krijuar populli ynë duhet ta shtojmë dhe ta shumëfishojmë në interes të tij dhe të brezave të tij të ardhshëm. Këtë qëllim ka plani ynë pesëvjeçar që po hartojmë.

KUSHITET REALE PËR HARTIMIN E PLANIT TË PARË PESEVJEÇAR

Shokë, e madhe dhe bujare ka qenë për popullin tonë ndihma e qeverisë sovjetike dhe e shokut Stalin. Kurrë populli ynë nuk do t'ua harrojë këtë ndihmë. Për jetë do t'u jetë mirënjohës. Në vendin tonë, kudo dhe në çdo moment, ndjehet dhe duket dora e forca

udhëheqëse e Partisë sonë, që ka dhënë prova të shkëlqyeshme si dje në udhëheqjen e luftës edhe sot në ndërtimin e vendit që ecën drejt socializmit. Kudo ndjehet ndihma e fuqishme e Bashkimit Sovjetik dhe e Stalinit të madh. Këtë e dëshmon atdheu ynë i rindërtuar, e tregon liria që ne gëzojmë në vendin tonë, e dëshmon pavarësia e atdheut tonë, e dëshmon përmirësimi i jetës së popullit tonë, besimi në forcat e tija të gjalla, për këtë dëshmojnë kombinatet, fabrikat, uzinat, traktorët që çajnë fushat tona, shkollat dhe institutet e reja që do të hapim sivjet¹; për këtë flasin njerëzit e klasës sonë punëtore, që edukohen nga Partia nën shembullin dhe eksperiencën e punëtorëve sovjetikë.

Shokë të Komitetit Qendror,

Si kurdoherë edhe për planin tonë pesëvjeçar, ndihmat e Bashkimit Sovjetik dhe të qeverisë sovjetike e personalisht të shokut Stalin kanë qenë të mëdha. Ata i kanë shqyrtuar kërkesat për kredi që ka kërkuar qeveria jonë me një kujdes të veçantë dhe me përzierje të bujari, duke na akorduar gjithshka që u kërkuar. Të vështirë do ta kishte populli shqiptar, që në një kohë kaq të shkurtër, të ndërtonte këtë industri që po ndërton sot, të ndërtonte këto hidrocentrale, këto hekur-

¹ Është fjala për tri institute të larta: Instituti pedagogjik, politeknik dhe bujqësor, që u çelën më 1 nëntor 1951; dy të parët dhe disa të tjerë që u hapën më vonë, ishin bërthama e Universitetit Shtetëror të Tiranës që u krijua më 16 shtator 1957.

udha, këto shkolla dhe institute të larta, të zhvillonte minierat në këtë shkallë e t'i modernizonte këto. Por ja që këto u bënë një realitet i shkëlqyer dhe i prekshëm nën udhëheqjen e Partisë së Punës dhe me ndihmën e Bashkimit Sovjetik. Me përzemërsi të madhe u shqyrtuan gjithashtu kërkesat e qeverisë sonë nga ana e qeverive të vendeve të demokracisë popullore. Këto qeveri të vendeve mike na kanë akorduar kredi të kënaqshme dhe të favorshme që janë një mbështetje për popullin dhe për qeverinë tonë për hartimin e planit pesëvjeçar.

Duke u mbështetur në këtë ndihmë që na është akorduar, populli ynë me Partinë e Punës në krye, si kurdoherë, do të dalë me sukses në këtë ndërmarrje kaq të madhe, siç është realizimi me sukses i planit pesëvjeçar.

Ja sepse, shokë, një entuziazëm i papërshkrueshëm do të ngjallet në masat e gjera të popullit, kur ai do të marrë vesh vendimet historike që do të marrë ky plenum në prakun e festës së madhe, 10-vjetorit të themelimit të Partisë sonë të lavdishme. Gjallëri dhe heroizma të panjohur deri tani do të manifestohen në masat e popullit për realizimin me sukses të planit pesëvjeçar. Me dashuri dhe me mirënjohje të pakufishme do të mbushen zemrat e popullit tonë për Partinë e tij heroike, për Bashkimin Sovjetik, për Partinë e madhe Bolshevike dhe për Stalinin. Uniteti moral e politik i popullit tonë do të forcohet edhe më shumë, do të lulëzojë akoma më shumë vendi dhe akoma më e bukur do të bëhet jeta e punonjësve të Shqipërisë së re. Të gjitha konditat reale ekzistojnë që plani pesëvjeçar të reali-

zohet më sukses. Për t'ja arritur kësaj dite ka punuar me vetëmohim dhe me heroizëm populli dhe Partia. Partia jonë heroike, që ndjek me besnikëri mësimet e Leninit e të Stalinit, ka punuar me pjekuri dhe urtësi të madhe për të krijuar këto kondita.

Në saje të përpjekjeve të mëdha të klasës sonë punëtore, të fshatarësisë dhe të masave të gjera punonjëse, vendi ynë gjatë këtyre vjetëve ka arritur rezultate të padëgjua ndonjëherë në historinë e tij.

Partia dhe qeveria jonë, të mbështetura fuqimisht mbi parimet e marksizëm-leninizmit, realizuan me sukses një sërë masash dhe reformash, të cilat qenë ndër faktorët kryesorë për krijimin e raporteve të reja në prodhim, për futjen e ekonomisë sonë në rrugën e planifikimit, për ndërtimin e bazave të socializmit në atdheun tonë.

Zbatimi i ligjit mbi tatimet e jashtëzakonshme të luftës dhe konfiskimi i pasurive të armiqve të popullit jo vetëm që siguruan të ardhura shtetërore për të përballuar nevojat e mëdha të pasluftës, por njëkohësisht qenë një goditje e fortë mbi borgjezinë e vendit dhe elementët spekulatorë.

Zbatimi i drejtë i reformës agrare, fitore e madhe politike dhe ekonomike, jo vetëm që goditi çifligarët dhe bejlerët si klasë, por hodhi bazat e reja të zhvillimit të bujqësisë sonë, hodhi baza parimisht të reja për marrëdhënjet midis qytetit dhe fshatit dhe e vuri bujqësinë në një rrugë zhvillimi krejt të ndryshme nga e kaluara. Në saje të masave që kanë marrë Partia dhe qeveria është eliminuar një herë e përgjithmonë rreziku

i shkatërrimit të fshatit. Bujqësia jonë sot ecën gjithmonë drejt zhvillimit dhe forcimit të saj. Krijimi dhe forcimi i sektorit shtetëror, i fermave dhe i stacioneve të maqinave e të traktorëve si dhe ngritja e forcimi i sektorit kooperativist në bujqësi, janë baza socialiste e zhvillimit të ardhshëm të bujqësisë sonë.

Centralizimi i kreditit në duart e shtetit si dhe politika e re financiare¹ krijuan një shpërndarje parimisht të re të të ardhurave kombëtare. Është rritur gradualisht akumulimi shtetëror si dhe fuqia blerëse e masave të gjera punonjëse.

Centralizimi i mjeteve të transportit në duart e shtetit, shtetëzimi i minierave, i industrisë etj., likuidimi i koncesioneve të kapitalit të huaj dhe i shoqërive të kapitalit të brendshëm, qenë një faktor determinues për kalimin e mjeteve të prodhimit nga duart e shfrytëzuesve në duart e shtetit e të popullit dhe krijuan raporte të reja në prodhim.

Krijimi dhe forcimi i tregëtisë shtetërore e kooperativiste dhe rritja e përgjithshme e volumit të prodhimeve industriale e bujqësore, kanë siguruar një ngritje të nivelit material të masave punonjëse të qytetit e të fshatit. Tregëtia socialiste është bërë baza kryesore e furnizimit në vendin tonë dhe përfshin pjesën dërmuese të qarkullimit të mallrave të konsumit të gjerë.

1. Më 1947 buxheti u kthye në plan financiar për gjithë ekonominë e vendit, tatimet humbën karakterin e tyre fiskal, banka u bë qendra e vetme e kredive dhe e llogarisë, tatimi mbi xhiron e ndërmarrjeve ekonomike dhe tepricat e fitimeve të tyre u bënë format kryesore të të ardhurave të buxhetit.

Kalimi nga sistemi i vjetër i grumbullimit¹, në sistemin e grumbullimit në bazë të hektarëve, ka qenë një faktor me rëndësi për sigurimin e fondit shtetëror të drithërave, ka zhvilluar akoma më shumë inisiativën dhe ndërgjegjen e fshatarësisë punonjëse për rritjen e prodhimeve të saj, si dhe për forcimin e marrëdhënjeve midis qytetit dhe fshatit.

Sektori shtetëror në saje të pushtetit popullor, si rezultat i shtetëzimit të degëve më me rëndësi të ekonomisë, u forcua duke u bërë në këtë mënyrë sektori predominues në tërë ekonominë e vendit. U rrit në mënyrë të dukshme, në krahasim me paraluftën, niveli material dhe kultural i masave të gjera punonjëse, të cilat, të sigurta në të ardhshmen, mobilizohen përditë e më shumë për ndërtimin e bazave të socializmit.

U krijuan mundësitë e drejtimit të planifikuar të ekonomisë popullore. Planifikimi është bazuar në politikën e Partisë dhe të qeverisë, e cila synon në zhvillimin e mëtejshëm të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë dhe në shkuarjen drejt zhdukjes së disproporcioneve që ekzistojnë, sidomos, në mes fshatit dhe qytetit. Planifikimi ka pasur përmirësime nga viti në vit dhe në përgjithësi planet tona kanë shprehur mundësitë reale të zhvillimit ekonomik të vendit tonë.

Por eksperiencia e drejtimit të planifikuar na tregon se planet tona kanë pasur nevojë për korrigjime dhe ndryshime të ndieshme dhe ka pasur raste të shthurjes

¹ Sipas sistemit të vjetër të grumbullimit, fshatarëve u merreshin të gjitha tepricat e prodhimit të drithit.

së disiplinës së planit, të mosorganizimit të mirë të kontrollit mbi zbatimin e planit etj.

Që prej çlirimit e këtej, populli ynë, duke pasur në duar pushtetin politik dhe drejtimin e ekonomisë, mundi të rimëkëmbë forcat prodhuese dhe t'i zhvillojë këto duke arritur dhe duke tejkaluar nivelin e paraluftës.

Plani dyvjeçar 1949—1950 ka qenë një faktor me rëndësi për zhvillimin e ekonomisë popullore dhe realizimi i tij shënoi rezultate të kënaqshme. Vëllimi i përgjithshëm i prodhimeve më 1950, në krahasim me atë të paraluftës, është rritur shumë. Vëllimi i prodhimit të minierave arriti 374,4 për qind, ai i prodhimeve të industrisë 301,1 për qind, bujqësia bëri hapa të rëndësishëm përpara. Investime të mëdha u kryen në sektorët e tjerë ekonomikë dhe kulturalë. Rëndësi e veçantë ju kushtua rritjes së industrisë vajgurore, bazë e rëndësishme e ekonomisë sonë. U rrit prodhimi i kromit, i qymyrit, i bakrit, i bitumit etj.

Gjatë planit dyvjeçar u arritën suksese në racionalizimin dhe koncentrimin e industrisë së lehtë ekzistuese dhe filluan ndërtimet madhështore për ngritjen e objekteve të industrisë së re siç janë: Kombinati i tekstileve «Stalin», Hidrocentrali «Lenin», Fabrika e sheqerit «8 nëntori» në Maliq, Fabrika e zhveshjes së pambukut në Fier e shumë objekte të tjera të rëndësishme, të cilat mbarojnë dhe vihen në funksionim sivjet. Këto objekte janë bazë e rëndësishme e industrisë sonë, e cila do të bëjë të rritet fuqia ekonomike e vendit dhe përmirësimi i konditave materiale të popullit.

Në saje të planit dyvjeçar u përmirësua raporti në strukturën e ekonomisë popullore, në drejtimin e rritjes

së prodhimeve industriale. Është përcaktuar në mënyrë të drejtë orientimi i zhvillimit të bujqësisë, duke pasur për qëllim sigurimin e bukës së popullit dhe përhapjen e kulturave industriale, në radhë të parë të pambukut, të panxhar sheqerit, të duhanit etj., të cilat duhet të plotësojnë nevojat e industrisë sonë dhe të rritin eksportimet.

Sipërfaqja e përgjithshme e tokës së mbjellshme, në krahasim me paraluftën, arriti 152,2 për qind, sipërfaqja e mbjellshme me drithëra 127 për qind dhe ajo me kultura industriale 1 069,2 për qind.

Është rritur në mënyrë të kënaqshme parku i të gjitha automjeteve të transportit dhe është krijuar baza e transportit hekurudhor, e cila do të lehtësojë qarkullimin e mallrave si dhe uljen e shpenzimeve të transportit.

Është rritur qarkullimi i mallrave të konsumit të gjerë dhe xhirua e përgjithshme e tregëtisë shtetërore e kooperativiste, në krahasim me vitin 1948, arriti në 195 për qind. Janë forcuar financat tona.

Paralelisht me këtë zhvillim të sektorit ekonomik janë zhvilluar dhe arësimi, arti, kultura, shëndetësia etj. Arësimi në vendin tonë jepet falas, arësimi fillor është i detyrueshëm dhe numri i institucioneve arësimore është rritur nga viti në vit. Shuma të konsiderueshme kanë qenë parashikuar në buxhetin e çdo viti për mbrojtjen e shëndetit të popullit si dhe për zhvillimin e artit dhe të kulturës.

Është rritur dhe është forcuar klasa punëtore, e cila, e sigurtë në të ardhshmen e saj të lumtur, mobilizohet përditë e më shumë dhe lufton në ballë të punës për realizimin e planit të shtetit, për ndërtimin e bazave të socializmit. Klasa jonë punëtore ka përfituar nga

eksperienca e punëtorëve sovjetikë, ka rritur dhe zhvilluar emulacionin socialist dhe ka zbatuar në një shkallë të gjerë sistemin e punës me norma. Kjo ka sjellë si rezultat që të shtohet numri i sulmuesve dhe të krijohen kondita për zgjerimin e mëtejshëm të lëvizjes së punëtorëve të pararojës.

Këto rezultate të arritura me planin dyvjeçar janë një mbështetje e madhe për hartimin e planit të parë pesëvjeçar. Këto rezultate tregojnë se ekonomia jonë i ka të gjitha mundësitë të zhvillohet me një ritëm më të shpejtë. Këto tregojnë se ekzistojnë konditat objektive për hartimin e planit tonë pesëvjeçar.

Vendi ynë ka pasuri që garantojnë zhvillimin më të madh të ekonomisë. Kemi naftë, krom, bakër, bitum, prodhojmë pambuk, panxhar sheqeri, duhan e shumë bimë të tjera; në vendin tonë prodhohet grurë, misër dhe drithëra të tjera; në atdheun tonë mbillen dhe rriten për bukuri ullinj të, portokallet, limonat e të tjera pemë frutore. Këto pasuri të mëdha janë në duar të popullit dhe shfrytëzohen për interesin e tij.

Pushteti popullor është i aftë për ta drejtuar ekonominë dhe për t'i shfrytëzuar si duhet këto pasuri, pse në fuqi është klasa punëtore dhe pararoja e saj, Partia; në pushtet janë njerëzit më të mirë të punëtorëve e të fshatarëve, të cilët ecin me vendosmëri në rrugën e socializmit.

Ky pushtet është nga më demokratikët, pse është pjellë e popullit dhe ka përkrahjen e plotë të punëtorëve, të fshatarëve dhe të të gjitha masave punonjëse të vendit.

Në saje të futjes së ekonomisë në rrugën e planifi-

kimit dhe në saje të rezultateve të arritura deri më sot, në vendin tonë nuk ekzistojnë kriza e papunësi dhe është përmirësuar jeta e popullit.

Ekonomia zhvillohet në bazë të një plani të caktuar, ajo rritet dhe forcohet çdo ditë dhe gjendja e popullit tonë, në krahasim me të kaluarën, ka ndryshuar shumë.

Popullin tonë e udhëheq Partia heroike e Punës e krijuar në luftë dhe e edukuar me mësimet e Leninit dhe të Stalinit dhe që është besnike deri në fund e marksizëm-leninizmit, e popullit tonë, e Bashkimit Sovjetik, e Partisë Bolshevike, e Stalinit, e socializmit dhe e internacionalizmit proletar.

Këta faktorë të rëndësishëm që përmenden më lart, si na mëson shoku Stalin, janë të domosdoshëm për të ndërtuar një ekonomi të planifikuar dhe për të shkuar një vend në rrugën e socializmit.

Duke marrë parasysh sa thashë më sipër del i mundshëm dhe i domosdoshëm hartimi i planit pesëvjeçar, realizimi me sukses i të cilit do të jetë një fitore e madhe për popullin tonë. Plani pesëvjeçar, i cili konkretizon vijën e caktuar nga Kongresi I i Partisë, duhet të parashikojë një zhvillim të gjithanshëm të ekonomisë dhe duke njohur mirë gjendjen e pasurive dhe të mundësive tona, t'i shfrytëzojmë si duhet të gjitha këto pasuri të nëntokës dhe të mbitokës.

Hartimi i planit është i domosdoshëm që të bazohet në mundësitë reale të zhvillimit të prodhimit si dhe të shfrytëzimit të rezervave të ekonomisë sonë popullore. Në hartimin e planit duhet të luftohet tendenca e planeve të mëdha e të fryra, tendenca e «gjigantomanisë», por edhe tendenca e zvogëlimit të mundësive reale të

planit, tendenca e paraqitjes së planeve të vogla, për të genë brenda. Në bazë të eksperiencës së deritanishme ne mund të nënvizojmë se, veçanërisht në disa ministri dhe në radhë të parë në Ministrinë e Industrisë, të Tregëtisë, të Komunikacionit etj., vihet re tendenca për uljen e planit në krahasim me mundësitë ekzistuese të prodhimit. Planet e reduktuara, duhet të dimë, nuk i mobilizojnë njerëzit për shfrytëzimin e plotë të mjeteve, të veglave, të mekanizmave etj. dhe u shkaktojnë dëm interesave të ekonomisë popullore.

Në lidhje me hartimin e planit pësëvjeçar duhet që e gjithë Partia, organet e planifikimit, organet administrative dhe ekonomike t'i kushtojnë kujdesin më të madh hartimit të tij dhe të mobilizohen totalisht. Por kjo nuk është e mjaftueshme, pse njëkohësisht duhet të mobilizohen të gjitha forcat për zbatimin praktik të planit që do të hartohet. Punonjësit e Komisionit të Planit dhe të gjitha entet shtetërore dhe ekonomike duhet të kenë kurdoherë parasysh se një planifikim burokratik, i shkëputur nga realiteti, nuk vlen shumë.

«Planet, thotë shoku Mollotov, janë të nevojshme për të pasur një vijë të drejtë në aktivitetin tonë ekonomik... planet janë të nevojshme për të kontrolluar zhvillimin e punës sonë ekonomike. Por në rast se zbatimi i një plani, nuk është i kontrolluar, ky plan transformohet në një copë letër, në hiç»¹.

Le të kalojmë tani në problemet konkrete të planit pësëvjeçar.

¹ V. M. Mollotov. Raport në Kongresin XVIII të PK (b) të B.S. «Pravda», Nr. 74 (7759), 16 mars 1939.

NGRITJA E INDUSTRIË — HALLKË KRYESORE PËR ZHVILLIMIN E EKONOMISË SOCIALISTE

Minierat. — Minierat zënë një vend të rëndësishëm në ekonominë tonë dhe shfrytëzimi sa më shumë i tyre krijon një burim të mirë të ardhurash për popullin. Dihet në ç'gjendje të mjerueshme i trashëguam nga lufta këto miniera, dihen dëmet e mëdha dhe grabitjet që na shkaktuan në këtë sektor trockistët jugosllavë, të cilët, veçanërisht në industrinë e naftës, u përpoqën të thithnin sa më tepër dhe sa më shpejt naftën dhe nënproduktet e saj me metoda antishkencore e kapitaliste dhe njëkohësisht të dëmtonin kantieret dhe të sabotonin shfrytëzimin që do të bëhej në të ardhshmen. Konsekuencat e kësaj pune armiqësore të tradhëtarëve jugosllavë i ndjejmë edhe sot. Përppjekjet e pushtetit popullor kanë qenë të mëdha në mëkëmbjen, zgjerimin dhe mekanizimin e minierave. Ndihma e Bashkimit Sovjetik ka qenë e çmueshme dhe është e qartë se pa këtë ndihmë, populli dhe Partia nuk do t'i kishin pasur plotësisht mundësitë materiale dhe eksperiencën e duhur për të ecur me sukses në këtë rrugë ku ecim sot. Janë dashur investime të konsiderueshme për zhvillimin e minierave, janë dashur përppjekje dhe heroizma nga punëtorët, është dashur një kujdes i veçantë nga ana e Partisë dhe e qeverisë në ngritjen dhe edukimin e kuadrove teknike që gati nuk ekzistonin fare. Është dashur një vigjilencë e jashtzakonshme dhe është zhvilluar një luftë e rreptë kundër sabotatorëve, armiqve të egër dhe dinakë titistë, kundër bandës anglo-amerikane me Herri Fulcin në krye, kundër terroristëve me rrogë

të amerikanëve, anglezëve, italianëve etj. Faktet treguan qartë se në rrugën tonë të drejtë, ne i kapërcyem këto vështirësi të mëdha. Partia jonë, që ndjek me besnikëri mësimet e marksizëm-leninizmit dhe përqa-fon me etje eksperiencën e Partisë Bolshevike, u bë e aftë në një periudhë kaq të shkurtër jete prej 10 vjetësh të ngrejë nga hiçi vepra të mëdha ndërtimore për të mirën e popullit të saj. Faktet tregojnë qartë se një vend shumë i prapambetur, i vogël, i varfër, siç ishte vendi ynë, mundi nën udhëheqjen e Partisë dhe me ndihmën e madhe të atdheut të socializmit e të Stalinit personalisht, të zhvillohet, të pasurohet e të përparojë. Rezultatet e arritura kanë gëzuar popullin, kanë çarmatosur skeptikët dhe kanë egërsuar armiqtë. Mbi bazën e këtyre sukseseve, ne do të mbështetim planin pesë-vjeçar në këtë sektor.

Në hartimin e planit pesëvjeçar, për sektorin e minierave, duhet pasur parasysh që këto të zhvillohen me një ritëm të shpejtë, që të rritet prodhimi total në një mënyrë të konsiderueshme në krahasim me vitin 1950 dhe me paraluftën. Detyra kryesore e minierave dhe e industrisë, gjatë pesëvjeçarit, është që të sigurojnë shpejtimin e ritmeve për ndërtimin e bazave ekonomike të socializmit në vendin tonë. Investime të rëndësishme të bëhen në industrinë vajguore, në atë të bitumit, në prodhimin e mineralit të kromit, në industrinë e bakrit e në nxjerrjen e qymyrgurit. Të bëhen studime dhe kërkime gjeologjike për zbulimin e rezervave të tjera minerale të naftës, bakrit, kromit, serës, qymyrit, hekurit, nikelit etj. Gjatë pesëvjeçarit të ndërtohet rafineria e re e naftës.

Të tregohet një kujdes i veçantë për zhvillimin e industrisë së naftës, të rritet prodhimi brut i saj, duke përmirësuar dhe duke shtuar shpimin e puseve në thellësi, duke zhvilluar metodat e shpejta të shpimit dhe duke përqafuar e duke zbatuar me përpikëri metodat e përparuara sovjetike të industrisë së naftës. Në planin pesëvjeçar duhet të parashikohet me kujdes edukimi e ngritja e kuadrove të naftës. Dihet rëndësia e madhe e kuadrove dhe mungesa jashtëzakonisht e madhe në këtë sektor. Kuadrot nuk krijohen në një ditë as në një vit, por duhet të punojmë me plan dhe për këtë arsye të merren masa me kohë si për nxjerrjen e naftës ashtu edhe për kuadrot e rafinerisë së re dhe kuadrot e tjerë të këtij sektori. Punëtorëve të naftës duhet t'u krijohen lehtësira më të mëdha se në çdo degë tjetër, duhet t'u jepen rroga më të mëdha, t'u paguhet vjetërsia, t'u lidhen pensione të mira, t'u akordohen urdhëra dhe medalje për meritat e tyre. Në rast se dëshirojmë që industria e naftës të shkojë përpara dhe kjo është e domosdoshme, punonjësve të naftës t'u krijojmë kondita më të mira, të ndërtohen për ta shtëpi, klube, kinema, shkolla të veçanta e kopshte për fëmijët e tyre. Në kantieret e naftës ka zanatçinj të vjetër, të cilëve duhet t'ua zgjerojmë e t'ua perfeksionojmë njohuritë në shkolla dhe në kurse. Në hartimin e planit pesëvjeçar duhet t'i kemi parasysh të gjitha këto gjëra. Vetëm në këtë mënyrë industria e naftës do të përparojë, do të pregatitim kuadro të aftë e do të krijohet traditë qëndrueshmërie për ta dhe nuk do të lëvizin aq shumë njerëzit, siç na ngjet deri tani.

Të zhvillohet një front i gjerë punimesh për rritjen

e prodhimit të bakrit si dhe të rritet kapaciteti prodhues i këtij minerali. Një zhvillim i madh duhet të parashikohet për qymyrgurin, i cili do të vlejë jo vetëm si lëndë djegëse kryesore për minierat e industrinë e re, por dhe si lëndë djegëse për nevojat e popullit; gjithashtu të mbahet parasysh zhvillimi i industrisë së kromit me një cilësi të tillë që t'u përgjigjet konditave të eksportit. Plani pesëvjeçar të synojë në zhvillimin e një fronti të gjerë punimesh për të përcaktuar pasuritë minerale të vendit, që do të vlejné për shtimin e prodhimit dhe për sigurimin e rezervave industriale të mjaftueshme për disa vjet me radhë në të ardhshmen. Për t'i arritur këto rezultate të vihet në funksionim furra e shkrirjes së bitumit të Selenicës. Në lidhje me industrinë e bakrit plani të parashikojë ndërtimin e fabrikës së pastrimit të këtij minerali. Plani pesëvjeçar të parashikojë energjinë elektrike të nevojshme për këto miniera dhe në radhë të parë për naftën dhe mekanizimin e tyre; të parashikojë gjithashtu ndërtim banesash e shkollash për punëtorët.

Industria. — Gjatë pesëvjeçarit të krijohet një industri, e cila të jetë e aftë të ngrejë në një nivel shumë më të lartë prodhimin e mallrave të konsumit të gjerë në bazë të shfrytëzimit më të madh të lëndës së parë në vend dhe me qëllim që të ulet në mënyrë të dukshme importimi i këtyre artikujve nga jashtë.

Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet industrisë tekstile. Kombinati i tekstileve «Stalin», i cili duhet të vihet në funksionim në nëntorin e ardhshëm, do t'i sigurojë popullit tekstile të nevojshme. Këto maqineri moderne janë pasuri e çmueshme e popullit dhe e pu-

nëtorëve, të cilët duhet të mësojnë dhe të perfeksionojnë zanatin, t'i ruajnë këto si sytë e ballit dhe të jenë shembull për gjithë punonjësit e industrisë sonë.

Kujdes i veçantë t'i vihet industrisë së sheqerit dhe kombinati i sheqerit në Maliq t'i japë popullit sheqer të bollshëm e sa më parë. Një rëndësi e veçantë t'i jepet industrisë së lëkurëve dhe asaj ushqimore, veçanërisht. Niveli i jetesës së popullit duhet të ngrihet çdo ditë dhe pra, na del si detyrë kryesore gjatë planit pesëvjeçar, që të shfrytëzojmë në mënyrë racionale lëndët e para ekzistuese në vend. Për këtë arsye duhet të zhvillohet industria ushqimore dhe sidomos të shtohen ndërmarrjet për përpunimin dhe konservimin e prodhimeve të mishit, të peshkut, të zarzavateve, të frutave etj. Krahas me zhvillimin e industrisë ushqimore, të perfeksionohet industria ushqimore ekzistuese, të zgjerohen llojet e prodhimit të konsumit të gjerë dhe të përmirësohet cilësia e tyre.

Gjatë pesëvjeçarit të ngrihet një fabrikë për shkrijen e hekurit dhe të çelikut¹, një fabrikë çimentoje në Vlorë, një kombinat druri në Elbasan, si dhe dy fabrika të tjera staxhionimi të lëndëve të drurit, një fabrikë për fermentimin e duhanit në Shkodër, një fabrikë për prodhimin e ekstrat-taninit, një fabrikë për prodhimin e fijes së pambukut, një fabrikë për prodhimin e tekstive të leshta e të tjera. Të përqëndrohen mjetet dhe

¹ Kjo fabrikë nuk u ngrit për shkak të ndryshimeve që KQ i PPSH dhe KM i RPSH i bënë më vonë planit të parë pesëvjeçar në dobi të bujqësisë dhe të rritjes së mirëqenjes së punonjësve të qytetit dhe të fshatit.

të shtohen përpjekjet për t'i futur me kohë në shfrytëzim objektet që po ndërtohen. Të organizohet më mirë puna në ndërmarrjet ekzistuese; për këto të sigurohet kuadri stabil i nevojshëm, të ngrihet kualifikimi i tij, të përgatitet kuadri drejtues si dhe kuadri inxhiniero-teknik.

Një detyrë shumë e rëndësishme dhe kryesore në pesëvjeçarin u shtrohet punonjësve të Ministrisë së Industrisë, gjithë ministrive e institucioneve të tjera: përvetësimi nga të gjithë kuadrot i teknikës moderne dhe mekanizimi i gjithanshëm i proceseve të punës. Niveli i tanishëm i njohjes së teknikës nga ana e kuadrove, njohja nga ana e tyre e maqinerisë dhe trajtimi i kësaj maqinerie moderne në mënyrat që bëhet sot, nuk përbëjnë konditat për shfrytëzimin e plotë të teknikës në interes të ekonomisë popullore dhe niveli i ulët i mekanizimit të proceseve të punës ka si konsekuencë të rëndë uljen e rendimentit në punë dhe ngritjen e kostos së prodhimit. Një situatë e tillë, që ekziston në realizimin e planeve të prodhimit të deritanishëm dhe në përdorimin e metodave primitive në punë nga ana e ndërmarrjeve duhet të marrë fund.

Në lëmin e zhvillimit të industrisë duhet pasur kujdes proporcioni i drejtë ndërmjet zhvillimit të kësaj të fundit dhe prodhimit të energjisë elektrike për ndërmarrjet industriale dhe për qytetet. Për këtë qëllim të sigurohet një ritëm i shpejtë për shfrytëzimin e lëndëve djegëse si dhe për prodhimin e energjisë elektrike e sidomos asaj hidraulike. Është e nevojshme që prodhimi i lëndëve djegëse jo vetëm të plotësojë nevojat e këtij pesëvjeçari për zhvillimin e industrisë në përgjithësi,

por bile të shkojë akoma më përpara me qëllim që të krijohet një bazë e fortë për zhdukjen e disproporcionit që ekziston sot ndërmjet zhvillimit të minierave, industrisë dhe energjisë elektrike.

Rëndësi të jashtzakonshme për vendin tonë, që ndërton bazat e socializmit, ka *energjinë elektrike*. Roli vendimtar që do të luajë ajo në çështjen e zhvillimit të ekonomisë popullore në vendin tonë është shumë i madh. Për këtë arsye një detyrë e dorës së parë, në këtë pesëvjeçar, është përpunimi i planit të përgjithshëm të elektrifikimit të vendit për vjetët e ardhshëm. Mungesa e një plani të tillë të përgjithshëm na çon në ndërtimin e centraleve elektrike të vogla pa shumë leverdi ekonomike. Prandaj të merren të gjitha masat për hartimin e këtij plani të përgjithshëm të elektrifikimit të vendit.

Për këtë qëllim të studjohet për ngritjen gjatë pesëvjeçarit të hidrocentraleve të reja. Në qytetin «Stalin» të vendosen turbinat dhe lokomobilat etj. me një kapacitet kompleksiv 12 mijë kw., të ngrihet termocentrali i rafinerisë së naftës, i fabrikës së çimentos dhe i Kombinatit të tekstileve «Stalin» me një kapacitet kompleksiv 14 mijë kw., të vendosen në Rubik e Bulqizë grupe «diezel» me një kapacitet kompleksiv 4 mijë kw. etj. Të vihet në shfrytëzim që në vitin 1951 Hidrocentrali «Lenin». Të ndërtohet gjithashtu linja e tensionit të lartë për shfrytëzimin sa më të madh të energjisë elektrike.

Një ndër problemet më me rëndësi në lidhje me zhvillimin e industrisë është kujdesi që duhet treguar për *uljen e kostos*. Ulja e koston është një ndër faktorët kryesorë që influencon në rritjen e prodhimeve indus-

triale, në shpejtimin e ritmit të zhvillimit të industrisë, në forcimin e hozrashotit të ndërmarrjeve. Ulja e kostos është një burim me shumë rëndësi i akumulimit dhe i financimit të ekonomisë popullore. Prandaj ulja e kostos është e vetmja rrugë nëpërmjet së cilës duhet të kalojë zhvillimi i industrisë dhe i minierave. Për uljen e kostos duhet që gjatë pesëvjeçarit të ulen normat e konsumit të lëndës së parë dhe të materialeve, duke vënë në jetë normat teknike të ndërmarrjeve dhe të punëtorëve të përparuar si dhe duke ushtruar një kontroll të rreptë mbi shpenzimin e lëndëve të para dhe të materialeve; të ulen shpenzimet e përgjithshme të ndërmarrjeve në saje të racionalizimit të punës dhe të shkurtimit relativ të personelit administrativ dhe shërbyes.

Ngritja e rendimentit të punës është një ndër faktorët kryesorë të shpejtimin të ndërtimit të bazave të socializmit. Për t'ja arritur këtij qëllimi, të rritet niveli i mekanizimit të prodhimit, të organizohet më mirë puna, të forcohet emulacioni socialist duke futur më tepër në jetë eksperiencën e punëtorëve të përparuar, si dhe të novatorëve dhe stakanovistëve sovjetikë. Të vendosen kudo normat teknike dhe të rishikohen herë pas here normat e punës si një nevojë e domosdoshme dhe si rezultat i përparimit teknik dhe i organizimit më të mirë të punës. Normat t'u përshtaten konditave teknike, të pasqyrojnë gjendjen reale të një ndërmarrjeje, të jenë mobilizuese dhe të caktohen duke u nisur nga mesatarja e normave që realizojnë punëtorët e përparuar.

Ulja e kostos do të krijojë një bazë të shëndoshë

për rritjen e akumulimit për t'i bërë ballë financimit të ekonomisë popullore dhe për të ulur çmimet e prodhimeve industriale me qëllim që në tregun e brendshëm të vendoset një raport i drejtë i çmimeve ndërmjet prodhimeve industriale dhe atyre bujqësore.

Në hartimin e planit pesëvjeçar kujdes i veçantë duhet të tregohet për zhvillimin e *industrisë lokale dhe të artizanatit* në mënyrë që këto të bëhen plotësuese të industrisë nacionale për sigurimin e mallrave të konsumit të gjerë. Zhvillimi i industrisë lokale dhe i artizanatit kooperativist të konsiderohet nga komitetet ekzekutive si një nga detyrat më të rëndësishme gjatë planit pesëvjeçar për të rritur prodhimin e mallrave të konsumit të gjerë dhe të sendeve ushqimore kryesisht në saje të prodhimit të lëndës së parë në vend dhe të mbeturinave të industrisë nacionale, duke prodhuar sa më shumë vegla bujqësore për fshatin. Të synohet në prodhimin e mallrave të një cilësie të mirë dhe me një çmim më të lirë. Të forcohet kooperimi i zanatçinjve, sidomos në ata sektorë prodhimi ku ka kërkesa të mëdha nga popullsia. Të tregohet kujdes i veçantë për forcimin e shërbimeve të ndryshme në mënyrë që të plotësohen nevojat e popullatës për meremetime këpucësh, rrobash dhe orendish shtëpiake. Për forcimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të artizanatit, të respektohet në mënyrë rigorozë statuti sipas të cilit një pjesë e fitimit të zanatçinjve të kooperuar të destinohet për investime dhe për përmirësimin e punës së artizanatit.

Rritja e industrisë, në lidhje me vënjen në shfrytëzim të ndërmarrjeve e të fabrikave të reja, kërkon organizim më të mirë të sistemit të drejtimit të indus-

trisë. Pra, i vihet si detyrë Ministrisë së Industrisë të krijojë sa më parë drejtoritë kryesore në sistemin e ministrisë: drejtorinë e industrisë tekstile, drejtorinë e industrisë ushqimore, drejtorinë e energjisë elektrike, drejtorinë e industrisë së drurit, atë të industrisë lokale etj.

Një detyrë tjetër e rëndësishme që u shtrohet Ministrisë së Industrisë njëkohësisht dhe asaj të Minierave është krijimi i këshillave tekniko-shkencore pranë dikastereve në fjalë. Këto janë të domosdoshme të krijohen sa më parë, pse këtë e kërkon rritja e vëllimit të punës, vënja në shfrytëzim e ndërmarrjeve të reja, ekzistenca e një maqinerie dhe teknike të madhe në prodhim, nevoja e përvetësimit të kësaj teknike, rritja e përgjithshme e kulturës së prodhimit dhe nevoja e përpunimit shkencor e teknik të problemeve të veçanta në sektorët e industrisë dhe të minierave.

ZHVILLIMI I MËTEJSHËM I BUJQËSISË — NJË NGA DETYRAT MË TË RËNDËSISHME TË PLANIT TË PARË PESEVJEÇAR

Bujqësia. — Sektori i bujqësisë është nga më të rëndësishmit, pse vendi ynë është një vend bujqësor dhe në vende të tilla bujqësia duhet të luajë një rol të rëndësishëm. Klima dhe toka te ne janë shumë të mira dhe në saje të këtyre dy faktorëve ne mund të prodhojmë çdo gjë në vendin tonë. Por çdo gjë bëhet me përpjekje dhe me një luftë sistematike të organizuar për të krijuar që tani kondita më të mira për një prodhim më të madh.

Pikësnyimi ynë duhet të jetë në shtimin e prodhimeve bujqësore dhe, duke marrë parasysh që pjesa më e madhe e bujqësisë është në sektorin privat, ne duhet të marrim të gjitha masat për ta ndihmuar fshatarin që ai të punojë më mirë dhe të prodhojë më shumë. Këtu duhet të tregohet kujdesi më i madh, pse këtu qëndron politika e drejtë e Partisë, pse kjo do të na ndihmojë të zhvillojmë dhe të forcojmë industrinë. Duhet të kemi parasysh se lidhja e ngushtë e fshatit dhe e qytetit do të sigurohet vetëm në baza ekonomike.¹ Rruga jonë e zhvillimit është e qartë dhe ekonominë tonë duhet ta ndërtojmë në mënyrë harmonioze, simetrike; bujqësia dhe industria të shkojnë paralel dhe asnjëra në kurriz të tjetrës. Ne jemi të interesuar për ngritjen e industrisë, por jemi po aq të interesuar për bujqësinë dhe të mos harrojmë për asnjë minutë se zhvillimi i industrisë varet dhe nga zhvillimi i bujqësisë. Pasuritë e mëdha të natyrës ne mund dhe duhet t'i transformojmë në pasuri të mëdha për popullin tonë. Një zhvillim i madh i bujqësisë, jo vetëm do t'i sigurojë popullit bukën dhe nevojat e tjera, por do të shtojë eksportimin e prodhimeve të vendit tonë, të cilat do t'i sjellin popullit të ardhura të konsiderueshme. Të kemi parasysh që bujqësia jonë është akoma e prapambetur, shumica e tokës është e copëtuar në prona të vogla private, prodhimi s'është i një cilësie të lartë dhe

¹ Kur baza politike e aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë ishte hedhur dhe forcuar, vendimtare paraqitej edhe hedhja e bazave ekonomike të kësaj aleance, prandaj Partia këtë gjë e ngrinte me forcë.

aty-këtu vihet re anarki në prodhim dhe në mbjelljen e kulturave; agroteknika moderne është akoma e panjohur nga fshatarët; shkalla e mekanizimit të bujqësisë është shumë e ulët; kemi mungesa të mëdha në sigurimin e konditave të ujitjes së tokave dhe nga ana tjetër të kullimit të ujërave; kemi mungesë në seleksionimin e farërave, mungesë në kafshë e vegla pune dhe një mungesë të madhe për ngritjen e kuadrove teknike për këtë sektor. Prandaj plani pesëvjeçar duhet të parashikojë zhdukjen e kësaj prapambetjeje dhe t'i vërë një kujdes të veçantë dhe të madh agrikulturës në vendin tonë.

Duke marrë parasysh se niveli i tanishëm i bujqësisë sonë nuk i përgjigjet rritjes së nevojave të vendit për prodhimet ushqimore të popullsisë, për lëndën e parë të industrisë dhe për rritjen e burimeve të eksportit, duke marrë parasysh gjithashtu se vendi ynë akoma vazhdon të importojë bukën nga jashtë dhe se gjendja në disa degë të bujqësisë sonë si për shembull në prodhimin e drithërave, të panxharit të sheqerit, të pambukut, të ullirit, të agrumeve dhe të duhanit nuk është e kënaqshme, një nga detyrat më të rëndësishme të planit pesëvjeçar, pra, duhet të jetë zgjerimi dhe zhvillimi i këtij sektori.

Me qëllim që të sigurohet buka në vend është e nevojshme të inkurajohet prodhimi i grurit dhe i misrit dhe prodhimi i bereqetit, në radhë të parë të rritet në saje të rendimentit të misrit dhe të grurit, duke përmirësuar agroteknikën, duke përdorur farëra të zgjedhura dhe duke përdorur plehra organike dhe kimike.

Për sigurimin e prodhimit të nevojshëm të pambukut, të panxharit të sheqerit dhe të duhanit, gjatë pesëvjeçarit të parashikohet marrja e masave për t'u krijuar leverdi materiale fshatarëve dhe kooperativave që kultivojnë këto kultura, në mënyrë që të shtohen sipërfaqet e mbjella dhe të rriten rendimentet e kulturave bujqësore.

Pambuku është një kulturë shumë e rëndësishme për vendin tonë, por për kultivimin e tij ne nuk duhet të shkojmë me sy mbyllur. Duhet të studjojmë mirë tokën ku do të mbillet pambuku, me fjalë të tjera të bëjmë një rajonizim të saktë. Kultura e pambukut do ujë dhe diell. Ne diell kemi, gjithashtu toka dhe klima janë të përshtatshme për këtë kulturë, por ne duhet të punojmë që të krijojmë konditat për ujitjen e tij, të sigurojmë me kohë ardhjen e plehut kimik nga jashtë dhe të mësohet përdorimi i tij. Duhet të kemi parasysh se konditat e favorshme klimaterike të vendit tonë, përdorimi i plehrave kimike dhe organike si dhe sigurimi i ujitjes së kësaj kulture do të na sigurojë prodhime shumë të mëdha. Pambuku është një kulturë e re në vendin tonë, prandaj dhe kujdesi i pushtetit duhet të jetë i madh. Duhet ta interesojmë dhe ta mësojmë fshatarin për kulturën e pambukut. Prandaj plani ynë pesëvjeçar duhet të parashikojë hapjen e kanaleve ujitëse, për pambukun në radhë të parë. Këto kanale mund të jenë të vogla, por po të çelim pesë kanale të tilla në vit, në vend që të ndërmmarrim hapjen e kanaleve të mëdha që lypin shpenzime, kjo do të na japë të ardhura më të konsiderueshme dhe frute të shpejta. Fshatarët duhet t'i ndihmojmë në këtë drejtim, duke

u dhënë kredi me afate të gjata, duke krijuar koopera-tiva bujqësore dhe duke ua bërë të qarta, me prova bindëse fitimet e mëdha që ata do të kenë. Në vendet ku ne mbjellim pambuk si në Fier dhe Lushnjë, është e domosdoshme marrja e këtyre masave. Kujdes të veçantë duhet t'i vëmë pambukut, pse dështimi në këtë drejtim mund ta largojë fshatarësinë nga kjo kulturë kaq e rëndësishme. Por që të arrihet prodhimi i bollshëm i pambukut, që ka rëndësi të dorës së parë për Shqipërinë, pse vetëm kështu do të sigurojmë popullin me tesha dhe do të eksportojmë, plani pesëvjeçar duhet të parashikojë edhe ngritjen e kuadrit teknik për këtë kulturë.

Duke marrë parasysh konditat klimaterike shumë të favorshme të vendit tonë, *të tregohet vëmendje e posaçme për ullinj të ekzistues, për mbjelljen e tyre dhe për agrumet.* Gjithashtu të përpunohet dhe të futet në jetë sistemi për stimulimin dhe grumbullimin e ullinjve, të portokalleve, të limonëve etj., në mënyrë që në vitet e ardhshme të vendoset stabiliteti i prodhimit të tyre nga viti në vit. Të rritet prodhimi i agrumeve në një mënyrë të konsiderueshme në krahasim me vitin 1950, kurse pemët frutore, fiqtë, vreshtat, arrat, bajamet etj., duhet të shtohen me shumicë, pse janë ushqim i rëndësishëm për popullin dhe lëndë shumë të çmueshme për eksportin.

Rritja e rendimentit të kulturave të konsiderohet një ndër detyrat kryesore të planit pesëvjeçar. Të rritet në shkallë sa më të madhe sistemi i ujitjes, të shfrytëzohen më mirë kanalet ekzistuese dhe të ndërtohen kanale të reja në mënyrë që të rritet sipërfaqja e tokës së ujitur në përgjithësi e sidomos për bimët industriale.

T'u jepet gjithashtu rëndësi e posaçme kanaleve ujitëse lokale. Të sigurohen në vend dhe të sillen nga jashtë gjatë pesëvjeçarit farëra të ndryshme të seleksionuara si për grurin, misrin, jonxhën, pambukun dhe panxharin e sheqerit. Të rritet në masë të konsiderueshme krediti agrar për fshatarësinë në mënyrë që ky të bëhet një mjet i rëndësishëm për shtimin e prodhimeve bujqësore të kooperativave, të fshatarësisë së varfër dhe të mesme.

Stacioneve të maqinave bujqësore t'u kushtohet rëndësi e veçantë gjatë pesëvjeçarit, duke shtuar numrin dhe duke e përmirësuar cilësinë e punës së tyre. Të organizohet puna në SMT-të në atë mënyrë që të gjitha kontratat e lidhura me kooperativat dhe me fshatarët për punimin e tokave të zbatohen patjetër. Për këtë qëllim të forcohet dhe të organizohet më mirë puna për riparimin e maqinerive bujqësore.

Në SMT-të duhet të forcohet disiplina në punë, të mirëmbahen maqinat dhe të forcohet puna e Partisë. Një kujdes të veçantë duhet të tregojmë për edukimin tekniko-profesional të punonjësve të SMT-ve; për këtë arsye të çelen kurse për traktoristët. Gjithashtu të mbahet parasysh trajtimi i mirë ekonomik i traktoristëve. Lidhjet e SMT-ve me fshatarësinë duhet të jenë të ngushta dhe nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe e Partisë të ushtrohet një kontroll i vazhdueshëm në kryerjen e detyrave nga SMT-të si dhe për përmbushjen e nevojave që ata kanë.

Në kohën e tanishme do të ishte jo i drejtë sforcimi i ritmit të kolektivizimit të bujqësisë. Këtë çështje e ka shtruar drejt Komiteti Qendror. Ngritja e kooperativave të reja bujqësore duhet të bëhet pas një pune përgatitore

shumë të kujdesshme për bindjen e fshatarit në epërsinë e ekonomisë kolektive mbi atë individuale, duhet të mbahet parasysh mundësia e mekanizimit të prodhimit, duke mos lejuar në punën e kolektivizimit ngutje dhe duke mbikëqyrur respektivisht parimin e vullnetarizmit. Në kohën e tanishme detyra kryesore është forcimi i kooperativave ekzistuese, përmirësimi i shërbimit të tyre nga ana e SMT-ve, dhënja e ndihmës në ngritjen e rendimentit të kulturave bujqësore dhe shtimi i bagëti të përbashkëta. Është e nevojshme që të fillohet rajonizimi i kulturave në kooperativat bujqësore. Shumica e kooperativave, që kanë konditat e përshtatshme për kultivimin e pambukut e të panxharit, duhet të orientohen vendimtarisht në këto kultura. T'u jepet kredi shtetërore për zhvillimin e tyre, t'u sigurohen farëra të zgjedhura të jashtme dhe të vendit dhe vetë kooperativat të bëhen qendra prodhimi farërash të seleksionuara. Për kooperativat bujqësore të edukohen kadro drejtues, teknikë, llogaritarë, të bëhen përpjekje që gruaja të marrë qind për qind pjesë në prodhim e në drejtimin e kooperativave; fëmijët e kooperativave bujqësore, në shkollat 7-vjeçare, të orientohen për bujqësinë, blegtorinë dhe pyjet; kooperativat të bëhen shembull dhe ndihmëse për ekonomitë bujqësore private. Ndihma e tyre në drejtim të sektorit privat të bujqësisë të jetë konkrete.

Në interes të krijimit të një baze të shëndoshë të lëndëve të para për industrinë, që është në zhvillim dhe për forcimin e bilancit të eksportit, duhet t'u kushtohet kujdes i madh kultivuesve të pambukut si në kooperativat bujqësore, ashtu dhe në sektorin privat. Për ata

fshatarë e kooperativistë, që mbjellin duhan, panxhar sheqeri dhe kultura të tjera industriale të rëndësishme, është e domosdoshme që Ministria e Bujqësisë të përdorë si duhet politikën e dekorimeve për të dalluarit dhe t'i inkurajojë këta. Kudo duhet të tregohet një respekt dhe një nderim i madh për bujqit përparimtarë që merren me këto kultura.

Fermtat shtetërore të kenë orientim të caktuar bujqësor, të forcojnë dhe të modernizojnë punën, të zbatojnë në maksimum agroteknikën dhe metodat e reja në bujqësi, të marrin rendimente të larta dhe me cilësi prodhimi të mirë. Ato të bëhen kombinatë të përsosura bujqësore, të bëhen burime kuadrosh për bujqësinë, për kooperativat dhe për veten e tyre, të bëhen qendra studimi, seleksionimi dhe prodhimi për farëra, për pemë frutore, për kafshë, për prodhime të çdo lloji, të caktuara në orientimin e tyre. Të bëhen shembull dhe ndihmëse konkrete për kooperativat bujqësore dhe për sektorin privat të bujqësisë. Të krijohen disa ferma shtetërore me profil të caktuar, veçanërisht për kulturën e pambukut dhe në të gjitha fermtat shtetërore të vendosen punëtorët e nevojshëm të bujqësisë. Në fermtat shtetërore, shkollave 7-vjeçare t'u caktohet orientimi bujqësor dhe nxënësit të bëjnë praktikën bujqësore në fusha dhe në laboratorë të fermës dhe të ushqehet ndër ta dashuria për bujqësinë, blegtorinë dhe pyjet.

Fermtat dhe kooperativat bujqësore duhet të jenë shembull për ekonominë bujqësore private. Ato t'i mësojnë bujqit privatë për zbatimin e metodave të përparuara, për përdorimin e mekanizimit, për planifi-

kimin e punërave, për kryerjen e punimeve bujqësore para afatit, për rritjen e rendimenteve të larta; t'i mësojnë ata të punojnë me cilësi të lartë dhe të pastër, të luftojnë kundër anarkisë në prodhim dhe për plotësimin sa më shpejt të detyrimeve ndaj shtetit, për përparimin e gjithanshëm të jetës së tyre.

Përreth qyteteve duhet të krijohen të tilla baza bujqësore që të shkohet drejt plotësimin të nevojave të qendrave të punës dhe të qyteteve me zarzavate, me patate dhe me qumësht. Duhet që ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe kooperativat bujqësore të organizojnë më mirë punën për shtimin e prodhimit, për furnizimin e qyteteve me perime të çdo lloji dhe me prodhime bujqësore të nevojshme.

Përpara ndërmarrjeve shtetërore duhet të shtrohet detyra kryesore që gjatë pesëvjeçarit ato të kalojnë në autonomi të plotë dhe të heqin dorë një herë e përgjithmonë nga subvencionimi shtetëror dhe të rritin rendimentet në bujqësi në mënyrë të konsiderueshme.

Para Ministrisë së Bujqësisë, komiteteve ekzekutive dhe komiteteve të Partisë në rrethe shtrohet si detyrë e madhe organizimi i luftës vendimtare kundër dëmtuesve të bujqësisë, siç janë sëmundjet e ndryshme, insektet, karkaleci etj. Lufta kundër dëmtuesve të bujqësisë të bëhet çështje e të gjithë popullit.

Ministria e Bujqësisë, fermat e kooperativat duhet të kenë për detyrë të organizojnë dhe të praktikojnë në shkallë të gjerë shkëmbimin e eksperiencës së bujqve të përparuar në lëmin e rritjes së kulturave të veçanta dhe të sukseseve të arritura në lëmin e blegtorisë. Tani ka raste që fshatarë të përparuar të Korçës në parcelat e

tyre arrijnë të vjelin 800 kv. panxhar sheqeri për hektar, ose ka fshatarë të përparuar të Fierit dhe të Elbasanit që vjelin në parcelat e tyre 10-15 deri në 20 kv. pambuk për ha. dhe kjo punë kaq e përparuar, nuk vihet në dukje ndër të tjerët, këto suksese nuk i di kurrkush. Kjo situatë duhet të marrë fund.

Të tregohet kujdes nga ndërmarrjet shtetërore për zhvillimin sa më të gjerë të ekonomive ndihmëse me qëllim që të sigurohet furnizimi i punëtorëve me prodhime bujqësore. Çdo rreth i Shqipërisë duhet të prodhojë me bollëk perime për popullin e rrethit si dhe për të tjerët.

Sektori privat në bujqësi në kushtet aktuale është i rëndësishëm dhe mjaft i komplikuar. Për këtë arsye duhet t'i kushtojmë kujdes të madh dhe t'i japim ndihmë fshatarit. Ndihma duhet të jetë e shuman-shme dhe konkrete. Në se duhet të konsistojnë këto ndihma? Në radhë të parë duhet të mbarohet kadastra dhe të punohet vazhdimisht mbi të, sepse problemi i tokës nuk është një gjë e vdekur, sidomos kur ekziston prona private. Një punë e pastër në këtë drejtim do të zhdukë shumë gabime, do të zhdukë disa pakënaqësira të fshatarit dhe ai do të krijojë besimin në punën e rregullt, të drejtë, të organizuar dhe të planifikuar nga ana e shtetit. Përcaktimi i drejtë i pronësisë mbi tokën lufton pikëpamjet mikroborgjeze të fshatarit në lidhje me raportet ndaj shtetit dhe ligjeve të tij që rregullojnë çështjen e pronësisë mbi tokën, mbi prodhimin dhe detyrimet ndaj shtetit. Përcaktimi i pronësisë me anë të kadastrës do t'i sqarojë edhe më mirë fshatarët në perspektivën e zgjerimit të tokës së punueshme, në

shtimin e rendimenteve të kulturave dhe shkuarjen drejt kolektivizimit.

Ndër ndihmat kryesore që duhet t'i japë shteti fshatarësisë janë: sistemimi i tokave, bonifikimet dhe kanalizimet. Ndërmarrjet e këtyre punimeve dhe kryerja me sukses e tyre, e bindin fshatarin sepse këto punime e ndihmojnë konkretisht atë në përmirësimin e jetës së tij. Përveç kanalizimeve dhe bonifikimeve me karakter nacional që do të fillohen në këtë pesëvjeçar, ne duhet të ndihmojmë fshatarësinë në hapjen e shumë kanaleve sekondare ujitëse dhe kulluese, nga të cilët ai do të shohë frute të shpejta. Për të përballuar, pra, punimet e mësipërme të planit pesëvjeçar, shteti duhet të parashikojë shuma të konsiderueshme për investime dhe t'u akordojë kredi fshatarëve. Nga ana tjetër organet planifikuese të shtetit duhet të bëjnë studime duke hartuar për këto punë të rëndësishme plane të qarta. Në hartimin e planeve për hapjen e kanaleve ujitëse lokale duhet të shkohet nga parimi që të tilla punime të ndërmerren atje ku do të mbillet pambuku, orizi etj. Për të kryer këto punime, të bëhet mobilizimi i gjerë i fshatarëve dhe të jemi të sigurtë se ata do të punojnë me vullnet të madh, sepse me këto punime do të përmirësohet toka e tyre, do të forcohet te ata edhe më shumë besimi ndaj Partisë e pushtetit popullor dhe do t'i bëjë ata të përqafojnë më lehtë rrugën e planifikimit. Duhet ta edukojmë dhe ta bindim fshatarin për rajonizimin e kulturave dhe në radhë të parë të pambukut, të panxhar sheqerit, të duhanit, të orizit etj., pse kjo është në interesin e tij dhe të gjithë popullit. Për t'ja arritur kësaj, ne duhet t'i krijojmë fsha-

t'arësisë një sërë konditash ku të mundet të mbësh-tetet.

Duhet t'i japim fshatarit farë drithërash dhe bi-mësh industriale të seleksionuara të vendit dhe të sjella edhe nga jashtë, të cilat japin dy-tri herë më tepër prodhim se ato ekzistueset. T'i vëmë në duar fshatarit plugje dhe vegla më të përparuara pune, t'u punojmë tokat me traktorë në radhë të parë prodhuesve të pa-mbukut e t'u akordojmë kredi të shumta për farë, për vegla, për kafshë pune dhe për ndërtim shtëpish. Të gjitha këto ndihma duhet të jenë konkrete, të vazh-dueshme dhe të organizuara mirë. Këto ndihma konkrete duhet të lidhen ngushtë me rrugën e planifikimit të bujqësisë në sektorin privat, që të ndihmojnë jo vetëm në shtimin e prodhimit, jo vetëm në përmirësi-min e jetës së fshatarëve, por të shërbejnë edhe për të luftuar pikëpamjet mikroborgjeze të tyre në prodhim, të luftohet te ata puna pa plan në prodhim dhe të përgatitet në këtë mënyrë rruga për kolektivizimin, duke kaluar nga këto hallka të vendosjes së planifiki-mit të bujqësisë. Organizimi i mirë i kësaj ndihme të planifikuar ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe. Kjo do ta bëjë fshatarin më të ndërgjegjshëm dhe më aktiv në punë, do ta lidhë më ngushtë me Partinë e pushtetin dhe ai do të zbatojë me entuziazëm akoma më të madh udhëzimet shpëtimtare të Partisë në lëmin e bujqësisë.

Duke u orientuar nga plani pesëvjeçar u vihet de-tyrë komiteteve ekzekutive në rrethe dhe komiteteve të Partisë që tok me këshillat popullore të fshatrave dhe me pjesëmarrjen e gjithë fshatarëve, të hartojnë

dhe të zbatojnë një plan perspektiv për çdo fshat, për ndërtim kanalesh ujitëse dhe kulluese, për pastrim kullotash, ndërtim rrugësh, shkollash, çesmesh etj. në interes të përgjithshëm të fshatit.

Fshatarit tonë duhet t'i mësojmë agroteknikën e përparuar, prandaj kuadrot e mësuar, të dalë nga universitetet e Bashkimit Sovjetik dhe të demokracive popullore, nga Instituti i lartë i bujqësisë dhe i veterinarisë në vendin tonë dhe nga Teknikumi bujqësor, ta kenë për nder dhe të jetë për ta një nga detyrat kryesore patriotike shkuarja në fshat dhe në fusha për të ndihmuar fshatarin dhe bujqësinë tonë.

Blegtoria. — Përsa i përket blegtorisë Byroja Politike dhe qeveria kanë hartuar një plan të veçantë pesëvjeçar dhe do ta aprovojnë së shpejti. Në këtë sektor, përveç rritjes së numrit të gjësë së gjallë, të tregohet kujdes i veçantë sidomos për rritjen e produktivitetit të blegtorisë. Për këtë qëllim është e nevojshme që gjatë pesëvjeçarit të përmirësohet në mënyrë të ndieshme baza ushqimore duke përmirësuar kullotat natyrale, duke shtuar në një mënyrë të konsiderueshme sipërfaqen e mbjellë me foragjere si dhe duke organizuar prodhimin e ushqimeve të koncentruara për kafshët nga mbeturinat e bimëve industriale.

Me qëllim që të sigurohen mishi dhe yndyrnat për popullsinë, t'i jepet rëndësi shtimit dhe majmërisë së derrave, duke krijuar tufa të posaçme pranë qendrave të mëdha të fabrikave ushqimore.

Të përmirësohet raca e gjësë së gjallë nëpërmjet seleksionimit dhe kryqëzimit me raca të mira. Të përhapet lopa shkodrane dhe ajo e Mursisë. Të shtohen

dhentë me lesh të cilësisë së mirë, prandaj të përhapet gjerësisht delja rudë e Kukësit. Të shkohet drejt qethjes dy herë në vit të dhënve. Të bëhet rajonizimi i blegtorisë.

Të forcohet dhe të zgjerohet rrjeti i qendrave zooteknike. Gjatë këtij pesëvjeçari t'i kushtohet kujdes shtimit të shpendëve, të bletës dhe krimbit të mëndafshit.

Grumbullimet. — Problemi i grumbullimeve të shikohet si një ndër problemet kryesore të pesëvjeçarit. Zgjidhja drejt dhe me sukses e çështjes së grumbullimit është zgjidhja e problemit të bukës për klasën punëtore. Kontraktimet dhe blerjet e produkteve në bazë të planit, luajnë një rol me rëndësi në rregullimin e ekonomisë fshatare në një drejtim të caktuar të nevojshëm për zhvillimin e ekonomisë popullore.

Grumbullimi i lëkurëve si dhe i prodhimeve pyjore (vallanidhe, shqeme, pefkë, shqopë etj.) të plotësojnë nevojat e industrisë dhe të eksportit.

Pyjet. — Komiteti Qendror dhe qeveria, duke i vënë rëndësi të madhe sektorit të pyjeve, kanë hartuar dhe kanë vendosur që më parë planin pesëvjeçar të pyllëzimit. Perspektivat e realizimit të këtij plani janë shumë të mira dhe rezultatet e deritanishme janë të kënaqshme.

Gjatë pesëvjeçarit të bëhen studime të plota të pasurisë pyjore, simbas llojeve kryesore të drurëve. Të bëhet inventarizimi i drurëve industrialë si dhe të sigurohet mbrojtja dhe shfrytëzimi racional i pyjeve. Për këtë qëllim të parashikohet në planin pesëvjeçar ndërtimi i disa rrugëve për shfrytëzimin e pyjeve simbas leverdisë ekonomike. T'u kushtohet kujdes pyllëzimeve

të reja duke pasur parasysh edhe pyllëzimin e bregdetit. Të kursehet sa më tepër lënda e drurit për ngrohje duke e zëvendësuar atë me qymyrguri.

TRANSPORTI

Rritja e mëtejshme e ekonomisë popullore kërkon një zhvillim të konsiderueshëm të transportit. Të synohet që gjatë pesëvjeçarit të arrihet një zgjerim i tillë i rrjetit të tri llojeve të transportit në mënyrë që të përballojë plotësisht nevojat e qarkullimit të mallrave. Duhet pasur kujdes në racionalizimin e transportit duke ngritur në një nivel më të lartë shfrytëzimin e transportit detar, hekurudhor dhe automobilistik, duke hequr dorë nga transporti i mallrave me automjete nëpër linjat hekurudhore, duke zhdukur transportin paralel. Të kihet parasysh, që qendrat e prodhimit të ngrihen pranë burimeve të lëndëve të para dhe afër konsumatorit me qëllim që të rregullohet një shpërndarje më e drejtë e mallrave dhe të evitohen transportet e panevojshme.

T'i jepet rëndësi zhvillimit të rrjetit hekurudhor duke ndërtuar linja të reja me qëllim që të lidhen qendrat më kryesore të prodhimit. Të sigurohet baza e riparimit të mjeteve hekurudhore si dhe të kryhet mekanizimi i transportit hekurudhor.

Me qëllim që të përballohet vëllimi i transportit detar, të shtohet kapaciteti i tij dhe të zgjerohet aktiviteti i kantierit detar dhe i porteve.

Zhvillimit të transportit automobilistik t'i kushto-

het një vëmendje e posaçme si nga pikëpamja e shtimit të parkut të automjeteve, ashtu edhe nga pikëpamja e shfrytëzimit të tyre. Të merren masa për një përdorim më të drejtë të automjeteve, duke siguruar masa teknike të nevojshme për mirëmbajtjen e tyre. Të forcohen dhe të zgjerohen ofiçinat ekzistuese, të krijohet baza e riparimit të motorave të automjeteve në përgjithësi si dhe të shtohet prodhimi i pjesëve të këmbimit në vend.

Lidhur me shfrytëzimin e mirë të transportit automobilistik, t'i kushtohet kujdes përmirësimit dhe sistemimit të rrugëve automobilistike.

T'i jepet rëndësi zhvillimit të transportit lokal si dhe përdorimit në një shkallë më të gjerë të transportit primitiv duke siguruar ushqimin e kafshëve me anë të ekonomive ndihmëse.

NDËRTIMET

Për të përballuar punimet e ndërtimeve kapitale, gjatë pesëvjeçarit, të forcohet si dhe të zgjerohet më tepër rrjeti i ndërmarrjeve të ndërtimit, duke krijuar ndërmarrje të posaçme për montime. Të rritet niveli i mekanizimit të ndërtimeve si dhe të sigurohet kuadri i përhershëm në ndërtime.

Orientimi i ndërtimeve gjatë pesëvjeçarit të jetë i tillë që në radhë të parë të sigurohen sektorët më me rëndësi të ekonomisë sonë: minierat, industria, bujqësia dhe transporti. Në lidhje me ndërtimet kapitale të mba-het parasysh leverdishmëria ekonomike e objekteve që

mendohet të ndërtohen. Duhet synuar gjithashtu që të ndërtohen objektet që japin një efekt të madh ekonomik dhe që ndërtohen më shpejt. Shkurtimi i afatit të ndërtimeve duhet të konsiderohet si një nga detyrat kryesore në lidhje me ndërtimet kapitale. Duhet të bëhet një luftë e madhe për uljen e kostos së ndërtimeve dhe për realizimin e planit të ndërtimeve në vëllim fizik.

Një kujdes i veçantë të tregohet për projektet. Kjo çështje gjatë pesëvjeçarit të zgjidhet në një mënyrë të tillë që ato të mos pengojnë realizimin e planeve të ndërtimeve.

Gjatë pesëvjeçarit shtrohet si detyrë problemi i urbanistikës. Të mendohet dhe të përpunohen plane rregulluese për qytetet kryesore dhe në radhë të parë për kryeqytetin. Të përgatitet për këtë çështje kuadri i nevojshëm.

Përveç ndërtimit të objekteve industriale, plani i ndërtimeve duhet të parashikojë edhe ndërtime të banesave për punëtorë. Të shikohet zgjidhja e problemit të banesave në qendrat e punës si faktor i rëndësishëm për realizimin e planit të shtetit në tërësi. Investitorët si dhe ndërmarrjet zbatuese të kenë parasysh thjeshtimin sa më tepër të ndërtimeve duke zëvendësuar hekurin, çimenton dhe të tjera materiale të importit me materiale që prodhohen në vend. Duhet të mbahet parasysh që industria e material ndërtimit gjatë pesëvjeçarit të zhvillohet në shkallë të tillë sa të jetë në gjendje t'i bëjë ballë planit të ndërtimit. Nëpër rrethe të prodhohet më shumë material ndërtimi, tulla, tjegulla, gëlqere etj.

Në lidhje me ndërtimin e objekteve kryesore të

pesëvjeçarit ne duhet të kemi parasysh të metat që janë shfaqur në organizimin e punës për ndërtimet gjatë vitit 1950. Duhet të zhduken të metat në ndërtim, të ecet me një ritëm të shpejtë dhe të kryhen në kohën e caktuar, se ndryshe kjo shkakton humbjen dhe vënjen me vonesë në funksionim të fabrikave të mëdha. Kjo shkakton gjithashtu zgjatjen e pagimit të interesit të kapitalit që ne kemi investuar dhe në këtë rast kreditë e çmueshme që na janë akorduar nga Bashkimi Sovjetik dhe demokracitë popullore nuk do të japin sa duhet frutin e dëshirueshëm dhe kjo bëhet një barrë mbi ekonominë tonë në vend që të jetë një ndihmë e madhe. Kurdoherë duhet të kemi parasysh të përqëndrojmë forcat në ndërtimet kryesore në mënyrë që të realizojmë me kohë ndërtimet dhe instalimet e veprave të mëdha që këto të japin sa më parë frutet. Realizimi i planit pesëvjeçar kërkon shpejtimin e ndërtimit të uzinave, pse kështu do të krijojmë bollëkun në prodhimet e fabrikuara, do të shtojmë klasën punëtore, të cilën duhet ta forcojmë dhe ta edukojmë që të nxjerrë nga dora punë të mëdha. Vetëm kështu do të pasurohet vendi, do t'i shtohen të ardhura buxhetit, do të pakësohen importimet, do të eksportojmë më shumë dhe populli do të kënaqet. Në rast se shpejtojmë ndërtimin, do të përfitojmë eksperiencën e duhur për t'i vënë në shfrytëzim sa më parë fabrikat dhe fitimet do të shkojnë gradualisht duke u shtuar. Në asnjë mënyrë nuk duhet të ngadalësohet ndërtimi dhe asnjë minutë nuk duhet të mbeten pa punuar maqinat. Një gjë e tillë s'duhet të ngjasë as në ndërtimet e dorës së dytë, pse të gjitha janë të lidhura me prodhimin, me ekonominë.

TREGËTIA

Plani pesëvjeçar të parashikojë një rritje të konsiderueshme të qarkullimit të mallrave me qëllim që të përmirësohen konditat materiale të popullit dhe të shkohet drejt heqjes së sistemit të triskëtimit.

Planifikimi i tregëtisë të bazohet në raportin e drejtë të ndërmjet fuqisë blerëse të popullsisë dhe kapacitetit të hedhjes së mallrave në treg, d.m.th. të ruhet raporti midis kërkesës dhe ofertës. Organizatat tregëtare shtetërore e kooperativiste të bëhen më të afta për një shpërndarje më të drejtë të mallrave duke pasur parasysh shijet dhe nevojat e secilit rreth. Të luftohen në formë të organizuar dhe sistematikisht spekulatorët dhe kjo luftë bëhet më mirë kur, përveç të tjerave, tregëtia socialiste siguron furnizimin pa ndërprerje të popullatës.

T'i jepet rëndësi e posaçme zgjerimit të tregëtisë në fshat, të shtohet furnizimi i fshatit me mallra industriale, të forcohen kooperativat e shitblerjes me qëllim që të krijohet një lidhje më e ngushtë midis qytetit dhe fshatit. Sektori kooperativist në tregëti duhet të luajë një rol të rëndësishëm në grumbullimin e tepricave të prodhimeve bujqësore. Organizatat tregëtare kooperativiste të bëhen të afta që të kryejnë më shpejt qarkullimin e mallrave nga prodhuesit te konsumatorët.

Të mbahet parasysh zgjerimi edhe më i madh i ushqimit social në qytet dhe në fshat për të krijuar kondita të një furnizimi më të rregullt për popullin. Të rritet më shumë vëllimi i mallrave të decentralizuara.

Për këtë qëllim të zhvillohet më tepër inisiativa e organizatave tregëtare shtetërore e kooperativiste për të blerë më tepër prodhime nga fshati, nga kooperativat, nga fshatarësia etj.

Organizatave tregëtare, duke studjuar mirë nevojat e popullit, të ushtrojnë një kontroll sistematik mbi prodhimet industriale me qëllim që të përmirësohet kualiteti dhe të zgjerohen asortimentet e tyre. Të merren masa për një qarkullim më të shpejtë të mallrave që të ulen në mënyrë të ndieshme shpenzimet tregëtare, të cilat rëndojnë çmimin e shitjes te konsumatori.

Politika e çmimeve të bazohet në kombinimin e plotë të rritjes së akumulimit shtetëror si dhe të rritjes së fuqisë blerëse të popullit. Politika e çmimeve duhet të synojë në organizimin e një raporti të drejtë midis çmimeve të mallrave industriale dhe të atyre bujqësore.

ARËSIMI DHE KULTURA

Plani pesëvjeçar të nisët nga nevoja, që krahas me zhvillimin ekonomik të vendit, me rritjen e nivelit material të masave punonjëse, të zhvillohet gjithashtu niveli kultural i tyre. Të rritet gjatë pesëvjeçarit rrjeti i shkollave dhe numri i nxënësve në to në një mënyrë të tillë që arësimi fillor i detyrueshëm të zbatohet në të gjithë vendin pa përjashtim, të forcohet arësimi 7-vjeçar dhe arësimi profesional i mesëm, të zgjidhen në mënyrë të konsiderueshme nevojat për teknikë të mesëm në sektorët ekonomikë. Për përgatitjen në vend të kuadrove të lartë të specializuar, gjatë pesëvjeçarit të

ngrihen institute të larta. Instituti i bujqësisë dhe i veterinarisë, Instituti pedagogjik dhe Instituti politeknik të çelen sivjet. Përveç këtyre tri instituteve të larta, me qëllim që të përgatitim kuadro me arësim të lartë për planovikë, për ekonomistë, për financierë dhe për mjekë, të parashikohet që në këtë pesëvjeçar të ngrihen dy institute të tjera të larta: Instituti i lartë ekonomik dhe Instituti i lartë i mjekësisë. Rëndësi të posaçme t'u jepet gjithashtu krijimit të fakulteteve të punëtorëve, arësimit parashkollor dhe atij jashtëshkollor, zhvillimit më të madh dhe ndjekjes së shkollave të natës. Të krijohen konditat e nevojshme për të lehtësuar frekuentimin e arësimit 7-vjeçar dhe të mesëm për fshatarët, që jetojnë në krahina të largëta dhe të vobekta. Të luftohet për zhdukjen e analfabetizmit gjatë këtij pesëvjeçari. Duke marrë parasysh zhvillimin e industrisë dhe të teknikës moderne, duhet të krijohen në vend një rrjet shkollash industriale dhe të organizohet mirë puna në shkollat e rezervave të punës.

Gjatë pesëvjeçarit të shtohet numri i shtëpive të kulturës e të sallave të leximit dhe bibliotekat në qytete e fshatra. Të ngrihet teatri nacional dhe kinostudio si dhe të zgjerohet rrjeti i kinoteatrove.

SHËNDETËSIA

Për të mbrojtur shëndetin e popullit, të forcohet dhe të zgjerohet gjatë pesëvjeçarit rrjeti i institucioneve shëndetësore. Të ngrihen spitale kombëtare rurale dhe qendra shëndetësore në lokalitete për shërbime të

REALIZIMI I PLANIT PESËVJEÇAR KËRKON ORGANIZIMIN E MIRË TË PUNËS, SHEMBULLIN E KOMUNISTËVE DHE HEROIZMIN E MASAVE

Realizimi i planit të parë pesëvjeçar i zhvillimit të ekonomisë popullore, plani i industrisë dhe i teknikës së re, kërkon një organizim më të mirë të punës në të gjitha degët e ekonomisë popullore, në të gjitha fushat e aktivitetit shtetëror si dhe zgjidhjen e një sërë detyrash:

a) Duhet të sigurohet një nivel teknik i lartë në të gjithë degët e ekonomisë popullore si një ndër konditat kryesore të rritjes së prodhimit. Të përvetësohet teknika e re me anën e përgatitjes së kuadrove të nevojshëm për ekonominë popullore.

b) Të futet në jetë sa më gjerë eksperiencia sovjetike dhe eksperiencia e punëtorëve tanë të përparuar dhe novatorë, të studjohen sa më me kujdes zbulimet e reja, racionalizimet, të përkrahët inisiativa krijuese e punëtorëve të përparuar, novatorëve, teknikëve, inxhinierëve. Të lidhet ngushtë Instituti i shkencave me industrinë, minierat dhe bujqësinë. Interesat e ekonomisë popullore kërkojnë riorganizimin e punës në Institutin ekzistues të shkencave duke e tërhequr atë në përpunimin shkencor dhe në zgjidhjen e detyrave praktike të ekonomisë popullore. Duke qenë se ekonomia popullore ka nevojë të madhe për ndihmë të kualifikuar teknike dhe shkencore, gjendja e sotme e punimeve në Institutin e shkencave nuk pajtohet me këto kërkesa. Prandaj duhet të ndihmohet instituti që t'u përgjigjet nevojave të mëdha dhe misionit të tij të rëndësishëm.

c) Për të gjitha degët e ekonomisë popullore është e nevojshme të forcohet përgjegjësia e udhëheqësve për punën e tyre që u është besuar, me qëllim që të shtohet operativiteti në punë si dhe kontrolli për zbatimin e detyrave të tyre. Të udhëhiqet ekonomia në mënyrë konkrete dhe të luftohet burokratizmi i cili degjeneron punën.

ç) Të vendoset një disiplinë e fortë në punë, si në ndërmarrjet industriale, ashtu dhe në ato bujqësore. Të luftohet në mënyrë të vendosur kundër shpenzimeve të kota, kundër shpërdorimeve dhe pakujdesisë, kundër dembellëkut dhe rutinës në prodhim.

d) Të ushtrohet një regjim i rreptë kursimi. Për këtë qëllim të vendosen dhe të zbatohen normativat e përdorimit të materialeve dhe përdorimit të maqinerisë. Planifikimi i materialeve si dhe i maqinerisë të bëhet vetëm në bazë të llogaritjes së normave dhe të ushtrohet një kontroll i rreptë në këtë drejtim. Të ruhet si sytë e ballit pasuria e shtetit, e cila është pasuria e përbashkët e masave punonjëse. Të hiqet dorë nga importime të panevojshme, të shfrytëzohen në maksimum mbeturinat e ndryshme dhe rezervat e brendshme. Të shkurtohet aparati administrativ. Të forcohen ditaditës financat e shtetit tonë, të forcohet çdo ditë e më shumë monedha e vendit tonë.

dh) Gjithashtu duhet pasur kujdes për përqëndrimin e forcave më të mira inxhiniero-teknike në sektorët më me rëndësi të prodhimit dhe jo në qendrat administrative.

e) Një rol vendimtar do të luajnë në realizimin e planit pesëvjeçar forcimi i gjithanshëm i komiteteve ekzekutive në rrethe e lokalitete. Duhet të forcohet dhe

të modernizohet pushteti popullor. Të aktivizohen këshillat popullore në të gjitha instancat e tyre, të aktivizohen komisionet e tyre dhe të marrin në dorë orientimin dhe kompetencat që u përcakton Kushtetuta e Republikës. Të vendoset, në mënyrë të përdiskutueshme kontrolli i masave punonjëse mbi pushtetin e tij, në mënyrë të organizuar, ashtu si e ka vendosur Kushtetuta e Republikës dhe ligjet në fuqi.

ë) Të forcohet dhe të zgjerohet emulacioni socialist dhe të krijohen të gjitha konditat teknike për zgjerimin e zhvillimit të lëvizjes sulmuese të punëtorëve të pararojës.

Të shtohet vigjilenca revolucionare kundër armiqve të popullit tonë si dhe ndjenja e përgjegjësisë për punën e ngarkuar përpara popullit, përpara klasës punëtore dhe Partisë së saj.

Duke marrë parasysh detyrat e mëdha që shtron përpara vendit tonë plani pesëvjeçar në fushën e ndërtimit ekonomik, është për t'u theksuar roli i madh që duhet të luajë Partia si pararoja e të gjitha masave punonjëse, si udhëheqësja e veprimtarisë krijuese të tyre, që bashkon vullnetin e popullit tonë duke i dhënë atij një drejtim të caktuar të nevojshëm për ndërtimin e socializmit në Shqipëri. Komunistët kudo që punojnë, të jenë shembull heroizmi në punë, shembull disipline, të bëjnë një punë intensive, të jenë të përpiktë dhe organizatorë të mirë. Ata duhet të futin në jetë dhe të zbatojnë drejt vijën e caktuar nga Partia. Të luftojnë në mënyrë më energjike çdo shfaqje që e shtrembëron vijën e Partisë në çdo rast dhe kundër kujt do. Organizatat e Partisë duhet të mobilizojnë rreth vetes të

gjitha organizatat shoqërore të masave, sidomos bashkimet profesionale dhe rininë heroike për kryerjen e të gjitha detyrave që vë përpara plani pesëvjeçar. Ato duhet të tërheqin në mënyrë shumë më intensive shtresat e gjera të grave të qytetit dhe të fshatit për ndërtimin e socializmit. Ato duhet të forcojnë marrjen e masave për ngritjen e kualifikimit të punës së grave punëtore.

Organizatat e Partisë duhet të mobilizojnë ditaditës më tepër rreth veprës së madhe të ndërtimit ekonomik masat e gjera të fshatarësisë. Organizatat e Partisë duhet të luftojnë me vendosmërinë më të madhe kundër çdo shtrembërimi të ligjeve e të urdhëresave të organeve të pushtetit. Të godasin në mënyrë më energjike çdo shfaqje burokratizmi kudo qofshin këto, çdo shfaqje indisiplinimi, çdo qëndrim të padrejtë ndaj pasurisë shtetërore, ndaj shpërdorimeve, vjedhjeve e pakujdesisë në punë. Ato duhet të përkrahin në mënyrë më energjike çdo inisiativë të punëtorëve që i sjell dobi vendit tonë. Të përkrahin shpikjet, racionalizimet dhe të kërkojnë me këmbëngulje që këto të vihen në jetë.

Vetëm duke zgjidhur këtë problem do të forcohet në baza socialiste e gjithë mënyra e punës dhe e jetesës së masave të gjera punonjëse të vendit tonë.

Një detyrë shumë me rëndësi në lidhje me këtë u takon organizatave profesionale, leva kryesore të Partisë. Organizatat profesionale të bëhen përcjellëse të mira të vijës së Partisë në masat dhe t'i mobilizojnë ato për zbatimin e saj. Ato duhet të përkrahin dhe të përhapin inisiativat krijuese të punëtorëve si dhe të ndih-

mojnë në punën e organizimit të brendshëm në ndërmarrje.

Një rol të madh duhet të luajë organizata e rinisë, e cila është krahu i djathtë i Partisë në zbatimin e vijës së saj në frontin e luftës kundër prapambetjes tekniko-ekonomike dhe kulturele. Rinia duhet të përhapë me guxim inisiativat përparimtare në qytet dhe në fshat, të jetë përhapëse e realizimeve në punë, të jetë leva kryesore e Partisë në luftën për edukimin e masave punonjëse.

Shokë,

Byroja Politike dhe qeveria kanë hartuar dhe shifrat orientuese të planit pesëvjeçar, të cilat pasi të studjohen dhe të vendosen nga ju, t'u rekomandohen qeverisë dhe organeve planifikuese të shtetit për të punuar në bazën e tyre dhe për të përfunduar planin pesëvjeçar. Siç do ta shihni nga këto shifra orientuese, investime të mëdha do të bëhen gjatë këtij pesëvjeçari.

Këto investime kaq të mëdha gjatë pesëvjeçarit do të ngrenë mirëqenjen, do të bëjnë që të ulen çmimet e sendeve ushqimore dhe të konsumit të gjerë për klasën punëtore dhe gjithë masat punonjëse. Këto investime do të bëjnë që të përmirësohet në mënyrë të dukshme jeta e fshatarëve tanë, do të rriten racionet dhe do të shkohet në rrugën e heqjes së triskëtimit. Sipas shifrave orientuese sigurohet një rritje e konsiderueshme e vëllimit të prodhimeve industriale dhe bujqësore me qëllim që të krijohet një bollëk edhe më i madh në mënyrë që punëtori, fshatari dhe tërë populli të kenë mundësi të marrin më shumë ushqime, më shumë vesh-

mbathje etj. Në saje të rritjes së vëllimit do të rritet paralelisht fuqia blerëse e popullit. Realizimi me sukses i planit pesëvjeçar kërkon, pra, mobilizimin e të gjitha forcave të gjalla të popullit, të cilat nën udhëheqjen e sigurtë të Partisë sonë të Punës, të mobilizohen totalisht për realizimin e planit që përfaqëson të ardhshmen e begatshme e më të lumtur të masave të gjera punonjëse të vendit tonë. Detyrat janë të rënda, por ato duhet të kryhen. Ne do të hasim në vështirësi të panumërta, por Partinë dhe popullin tonë nuk e kanë trembur dhe nuk do ta trembin vështirësitë. Këto do të kapërcehen me sukses, pse në këtë ndërmarrje të madhe dhe jetike për vendin tonë për sigurimin e një të ardhshmeje më të mirë të popullit, për sigurimin e pavarësisë së vendit tonë, për sigurimin dhe mbrojtjen e paqes, që kërcënohet nga luftënxitësit amerikano-anglezë dhe satelitët e tyre, populli dhe Partia jonë kanë ndihmën e madhe dhe përkrahjen e fuqishme të Bashkimit Sovjetik dhe personalisht të shokut Stalin, kanë ndihmën e përkrahjen e vendeve të demokracisë popullore, kanë përkrahjen e gjithë popujve përparimtarë të botës. Suksesi për realizimin e këtij plani pesëvjeçar madhështor të vendit tonë është në duart tona dhe ne do ta kryejmë me sukses dhe me nder këtë barrë të rëndë, por të lavdishme për lumturinë dhe begatinë e popullit tonë, për mbrojtjen e lirisë dhe të pavarësisë së vendit, për mbrojtjen e paqes në botë.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 229 (923), 25 shtator 1951

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

MBI KRITERET PËR VAZHËDIMIN E STUDIMEVE TË LARTA

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

5 tetor 1951

Byroja Politike ka dhënë direktivë se cilët nxënës ose punonjës duhet të ndjekin studimet e larta. Kjo direktivë, megjithëse ka qenë kurdoherë dhe është e drejtë, në praktikë është shtrembëruar, sidomos kur ka qenë rasti për të gjykuar se cilët nxënës ose kuadro do të kalojnë në institutet e larta. Byroja Politike ka thënë që në institutet tona të futen bij e bija të popullit, të punëtorëve e të fshatarëve. Gjithashu ajo ka thënë se kur numri i studentëve, që do të vazhdojnë studimet në këto institute, nuk plotësohet nga persona me përbërje të mësipërme, atëhere mund të pranohen edhe fëmijë të shtresave të pasura, por këta të zgjidhen me shumë kujdes që të jenë nga ata që prindërit e tyre nuk kanë qenë të këqinj ose nga ata, prindërit e të cilëve japin

¹ Në këtë mbledhje u shqyrtua plani e kriteret për nxënësit e shkollave të mesme që do të ndiqnin studimet e larta.

shenja që do të ndreqen, pse është absurde të dërgohen në institute njerëz, të cilët pas katër vjetësh, kur të kryejnë studimet e larta, të dalë pikëpyetja se «ku do të çohen», «a mund të vendosen këtu, në uzinat e ndër-marrjet tona» etj. Origjina e nxënësve që do të ndjekin studimet e larta të mbahet kurdoherë parasysht, prandaj ne, për ata me përbërje jo të mirë, duhet të ecim me kujdes, pse ata duhet të japin prova. Më duket kjo është rruga më e drejtë.

Vijmë te ata që do të çojmë në prodhim. Edhe për këta kemi thënë që të jenë elementë të mirë, pse prodhimi ka nevojë për njerëz të tillë, por duke marrë parasysht se punonjësit më të mirë ne i çojmë për studime, në prodhim mbeten njerëz që janë edhe analfabetë. Në shkollat e mesme ne kemi njerëz që mund ta bëjnë punën më mirë se ata që kemi sot në prodhim, prandaj nga këta të dërgojmë edhe në prodhim dhe Partia t'i ndihmojë e t'i kontrollojë ata në punë.

Këto direktiva të drejta të Byrosë Politike nuk janë zbrërthyer mirë. Unë kam marrë vesh se verifikimi i njerëzve që ndjekin studimet e larta, nuk bëhet si duhet nga Partia. Kujdesi për këta studentë duhet të jetë njësoj si edhe për ata që shkojnë për studime jashtë shtetit. Ato kritere që ndiqen për ata që dalin për studime jashtë shtetit, duhet të ndiqen edhe për ata që do të hyjnë në institutet e larta të vendit tonë. Por kjo nuk është bërë në rregull, sidomos nga Ministria e Arësimit. Mirëpo kjo nuk duhet të jetë vetëm çështje e Ministrisë së Arësimit, por e të gjitha dikastereve. Ministri duhet t'i thotë shefit të kuadrit që për studime të shkojë ai kuadër që ka kërkuar, por të mendojë për

zëvendësimin e tij dhe, kur të mbarojë, të kthehet aty.

Ka ankesa nga njerëz të ndryshëm, pse deri tani, këto punë janë kryer me shumë gabime edhe nga ana politike, gabime të cilat u konstatuan nga Kryesia e Këshillit të Ministrave.

Gjithashtu ka edhe një tendencë që t'u jepen të gjithëve bursa, por kjo s'është e drejtë, pse ka familje që kanë njerëz të tyre në punë këtu në Tiranë etj., të cilat duhet të bëjnë disa vjet sakrificë, ashtu sikurse kanë bërë deri tani. Pra, këtyre njerëzve mund të mos u jepen bursa. Pastaj mund të jepen edhe gjysmëburse, që të bëjmë ekonomi. Këto çështje duhen parë më drejt.

Shokët që kishim ngarkuar për këtë punë duhet t'i shikonin me kujdes këto çështje delikate dhe të mos na vinin këtu për të na paraqitur vetëm shifra e lista.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekreta-
riatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

MBI PREGATITJEN DHE NGRITJEN E KUADROVE TË PARTISË NGA RADHËT E KLASËS PUNËTORE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

12 tetor 1951.

Direktiva e Komitetit Qendror për çështjen e kuadrit ka qenë dhe është e qartë: në aparatet e Partisë të punojnë kuadro besnikë, të dalë nga klasa punëtore, të cilët, për t'u bërë të aftë për të marrë në dorë drejtimin e punës së Partisë, duhet të përgatiten në kurset dhe në Shkollën e Partisë. Por, me sa shohim, kjo direktivë nuk është zbërthyer si duhet dhe si rrjedhim, poshtë në bazë, ajo nuk është zbatuar mirë.

Siç dihet, niveli arësimor dhe ngritja ideologjike e punëtorëve tanë komunistë, sot për sot janë të ulëta.

Ne kemi punëtorë, anëtarë partie që nuk kanë shkollë, por që kanë eksperiencën e jetës, kemi të tjerë me shkollë filllore, por që edhe ata kanë një farë praktike nga jeta dhe drejtojnë sektorë të Partisë ose të shtetit,

¹ Në këtë mbledhje u shqyrtua problemi i propagandës në Parti gjatë vitit 1950—1951.

këmi gjithashtu dhe të tjerë me më shumë shkollë, për shembull me ndonjë qytetëse¹.

Me qëllim që këta shokë të ngrenë nivelin e tyre, Partia ka hapur një sërë kursesh, por duhet pasur parasysh se ata nuk mund t'i bëjmë të përsosur me një muaj ose me një vit kurs, po do t'i ngremë gradualisht e shkallë-shkallë dhe jetën e punën e tyre do ta ndjekim vazhdimisht.

Partia, kur e shikon se një grup punëtorësh mund të punojnë në aparatet e saj, megjithëse mund të kenë pak shkollë, duhet t'i dërgojë në kurset e shkurtra të Partisë. Pastaj ata të vendosen në aparatet e Partisë për të punuar. Si të rrinë këtu një vit ose më tepër dhe të fitojnë eksperiencën e duhur në punë, të dërgohen në një kurs tjetër më të gjatë, si në atë tremujor ose pesëmuajor dhe si ta kryejnë atë, të kthehen prapë e të punojnë në aparatet e Partisë. Më vonë, si të kenë punuar aty një farë kohe, të dërgohen në Shkollën e Partisë dhe me mbarimin e saj, të kthehen përsëri në aparatet e Partisë. Kështu, me këta kuadro, dalëngadalë, zëvendësohen mjaft nga elementët intelektualë që punojnë në aparate të Partisë ose ata që mund t'i dërgojmë të punojnë në sektorë të tjerë. Në këtë mënyrë mendoj të veprohet në të ardhshmen dhe të mos ndodhë si tani që merret punëtori dhe dërgohet drejt në kurs pesëmuajor ose më keq, në Shkollën e Partisë, pa menduar se atje ai do të hasë vështirësi, pse i mungon si parapregatitja e nevoj-

¹ Shkolla gjysmë të mesme që zgjatnin 4 vjet pas mbarimit të shkollës fillore.

shme praktike, ashtu edhe baza e domosdoshme arësi-more-kulturale.

Por, për të vepruar siç thashë më lart, është e domosdoshme të punohet me perspektivë, të dihet mirë gjendja e kuadrove në aparat, të mendohet me kohë se kush duhet dërguar në shkollë, kush duhet zëvendësuar ose dërguar në sektorë të tjerë. Pa një punë të tillë nga ana e drejtuesve të Partisë në rreth, nuk mund të zbatohet plotësisht direktiva e Komitetit Qendror. Ka komitete partie që nuk kanë punuar kështu, prandaj hasin dhe vështirësi në zbatimin e kësaj direktive.

Le të marrim si shembull rrethin e Vlorës. Atje është hapur një kurs partie pesëmujor, po unë jam i sigurtë se sekretari i parë i Partisë të këtij rrethi jo vetëm nuk e ka parë mirë përbërjen e njerëzve që janë dërguar në këtë kurs, por më e keqja është se nuk ka menduar qysh tani se cilin prej tyre do ta marrë në aparat dhe cilin do të heqë prej andej, ose me cilin do të zëvendësojë atë tjetrin që vitin e ardhshëm do të dërgohet në Shkollën e Partisë. Kjo tregon se shokët në rrethe pak interesohen për kurset dhe Shkollën e Partisë dhe nuk u japin atyre rëndësinë e duhur.

Partia duhet ta vlerësojë shkollën si një faktor me rëndësi jashtëzakonisht të madhe për ngritjen dhe edukimin e kuadrove duke pasë shumë parasysh perspektivën e vendosjes së tyre, pse një punë e tillë, pa perspektivë, do të na pengojë shumë në zbatimin e direktivave.

E vlen barra qiranë që kurset pesëmujore të kontrollohen e të ndihmohen më shumë edhe nga aparati i Komitetit Qendror duke dërguar herë pas here shokë në çdo rreth ku ka kurse të tilla. Atje të njihen një për

një dhe nga afër elementët që janë dërguar. E them këtë se, më duket, se si nga ana e Partisë, ashtu dhe nga ana e pushtetit nuk po tregohet interesimi i duhur për kuadrot, nuk po ndiqet këmba-këmbës ngritja dhe edukimi i tyre ideologjik, politik dhe profesional. Një gjë e tillë nuk mundet më të lejohet.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

**PËRSHËNDETJE DËRGUAR NDËRTUESVE TË
FABRIKËS SË SHEQERIT «8 NËNTORI» ME RASTIN
E MBARIMIT TË PUNIMEVE**

31 tetor 1951

**SHOKËVE TË KOLEKTIVIT PUNONJËS TË FABRIKËS SË
SHEQERIT «8 NËNTORI»**

Maliq

Qofshi të gëzuar dhe të nderuar, ju, shokë punëtorë, teknikë, inxhinierë, ndërtues, që gëzuat popullin tonë, duke ndërtuar për të, një nga fabrikat madhështore të planit të parë pesëvjeçar, Fabrikën e sheqerit «8 Nëntori».

Ju falenderoj nxehtësisht dhe i uroj gjithashtu kolektivit punonjës të shfrytëzimit, të ndjekë rrugën tuaj plot zotësi dhe heroizëm, për t'i dhënë popullit sa më shpejt dhe sa më shumë sheqer.

Rroftë Partia jonë e dashur që na udhëheq në rrugën e fitoreve!

Kryeministri

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 260 (1954), 31 tetor 1951

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 260 (1954), 31 tetor 1951

**NGA BISEDA NË TAKIMIN ME DELEGACIONIN
E PUNONJËSVE TË NDËRTIMIT DHE TË
SHFRYTËZIMIT TË FABRIKËS SË SHEQERIT
«8 NËNTORI»**

31 tetor 1951

Mbasi drejtori i kantierit të ndërtimit të fabrikës së sheqerit i transmeton përshëndetjen nga ana e punonjësve, shoku Enver merr fjalën:

Kjo është një vepër e madhe që po vihet në shërbim të popullit dhe ju detyrohet juve, punëtorëve të këtij kantieri që keni punuar me vetëmohim dhe heroizëm dhe keni nxjerrë një punë të pastër. Shokët që e kanë vizituar, pak më parë, na kanë thënë se atje, veç të tjerave, është bërë një punë e bukur artistike. Kjo gjë tregon se sa vlera të mëdha dhe ç'punëtorë të zot ka në gjirin e klasës sonë punëtoreshë që janë në gjendje të mësojnë, të përparojnë dhe të kryejnë vepra me të vërtetë të denja për socializmin, të cilëve populli ynë do t'ua dijë për të mirë dhe do t'u jetë mirënjohës. Kjo është një nga veprat e para të socializmit, po ne na presin edhe punë të tjera, fabrika të tjera, pse industria jonë do të zhvillohet çdo ditë e më tepër. Partia do t'i vërë

rëndësi të madhe industrisë, që në vendin tonë të ketë më shumë prodhime për popullin, të shtohet dhe të forcohet më shumë klasa jonë punëtore, pse atje qëndron forca e Partisë sonë. Njëkohësisht Partia do të punojë që të zhvillohet edhe bujqësia, pa të cilën nuk mund të zhvillohet industria, se ju, për shembull pa pasur panxharin, nuk mund të prodhoni sheqerin.

Edhe shokët sovjetikë kanë punuar bashkë me ju, ju kanë ndihmuar dhe në e dimë se pa ndihmën materiale-teknike dhe eksperiencën e tyre, nuk mund të ngriheshin kaq shpejt vepra të mëdha. Me ndihmën e tyre ne përgatitëm edhe njerëz të aftë për të ndërmarrë dhe për të ndërtuar vepra edhe më të mëdha. Shokët sovjetikë që i njohin njerëzit tanë, na thonë se ju keni punëtorë të mrekullueshëm, që bëjnë punë për t'u lavdëruar dhe, megjithëse u mungon shkolla, ata e përvetësojnë shpejt dhe mirë zanatin.

Gjatë ndërtimit të këtyre veprave të mëdha te ne kanë dalë mjeshtra të mirë. Këta janë një thesar i madh për popullin tonë dhe një siguri për ndërtimin e bazave të socializmit.

Në radhë të parë jeni ju punëtorët e ndërtimeve që keni pasur suksese të mëdha në të gjitha ndërmarrjet si në fabrikën e sheqerit, ashtu edhe në ndërtimin e Hidrocentralit «Lenin» e të Kombinatit të tekstileve «Stalin». Këto janë bërë shkolla dhe këtu Partia po formon kuadrot e ardhshëm.

Po, është e vërtetë, që edhe populli i Korçës ju ka ndihmuar mjaft në ngritjen e fabrikës. Komiteti i Partisë për Korçën ka qenë në lartësinë e duhur në ndihmën që ju ka dhënë për organizimin e punës. Udhëheqja e

ndihma e afërt e Partisë luajnë një rol të madh në realizimin e veprave të tilla të mëdha.

NJË PUNËTOR: Në fabrikën e sheqerit fillova i pari të punoja me metodën Kulikov, i ndihmuar nga shokët sovjetikë dhe arrita kështu, dalëngadalë, që të bëja deri në 5 metra kub mur në ditë dhe, përveç asaj, të mos kisha shumë lodhje, kurse me mënyrën e vjetër, çdo mbrëmje ndjeja lodhje të madhe në mes. Unë jam shumë i kënaqur, që Partia më shpëtoi nga torba në krahë për gjithë jetën dhe që punova për ngritjen e një fabrike për të mirën e popullit dhe të gjithë Shqipërisë¹.

SHOKU ENVER: Ju e shihni vetë, pra, se sa të mira janë metodat e reja, prandaj ato duhet t'i vëmë në zbatim.

NJË PUNËTOR TJETËR: Unë, më përpara, kam qenë shitës gazetash rrugëve dhe e them sinqerisht, nuk mendoja kurrë se do të bëhesha një teknik. Por ja që Partia mua më bëri teknik dhe unë bëra një kthesë në jetën time. Të gjithë këtë unë ja dedikoj Partisë që më dha dorën dhe më ngriti. Gëzim i madh ka qenë për mua kur filloi maqinaria të punojë! Në kohën kur rrinim në centrifugë për të parë frutin e punës që kishim bërë, kujtoja tërë kohën e kaluar (qan). Mbas dy minutash doli sheqeri, të gjithë punëtorët u grumbulluan me gëzim dhe morën për ta provuar dhe një pjesë ua kemi sjellë edhe Juve.

Nën udhëheqjen e Partisë dhe Tuajën dhe me

¹ Fjala e pjesëmarrësve të tjerë në bisedë botohet me shkurtime.

ndihmën e Bashkimit Sovjetik le të bëhet e ardhshmja e popullit tonë e ëmbël si ky sheqeri dhe armiqtë le të pëlçasin. Sipas mësimeve Tuaja ne do të shkojmë atje ku të na thërresë Partia dhe do të japim edhe jetën për të.

SHOKU ENVER: Me të tillë njerëz, që rrit Partia, çdo gjë do të shkojë përpara, vendi ynë do të përparojë, populli do të rrojë më mirë, mbrojtja e pavarësisë do të forcohet. Kjo është e ardhshmja e popullit tonë.

Tani ju duhet të perfeksionoheni dhe ta fitoni mirë zanatin e shokëve sovjetikë; prodhimi i sheqerit është një industri delikate, që do mjaft kujdes dhe përpjekje për të mësuar. Sigurisht shokët sovjetikë, si gjithnjë, nuk do të kursehen t'i mësojnë kuadrot tanë, por ju e dini mirë se shokët sovjetikë nuk do t'i kemi gjithnjë këtu, por ata do të vënë të gjitha forcat që ne të mësojmë dhe të marrim nën drejtimin tonë edhe maqineritë më moderne. Ata do t'i mbajmë derisa punëtorët tanë të bëhen vetë specialistë dhe të aftë për të drejtuar ekonominë. Kjo është dhe këshilla e shokut Stalin, që më ka dhënë mua. Ai na ka thënë se do të na ndihmojnë me të gjitha forcat, që të ngremë fabrika, të mësojmë kuadrot, që kështu ta marrim vetë në dorë punën. Unë kam vizituar shumë fabrika dhe uzina të BS. Drejtori i një uzine në Stalingrad më tha se atje punonin 3500 inxhinierë. Kur unë i thashë se kjo është e habitshme, ai m'u përgjeggj se kur ishte ngritur për herë të parë uzina e traktorëve, ai vetë ishte sekretar i dytë partie dhe uzina kishte fare pak inxhinierë, kurse shumë punëtorë nuk dinin të shkruanin e të lexonin. Por, tha ai, nëpërmjet shkollave, që hapi partia, u bë e mundur që ata të mësonin dhe tani të gjithë janë bërë inxhinierë të zot.

Kështu duhet të bëni dhe ju, të mësoni në kurset e shkollat që hap Partia. Kjo është rruga e Partisë sonë. Ne duhet të ngremë kuadrot tanë drejtues nga radhët e klasës sonë punëtore dhe nga fshatarësia e varfër dhe këtë ta bëjmë jo vetëm për sektorët e ekonomisë, po për të gjithë sektorët kyç të shtetit tonë. Ne kemi suksese në këtë drejtim dhe plani pesëvjeçar do të jetë një hap i madh përpara në këtë rrugë. Klasa jonë punëtore ka qenë e vogël në vendin tonë, pse kapitalizmi nuk ishte zhvilluar dhe vendi ynë ishte feudal dhe gjysmëfeudal. Por nga çlirimi e këtij, ajo është zgjeruar e forcuar dhe është shtuar përqindja e njerëzve të klasës punëtore në drejtimin e udhëheqjes së Partisë dhe të ekonomisë. Kjo duhet dhe do të shkojë me një ritëm edhe më të madh. Plan i pesëvjeçar do t'i japë popullit me mijëra kuadro të rinj. Këtu është siguria jonë, e së ardhshmes sonë. Te ne, është treguar me fakte që njerëzit e popullit tonë janë të tillë që mund ta përvetësojnë shpejt e mirë kulturën dhe shkencën. Ne duhet të luftojmë më shumë për këtë, pse kjo është një gjë e madhe dhe për klasën punëtore kjo nuk është shumë e rëndë. Vetëm se në fillim duhet më shumë insistim dhe kujdes më i madh nga Partia dhe nga udhëheqja. Shokët që shkojnë në shkollat jashtë shtetit kanë dalë faqebardhë dhe kanë habitur edhe vendësit. Populli ynë është një popull i zgjuar, plot energji e vullnet.

Këtë sheqer që më dhuroat ne do ta vëmë në muze, pse ne do të krijojmë edhe muzeun e industrisë, që pas disa dhjetëra vjetësh pasardhësit tanë të vijmë e t'i shikojmë këto gjëra, të njohin gëzimet tona.

Fabrika e sheqerit u ngrit nga organizimi i mirë i

punës, nga rregulli e disiplina për të cilat klasa punëtore duhet të japë shembull, pse me disiplinë dhe organizim realizohet çdo gjë. Prandaj të jeni të ashpër ndaj lëshimeve, pse në disa njerëz ekziston akoma fryma e vjetër.

Në gjirin e popullit tonë ka njerëz të mrekullueshëm. Një njeri i thjeshtë më ka dërguar një portret me kokrra gruri, misri, fasule, me fletë trëndafili etj. Një kryevepër e bukur që edhe artistët tanë zor ta bëjnë ashtu. Ky njeri i thjeshtë populli që e bëri këtë portret, thotë se kur e filloi ju kujtua e gjithë e kaluara. Këto janë talentet e reja që po rrit Partia. Njerëzit e thjeshtë përpiqen të mësojnë, të perfeksionohen me metoda të reja për të prodhuar më shumë që jeta e njeriut të bëhet më e mirë dhe më e begatshme.

Ndryshe nga ne, imperialistët punojnë për të shtypur dhe për t'ua bërë sa më të rëndë jetën popujve. Teoria e tyre është që njerëzimi të shtohet sa më pak, bile përpiqen për të bërë vrasje në masë. Kjo është teoria raciste e imperialistëve amerikanë. Por kjo nuk do t'u shkojë se e drejta fiton dhe do të fitojë.

Kështu pra, shokë, ju uroj edhe një herë për suksesin e madh që keni arritur dhe punë të mbarë!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 262 (1956), 2 nëntor 1951

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**PËRSHËNDETJE DËRGUAR NDËRTUESVE TË
KOMBINATIT TË TEKSTILEVE «STALIN» ME
RASTIN E MBARIMIT TË PUNIMEVE DHE
VËNJES SË TIJ NË SHFRYTËZIM**

1 nëntor 1951

**SHOKUT NEÇO KONOMI
DREJTOR I NDËRMARRJES «21 DHJETORI» PËR
NDËRTIMIN E KOMBINATIT TË TEKSTILEVE «STALIN»**

T i r a n ë

Shokë të kolektivit punonjës,

Me gëzim të madh mora letrën ku më njoftoni mbarimin dhe vënjën në shfrytëzim të kombinatit. Ju falenderoj nxehtësisht të gjithë ju, shokë punëtorë, teknikë, inxhinierë për punën e shkëlqyer që keni bërë duke i dhënë popullit këtë vepër monumentale që mban emrin e të madhit Stalin.

Ky kombinat është një nga veprat më të mëdha të socializmit, që gëzon pa masë popullin tonë, pse ai do t'i sigurojë veshje në sasi të mjaftueshme. Kjo vepër, që Partia ja premtoi popullit dhe sot ja bëri realitet, u

ngrit në saje të ndihmës së Bashkimit Sovjetik dhe të interesimit personal të shokut Stalin.

Ju uroj suksese akoma më të mëdha në realizimin e veprave të tjera të planit pesëvjeçar, i cili do të bëhet realitet, në saje të zotësisë dhe të heroizmave tuaja, në saje të ndihmës dhe të eksperiencës së madhe që i jepet popullit dhe klasës sonë punëtoare heroike nga punonjësit sovjetikë.

Rroftë organizatorja e të gjitha fitoreve të popullit tonë, Partia e Punës!

Të rrojë sa malet i madhi Stalin që na udhëheq në rrugën e lavdishme të socializmit dhe të paqes!

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 261 (955), 1 nëntor 1951

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 261 (955), 1 nëntor 1951



**PËRSHËNDETJE DËRGUAR NDËRTUESVE TË
UJËSJELLËSIT LANABREGAS—TIRANË—
—KOMBINATI I TEKSTILEVE «STALIN» ME
RASTIN E MBARIMIT TË PUNIMEVE**

2 nëntor 1951

**SHOKË TË KOLEKTIVIT PUNONJËS TË KANTIERIT PËR
NDËRTIMIN E UJËSJELLËSIT LANABREGAS—TIRANË—
—KOMBINATI I TEKSTILEVE «STALIN»**

Ju përgëzoj për mbarimin e punimeve të Ujësjiellësit Lanabregas—Tiranë—Kombinati i tekstileve «Stalin». Populli i kryeqytetit të atdheut tonë të lirë e të lumtur do t'ju jetë mirënjohës përjetë për ndërtimin e kësaj vepre të madhe të socializmit.

Rroftë Partia jonë e Punës!

Rrofshin Bashkimi Sovjetik dhe i madhi Stalin që na japin të gjitha mundësitë për të ndërtuar vepra të tilla që do ta bëjnë të lulëzuar jetën e popullit tonë!

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 262 (1956), 2 nëntor 1951

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 262 (1956), 2 nëntor 1951

**NGA BISEDA NË TAKIMIN ME NJË DELEGACION
TË PUNONJËSVE TË HIDROCENTRALIT «LENIN»
ME RASTIN E MBARIMIT TË PUNIMEVE**

2 nëntor 1951

Mbasi takohet përzemërsisht me ta, shoku Enver u thotë:

Ju falenderoj, shokë, për veprën madhështore që ngritët me punën dhe heroizmat tuaja, të gjithë ju, punëtorë, teknikë e inxhinierë. Vepra juaj është e pavdekshme. Ajo jo vetëm do t'i japë Tiranës ujë dhe do të bëjë kryeqytetin të ndritë, por çel rrugën për të bërë punime të tjera më të mëdha se ky hidrocentral në vendin tonë. Këtë vepër kaq të madhe arritëm ta ngremë me ndihmën e shokëve sovjetikë, pa të cilët me forcat dhe mundësitë tona do të ishte e vështirë që ta ndërtonim në një kohë të tillë. Me ndihmën e Bashkimit Sovjetik dhe të shokëve inxhinierë e teknikë sovjetikë ne ngritëm këtë hidrocentral, po ne njëkohësisht krijuam atje edhe një inteligjencë të re d.m.th. njerëz të zot, të zgjuar, që kanë bërë trimëri dhe heroizma dhe kanë përvetësuar mirë mjeshtërinë që u është ngarkuar. Edhe inxhinierët tanë të vjetër duke punuar në këtë vepër të madhe, me ndihmën e inxhinierëve sovjetikë,

janë perfeksionuar. Ata kanë fituar eksperiencë të madhe gjatë punimeve të ngritjes së hidrocentralit. Tani kemi kuadro të rinj, të dalë nga gjiri i popullit që janë në gjendje të kryejnë edhe punë të tjera më të mëdha që ne do të bëjmë dhe do t'i kryejmë me sukses në të ardhshmen. Dhe ne do të bëjmë më shumë se ky hidrocentral, sepse tani kemi përgatitur njerëz të aftë e të guximshëm nga klasa punëtore, njerëz që çajnë malet dhe, kur ja japin fjalën Partisë për të bërë një vepër madhështore si kjo, e mbajnë, duke e kryer punën me sukses dhe në kohën e caktuar. Pra, bashkë me ngritjen e hidrocentralit njëkohësisht krijuam dhe mësuam kuadro të çelniktë që janë forca e Partisë dhe e popullit tonë. Duke forcuar klasën punëtore ne kemi ndihmuar që të forcohet më shumë mbrojtja e pavarësisë së vendit tonë dhe të bëhet më e lumtur e tashmja dhe e ardhshmja e Shqipërisë. Ndërtimi i veprave të mëdha të socializmit që u mbaruan me rastin e 10-vjetorit do ta bëjnë më të lumtur, më të gëzuar dhe më të pasur jetën e popullit tonë. Për këtë lufton Partia, që të përmirësohet jeta e popullit nga viti në vit dhe të ngrihet standardi i jetesës. Kjo do ta bëjë popullin më të fortë, më të shëndetshëm dhe më luftëtar për mbrojtjen e paqes e të socializmit.

Partia jonë lufton që të përmirësohet jeta e popullit në vendin tonë, të ketë bollëk dhe të bëhet e mundur që njerëzit të rrojnë sa më shumë. Toka jonë, ka aq pasuri, aq thesare të mëdha, sa mund të mbajë dhe të ushqejë mirë, jo vetëm këtë numër njerëzish që janë sot, por shumë më tepër. Dhe shkenca përparimtare botërore e sovjetike do t'ja arrijë qëllimeve për të

shtuar jetën e njeriut. Sot në të gjithë botën forcat përparimtare po bëjnë përpjekje që të mos ketë luftë grabitqare, pse doktrina marksiste-leniniste është për paqen midis popujve. Ndryshe është puna me imperialistët. Ata janë për luftën, për shfarosjen e sa më shumë njerëzve. Ata janë një grup kriminelësh që rrojnë me gjakun e popullit dhe e varfërojnë në kulm atë. Krejt ndryshe është nga ana jonë. Ne luftojmë që jeta të bëhet më e bukur, që njerëzit të shtohen, të rrojnë të gëzuar dhe të kenë jetë sa më të gjatë. Kjo është e ardhshme që siguron shoqëria socialiste dhe ne do të fitojmë se popujt janë më të fortë nga klikat imperialiste.

Është një gëzim i madh për popullin, kur sheh që dalin te ne njerëz të rinj, të cilët ndërmarrin vepra kaq të mëdha. Komiteti Qendror i Partisë ka dijeni se në të gjithë Shqipërinë ka shpërthyer një entuziazëm i papërshkruar me rastin e 10-vjetorit të Partisë, pse populli sheh konkretisht që çka i ka premtuar Partia, ja ka realizuar. Po këto realizime, këto suksese në ngritjen e këtyre veprave të mëdha i detyrohen vullnetit tuaj, heroizmave tuaja. Pa ju Partia nuk mund të ecte. Me ju Partia është e fortë, ajo dita-ditës do të forcohet më shumë dhe rreziqet që kërcënojnë sot vendin tonë do të zhduken. Dhe kështu është. Kur armiku gjen përpara një popull të tillë, si tonin, të pafrikshëm, të bashkuar si një trup i vetëm dhe të fortë, nuk guxon t'i afrohet. Përkundrazi, kur e gjen të dobët, e atakon dhe e dëmton. Prandaj, ne duhet të jemi jashtëzakonisht të fortë. Me punën që po bën sot Partia jonë, grumbullon rreth saj dhe rreth qeverisë së Republikës me mijëra njerëz të tjerë që më parë kanë qenë të lëkundshëm. Por jo vetëm

këta, po edhe të tjerë që kanë qenë në pozita më të këqia, po i vënë gishtin kokës dhe thonë: «çfarë të keqe kam unë nga ky pushtet? Unë i lirë jam, mund të zhvillohem, punë kam, jeta në vendin tim po përmirësohet, përse të mos jem me këtë pushtet, që punon për popullin?» Kështu mendojnë tani edhe këta njerëz dhe fillojnë të afrohen me vijën e Partisë, pse e shohin që ajo është e drejtë, në interesin e popullit dhe të atdheut. Për të gjithë ata që duan të ndjekin rrugën e drejtë, ekzistojnë të gjitha mundësitë që të jetojnë të lumtur dhe të zhvillohen.

Ngritja e hidrocentralit dhe e objekteve të tjera janë vepra të mëdha të popullit e të Partisë dhe ata që janë jashtë kufive, le të lehin sa të duan, nuk kanë ç't'i bëjnë Shqipërisë. Koha e tyre ka vdekur përgjithnjë. Por, natyrisht, ne duhet të jemi kurdoherë vigjilentë dhe t'i hapim sytë e t'i bëjmë katër; t'i mbrojmë me vendosmëri fitoret e popullit dhe këto vepra të mëdha që po ndërtojmë. Këtë ta kemi parasysh, sepse armiku nuk fle dhe, sa më të fortë të bëhemi ne e sa më tepër suksese të korrим, aq më i egër do të bëhet, prandaj shumë më të ashpër duhet të jemi kundrejt tij. Ky është ligj për mbrojtjen e jetës së popullit. Armiqtë e vendit tonë duan vdekjen e popullit, prandaj ne do t'i shtypim.

Kolektivi juaj, që ka treguar kaq heroizma në ndërtimin e këtij hidrocentrali, do të mbahet i grumbulluar dhe do të përdoret për të ndërtuar në të ardhshmen vepra të tjera më të mëdha se ky hidrocentral.

Sikurse më njoftonit në letrën që më keni drejtuar, hidrocentralin e keni gati dhe vetëm prisni urdhërin që t'i jepni dritë Tiranës.

Është një sukses i madh për popullin tonë realizimi i kësaj vepre të madhe që u ndërtua nga ju. Ju punuat me heroizëm dhe përballuat vështirësi të mëdha. Sikur të punojnë në çdo sektor, ashtu sikurse keni punuar ju dhe disa të tjerë, populli do të ketë dhe më shumë ushqime e sende të tjera të nevojshme. Ne do t'ja vëmë si detyrë Partisë që brenda këtij pesëvjeçari t'i heqim triskat; këtij objektivi ne do t'ja arrijmë, sepse vullneti i popullit dhe i njerëzve tanë është jashtëzakonisht i madh.

Shoku Enver pyeti pastaj punëtorin Sali Vata në ç'punë do të shkonte pas ndërtimit të kësaj vepre.

PUNËTORI SALI VATA: Ku të thotë Partia, shoku Komandant. Ne jemi ushtarë të Partisë dhe do të shkojmë atje ku të jetë nevoja. Ne do të jemi më të fortë në ndërtimin e veprave të pesëvjeçarit, pse tani, me eksperiencën që fituam në ndërtimin e këtij hidrocentrali, jemi bërë specialistë. Prandaj kemi besim të plotë se do të jemi dyfish më të zot në punët që do të bëjmë gjatë planit pesëvjeçar.

SHOKU ENVER: Me këta kuadro që janë rritur në vendin tonë ne do të ndërtojmë shpejt socializmin. Populli ynë, që ka qenë i shtypur në të kaluarën, ka ruajtur energji të mëdha revolucionare, që tani kanë shpërthyer si një vullkan i madh. Këto janë momente jashtëzakonisht revolucionare që Partia jonë duhet t'i shfrytëzojë. Njerëzit kanë dëshirë të madhe të mësojnë, të zhvillojnë dhe të zgjerojnë njohuritë e tyre dhe të përvetësojnë shkencën. Partia e ndjek me kujdes këtë dëshirë që kanë njerëzit tanë për të mësuar. Ajo do t'i dërgojë ata në shkolla e universitete, do t'u hapë kurse të gjata dhe të shkurtëra, që nga radhët e klasës punëtore dhe të

fshatarësisë së varfër të dalin njerëz të zot. Ne i kemi të gjitha mundësitë dhe këtë gjë do ta bëjmë për të përgatitur kuadrin tonë të ri. Ju deri dje ishit fshatarë të thjeshtë, kurse tani jeni bërë specialistë, montatorë, inxhinierë. Tani ne kemi montatorë të tillë, që janë në gjendje të montojnë edhe rafinerinë e re që do të ngremë, pa qenë nevoja të vijnë montatorë sovjetikë, mbasi njerëzit tanë tani kanë fituar një eksperiencë të madhe. Mjafton vetëm të kenë një inxhinier që t'i udhëzojë. Këtë na e thonë edhe shokët sovjetikë.

Për këta kuadro të shquar, që janë dalluar në këto vepra të mëdha, ne do të vëmë edhe disa rregulla që të mos shpërndahen andej-këtej e të humbasin, por të qëndrojnë në specialitetin e tyre dhe vetëm me urdhërin e ministrit do të lëvizin. Në këtë drejtim ne do të vëmë një disiplinë të fortë.

NJË INXHINIER SOVJETIK¹: Duhet pasur parasysh se gjithë puna e ndërtimit në hidrocentral është bërë vetëm nga punëtorët shqiptarë. Në mes tyre ka njerëz shumë të mirë dhe të vlefshëm. Gjatë punës ne kemi hasur në shumë vështirësi, por asnjë nuk u përkul dhe kjo është një cilësi shumë e çmueshme e njerëzve tuaj. Ata kanë besim në forcat e tyre dhe i kalojnë me këmbëngulje vështirësitë. Unë them se punëtorët tuaj tani mund t'ja fillojnë çfarëdo hidrocentrali elektrik dhe shumë më të madh se ky, pse jeta dhe puna e punëtorëve, e teknikëve dhe e inxhinierëve shqiptarë në Hidrocentralin e Selitës ka qenë një shkollë e madhe.

¹ Në këtë takim merrte pjesë dhe një grup specialistësh sovjetikë.

Pasi pyeti Sali Vatën ku ka mësuar, në ç'shkollë ose në ç'kurs dhe pasi punëtori Sali Vata ju përgjegy se ai kishte filluar të mësojë në hidrocentral, shoku Enver vazhdoi:

Ju, shokë punëtorë, duhet të bëni përpjekje që të mësoni edhe më shumë. Juve që bëtë këto heroizma për të çarë malet dhe për të përvetësuar teknikën, vullneti nuk ju mungon, prandaj duhet t'i përvisheni punës që të përvetësoni dhe diturinë. Natyrisht, kjo punë nuk bëhet as për disa muaj, as për një vit, por duhet të filloni dhe të mësoni vazhdimisht me këmbëngulje.

Delegatët e partive motra që kanë ardhur të ftuar në vendin tonë me rastin e 10-vjetorit të Partisë çuditen si janë transportuar, me mjetet që kemi ne, gjithë këto maqineri të mëdha dhe të rënda. Dhe e vërteta kështu është. Kudo njerëzit tanë kanë treguar heroizma; në ndërgjegjen e tyre është zhvilluar një patriotizëm i ri, që s'është parë asnjëherë në vendin tonë. Ja t'ju them një shembull: shokët na thonë se shoferi Koço Afezollu, që ka treguar heroizma në transportimin e materialeve të këtyre veprave të mëdha, përveç punës së madhe që ka bërë në këtë drejtim, ai ushqen një dashuri shumë të madhe për maqinën e tij, të cilën e përdor jashtëzakonisht mirë, e ruan me shumë kujdes dhe në saje të këtyre përpjekjeve, megjithëse maqinën e ka të vjetër, ai e mban në gjendje të atillë që të punojë në çdo kohë. Por ky punëtor i ndërgjegjshëm ka bërë që edhe familja e tij të jetë e lidhur me maqinën e tij. Ai kur shkon në mbrëmje në shtëpi, i mobilizon të gjithë pjesëtarët e familjes të lajnë dhe të pastrojnë maqinën së bashku me të. Dhe vetëm mbasi bën këtë punë hyn në shtëpi

për t'u shlodhur. Dhe në qoftë se ndonjë fëmijë i afrohet maqinës së tij, ai i flet që të mos e ndotë atë. Ja, pra, një patriot i shquar i ndërtimit të bazave të socializmit në vendin tonë. Si ky ka dhe shumë punëtorë të tjerë të shquar që bënë të mundur ngritjen e kësaj veprë të madhe që po i siguron kryeqytetit dritë dhe ujë.

Ju falenderoj shumë, shokë, edhe për ujin që më sollët sot në këtë shishe me rastin e mbarimit të punimeve.

Ky ujë i parë i Selitës, që shokët punëtorë të hidrocentralit më dërgojnë me «Luanin e tuneleve» minatorin e shquar kuksian, Sal Vatën, nuk është ujë si çdo ujë. Ky ujë përfaqëson zotësinë, vuajtjet, mundimet, djersën, gjakun e shokëve minatorë që dhanë jetën, përfaqëson gëzimin e papërshekrueshëm të triumfit të punëtorëve, të teknikëve dhe të inxhinierëve shqiptarë dhe sovjetikë, që punuan si heronj për t'i dhënë ujin e shëndetshëm e të kulluar si kristal popullit të kryeqytetit. Sa banorë të kryeqytetit lëngonin në të kaluarën nga tifua, sa njerëz vdisnin nga kjo sëmundje! Ky rrezik i madh tani u zhduk në saje të Partisë sonë heroike të Punës që lë kokën për popullin, në saje të heroizmave dhe të dashurisë që ju keni për popullin dhe Partinë tuaj, shokë punëtorë, në saje të ndihmës së Stalinit të madh që e do me gjithë shpirt popullin tonë. Për këtë brez pas brezi, populli i Tiranës do t'ju urojë.

Kështu, pra, ju falenderoj edhe një herë dhe ju uroj nga zemra për këtë punë të madhe që bëtë dhe të jeni gati që të realizoni kështu me sukses edhe veprat e tjera të mëdha që parashikon plani pesëvjeçar dhe që do t'ju ngarkohen t'i kryeni.

Porosive të shokut Enver, punëtori Sali Vata ju përgjegj:

«Jo vetëm që jemi gati të shkojmë atje ku na dërgon Partia, shoku Komandant, por ne jemi gati të japim dhe jetën për Partinë dhe për popullin, se Partia na mori, na dha dorën dhe na bëri njerëz të lirë dhe të zot të punojmë për popullin».

Botuar për herë të parë me shkurtime në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 263 (1957), 3 nëntor 1951

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**PËRSHËNDETJE DËRGUAR NDËRTUESVE TË
HIDROCENTRALIT «LENIN» ME RASTIN
E MBARIMIT TË PUNIMEVE**

3 nëntor 1951

**SHOKËVE TË KOLEKTIVIT PUNONJËS TË NDËRMARRJES
SË NDËRTIMIT TË HIDROCENTRALIT «LENIN»**

Tiranë

I papërshkruar është gëzimi i popullit për mbarimin me sukses të të parit hidrocentral madhështor në vendin tonë. Populli shqiptar dhe veçanërisht ai i Tiranës do t'ju jetë mirënjohës përjetë juve, shokë punëtorë, teknikë dhe inxhinierë që me zotësinë e madhe dhe heroizmat e papërshkruara, realizuat në kohën e duhur këtë vepër të madhe të socializmit, që do të furnizojë me energji elektrike industrinë dhe do të bëjë të ndritë kryeqyteti i atdheut tonë të lirë e sovran.

Në këto ditë historike, kur populli ynë feston i gëzuar 10-vjetorin e Partisë sonë heroike dhe 34-vjetorin e Revolucionit të madh socialist të Tetorit, zemrat e të gjithë shqiptarëve rrahin me mirënjohje të thellë për

Partinë tonë të Punës dhe për Bashkimin Sovjetik e të madhin Stalin që e ndihmojnë popullin tonë në rrugën e paqes, të përparimit dhe të lumturisë.

Ju përgëzoj nxehtësisht për punën vetëmohuese që keni bërë dhe ju uroj suksese të mëtejshme në realizimin e veprave të tjera të tilla edhe më të mëdha që do të ndërtohen në të ardhshmen.

Rroftë Partia jonë heroike e Punës!

Rrofshin miqtë tanë të shtrenjtë Bashkimi Sovjetik dhe Stalini i madh!

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 263 (1957), 3 nëntor 1951

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 263 (1957), 3 nëntor 1951

**NGA BISEDA ME SHOKËT E KOMISIONIT PËR
PËRKTHIMIN E VEPRAVE TË SHOKUT STALIN
DHE ME PËRFAQËSUESIT E PUNONJËSVE
TË SHTYPSHKRONJËS**

4 nëntor 1951

Këto vepra janë një thesar për Partinë tonë dhe në radhë të parë ju detyrohet juve, shokë të komisionit, falenderimi nga ana e Komitetit Qendror dhe gjithë Partisë, pse keni punuar me kujdes të madh. Komunistët duhet të kenë shumë kujdes për veprat e mësuesit tonë të madh shokut Stalin. Puna juaj do t'i shërbejë jashtëzakonisht Partisë pse anëtarët e Partisë do të kenë në duart e tyre këtë vepër të madhe të Stalinit që do ta studjojnë dhe do të edukohen për të zgjidhur problemet e rëndësishme të Partisë që na dalin në ndërtimin e socializmit.

Pastaj falenderimi ju takon edhe juve, shokë të shtypshkronjës, që e mbajtët premtimin që i dhatë Komitetit Qendror dhe e botuat volumin e parë në kohë dhe me paraqitje të mirë.

Duhet bërë përpjekje që librat marksiste të shtypen sa më mirë, të jenë me çmime sa më të ulëta, që të mund t'i blejë çdo komunist dhe sa më shumë punonjës.

Pastaj shoku Enver u interesua mbi vazhdimin e përkthimit të volumeve të tjera. Ai përgëzoi anëtarin e komisionit të përkthimeve nënkolonel Ndreçi Plasarin që ka mësuar mirë gjuhën ruse vetë. Mbasandaj të gjithë të pranishmit pinë nga një dolli duke uruar jetë të gjatë për shokun Stalin.

Duke folur për inteligjencien e re të vendit tonë shoku Enver tha:

Me inteligjencë nuk duhet të kuptojmë vetëm njerëzit që kanë mbaruar shkolla, gjimnaze ose universitete, po dhe gjithë ata njerëz të rinj që po ngrenë këto vepra madhështore në vendin tonë, deri te bujqit përparimtarë. Specialistët sovjetikë më kanë thënë se ju keni njerëz të mrekullueshëm, i kapin shpejt çështjet, më tregonin me entuziazëm për një montator të fabrikës së re të sheqerit, i cili, siç thoshin, po të vejë dhe dy vjet në shkollë bëhet një kuadër i mrekullueshëm. Unë ju siguroj, më thoshte njëri nga specialistët sovjetikë, se përsa i përket montimit, montatorët tuaj që kanë bashkëpunuar me njerëzit tanë tani janë në gjendje të montojnë dhe rafinerinë e naftës. Përsa i përket shfrytëzimit atje duhet më tepër eksperiencë dhe këtu sigurisht duhet të mësojnë dhe do të mësojnë. Shokët sovjetikë theksuan nevojën që kuadrot tanë që po rriten në këto punë të mëdha të futen nëpër shkolla dhe në kurse, bile edhe në kurse të shkurtëra, se me këto kapacitete dhe me këtë zgjuarësi të njerëzve tuaj, populli juaj shpejt do ta ngrejë socializmin. Është një vullkan i madh që zien te ju.

Dhe kështu është me të vërtetë. Në qendrat tona të punës kanë ardhur fshatarë të thjeshtë dhe në një ose dy vjet janë bërë specialistë të mbaruar. Ja tani se si

jemi ne në gjendje të bëjmë edhe libra të tillë të mirë, të bukur.

Pastaj shoku Enver u interesua për punonjësit e shtypshkronjave dhe porositi që të gjithë ata duhet të ndjekin shkollat e natës sidomos ata që punojnë në radhitje.

Ne kemi njerëz me vullnet — *tha shoku Enver* — kemi njerëz që e punojnë maqinën shumë shpejt, po që bëjnë gabime, prandaj ata duhet të bëjnë përpjekje të mësojnë dhe të përmirësojnë kualitetin.

Shoku Enver u foli shokëve edhe për rëndësinë e disiplinës që duhet të vendoset kudo.

Pa rregull dhe organizim e disiplinë nuk mund t'i plotësojmë dot detyrat. Njerëzit tanë bëjnë heroizma, por nga drejtuesit duhet të kërkohet që urdhërat të zbatohen, të mos bëhen lëshime, se po të shtihet disiplina nga lart sigurisht që do të ketë neglizhenca në punë.

Gjithashtu shoku Enver foli edhe për kujdesin që duhet treguar për punonjësit, për t'i shpërblyer ata, dhe ata më të mirët edhe të dekorohen.

Po kjo gjë të mos pritët të bëhet — *tha ai* — me raste festash, po në çdo rast kur një njeri punon mirë.

Më në fund ai i porositi delegatët e punonjësve të shtypshkronjës dhe i ngarkoi që t'u çojnë shokëve të tyre falenderimin për këtë punë të pastër që kanë bërë në nxjerrjen e volumit të parë të veprave të shokut Stalin.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

NGA BISEDA NË TAKIMIN ME DELEGATËT DHE GAZETARËT E HUAJ QË KANË ARDHUR NË VENDIN TONË ME RASTIN E 10-VJETORIT TË PPSH

5 nëntor 1951

Më lejoni, të dashur shokë, t'ju falenderoj nga zemra në emër të Komitetit Qendror të Partisë për ardhjen tuaj me rastin e festës sonë të madhe, 10-vjetorit të Partisë sonë. Falenderoj gjithashtu partitë tuaja, motra, që ju dërguan ju në vendin tonë në këto ditë të mëdha gëzimi për popullin shqiptar. Kjo është një ndihmë shumë e madhe për popullin tonë dhe tregon solidaritetin internacionalist që na lidh ne të gjithëve për një çështje të përbashkët dhe të vetme, siç është ajo e ndërtimit të socializmit dhe e ruajtjes së paqes në botë.

Populli ynë është shumë i vogël dhe si i tillë më tepër se kushdo tjetër ka nevojë të madhe për këtë dashuri të sinqertë që tregojnë për të popujt e demokracive popullore dhe partitë komuniste e punëtore motra. Populli ynë ka qenë vazhdimisht i shtypur nga imperialistët. Atë kurdoherë e kanë përgjakur feudalët, bejlerët dhe kapitalistët dhe për herë të parë në historinë e tij ai u çlirua me të vërtetë më 29 Nëntor 1944 dhe sot ndërton jetën e re.

Të gjitha fitoret që ka korrur deri më sot populli shqiptar dhe ato që do të korrë në të ardhshmen ja detyron Partisë së Punës të Shqipërisë, si dhe Bashkimit Sovjetik. Besoj se patët rastin dhe u takuat me popullin tonë dhe në këto takime ju keni parë sa dashuri të madhe ndjen dhe ushqen ai për Bashkimin Sovjetik, për Partinë Bolshevike dhe për shokun Stalin. Kjo dashuri e singertë është rrënjësor thellë në zemrat e popullit tonë dhe kjo përbën një fitore kryesore të tij dhe të Partisë sonë. Partia jonë është një parti e re. Ajo lindi në luftën që përfaqësonte hovin revolucionar të popullit tonë, mësoi në shkollën e Partisë Bolshevike dhe ecën në mësimet e lavdishme të Stalinit. Me këto Partia jonë ecën përpara.

Por ne, shokë, kemi shumë për të bërë, pse Partia jonë e re është akoma në hapat e saj të parë, sidomos përse i përket forcimit të saj. Ju e dini se vendi ynë ka qenë gjysmëfeudal. Ndër ne nuk kishte proletariat, por një klasë punëtore të vogël, e cila megjithatë ishte e ndërgjegjshme e revolucionare dhe e udhëhoqi luftën e popullit me nder. Klasa punëtore grumbulloi rreth vetes, në një aleancë të shëndoshë, fshatarësinë tonë që është shumë revolucionare, pse tërë jetën e saj ajo ka qenë e shtypur, pa tokë. Çdo gjë fshatarësisë ja kishte rrëmbyer beu dhe agai, prandaj ajo u lidh ngushtë me klasën tonë punëtore të vogël, por të fortë. Por Partia jonë e ka për detyrë që ta forcojë më shumë klasën punëtore dhe në këtë drejtim ne jemi vënë në rrugë të mirë. Me ndihmën e Bashkimit Sovjetik, ne po ngremë industrinë tonë të re të naftës, të bakrit, të kromit etj. dhe nga gjiri i popullit tonë po dalin punëtorë të mrekullue-

shëm, të vendosur, besnikë për Partinë, për popullin. Ata nuk kanë shumë dijeni teknike, nuk kanë shumë zhvillim, po kanë një kapacitet të tillë që përfitojnë dhe mësojnë me etje eksperiencën e madhe, të çmueshme, të shokëve sovjetikë që i ka dërguar në vendin tonë shoku Stalin.

Edhe në bujqësi ne kemi shumë e shumë për të bërë, sepse kjo ka qenë një sektor shumë i prapambetur. Mbasi u bë reforma agrare që u dha tokën fshatarëve, Partia punoi me forcë që ata të përqafonin metodat e reja të punës, të pranonin veglat e reja moderne e frutdhënëse që nuk i njihnin më parë, mbasi nuk punonin veçse me parmenda primitive prej druri, nga të cilat ka akoma sot në vendin tonë. Por me ndihmën e Bashkimit Sovjetik ne i kemi dhënë fshatarësisë mjaft ndihma si vegla bujqësore, kredi, farë etj. Kështu bujqësia jonë ka filluar të ecë në rrugën e përparimit. Këtu ne akoma jemi të dobët, po do të ecim përpara, pse fshatarësia jonë është patriote, përparimtare dhe nën udhëheqjen e Partisë do të shkojë gjithnjë përpara. Jeta në fshat ka bërë përparime të mëdha. Plagë kryesore atje ka qenë analfabetizmi. 90 për qind e popullatës fshatare nuk dinin të shkruanin dhe të lexonin, por me kujdesin që tregoi Partia gati në çdo fshat janë hapur shkolla të ditës dhe të natës, kurse bujqësore etj. Por prapë edhe këto janë pak. Partia jonë duhet të luftojë akoma më shumë për të arritur në rezultate më të mira. Për këtë gjë ajo duhet të bëjë më tepër përpjekje, pse në fshat ajo nuk është sa duhet e fortë. Anëtarët e Partisë të organizatave të fshatit janë shokë të vullnetshëm, luftëtarë, por kanë nivel të ulët arësimor dhe ideologjik.

Prandaj Partia jonë i ka vënë rëndësi të madhe çështjes së ngritjes ideologjike. Është hapur Shkolla njëvjeçare e Partisë, janë hapur shkolla politike, kurse tremujore etj. Është shtypur një literaturë e gjerë marksiste-leniniste me një tirazh të madh dhe Partia vazhdimisht i këshillon shokët të mësojnë gjithnjë më shumë, pse vetëm kështu do të mund të zgjidhin problemet e rëndësishme që u dalin përpara. Vetëm një gjë duket qartë, se, megjithëqë Partia jonë është e re, anëtarët e saj, ashtu sikurse na mëson Lenini, po bëjnë përpjekje të mëdha që t'i plotësojnë boshllëqet teorike. Me një vendosmëri të madhe, Partia jonë i ruan radhët e saja të pastra nga të gjithë deviatorët, trockistët, nga agjentët dhe spiunët e Beogradit nga të cilët Partia jonë ka vuajtur shumë.

Partia jonë ka kaluar momente shumë të vështira, të shkaktuara nga ana e trockistëve të Beogradit. Titistët kanë punuar sistematikisht që në kohën e luftës për të dëmtuar Partinë tonë. Ata janë përpjekur të pengonin zhvillimin e drejtë të Luftës nacional-çlirimtare. Në ç'mënyrë kërkonin ata t'ua arrinin qëllimeve të tyre? Ata nënvleftësonin udhëheqjen e Partisë sonë, duke e kritikuar se gjoja vija politike e saj ka qenë sektare, se ajo nuk kishte hyrë në bisedime me ballistët, zogistët etj. Por Partia jonë punën me Frontin Nacional-Çlirimtar për grumbullimin e të gjithë popullit, e ka bërë në vijë të drejtë, marksiste-leniniste. Më vonë, në prakun e çlirimit të Shqipërisë, trockistët jugosllavë filluan ta godasin Partinë, duke organizuar grupin e tyre agjentural me Koçi Xoxen në krye. Qëllimi i tyre ishte që ta likuidonin Partinë, të gërryenin themelet e saj mark-

siste-leniniste. Trockistët filluan të përdornin pak nga pak metoda policore në Parti dhe ta vinin këtë nën kontrollin e Ministrisë së Punëve të Brendshme që drejtohej nga Koçi Xoxe. Ata futnin frikën në anëtarët e Partisë, ngjallnin dyshime, persekutonin elementët më të mirë të Partisë me format që organizonin Ministria e Punëve të Brendshme dhe jugosllavët. Ata bënë shpifje të poshtra kundër anëtarëve të Partisë dhe me punën e tyre trockiste ua arritën disa qëllimeve: u dobësua demokracia e brendshme e Partisë, që gjatë luftës ka qenë mjaft e fortë, disiplina e hekurt e Partisë sonë filloi të shtuhet, kritika dhe autokritika u dobësuan shumë. Shoku ynë Nako Spiru, vrau veten nën presionin e egër të trockistëve jugosllavë.

Duke përfituar nga marrëdhënjet ekonomike që ekzistonin në atë kohë në mes të popullit tonë dhe popujve jugosllavë, trockistët e Beogradit u përpoqën ta mbysnin Partinë dhe shtetin tonë me mënyrat më të poshtra. Ata kërkonin të hidhnin në duar të gjitha kyçet e ekonomisë së vendit tonë. Aparati shtetëror u mbush me agjentë të trockistëve jugosllavë, gjë që bëri të sabotohen planet tona ekonomike në të gjitha fushat. Nga kjo platformë ata ngritën një sërë çështjesh të kurdisura sikur gjoja rinia jonë po sabotonte rindërtimin ekonomik. Ata i bënë dy-tri herë kritikë të ashpër Komitetit Qendror të Partisë sonë, jo kritikë shoqërore, pse nga trockistët nuk mund të kishte një kritikë të tillë, por një kritikë për të na goditur. Po në atë kohë Partia jonë nuk dyshonte te ata, sidomos te udhëheqja e tyre. Më vonë ajo e rimori veten dhe i pa çështjet më me qartësi dhe studjoi më me kujdes gjërat që po ngjishnin.

Kur puna e tyre armiqësore filloi të zbulohet nga Partia Bolshevike, atëhere ata u shpejtuan dhe nisën sulmet më të egra dhe më të shpeshta kundër Partisë dhe popullit tonë. Udhëheqja jugosllave propozoi se për të shpëtuar gjoja Shqipërinë nga një sulm i monarko-fashistëve, të lejohej ushtria jugosllave për të hyrë në Korçë. Me këtë mënyrë ata donin që në prakun e zbulimit të veprimtarisë së tyre trockiste nga Partia Bolshevike, të kishin ushtri të tyre në Shqipëri për ta mposhtur lehtë Partinë tonë. Kjo çështje kishte një rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare, prandaj ne u konsultuam edhe me shokun Stalin, i cili na këshilloi të mos pranohim futjen e ushtrive jugosllave në Shqipëri. Nga ana e trockistëve jugosllavë ka pasur edhe më pas një sërë provokacionesh të tjera. Ata kërkuan të merrnin nga ana e Komitetit Qendror aprovimin e bashkimit të Shqipërisë me Jugosllavinë. Por edhe këtë Komiteti Qendror nuk e pranoi. Kohët e fundit ata na propozuan të lidhnim së bashku disa «forma të reja» marrëveshesh ekonomike dhe politike si ato të «Beneluksit». Komiteti Qendror ua hodhi poshtë edhe këto me përbuzje. Kjo na u tha në kohën kur ne kishim marrë letrën e parë të Partisë Bolshevike, kur për Partinë tonë ishte fare e qartë tradhëtia e tyre e poshtër. Që në fillim e gjithë Partia jonë e kuptoi situatën e rëndë dhe rrezikun që e kërcënonte nga titizmi. Prandaj ajo luftoi me ashpërsi dhe në këtë luftë ka fituar një eksperiencë jashtëzakonisht të madhe.

Edhe më vonë u shfaqën në Partinë tonë, të tjerë deviatorë dhe oportunistë. Mirëpo Partia tani ishte e armatosur me eksperiencë. Ajo i zbuloi ata dhe i goditi.

Partia jonë ka pasur parasysh vazhdimisht mësimet e shokut Stalin që të hapim sytë ditë dhe natë kundër të gjithë deviatorëve, trockistëve dhe titistëve.

Partia jonë e luftoi me ashpërsi titizmin, bëri Kongresin I të saj dhe gjendja në vendin tonë filloi të ndryshojë.

Ju i shikoni, shokë, përparimet që janë bërë te ne në industri, bujqësi, arësim etj. Këto i detyrohen kthesës së madhe të Partisë që mbas marrjes së letrave të Partisë Komuniste (bolshevike) të BS, Rezolutës së Byrosë Informative dhe punimeve të Kongresit I të Partisë sonë.

Vendin tonë të vogël e duan me gjithë shpirt edhe popujt e demokracive popullore motra. Populli ynë ka pasur vazhdimisht ndihmën e tyre. Partitë komuniste dhe punëtore i kanë pranuar kurdoherë kërkesat e Partisë sonë dhe për këtë ne dhe gjithë populli shqiptar u jemi mirënjohës.

Edhe një herë në emër të Komitetit Qendror ju falenderoj dhe ju lutem që këto falenderime t'ua transmetoni edhe shokëve udhëheqës të partive tuaja dhe dijeni se ardhja juaj në Shqipëri i ka gëzuar të gjithë dhe ka forcuar besimin e Partisë dhe të popullit tonë në miqësinë e solidaritetin internacionalist e në të ardhshmen e tyre të lumtur në rrugën e socializmit.

Ne do të jemi të gëzuar dhe të lumtur që shokët të na bëjnë vërejtje, të na japin mendime, pse ne jemi të rinj, kemi nevojë për ndihmën tuaj që të mund ta përmirësojmë punën dhe të ecim më me siguri përpara.

Shoku Enver, pasi i pyeti delegatët për përshtypjet nga vizitat që kanë bërë në qytetet e tjera, vazhdoi:

Në qytetin e Korçës janë bërë lëvizjet e para të klasës punëtore. Atje ka zhvilluar punën e tij një nga grupet komuniste që ka pasur një vijë të drejtë, megjithëse ka pasur dhe mjaft gabime. Në Korçë ka punuar komunisti, militanti i shquar dhe shok i Dimitrovit — Ali Kelmendi, i cili ka qenë në Bashkimin Sovjetik. Ai punoi në Shqipëri për të përhapur idetë komuniste dhe qeveria e Zogut nuk kishte ç't'i bënte. Kur e fuste në burg ai vazhdonte propagandën, kur e nxirrte dhe e internonte në ndonjë fshat, ai vazhdonte punën me fshatarët. Duke parë se nuk ja dilte dot këtij militanti të vendosur komunist, qeveria e atëhershme e zboi fare nga Shqipëria.

Po edhe në Tiranë ka ndryshuar puna. Më parë këtu nuk ka pasur industri, kurse tani janë hedhur bazat e një industrie dhe kjo do të shtohet mjaft gjatë pesëvjeçarit. Edhe nga ana kulture Tirana ka marrë një zhvillim të mirë. Këtu kemi teatrin tonë nacional dhe institute të tjera kulture. Shokëve që merren me propagandë, Partia u ka dhënë orientimin që në pjesët teatrale dhe letrare të mos lejojnë gabime parimore, nga ana tjetër të kenë kujdes që të mos u presin shkrimtarëve të rinj inisiativën dhe hovin për të shkruar. Ata të nxiten që të shkruajnë, pastaj t'u bëjnë kritika të shëndosha e në bazë të tyre të rregullojnë veprat që do të botojnë dhe këto kritika të vlejné si shembull edhe për shkrimtarët e ardhshëm. Në këtë drejtim ne kemi pasur mjaft suksese. Shkrimtarët dhe poetët tanë, megjithëse janë njerëz të rinj, megjithëse nuk kanë shumë eksperiencë, si luftëtarë që janë, ata kanë mundur të nxjerrin mjaft vepra në shërbim të popullit.

Pastaj e morën fjalën disa nga anëtarët e delegacioneve dhe u bënë përshëndetjet e rastit.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**URDHËR PËR DHËNJEN E DRITËS ELEKTRIKE
QYTETIT TË TIRANËS**

7 Nëntor 1951

**SHOKUT RAHMAN HANKU
DREJTOR I NDËRMARRJES PËR NDËRTIMIN E
HIDROCENTRALIT «LENIN»**

T i r a n ë

Me rastin e festave më të mëdha të popullit tonë 10-vjetorit të themelimit të Partisë sonë heroike të Punës dhe 34-vjetorit të Revolucionit socialist të Tetorit urdhëroj që kryeqytetit të Republikës sonë Popullore, Tiranës, më datën 7 Nëntor, në ora 17,30' t'i jepet drita elektrike nga Hidrocentrali elektrik «Lenin».

Kryeministri

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 267 (1961), 7 nëntor 1951*

*Botohet sipas tekstit të gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 267 (1961),
7 nëntor 1951*

NGA FJALA NË TAKIMIN ME NJË DELEGACION TË PUNËTORËVE TË QYTETIT TË SHKODRËS

7 Nëntor 1951

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë, të Byrosë Politike dhe të qeverisë, ju falenderoj, shokë, që erdhët dhe ju uroj për punën dhe rezultatet e mira që keni arritur, ju shokë punëtorë të qytetit të Shkodrës. Ne jemi të sigurtë se edhe në të ardhshmen punëtorët e Shkodrës do t'i përvishen punës edhe më me zell e kurajë. Ditë të mëdha për popullin, këto që po kalojmë, siç janë 10-vjetori i Partisë sonë dhe 34-vjetori i Revolucionit të madh të Tetorit. Veprat madhështore, që u ngritën dhe u mbaruan në këto ditë feste nga më të shënuarat për popullin tonë, si Hidrocentrali i Selitës «Lenin», Kombinati i tekstileve «Stalin», Ujësjiellësi i kryeqytetit, Fabrika e sheqerit «8 Nëntori», etj. dhe ato që po ndërtohen e do të ngrihen edhe në të ardhshmen, do t'ja ndërrojnë faqen vendit tonë. Të gjitha këto suksese të mëdha u arritën në saje të udhëheqjes së urtë të Partisë si dhe të ndihmës së Bashkimit Sovjetik dhe të madhit Stalin, që tregon veçanërisht një interesim të madh për popullin tonë.

Unë kam pasur fatin të takohem shumë herë me

shokun Stalin dhe më ka këshilluar që Partia jonë të ketë shumë kujdes për klasën tonë punëtore, e cila do të forcohet dita-ditës me zhvillimin e madh që po merr industria në vendin tonë. Shoku Stalin është interesuar se kur mbaron kombinati i tekstilit, fabrika e sheqerit dhe vepra të tjera të mëdha që ngrihen te ne. Shoku Stalin gjithashtu na këshillon t'i vëmë kujdes të madh përgatitjes së kuadrit. Ne do të dërgojmë kuadro në Bashkimin Sovjetik për të mësuar, do të hapim dhe në vendin tonë kurse të ndryshme duke filluar nga më të shkurtërat prej disa muajsh e deri në kurset më të gjata, një dhe dyvjeçare. Ne do të hapim shkolla industriale dhe universitetin në vendin tonë ku të futen dhe të mësojnë punëtorët, pse ata do të jenë pjesa më e rëndësishme e inteligjencies së re që po lind duke ndërtuar socializmin. Inteligjencia nuk përbëhet vetëm nga njerëz që mbarojnë drejtpërdrejt shkolla të mesme dhe universitete, po edhe nga punëtorët që dallohen në ngritjen e veprave madhështore si këto që ngrihen te ne nga zanatçinjtë e bujqit më të mirë, që punojnë dhe përparojnë dhe që vazhdojnë shkollat pa shkëputje nga puna. Edhe ju, megjithëse nuk keni pasë shkollë, duke vazhduar shkollat, do të bëni pjesë në inteligjencien e re të vendit tonë. Prandaj ju duhet të bëni përpjekje që të kryeni studime. Zotësia në ngritjen e këtyre veprave të mëdha ju ka bërë të zhvilloheni dhe të zgjeroni njohuritë tuaja teknike. Ju jeni krenaria e klasës punëtore, e cila dita-ditës po forcohet e po zgjerohet dhe bashkë me të, po forcohet edhe Partia jonë, po forcohet edhe pavarësia dhe liria e popullit po çelënikoset çdo ditë e më shumë. Punëtorët e Shkodrës përbëjnë një forcë të

madhe të Partisë dhe të shtetit tonë. Atje ka një emulacion socialist të madh. Si kudo në Shqipëri edhe në qytetin tuaj, klasa punëtore është themelia e së ardhshmes së vendit tonë.

Armiqtë e vendit tonë dhe feja janë përpjekur vazhdimisht ta lënë popullin tonë në errësirë. Ka disa klerikë që luftojnë akoma në këtë drejtim, po nuk do t'ja dalin dot, sepse në Shkodër ka një klasë punëtore të vendosur, që punon e lufton nën udhëheqjen e Partisë së Punës. Ne luftojmë kundër të gjithë priftërinjve që veprojnë në kundërshtim me interesat e popullit, ndaj këtyre ne jemi të pamëshirshëm. Armiku përpiqet që kishën katolike dhe priftërinjtë reaksionarë t'i bëjë vegla për të luftuar pushtetin tonë. Ata hapin lloj-lloj parullash. Në rast se klerikët kërkojnë t'i vënë gurë në rrota qerres tonë, patjetër nuk do t'i kenë mirë punët me ne. Dhe këtë gjë duhet ta kuptojë mirë kleri katolik i Shkodrës. Në mes të klerikëve ka edhe njerëz të ndershëm, që kanë filluar të kuptojnë se ç'është regjimi ynë popullor dhe ç'janë intrigat e Vatikanit. Këtë do ta kuptojnë edhe të tjerët, po natyrisht, kjo punë nuk mund të bëhet menjëherë. Qëndrimi i Partisë sonë ndaj klerikëve, që shkelin ligjet e shtetit, është dhe do të jetë i prerë; qeveria jonë do t'i godasë ata si qytetarët e tjerë që veprojnë kundër popullit. Të tjerët, që zbatojnë me përpikëri ligjet dhe ecin në rrugën e masave punonjëse, shteti ynë do t'i trajtojë si gjithë qytetarët tanë. Qëndrimi i drejtë i qeverisë sonë do ta bëjë klerin katolik që ta ndreqë pozitën e tij dhe kështu do të ndodhë, pse po të mos lidhesh me popullin, je i humbur. Disa nga klerikët do të bëjnë akoma spiunllëqe në favor të Vati-

kanit ose të imperialistëve, po kjo nuk do të zgjatë shumë. Prandaj për ta ka vetëm një rrugë, që është ajo e popullit.

Partia jonë do t'i kushtojë një rëndësi të madhe klasës punëtore të Shkodrës dhe do ta forcojë edhe më shumë atë. Punëtorët e Shkodrës janë të zgjuar e u zë mjaft dora. Në Shkodër ka pasur dhe ka edhe zanatçinj shumë të mirë. Këtë gjë e ka parasysh Partia. Punëtorët tanë i kanë duart e tyre të arta. Tani ne kemi hapur dhe një ekspozitë të artizanatit, ku janë ekspozuar shumë gjëra të bukura. Në artizanat shkodranët më duket se janë të parët, sepse ata kanë pasur tradita në këtë drejtim.

Fabrika e çimentos atje punon shumë mirë. Edhe Fabrika e cigareve mori flamurin e Ministrisë së Industrisë dhe të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë. Por në industrinë ekzistuese të Shkodrës së shpejti do të hyjë edhe fabrika e re e duhanit. Si Partia ashtu edhe bashkimet profesionale në Shkodër dhe në gjithë Shqipërinë duhet të kenë kujdes që në të gjitha qendrat e punës, po sidomos në fabrikat e duhanit, të marrin masa për ruajtjen e shëndetit të punëtorëve, pse në këto fabrika puna është mjaft e zorshme, nga vetë natyra e punës atje, e cila e dëmton shëndetin e punëtorëve. Prandaj të harxhohen të holla në këtë drejtim, pse pa shëndetin e punëtorëve, nuk ka ç'na duhet duhani. Njerëzit duhet të punojnë në ajër të pastër, të jenë të shëndetshëm, se vetëm kështu do të shtohet rendimenti i punës dhe prodhimi. Këto nuk duan fonde dhe shpenzime të mëdha, veçse pak më tepër kujdes nga ana e drejtorive të ndërmarrjeve dhe e bashkimeve

profesionale. Kështu që në qendrat e punës të ketë ajër të pastër dhe pastërti shembullore.

Pozitat e vendit tonë po forcohen dita-ditës, pavarësia e Shqipërisë është në dorë të sigurtë. Armiqtë e vendit tonë çirren kundër popullit tonë, ata përgatiten për luftë. Po ata le të çirren, atë punë kanë. Kampi ynë është shumë i fortë.

Përsa i përket kampit imperialist qeveritë atje, nga jashtë, duken sikur merren vesh me njëra-tjetrën, po në të vërtetë brenda ato i brejnë kontradiktat. Popujt po zgjohen dhe si në Amerikë, ashtu dhe në vendet e tjera borgjeze e koloniale, po zien një revolucion që i pengon seriozisht qëllimet e imperialistëve për të shpërthyer një luftë të re. Ata nuk duhet të harrojnë se Bashkimin Sovjetik nuk e mundën dot në mbarim të Luftës së parë imperialiste, kur ai ishte i pamëkëmbur akoma mirë dhe jo sot pas Luftës së dytë botërore, nga e cila Bashkimi Sovjetik doli më i fortë dhe krahtij dolën edhe demokraci të reja popullore. Në qoftë se ata do të guxojnë të shpërthejnë një luftë tjetër botërore, kjo do të jetë shkatërrimi i tyre i sigurtë, shkatërrimi i plotë i sistemit imperialist në të gjithë botën.

Gjeografikisht Shqipëria është një vend i rrethuar nga armiq, po ajo nuk është aspak e izoluar politikisht dhe ekonomikisht. Në saje të politikës së drejtë të Partisë, Shqipëria jo vetëm që është njohur në të gjithë botën, por të gjithë popujt e botës ushqejnë një dashuri të patreguar për popullin tonë. Një shkrimtar sovjetik ka thënë se malet e Shqipërisë nuk janë edhe aq të larta, sepse në botë ka male të tjera shumë më të larta, po megjithatë, ato duken nga të katër anët e botës.

Armiku përpiqet me të gjitha forcat të na dëmtojë. Prandaj populli shqiptar duhet të jetë i mobilizuar, të shtërngojë radhët e tija rreth Partisë dhe të forcojë edhe më shumë vigjilencën e tij revolucionare, sepse duhet të kemi gjithnjë parasysh që rrotull nesh ekziston rrethimi kapitalist.

Në kufirin tonë verior ne kemi armiq të egër, të cilët dërgojnë kundër vendit tonë diversantë e përhapin gënjeshtër. Për ne është shumë e qartë se kush është Titua. Ai foli tani hapët në një konferencë¹, ku u la imperialistëve të kuptonin se në rast lufte ata të jenë të sigurtë që do të kenë ndihmën e tij. Titua pranoi që të armatohet me armë amerikane. Kështu Jugosllavia po vihet plotësisht nën kthetrat e amerikanëve. Titistët janë armiq jo vetëm të popullit tonë, po dhe të vetë popullit jugosllav. Ata po bëjnë krime të mëdha kundër shqiptarëve të Kosovës. Që në kohën e luftës ata kanë bërë veprime shfarosjeje kundër kosovarëve. Mijëra shqiptarë i kanë vrrarë dhe mijëra të tjerë i kanë hedhur nëpër burgje dhe kampe internimi. Shqiptarëve u marrin tokat, atyre, ku mundin u mbyllin shkollat shqipe dhe i detyrojnë fëmijët shqiptarë të venë të mësojnë në shkollat turqisht. Por popujt e Jugosllavisë nuk do t'u binden kurrë tradhëtarëve, po do t'i luftojnë. Popujt e Jugosllavisë e duan popullin sovjetik dhe ata kurrë nuk do të luftojnë kundër tij. Ju e dini se në kohën e Luftës së dytë botërore Bullgaria nuk i deklaroi asnjëherë luftë Bashkimit Sovjetik sado që qeveria fashiste

¹ Është fjala për deklaratën në konferencën e shtypit më 31 tetor 1951.

e asaj kohe bënte pjesë në koalicionin hitlerian. Megjithëse në krye të shtetit bullgar ishte një mbret fashist, prapë ai nuk guxoi ta bënte këtë, sepse populli ishte kundër një gjëje të tillë. Kështu do të ndodhë edhe me Jugosllavinë, sepse popujt jugosllavë nuk duan të luftojnë kundër popullit sovjetik. Po edhe sikur qeveria nacionaliste e Beogradit ta bëjë këtë hap, populli jugosllav do t'ja kthejë armët asaj. Popujt e Jugosllavisë kanë tradita revolucionare, ata kanë luftuar kundër fashizmit. Ata tani po e kuptojnë se situata në Jugosllavi është rikthyer edhe një herë si në kohën e regjimit të mbretërve, domethënë që ata kanë rënë nën një shfrytëzim të ri. Këtë gjë populli jugosllav e ka kuptuar dhe tani ka filluar rezistencën. Patjetër atje forcat revolucionare do të çohen e do të organizohen një ditë:

Partia në Shkodër duhet të jetë shumë vigjilente ndaj orvatjeve të titistëve dhe kurdoherë e ashpër kundër atyre dhe agjentëve të tyre. Vazhdimisht Shkodra ka qenë në rrezik nga shovinistët serbomëdhenj. Prandaj të luftohen pa mëshirë të gjithë ata që pengojnë veprën ndërtimtare të Partisë dhe të popullit tonë, të gjithë ata që kërkojnë ta bëjnë Shqipërinë pré të bandave reaksionare.

Ne duhet të luftojmë shumë më tepër për të mirën e popullit, pse vetëm 7 vjet kemi që jemi çliruar dhe megjithëse mund të na duket se janë bërë shumë gjëra, prapë ato janë pak. Prandaj Partia dhe klasa punëtore duhet të punojnë me vetëmohim të madh dhe me sakrifica që t'i japin sa më shumë popullit, pse është një popull heroik, me pikëpamje shumë të qarta politike dhe që e kupton mirë situatën e vendit të vet, që ka

besim të plotë se nën udhëheqjen e Partisë ai po ndërton jetën e tij të lumtur. Ne e dimë se një shtëpi e re nuk mund të bëhet komplet menjëherë, ne nuk mund të krijojmë bollëkun në vendin tonë menjëherë, po ne dimë dhe e kemi të qartë se pas çdo viti do të jemi më mirë.

Sa përparime të mëdha janë bërë në Shqipëri! Le të marrim çështjen e grave tona. Si ishin ato përpara dhe si janë sot! Një zhvillim i madh është bërë në këtë drejtim. Shkollat janë plot me vajza, fabrikat plot me vajza e gra, po kështu edhe në zyrat, ku ato tregojnë energji të mëdha në punë. Po çfarë bëhet në vendet e tjera të botës, p.sh. në Afrikën e Veriut? Një shok nga Algjeria na ka treguar se ç'bëjnë imperialistët francezë atje. Gruaja atje është në injorancë të thellë dhe e mbytur nga një fanatizëm i madh. Të rinjtë algjerianë nuk i lejojnë të ndjekin shkollat arabe. Franca, që në sy të botës tregon sikur u jep popujve liri, nuk i lejon popujt e Afrikës së Veriut të kenë shkolla, nuk lejon të shtypet asnjë gjë në gjuhën e tyre. Edhe ato gjëra të pakta që bëhen, shtypen me zor dhe në fshehtësinë më të madhe. Mizori të papërshkrueshme bëjnë imperialistët në kurrizin e popujve afrikanë e sidomos të atij algjerian. Uria dhe sëmundjet janë përhapur kudo. Nuk ka doktorë dhe spitale. Shokut nga Algjeria, kur pa vajza e gra në fabrikat tona, kur pa në stadium gjithë ato vajza të shëndetshme që merrnin pjesë në ushtrime gjimnastikore, ju mbushën sytë me lot. Ne i thamë që në të kaluarën edhe në vendin tonë femra nuk përfillej, po ato i zgjoi Partia e Punës e Shqipërisë, i zgjoi lufta e çlirimit të atdheut, në të cilën ato morën pjesë

në masë. Ai tha se për të gjitha këto përparime që janë arritur, Shqipëria është një shembull demokracie për gjithë popujt e tjerë të shtypur nga kapitalizmi. Ai na tha se populli algjerian nuk ka dijeni për popullin tonë dhe për sukseset e tij dhe kjo ndodh, sepse imperialistët francezë nuk lejojnë të futet në Algjeri asgjë që flet për Shqipërinë. Mezi kanë gjetur një fotografi nga të vendit tonë që e kanë botuar. Ai na u lut të lejojmë të vijë në Shqipëri një delegacion i grave algjeriane për të parë se si Partia jonë luftoi dhe sot punon për lirinë e popullit, se ç'përparime ka bërë gruaja në vendin tonë. Kolonizatorët francezë bëjnë një propagandë të madhe në Algjeri, Tunizi e gjetkë sikur komunistët janë kundër familjes etj., por popujt nuk i besojnë këto profka.

Fjalët e shokëve delegatë që kanë ardhur me rastin e festave në vendin tonë na inkurajojnë shumë, po nuk na rritet mendja, pse sigurisht po të rritet mendja, bie në hendek. Prandaj duhet të jemi sa më të thjeshtë, ashtu sikurse është populli ynë. Të punojmë pa u lodhur dhe sa më shumë rezultate të kemi, aq më ulët ta mbajmë kokën dhe të përpiqemi të realizojmë dhe të korrin suksese edhe më të mëdha. Të kemi parasysh të mos shkëputemi asnjëherë nga populli, po të rrimë gjithnjë afër tij. Shkëputja nga populli është vdekje për Partinë tonë. Çfarë e bën Partinë tonë të jetë e fortë? Sigurisht populli. Ata njerëz që kërkojnë të mos e përfillin popullin, të mos zbatojnë si duhet ligjet, që janë armë e fortë e popullit, që nuk zbatojnë nenet e Statutit të Republikës sonë Popullore, burokratët e të tjerë si dhe të gjithë ata që nuk duan të mësojnë nga populli, të luftohen ashpër. Populli kupton çdo gjë. Kur

ka vështirësi dhe i thuhet popullit, ai i kupton fare lehtë dhe mobilizohet t'i përballojë ato. Prandaj kur ka vështirësi t'i thuhet drejt popullit. Dhe ja se ç'ka bërë ai. Të gjitha këto që po shohim janë vepra të tija që i ka bërë nën udhëheqjen e Partisë. Po, që të korrin më shumë suksese në të ardhshmen, duhet që edhe ju të mësoni mirë zanatin, pse kështu do të jeni në gjendje të prodhoni edhe më shumë për popullin.

Edhe një herë ju falenderoj nga zemra dhe u çoni gjithë shokëve punëtorë të Shkodrës përshëndetjet më të nxehta të Komitetit Qendror të Partisë dhe të miat. Ju uroj të gjithëve që në çdo vit të arrini suksese edhe më të mëdha në interes të popullit dhe të forcimit të pavarësisë së popullit tonë.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**URDHËR PËR DHËNJEN E UJIT TË SELITËS
QYTETIT TË TIRANËS**

8 Nëntor 1951

**SHOKUT LEFTER LAQRORI
DREJTOR I NDËRMARRJES «URA»**

D u r r ë s

Me rastin e festës më madhështore të popullit tonë, përvjetorit të 10-të të themelimit të Partisë sonë të Punës, urdhëroj që më datën 8 Nëntor në ora 8 të mëngjezit t'i jepet Tiranës uji i Selitës.

Kryeministri

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 268 (962), 8 Nëntor 1951

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 268 (962), 8 Nëntor 1951

FJALIM NË KONFERENCËN SOLEMNE ME RASTIN E 10-VJETORIT TË THEMELIMIT TË PPSH

8 Nëntor 1951

Të dashur shokë dhe miq,

Sot, më 8 Nëntor 1951, populli shqiptar me gëzim të madh feston 10-vjetorin e Partisë së tij të dashur të Punës.

Shumë ditë të shënuara ka në historinë qindrvjeçare të popullit tonë që përkujtojnë luftërat për liri dhe pavarësi. Këto luftëra janë bërë kundër imperialistëve dhe feudoborgjezisë. Gjaku i gjyshërve tanë është derdhur si lumë dhe vuajtjet e popullit kanë qenë të mëdha, por ky s'është trembur kurrë nga forcat e panumërta dhe intrigat e armiqve. Populli ynë ka çarë rrugën e historisë me shpatë në dorë. Vazhdimisht populli ynë ka qenë tradhëtuar dhe shitur nga feudalët dhe borgjezia e vendit, vazhdimisht imperialistët e kanë konsideruar vendin tonë si një plaçkë tregu. Edhe pas shpalljes së pavarësisë më 1912 dhe pas vendosjes së kufive të Shqipërisë më 1913, imperialistët, për të ruajtur sferat e influencës së tyre, vendosën dhe përkrahën në vendin tonë mbretër dhe qeveri antipopullore.

Qeveritë, gjoja shqiptare, të këtyre kohërave, ishin qeveri kukulla, që mbronin interesat e imperialistëve dhe të klasave sunduese, në dëm të pavarësisë së vërtetë dhe të interesave të popullit. Nën këto qeveri feudalësh dhe bejlerësh, nuk u mbrojt pavarësia e Shqipërisë dhe nuk u bë asnjë reformë e vogël ekonomike dhe shoqërore, për të cilat luftoi populli ynë. Kryengritja e fshatarëve të varfër të Shqipërisë së Mesme, që filloi në maj 1914 dhe vazhdoi deri në qershorin e 1915-ës, e udhëhequr nga Haxhi Qamili, fshatar i thjeshtë, u shua në gjak. Kjo kryengritje fshatarësh kishte një karakter të theksuar klase. Fshatarët revolucionarë luftuan për t'u çliruar nga zgjedha e imperialistëve dhe e feudalëve, për t'u rrëmbyer tokat dhe pasuritë bejlerëve, për të shkatërruar pushtetin e kurdisur nga imperialistët dhe feudalët dhe për të vendosur pushtetin e popullit. Një kryengritje e tillë popullore aso kohe përbënte një rrezik të madh për imperialistët dhe bejlerët, prandaj ata, me anë të agjentëve të tyre, u përpoqën t'i jepnin kësaj kryengritjeje fshatare jo vetëm ngjyrën e një lufte fetare dhe gjoja antishqiptare, por edhe e luftuan ashpërsisht me armë. Lufta e «rebelëve» ishte lufta e popullit kryengritës, prandaj ata janë të popullit, janë të Partisë sonë.

Populli shqiptar ka luftuar me ashpërsinë më të madhe kundër intrigave të imperialistëve serbë, grekë, austro-hungarezë, anglezë, amerikanë, italianë, gjermanë e të tjerë. Dy herë me radhë i është dashur popullit shqiptar brenda një çerek shekulli të luftojë dhe të hedhë në det imperialistët italianë. Po këta imperialistë sollën në fuqi feudalën xhelat të popullit shqiptar,

Ahmet Zogun, nën regjimin e të cilit populli ynë vuajti të zezat e ullirit. Po këta imperialistë i lanë dorë të lirë Musolinit të pushtojë Shqipërinë më 1939 dhe ta bëjë atë një fushë lufte dhe urë kalimi për agresion kundër popujve të tjerë fqinjë.

Mirëpo kohërat do të ndryshonin. Historia e hidhur e së kaluarës për popullin shqiptar nuk do të përsëritej më. Ky ndryshim rrënjësor në kursin e historisë së njerëzimit u arrit në sajë të Revolucionit të madh të Tetorit që ne i festojmë 34-vjetorin dhe pjellës së tij të lavdishme, Bashkimit Sovjetik. Partia Bolshevike, Lenini dhe Stalini, u ndritën rrugën popujve dhe i ndihmuan për të shkëputur prangat e robërisë kapitaliste.

Këtë rrugë e ndoqi me besnikëri të madhe populli dhe Partia jonë, pse ishte e vetmja rrugë daljeje nga tirania e përjetshme. Për herë të parë në historinë e tij, populli shqiptar gjeti mikun e tij të madh, besnik, të fortë: shtetin e punëtorëve dhe të kolkozianëve sovjetikë. Një miqësi të tillë populli ynë e ka pasë ëndërruar dhe kërkuar në errësirën e shekujve. Vetëm kur u çua fronti imperialist dhe u krijua shteti i parë socialist në botë, popujt gjetën rrugën e miqësisë dhe të vëllazërimit midis tyre. Këto u farkëtuan nga Lenini dhe Stalini dhe gur themeltar i këtij vëllazërimi midis popujve është atdheu i lavdishëm sovjetik. Revolucionit i madh i Tetorit përcaktoi fatet e Shqipërisë dhe u dukën perspektivat e çlirimit të tij, megjithëse re të zeza ishin grumbulluar në qiellin e Evropës dhe të Azisë dhe veçanërisht në qiellin e atdheut tonë, ku shpërtheu për herë të parë në Evropë rrufeja e fashistëve italianë.

Populli shqiptar e dinte se liria nuk dhurohej, por fitohej me luftë dhe me gjak. Eksperienca qindravjeçare e luftërave të tija, disfatat që ai kishte pësuar, i qenë bërë mësim të vlefshme.

Në prakun e luftërave kundër okupatorëve italo-gjermanë dhe tradhëtarëve, populli shqiptar zgjidhi dy çështje shumë të rëndësishme që ai i konsideron si kondita të domosdoshme për fitore, kondita këto të diktuara nga eksperienca e së kaluarës së hidhur. Çështja e parë ishte formimi i një udhëheqjeje të sigurtë, besnike deri në fund e interesave të popullit dhe kjo ishte Partia Komuniste Shqiptare. Çështja e dytë ishte farkëtimi i një miqësie dhe i një dashurie të madhe për Bashkimin Sovjetik dhe shokun Stalin, si të vetmit përkrahës dhe mbrojtës të vendosur të popullit tonë.

Populli shqiptar nuk do të lejonte më të udhëhiqej nga feudalët dhe borgjezia, por do t'i drejtonte vetë fatet e tij. Prandaj atij i duhej të krijonte, në shembullin e Partisë Bolshevike, udhëheqjen e tij, e cila do të ndërtohej dhe do të udhëhiqej nga mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Këtë vepër të madhe populli ynë e realizoi në 8 Nëntor 1941. Në këtë datë historike, në Tiranë, nën terrorin e egër të fashizmit, u themelua Partia Komuniste heroike e Shqipërisë.

Partia jonë e re dhe trime e mbajti kurdoherë lart dhe të papërkulur flamurin e internacionalizmit proletar, ajo i qëndroi besnike deri në fund marksizëm-leninizmit. Ajo priu popullin nëpërmjet luftërave heroike deri në fitoren e plotë mbi okupatorët dhe tradhëtarët. Partia jonë, e inkurajuar nga fitoret e Ushtrisë së lavdishme Sovjetike dhe e udhëhequr nga mësimet e

Leninit dhe të Stalinit, realizoi pas kaq shekujsh robërie, aspiratat e popullit shqiptar. Vetëm sot Shqipëria dhe populli shqiptar janë të lirë dhe të pavarur me tërë kuptimin e fjalës, se vetëm sot është në fuqi populli dhe drejton fatet e tij. Partia jonë realizoi qëllimet për të cilat luftoi për 25 vjet rresht populli ynë me Skënderbeun në krye, realizoi qëllimet për të cilat luftuan Naim Frashëri, Rrapo Hekali, Selam Musai, Bajram Curri, Avni Rustemi, Ali Kelmendi, Asim Vokshi, heronjtë e popullit Qemal Stafa, Vojo Kushi e qindra e qindra heronj të tjerë.

Le të nderojmë kujtimin e bijve më të mirë të popullit shqiptar, që ranë në luftë për çlirimin e Shqipërisë!

Lavdi heronjve të popullit që ranë në fushën e nderit për çlirimin e popullit dhe të atdheut!

Është pikërisht për këtë arësye që dita e 8 Nëntorit 1941, është data më e shënuar e historisë së popullit shqiptar dhe është për këtë arësye që themelimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë, sot Partia e Punës e Shqipërisë, populli shqiptar e feston me kaq dashuri dhe entuziazëm. Në emër të Komitetit Qendror të Partisë, përshëndes nga zemra popullin heroik shqiptar, komunistët shqiptarë, gjithë patriotët e vendit tonë dhe të tërë së toku të brohorasim:

Lavdi popullit heroik, lavdi udhëheqëses së popullit tonë, Partisë së Punës të Shqipërisë!

Miqësia e popullit tonë me popujt e Bashkimit Sovjetik nuk ishte një gjë e rastit. Ajo ekzistonte që në kohërat e lashta. Në luftërat ruso-turke të shekullit XVIII, kryengritës shqiptarë, që shihnin te populli i

madh rus mikun e tyre, luftuan me trimëri së bashku me marinarët rusë në tokë dhe në det kundër turqve. Që në vitet e para të jetës së shtetit sovjetik populli shqiptar, nga fundi i errësirës, edhe pse imperialistët e ndryshëm i qëndronin atij mbi krye si shpendë të egër, me një pjekuri të rrallë politike e me trimëri njohu¹ ndër të parët shtetin e madh që themeloi Lenini. Kur Lenini mbylli sytë përgjithmonë, parlamenti i 1924-ës nën presionin e deputetëve përparimtarë nderoi kujtimin e këtij gjeniu të madh. Këto akte politike dhe trimërie do t'i kushtonin shtrenjtë popullit tonë, por ai nuk ka pasur kurrë frikë të thoshte të vërtetën dhe të shfaqte botërisht dashurinë që ai ndjente për shtetin sovjetik.

Krijimi i një udhëheqjeje të sigurtë dhe besnike duhej të mbështetej edhe mbi bazën e eksperiencës së ndritur dhe të mësimave të bolshevikëve. Prandaj në Luftën tonë nacional-çlirimtare miqësia me Bashkimin Sovjetik dhe dashuria për Stalinin e madh u çelnikosën dhe u bënë gur themeltar i fitoreve. Armatat e lavdishme sovjetike nën udhëheqjen e shokut Stalin, duke shpartalluar hordhitë naziste, i krijuan kushte popullit shqiptar për të fituar lirinë, pavarësinë, demokracinë, për të cilat kishte luftuar me shekuj. Qeveria sovjetike që e para që njohu qeverinë demokratike të popullit shqiptar të lirë dhe sovran. Popujt sovjetikë dhe shoku Stalin e mbrojnë dhe e ndihmojnë me gjithë zemër popullin tonë, i cili në saje edhe të kësaj përkrahjeje përparon dhe ecën në rrugën e ndritur të socializmit.

¹ Më 1924, qeveria demokratiko-borgjeze e Fan Nolit njohu qeverinë sovjetike.

I. — PARTIA ÇLIROI POPULLIN SHQIPTAR NGA ROBERIA DHE VENDOSI NË SHQIPËRI DEMOKRACINË POPULLORE

Momente shumë të rënda kalonte vendi ynë përpara okupimit dhe pas okupimit të Shqipërisë nga Italia fashiste. Nën regjimin e Zogut populli rronte në feudalizëm ose në gjysmëfeudalizëm. Ky regjim terrori kishte zhdukur çdo liri demokratike, shoqërore, ekonomike dhe politike. Fshatarët ishin në mjerim të madh, toka s'ishte e tyre, ata ishin të mbytur në taksa të rënda. «Reforma agrare» dhe «moratoriumet»¹ e këtij regjimi ishin blofe skandaloze për t'i hedhur hi syve popullit që kërcënonte regjimin. Mbreti Zog i shiti Italisë fashiste gjithë pasuritë e Shqipërisë. Ai e bëri Shqipërinë një koloni italiane, ai përgatiti okupacionin e 1939-s dhe vetë u largua nga Shqipëria. Italianët me okupimin e Shqipërisë kujtuan se e mposhtën popullin tonë të vogël. Një gjë e tillë nuk do të ngjiste kurrë. Populli shqiptar s'do ta pranonte për asnjë moment robërinë dhe ai e priti dhe e përcolli okupatorin me plumba kokës. Gjithashtu Bashkimi i madh Sovjetik nuk e pranoi okupimin e Shqipërisë nga Italia fashiste. Këtë e deklaroi botërisht dhe e mbrojti popullin shqiptar deri në fund. Në këto momente tragjike, kur vendi ynë ishte i okupuar nga Italia, kur Bashkimi Sovjetik u sulmua nga nazizmi gjerman dhe kur fashistët italianë, gjermanë dhe japonezë kishin shpërthyer Luftën e dytë

¹ Shtytje afati.

botërore, populli ynë u tregua me nerva të fortë, i guximshëm, gjakftohët dhe i pjekur politikisht.

Që në ditët e para të okupimit, fashistët italianë kujtuan se do ta shtypnin lehtë rezistencën e popullit tonë. Roma e Musolinit i diktoi ligjin e shfrytëzimit të egër dhe të skllavërimit popullit tonë, gjë që solli edhe pasurimin e kapitalistëve italianë. Politika e fashistëve italianë ishte një politikë shfarosjeje dhe shkombëtarizimi. Ata shpërthyen sulme brutale mbi çdo gjë që ishte shqiptare, mbi traditat dhe zakonet e popullit, ata tentuan për t'i italianizuar shkollat shqipe, ata përdorën çdo formë demagogjie për të gënjyer popullin dhe për ta nënshtruar këtë nën ligjet e tyre. Por fashistët italianë dhe kuislingët nuk patën asnjë sukses, sepse populli shqiptar qëndroi i papërkulur, s'ju bind asnjëherë urdhërave të fashizmit dhe filloi rezistencën e luftën kundër tyre. Ishin momente të mëdha revolucionare, kur ndjenjat patriotike të popullit po shpërthenin me forcë; një zjarr po ndizej në gjirin e punëtorisë sonë, të fshatarësisë, të rinisë, të grave, një zjarr që nuk do të shuhej kurrë, por do të përllante dhe do të shkatërronte okupatorët e tradhëtarët.

Në organizimin e rezistencës së popullit, që filloi që më 7 prill 1939, rolin kryesor udhëheqës e luajtën komunistët shqiptarë, të cilët, megjithëse akoma të paorganizuar në një parti marksiste-leniniste, udhëhoqën rezistencën dhe luftën. Terreni ishte i përshtatshëm, një urrejtje e madhe ndjehej në popull kundër shkelësit të vendit tonë, kundër tradhëtarëve kuislingë dhe të gjithë atyre pseudopatriotëve, që nën lloj-lloj maskash dhe parullash, përpiqeshin të shuanin këtë

urrejtje dhe zemërim të popullit. Komunistët dhe patriotët i peshuan mirë këto momente dhe pa humbur kohë organizuan greva, demonstrata dhe protesta kundër okupatorëve. Kështu ata u njohën si duhet me situatën e krijuar, u futën dhe u lidhën ngushtë me popullin për të kanalizuar dëshirat dhe vullnetin e tij për luftë. Në kaosin e madh që kërkonte të vendoste okupatori për të çorientuar masat, komunistët përgatitën me pjekuri e me këmbëngulje terrenin për një organizim luftarak të popullit që do të shpërthente në aksione të guximshme. Kjo rrugë e drejtë përgatitjeje nga ana e komunistëve konsistonte në hedhje traktesh në të katër anët e Shqipërisë, të cilat sqaruan masat e gjera të popullit mbi momentet e rënda dhe u tregonin këtyre rrugën e shpëtimit. Traktet u shoqëruan me demonstrata madhështore të popullit e të rinisë, me greva në shkolla e në vende pune, me goditje me armë të autokolonave të armikut, me atentate dhe vrasje të spiunëve të fashizmit. Kjo përgatitje e popullit për kryengritje, këto aksione të guximshme dhe të studjuara, rrëzuan qeverinë e parë kuislinge të Vërlacit dhe i vunë përpara pushtesit realitetin e hidhur që e priste. Për ta shuar këtë zjarr, okupatori fashist shpërtheu terror të egër me anën e forcave të tija të okupimit. Ai përdori rezervat e tija: feudalët, bejlerët, bajraktarët, pseudodemokratët dhe pseudopatriotët për të shuar, për të minuar dhe për të neutralizuar lëvizjen e popullit. Por më kot. Aksionet u shumëfishuan nga të katër anët e Shqipërisë dhe lufta e armatosur e popullit, që do t'u kallte tmerrin italianëve dhe më vonë gjermanëve, kishte marrë një hov të madh. Kjo ngjau pse lindi

udhëheqja e re dhe besnike e popullit, Partia Komuniste e Shqipërisë, partia e tipit Lenin-Stalin, e cila mori në dorën e saj të hekurt lëvizjen që grupet komuniste kishin organizuar, mori me guxim, me besim dhe me përgjegjësi të plotë barrën e rëndë historike dhe të lavdishme, të udhëhiqte popullin në fitoren e plotë përfundimtare.

Rruga e përgatitjes së luftës kundër okupatorit ishte rruga e domosdoshme që duhej të ndiqnin komunistët e grupeve për të arritur në ditën historike të 8 Nëntorit 1941. Momenti nacional ishte në favorin e themelimit të Partisë. Regjimi i terrorit të Zogut, që kishte mbytur çdo liri demokratike, nuk kishte lejuar formimin e partive të ndryshme politike, jo vetëm të një partie komuniste, por as formimin e partive borgjeze. Borgjezia nën regjimin e Zogut sapo kishte filluar të ndjehej jo me manifestime politike, por duke hedhur hapat e parë në zhvillimin ekonomik. Pra, kjo ishte e dobët dhe s'arriti kurrë të bëhej një forcë për të detyruar Zogun t'i bënte kësaj koncesione politike. Klasa jonë punëtore për arsye të zhvillimit të dobët të kapitalizmit e të industrisë ishte dhe ajo e vogël. Por nën shtypjen e regjimit të Zogut punëtoria jonë ishte e ndërgjegjshme për rolin e saj avangardë, dhe gjatë këtij regjimi ajo ka manifestuar me forcë kundër shtypjes, për liritë demokratike dhe ekonomike. Pra, punëtoria jonë e vogël ishte revolucionare dhe luftarake. Fshatarësia, gjithashtu, ishte një forcë e madhe revolucionare në vendin tonë. Kjo ishte e gatshme për çdo moment të ngrinte krye kundër regjimit të feudoborgjezisë dhe të shkundte zgjedhën shekullore. Çështja e

çlirimit të vendit dhe çështja e tokës do të përbënin për fshatarësinë tonë dy probleme jetike, të cilat ajo ishte e bindur se vetëm me armë do t'i zgjidhte. Nga eksperiencia e historisë së saj të kaluar fshatarësia dhe i gjithë populli shqiptar kishte nxjerrë konkluzione të rëndësishme që ishin: përpara armikut të huaj dhe bashkëpunëtorëve të tij tradhëtarëve të vendit, duhej që populli të forconte unitetin, të krijonte aleancën e shëndoshë në mes të punëtorëve dhe fshatarëve, nën udhëheqjen e klasës punëtore dhe të krijohej udhëheqja e vërtetë e popullit e dalë nga gjiri i tij i përvuajtur. Okupacioni fashist italian dhe rreziku i madh i shfarosjes së popullit tonë i kristalizoi edhe më tepër këto ndjenja përparimtare dhe revolucionare të popullit tonë. Këta ishin faktorë të rëndësishëm për themelimin e Partisë sonë Komuniste. Gjithashtu mungesa e partive borgjeze dhe e një borgjezie të fortë dhe të organizuar në vendin tonë, ishte prapë një faktor në favorin e themelimit të Partisë sonë.

Që në kohën e regjimit të Zogut, me gjithë lëvizjet përparimtare të udhëhequra nga komunistë, nuk qe e mundur të formohej një front popullor antifashist simbas direktivave të Kominternit që paralajmëronin rrezikun e madh të fashizmit dhe të luftës. Kjo ngjau për dy arsye: E para se terrori ishte i madh dhe e dyta, pse komunistët shqiptarë, që militonin në grupet komuniste, nuk ishin të organizuar si duhej dhe të lidhur me masat e popullit. Në grupet komuniste, para formimit të Partisë, ekzistonin mosmarrëveshje e grindje parimore dhe forma organizative shumë sektare, gjë që i kishte hedhur grupet në luftë joparimore në mes të njëri-

-tjetrit dhe i kishte larguar komunistët nga populli dhe nga aksionet e gjera masive. Në këto grupe komuniste ishin infiltruar armiq të klasës punëtore, trockistë provokatorë, të cilët për të frenuar krijimin e frontit popullor antifashist dhe më vonë për të sabotuar formimin e Partisë Komuniste, zhvillonin një aktivitet të madh përçarës politik, teorik dhe organizativ. Për fat të keq shumë nga këta trockistë provokatorë ishin në udhëheqje të grupeve dhe me çdo mjet luftonin për dezorientimin e komunistëve të bazës. Me okupimin e Shqipërisë dhe me fillimin e organizimit të rezistencës, këta trockistë u aktivizuan edhe më shumë për të penguar luftën e popullit shqiptar. Megjithëse të okupuar nga Italia dhe kur momenti e kërkonte të luftohej okupatori me armë, këta propagandonin në masë me parullat: «S'ka ardhur koha të luftojmë». Duke përdorur parulla mënçjerashe si: «meqë nuk ekziston proletariati te ne, duhet të presim sa të zhvillohet kapitalizmi», këta trockistë bënë lojën e okupatorit dhe të borgjezisë duke frenuar në këtë mënyrë mobilizimin e popullit për luftë dhe njëkohësisht shtrembëronin e nënvleftësonin parimet marksiste-leniniste të luftës së çlirimit dhe të revolucionit. Por në pamundësi ta frenonin këtë luftë të klasës punëtore dhe të popullit, ata zhvilluan teorinë e «mosrrezikimit të kuadrove» dhe predikuan më vonë të shkonin në luftë «vetëm me proletariatin», duke pretenduar se «fshatarësia s'mund të jetë aleatja dhe rezerva e proletariatit». Këta trockistë, në vend që ta vlerësonin fshatarësinë e shtypur nga feudalët dhe bejlerët si rezervën e madhe revolucionare, e konsideronin atë si një element reaksionar, duke goditur kështu rëndë

parimin themelor marksist-leninist të aleancës së proletariatit me fshatarësinë që është një faktor kryesor për fitoren e revolucionit proletar. Por megjithkëtë sabotim, këta trockistë provokatorë s'mundën dot të gënjenin pjesën e madhe të shëndoshë të komunistëve të grupeve. Komunistët internacionalistë shqiptarë, megjithëse u mungonte ngritja teorike, e shihnin të domosdoshme dhe jetike themelimin e partisë së tyre. Ata kishin të qartë rolin e Bashkimit Sovjetik dhe ishin të bindur se shpëtimi i popullit tonë do të vinte nga lufta që do të bënte vetë populli, i udhëhequr nga një parti marksiste-leniniste dhe nga përkrahja e Bashkimit Sovjetik. Organizimi i rezistencës, aksionet e guximshme kundër okupatorit dhe sulmi tradhëtar i hitlerianëve kundër Bashkimit Sovjetik, do të krijonin të gjitha konditat për themelimin e Partisë, për mposhtjen e trockistëve dhe për kapërcimin e të gjitha vështirësive. Dëshira e zjarrtë e komunistëve të grupeve në bazë ishte bashkimi në një parti të vetme marksiste-leniniste. Për këtë gjë, me gjithë pengesat e mëdha që hasën në rrugë nga okupatori dhe nga krerët trockistë provokatorë, komunistët e shëndoshë të grupeve dërguan përfaqësuesit e tyre në Konferencën e parë të grupeve. Në këtë konferencë përfaqësuesit e grupeve të ndryshme komuniste bënë një analizë të hollësishme të situatës dhe të detyrave që u impononte historia klasës punëtore dhe komunistëve. Ata u bënë një kritikë dhe autokritikë të rreptë bolshevike gabimeve të tyre, pikëpamjeve të gabuara dhe antimarksiste, që ishin shfaqur deri atëhere në punën e tyre. Për shumë ditë rresht komunistët e shëndoshë sulmuan me rreptësi trockistët Anastas Lula e

Sadik Premte, që mbronin me këmbëngulje teoritë trockiste-menshevike-likuidatore, që mbronin tezën e okupatorit dhe të kuislingëve, që përfaqësonin çka ishte e huaj dhe armiqësore për proletariatin dhe për partinë komuniste. Tezat e Anastas Lulës, të Sadik Premtes, të Zef Malës, të Aristidh Qendros, të Andrea Zisit dhe të provokatorëve të tjerë u shqelmuar në Mbledhjen historike të 8—14 Nëntorit dhe triumfoi teza marksiste-leniniste. Më 8 Nëntor 1941 u muar vendimi historik për shkrirjen e grupeve dhe për themelimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë. Në këtë mbledhje u zgjodh Komiteti Qendror i Përkohshëm, të cilit ju ngarkua barra historike të unifikonte grupet, të skartonte elementët antimarksistë, të organizonte Partinë dhe të përcaktonte programin e saj.

Partia u themelua mbi parimet marksiste-leniniste-staliniane dhe organizimi i saj u bazua në eksperiencën e Partisë Bolshevike, e cila e ndriçoi në çdo hap Partinë tonë të re. U vendos që në fillim parimi i centralizmit demokratik, u krijuan celulat dhe komitetet, u vendos dhe u zhvillua kritika dhe autokritika bolshevike, u vendos disiplina e hekurt dhe e ndërgjegjshme, u vendos konspiracioni bolshevik dhe i rreptë, ashtu si e kërkonin momentet. Komunistët shqiptarë i mbrojtën këto parime me një energji të madhe, ata plotësuan boshllëqet e mëdha teorike të tyre, ata e mbrojtën Partinë si gjënë më të shtrenjtë dhe s'vunë asgjë mbi interesat e Partisë. Partia i mbajti radhët e saja të pastra. Lufta në dy frontet kundër okupatorit dhe trockistëve vazhdoi e pamëshirshme. Trockistët Anastas Lula, Sadik Premte e shokët e tyre nuk i hodhën armët, por luftuan me sa mundën

të pengonin zhvillimin e Partisë në rrugën e saj të drejtë, organizimin e Partisë dhe vijën politike të qartë të saj. Partia i goditi këta pa mëshirë dhe Konferenca e Jashtzakonshme, që u mbajt në Tiranë më datën 28 e 29 qershor 1942, i nxori jashtë nga Partia këta armiq dhe më vonë në prill-maj 1943, likuidoi dhe tentativën e tyre të armatosur kundër Partisë.

Konferenca e parë e Vendit, e mbajtur në Labinot më 17—22 mars 1943, është një datë nga më të rëndësishmet të Partisë sonë. Në prakun e Konferencës së parë të Vendit, Partia jonë përbëhej prej 700 vetësh. Nga kjo konferencë doli Komiteti Qendror Definitiv. Në këtë konferencë u aprovua lufta e ashpër dhe e drejtë e Komitetit Qendror Provizor kundër fraksionistëve dhe u caktua rruga e Partisë që duhej të ndiqej në të ardhshmen. Orientimi i Konferencës së parë të Vendit të Partisë ka qenë: Të zgjeroheshin lidhjet me masat e popullit dhe të ashpërsohej lufta kundër okupatorit, të organizoheshin dhe të shumëfishoheshin këshillat nacional-çlirimtare, të cilat të bëheshin organet e vërteta të pushtetit demokratik popullor dhe të shkatërrohej plotësisht pushteti i vjetër, të popullarizohej dhe të ngjallej dashuria e madhe në popullin tonë për Bashkimin Sovjetik dhe për Ushtrinë e Kuqe lavdiplote. Rezolucioni i Konferencës së parë të Vendit mbyllet me këto fjalë:

«Megjithëse para Partisë sonë të re paraqiten detyra të shumta dhe të rënda ajo do të shkojë me krenari drejt fitimit definitiv nën flamurin e I.K., të Leninit dhe të Stalinit dhe do të plotësojë detyrën karshi masave punonjëse dhe karshi popullit tonë.

Duhet të jemi të pamëshirshëm dhe në radhët e para të luftës kundër armikut të betuar të njerëzimit dhe të popullit tonë, kundër fashizmit.

Duhet të krijojmë dhe të spastrojmë Partinë si na ka mësuar i madhi Lenin, si na ka mësuar i madhi Stalin, duke krijuar Partinë më revolucionare dhe të marrim vend të merituar në radhët e lavdishme të I.K.»¹

Komunistët i zbatuan me nder këto detyra, ata kurrë s'ju shmangën këtyre direktivave dhe s'e përlyen emrin e Partisë, por edhe me litar në grykë, përpara torturave dhe plumbave të armikut thërritnin: «Rroftë Partia, rroftë populli, rroftë Stalini!».

Vija politike e Partisë ka qenë e drejtë dhe e qartë. Programi i saj ishte:

1) Luftë e paprerë dhe pa kompromis kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve. Për këtë gjë duhej grumbulluar dhe organizuar populli për kryengritje të përgjithshme. Duhej krijuar ushtria heroike e popullit, e cila të luftonte për çlirimin e plotë të Shqipërisë.

2) Marrja e pushtetit në duart e popullit. Shkatërrimi nga themeljtë i pushtetit të borgjezisë e të okupatorit dhe ngritja e pushtetit të ri të këshillave nacional-çlirimtare.

3) Vendosja në vendin tonë e demokracisë popullore.

4) Pas çlirimit të Shqipërisë të zbatoheshin reforma të mëdha shoqërore dhe ekonomike për popullin dhe populli të thërritej në zgjedhje të përgjithshme për Asamblenë Kushtetuese, e cila të vendoste formën e regjimit.

¹ «Dokumenta Kryesore të PPSH» Vëll. I, f. 119.

Ky program i qartë i Partisë ngriti peshë popullin shqiptar dhe trenditi okupatorët e tradhëtarët. Këtë program të saj Partia jonë e zbatoi me përpikëri dhe në rrugën më revolucionare. Për vite me radhë populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë, luftoi pa mëshirë okupatorët dhe kuislingët për t'i kryer me nder këto detyra jetike për popullin.

1. — Lidhja e shëndoshë e Partisë me masat dhe organizimi i popullit në luftë kundër zaptuesve, ishte një nga detyrat kryesore të Partisë. Qëllimi i shenjtë ishte të futeshin në lëvizje energjitë revolucionare të popullit, të krijohej një unitet i shëndoshë dhe të kalitej një patriotizëm i madh në masat e gjera të popullit. Partia dinte se Lufta nacional-çlirimtare do të dështonte në rast se ajo mbetej një luftë kuadrosh të Partisë. Partia Komuniste, pararoja e klasës punëtore, duhej të organizonte në një front të gjerë nacional-çlirimtar, të gjitha forcat luftëtare antifashiste. Në këtë front duhej të merrnin pjesë të gjithë patriotët pa dallim shtrese, feje, origjine, klase që kishin pikëpamje politike të ndryshme, por që në radhë të parë pranonin luftën kundër okupatorit dhe tradhëtarëve nën drejtimin e Partisë. Me këtë program të qartë, Partia sqaronte njerëzit e ndershëm se interesat e atdheut e kërkonin që më parë të luftoheshin dhe të mposhteshin armiqtë kryesorë, fashizmi dhe tradhëtarët, që shtypnin punëtorët, fshatarët, inteligjencien patriote, tregëtarët e vegjël e zanatçinjtë dhe gjithë shtresat e varfëra të qytetit dhe të fshatit. Këtë vijë të qartë dhe të drejtë Partia e konkretizoi në Konferencën e Pezës. Klasa punëtore që në ditët e para të luftës u hodh me ven-

dosmëri në luftë dhe kuptoi rolin historik drejtues të saj, ajo kuptoi se Partia Komuniste e Shqipërisë ishte detashmenti pararojë i organizuar i saj. Fshatarësia e varfër dhe e mesme përqafoi gjithashtu politikën e drejtë të Partisë për luftë dhe kuptoi se Lufta nacional-çlirimtare, që e udhëhiqte Partia Komuniste, ishte lufta e klasës punëtore në aleancë të ngushtë me fshatarësinë për çlirimin dhe për demokracinë. Kjo luftë nuk pajtohej me interesat e klasave sunduese. Prandaj qëllimet dhe tradhëtia e klasave sunduese gjatë Luftës nacional-çlirimtare u përcaktuan nga konditat dhe pozitat sociale të tyre. Feudoborgjezia, për të ruajtur privilegjet që rrezikoheshin nga hovi i luftës revolucionare të popullit, u bashkua dhe u shit te okupatori. Borgjezia e pasur fshatare, u bashkua edhe ajo me organizatat tradhëtare të «Ballit Kombëtar» dhe të «Legalitetit». Një hendek i madh po hapej dhe lufta do të bëhej gjithmonë më e ashpër gjatë revolucionit popullor. Partia Komuniste forcoi besimin e fshatarësisë së varfër dhe të mesme se vetëm duke luftuar nën udhëheqjen e klasës punëtore, ajo do të realizonte aspiratat e saja. Vija e Partisë që u përcaktua në Konferencën e Pezës dhe krijimi i Frontit Nacional-Çlirimtar, ishte një fitore e madhe e politikës tej pamëse të Partisë. Masat e gjera të punonjësve të qytetit dhe të fshatit e pritën me entuziazëm krijimin e Frontit Nacional-Çlirimtar dhe, nën udhëheqjen e Partisë, organizata e Frontit grumbulloi dhe organizoi popullin në aksione e në luftë politike. Politika e drejtë e Partisë demaskoi parullat dhe punën armiqësore të organizatave tradhëtare të «Ballit Kombëtar» dhe të «Legalitetit», që mundoheshin

ta bënin fshatarësinë dhe shtresat mikroborgjeze të qytetit rezervën e tyre. Në Front, nën udhëheqjen e Partisë dhe nëpërmjet luftërave, u kalit patriotizmi i vërtetë i popullit tonë, u kalit dashuria dhe besnikëria ndaj atdheut, ndaj Bashkimit Sovjetik dhe shokut Stalin. Masat e gjera të popullit panë qartë qëllimet e poshtra të imperialistëve dhe të feudoborgjezisë. Masat e popullit u edukuan politikisht dhe shtërnguan radhët rreth Partisë Komuniste dhe panë te ajo udhëheqjen e vërtetë të tyre.

2. — Për krijimin e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, Partia ndoqi me besnikëri mësimet e Leninit e të Stalinit dhe u mbështet vazhdimisht në mësimet e klasikëve të marksizmit. Ushtria Nacional-Çlirimtare do të përbëhej dhe do të drejtohej nga punëtorë, nga fshatarë dhe nga elementë përparimtarë të shtresave të varfëra. Ushtria jonë Nacional-Çlirimtare në formimin e saj do të ndjekë rrugën e njësiteve guerrile e të çetave partizane dhe më në fund do të marrë formën e një ushtrie të madhe dhe të rregullt. Baza e ushtrisë sonë popullore ka qenë populli, i cili e ka dashur, e ka mbrojtur, e ka ushqyer si pjellën e tij më të shtrenjtë. Ushtria jonë Nacional-Çlirimtare në luftimet e saj të përgjakshme kundër okupatorëve, kuislingëve dhe bandave tradhëtare të «Ballit Kombëtar» dhe të «Legalitetit» do të ndjekë rrugën dhe mësimet e bolshevikëve dhe të Ushtrisë së Kuqe famëmadhe. Ushtria jonë Nacional-Çlirimtare do t'i lidhë vazhdimisht luftimet e saj me betejat legjendare të Ushtrisë Sovjetike. Furnizimi i ushtrisë sonë me ushqime dhe veshmbathje do të bëhej nga populli, i cili ka shkëputur kafshatën e gojës së tij dhe ua ka dhënë

partizanëve. Përsa i përket armatimit, Ushtria jonë Nacional-Çlirimtare atë do ta siguronte me armët dhe me municionet që do t'u mernte ushtrive të okupatorëve. Këto kanë qenë burimet e armatosjes së ushtrisë sonë. Kjo ka qenë vija politike e organizative dhe taktika luftarake e Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare. Një ndërtime i tillë dhe një vijë e tillë e luftës e bëri ushtrinë tonë të çelniktë dhe të pamposhtur. Kjo bëri që ushtria jonë të thyejë njërën pas tjetrës ofensivat e okupatorëve dhe të kuislingëve, të shpartallojë çetat mercenare të ballistëve dhe të zogistëve në shërbim të okupatorit, të çlirojë zona të tëra dhe më në fund gjithë Shqipërinë.

Një nga ditët më të shënuara të ushtrisë sonë është formimi i Shtabit të Përgjithshëm më 10 Korrik 1943. Në këtë datë filloi një etapë e re e luftës për çlirimin e vendit; kryengritja e përgjithshme e popullit kishte filluar. Në këtë rrugë të lavdishme Partia dhe Ushtria Nacional-Çlirimtare u udhëhoqën nga shkenca marksiste-leniniste mbi kryengritjen e armatosur, e cila na mëson se menjëherë, me të filluar kryengritja, duhet vepruar me vendosmërinë më të madhe, duhet kaluar patjetër medoemos në ofensivë, dhe se mbrojtja është vdekje për kryengritjen e armatosur.

Zbatimi i përpiktë i këtij parimi themeltar të marksizëm-leninizmit mbi kryengritjen e armatosur i dha fitoren Partisë sonë. Shtabi i Përgjithshëm i mësoi raportet e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare të godasin armikun pa pushim dhe në befasi dhe ta përdorin befasinë dhe shpirtin sulmues si një taktikë të rëndësishme në luftë kundër armikut. Në këtë mënyrë dhe në çdo

rrethanë, duke u bazuar në artin marksist-leninist të kryengritjes dhe të luftës së armatosur të popullit, Partia dhe Shtabi i Përgjithshëm e orientuan drejt ushtrinë tonë në pikëpamje politike dhe ushtarake.

Partia dhe Ushtria Nacional-Çlirimtare kanë hasur shumë pengesa në rrugën e tyre të lavdishme. Përveç luftës të përditshme kundër ushtrisë së okupatorit dhe bandave të armatosura të kuislingëve, të «Ballit Kombëtar» dhe të Bazit të Canes, Partia dhe ushtria duhej të vigjilonin dhe të luftonin kundër sabotazhit dhe intrigave të anglo-amerikanëve. Misionet angleze në Shqipëri, gjatë kohës së luftës, zhvilluan një aktivitet të madh djallëzor kundër Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare. Ata tentuan të merrnin në dorë drejtimin e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare për ta likuiduar atë; ata spiunuan te okupatorët dhe te kuislingët aktivitetin dhe veprimtarinë e ushtrisë sonë, për të krijuar konfuzion dhe demoralizim në radhët e partizanëve; ata tentuan të sabotonin krijimin e Shtabit të Përgjithshëm dhe të njësiteve të mëdha të ushtrisë sonë; ata, tok me gjermanët e me kuislingët, organizuan ofensivën e madhe të dimrit të vitit 1944, tentuan të pengonin ofensivën e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare kundër zogistëve dhe kuislingo-gjermanëve dhe tentuan të futnin në kurth me qëllim shfarosjeje repartet tona që luftonin heroikisht për çlirimin e Tiranës. Por të gjitha këto u dështuan njëra pas tjetrës, pse Partia dhe ushtria ishin vigjilente dhe të vendosura deri në fund për t'u prerë rrugën tentativave të okupatorëve fashistë, të reaksionit dhe të imperialistëve anglo-amerikanë. Ushtria jonë e kreu me nder detyrën e saj, e çliroi Shqipërinë dhe ajo,

duke u kalitur në luftëra dhe duke u edukuar me mësimet e Stalinit, është bërë sot mburoja e çelniktë e lirisë, e pavarësisë dhe e fitoreve të popullit tonë.

3. — Marrja e pushtetit në duart e popullit, shkatërrimi nga themeli i pushtetit të borgjezisë dhe ngritja e pushtetit të ri të këshillave popullore, ishte një nga detyrat më të rëndësishme të Partisë sonë. Çështja e pushtetit në vendin tonë u zgjidh në rrugën e vërtetë marksiste-leniniste. Pushteti në vendin tonë nuk u themelua me forma paqësore, po me metodat nga më revolucionaret. Pushteti i këshillave popullore u ngrit në vendin tonë që në kohën e luftës dhe me luftë. Ky pushtet nuk ishte një shartim ose një kombinim me pushtetin e vjetër të borgjezisë, por një pushtet i ri, i ndërtuar në shembullin e Sovjetëve. Pushteti i borgjezisë u shkatërrua nga themelitet, nga lufta e popullit shqiptar. Direktiva e Partisë që në fillimin e ofensivës së çetave partizane para vitit 1942 ka qenë: Të çlirohen zona, të shkatërrohen të gjitha institucionet dhe administrata e ngritur nga okupatori dhe kuislingët, të shkatërrohen postat e xhandarmërisë e komunet dhe të ngrihen këshillat nacional-çlirimtare. Kështu u veprua. Zonat e çliuruara zgjodhën këshillat e tyre nacional-çlirimtare. Ishte e qartë për Partinë tonë që në fillim, se lufta kundër okupatorit ishte njëkohësisht lufta kundër feudoborgjezisë dhe pushtetit të saj burokratik e shtypës. Në fakt e gjithë administrata e vjetër zogiste dhe format e reja të pushtetit të vendosur nga okupatori fashist, u vunë nën shërbimin direkt të okupatorit dhe në luftë të egër kundër popullit dhe Partisë së tij. Me proporcionet që merrte Lufta jonë nacional-

-çlirimtare, Partia parashikoi se çështja e pushtetit duhej zgjidhur dhe duhej bërë një nga problemet më kryesore të popullit, i cili duhej të luftonte dhe me luftë ta ngrinte pushtetin e tij. Për këtë çështje Partia organizoi Konferencën e Pezës më 16 shtator 1942. Në Pezë u përcaktua drejt çështja e pushtetit popullor. Në Rezolucionin e Konferencës së Pezës përcaktohet krijimi i këshillave në të gjitha krahinat si dhe kompetencat e këshillave nacional-çlirimtare, për të cilat në mes të tjerave thuhet:

«Në tokat e çliruara. Këshillat nacional-çlirimtare bëjnë detyrën qeveritare... , vënë rregull dhe qetësinë, bëjnë luftë kundër tradhëtarëve... , kujdesohen për ekonominë dhe ushqimin e popullit; organizojnë tregëtinë dhe financat;... zhvillojnë arësimin dhe punën e edukatës popullore... Rëndësia e këshillave nacional-çlirimtare është e madhe. Me anë të këtyre bëhet qeveria...»¹

Siç shihet, që në fillim Partia e kishte të qartë çështjen e pushtetit popullor dhe luftoi me ashpërsinë më të madhe për ngritjen e tij në zona të çliruara dhe të okupuara. Pra, ekzistonin dy pushtete. Njëri pushteti i popullit, i ri, i krijuar që nga themelitet nga Partia, dhe tjetri pushteti i vjetër i borgjezisë dhe i okupatorit. Të dy këto pushtete ishin në luftë të ashpër dhe pushteti popullor do të triumfonte. Pas Konferencës së Pezës, ngritja e këshillave nacional-çlirimtare mori një hov të jashtëzakonshëm. Në të gjitha zonat e çliruara s'kishte përveçse këshilla nacional-çlirimtare, të udhëhequra nga Partia. Në to kishte fshatarë, punëtorë dhe partizanë,

¹ «Dokumenta të organeve të larta të pushtetit revolucionar nacional-çlirimtar (1942—1944)», f. 13, Tiranë 1962.

të zgjedhur demokratikisht nga mbledhje të gjera popullore. Në qytete, ku ishin struktur okupatorët dhe kuislingët, ishin krijuar gjithashtu këshillat nacional-çlirimtare, të cilat vepronin në bazë të udhëzimeve të Partisë dhe të Frontit Nacional-Çlirimtar, luftonin pushtetin e okupatorëve. Forcimi i pushtetit tonë popullor u bë nëpërmjet luftërash, ai u perfeksionua dhe u zgjerua, duke kaluar në disa etapa.

Etapat kryesore për forcimin e pushtetit pas Konferencës së Pezës kanë qenë:

Kongresi historik i Përmetit, që u mbajt më 24 Maj 1944. Këtu delegatët e popullit, të zgjedhur demokratikisht nga të gjitha anët e Shqipërisë, nën terrorin e egër të okupatorëve dhe të kuislingëve ballistë, konsakruan me ligje veprën e pavdekshme të popullit e të Partisë, demokracinë popullore. Kongresi i Përmetit i dha Shqipërisë Këshillin Antifashist Nacional-Çlirimtar, organi më i lartë legjislativ dhe ekzekutiv njëkohësisht, një formë krejtësisht e re e demokracisë sonë popullore, ku të dy organet janë të bashkuara, dalin prej popullit dhe i përkasin popullit. Këto ishin bazat e një forme të re qeverimi, shumë të përparuar, ku do të mbështetej regjimi i ri i popullit, regjimi i demokracisë popullore dhe që më vonë do të konsakrohej nga Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë. Kongresi i Përmetit gjithashtu zgjodhi Komitetin Antifashist Nacional-Çlirimtar, organ ekzekutiv kryesor me atributet e një qeverie provizore.

Më vonë Mbledhja e dytë e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar të Shqipërisë në Berat më 20 tetor 1944 shndërroi Komitetin Antifashist në Qeveri Demokratike të Shqipërisë.

Asambleja Kushtetuese, që u zgjodh demokratikisht nga populli i lirë dhe sovran, më 11 Janar 1946 shpalli Republikën Demokratike Popullore, datë nga më të shënuarat e historisë së popullit tonë. Nga këto etapa ka kaluar formimi i pushtetit tonë popullor dhe këto nuk u arritën në rrugë paqësore, por me luftë të ashpër pa kompromis kundër okupatorëve, kuislingëve, ballistëve, zogistëve dhe anglo-amerikanëve. Partia jonë nuk ka lejuar kurrë të ndahej pushteti me borgjezinë. Ajo ka luftuar me ashpërsi kompromisin dhe tradhëtinë në çdo drejtim të luftës. Konferencën e Pezës, ku u hodhën bazat e pushtetit tonë popullor, e sulmuan okupatorët dhe tradhëtarët me armë dhe me demagogji, për arsye se krijimi i pushtetit popullor nën udhëheqjen e Partisë Komuniste formonte për ta një rrezik të madh. «Balli Kombëtar» u krijua nga okupatorët fashistë si reaksion i tërbuar kundër Partisë dhe Frontit Nacional-Çlirimtar, që u themelua në Pezë. «Balli Kombëtar» s'ishte një parti politike, por ishte një agjunkturë e okupatorëve fashistë. Atje ishte grumbulluar reaksioni i brendshëm, i cili, duke zbatuar direktivat e fashistëve italianë dhe me qëllim që të neutralizonte dhe të shkatërronte veprën e madhe të Partisë, Luftën nacional-çlirimtare, zhvilloi një demagogji të madhe kundër Partisë dhe vendimeve historike të Pezës. Qëllimi i «Ballit Kombëtar» ka qenë të izolonte Partinë Komuniste nga populli, të shuante Luftën nacional-çlirimtare dhe të shkatërronte pushtetin nacional-çlirimtar që po ngrihej, pse ky pushtet i ri përbënte për të dhe për okupatorët një rrezik shumë të madh. Por duke mos mundur dot të korrnin sukses, qoftë me

armë, goftë me demagogji, ballistët tentuan të krijonin dhe ata disa farë çetash e disa farë këshillash balliste për të çorientuar opinionin e masave. Por këto tentativa u dështuan, pse Partia dhe Fronti Nacional-Çlirimtar ua shpartalluan këto pseudokëshilla. Anglezët u përpoqën që ta pengonin luftën e popullit, ndërtimin e pushtetit popullor, ashtu sikundër bënë edhe për Ushtrinë Nacional-Çlirimtare. Qëllimi i tyre ishte ta vinin lëvizjen nacional-çlirimtare në pozita të tilla që ajo të ndante pushtetin me kuislingët dhe tradhëtarët. Një tentativë të tillë dhe në bashkëpunim me ballistët dhe me okupatorin gjerman ata e bënë në mbledhjen e Mukjes më 1943. Qëllimi i anglezëve dhe i kuislingo-tradhëtarëve ishte që të rehabilitohej «Balli», të vihej në një radhë me Frontin Nacional-Çlirimtar dhe kështu të drejtonte, ose më mirë të likuidonte Luftën nacional-çlirimtare dhe Partinë Komuniste të Shqipërisë. Në këtë mbledhje Ymer Dishnica dhe Mustafa Gjinishi tradhëtuan Partinë dhe direktivat e Komitetit Qendror. Ata pranuan plotësisht pikëpamjet angleze dhe të tradhëtarëve. Anglezët vepruan në Mukje me anën e agjentëve të tyre Abaz Kupi etj. Por Partia i shqelmoi që në ditën e parë «vendimet» e Mukjes dhe e likuidoi këtë tentativë të anglezëve dhe të tradhëtarëve. Pas disfatës së Mukjes, anglezët krijuan «Legalitetin» gjoja si parti legjitime zogiste; edhe këtë gjë ata e bënë që të pranohej prej gjermanëve dhe tradhëtarëve si parti legjitime. Kjo kishte për qëllim që, përballë Partisë Komuniste dhe Frontit Nacional-Çlirimtar, anglezët të krijonin një blok të ri, të cilin, duke e ndihmuar me të gjitha forcat, pas shpartallimit të gjermanëve, ta për-

dorin kundër Partisë e Frontit dhe të tentonin të shkatërronin Partinë tonë, ose të ndanin pushtetin. Po edhe këtë manevër Partia ua shpartalloi me luftë. Në këtë drejtim imperialistët anglezë do të vepronin me gjallëri, duke kërcënuar Shtabin e Përgjithshëm me ultimatumë për të ndaluar luftën në Shqipërinë e Veriut kundër Bazit të Canes e kuislingo-gjermanëve dhe do të përpiqeshin të hidhnin parashutistë në Shqipëri, të zbarkonin trupa për t'u marrë krahët partizanëve dhe për t'u shkuar në ndihmë kuislingëve e tradhëtarëve. Anglezët do të përpiqeshin gjithashtu të sabotonin Kongresin e Përmetit. Mirëpo të gjitha tentativat e tyre djallëzore u shpartalluan me luftë nga Partia jonë heroike. Kështu e krijoi dhe e çelnikosi pushtetin e ri popullor Partia jonë; kështu e shpartalloi pushtetin e vjetër të feudoborgjezisë dhe të okupatorëve. Me luftë dhe me heroizëm Partia jonë bëri të dështojnë ofensivat e gjermanëve, të ballistëve, të zogistëve dhe intrigat e mëdha të anglo-amerikanëve gjatë kohës së luftës. Një rëndësi të jashtzakonshme ka deklarata historike e shokut Mollotov më 18 dhjetor 1942. Kjo deklaratë thotë:

«Bashkimi Sovjetik, duke parë me simpati të plotë luftën çlirimtare të patriotëve shqiptarë, deklaroi se nuk njeht asnjë pretendim të imperializmit fashist italian mbi tokën shqiptare dhe dëshiron ta shohë Shqipërinë të lirë dhe të pavarur... Çështja e strukturës së shtetit është një çështje e brendshme e Shqipërisë dhe duhet të zgjidhet prej vetë popullit shqiptar»¹.

¹ Shih: «Pravda», Nr. 352 (9123), 18 dhjetor 1942.

Kjo deklaratë bëri që edhe qeveritë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Anglisë të detyroheshin të mbanin të njëjtin qëndrim. Kjo ishte një fitore e madhe për popullin shqiptar, pse deklarata e Mollotovit e mbronte Shqipërinë nga çdo rrezik i ardhshëm. Deklarata e Mollotovit, e Hullit dhe e Idenit qëndrojnë kurdoherë si dokumenta me rëndësi ndërkombëtare, të cilat nuk mund të shkelen lehtë nga imperialistët anglo-amerikanë.

Partia Komuniste e Shqipërisë, që ishte trashëgimtarja besnike e vetive të larta të popullit, e guximit, e heroizmit dhe e drejtësisë së tij, Partia jonë, që ndoqi me besnikëri mësimet e Leninit dhe të Stalinit dhe eci në rrugën e lavdishme të Partisë Bolshevike, e çliroi Shqipërinë tërësisht dhe përgjithmëni nga robëria e fashistëve dhe e feudoborgjezisë. Heroizmat e popullit shqiptar, të ushtrisë sonë, të komunistëve që luftonin kudo në ballë të të gjithë patriotëve, do të shkruhen me shkronja të arta në historinë e popullit tonë. Në këtë luftë populli pësoi humbje, se armiku dogji kra-hina të tëra, vrau me mijëra njerëz të pafajshëm, por ai nuk ju shmang sakrificave, s'ju tremb terrorit, shtërngoi radhët rreth Partisë dhe luftoi trimërisht i sigurtë se kauza e tij ishte e drejtë dhe se luftën e tij për fitore e përkrahte fuqimisht BS dhe Stalini. Populli shqiptar doli nga errësira në dritë dhe do t'i përvishej një lufte të re heroike për ndërtimin e jetës së tij të lumtur, për ndërtimin e bazave të socializmit.

II. — NËN UDHËHEQJEN E PARTISË, SHQIPËRIA U RINDËRTUA DHE POPULLI SHQIPTAR NDËRTON NË VENDIN E TIJ BAZAT E SOCIALIZMIT

Çlirimi e gjeti vendin tonë në një situatë ekonomike jashtëzakonisht të rëndë dhe të mjeruar. Çdo gjë pothuajse ishte shkatërruar dhe djegur nga lufta. Bujqësia ishte në gjendje të vajtueshme. Armiku dëmtoi rëndë blegtorinë, kafshët dhe mjetet e punës të fshatarit. Edhe ato pak fabrika e punishte që ekzistonin në të kaluarën, u dogjën, ose u hodhën në erë nga okupatorët. Minierat ekzistuese u shkatërruan nga okupatorët. Çdo gjë duhej rindërtuar dhe duheshin marrë masa urgjente. Partia jonë heroike, në krye të popullit dhe me ndihmën e madhe të Bashkimit Sovjetik dhe të Stalinit, u doli mbanë të gjitha këtyre vështirësive dhe e ndryshoi krejtësisht situatën, e ngriti ekonominë e vendit tonë, përmirësoi në mënyrë të dukshme standardin e jetës së popullit dhe nga dita në ditë u korrën fitore të pashembullta në historinë e popullit tonë.

Partia dhe qeveria, që në ditët e para të çlirimit, zbatuan me vendosmëri programin e tyre të reformave të mëdha ekonomike, shoqërore dhe kulturale që do të futnin vendin tonë në rrugën e mirëqenjes dhe të përparimit.

Reforma agrare çliroi fshatarësinë tonë nga mjerimi dhe varfëria. Partia jonë i dha fshatarësisë tokën. U konfiskuan pasuritë e tjera të bejlerëve dhe të pasanikëve borgjezë. Tregëtarët e mëdhenj gjakpirës u detyruan t'i kthenin popullit çka i kishin grabitur dhe

tatimet mbi fitimet e tyre gjatë luftës përbënë një fond të rëndësishëm të financave të shtetit të ri që po ndërtohej. U konfiskuan pallatet e tyre dhe u bënë pasuri shtetërore, u shtetëzuan fabrikat dhe koncesionet duke u bërë pronë e shtetit. Tregëtia e jashtme dhe ajo grosiste e brendshme u bënë ekskluzivisht të shtetit. U luftuan ashpër tregu i zi dhe spekulimi që bënë tregëtarët; u fshinë borxhet e popullit; u ngrit arësimi i ri dhe u ndërtua kultura e re për popullin punonjës; u luftuan me kujdes dhe me këmbëngulje sëmundjet. Në luftën heroikë të ndërtimit të bazave të socializmit, që udhëheq me urtësi të madhe Partia jonë e Punës, populli, me një entuziazëm të papërshkruar, bëri heroizma të njëllojta me ato të kohës së luftës. Kjo tregoi sa e thellë ishte dashuria e popullit tonë për Partinë e Punës. Populli e ndoqi Partinë me besnikëri të madhe dhe Partia me besnikëri të madhe ja realizoi qëllimet popullit.

Klasa jonë punëtore, që luftoi heroikisht në ballë të luftës, që në ditët e para të çlirimit bëri heroizma të mëdha. Ajo udhëhoqi gjithë punonjësit e vendit tonë në qindra aksione të lavdishme që i siguruan vendit bazat e shëndosha të një zhvillimi ekonomik dhe shoqëror më të madh në të ardhshmen. Me heroizëm dhe vetëmohim të pashoq punuan rinia jonë, gruaja shqiptare dhe gjithë punonjësit e Shqipërisë. Gati nga hiçi u ndërtuan vepra madhështore për vendin tonë. Në Shqipërinë e re u realizuan të tilla suksese që njerëzit, të cilët e kanë njohur në të kaluarën vendin tonë, habiten. Kjo gjë i detyrohet Partisë sonë heroike, që vuri të gjitha forcat për realizimin e dëshirave të popullit,

që përmbushi qëllimet e tij. Kjo gjë i detyrohet edhe Bashkimit Sovjetik dhe të madhit Stalin që me aq kujdes e bujari e ndihmuan popullin tonë të dilte nga rruga e varfërisë dhe e robërisë, në rrugën e lirisë dhe të mirëqenjes.

Faza e parë e rindërtimit të vendit tonë nuk kaloi pa rreziqe për popullin dhe Partinë. Partia do të kërcënohej seriozisht nga brenda dhe nga jashtë. Armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm të Partisë do të tentonin nga të dy anët për të rrëzuar pushtetin popullor dhe për të likuiduar Partinë. Mbas çlirimit misionet zyrtare angleze dhe amerikane tentuan të riorganizonin reaktionin e shpartalluar dhe ta hidhnin në akte diversioni, sabotazhi e atentatesh për të rrëzuar pushtetin popullor. Por vigjilenca e Partisë ua dërmoi planet e tyre dhe likuidoi agjenturat e grupet e sabotazhit amerikano-anglez. Këta, në pamundësi të vepronin nga brenda, zhvilluan kundër Republikës sonë në arenën ndërkom-bëtare një propagandë jashtëzakonisht të poshtër. Ata krijuan incidentin e kanalit të Korfuzit e të tjera akte piraterije me anë të satelitëve të tyre. Por populli shqiptar në saje të punës së tij plot vetëmohim dhe të ndihmës së Bashkimit Sovjetik i forcoi pozitat e tija të brendshme dhe të jashtme.

Brenda në Parti dhe në udhëheqje të saj do të zhvillohej lufta kundër deviatorit oportunist Sejfulla Malëshova, i cili punoi për likuidimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe të demokracisë popullore. Pikkëpamjet e Sejfulla Malëshovës çonin në likuidimin e fitoreve të popullit shqiptar, të arritura nën drejtimin e Partisë, ato ishin në favorin e borgjezisë dhe të im-

perializmit; pikëpamjet e tija ishin të atilla që borgjezia të ringjallej, të ruante privilegjet dhe Partia të ndante pushtetin me të. Partia likuidoi pikëpamjet oportuniste të Sejfulla Malëshovës.

Por një rrezik tjetër shumë më i madh do t'i turrej Partisë dhe popullit tonë në këto momente dhe ky ishte rreziku i titizmit, agjenturë e imperializmit amerikan. Grupi nacionalist i Titos ka qenë një rrezik i madh dhe vazhdon të jetë i tillë për Partinë dhe për Republikën tonë Popullore. Nën maskën e aleancës dhe të miqësisë, nën maskën e komunizmit ai filloi veprimtarinë armiqësore kundër Partisë dhe popullit tonë që në kohën e luftës. Ky grup krijoi brenda në udhëheqjen e Partisë sonë agjenturën e tij me Koçi Xoxen në krye. Në Plenumin II të Komitetit Qendror në Berat trockistët jugosllavë dhe agjenti i tyre Koçi Xoxe me shokë, akuzuan udhëheqjen e Partisë se gjoja ajo kishte shtrembëruar vijën politike, organizative dhe ushtarake dhe se fitoret e arritura i detyroheshin më tepër lëvizjes spontane, se sa udhëheqjes së Partisë. Ata akuzuan gjithashtu udhëheqjen e Partisë se ajo, gjoja, kishte shmangur nga drejtimi njerëz «me vlerë» si Koçi Xoxen, Pandi Kriston, Sejfulla Malëshovën e të tjerë. Në këtë plenum këta trockistë fituan disa pozita, por nuk mjaftoi me kaq, qëllimi i tyre i fundit ishte likuidimi krejtësisht i elementëve besnikë të marksizëm-leninizmit dhe marrja e plotë e drejtimit të Partisë në duart e tyre. Nga këto pozita e filluan luftën ata për degjenerimin e Partisë sonë në një parti trockiste; ata punuan intensivisht për të shpartalluar parimet marksiste-leniniste të Partisë sonë dhe për t'i zëvendësuar

këto me metoda trockiste e fashiste. Qëllimi i tyre ishte: likuidimi i Partisë, i Republikës Popullore të Shqipërisë dhe kolonizimi i Shqipërisë nga ana e nacionalistëve jugosllavë. Plani i imperialistëve amerikanë, që do të zbatohet prej titistëve jugosllavë dhe Koçi Xoxes në lidhje me Shqipërinë, ishte një pjesë e planit të madh të agjunkturës amerikane në Ballkan, plan i cili synonte që, nën drejtimin e trockistëve të Beogradit, të likuidoheshin partitë komuniste dhe punëtorë në Ballkan e në Evropën Qendrore, të përmbyseshin regjimet e demokracisë popullore dhe të vendoseshin në këto vende regjimet e borgjezisë. Qëllimi i trockistëve jugosllavë dhe i Koçi Xoxes me shokë ishte të izolonin Shqipërinë nga Bashkimi Sovjetik dhe kampi i socializmit, të shuanin dashurinë që kishte populli ynë dhe Partia për Bashkimin Sovjetik, për Partinë Bolshevike dhe për Stalinin. Tradhëtari Koçi Xoxe, tok me jugosllavët, kurdisnin komplete dhe krime kundër udhëheqësve të Partisë dhe të shtetit. Shoku ynë i dashur Nako Spiru, në këto rrethana të rënda, vrau veten duke rënë viktimë e presioneve të pòshtra e kriminale të trockistëve jugosllavë dhe të veglave të tyre në Shqipëri, të cilët sabotonin me të dy duart ekonominë dhe ndërtimin e bazave të socializmit. Megjithëse në rrethana kaq të vështira njerëzit më të mirë të Partisë nuk e humbën toruan, por i qëndruan besnikë deri në fund internacionalizmit proletar, Bashkimit Sovjetik, mësuësit të tyre të lavdishëm, shokut Stalin. Trockistët jugosllavë dhe Koçi Xoxe nuk mundën dot të realizonin planet e tyre, pse Partia jonë e mori veten përnjëherë dhe filloi luftën kundër armiqve të brendshëm të Par-

tisë dhe klikës nacionaliste të Titos. Kur qëllimet e agjenturës amerikane në Ballkan, me Titon në krye, po zbuloheshin nga Partia Bolshevike, titistët dhe Koçi Xoxe me shokë, filluan të aktivizohen gjallërisht për të realizuar shpejt e shpejt e definitivisht planet e tyre. Ata tentuan të sillnin trupa jugosllave në Shqipëri dhe të okuponin Korçën, gjoja se Shqipëria ishte në rrezik të invadohej nga monarko-fashistët grekë. Kjo tentativë e titistëve kishte për qëllim të frikësonte popullin shqiptar dhe Partinë, të pushtonte Shqipërinë në mënyrë «paqësore» dhe në momentin oportun të likuidonte Partinë dhe çdo rezistencë. Por Partia ua hodhi poshtë këtë plan makiavelik¹ nationalistëve jugosllavë dhe nuk lejoi ardhjen e divizionit të tyre në Shqipëri. Përpara këtij refuzimi, agjenti titist, gjenerali Kupreshanin bëri një provokacion tjetër, duke «këshilluar» qeverinë shqiptare që të qëllonte me top çdo anije të huaj që mund të afrohej në bregdetin tonë. Por këtë «këshillë» nuk ja pranoi Partia. Tradhëtarët e Beogradit dhe agjentët e tyre shqiptarë tentuan të bashkonin Shqipërinë me Jugosllavinë, por edhe ky provokacion dhe rrezik i madh u shqelmua nga Partia. Duke parë se edhe ky plan u dështoi, agjenti titist Sllavo Zllatiç, i bëri udhëheqjes shqiptare propozime të reja bashkëpunimi në mes të dy shteteve, të ngjashme me ato që ka vendosur imperializmi amerikano-anglez në shtetet

¹ Nga emri Makiaveli (1469—1527), personalitet politik dhe shkrimtar i Republikës së Firences, i cili për realizimin e një qëllimi predikonte një politikë të tillë, që nuk ndalej para asnjë mjete mizor lufte, duke përdorur gënjeshtrenë, hipokrizinë, tradhëtinë, pabesinë, vrasjen etj.

e Beneluksit, duke i cilësuar këto si forma të reja bashkëpunimi. Udhëheqja shqiptare me urrejtje i për-buzi këto propozime dhe i hodhi poshtë.

Ishte fundi i veprimtarisë nacionalisto-trockiste të jugosllavëve dhe të Koçi Xoxes me shokë. Partia e lavdishme Bolshevike e Lenin-Stalinit me letrat historike që ajo i drejtoi ish-Partisë Komuniste Jugosllave dhe Rezolucioni i Byrosë Informative ua çorrën krejtësisht maskën këtyre agjentëve të borgjezisë. Letrat e Partisë Bolshevike qenë një ndihmë e madhe për Partinë tonë. Ato kthjelluan situatën dhe u dhanë një armë të fuqishme në dorë Partisë sonë dhe gjithë partive komuniste dhe punëtore motra të botës, për të luftuar me ashpërsi dhe me sukses rrezikun e titizmit, të këtyre tradhëtarëve, që fshihen nën maskën e marksistëve, u dhanë një armë të madhe për të shëndoshur partitë e tyre dhe për të spastruar radhët nga provokatorët në shërbim të imperializmit dhe të borgjezisë. Gjyqet kundër Koçi Xoxes, Laslo Rajkut dhe Trajçe Kostovit, demaskuan përgjithmonë këto agjentura të rrezikshme. Në radhët e Partisë sonë u zhvillua një luftë e ashpër kundër agjenturës titiste. Gjithë Partia dhe populli shqiptar u ngrit peshë dhe goditi me ashpërsinë më të madhe çdo armik nën çdo maskë që ai fshihej. U çelnikos Partia jonë, u çelnikos udhëheqja e Partisë dhe Kongresi I ndërtoi për Partinë vijën e shëndoshë marksiste-leniniste, të cilën ajo do ta zbatonte me sukses dhe do të korrte fitore në fushën ekonomike, politike dhe sociale.

Kongresi I i Partisë është një datë me shumë rëndësi në historinë e Partisë sonë, pse ai shënoi një

kthesë vendimtare në forcimin dhe bolshevizimin e Partisë. Nën influencën e trockistëve jugosllavë, në Partinë tonë ishin vërtetuar gabime të rënda parimore dhe organizative. Në dritën e letrave historike të Partisë Bolshevike dhe të Rezolutës së Informbyrosë, Komiteti Qendror i Partisë konstatoi këto gabime serioze parimore: Partia jonë ishte në gjysmilegealitet dhe deri në atë kohë ajo kryente veprimtarinë e saj nëpërmjet Frontit Demokratik. Një gabim i tillë na çonte në likuidimin e Partisë. Lidhur me këtë ishte çështja e mungesës së Statutit të Partisë, gjë që influenconte në dezorientimin e Partisë në çështjet organizative, në problemet e ndërtimit të Partisë dhe në njohjen e ligjeve të jetës së brendshme të saj. Ne kishim shkelur parimet themelore mbi të cilat ishte ndërtuar Partia: parimin drejtues të strukturës organizative, centralizmin demokratik. Udhëheqja trockiste jugosllave dhe agjentët e tyre kishin punuar sistematikisht për t'i minuar këto parime themelore marksist-leniniste të Partisë. Që prej çlirimit dhe deri në Kongresin I nuk bëheshin zgjedhjet në bazë të rregullave organizative të Partisë, por caktoheshin nga lart. Po e njëjta gjë bëhej për të kooptuar anëtarë të forumeve të Partisë. Nuk jepej llogari nga organet e larta dhe ishte mbytur kritika dhe autokritika. Disiplina e hekurt dhe e ndërgjegjshme, që ishte një armë e fortë e Partisë sonë gjatë gjithë kohës së luftës, kishte filluar të shthurej dhe praktikisht në Partinë tonë, nën influencën e trockistëve jugosllavë, ishte vendosur disiplina zyrtare mbi disiplinën e Partisë. Trockistët jugosllavë dhe Koçi Xoxe me shokë futën metodat ushtarake dhe

policore në drejtimin e Partisë dhe në zgjidhjen e problemeve. Kjo shtypi kuadrot e Partisë, pengoi inisiativën e tyre dhe i demoralizoi. Duke folur për këtë çështje shoku Zhdanov në raportin e tij në Kongresin XVIII të Partisë Bolshevike thotë:

«Elementët armiq praktikojnë gjerësisht vënjen e disiplinës zyrtare përmbi disiplinën e Partisë, për të demoralizuar anëtarët e ndershëm të Partisë»¹.

Kështu ngjiste edhe në Partinë tonë pas çlirimit dhe derisa erdhën letrat historike të Partisë Bolshevike. Qenja e sekretarit organizativ të Partisë, Koçi Xoxes, njëkohësisht ministër i brendshëm dhe aq më tepër agjent i jugosllavëve, ka dëmtuar rëndë vijën organizative të Partisë sonë. Kjo formë organizative antimarksiste na qe huajtur nga trockistët jugosllavë. Praktikisht kjo formë organizimi bëri të futen në Parti metodat ushtarake, zëvendësoi vigjilencën revolucionare me informacionin policor; krijoi frikë në anëtarët e Partisë, ngjalli dyshim e pasiguri në ta. Kjo formë vinte Partinë nën mbikqyrjen policore të Ministrisë së Brendshme.

Me këto gabime të rënda patjetër ishte dobësuar puna kolegjiale në drejtimin e Partisë, zhvillohej një politikë e gabuar kuadri, që kishte për qëllim të sillte në vendet drejtuese elementë antimarksistë dhe njerëz të besuar të trockistëve jugosllavë dhe të godiste nga ana tjetër elementin e shëndoshë të Partisë. Disa kuadro të shëndoshë shpërdoroheshin, shtypeshin e trajtoheshin shumë keq. Trajtimi i keq i tyre shkante deri në

¹ Shih: «Pravda», Nr. 78 (7763), 20 Mars 1939.

torturime dhe ekzekutime me akuza të falsifikuara nga Koçi Xoxe. Këto gabime të rënda kishin reperkusione të tmerrshme dhe shkaktonin konfuzion e pasiguri në lidhje me drejtimin e problemeve ekonomike dhe politike të Partisë dhe kjo dëmtonte sukseset e Partisë.

Letrat historike të Partisë Bolshevike dhe Rezoluta e Informbyrosë qenë një ndihmë e madhe për Partinë tonë. Plenumi XI dhe Kongresi I i Partisë i spastroi këto gabime të rënda shumë të rrezikshme. Nëpërmjet kritikës dhe autokritikës bolshevike, që u zhvilluan në Komitetin Qendror dhe deri në organizatat bazë të Partisë, masat urgjente që u morën nga Partia, në bazë të vijës që përcaktoi kongresi, bënë që Partia të marrë frymë lirisht, të hyjë në rrugën e vërtetë marksiste-leniniste, nga e cila u përpoqën ta shmangnin trockistët jugosllavë me Koçi Xoxen dhe shokët e tij. U rivendos centralizmi demokratik, kritika dhe autokritika, disiplina e hekurt dhe e ndërgjegjshme e Partisë, u luftua sektarizmi dhe oportunizmi në radhët e Partisë, u forcuan radhët e saja me kuadro të rinj, besnikë, të dalë nga gjiri i klasës punëtore.

Aprovimi dhe lufta për zbatimin e Statutit solli me vete forcimin e centralizmit demokratik, vendosi në rrugën e drejtë punën kolegjiale në udhëheqje dhe shtoi aftësinë udhëheqëse të komunistëve. Kudo u bënë zgjedhjet demokratike dhe erdhën në udhëheqje shokë nga më të mirët. Jeta e brendshme e Partisë është forcuar, ashtu sikurse është forcuar edhe roli udhëheqës i Partisë mbi organet shtetërore të ekonomisë dhe mbi organizatat e masave. Uniteti i Partisë është forcuar vazhdimisht. Mbledhjet e plenumeve të Komitetit Qe-

ndror si dhe mbledhja e Plenumit V, mbajtur më 20—22 shkurt 1950, goditën me forcë veprimtarinë dhe pikëpamjet antiparti të grupit të Abedin Shehut dhe të Niazi Islamit, që rrezikonin Partinë. Lufta e ashpër kundër këtyre deviatorëve ka forcuar unitetin në udhëheqjen e Partisë dhe ka mprehur akoma më shumë vigjilencën revolucionare dhe luftarake të komunistëve kundër çdo deviatori ose agjenti të maskuar titist. Pas kongresit u vendos parimi bolshevik në politikën e kuadrit dhe kjo u bë duke u bazuar në eksperiencën e madhe të Partisë Bolshevike që na është dhënë pa kursyer; u riorganizuan funksionet e aparateve të Partisë, gjë që shkaktoi përmirësimin në një shkallë të madhe të punës në aparatet e qendrës dhe të rretheve dhe forcoi lidhjet e tyre me organizatat bazë të Partisë. Pas kongresit, me pranimet në Parti, është rritur numri i anëtarëve të saj me elementë të klasës, gjithashtu edhe në organet udhëheqëse të Partisë. Partia jonë në qershorin e vitit 1951 numëronte 48 087 komunistë dhe është përmirësuar shumë shtrirja e organizatave të Partisë. Në fakt nga 2 050 organizata bazë që numëronte Partia jonë para kongresit, sot ka 2 579 organizata bazë dhe grupe kandidatësh partie në qendra pune, në fshatra dhe në kooperativa bujqësore. Partia është duke mbaruar verifikimin, i cili do të spastrojë radhët e saja nga elementët e padëshirueshëm ose elementë të huaj dhe armiq që kishin hyrë kontrabandë. Kjo punë do të forcojë radhët dhe do të bolshevizojë Partinë tonë. Kjo ka shtuar vigjilencën e komunistëve, ka forcuar kritikën dhe autokritikën. Me rastin e 10-vjetorit të Partisë dhe me qëllim që të forcohen radhët e Partisë me elementë

të klasës punëtore, Komiteti Qendror ka marrë vendim që të pranohen në Parti punëtorët, që me heroizëm të pashoq, kanë realizuar veprat madhështore të bazave të socializmit në vendin tonë.

Lavdi klasës sonë punëtore!

Kongresi I i Partisë vërejti se puna për edukimin marksist-leninist paraqitej mjaft e dobët si nga shtrirja, ashtu edhe nga përmbajtja. Ai i caktoi detyra të rëndësishme Partisë për ta ngritur këtë problem kaq të rëndësishëm në baza të shëndosha. Komiteti Qendror ka marrë vendime të rëndësishme në bazë të vijës së kongresit dhe ka organizuar arësimin marksist-leninist në Parti. Në bazë të të gjitha programeve të studimit është vënë kursi i shkurtër i «Historisë së Partisë Komuniste (bolshevike) të BS» dhe historia e Partisë sonë. Me gjithë të metat që ekzistojnë në organizimin e arësimit në Parti, përmbajtja dhe cilësia e punës ideologjike çdo vit përmirësohet dhe janë arritur rezultate të mira. Ndërsa në vjetët 1944—1948 efektiviteti që ka kaluar në ndonjë kurs teorik ishte rreth 4 684, në vjetët 1949—1950 në format e arësimit të Partisë, në shkollat politike, në rrethet dhe në kurset e ndryshme morën pjesë 6 246 vetë, kurse në 1950—1951, 12 264, që është barazi me 42 për qind të efektivitetit të Partisë në terren, pa llogaritur këtu format e arësimit marksist-leninist të Partisë që zhvillohen në shkallë të gjerë në ushtri.

Çdo vit kalojnë në Shkollën njëvjeçare të Partisë rreth 100 kuadro, studjojnë me korrespondencë në kursin dyvjeçar pranë Shkollës së Partisë 283 kuadro. Kanë kaluar në kurset njëmuajore rreth 4 414 sekretarë organizatash bazë dhe në kurset tremujore rreth 1 210 kuadro dhe

punëtorë partie. Vetëm gjatë verës së vitit të kaluar janë përgatitur në kurse të posaçme 1 000 propagandistë.

Në të gjitha rrethet e Shqipërisë janë ngritur kabinetet e Partisë dhe bibliotekat. Të gjitha programet dhe rrjeti i formave të arësimit në Parti është furnizuar me leksione dhe broshura. Janë përkthyer dhe botuar për këtë qëllim 74 lloje librash nga literatura marksiste-leniniste me një tirazh të përgjithshëm prej 1 060 000 copë. Me vendim të Byrosë Politike filloi përkthimi i veprave të shokut Stalin. Në radhën e veprave që po përfundohen me rastin e festës së 10-vjetorit të Partisë, punëtorët e shtypshkronjës i dorëzuan Partisë vëllimin e parë të veprave të shokut Stalin, i dhanë Partisë dhe popullit një armë të re për luftën e tij në rrugën e ndërtimit të socializmit dhe të mbrojtjes së paqes. Por Partia jonë ndjen një nevojë shumë të madhe dhe më shumë se kurrë, të forcojë përgatitjen e saj politike, arësimore, kulturele dhe ideologjike, për të qenë në ballë të detyrave shumë të mëdha e të rëndësishme që na vë përpara ndërtimi i mëtejshëm i bazave të socializmit, realizimi i planit pesëvjeçar dhe përforcimi i gjithanshëm i Republikës sonë Popullore.

Por Partia jonë duhet të kryejë me nder edhe këtë detyrë të madhe e të domosdoshme dhe çdo komunist nuk do të harrojë kurrë se teoria marksiste-leniniste është një armë që të bën të marrësh çdo kala, që të bën të kapërcesh çdo vështirësi. Partia jonë do të ketë parasysh gjithmonë fjalët e mësuesit tonë të madh Stalin:

«... por në qoftë se megjithkëtë për një arësye ose për një tjetër propaganda jonë e partisë fi-

llon të çalojë, në qoftë se fillon të dobësohet puna e edukimit marksist-leninist të kuadrove tanë, në qoftë se dobësohet puna jonë për ngritjen e nivelit politik dhe teorik të këtyre kuadrove dhe si pasojë vetë kuadrot nuk interesohen më për perspektivën e përparimit tonë, nuk e kuptojnë më drejtësinë e çështjes sonë dhe shndërrohen në praktikienë pa perspektivë... — dobësohet gjithë puna jonë e shtetit dhe e partisë. Duhet pranuar, si një aksiomë, se sa më të lartë të jenë niveli politik dhe vetëdija marksiste-leniniste e kuadrove lë çdo sektori të punës së shtetit dhe të partisë, aq më e mirë dhe më frutdhënëse është vetë puna, aq më të efektshme janë rezultatet e punës, dhe anasjelltas, sa më të ulët që të jenë niveli politik dhe vetëdija marksiste-leniniste e kuadrove, aq më të mundshme janë gabimet dhe dështimet në punë...»¹

Duke zbatuar orientimet që përcaktoi kongresi në të gjitha drejtimet e aktivitetit ekonomik, shoqëror dhe kultural, Partia, me punën e saj të palodhur, korri shumë suksese. Në një kohë kaq të shkurtër u realizuan ndërtime të mëdha në vendin tonë dhe u përmirësua jeta e masave punonjëse në mënyrë të kënaqshme. Një detyrë e madhe i caktohej Partisë për rindërtimin dhe zgjerimin e industrisë sonë. Që në ditët e para të çlirimit u rindërtuan dhe u vunë në veprim fabrikat dhe punishtet ekzistuese. Por do të ishte edhe ndihma e Bashkimit

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 246—247.

Sovjetik që do krijonte mundësitë për popullin tonë të zhvillonte dhe të forconte industrinë, e cila gjatë planit dyvjeçar, veçanërisht, mori një hov dhe prodhimi industrial i krahasuar me vitin 1938, më 1951 arriti 595,6 për qind¹. U shtuan degë të reja në industri, si prodhimet metalike, sheqeri, këpucët, prodhimet e gomës, të peshkut. Në saje të punës plot vetëmohim të popullit tonë si dhe të kredive të Bashkimit Sovjetik, Shqipëria ndërtoi Kombinatin e tekstilit me emrin «Stalin» me një kapacitet 20 milion metra linear pëlhurë në vit, fabrikën e sheqerit me kapacitet 10 mijë ton në vit, u ndërtua hidrocentrali elektrik «Lenin». Gjithashtu gjatë planit dyvjeçar 1949—1950 u filluan veprat e tjera të mëdha si kombinati i drurit, fabrika e zhveshjes së pambukut, e cila ka filluar prodhimin, fabrika e fermentimit të duhanit. Investimet në sektorin e industrisë gjatë dyvjeçarit kanë qenë baras me 279,7 për qind në krahasim me investimet e bëra në vitet 1946, 1947, 1948 të marrura së bashku. Po një zhvillim shumë më të gjerë do të marrë industria gjatë planit pesëvjeçar 1951—1955. Do të ngrihen një numër fabrikash dhe uzinash të mëdha si rafineria e naftës, fabrika e çimentos, uzina e dytë për zhveshjen e pambukut, një fabrikë për penj pambuku, një kombinat për tekstilet e leshta, një uzinë (fonderi) për shkrirjen e hekurit dhe të çelikut si dhe një numër fabrikash të prodhimeve ushqimore si për konservim frutash, peshku, mishi, fabrikë buke, një fabrikë për prodhim të ekstrat-taninit, dy fabrika të tjera për sta-

¹ Shifrat e këtij dokumenti u rishikuan nga Komisioni i Planit të Shtetit dhe disa prej tyre u saktësuan.

xhionimin e lëndës së drurit, një fabrikë për prodhimin e letrës, një fabrikë qelqi, një hidrocentral tjetër me kapacitet shumë më të madh etj.

Krahas me industrinë, zhvillohet dhe artizanati në vendin tonë dhe ky është bërë një ndihmës i mirë i industrisë në prodhimin e veglave bujqësore, të pëlhurës, të mëndafshit dhe të prodhimeve të tjera që ka nevojë populli. Partia dhe qeveria i vunë një kujdes të veçantë zhvillimit të minierave, që ishin shfrytëzuar në mënyrë grabitqare në të kaluarën dhe të shkatërruara nga lufta. Klasa jonë punëtore tregoi heroizma të pashembullta, ajo i ndërtoi minierat dhe i vuri në shfrytëzim të plotë. Në naftë, në minierat tona të bakrit, të qymyrit, të kromit, të bitumit etj., prodhimet janë kudo shumë më të larta se në vitin 1938. Nga ky zhvillim një numër i madh teknikësh, më të aftë, u shtuan dhe do të shtohen nga viti në vit. U krijuan qendra pune dhe qytete të reja si Patosi, Selenica etj. Punëtorët tanë të aftë, të zgjuar, heroikë po përvetësojnë eksperiencën e punëtorëve sovjetikë. Minierat tona u pajisën me maqineri të reja dhe në planin tonë pesëvjeçar për to parashikohen investime më të mëdha.

Po aq kujdes dhe rëndësi i vuri Partia jonë zhvillimit të bujqësisë dhe të blegtorisë, të lëna pas dorë nga regjimet e kaluara dhe të shkatërruara nga lufta. Revolucioni popullor duke shpronësuar latifondistët, përmbysi raportet në fshat dhe me reformën agrare fshatari u bë zot i tokës dhe u krijua njëkohësisht sektori socialist në bujqësi, me ferma shtetërore dhe me kooperative bujqësore. Bujqësia jonë u rimëkëmb dhe ditë-ditës po forcohet. Nga viti në vit sipërfaqet e mbjella po

rriten në mënyrë të konsiderueshme dhe në vitin 1951, këto arritën në 149,5 për qind në krahasim me vitin 1938. Në bujqësi u futën mjetet e mekanizuara, u krijuan SMT-të, u përhapën metodat agroteknike në bujqësi të bazuara në eksperiencën sovjetike dhe këto masa bënë që të ngrihen rendimentet e kulturave si për shembull rendimenti i grurit ka arritur 134,3 për qind dhe i orizit 110 për qind në krahasim me vitin 1938. Bimët industriale, që nuk njiheshin më parë nga fshatarësia jonë, me gjithë konditat e favorshme klimaterike, u përhapën në shkallë të gjerë dhe sipërfaqja e mbjellë me këto bimë më 1951 është 14 herë më e madhe se ajo e paraluftës; vetëm sipërfaqja e mbjellë me kulturën e pambukut është rritur më tepër se 70 herë.

Investime të mëdha janë bërë dhe do të bëhen për zhvillimin e bujqësisë; lart nga 627 270 000 lekë janë harxhuar për bonifikime dhe kanale. Shteti kujdeset veçanërisht për fshatarësinë duke i dhënë asaj kredi me afate të gjata, duke e furnizuar me farëra të zgjedhura, me plehra kimike, duke i dhënë vegla bujqësore dhe kafshë, duke ja punuar tokat me traktorë. Agronomë, teknikë dhe agjentë bujqësorë¹, jetojnë dhe punojnë me fshatarët, prej të cilëve dalin me qindra kuadro të rinj, që ndjekin kurse, shkolla, teknikume bujqësore dhe universitete. Veçanërisht kujdes të madh i ka vënë Partia forcimit të kooperativave bujqësore, duke ecur në këtë drejtim me kujdesin më të madh dhe duke ruajtur rigorozisht parimin leninist-stalinian të pjesëmarr-

¹ Kështu quheshin ata kuadro që kishin kryer kurse ose shkolla bujqësore 1—2-vjeçare.

jes vullnetare në to. Kooperativat tona bujqësore, ditaditës forcohen, jeta lulëzon dhe ato bëhen shembull i mirë për fshatarësinë individuale.

Stacionet e maqinave dhe të traktorëve çdo vit po shtohen dhe në fermat shtetërore po zbatohen me sukses metodat e përparuara agroteknike.

Blegtoria jonë, që është një pasuri e madhe për vendin, po shtohet. Që në vitin 1946, bagëtia jonë e dëmtuar rëndë nga lufta, nën kujdesin e madh të Partisë e kapërcëu numrin e paraluftës. Është krijuar sektori blegtoral shtetëror, pas shtetëzimit të tufave të mëdha të pronarëve të mëdhenj. Këto janë bërë baza të zooteknikës, ku krijohen raca të reja me cilësi të larta prodhimi.

Pyjet, të djegura e të shkatërruara nga lufta dhe që përbëjnë një pasuri të madhe për ekonominë tonë, mbulojnë mbi një të tretën e sipërfaqes së vendit. Pyllëzimi ka filluar në shkallë të gjerë. Plani pesëvjeçar i pyllëzimit po kryhet me sukses. Si në çdo sektor edhe këtu vullneti i popullit është i patregueshëm dhe shpejt do të vijë koha që vendi ynë, i favorizuar nga klima, do të pyllëzohet dhe do të lulëzojë.

Një plagë e madhe pas luftës ishte çështja e komunikacioneve. Çdo gjë ishte krejtësisht e shkatërruar nga lufta dhe në një kohë rekord, me heroizmat e punëtorëve dhe të rinisë, çdo gjë u rindërtua: urat, rrugët, postat, telefonat dhe në mbarim të vitit 1945, komunikacioni u stabilizua dhe vendi filloi jetën normale. Për herë të parë në vendin tonë populli nën drejtimin e Partisë ndërtoi hekurudhat e para prej 122 kilometrash. Këto hekurudha populli ja detyron rinisë sonë heroike të edukuar nga Partia në rrugën e lavdishme të komsonolit.

Lavdi rinisë sonë heroike!

U ndërtuan rrugë të reja automobilistike, me të cilat u lidhën krahina të lëna në errësi nga regjimet e kaluara dhe këto çojnë atje diturinë, përparimin, dhurata të mëdha të Partisë sonë. U ndërtuan mole prej betoni dhe druri, kantiere detare, parqe automobilistike dhe ofiçina të ndryshme, u shtua rrjeti telefonik.

Gjatë pesëvjeçarit komunikacioni do të furnizohet edhe më shumë në përputhje me zhvillimin e industrisë, të minierave, të bujqësisë, me zhvillimin e kulturës dhe të mirëqenjes së popullit.

Ndërtimet në vendin tonë morën një hov të madh. Nga të katër anët e Shqipërisë po ndërtohet; vendi ynë është një kantier pune, ku kalitet klasa punëtore, ku ndjehet vrulli revolucionar i punonjësve që ndërtojnë jetën e lumtur. Mbi 105 000 metra katrorë sipërfaqe janë zënë nga fabrikat, uzinat e kombinatet; mbi 102 000 metra katrorë janë zënë me shtëpi të reja banimi për punëtorët e fabrikave, të minierave, të qendrave të punës dhe të qyteteve. Janë ndërtuar me qindra shkolla, klube, kinema, kopshte fëmijësh etj. Janë bonifikuar me mijëra hektarë tokë. Janë hapur me qindra kilometra kanale kulluese dhe ujitëse, janë hapur me mijëra metra linear tunele. Në këtë shkollë të madhe të ndërtimit janë kalitur punëtorët, nga ku kanë dalë teknikë të mrekullueshëm dhe me qindra sulmues.

Nën udhëheqjen e Partisë, po forcohet dhe po edukohet klasa jonë punëtore. Partia i mëson punëtorët të ecin në rrugën e lavdishme të punëtorisë sovjetike dhe i bëri ata të ndërgjegjshëm për rolin avangardë të klasës së tyre. Punëtorët dhe bijtë e punëtorëve më të

mirë, Partia i çon në kurse, në shkolla, në universitete. Këta tregojnë si në punë ashtu edhe në shkolla zotësi të pashembullt dhe kapacitete të rralla, aftësi të mëdha në përvetësimin e arësimit, të shkencave dhe të zanateve. Klasa jonë punëtore forcon disiplinën, në të zhvillohet emulacioni socialist dhe inisiativa krijuese. Sot 89 për qind të punëtorëve përfshihen në emulacionin socialist dhe deri tani numri i punëtorëve në prodhim që punojnë me norma ka arritur 83,9 për qind.

Inteligjencia e re e mrekullueshme e vendit tonë po ecën përpara e edukuar nga Partia. Inteligjencia e re nuk përbëhet vetëm nga ata që mbarojnë gjimnaze dhe universitete, jo, ajo është një pjesë. Inteligjencia e re e vendit tonë është shumë më e madhe, pse në të bëjnë pjesë punëtorët, bujqit, artizanët me mendje të ndritur e me duar të arta që krahas punës vazhdojnë edhe shkollat. Inteligjencien e re ne e gjejmë të ndërtojë hidrocentralet madhështore, punë shumë e komplikuar teknike, ajo monton fabrikën e sheqerit në Maliq dhe drejton prodhimin në mënyrë të shkëlqyer, ajo ngre kombinatin e sheqerit, ngre oxhaqet e fabrikave prej 70 metrash, ajo instalon maqineritë e komplikuar. Inteligjencien e re e gjejmë në sektorin e naftës, punë e zorshme dhe delikate, atë e gjejmë në minierat e qymyrit, të kromit, të bakrit, atë e gjejmë në shoferët tanë të mrekullueshëm e të zot, e gjejmë në hekurudha, në artizanat, e gjejmë në bujqësi duke luftuar për rendimente të larta. Prej kësaj inteligjencie të re që është thesar i popullit tonë kanë dalë sulmuesit Sali Vata, Negri Nikolla, Veli Allajbej, Halil Kraja, Koço Afezolli, Bale Nallbani, Ferit Qenska e qindra e qindra të tjerë. Partia

jonë me punën e saj të palodhur këtë inteligjencie të re do ta forcojë, do ta edukojë e do ta shtojë nga dita në ditë, se kjo është një bazë për ndërtimin e socializmit. Punëtorët tanë kanë në duar drejtimit kyçe në të gjithë aktivitetin e vendit. Për ta janë ndërtuar banesa, janë krijuar qendra pushimi në vendet më të bukura të atdheut tonë, për ta janë hapur mensa, biblioteka, klube, shtëpi kulture, kinema dhe kënde sportive.

Për të gjitha këto punime, për zbatimin e këtij programi të madh të rindërtimit, duheshin siguruar mjetet financiare. Çlirimi i gjëti financat tona bosh, por Partia i kushtoi kujdesin më të madh kësaj çështjeje. Ligji mbitatimet e fitimeve të jashtëzakonshme të luftës, politika fiskale e bazuar mbi të ardhurat nga taksat progresive shkallëzore, politikë që shërbeu në zhvillimin e luftës së klasave duke favorizuar masat e varfëra, regjimi i rreptë i kursimit të lekut të popullit, futja e ekonomisë sonë në rrugën e planifikimit, zgjerimi i sektorit socialist të ekonomisë dhe akumulimi shtetëror, që u rrit nga viti në vit dhe që sot zë një nga vendet më të rëndësishme në buxhetin tonë, u bënë të vetmet burime dhe bazë për financimin e ekonomisë sonë popullore. Partia zbatoi si kudo, edhe në politikën financiare, eksperiencën e marrur nga Bashkimi Sovjetik. Sot financat tona janë të forta dhe monedha jonë e stabilizuar, dita-ditës forcohet.

Me ligje revolucionare Partia krijoi konditat për ngritjen e sektorit socialist të tregëtisë, shteti monopolizoi tregëtinë e jashtme dhe grosiste dhe goditi pa mëshirë spekulatorët, duke lënë kurdoherë të lirë tregëtinë e vogël private. Kjo përmirësoi zhvillimin e tregëtisë sonë. Kjo bëri që në vitin 1950 qarkullimi i përgjithshëm

i mallrave nëpërmjet të gjitha kanaleve të tregëtisë, i krahasuar me vitin 1938, të arrijë 187,1 për qind, ndërsa gjatë këtij viti do të realizohet një xhiro baras me 214 për qind, në krahasim me vitin 1938. Ndërsa në vitin 1938 i gjithë qarkullimi i mallrave bëhej nëpërmjet sektorit privat, në vitin 1950, 76,73 për qind e qarkullimit realizohet nga sektori socialist. Tregëtia u bë më e kulturuar, çdo vit u shtuan fondet e mallrave që i shiten popullsisë dhe populli është furnizuar më mirë. Në vendin tonë është krijuar një rrjet i gjerë organizatash kooperativiste, të cilat sidomos në fshat, nëpërmjet të shitblerjes së mallrave të qytetit dhe të fshatit, janë bërë një faktor i rëndësishëm për tregëtinë dhe për forcimin e aleancës midis qytetit dhe fshatit. Partia dhe qeveria kanë vënë si detyrë që gjatë pesëvjeçarit të shtohen mallrat e konsumit të gjerë dhe të shkohet drejt likuidimit të sistemit të triskëtimit në mënyrë që jeta e popullit të bëhet më e begatshme dhe e lumtur.

Nën drejtimin e Partisë u zhvillua arësimi si dhe kultura popullore në vendin tonë. Ky problem i rëndësishëm ishte lidhur ngushtë me vetë forcimin e fitoreve të revolucionit popullor, të zhvillimit ekonomik dhe të ndërtimit të socializmit në vendin tonë. Kultura jonë nacionale duhet të jetë, siç na mëson shoku Stalin, socialiste në përmbajtje dhe nacionale në formë. Ajo duhet të jetë pasuri e masave të gjera të popullit, t'i shërbejë popullit, ta edukojë popullin me frymën e internacionalizmit proletar, të forcojë pushtetin popullor dhe të zbukurojë jetën e njeriut. Ky ka qenë orientimi i Partisë dhe kjo siguroi brenda pak vjetëve një zhvillim kultural të atillë që s'mund të ëndërronte populli ynë në regjimet

e kaluara. U çelën me qindra shkolla të reja fillore dhe numri i tyre me paraluftën u rrit në 316 për qind, kurse numri i nxënësve në 289 për qind. Arësimi fillor u bë i detyrueshëm. Numri i shkollave 7-vjeçare u shtua nga 11 që ishte para luftës, në 193. Nën pushtetin popullor është bërë e mundshme që sot të kemi shkolla fillore gati në të gjitha fshatrat dhe luftojmë për krijimin e konditave për arësimin 7-vjeçar të detyrueshëm. Numri i shkollave të mesme nga 11 që ishte para luftës, arriti në 23, kurse numri i nxënësve në to e kaloi në 316 për qind numrin e nxënësve të paraluftës. Përveç këtyre shkollave janë ngritur një numër i madh kursesh dyvjeçare profesionale, në qendra pune është hapur një rrjet i gjerë kursesh profesionale për kualifikimin e punëtorëve. Jo vetëm në të kaluarën që arësimi popullor ishte krejtësisht përtokë, por feudoborgjezia e mbante popullin në analfabetizmin më të plotë. Lufta kundër analfabetizmit është bërë për Partinë dhe për popullin një detyrë e madhe dhe rezultatet janë të shkëlqyera. Deri sivjet mbi 192 mijë analfabetë kanë mësuar shkrim e këndim. Asnjë shkollë e lartë nuk ekzistonte në regjimet e vjetra. Për herë të parë në historinë e Shqipërisë u ngritën institute të larta si Instituti i lartë pedagogjik, Instituti politeknik dhe ai bujqësor. Në këtë pesëvjeçar do të çelen gjithashtu dy institute të tjera të larta, ai i mjekësisë dhe ai për plano-ekonomist.

Populli shqiptar, rinia jonë heroike, që luftoi për çlirimin e atdheut, që ndërton sot jetën e saj të lumtur, brezat e rinj të vendit tonë, që do të edukohen në këto institute të larta, i shprehin mirënjohje të pafund Partisë sonë të Punës si dhe shokut Stalin, i cili u interesua

personalisht dhe na dha të gjitha ndihmat për ngritjen e këtyre instituteve.

Lufta e popullit dhe ndërtimi i bazave të socializmit ka krijuar artistë popullorë, ka nxjerrë talente të mrekullueshme të popullit, këngëtarë, muzikantë, aktorë të dramës dhe të baletit, regjizorë, piktorë e të tjerë që me vullnet të madh përvetësojnë mjeshtrinë e artit dhe frymëzojnë masat punonjëse në luftën për zbukurimin e jetës të shoqërisë sonë të re. Revolucioni popullor dhe ndërtimi i bazave të socializmit ka zhvilluar një lëvizje të madhe letrare. Shkrimtarë dhe poetë të talentuar, të lidhur ngushtë me jetën e popullit, me përpjekjet e heroizmat e tij, u kanë dhënë masave të gjera të popullit vepra të çmueshme. Këta bij të popullit, shkrimtarë, poetë, artistë, që me punën e tyre të palodhur dhe të ndërgjegjshme edukojnë dhe zhvillojnë ndjenjat dhe shpirtin e punonjësve, kanë pasur dhe do të kenë vazhdimisht përkrahjen më të madhe dhe kujdesin e veçantë të klasës punëtore dhe të avangardës së saj, Partisë së Punës të Shqipërisë. Në regjimin popullor sporti ka marrë një zhvillim të jashtëzakonshëm dhe Partia e përkrahu këtë me të gjitha forcat e saja për t'i bërë shtetasit e Republikës sonë Popullore njerëz të aftë fizikisht, plot shëndet. Në vendin tonë janë krijuar për herë të parë muzeume, nga të katër anët janë ngritur biblioteka, shtëpi kulture, shtëpi leximi, kënde të kuq e të tjera. Shtypi ka marrë përpjesëtime të gjera dhe është bërë i masave. Tirazhi i gazetave është shtuar nga 222 800 kopje në 1938, në 1 523 000 kopje në 1951. Një zhvillim të madh ka marrë botimi i librit dhe tirazhi kompleksiv i tij në 7 vjet ka arritur në 7 566 760 kopje.

Shëndeti i popullit ka qenë një nga preokupacionet e Partisë, e cila ka vënë të gjithë kujdesin për ta mbrojtur popullin nga sëmundjet. Në regjimin antipopullor të Zogut, aktiviteti shëndetësor përmbliidhej në 8 spitale. Pas çlirimit dhe deri sot funksionojnë 44 spitale, janë ngritur dhe funksionojnë 378 ambulanca, ku vizitohen më shumë se 816 mijë vetë në vit; funksionojnë 36 dispenseri antimalarike; kështu infeksioni malarik nga 60 për qind që ishte në 1938, u ul në 15 për qind në 1950; janë ngritur dhe funksionojnë 91 maternitete, ku lindin në kondita të mira me mijëra gra, janë ngritur 37 konsultore për gra dhe 40 konsultore për fëmijë, ku vizitohen 60 000 gra dhe 100 746 fëmijë në vit. Janë ngritur 4 preventoriume për fëmijë prej 7-14 vjeç me 520 shtretër dhe çerdhe ditore për fëmijë të vegjël me 1 677 shtretër si dhe një rrjet i gjerë qendrash të posaçme për edukimin higjieno-sanitar të mëmave. Të gjithë fëmijët e shkollave janë nën kontrollin mjekësor. Janë ngritur gjithashtu 35 klinika dentare, 60 farmaci qendrore me 180 agjenci farmacish në lokalitete për furnizimin e popullit me barëra. Të gjitha shërbimet mjekësore bëhen me shpenzimet e shtetit. Vazhdimisht Partia do t'i vërë kujdesin më të madh kësaj çështjeje. Në vendin tonë funksionon shkolla që nxjerr çdo vit ndihmësmjekë; me qindra studentë mbarojnë institutet e larta të mjekësisë në Bashkimin Sovjetik dhe në demokracitë popullore dhe fakulteti i ri i mjekësisë që do të hapet në vendin tonë, do të nxjerrë me qindra kuadro të rinj doktorësh. Gjendja demografike e popullit tonë ka ndryshuar shumë, duke pasur çdo vit një shifër rekord në shtesën e popullatës. Në regjimin e demokra-

cisë popullore, që udhëhiqet me urtësi nga Partia e Punës e Shqipërisë, jeta e popullit tonë zbukurohet, populli ynë rron i qetë dhe në liri, ai shtohet, forcohet, përparon.

Të tilla janë në vija të përgjithshme sukseset që ka arritur populli ynë në një kohë kaq të shkurtër, nën udhëheqjen e Partisë së tij të Punës.

Perspektiva të shkëlqyera i hapen përpara popullit shqiptar. Plani pesëvjeçar 1951—1955 do t'i sjellë popullit fitore të reja që do t'i përmirësojnë jetën. Plani pesëvjeçar, parashikon zgjerimin dhe modernizimin e industrisë, do të prodhohet në vend çdo gjë që ka nevojë populli. Kjo do të sjellë ngritjen e standardit të jetës, zhvillimin, edukimin, çelnikosjen e klasës punëtore që udhëheq fatet e vendit në rrugën e socializmit, do të forcojë aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse.

Plani ynë pesëvjeçar parashikon zgjerimin dhe modernizimin e industrisë sonë minerale. Kjo do t'i japë popullit më shumë naftë, bakër, qymyr, krom, serë e shumë minerale të tjera të vlefshme. Kjo do të shtojë të ardhurat e vendit, do të shtohen eksportimet tona, do të bëjë që ne të kemi mundësi të importojmë më shumë traktorë, maqineri, fabrika, të ngremë më shumë shtëpi për punonjësit, të zhvillojmë arësimin dhe kulturën në një shkallë akoma më të lartë.

Plani ynë pesëvjeçar parashikon zhvillimin dhe modernizimin e bujqësisë, ku do të bëhen bonifikime, do të hapen kanale, do të shtohet forca motorike e traktorëve dhe e vëglave të tjera moderne bujqësore, do të përdoren farëra të zgjedhura, të cilat do të sjellin shti-

min dhe përmirësimit e prodhimeve; pasurimin e kooperativave bujqësore dhe të fshatarëve. Fshatarit tonë do t'i hapen perspektiva të shkëlqyera dhe do të ndihmohet me kredi, me kafshë pune, me farëra të zgjedhura, me kuadro të mësuar. Kështu ai do të pasurohet dhe do të prodhojë sa më shumë për veten e tij dhe për gjithë popullin. Partia do të forcojë për popullin, më shumë Armën e Sigurimit të Shtetit, e cila me heroizma të përditshme, është bërë tmerri i armiqve të jashtëm dhe të brendshëm dhe një nga armët më të dashura dhe besnike të popullit. Ajo do të godasë akoma edhe më ashpër armiqtë nën çdo maskë që ata do të tentojnë të fshihen.

Partia jonë e Punës, besnike deri në fund e marksizëm-leninizmit, e Partisë Bolshevike dhe e shokut Stalin, do të forcojë radhët e saja dhe do t'i mbajë kurdoherë të pastra. Ajo, me flamurin e internacionalizmit proletar, do të luftojë pa mëshirë trockistët, deviatorët, oportunistët, provokatorët e të tjerë, brenda dhe jashtë radhëve të saja. Partia jonë do të edukojë klasën punëtore dhe do të forcojë aleancën e saj me fshatarësinë punonjëse. Ajo me këmbëngulje bolshevike do të edukojë kuadrot e saj me teorinë marksiste-leniniste, do të forcojë demokracinë e brendshme të Partisë dhe kritikën e autokritikën bolshevike, këtë armë të fuqishme të partive tona komuniste dhe punëtore.

Partia jonë e Punës, si kurdoherë, do të mbrojë deri në fund interesat e larta të popullit dhe do të udhëheqë me urtësi dhe me siguri popullin dhe atdheun tonë në rrugën e lavdishme të socializmit.

III. — PARTIA NË LUFTË PËR MBROJTJEN E PAQES, TË PAVARËSISË DHE TË INTEGRITETIT TË ATDHEUT

Populli shqiptar me kujdes të madh ndjek zhvillimin e situatës ndërkombëtare dhe është i ndërgjegjshëm për momentet kritike nga ku kalon njerëzimi, i kërcënuar me një luftë tjetër botërore nga imperialistët amerikano-anglezë dhe satelitët e tyre. Përpara këtyre momenteve kaq të rënda populli shqiptar është mobilizuar dhe lufton me vendosmëri për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e paqes.

Imperialistët amerikano-anglezë dhe satelitët e tyre, të zhytur në kontradikta e në kriza dhe duke parë se lëvizja revolucionare e popujve u rrezikon atyre privilegjet dhe pasuritë përralore, që ata kanë vënë me gjakun e popullit, po përgatiten me shpejtësi të madhe për një kasaphanë të re botërore kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore. Kampi i luftënxitësve, që udhëhiqet nga imperializmi amerikano-anglez, armatoset dhe e shndërron ekonominë e tij në një ekonomi lufte dhe i ka zhytur në varfëri e kriza popullin amerikan dhe popujt e vendeve Perëndimore. Ata mobilizojnë me forcë bijtë e këtyre vendeve për t'i pasur mish për top dhe për t'i çuar në kasaphanë për interesat e miliardërëve të Uoll Strit-it. Ata me arrogancë dhe paturpësi kanë shkelur të gjitha traktatet ndërkombëtare të pasluftës, të cilat do të rregullonin situatën pas thyerjes së Gjermanisë hitleriane, dhe kanë nënshkruar në mes tyre traktate agresive dhe lufte, siç

është ai i Atlantikut Verior, kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore. Imperialistët amerikano-anglezë po armatosin Gjermaninë hitleriane, po rikrijojnë Vermahtin gjerman, po rikrijojnë industrinë e luftës të Gjermanisë Perëndimore, me qëllim që kjo ushtri e re hitleriane, nën urdhërat e imperializmit amerikan, të përdoret kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore.

Traktati i turpshëm dhe i veçuar i San-Franciskos, legalizoi veprën e shëmtuar të luftënxitësve amerikanë për të mbajtur Japoninë si bazë ushtarake amerikane kundër Bashkimit Sovjetik dhe Kinës. Amerikano-anglezët, duke shpurë zjarrin në Korenë heroike, po përpiqen të përhapin luftën në Azi kundër Republikës Popullore të Kinës dhe popujve të tjerë aziatikë. Një ushtri mercenare po ngrihet nga imperialistët amerikanë, ushtri e përbërë nga fashistë tradhëtarë të vendeve të demokracisë popullore dhe këto banda kriminelësh stërviten nga amerikanët për akte spiunazhi dhe diversioni kundër vendeve të demokracisë popullore dhe Bashkimit Sovjetik. Imperialistët amerikano-anglezë dhe satelitët e tyre kërcënojnë botën me shantazhe dhe frikësime. Propaganda e tyre shurdhuese po mbjell psikozën e luftës, të frikës, të tmerrit me qëllim që të trembë, të çorientojë dhe të dobësojë njerëzit me nerva të dobët. Ata kërcënojnë botën me bombën atomike. Persekutimet dhe vrasjet, terrori dhe tortura, janë në rendin e ditës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në vendet e marshallizuara.

Imperializmi amerikan, që bën ligjet në kampin e luftënxitësve, ka hedhur poshtë me paturpësinë më të

madhe propozimet e qeverisë sovjetike, të cilat synojnë në ndalimin e luftës grabitqare, në forcimin e paqes në botë dhe në bashkëpunimin e shteteve të mëdha për rregullimin e të gjitha çështjeve ndërkombëtare. Zëri i fuqishëm dhe paqësor i Bashkimit Sovjetik në OKB dhe në të gjitha mbledhjet e rëndësishme ndërkombëtare, ka mbrojtur paqen, ka dënuar luftën, ka bërë propozime të drejta për zgjidhjen e problemeve të rëndësishme ndërkombëtare, që preokupojnë njerëzimin.

Kërcënimi dhe shantazhi, që amerikanët i bënin botës me bombën atomike, dështoi. Në deklaratën historike dhënë korrespondentit të Pravdës më datën 6 tetor të këtij viti, në mes të tjerave shoku Stalin u shpreh:

«Në të vërtetë, këto kohët e fundit u provua në vendin tonë një nga llojet e bombave atomike. Prova të bombave atomike të kalibrave të ndryshëm do të bëhen gjithashtu edhe në të ardhshmen, në bazë të planit për mbrojtjen e vendit tonë prej sulmit të blokut agresiv anglo-amerikan»¹.

Dhe më poshtë në lidhje me kontrollin ndërkombëtar mbi armën atomike shoku Stalin vazhdon:

«Bashkimi Sovjetik është në favor të ndalimit të armës atomike dhe që t'i jepet fund

¹ J. V. Stalin. Përgjegje pyetjeve të korrespondentit të gazetës «Pravda». «Pravda», Nr. 279 (12116), 6 tetor 1951.

prodhimit të armës atomike. Bashkimi Sovjetik është në favor të vendosjes të një kontrolli ndërkombëtar në zbatimin e plotë, të përpiktë dhe të ndërgjegjshëm të vendimit për të ndaluar armën atomike, për t'i dhënë fund prodhimit të armës atomike dhe për të përdorur bombat atomike që janë prodhuar vetëm për qëllime civile. Bashkimi Sovjetik është në favor pikërisht të këtij lloji kontrolli ndërkombëtar»¹.

Intervista e shokut Stalin i bëri copë e thërrime pretendimet e imperialistëve amerikanë për monopolin e bombës atomike. Deklarata historike e shokut Stalin, deklaratë e rëndësishme për mbrojtjen e paqes, mbushi me gëzim dhe besim zemrat e të gjithë popujve të botës që luftojnë për paqen. Kjo ishte një fitore tjetër e madhe për kampin e paqes dhe një disfatë për luftënxitësit imperialistë. Por lufta nuk është e paevitueshme. Rreziku i madh që kërcënon paqen nga luftënxitësit amerikano-anglezë dhe të tjerë, mund të evitohet ashtu siç ka thënë shoku Stalin:

«Paqja do të ruhet dhe do të forcohet, në qoftë se popujt do ta marrin në duart e veta çështjen e ruajtjes së paqes dhe do ta mbrojnë atë deri në fund»².

¹ J. V. Stalin. Përgjegje pyetjeve të korrespondentit të gazetës «Pravda». «Pravda», Nr. 279 (12116), 6 Tetor 1951.

² J. V. Stalin. Bisedë me korrespondentin e gazetës «Pravda». «Pravda», Nr. 48 (11835), 17 shkurt 1951.

Politika e urtë dhe paqësore e Bashkimit Sovjetik ka bërë që të gjithë popujt e botës, të gjithë njerëzit e thjeshtë të simpatizojnë Bashkimin Sovjetik dhe të shtërngojnë radhët rreth tij, ta duan dhe ta njohin atë si përkrahësin e tyre.

Bashkimi Sovjetik u tregon popujve të mbarë botës rrugën e shkëlqyeshme të socializmit.

Bashkimi Sovjetik, vendi i lavdishëm i socializmit dhe i paqes, nën udhëheqjen e Stalinit të madh po ndërton vepra madhështore. Plani i parë pesëvjeçar stalinian i pasluftës që në vitin 1950 u realizua dhe u tejkalua në mënyrë të konsiderueshme, niveli i lartë material e kultural i popujve sovjetikë, që është lidhur me këto fitore të mëdha ekonomike, kanë mbushur me gëzim dhe me besim të patundur zemrat e gjithë njerëzimit për fitoren e paqes. Këto fitore madhështore të Bashkimit Sovjetik shmangin shpërthimin e luftës, mbrojnë paqen që kërcënohet nga gjakpirësit imperialistë amerikanë, anglezë dhe satelitët e tyre.

Fronti i fuqishëm i paqes, që përmbledh në gjirin e vet me qindra milion njerëz, është bërë një barrierë e pathyeshme kundër luftënxitësve amerikano-anglezë dhe satelitëve të tyre. Politikën paqësore të Stalinit e kanë bërë të tyre qindra milion njerëz, të cilët çdo orë dhe çdo ditë në të katër anët e botës po bëjnë heroizma të papërshkruara kundër përgatitjeve të një kasap-hane të re.

Përpara kësaj force të madhe të popujve, që luftojnë për të mbrojtur jetën e tyre dhe të brezave të ardhshëm, imperialistët amerikanë dhe anglezë nuk e kanë aq të lehtë ndërmarrjen e tyre kriminale. Ata pësojnë

dëfata. Me gjithë terrorin dhe krimet e pashembullta në histori, imperialistët amerikanë nuk mundin dot të mposhtin popullin heroik korean dhe vullnetarët heroikë të popullit kinez që luftojnë dhe i thyejnë hordhitë amerikane. E njëjta gjë ngjet në Vietnam, Malezi, Iran, në vendet e Lindjes së Mesme, në Egjipt e gjetkë. E njëjta gjë do t'u ngjasë imperialistëve francezë në Algjeri e gjetkë. Imperializmi nuk do të ketë më sukses t'i çojë popujt në kasaphanë dhe t'i përdorë ata si mish për top. Në qytetin tonë të Korçës ndodhen disa varreza që quhen varrezat e francezëve. Por në këto varreza nuk ka shumë francezë. Atje janë bijtë e mjeruar të popujve të Afrikës së pushtuar nga kolonizatorët francezë. Këta kanë lënë koskat në vendin tonë për llogari të Klemansoit, të Uilsonit dhe të Lloid Xhorxhit. A kishte për të ndarë gjëkafshë populli ynë me popujt vëllezër të Afrikës? Jo, asgjë. Ata kanë qenë dhe janë vëllezërit tanë të dashur. Populli ynë ashtu si dhe popujt e këtyre vendeve ka vuajtur të zezat e ullirit nga imperialistët, të cilët kanë përdorur edhe çështjen e fesë si një armë për të shtypur çdo ndjenjë përparimtare, çdo lëvizje shoqërore, çdo përpjekje për t'u çliruar. Por ja, Shqipëria jonë e vogël u çlirua nga zgjedha e imperializmit dhe e feudoborgjezisë. Në vendin tonë nuk ka shtypje koloniale e raciale. Populli ynë e kuptoi se feja në asnjë mënyrë nuk duhet të bëhet një pengesë për të fituar lirinë dhe për të hequr qafe zgjedhën shekullore të imperialistëve dhe të tradhëtarëve. Pa dallim feje, i tërë populli ynë u bashkua si një trup, rroku armët, shtërngoi radhët rreth Partisë së tij Komuniste dhe fitoi lirinë. Tani në kurrizin e popullit nuk

ka më kamxhik të të huajve dhe pranga të beut. Nuk ka më gënjeshtër dhe spekulime.

Çdo gjë i bashkon popujt dhe asgjë nuk i ndan. Ata kanë një armik të vetëm dhe të përbashkët: imperia-listët amerikanë, anglezë, francezë dhe të tjerë. Kjo bën që populli ynë t'u zgjatë dorën me dashuri popujve të tjerë përtej malesh dhe detesh dhe t'u thotë: «Vëllezër, të bashkohemi, të luftojmë që të mos përsëritet më e kaluara e hidhur, të ndalojmë luftën grabitqare, që as djemtë tanë as tuajt të mos bëhen mish për top në interes të imperialistëve gjakatarë dhe skllavërues. Të bashkojmë forcat tona, pse ne jemi më të fortë, pse ne do t'i mposhtim armiqtë tanë shekullorë».

Këto ndjenja humanitare i frymëzojnë sot të gjithë popujt e botës.

Me heroizëm të madh luftojnë për paqen dhe lirinë popujt trima italianë, francezë, Spanja heroike, populli heroik grek dhe popujt e vendeve të tjera të marshallizuara e të robëruara nga gjakpirësit amerikanë, anglezë, francezë dhe shërbëtorët e tyre.

Populli shqiptar do ta mbrojë paqen me të gjitha forcat e tija pse paqja i është një nevojë jetike. Populli ynë është një popull paqësor që dëshiron të lihet i qetë në punën e vet, por njëkohësisht, ai do të qëndrojë kurdoherë dhe vazhdimisht i gatshëm për të mbrojtur jetën e tij, Republikën e tij Popullore dhe kufitë e saj. Populli shqiptar, duke punuar me vetëmohim për mbrojtjen e paqes, duke punuar me heroizëm për ndërtimin e bazave të socializmit, do të mbajë pushkën kurdoherë afër kazmës, afër traktorit, afër librit.

Si qenër të tërbuar po i ndërsehen popullit tonë të

vogël imperialistët amerikanë e anglezë, titistët, monarko-fashistët dhe fashistët e rinj italianë.

Nën drejtimin e amerikanëve janë grumbulluar dhe organizuar në banda spiunësh dhe terroristësh, të gjithë tradhëtarët e popullit shqiptar që gjenden jashtë në emigracion, në vendet e marshallizuara dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Çfarë bëjnë këta tradhëtarë kundër popullit tonë? Ata nuk lënë gjë pa bërë, por nuk kanë asnjë fitim. Puna e tyre është thjesht një punë agjenturale dhe diversioni në shërbim të amerikanëve, anglezëve, italianëve, titistëve e grekëve. Ata ekzekutojnë urdhërat e padronëve të huaj, duke u shpërblyer me dollarë. Atdheu i këtyre tradhëtarëve është dollari dhe aktiviteti i tyre është që kush nga grupet dhe partitë që gjoja ata kanë formuar, t'u shërbejë më mirë imperialistëve amerikanë dhe satelitëve të tyre. Këto parti tradhëtare, që grumbullojnë kriminelë luftime shqiptarë, përgatitin terroristë dhe diversantë që t'i lëshojnë me aeroplanë amerikanë, italianë, grekë dhe jugosllavë në vendin tonë, me qëllim që të organizojnë reaksionin e brendshëm dhe të kryejnë sabotazhe e atentate. Ata janë «të famshmit» parashutistë që Arma e lavdishme e Sigurimit tonë të Shtetit dhe populli shqiptar i ka kapur të gjithë si miu në dhokan dhe u ka dhënë dënimin e merituar. Imperialistët amerikanë dhe satelitët e tyre kanë kujtuar se këta parashutistë, diversantë do ta turbullonin situatën në vendin tonë. Por sa keq ata janë gabuar. Imperialistët amerikanë, anglezë dhe satelitët e tyre si dhe kriminelët shqiptarë, duke hedhur këta parashutistë, kanë kujtuar se do të gjejnë mbështetje në vendin tonë dhe do të krijonin baza për veprime kundër

pushtetit popullor. Por ata janë gabuar rëndë. Populli shqiptar dhe qeveria e tij, nën udhëheqjen e Partisë së tyre heroike, i kanë dërmuar pa asnjë shpresë ringjalljeje të gjitha bazat e reaksionit të brendshëm. Tradhëtarët shqiptarë në mërgim kanë mësuar se çfarë pësuan të gjithë njerëzit e tyre, që tentuan të vepronin kundër pushtetit popullor dhe interesave të popullit. Po ky fat do t'u rezervohet të gjithë atyre kriminelëve, që krerët e tradhëtisë jashtë dhe padronët e tyre do t'i gënjejnë paskëtaj për t'i hedhur në Shqipëri duke u thënë se gjoja populli i pret me lule. Me plumb do t'i presë populli këta tradhëtarë. Imperialistët amerikanë, anglezë dhe satelitët e tyre, veprojnë kundër vendit tonë në një mënyrë aq të poshtër, saqë nuk njihet një praktikë e tillë në mes të shteteve. Aeroplanë amerikanë, anglezë, jugosllavë, grekë, italianë shkelin integritetin e Republikës sonë Popullore. Ata hedhin diversantë dhe fletushka. Imperialistët i kanë në gjak aktet e piratëve. Ata kujtojnë se profkat që shkruajnë në fletushkat dhe në gazetat e tyre që lëshojnë me aeroplanë, bëjnë efekt në popullin tonë. Sa rëndë gabohen. Këto fletushka e shtojnë edhe ca më tepër urrejtjen dhe vigjilencën e popullit tonë kundër piratëve të ajrit dhe tradhëtarëve të jashtëm dhe të brendshëm.

Por akte të tilla piraterie tregojnë dobësinë e madhe të reaksionit të jashtëm dhe të brendshëm, i cili është katandisur «kokoshi një thelë», siç thotë populli ynë.

Reaksioni i jashtëm mendon se në Shqipëri ka njerëz, që mund të bëjnë diçka kundër pushtetit popullor. Le të mësojnë anglo-amerikanët dhe tradhëtarët, se miqtë e tyre brenda në Shqipëri janë bërë si pula të

lagura, që nuk i zë gjëkund vendi dhe në rast se gabohen të lëvizin ndopak bishtin, do të jetë shkak që t'u pritët koka.

Po të njëjtin fat do të pësojnë edhe agjentët e Beogradit. Jugosllavia e Titos është bërë një çerdhe banditësh dhe kriminelësh që mbahen me dollarët e amerikaneve. Grupi nationalist Tito-Rankoviç me shokë jo vetëm po shtypin, gjakosin dhe torturojnë popujt vëllezër të Jugosllavisë, por ushtrojnë një terror të pashembullt mbi vëllezërit shqiptarë të Kosovës, të cilët po i shfarosin në masë, po i internojnë, po i burgosin, po u mbyllin shkollat shqipe duke i zëvendësuar ato me shkolla turqishte dhe përpiqen t'u zhdukin çdo të drejtë demokratike, nacionale dhe sociale.

Titistët, armiq të egër të popullit tonë, pas grushtit që hëngrën me demaskimin e tradhëtisë së tyre dhe pas shporrjes nga vendi ynë, intensifikuan luftën kundër Republikës Popullore të Shqipërisë.

Jugosllavia u bë çerdhe brigandësh të arratisur shqiptarë, të cilët i organizojnë sistematikisht dhe i dërgojnë fshehurazi në vendin tonë për të kryer akte terroriste e sabotazhe, për të krijuar agjentura spionazhi dhe diversioni e për të gënjyer njerëzit e thjeshtë. Në kufitë tanë të Veriut, nuk ka ditë që bandat titiste të mos bëjnë provokacione me armë, të vrasin rojet tona kufitare dhe të shpifin kundër nesh se gjoja u vrasim atyre njerëzit. Këto akte terroriste dhe këto shpifje të poshtra kanë për qëllim të vetëm të krijojnë një psikozë pasigurie rreth popullatave të kufirit të Veriut, të krijojnë psikozën brenda në Jugosllavi se gjoja shqiptarët vrasin jugosllavët dhe në opinionin ndërkombëtar të

tregohen si qengja të persekutuar dhe të shqetësuar nga vendet e demokracisë popullore. Por më kot, asnjë njeri nuk u beson banditëve titistë. Rojet heroike të kufive tanë kurrë nuk provokojnë, por vigjilojnë dhe s'lënë që kufiri ynë të cënohet dhe të shkelet. Bota përparimtare e di tani qartë se çfarë janë sunduesit e Beogradit. Bota e di se Titua dhe grupi i tij nuk janë veçse agjentë të amerikanëve, shtypës dhe xhelatë të popujve të Jugosllavisë dhe provokatorë të mbaruar, që vazhdojnë të provokojnë dhe të përgatitin sulme dhe luftën kundër vendeve të demokracisë popullore. Trockisti Tito, s'mund të maskohet më. Në një konferencë shtypi që ai dha tani së fundi doli qartë nënshtrimi i Jugosllavisë te imperialistët amerikanë; ai pohoi se Jugosllavia po armatoset nga SHBA; gjithashtu dolën lidhjet e ngushta të grupit të Titos me bandën monarko-fashiste greke, xhelatë të popullit grek. Popujt jugosllavë tashmë po shohin se vendi i tyre u bë preja e amerikanëve, se borgjezia është tash në fuqi në Jugosllavi, se UDB-ja bën atje ligjin, se amerikanët janë zotër të vërtetë të pasurive të popujve të Jugosllavisë. Por popujt heroikë të Jugosllavisë nuk do ta durojnë për shumë kohë akoma këtë zgjedhë të tmerrshme të amerikanëve dhe të shërbëtorëve të tyre. Populli shqiptar nuk frikësohet nga kërcënimet e provokacionet dhe nga aktet terroriste të nacionalistëve të Beogradit. Populli shqiptar e di mirë se armiqtë më të tërbuar të tij janë titistët dhe kundër tyre dhe agjentëve të tyre, nën çdo maskë që ata do të fshihen dhe do të përpiqen të veprojnë, ai do të jetë i pamëshirshëm dhe do t'i likuidojë.

Përpara këtyre momenteve të rënda dhe kritike nga

kù kalon njerëzimi, populli shqiptar do t'i shtërngojë radhët e tija rreth Partisë heroike të Punës dhe qeverisë së Republikës Popullore, do të forcojë mbrojtjen e vendit, do të jetë vigjilent dhe kurdoherë i gatshëm. Populli shqiptar do të forcojë unitetin dhe dashurinë për atdheun e tij të shtrenjtë, të cilin e çliroi pas kaq luftërash dhe sakrificash të panumërta. Imperialistët dhe satelitët e tyre tradhëtarë kriminelë lufte shqiptarë, që sot në mërgim përpiqen të dëmtojnë vendin tonë, të gjithë ata kërkojnë dhe luftojnë për të përsëritur 7 prillin 1939. Por 7 prill nuk do të ketë më, pse forcat e popullit shqiptar janë dhjetëfishuar, pse mbrojtja e vendit tonë është e fortë, pse politikisht populli shqiptar është në pararojë dhe taktika e ballistëve, e zogistëve dhe e plehrave të tjera, nuk do të ketë kurrë sukses, sikundër nuk patën sukses gjatë kohës së luftës. Po të njëjtin fat do të kenë edhe manevrat, shantazhet dhe demagogjia e imperialistëve. Populli shqiptar tashmë e ka rrugën të qartë dhe nuk ka forcë që ta lëvizë nga kjo rrugë.

Imperialistët dhe tradhëtarët bërtasin se vendi ynë është i izoluar. Populli ynë sado i rrethuar gjeografikisht nga shtete armiq, nuk është i izoluar politikisht dhe ekonomikisht.

Populli shqiptar ka miq të fortë dhe besnikë: ai ka popujt e Bashkimit Sovjetik dhe Stalinin e madh dhe të lavdishëm, me të cilët është lidhur ngushtësisht. Dashuria dhe besnikëria e popullit tonë për Bashkimin Sovjetik dhe Stalinin e armatos atë me guxim dhe me besim të patundur në të ardhshmen e tij të lumtur.

Nuk mund të jetë kurrë i izoluar populli ynë kur

ai ka fituar dashurinë dhe përkrahjen e vendeve të demokracisë popullore, të popullit të madh dhe heroik kinez dhe të shokut të dashur Mao Ce Dun. Me popullin tonë janë popujt e Italisë, të Francës, të Greqisë dhe popujt e Jugosllavisë. Me ne janë të gjithë popujt e botës. Kjo është një nga fitoret më të mëdha të popullit tonë, i cili sot është në kulmin e gëzimit, kur sheh se në saje të luftës së tij dhe të udhëheqjes së Partisë së tij të Punës, vendi i tij i vogël fitoi dashurinë e popujve të botës dhe zuri vendin e merituar në gjirin e kampit të socializmit dhe të paqes.

Të dashur miq, përfaqësues të partive komuniste dhe punëtoare motra dhe të vendeve miq, sot zemra e popullit tonë është bërë mal, pse në këtë ditë, nga më të shënuarat të historisë së tij, ai ju ka në gjirin e vet. Më lejoni që në emër të popullit shqiptar, të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të Komitetit të saj Qendror t'ju përsëndes nga zemra dhe t'ju falënderoj nxeh-tësisht. Ne jemi të bashkuar si një trup i vetëm.

Popull shqiptar, kauza jonë, fitorja e plotë e socializmit është e drejtë dhe e sigurtë, përpara, pra, kurdoherë përpara, në sulm për ndërtimin e jetës së lumtur, për ndërtimin e socializmit!

Lavdi popullit tonë të mrekullueshëm dhe heroik!

Lavdi Partisë heroike të Punës që çliroi popullin dhe e udhëheq atë në rrugën e ndritur të socializmit!

Lavdi Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Bolshevike të Lenin-Stalinit!

Lavdi të madhit Stalin!

Rrofshin partitë komuniste dhe punëtoare motra të

vendeve të demokracisë popullore dhe të të gjitha vendeve të tjera të botës!

Rroftë dhe u forcoftë kampi i fuqishëm i paqes!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 269 (963), 9 nëntor 1951

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PA PËRMIRËSUAR METODËN E PUNËS NUK MUND TË NDREQEN GABIMET

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

15 nëntor 1951

Byroja Politike nuk është shumë e kënaqur nga puna e byrosë së Komitetit të Partisë të rrethit të Vlorës, nga puna e sekretarit të parë të tij si dhe nga aparati i Komitetit Qendror të Partisë. Prandaj kjo analizë duhet të shërbejë jo vetëm për rrethin e Vlorës, po edhe për ne të Komitetit Qendror.

Dobësitë e punës politike në rrethin tuaj, shokë të Vlorës, nuk janë të lejueshme, prandaj ato duhet t'i kuptoni e t'i vlerësoni si çështje mjaft serioze, të ndreqni gabimet që janë vërtetuar dhe të fitoni kohën e humbur. Duke pasë parasysh ngritjen dhe eksperiencën tuaj, lëshimet që vihen re në atë rreth, janë të pajustificueshme, pse ju nuk jeni njerëz me nivel të ulët politik, as

¹ Në këtë mbledhje u analizua puna e Komitetit të Partisë të rrethit të Vlorës në bazë të raporteve paraqitur nga byroja e këtij komiteti dhe nga një ekip i KQ të PPSH.

shokë të rinj në drejtimin e punës politike të Partisë. Për këtë arsëye përgjegjësia juaj bëhet më e rëndë, sepse punoni në një rreth ku terreni është shumë i shëndoshë. Drejtuesit e Partisë nuk lejohen që të neglizhojnë asnjë krahinë ose fshat, përkundrazi ata duhet të ndihmojnë organizatat bazë kudo, që ato të vihen plotësisht në krye të situatës. Gjithashtu nuk është e lejueshme të lihet pas dore qoftë dhe ndonjë zonë, që ka qenë e tëra me Partinë, sepse, po s'punuam ne, atje mund të punojë armiku.

Popullin duhet me e mbajtë në korrent për çdo gjë e me e goditë armikun në çdo rast, pse po të mos bëhet kështu, zbatimi i politikës së Partisë do të hasë në vështirësi dhe kjo gjë nuk mund të bëhet nga lart, po duhet të punoni në radhë të parë ju. Në rast se drejtuesit kanë parasysh vijën e Partisë, mbajnë në duar drejtimin e të gjitha organizatave, vetëvetiu ata do të jenë në korrent të situatës, të dobësive dhe do të marrin masat sipas rastit. Dobësitë që vihen re në Vlorë rrjedhin sepse drejtuesit e Partisë atje nuk kanë qenë në krye të punës, nuk kanë ndihmuar bazën dhe nuk janë lidhur ngushtë me të. Kjo do të forconte punën politike dhe do t'i evitonte gabimet. Këtëj rrjedhin edhe lëshimet tuaja herë nga e majta dhe herë nga e djathta, siç ka ndodhur në luftën kundër kulakëve. Për këtë çështje Komiteti Qendror ka bërë letra, ku përcaktohet qartë vija e Partisë. Drejtuesit këto duhet t'i kishin përtypur mirë për vete dhe pastaj të punonin që t'i kuptonin të gjithë komunistët, për të qenë në gjendje si të luftojnë. Por ne konstatojmë një dobësi të tillë edhe në disa rrethe të tjera, ku nuk dallohen problemet kryesore nga ato të dorës së dytë. Gabime të tilla bëhen edhe këtu, në Komitetin

Qendror ku, nganjëherë, ne tërhiqemi nga rryma dhe harrojmë çështjet kryesore që do të na japin zgjidhjen e të gjitha problemeve. Prandaj duhet treguar kujdes në këtë drejtim, për shembull në qoftë se Partia thotë që kulakët të kufizohen ekonomikisht, kështu duhet bërë, ndryshe do të biem në oportunitizëm ose në ekstremizëm, të cilët, si njeri dhe tjetri, janë të dëmshëm.

Në Vlorë janë bërë gabime edhe në lidhje me shpërndarjen e kartave të Frontit që duhet të ndreqen sa më parë, pse kjo është një çështje politike dhe Komiteti Qendror ua ka sinjalizuar shumë herë. Gabime të tilla po bëhen edhe në rrethe të tjera, ku vihet re një gjykim i ngushtë pa marrë parasysh momentin nacional dhe rrethimin e armikut. Detyra e Frontit është të grumbullojë popullin rreth vijës së Partisë. Armiqve të deklaruar të popullit tonë nuk mund t'ua japim kartën e Frontit, por ata që kanë qenë të lëkundshëm dhe që sot nuk na luftojnë, nuk humbasim gjë po t'i futim në këtë organizatë, ndryshe ne i japim forca armikut. Duhet të kemi parasysh se këta njerëz nuk i futim në Parti, as do t'u japim drejtimin e shtetit. Kur një njeri i tillë, nuk hedh parulla dhe vjen vullnetar për të punuar, pse të mos i jepet karta e Frontit? Kjo nuk mund t'i shërbejë atij si një maskë për të mbuluar veprimtarinë e tij armiqësore, në qoftë se ai do të mundohet ta bëjë këtë, pse edhe po të dojë ta bëjë këtë, një ditë do të zbulohet patjetër. Edhe me taserën e Partisë, sikur të jetë i maskuar armiku, një gjë e tillë përsëri do të zbulohet. Pra, karta e Frontit nuk mund ta shpëtojë atë që ruan qëllime armiqësore.

Ka shumë njerëz që duan të rehabilitohen, kurse

nga shokët tanë nuk u jepet kjo mundësi, duke rënë kështu në sektarizëm, i cili është i dëmshëm. Prandaj Partia duhet të tregojë më shumë zgjuarësi në këtë drejtim dhe të ndreqen shtrembërimet. Komunistët duhet të jenë konsekuentë në vijën e Partisë në lidhje me Frontin. Ne i dhamë taserën e Partisë një personi që kishte rënë në pozita të trockistëve jugosllavë, por pasi bëri autokritikë, Partia i krijoi atij mundësi të ndreqet. Aq më tepër duhet të jemi të gjerë në çështje të Frontit, prandaj të mos konsiderohet armik ai që nuk na dëmton. Në Vlorë ka një terren me një brumë shumë të mirë. Populli i atij rrethi është mjaft i ngritur politikisht dhe i ndërgjegjshëm për vijën e Partisë. Po të përmirësohet dhe të forcohet më shumë puna e Partisë, do të ketë me siguri më shumë suksese. Prandaj, që Partia ta ketë Vlorën kurdoherë një grusht të fortë kundër armikut, ju, shokë drejtues të Partisë në Vlorë, të mos ju zërë gjumi. Ju duhet t'ju shqetësojë fakti sa dëm të madh i sjellin Partisë gabimet e neglizhencat tuaja. Ju keni mundësi që ta forconi më tej gjendjen atje, vetëm se duhet të punoni më mirë.

Byroja Politike ju rekomandon t'i vini rëndësi çështjes së forcimit të punës së Partisë në Himarë, pse atje ka organizata bazë që kanë nivel të ulët, aq sa bien edhe nën influencën e armikut, duke pranuar të marrin nga kulaku toka dhe ullinj. Një veprim i tillë e diskrediton Partinë. Prandaj të mos ngjasin më gjëra të tilla. Gjithashtu zgjidhja e çështjes së bukës në Himarë është bërë problem¹. Kjo gjë nuk duhet të ndodhë as në Himarë

¹ Çrregullimet në furnizimin e Himarës me bukë vinin, në

dhe as në qytetet e tjera, pse propaganda e armikut nuk luftohet vetëm me fjalë.

Unë jam dakord me atë që u ngrit këtu se zëri i bazës duhet dëgjuar me kujdes. Rregullat tona u japin të drejtë shokëve të Partisë që të thonë mendimin e tyre dhe këtë ne duhet ta zbatojmë. Ndryshe Partia nuk mund të korrigjojë gabimet e veta dhe të ecë si duhet përpara. Ne duhet të mbështetemi në punën e komisioneve që krijojmë, por ata të formohen me njerëz të mirë e të ndërgjegjshëm dhe të kryejnë si duhet detyrat. Të gjithë të mbështetemi në punën e komiteteve të Partisë dhe të komiteteve ekzekutive poshtë, ndryshe veprimet e secilit nuk do të jenë të plota. Partia është ajo që mban gjithë peshën në supet e veta, prandaj të vlerësohen propozimet e saj. Nuk duhet vetëm t'i nxitim shokët në bazë, por edhe t'i ndihmojmë që t'i kryejnë mirë detyrat. Këtu ka përgjegjësi edhe Komiteti Qendror që nuk u ka dhënë ndihmën e plotë rretheve.

Ku qëndrojnë gabimet tona? Ne po zbatojmë një praktikë të gabuar në lidhje me ekipet që dërgojmë në rrethe, sepse ato nuk organizohen e nuk shkojnë në momentin kur shokët poshtë kanë më shumë vështirësi. Nuk është arritur akoma që kur rrethi nuk i zgjidh dot problemet, t'u shkojë menjëherë instruktori i Komitetit Qendror. Por duhet të kemi parasysh se edhe instruktorët e Komitetit Qendror, në shumicën e tyre janë shokë që nuk mund t'i barazojmë me sekretarët e parë.

fakt, jo nga mungesa e drithit, por si rrjedhim i mosrealizimit në kohë të plandetyrimit të ullirit dhe të agrumeve.

Nga se vjen kjo? Kjo vjen se Partia jonë është e re, megjithatë na vihet si detyrë që t'i ngremë këta quadro me qëllim që të ndihmojnë edhe më mirë sekretarët e parë, të cilët drejtojnë Partinë në rreth. Në këtë mënyrë instruktorët do të jenë me të vërtetë njerëz me eksperiencë, që do të gjejnë më me lehtësi ku janë dobësitë për të dhënë ndihmën e duhur. Megjithatë instruktorët e Komitetit Qendror nuk duhet të nisen nga mendimi se janë të plotfuqishëm, por të bashkëpunojnë ngushtë me sekretarët e parë të komiteteve të Partisë në rrethe, të cilët janë patjetër në gjendje të kuptojnë funksionin e instruktorëve dhe nga i marrin detyrat ata. Si ju edhe ne, të ruhem nga formalizmi. Kur shkojnë poshtë instruktorët e Komitetit Qendror, sekretarët e parë të mos mbeten në zyra, por të shkojnë edhe ata së bashku në organizatat bazë, në qendrat e prodhimit, në fusha etj. dhe atje të shikojnë si zbatohen udhëzimet, metodat dhe format e punës. Ndryshe nuk mund të ecet si duhet përpara.

Kryesorja është që shokët drejtues të shkëputen nga punët burokratike, ata duhet të venë më shumë në terren, pse atje punon dhe edukohet kuadri. Nuk do të lejojmë më që të mbetemi në zyra, pse kështu veç të tjerave, nuk njohim as njerëzit, por vërtitemi rreth pak kuadrove. Ndërtimet e mëdha që bëhen te ne, po na nxjerrin njerëz të zot dhe të vlefshëm. Në qoftë se të nevojitet një drejtor fabrike, mos e kërko në zyrë, por në prodhim, prandaj edhe instruktori i Komitetit Qendror atje të shkojë, të shohë dhe të marrë eksperiencë, të marrë pjesë në mbledhjen e organizatës bazë të Partisë. Kështu do të njihen më mirë kuadrot. Këtë

gjë duhet t'ua futim në gjak të gjithë kuadrove. Kjo është puna e Partisë dhe jo gjithnjë punë zyre. Duhet medoemos që ta zbatojmë këtë gjë.

Edhe dobësitë në sektorin ekonomik rrjedhin nga drejtimi juaj i dobët. Ju duhet t'u vini rëndësi çështjeve ekonomike. Lenini na mëson se puna e Partisë nuk është vetëm të bëjë mbledhje, por të luftojë për të përmirësuar vazhdimisht jetën e popullit. Në rast se mendoni se punën e Partisë e keni bërë vetëm duke bërë mbledhjet e organizatës, atëhere nuk keni bërë gjë dhe nuk e keni udhëhequr Partinë në çështjet ekonomike. Gjendja ekonomike e dobët e popullit tregon se edhe Partia është e dobët.

Sekretari i parë i komitetit të Partisë në rreth duhet të jetë plotësisht në korrent të situatës ekonomike, politike dhe sociale të rrethit, ai duhet të jetë në dijeni të problemeve, të shkollave e kurseve dhe deri në kooperativat bujqësore, bile jo vetëm të njohë nga ana organizative, po dhe nga ajo ekonomike. Ai duhet të dijë se ku janë dobësitë dhe ç'duhet të bëjë Partia për forcimin e gjendjes ekonomike. Nga ana tjetër ju duhet të merrni masat që kooperativat bujqësore dhe fermat të mos jenë në një situatë të tillë siç janë tani. Kur ju t'u keni dhënë atyre kredi, kafshë etj., nuk ka vend që shteti t'u japë edhe bukë, me përjashtim të ndonjë rasti fatkeqësie. Në qoftë se kooperativat nuk do të prodhojnë vetë gjithë sasinë e bukës që u duhet, ky do të ishte një gabim i rëndë. Ato duhet të jenë pararojë në prodhim. Fermat akoma ca më tepër. Prandaj të luftohet me këmbëngulje që këto të bëhen shembull dhe ne kemi mjaft prova që tregojnë se atje ku punohet

mirë, janë kapërcyer edhe vështirësitë. Ne i kemi të gjitha mundësitë që, duke luftuar kundër dobësive dhe neglizhencave, planin pesëvjeçar ta realizojmë dhe ta tejkalojmë; do të ishte skandaloze po të vazhdojë puna kështu, me deficite, pse ato që i themi popullit se do t'ja japim, ne duhet t'ja japim medoemos. Prandaj të luftojmë kundër dobësive, neglizhencave, vjedhjeve, abuzimeve etj.

Përsa i përket çështjes së pushtetit dhe rolit drejtues të Partisë, këtë e kemi shtruar shumë herë. Kësaj duhet t'i kushtoni një rëndësi jashtzakonisht të madhe. Ju duhet të bëni që pushteti t'i kryejë si duhet të gjitha funksionet e tij dhe Partia ta udhëheqë atë. Kryetari i komitetit ekzekutiv ka plot kompetenca. Ai e drejton pushtetin, po mbi të është Partia, nga e cila ai duhet të udhëhiqet. Por duhet të mbahet mirë parasysh roli drejtues i Partisë, e cila duhet të kontrollojë e të ndihmojë dhe jo t'i bëjë vetë ato punë që, sipas vendimeve e direktivave të Partisë, në praktikë i takojnë t'i kryejnë vetë organet e pushtetit. Sekretari i parë duhet t'i ndodhet pranë kryetarit të pushtetit, ta ndihmojë e ta udhëzojë atë, por nga ana tjetër duhet edhe Partinë ta mobilizojë për problemet e pushtetit. Pastaj nuk duhen marrë kompetencat e pushtetit, pse ndryshe nuk bëhet dot as puna e pushtetit dhe as puna e Partisë.

Të vijmë tani te çështja e Partisë. Ajo kalitet në luftë nëpërmjet një kritike dhe autokritike bolshevike, por nga kjo ne jemi akoma larg. Në rast se nuk e bëjmë Partinë tonë luftarake, të aftë që të kuptojë detyrat dhe të luftojë të metat dhe dobësitë me anën e kritikës, do ta kemi gjithnjë të dobët. Ne kemi brumë shumë të

mirë, por e meta qëndron në organet udhëheqëse të saj, të cilat akoma nuk dalin si duhet përpara masës së Partisë me autokritikë dhe kritikë të shëndoshë. Kjo gjë duhet bërë më mirë që këtej nga ne dhe deri në organizatën bazë. Ne po shikojmë se rregullat 'që ka caktuar Komiteti Qendror, nuk po zbatohen sa duhet. Për shembull, ju keni kontrolluar disa organizata bazë, por forma të tjera ku Partia edukohet dhe çelnikohet, nuk zbatohen. Mbledhjet e rregullta me sekretarët e organizatave bazë, nuk ndiqen nga udhëheqja, këto mbledhje nuk bëhen rregullisht në të gjitha rrethet. Organizatat bazë janë të lidhura drejtpërdrejt me komitetin e Partisë. Megjithkëtë, në rast se nuk bëhen mbledhje çdo muaj me sekretarët e organizatave bazë, ku të ngrihen problemet e kohës, të edukohen e t'u jepen atyre detyra dhe t'u kërkohet llogari për zbatimin e tyre, nuk mund të forcohet Partia. Në mbledhjen e sekretarëve të organizatave bazë duhet të marrin pjesë në radhë të parë sekretarët e parë të komiteve të Partisë dhe këto mbledhje të bëhen në mënyrë të organizuar e të përgatitura mirë që përpara. Referati që do të mbahet në këto mbledhje qoftë për çështje politike, organizative ose ekonomike, duhet të aprovohet në byro të komitetit të Partisë. Në mbledhje duhet të bëhen pyetje, diskutime e kritika për byronë e rrethit, për komitetin e Partisë, për sekretarin e parë.

Edhe procesverbalet, që vijnë nga organizatat bazë, nuk studjohen në rregull dhe nuk nxirren prej tyre detyra e të merren masa për të përmbushur nevojat e shokëve të bazës. Atëhere, si mund të forcohet Partia? Si mund të forcohet kritika dhe autokritika? Pra, kjo

çështje është neglizhuar, gjë që nuk duhet lejuar në asnjë mënyrë. Prandaj të hartohet një plan pune dhe këto detyra të kryhen në rregull.

Akoma më e rëndësishme është çështja e aktiveve të Partisë. Nuk duhet të pritni që t'ju thotë Komiteti Qendror dhe pastaj t'i zhvillonin në rregull këto aktive. Këto mbledhje shumë të rëndësishme të Partisë, siç janë aktivet, duhet të organizohen një herë në tre muaj. Komiteti i Partisë të vendosë shumë më përpara se ç'probleme do të shtrojë, sigurisht ato më të rëndësishmet dhe ato për të cilat ka nevojë më shumë organizata e rrethit. Raporti që do të mbahet në aktiv duhet të jetë serioz dhe për dy-tri probleme të caktuara; ai nuk duhet të jetë vetëm për çështje të grumbullimit, por të trajtojë edhe probleme të tjera, deri te ato të drejtësisë popullore. Veç kësaj, udhëheqja e Partisë të mos i fshehë gabimet e saj në këto aktive, por të inkurajojë kritikën dhe autokritikën. Në Parti të vlejë kritika dhe autokritika. Edhe po të jetë druri pak më i ashpër, nga sa duhet, kjo nuk na bën keq, po na bën mirë. Shpifjet të luftohen.

Duhet të kuptohet mirë se të gjithë ju jeni përgjegjës, ju përpara byrosë e komitetit të Partisë dhe ne përpara Komitetit Qendror. Të mos shkohet nga parimi se «unë jam sekretar i parë dhe mund t'ja kapërcej byrosë». Në një rast të tillë duhet të ziej kritika. Në Komitetin Qendror ka filluar që njerëzit të kritikohen, megjithëse kjo armë është akoma e dobët. Edhe konsultimet me njëri-tjetrin kanë filluar të bëhen më shumë. Ne konsultohemi me shokët, pse të gjithë veç e veç jemi përgjegjës përpara Byrosë Politike për de-

tyrat që ajo na ngarkon. Në byro, secili duhet të vijë me detyra të kryera, por kjo gjë nuk bëhet akoma si duhet. Në vend që të vijmë përpara byrosë dhe të themi se «vendimin e kam realizuar» ose «për zbatimin e tij gjej këto vështirësi», ka shokë që vijnë me justifikime. Vendimi duhet medoemos të zbatohet dhe secili, kur të vijë në byro, të japë llogari dhe të mos nxjerrë njëqind avaze. Prandaj të kuptohet mirë përgjegjësia kolegjiale e udhëheqjes së Partisë dhe secili veç e veç në byro të marrë përgjegjësinë e tij; mbledhjet të bëhen në rregull dhe atje të jepet llogari me ndërjegje; kur byroja has në vështirësi, të thërresë mbledhjen e plenumit të komitetit të Partisë dhe të kërkojë ndihmën e tij. Shokët përgjegjës të konsultohen me njëri-tjetrin dhe të luftojnë për kapërcimin e pengesave e të vështirësive. Në këtë mënyrë duhet luftuar për bolshevizimin e Partisë dhe për kryerjen e plotë të detyrave.

Ju këtu folët dhe ne konstatuam se jeni në gjendje t'i likuidoni këto të meta dhe kuraja nuk ju mungon, pse ju kritikuat edhe qeverinë, edhe Byronë Politike. Kjo është në rregull se edhe ne jemi njerëz dhe bëjmë gabime. Nuk duhet me u justifikue me natyrën e butë, pse natyra ndryshohet. Kur shoku gabon ose kur nuk e kryen detyrën, kur nuk mobilizohet në punë, atëhere kritikoje ashpër dhe haptas, se kështu nuk do të përsëriten më gabimet dhe në qoftë se ato do të përsëriten, atëhere të merren edhe masa ndaj fajtorëve. Kjo frymë duhet të vendoset në komitetet e Partisë që të zhduken të metat.

Edhe me rininë, ju, shokë të Vlorës, nuk keni punuar mirë. Rinia është e ardhshmja e vendit tonë, është

krahu i djathtë i Partisë. Si është e mundur që të zhvillohet plenumi i rinisë dhe të mos shkojë sekretari i parë i Partisë ose të mos lexojë as rezolucionin? Kjo është një neglizhencë e dënueshme për një sekretar të parë edhe për shokët e tjerë të byrosë. Gjëra të tilla nuk duhet të ndodhin, pse rinia është rezervë e madhe për Partinë, prandaj shokët udhëheqës duhet të interesohen veçanërisht për të, për edukimin dhe dëfrimin e saj. Të mos ju bëhet mendja grumbullim nga të katër anët, por të forconi të gjithë sektorët, pse problemet janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Syri juaj duhet të shikojë mbi të gjitha problemet, të cilat nuk do t'i zgjidhni vetë, por ju si udhëheqje të kërkonin ndihmën e të gjithë Partisë dhe të popullit. Prandaj anëtarët e Partisë të futen më shumë në masat e gjëra.

Ju i kuptoni gabimet tuaja të rënda, bile shumë të rrezikshme. Për këto arsye Byroja Politike vendosi t'u tërheqë vërejtje me shënim në kartën e regjistrimit gjithë anëtarëve të byrosë së Komitetit të Partisë të rrethit të Vlorës për drejtim të dobët dhe gabime që janë vërtetuar. Kur të bëhet konferenca e rrethit, duhet të dilni me autokritikë të shëndoshë, t'i thoni Partisë gabimet dhe të metat tuaja dhe të premtoni përpara saj si komunistë që jeni, se këto të meta do t'i pastroni. Kjo do të jetë shumë pozitive, pse nga kjo do të mësojnë edhe organizatat e Partisë. Një pjesë të këtyre gabimeve duhet me i likuidue sa më parë. Tani, me të shkuar në Vlorë, t'i shtroni me forcë këto çështje dhe të ndreqni situatën, t'i ndihmoni shokët në mënyrë aktive që të kryejnë mirë detyrat që u ngarkohen.

Ne kemi bindje se Komiteti i Partisë i Vlorës dhe

Ju do t'i ndreqni këto gabime, duke njohur më parë rëndësinë e tyre. Ne kemi besim se organizata e Partisë në Vlorë është shumë luftarake, ashtu siç është populli i asaj krahine. Ju e keni organizatën shumë të gjerë, keni organizata bazë gati në çdo fshat. Ju keni të fortë edhe aktivin. Prandaj, përmirësojeni situatën sa më shpejt, por kjo s'mund të bëhet pa mos përmirësuar metodën tuaj të punës.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TË FORCOJME MË SHUMË PUNËN NË ORGANET E SIGURIMIT TË SHTETIT

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH*

15 nëntor 1951

Pa u zgjatur dëshiroj të flas për disa masa që duhen marrë për forcimin e mëtejshëm të situatës sonë të brendshme, në lidhje me ashpërsimin e luftës kundër armiqve tanë. Jam dakord me raportin që u paraqit këtu nga shokët e Ministrisë së Punëve të Brendshme, i cili është i qartë dhe na jep një pasqyrë të mirë të situatës së brendshme dhe të jashtme të vendit tonë, të sukseseve dhe të metave tona në luftën kundër armiqve.

Çështja e mbrojtjes së vendit ka një rëndësi shumë të madhe. Arma e Sigurimit të Shtetit është ngarkuar për të zbuluar punën armiqësore, përpara se ajo të na dëmtojë. Për të kryer këtë detyrë kërkohet që të forcohet vigjilenca revolucionare dhe disiplina në punë jo vetëm në organet e sigurimit, po edhe në të gjithë Partinë, për të qenë të ashpër kudo që konstatohet një punë armiqësore.

Detyrat nga ana e sigurimit, me sa shohim ne, nuk kryhen keq, në luftën kundër armiqve kemi rezultate. Kjo tregon se shokët e sigurimit janë mobilizuar mirë në punë, kanë forcuar aparatet e tyre, kanë forcuar dhe mprehur vigjilencën.

Natyra e punës në këtë sektor është e shumanshme, shokët e kanë të qartë dhe kanë fituar eksperiencë në këtë drejtim. Por Partia duhet ta ndihmojë më tepër Armën e Sigurimit me elementë që, në radhë të parë, të jenë besnikë, me njerëz të shtresave të varfëra, pse sigurimi është një armë speciale dhe shumë delikate, është një armë e dashur për popullin dhe e tmerrshme për armiqët. Kjo armë do të forcohet edhe më shumë në qoftë se Partia do ta ndihmojë kurdoherë me kadro të mirë, besnikë dhe të aftë. Kadro të tillë edhe i janë dhënë dhe s'i janë dhënë sigurimit, megjithëse i ka kërkuar. Prandaj të gjithë ne e veçanërisht shokët që drejtojnë aparatet e Partisë në rrethe, duhet ta kenë shumë parasysh këtë detyrë. Ne jemi në dijeni të nevojës së madhe që ka sigurimi për kadro, natyrisht, jo aq në detaje sa janë shokët e sigurimit, të cilët i preokupon shumë mungesa e kadrove dhe mosplotësimi i organikave. Kjo shtrun detyrën para nesh dhe shokëve në rrethe që t'ja sigurojmë këta kadro. Si të sigurohen kadrot e nevojshëm, drejtuesit e këtij sektori kanë për detyrë që me anë të kurseve dhe të shkollave, t'i perfeksionojnë ata në punë.

Partia duhet të punojë edhe në një drejtim tjetër, në atë të rritjes së besimit dhe të autoritetit të punonjësve të sigurimit. Siç dihet armiku synon shumë që

ta diskreditojë këtë armë në dorë të klasës punëtore. Ai, për të dobësuar vigjilencën e masave punonjëse, përpiqet që sigurimit t'i japë një ngjyrë tjetër duke u munduar ta paraqesë në popull atë si një gjë të tmerrshme. Prandaj, detyra e Partisë është që të edukojë në masat punonjëse dashurinë dhe besimin për punonjësit e sigurimit dhe ato ta përkrahin këtë armë dhe të kenë respekt për njerëzit e saj. Këtë gjë Partia duhet ta bëjë jo vetëm me propagandë, por edhe me fakte konkrete, me ndihmë sigurimin që vetë masat e popullit të vigjilojnë e të mësohen të informojnë kudo këto organe. Nuk duhet të ngjasë si me një anëtar partie, që për një informatë ngrihet që nga kufiri e vjen ta thotë në Shkodër. Si duket, ky komunist nuk e sheh sigurimin ashtu si duhet, derisa nuk ua thotë këtë informatë organeve të sigurimit në kufi, atje ku ai punon e jeton. Këtë anë duhet t'ja theksojmë veçanërisht Partisë që ajo të edukojë masat me besimin më të madh në punonjësit e Sigurimit të Shtetit kudo që janë.

Detyrën që ka Partia për të luftuar armikun, më duket se duhet ta kryejë më mirë. Në rast se Partia nuk do të bëjë një politikë të drejtë përse u përket kulakëve, telashet e sigurimit do të shtohen, pse, po s'u bë mirë kjo detyrë nga Partia, armiku do të punojë për të shtuar radhët e tija me elementë që janë të predispozuar të bëhen kontingjent i tij. Në qoftë se njerëzit nuk do të kryejnë si duhet detyrat që u ngarkon Partia për zbatimin e direktivave të saja, armiku ata do t'i vërë në shenjë dhe do të përpiqet t'i bëjë për vete, pse ai këto raste shfrytëzon. Por sa më shumë të bëjë për vete

armiku, aq më tepër vështirësohet puna e sigurimit. Një punë më e shëndoshë e Partisë do të evitojë shumë dëme, shumë njerëz nuk do të mund t'i hedhë dot në dorë armiku, do të forcohet situata e brendshme në vendin tonë dhe atëhere sigurimi do të jetë më i lirë të punojë në drejtime të tjera, sidomos në drejtim të luftës kundër armikut të jashtëm. Prandaj duhet ta marrim seriozisht çështjen e forcimit të situatës së brendshme, të mbajmë vazhdimisht të ngritur luftën kundër armiqve. Partia të jetë vigjilente dhe të luftojë si kundër oportunitizmit, ashtu edhe kundër sektarizmit, pse kështu do të evitohen situatat e vështira që armiku mundohet të kurdisë. Diversantët që janë hedhur në vendin tonë, përbëjnë një rrezik, po ne kemi pasur suksese në kapjen dhe në asgjësimin e tyre, pse me ndihmën e përkrahjen që i ka dhënë populli sigurimit, diversantët nuk kanë gjetur e nuk do të gjejnë kurrë shteg të kalojnë dhe as të zënë baza në vendin tonë.

· Armiku kërkon të shfrytëzojë në favor të tij edhe ndonjë vështirësi ekonomike dhe, duke u nisur nga kjo, ai nxit arratisjet. Këtë problem ne duhet ta shtrojmë me forcë, sidomos në zonat kufitare dhe jo vetëm të bëjmë propagandë, por të marrim edhe masa konkrete për një furnizim më të mirë në ato zona. Të jepet urdhër që në zonat kufitare të dërgohet rregullisht kripa, mielli, vaji i gurit etj. dhe kjo neve nuk na kushton. Kjo masë të merret nga ana shtetërore, ndërsa nga ana e Partisë të tregohet kujdesi më i madh që këto furnizime të ndahen në rregull dhe të shoqërohen me një propagandë të dendur kundër armiqve. Puna e organeve të sigurimit do të lehtësohet më shumë

në qoftë se Partia intensifikon më tepër propagandën si përbrenda vendit, ashtu edhe përjashta kundër armiqve.

Kjo propagandë duhet intensifikuar me anë të emisioneve radiofonike, duke vënë në dukje në radhë të parë sukseset e vendit tonë. Propaganda kundër shpifjeve dhe informatave false që japin armiqtë ndaj Shqipërisë mund të bëhet fare mirë jo vetëm me anë të radios, por edhe me anë të shtypit tonë. Në shtyp kjo mund të bëhet me anën e artikujve që duhen botuar herë pas here që edhe populli të shohë falsitetin e fjalëve të armiqve të jashtëm. Artikuj të tillë do të influencojnë shumë, sidomos, te ata që janë të lëkundur. Armiqtë e jashtëm thonë për shembull, se «në Shqipëri fabrikat që ndërtohen do të prodhojnë armë», në rast se kjo do të demaskohej me fakte nga shtypi ynë, në përgjegje të shpifjeve të armiqve, patjetër edhe ai që është i lëkundur, do të mendojë e do të thotë: «sa të poshtër janë armiqtë që japin lajme të tilla shpifëse, në kundërshtim me realitetin».

Për intensifikimin e mëtejshëm të propagandës sonë është mirë që të organizohet si duhet shpërndarja e shtypit tonë për jashtë shtetit. Fakti është se në këtë drejtim ne s'kemi bërë një punë të organizuar, po e kemi lënë sa mund të bëjë Ministria e Jashtme dhe kjo nuk është kontrolluar vazhdimisht nga ana jonë. Kjo gjë duhet bërë patjetër. Opinioni i shqiptarëve jashtë ka nevojë të sqarohet, me qëllim që armiqtë të mos mundin dot të rekrutojnë për agjentë njerëz prej tyre. Kjo ka rëndësi të madhe. Krahas kësaj është edhe çështja që në vetë radhët e armiqve tanë, me propa-

gandën tonë të drejtë, të futim çorientim dhe konfuzion. Një propagandë e organizuar mirë, do të sjellë fitore të reja.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

**TELEGRAM URIMI DËRGUAR SHOKUT
KLEMENT GOTVALD ME RASTIN E 55-VJETORIT
TË DITËLINDJES**

23 nëntor 1951

**SHOKUT KLEMENT GOTVALD
PRESIDENT I PARTISË KOMUNISTE
TË ÇEKOSLLOVAKISË**

Pragë

Me rastin e 55-vjetorit të ditëlindjes Suaj më lejoni t'Ju dërgoj përshëndetjet më të përzemërta të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të miat personale. Me këtë rast, Ju urojmë nga zemra shëndet të plotë dhe jetë të gjatë për të mirën e popullit çekoslovak, i cili nën udhëheqjen Tuaj lufton e punon për mbrojtjen e paqes dhe për ndërtimin e socializmit. Populli shqiptar shikon në Ju, shoku Gotvald, një mik të dashur e të sigurtë që nuk keni kursyer asgjë për forcimin përherë e më tepër të miqësisë midis popullit shqiptar dhe popullit vëlla çekoslovak, miqësi e cila u bë e mundur në saje

të çliruesit, përkrahësit dhe mësuesit tonë të përbashkët,
Bashkimit Sovjetik dhe Stalinit të madh.

Për Komitetin Qendror të Partisë
së Punës të Shqipërisë
Sekretari i Përgjithshëm

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 282 (976), 23 nëntor 1951*

*Botohet sipas tekstit të gazetës:
«Zëri i Popullit», Nr. 282 (976),
23 nëntor 1951*

L È N D A

PARATHËNJE PËR VËLLIMIN 8	V—VII
---------------------------------	-------

1951

DISA ÇËSHTJE PËR PUNËN ME KUADRIN Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (12 janar 1951)	1—4
TELEGRAM URIMI DËRGUAR SHOKUT VILHELM PIK ME RASTIN E 75-VJETORIT TË DITËLINDJES	5—6
TELEGRAM PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR KQ TË PK ITALIANE ME RASTIN E 30-VJETORIT TË FORMIMIT TË SAJ (21 janar 1951)	7—8
TË NJOHIM MIRË GABIMET DHE TË METAT NË REALIZIMIN E PLANIT DYVJEÇAR QË ATO TË MOS PËRSËRITEN NË PLANET E ARDHSHME Nga diskutimi në mbledhjen e Qeverisë së RPSH (22 janar 1951)	9—16
MBI PËRMIRËSIMIN E MËTEJSHËM TË GJENDJES EKONOMIKE NË FSHAT — Nga diskutimi në mble- dhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (16 shkurt 1951)	17—22
RAPORT «MBI GJENDJEN POLITIKE DHE PUNËN E PARTISË» — Mbajtur në Plenumin IX të KQ të PPSH (19 shkurt 1951)	23—99
I. MBI GJENDJEN E JASHTME POLITIKE ..	23—42

II. MBI GJENDJEN E BRENDSHMË TË VENDIT	43—54
III. TË PËRMIRËSOJMË METODËN E UDHË- HEQJES POLITIKE E ORGANIZATIVE TË PARTISË	55—59
1. ROLI DREJTUES I KOMITËTIT QENDROR DHE LËSHIMET QË JANË VERTETUAR NË KETË DREJTIM	60
2. SI KA DREJTUAR DHE SI KA KONTROLLUAR BYROJA POLITIKE ZBATIMIN E DËTYRAVE TË SAJA	71
3. DËMET QË I KANË SJELLË KËTO GABIME PARTISË NË BAZE DHE MASAT PËR EVITIMIN E TYRE	82
KONKLUZIONE DHE VËREJTJE RRETH DISA DIS- KUTIMEVE NË LIDHJE ME RAPORTIN «MBI GJENDJEN POLITIKE DHE PUNËN E PARTISË» (20 shkurt 1951)	100—116
KONKLUZIONE NË LIDHJE ME RAPORTIN E MBAJTUR NË PLENUMIN IX TË KQ TË PPSH «MBI REALIZIMIN E PLANIT DYVJEÇAR» DHE DISKU- TIMET QË U ZHVILLUAN RRETH TIJ (21 shkurt 1951)	117—131
RAPORT «MBI GABIMET DHE TË METAT E TUK JAKOVËS» — I mbajtur në Plenumin IX të KQ të PPSH (21 shkurt 1951)	132—153
KONKLUZIONE MBI DISKUTIMET QË U ZHVI- LLUAN RRETH RAPORTIT «MBI GABIMET DHE TË METAT E TUK JAKOVËS» (23 shkurt 1951)	154—167
FJALIM NË KONFERENCËN E PARË NACIONALE TË SULMUESVE DHE TË NOVATORËVE (2 mars 1951)	168—193
TELEGRAM PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR KQ TË PP RUMUNE ME RASTIN E 30-VJETORIT TË THEMELIMIT TË SAJ (10 maj 1951)	194—195
NGA FJALA NË PLENUMIN E JASHTËZAKONSHËM TË KOMITËTIT QENDROR TË PPSH (14 maj 1951)	196—206

TELEGRAM PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR KQ TË PK ÇEKOSLLOVAKE ME RASTIN E 30-VJETORIT TË FORMIMIT TË SAJ (15 maj 1951)	207—208
MINISTRITË TË INTERESOHEN MË SHUMË PËR PLANIFIKIMIN E DREJTË TË INVESTIMEVE Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (17 maj 1951)	209—212
SHËNIME RRETH STUDIMIT «MBI MASAT PËR SHTIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E BLEGTORISË GJATË VITEVE 1951—1955» (Maj 1951)	213—216
BLEGTORIA NUK MUND TË SHTOHET PA SIGU- RUAR BAZËN E SAJ USHQIMORE — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (21 maj 1951)	217—219
TË KUPTOHET DHE TË ZBATOHEJ DREJT POLI- TIKA E PARTISË NË LIDHJE ME KUFIZIMIN EKO- NOMIK TË KULAKËVE — Letër udhëzuese dërguar komiteteve të Partisë në rrethe. (21 maj 1951)	220—224
MBI TË METAT DHE DOBËSITË NË PUNËN E KOMITETIT TË PARTISË DHE TË DREJTORISË SË KOMBINATIT TË NAFTËS «STALIN» — Nga dis- kutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (24 maj 1951)	225—238
TË NDIHMOHET MË SHUMË ORGANIZATA E GRUAS — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (1 qershor 1951)	239—242
MBI ROLIN DHE DETYRAT E KËSHILLTARIT DHE TË DEPUTETIT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (8 qershor 1951)	243—247
TREGËTIA TË KOMBINOJË MIRË PLANIFIKIMIN ME KËRKESAT E POPULLIT — Diskutim në	

- mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH
(11 qershor 1951) 248—253
- PËRGJEGJE LETRËS SË FSHATARËVE TË TURANIT
(12 qershor 1951) 254—257
- PARTIA NUK E DREJTON DREJTPËRDREJT MINIERËN,
POR E UDHËHEQ ATË NËPËRMJET DREJTORISË
DHE ORGANIZATAVE TË MASAVE
Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH
(22 qershor 1951) 258—262
- TELEGRAM PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR KQ TË
PK TË KINËS ME RASTIN E 30-VJETORIT TË FORMIMIT
TË SAJ (30 qershor 1951) 263—264
- MBI DISA DETYRA TË VEÇANTA PËR ORGANIZATËN
E PARTISË TË RRETHIT TË SARANDËS
Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH
(6 korrik 1951) 265—273
- TELEGRAM PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR QEVERISË
SË RP TË MONGOLISË ME RASTIN E 30-VJETORIT
TË REVOLUCIONIT POPULLOR MONGOL
(11 korrik 1951) 274—275
- TELEGRAM FALENDERIMI DËRGUAR ADMIRALIT MULEK
(14 korrik 1951) 276
- TELEGRAM PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR KQ TË
PK BULLGARE ME RASTIN E 60-VJETORIT TË KONGRESIT
TË PARË SOCIALIST (2 gusht 1951) 277—278
- MBI POLITIKËN E BLERJES DHE TË GRUMBULLIMIT
TË TEPRICAVE — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH (17 gusht 1951) 279—283
- PARTIA TA NDIHMOJË MË SHUMË RININË NË KRYERJEN
E DETYRAVE DHE NË FORCIMIN E ORGANIZATËS SË SAJ —
Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH
(17 gusht 1951) 284—289

TELEGRAM PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR SHOKUT HO SHI MIN ME RASTIN E 6-VJETORIT TË DITËS SË REVOLUCIONIT DHE TË PAVARËSISË SË RD TË VIETNAMIT (1 shtator 1951)	290—291
LETËR DËRGUAR DREJTORIT TË MUZEUMIT TË LUFTËS NACIONAL-ÇLIRIMTARE (1 shtator 1951)	292—295
MBI LIGJSHIMËRINË TONË SOCIALISTE DHE FORMIMIN E PUNËS NË ORGANET E DREJTËSISË Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (14 shtator 1951)	296—299
RAPORT «MBI DIREKTIVAT E PLANIT TË PARË PESEVJEÇAR 1951—1955» — Mbajtur në Plenumin XI të KQ të PPSH (21 shtator 1951)	300—355.
— <i>KUSHTET REALE PËR HARTIMIN E PLANIT TË PARË PESEVJEÇAR</i>	307—317
— <i>NGRITJA E INDUSTRISË — HALLKË KRYESORE PËR ZHVILLIMIN E EKONOMISË SOCIALISTE</i>	318—326
— MINIERAT	318
— INDUSTRIA	321
— <i>ZHVILLIMI I MËTEJSHËM I BUJQËSISË — NJË NGA DETYRAT MË TË RËNDËSISHME TË PLANIT TË PARË PESEVJEÇAR</i> ..	327—340.
— BUJQËSIA	327
— BLEGTORIA	339
— GRUMBULLIMET	340
— PYJET	340
— <i>TRANSPORTI</i>	341
— <i>NDËRTIMET</i>	342—344

— TREGËTIA	345
— ARËSIMI DHE KULTURA	346
— SHËNDETËSIA	347
— FUQIA PUNËTORE DHE PREGATITJA E KUADROVE	348—349
— REALIZIMI I PLANIT PESHËVJEÇAR KËRKON ORGANIZIMIN E MIRË TË PUNËS, SHEMBULLIN E KOMUNISTËVE DHE HEROIZMIN E MASAVE	350—355
MBI KRITERET PËR VAZHDIMIN E STUDIMEVE TË LARTA — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (5 tetor 1951)	356—358
MBI PREGATITJEN DHE NGRITJEN E KUADROVE TË PARTISË NGA RADHËT E KLASËS PUNËTORE Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (12 tetor 1951)	359—362
PËRSHËNDETJE DËRGUAR NDËRTUESVE TË FABRIKËS SË SHEQERIT «8 NËNTORI» ME RASTIN E MBARIMIT TË PUNIMEVE (31 tetor 1951)	363
NGA BISEDA NË TAKIMIN ME DELEGACIONIN E PUNONJËSVE TË NDËRTIMIT DHE TË SHFRYTËZIMIT TË FABRIKËS SË SHEQERIT «8 NËNTORI» (31 tetor 1951)	364—369
PËRSHËNDETJE DËRGUAR NDËRTUESVE TË KOMBINATIT TË TEKSTILEVE «STALIN» ME RASTIN E MBARIMIT TË PUNIMEVE DHE VËNJES SË TIJ NË SHFRYTËZIM (1 nëntor 1951)	370—371
PËRSHËNDETJE DËRGUAR NDËRTUESVE TË UJË-SJELLËSIT LANABREGAS—TIRANË—KOMBINAT I TEKSTILEVE «STALIN» ME RASTIN E MBARIMIT TË PUNIMEVE (2 nëntor 1951)	372

NGA BISEDA NË TAKIMIN ME NJË DELEGACION TË PUNONJËSVE TË HIDROCENTRALIT «LENIN» ME RASTIN E MBARIMIT TË PUNIMEVE (2 nëntor 1951)	373—381
PËRSHËNDETJE DËRGUAR NDËRTUESVE TË HI- DROCENTRALIT «LENIN» ME RASTIN E MBARI- MIT TË PUNIMEVE (3 nëntor 1951)	382—383
NGA BISEDA ME SHOKËT E KOMISIONIT PËR PËRKTHIMIN E VEPRAVE TË SHOKUT STALIN DHE ME PËRFAQËSUESIT E PUNONJËSVE TË SHTYPSHKRONJËS (4 nëntor 1951)	384—386
NGA BISEDA NË TAKIMIN ME DELEGATËT DHE GAZETARËT E HUAJ QË KANË ARDHUR NË VE- NDIN TONË ME RASTIN E 10-VJETORIT TË PPSH (5 nëntor 1951)	387—395
URDHËR PËR DHËNJEN E DRITËS ELEKTRIKE QYTETIT TË TIRANËS (7 nëntor 1951)	396
NGA FJALA NË TAKIMIN ME NJË DELEGACION TË PUNËTOREVE TË QYTETIT TË SHKODRËS (7 nëntor 1951)	397—406
URDHËR PËR DHËNJEN E UJIT TË SELITËS QY- TETIT TË TIRANËS (8 nëntor 1951)	407
FJALIM NË KONFERENCËN SOLEMNE ME RAS- TIN E 10-VJETORIT TË THEMELIMIT TË PPSH (8 nëntor 1951)	408—413
I. PARTIA ÇLIRI POPULLIN SHQIPTAR NGA ROBERIA DHE VENDOSI NË SHQI- PËRI DEMOKRACINË POPULLORE	414—435
II. NËN UDHËHEQJEN E PARTISË, SHQIPË- RIA U RINDËRTUA DHE POPULLI SHQIP- TAR NDËRTON NË VENDIN E TIJ BAZAT E SOCIALIZMIT	436—462

III. PARTIA NË LUFTË PËR MBROJTJEN E PAQES, TË PAVARËSISË DHE TË INTE- GRITETIT TË ATDHEUT	463—476
PA PËRMIRËSUAR METODËN E PUNËS NUK MUND TË NDREQEN GABIMET — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (15 nëntor 1951)	477—489
TË FORCOJME MË SHUMË PUNËN NË ORGANET E SIGURIMIT TË SHTETIT — Nga diskutimi në mble- dhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (15 nëntor 1951)	490—495
TELEGRAM URIMI DËRGUAR SHOKUT KLEMENT GOTVALD ME RASTIN E 55-VJETORIT TË DITË- LINDJES (23 nëntor 1951)	496—497

Shtypur NISH shtyp. «M. Duri», Stab. «8 NËNTORI» — Tiranë